

Vrojtime leksikologjike

Frazeologjizmat në FGJSSH të vitit 1980

Mr. Agim Spahiu

18 qershor 2008

Përmbledhje

Frazeologjia është njëra nga katër disiplinat e njohura të fushës së leksikologjisë. Ajo ka për bazë të studimit idiomat, njësitë dhe bashkimet frazeologjike në një gjuhë të caktuar. Pra, ato mund të vështrohen në disa rrafshë: në rrafshin sinkronik dhe diakronik në një gjuhë të vetme ose në disa gjuhë ku synohet të vihen në dukje pikëpërkimet dhe pikëdallimet në mes tyre. Gjuha shqipe është shumë e pasur me frazeologjizma, me të gjitha tipat e njohura. Ajo është mbledhur dhe shpjeguar teorikisht mjaft mirë edhe në gjuhën tonë. Për këtë disiplinë gjuhësore ne sot kemi disa dhjetëra studime, artikuj e madje edhe monografi në gjuhën shqipe. Edhe hartuesit e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe i kanë kushtuar vëmendje të madhe kësaj njësie gjuhësore, ngase çdo fjalë është vështuar edhe nga ky aspekt. Në Fjalor është shënuar nën kllapa 'edhe në një varg togjesh, njësisë etj. frazeologjike', por edhe në radhitjen me një yll në fund të fjalëve emërtuese, sidomos. Prandaj, e pamë të udhës që në këtë shkrim ta bëjmë një prezantim të tërësishëm të korpusit gjuhësor të frazeologjisë në këtë Fjalor. Po së pari të shohim se ç'është frazeologjia në thelb?

Në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980 termin **FRAZELOGJI** e gjejmë të definuar në këtë mënyrë:

Tërësia e togjeve dhe e thënieve a e shprehjeve të qëndrueshme të një gjuhe, të cilat janë të pandashme nga ana leksikore, kanë kuptim tërësor, të njësisishëm, të mëvetësishëm e gjithnjë të figurshëm, riprodhohen në ligjërim si njësi të gatshme dhe kryejnë funksionin e një fjale a të një fjalie të vetme.

Është njësi gjuhësore me karakteristike e një gjuhe. Pse themi kështu? Sepse një prej elementeve të rëndësishme që e karakterizon dhe e shquan një gjuhë nga të tjera është pikërisht frazeologjia. Me të del në pah origjinaliteti dhe veçantia e saj. Shqiptarët zakonisht thonë: **Mos i fut hundët kudo!**, **M'u bë zemra mal**, **Bëj pallë**, **Dikush thumbit**, **dikush patkoit**, **Dushk për gogla**, **As për peng e as për dorëzon**, **S'është as i huntit as i litarit**, **E hedh gurin e fsheh dorën**, **Ia ktheu shpinën (kurrizin) dikujt**, **Ai të çon me pi e të kthen pa pi ujë**, **Shkoi t'i nxjerrë brirët e i la edhe veshët**, **Nuk i bihet murit me kokë**, **Nuk lëshon pe**, **E hëngri kokën**

e vet, **Hoqi** të zitë e ullirit, **I** hedh hi syve, **Po** i kruhet prapanica, **E** mbajti fjalën, **E** hëngri fjalën, **E** mori më qafë, **E** la pa mend në kokë, **Iu** bë gjaku ujë, **E** qiti për fushe, **Nuk** shkel në dërrasë të kalbur / ka shkelur në dërrasë të kalbur/, **I** shkoi koka, **Shet** mend, **Petulla** në ujë, **Atij/** asaj/ nuk i zihet besë, **Ia** shkeli rrota bishtin etj..

Këto njësi a shprehje frazeologjike nuk i përdorin popujt dhe gjuhët e tjera. Madje as ata rreth nesh. Këto janë karakteristike vetëm për gjuhën shqipe. Prandaj në të qëndron veçantia e saj, origjinaliteti.

Edhe nga përkufizimi i mësipërm pamë se frazeologjizmat duhet t' i kenë këto elemente: **1. Qëndrueshmërinë e fjalëve ose e elementeve përbërëse; 2. Pandarshmërinë e elementeve përbërëse; 3. Njësueshmërinë tërësore, kuptimore e figurative të elementeve përbërëse; 4. Mosndërtimin ose mosformimin e tyre në momentin e ligjërit, meqë janë të gatshme; 5. Brasvlerësinë e tyre me një fjalë të vetme, nga aspekti kuptimor (kjo fjalë e vetme mund të jetë sinonimike me togun frazeologjik, po jo krejtësisht identike me të), ndërsa nga aspekti gramatikor i tërë togu frazeologjik ka vlerën dhe kuptimin e fjalëve emërtuese (Fjalë emërtuese, sikundër dihet, konsiderohen: emrat, mbiemrat, foljet dhe ndajfoljet), përkatësisht si një gjymtyrë fjalie (si gjymtyrë kryesore ose e dytë e fjalisë); 6. Shumëkuptimësinë tyre, varësisht nga konteksti i përdorimit; etj..**

Këto janë ndërtime kryesisht popullore, d.m.th. kanë karakter dialektor. Por një pjesë e madhe e tyre sot kanë gjetur një shtrirje pothuaj në të gjitha treva shqipfolëse.

Kjo njësi gjuhësore është vjelë mjaft mirë nga goja e popullit. Dhe për këtë gjë janë hartuar edhe disa fjalorë frazeologjikë¹.

Është studiuar mjaft mirë edhe nga aspekti shkencor. Vlen të përmendet me këtë rast studimi monografik i J. Thomajt me titull **Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipes**, botuar në Tiranë më 1981.

Në këtë shkrim vëmendjen e kemi përqendruar po në këtë çështje. Por kësaj çështjeje i jemi qasur nga një këndvështrim tjetër: Këtu kemi marrë për bazë **Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe** dhe, me ndihmen e programeve standarde të LINUX-it, kemi nxjerrë të gjitha ndërtimet gjuhësore që kanë vlerë dhe kuptim frazeologjik dhe kështu kemi 'krijuar', si të thuash, një Fjalorth të frazeologjizmeve. Këtë e kemi bërë për të vetmen arsye që lexuesi ta ketë në dorë një vëllim më komplet e kompakt dhe më të lehtë për shfrytëzim.

Në këtë **Fjalorth** i kemi përfshirë edhe ndërtimet të përafërta me to siç janë: frazeologjizmat letrarë, siç janë: *proverbat, fjalët të urta, gjë e gjëzat etj.* dhe termat **terma të pathjeshtë**, ngase janë ndërtime të qëndrueshme dhe përdoren me kuptim të dytë a të figurshëm, si p. sh.: **Ari i bardhë** për pambukun, **ari i zi** për naftën, **molla e Adamit** për fikthin në anatomi etj., ndërsa janë lënë anash ndërtimet e qëndrueshme të përhershme që emërtojnë frymorë, gjësende etj., pa ndonjë kuptim të theksuar figurativ,

¹Këtu do përmendur fjalorin e M.Gjevorit *Frazeologjizma të gjuhës shqipe*, të botuar në Prishtinë më 1988, pastaj atë të H. Bogajt *Frazeologjizmat popullore në Drenicë*, botuar më 1990; *Fjalor frazeologjik ballkanik*, botuar në Tiranë më 1999, nga një grup autorësh, *Fjalor i shprehjeve frazeologjike anglisht-shqip*, botuar më 1990 nga V. Nuhiu; *Fjalor i shkurtër frazeologjik rusisht-shqip*, botuar nga Z. Sadiku më 1990; *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, botuar në Tiranë më 1999 nga J. Thomaj etj.

si fjala vjen: **çelësi anglez, asistencë sociale, koha e kryer e thjeshtë** (në gjuh.) etj.

Këtu në vazhdimësi po e prezantojmë në tërësi këtë **Fjalorth të frazeologjizmave** nga FGJSSH i vitit 1980:

- ABANOZ** m. bot. U bë abanoz rroi shumë kohë, jetoi gjatë.
- ABSOLUT** mb. Shumicë absolute shumicë që e kalon gjysmën e tërësisë së numëruar, shumicë dërrmuese.
- ADET** m. bised. Si adeti shumë i mirë, shumë i bukur.
- ADRESË** f. Na harroi adresën shak. shih te **HARROJ**.
- AFAT** m. S'i jap afat dikujt e ngut tepër, e shtrëngo, s'e lë të marrë frymë.
- AFËR** Është afër mendsh (mendjes) kuptohet vetvetiu; është fare e qartë. Është më afër mendsh (mendjes) ka me shumë të ngjarë, është më e mundshme. Është me afër dera se qilari fj. u. shih te **DER/Ë,~A**.
- AFROHEM** vetv. Nuk i afrohet (nuk i vjen) as te gishti (te thoi) i këmbës shih te **GISHT,~I**.
- AG** m. Agu i syrit bebja e syrit; pikë e bardhë, që del në sy. I kanë vënë ag sytë
- AGIM** m. Agimi polar shih te **POLAR,~E**.
- AGMI** f. Agmi njeri, njeri me shpirt të kulluar, njeri zemërbardhë e i dashur.
- AGULL** m. Më bëjnë sytë agull më vishen, më mjegullohen sytë.
- AGZOT** m. Në flakë të agzotit aty për aty, në mënyrë të rrufeshme. Mbaj agzotin të thatë mbaj barutin të thatë.
- AGJËROJ** jokal. Agjëron ditën e vjedh natën keq. paraqitet i mirë, por në të vërtetë është i keq.
- AH II** m. Me ah e me bah me rënkime të mëdha, duke u ankuar për çdo gjë. Lë në ahe lë në mjerim, në vuajtje.
- AHENG** m. bised. Dasmë pa aheng punë së cilës i mungon gjëja kryesore, gjellë pa kripë.
- AHUR** m. Si kali në ahur shih te **KAL/Ë,~I**. Lë në ahur dikë e trajtoj keq një njeri, nuk tregoj asnjë kujdes për dikë. Është bërë shtëpia ahur është fëlliqur shtëpia e është bërë rrëmujë. Ka plak (zot) ahuri ka kush i del zot një pune, ka kush e mbron një gjë. Pastroj ahuret e Augjiasit libr. vë rregull aty ku ka rrëmujë të madhe, përmirësoj me masa rrënjësore e të shpejta një gjendje me të meta të shumta të grumbulluara prej kohësh.
- AI** përem. Në atë mes shih te **MES,~I**. Që ç'ke me të shih te **KAM**. Java shtatë ai tetë shih te **JAV/Ë,~A**. I kam hipur atij kali shih te **HIPI**.
- AJAR** m. vjet. Bëj ajar peshoj, mat (edhe fig.); rregulloj; ndreq
- AJËR** m. Qëndron (mbetet) në ajër është pa mbështetje, mbetet pezull. Ngre (ndërtton, bën) kështjella në ajër (në erë) keq. shih te **KËSHTJELL/Ë,~A**.
- AJKË** f. E ka gojën ajkë është gojëmbël, flet butë. I rritur me ajkë qumështi i rritur me gjithë të mirat, në mes të të mirave. E shet shkumën për ajkë shih te **SHKUM/Ë,~A**.
- AJO** përem. Ajo botë (jetë) bota tjetër sipas paragjykimeve fetare e idealiste. I ra në të (në fije, në fill) shih te **FIJ/E,~A**. S'ka gjë në të shih te **KAM**.
- AJROR** mb. Oqeani ajror libr. atmosfera.
- AKADEMIK** mb. Mbrëmje akademike mbrëmje me karakter solemn, që i kushtohet përkujtimit të një ngjarjeje të rëndësishme.
- AKOMA** ndajf. Akoma ti?!

- AKORDOJ** kal. I akordoi telat me dikë keq. është marrë vesh, ka rënë në ujdi me dikë.
- AKREP** I m. M'u bë akrep m'u bë ferrë, s'e shoh dot me sy.
- AKSHAM** m. vjet. Lule akshami bot. shih te LUL/E,~JA.
- AKTIV** II mb. fin. Bilanc aktiv libr. gjendje kur janë arritur shumë suksese në punë.
- AKULL** m. Me akull të mendjes libr. me gjykim të ftohtë, me arsye të ftohtë. Jam (kam mbetur) akull jam (kam mbetur) pa asgjë, jam pa një lek në xhep. Shkriu akulli nisi një ndryshim për të mirë, zunë të përmirësohen kushtet e të kapërcehet një gjendje e vështirë. E shkruaj në akull e quaj të humbur diçka. Thyej (çaj) akullin libr. bëj hapin e parë e më të vështirë, hap i pari shtegun për të tjerët në një punë që ka ngecur në vend. M'u bë zemra akull më ngriu zemra nga frika, nga dëshpërimi, nga një fatkeqësi. E ka mendjen akull e ka gjykimin të kthjellët, e ka mendjen të ftohtë. Ngul këmbët në akull jam pa mbështetje, nuk kam ku të mbahem. Akull i thatë spec. gaz karbonik i ngurtësuar. Xham akulli shih te XHAM,~I 3. Lule akulli bot. shih te LUL/E, ~JA.
- AKUMULIM** m. Akumulimi fillestar i kapitalit ek. proces historik, gjatë të cilit prodhuesve të vegjël, sidomos fshatarëve, iu morën me forcë mjetet e prodhimit dhe u krijua prona e madhe kapitaliste.
- AKUZUAR** m. drejt. Në bankën e të akuzuarve shih te BANK/Ë,~A I.
- ALARM** m. E bëj alarm e bëj diçka problem shqetësues për të gjithë, shpesh pa nevojë.
- ALBËR** f. Trembet nga një albër trembet nga një punë a nga një vështirësi fare e vogël.
- ALEM** m. vjet. Alemi e polemi mbarë bota, të gjithë njerëzit.
- ALET** m. bised. vjet. Me alete në brez i përgatitur për çdo rrethanë, i gatshëm për çdo rast.
- ALFA** f. palak. Alfa dhe omega fillimi dhe fundi i diçkaje; gjëja kryesore, themelore. Nga alfa tek omega nga fillimi deri në fund, nga a-ja te zh-ja.
- ALFABET** m. Alfabeti telegrafik (Mors) sistemi i shenjave me pika e vija, që përdoren në telegrafi për të dhënë shkronjat.
- ALILLUJA** pasth. fet. vjet. I këndon allilluja dikujt keq. i thur lëvdata të tepruara dikujt; i bën lajka; i shkon pas avazit.
- ALL** mb. Lule alle bot. shih te LUL/E,~JA.
- AMË** I f. Doli nga ama i kaloi kufijtë, e shkeli rregullin e zakonshëm e të lejueshëm. E shtie në amë e sjell përsëri brenda kufijve, e vë në udhë.
- AMË** II f. S'merr amë nga diçka nuk e njeh diçka, nuk merr erë nga një punë etj.
- AMIN** pj. fet. vjet. Amin, o hoxhë thjeshtilig. përdoret për një njeri që pajtohet vend e pa vend me çdo mendim e veprim të një tjetri. Bën (thotë) amin pranon çdo gjë, që thotë një tjetër; ia ushqen fjalën, i vete pas avazit.
- AMULL** m. Të daltë amulli! mallk. mbetsh në vend pa lëvizur, u myksh.
- ANALIZË** f. Në analizë të fundit libr. pasi është shqyrtuar nga të gjitha anët, në fund të fundit.
- ANASH** ndajf. I kaloj anash një çështjeje (një problemi) përpiqem t'i shmangem, ta kapërcej pa i dhënë rëndësi.
- ANDEJ** Andej e këtej (sa andej këtej)
- ANDRALLË** f. bised. Me vjen andrallë më merren mendtë, më vjen koka vërdallë.
- ANEPËRQARK** ndajf. E sjell anepërqark e sjell rrotull. ç
- ANË** I f. Nga ana e dikujt lidhur me njeriun që bën a që thotë diçka, për dikë. Nga ana e burrit (e gruas, e vëllait, e babait...) në vijën e lidhjes familjare me burrin (gruan, vëllanë, babanë...). Me anën e dikujt me ndihmën e dikujt, nëpërmjet dikujt. Me anë të diçkaje (me anën e diçkaje) me një mjet, me një mënyrë a me një rrugë; me ndihmën e..., me. Nga njëra

- (një) anë... nga ana (me anë) tjetër përd. fj. ndërm. përdoret kur kundërvihen dy fakte, dy rrethana, dy kënde vështrimi, dy rrugë zgjidhjeje etj. Në anën tjetër të barrikadës shih te **BARRIKAD/Ë, ~A**. Ana e keqe euf. djalli. Ana tjetër e medaljes shih te **MEDALJ/E, ~A**. Dal (e nxjerr) në anë (e) shpëtoj nga një e keqe, kapërcej një vështirësi. S'ia di anën diçkaje nuk e di ku e ka burimin, shkakun diçka. Ia gjej anën
- ANËS** I vjen anës shih te **VIJ**. Vjen anës (rrotull, rreth) për shi (për borë) shih te **RROTULL**.
- ANGLEZ** mb. Çelës anglez tek. çelës që me anë të një burme mund të përshtatet për bulona me madhësi të ndryshme.
- ANKAND** m. Nxjerr (vë) në ankand diçka bën tregti me një gjë të shenjtë e të shtrenjtë për dikë, e cila as që duhet të mendohet se mund të shitet e të blihet.
- ANKOJË** f. keq. Moj dhelpër, moj ankojë, shumë armiq zure në gojë! iron. shih te **DHELP/ËR, ~RA**.
- ANOJ** jokal. Nga anon balanca shin te **BALANC/Ë, ~A 2**.
- ANONIM** mb. Shoqëri anonime shoqëri akcionare në vendet kapitaliste, që nuk mban emrin e asnjërit nga pjesëtarët e saj.
- AQ** Aq sa
- AR I** m. Ari i bardhë pambuku. Ari i gjelbër drurët e pyllit si lëndë e vlefshme për ndërtim e për orendi. Ari i zi nafta ose qymyrguri. Fjalë ari fjalë të vërteta e me vlerë, fjalë me vend; fjalë e urtë. I ra ari në ujë u zemërua, i mbeti hatëri.
- ARAB** mb. Shifrat arabe shenjat e sotme të numrave (1, 2, 3...), të ndryshme nga shifrat romake.
- ARABIK** mb. Gomë arabike lloj rrëshire që ngrin shpejt, e cila nxirret nga disa akacie dhe përdoret si ngjitës në industrinë e tekstile, në shtypshkronja etj.
- ARALLËK** m. vjet. Lë arallëk lë shteg, lë vend.
- ARAP** m. U bë lesh (flokë) arapi shih te **LESH, ~I**.
- ARAPASH** m. gjell. I është bërë goja për arapash i kanë rënë dhëmbë e dhëmballë.
- ARDHËM** mb. Koha e ardhme gjuh. kohë e foljes, që tregon se veprimi ose gjendja e shprehur prej saj pritet të ndodhë a të vijë pas çastit të ligjërit.
- ARDHSHËM** mb. Koha e ardhshme gjuh. shih tek **ARDH/ËM (i), ~ME (e)**.
- ARË** f. Flet në arë e në vresht flet në tym, kot, kuturu. I tregon (i rrëfen) babait arat iron. shih te **BABA, ~I**. E bën arë e hamull i përhap fjalët në të katër anët, është llafazan i madh. E hante grurin që në arë shih te **GRUR/Ë, ~I**. Kam ujin në arë shih tek **UJ/Ë, ~I**. Bjer shi në arën time thuhet për njerëz që shohin vetëm interesin e tyre të ngushtë, që mendojnë vetëm për vete. Kur s'ke ara në mal, pse bën dava me çakejtë? fj. u. mos u ngatërro në një punë që nuk të përket.
- ARËZ** f. Fole arëzash (grerëzash) keq. shih te **GRERËZ, ~A**.
- ARGJEND** m. Bar argjendi bot. këputje. Lule argjendi bot. shih te **LUL/E, ~JA**.
- ARGJENDTË** mb. Dasma e argjendte libr. Njëzetepesëvjetori i martesës së një çifti.
- ARGJILË** f. Kolos me këmbë argjile mospërf. shih te **KOLOS, ~I**.
- ARI** m. S'ngopet ariu me miza fj. u.
- ARKË** f. Arkë e dry të lidhur si mish me thoin njëri me tjetrin, të pandarë njëri nga tjetri. Fundi i arkës shih te **FUND, ~I**. Është arkë e mbyllur dikush shih te **MBYLLUR (i, e)**. E ka gojën arkë nuk nxjerr fjalë nga goja, i ruan mirë të fshehtat.
- ARKIV** m. E lë (e fut) në arkiv libr. e lë në harresë, nuk merret më me të.

ARMATOSUR mb. I armatosur gjer (deri) në dhëmbë shih te DHËMB, ~L Asnjanësi e armatosur mosndërhyrje në një luftë, qëndrim mënjane duke qenë i gatshëm për luftë. Forcat e Armatosura te Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë shih te FORC/Ë, ~A.

ARMË f. Shok armësh bashkëluftëtar; shok i ngushtë në përpjekjet për të arritur një qëllim politik e ideologjik të përbashkët. Shesh armësh vend ku përgatiten dhe prej ku mund të, fillojnë veprime luftarake kundër një vendi tjetër. Me armë në dorë i gatshëm për luftë; pa u dorëzuar, duke luftuar. Me forcën e armëve me forcë, me dhunë ushtarake. Bashkojmë armët bashkojmë forcat, luftojmë së bashku krah për krah. Dorëzoi (dha, hodhi, la, lëshoi, uli) armët pushoi luftën, nuk bëri më qëndresë, u dorëzua. I kthej armët (armikut) shih te KTHEJ. Mat armët me dikë hyj në betejë me dikë, ndeshem, mat forcat në luftë me kundërshtarin. Mpreh armët shih te MPREH. Rrëmbej (rrok) armët (pushkët) shih te RRËMBEJ.

ARMIK m. Nën bajonetën e armikut shih te BAJONET/Ë, ~A.

ARNË f. U ndesh arna me thesin gjeti tenxherja kapakun. Ia kanë qepur arnën dikujt i kanë vënë një njollë; e kanë vënë në shenjë për të keq.

ARNOHEM vetv. E gjerr ku s'arohet shih te ÇJERR.

ARNOJ kal. Gris (prish) gjirin, arno pëqirin! fj. u. shih te GRIS.

ARSYE f. Për arsye se... sepse, nga që, për shkak se... Nuk hante arsye shih te HA 13. I jap arsye dikujt

ART m. Arti për art parimi themelor i një teorie estetike reaksionare, që e sheh artin si qëllim në vetvete, të shkëputur nga përmbajtja, nga jeta shoqërore e politike dhe nga detyra për t'u shërbyer masave të gjera. Vepër arti ndërt. objekt

në vepra të mëdha, si në rrugët, hekurudhat, kanalet etj., ndërtimi i të cilit kërkon një punë të veçantë.

ARTË mb. Çelës i artë libr. mjet për të zgjidhur çdo gjë, shkop magjik. E mesmja e artë (mesi i artë) keq. qëndrim i mesëm, as andej as këtej; qëndrim ose veprim që nuk të çon në ndeshje me dy palët e kundërta dhe që lejon të përfitosh nga të dyja anët. Moshë e artë libr. koha më e bukur në jetën e njeriut, vitet e rinisë. Shekulli i artë (koha e artë) koha e lulëzimit më të madh të shkencave e të arteve në historinë e një vendi. Libër i artë libër nderi, në të cilin shënohen emrat e njerëzve më të shquar. Shkruaj me shkronja të arta përjetësoj diçka të shënuar a të lavdishme. Prerja e artë mat., art. ndarja e një segmenti në dy pjesë, në mënyrë që njëra pjesë të jetë e mesmja e përpjesëtueshme ndërmjet gjithë segmentit dhe pjesës tjetër. Rregulla e artë e mekanikës fiz. parimi i ruajtjes së punës, sipas të cilit në çdo makinë, kur mungojnë forcat e fërkimit, puna lëvizëse është e barabartë me punën e qëndresës.

ARUSHË f. Luan arushë me dikë keq. tallet me dikë, e sjell vërdallë sipas qejfit të tij. T'i lë këmbët e arushës në dorë shpëton vetë duke ia lënë rrezikun, barrën a kokëçarjet një tjetri; ia hedh dikujt. Nuk trembet arusha (ariu) me shoshë shih te SHOSH/Ë, ~A. Arusha e Madhe astr. emër i një yllësie në gjysmërruzullin verior të qiellit, që përbëhet nga shtatë yje të renditura si qerre; Qerrja e Madhe. Arusha e Vogël astr. emër i një yllësie në gjysmërruzullin verior të qiellit, që përbëhet nga shtatë yje të renditura si qerre, njëri nga të cilët (ylli i bishtit) është Ylli Polar i Veriut; Qerrja e Vogël. Lule arushë bot. dorëzonjë. Rrush arushe bot. shih te RRUSH, ~I.

ARRATI f. I dha arratinë e detyroi të largohet me ngut e në mënyrë të çrregullt, e bëri të ikte nga sytë këmbët, t'ua mbathte këmbëve nga frika. Mori arratinë

- ARRË** f. Arrë fyçkë keq. shih te FYÇK/Ë, ~A. Arrë në gojë diçka që nuk kapërcehet, nuk gëlltitet lehtë; dikush a diçka që nuk mposhtet lehtë, kockë në fyt. Shtagë arrash shih te SHTAG/Ë, ~A. Si fiku (me) arrën (si arra me palën) shih te FIK, ~U. I marr (i ha) arrat dikujt jam më i zoti se një tjetër, ia kaloj dikujt, ia hedh, e mund. S'i hahet arra në dorë dikujt nuk mbahet pastër, as lahet as ndërrohet, është shumë i ndyrë. S'i mban goja arra dikujt s'pushon së foluri, është llafazan i madh. Të thyen arrën në dorë shih te THYEJ. Thyej arra kot flas gjëra pa vlerë e pa kuptim, flas kot me kot. I peshon arrat pa i shkundur shih te PESHOJ. E shkund arrën në korrik (manin në prill) shih te SHKUND. Kur të bëjë qarri arra kurrë, asnjëherë.
- ARRËZ** I f. anat. Theu arrëzën shih te THYEJ. Thyej (këput) arrëzën (qafën)! keq. largohu që këtej, shporru! Zuri arrëzën u rrëzua e u vra, theu qafën.
- ARRIJ** kal. dhe jokal. Aq të arrin ty (mendja)! aq ta pret mendja, aq mendon. Aq sa arrin aq sa mund ta kuptojë, sipas fuqisë e aftësisë mendore që ka. Sa i arrin dora shih te DOR/Ë, ~A. S'më arrin dora nuk kam fuqi, nuk kam mundësi.
- AS** I m. Më doli asi fitova, më eci.
- AS** 4. Përdoret në një varg togjesh të qëndrueshme frazeologjike me vlerë mohuese.
- ASGJË** pakuf. E bën për asgjë nuk e përfill fare, e përbuz. Nuk ka asgjë të përbashkët me dikë shih te PËRBASHKËT (i,e).
- ASGJËKUND** ndajf. S'është asgjëkundi nuk është aspak në rregull, nuk e ka fare në vijë një punë. Ku ishe? Asgjëkundi. thuhet duke e bërë pyetjen e duke u përgjigjur vetë, kur themi diçka ose bëjmë një punë pa pasur ndonjë fryt konkret.
- ASISTENCË** f. libr. Asistencë sociale shih te SOCIALE.
- ASNJË** pakuf. Asnjë për be shih te BE, ~JA. (Për) asnjë çast vazhdimisht, pa ndërpreje, asnjëherë. Në asnjë mënyrë aspak, kurrën e kurrës. Asnjë për fare shih te FAR/Ë, ~A. Pa asnjë dyshim (s'ka asnjë dyshim) si fj. ndërm. patjetër, medeoemos. Një si asnjë fj. u. shih te NJË. Asnjë qime (fije floku) shih te QIM/E, ~JA.
- ASPËR** f. vjet. U shit për tridhjetë aspra tradhtoi, u hodh në anën kundërshtare për një shpërblim të vogël.
- ASHËR** I f. Ashër e pisë (i zi) shumë i zi. M'u bënë ashër (ashra-ashra) m'u plasaritën, m'u ashpërsuan (për duart, gjuhën etj.). Janë bërë ashër u ka hyrë grindja, janë zënë; janë përçarë.
- ASHKË** f. S'merr ashkë nuk gdhendet, nuk merr vesh, nuk ha arsye. E ka një ashkë nga dikush e ka një lidhje gjaku me dikë, ka diçka të trashëguar prej dikujt. Nuk i veton (as që i veton) ashka e syrit dikujt nuk ka frikë fare, as që do t'ia dijë, është trim i madh.
- ASHKËL** f. S'lëshon ashkël nuk gdhendet, nuk merr vesh, nuk ha arsye. Ia mbush kokën me ashkla e mërzit me fjalë të kota, me cikërrima. Asnjë ashkël nuk i hiqet nuk shqetësohet fare, nuk bëhet merak. ASHKLA-ASHKLA ndajf. U bënë ashkla-ashkla u zunë e u ndanë njëri nga tjetri, u përçanë.
- ASHT** I m. I ka shkuar (i ka vajtur) thika në asht (në kockë) shih te THIK/Ë, ~A.
- ASHTU** ndajf. Kështu ose ashtu shih te KËSHTU. Ashtu (kështu) i do mushka drutë shih te MUSHK/Ë, ~A.
- ASHURE** f. E bëj ashure e ngatërroj, e përziej një punë, e bëj lëmsh.
- ATA** II përem. vjet. bised. Ç'qe ata? vjet. si ndodhi? si rastisi? si qe puna? Ç'qe ata! vjet., iron. Çudi! Si është e mundur! Si mund të ndodhte! Ç'është ata! vjet. Përdoret si përgjigje për ta qetësuar bashkëbiseduesin, duke e siguruar se diçka do të bëhet, me kuptimin: patjetër, pa asnjë dyshim.

- ATË** m. Atë pas ati brez pas brezi.
- ATËHERË** ndajf. Atëherë kur ... në atë kohë që, në vend që, ndërsa.
- ATILLË** mb. dëft. I atillë e i këtillë përdoret për të zëvendësuar fjalët vlerësuese, zakonisht sharëse, që janë thënë për dikë. Diçka e atillë pak a shumë ajo gjë, afërsisht ashtu.
- ATJE** ndajf. Atje tek (atje që) vjet. në vend që. Bam këtu, bam atje (bam këtej, bam andej) shih te BAM. Kokën këtu, këmbët atje shih te KËMB/Ë,~A. Qeni leh atje ku ha fj.u. keq. shih te QEN,~I.
- ATO** përem. Ato të grave euf. zakonet, të përmuajshmet e grave. Në ato (e sipër) ndërkaq, në atë kohë. S'bie në ato ujëra edhe poh. shih tek UJ/Ë,~I.
- ATOMIK** mb. Ombrellë atomike shih tek OMBRELL/Ë,~A 3.
- ATY** ndajf. Aty për aty menjëherë, në çast, shpejt e shpejt, sakaq; në atë çast. Aty afër afërsisht, rreth, pothuaj. Aty edhe... deri, edhe, madje. Aty ta kam! shih te KAM. Aty më rri thjeshtligj. ndalu në atë çështje, mos u largo nga ajo pikë. Lindi (leu) e mbin aty shih te LIND. Nuk e ka mendjen aty (në vend) shih te VEND, ~ I.
- AURORË** f. libr. Aurora boreale agimi polar i Veriut, agimi verior.
- AUTOMATIK** mb. Çelës automatik shih te ÇELËS,~I 1.
- AVANCË** f. bised. Me avancë... para afatit, para kohës së caktuar.
- AVAZ** m. bised. Avazi i Mukës keq. gjë e vjetër, që është thënë e stërthënë; diçka e njohur, që është përsëritur vazhdimisht. (Këndo, i heq këmbët, i hedh hapat) sipas avazit të dikujt keq. sipas dëshirave të dikujt, siç ka qejf ose siç me porosit dikush. I bie një (po atij avazi) (mban një avaz) keq. vepron në të njëjtën mënyrë ose flet po të njëjtat gjëra, i bie fyellit në një vrimë. I mban avazin (i shkon pas avazit, i vete pas avazit) i shkon pas qejfit, vepron sipas dëshirave e porosit të dikujt. Ia mban avaz ia përmend vazhdimisht, ia përsërit shumë herë, ia mban këngë.
- AVLËMEND** m. Ia ka shtrënguar avlëmendit (vegjës) shih te SHTRËNGOJ.
- AVULL** m. Marr avull nxehem, zemërohem. Ia marr avullin e njoh mirë diçka a dikë; ia marr dorën. Ia mori avullin dikujt e mundoi shumë, ia mori frymën, ia mori shpirtin.
- AVULLOHEM** vetv. Iu avullua gjaku u zemërua shumë, u nxeh tepër.
- AVULLOJ** kal. Më avullon koka kam shumë shqetësim e telashe, më zien koka.
- BABA** m. Për shpirt të babait iron. shih te SHPIRT,~I. S'ia jap për shpirt të babait s'ia jap falas, për asgjë (për diçka që jepet pa dëshirën e të zotit).
- BABË** m. Babë pas babe e djalë pas djali brez pas brezi. Të vë babën burrë keq. është shpifës i madh. Të kërkon babën e nënën kërkon shumë shtrenjtë.
- BABO** f. vjet. Shumë babo e mbytin fëmijën fj. u. kur ndërhyjnë shumë veta në një punë, e prishin në vend që ta ndreqin.
- BABUNE** f. Ia ktheu huan me babune ia mori hakun me të tepërt.
- BADËR** f. E bëri badër e shkatërroi krejt diçka, e bëri fije-fije; e bëri pluhur e hi.
- BAFT** m. bised. vjet. Tafti-bafti shih tek TAFT,~I.
- BAGËTI** f. Me shtëpi e bagëti shih te SHTËPI,~A. Mbeti si bariu pa bagëti shih te BARI,~U.
- BAH** pasth. bised. Me ah e me bah shih tek AH,~U II.
- BAHÇE** f. bised. Bahçe (kopsht) me lule shih te KOPSHT, ~I. I lulon bahçja (edhe) në dimër shih te LULOJ.
- BAHÇEVAN** m. bised. Qen bahçevani (kopshti, kopshtari) keq. shih te KOPSHT, ~I.

- BAJAT** mb. bised. Mall bajat shih te MALL,~I II 3.
- BAJGË** f. I bëri bajgën dikujt a diçkaje thjeshtligj. E braktisi dikë a diçka pa çarë kokën për të. Iu bë bajgë dikujt thjeshtligj. iu nënshtrua plotësisht, iu qep e i lëpihet për t'i bërë qejfin. E lëshon bajgën thjeshtligj. nuk ka kujdes fare, nuk di as vetë se ç'bën, e bën një punë shkel e shko; flet pa u menduar, pa i peshuar fjalët. I lëshon fjalët si lopa bajgën thjeshtligj. flet fare pa përgjegjësi e pa u menduar, nuk di as vetë se ç'thotë. Iu ngjit si bajga (si balta) pas këpucës thjeshtligj. iu ngjit nga pas e nuk i ndahet; e mërziti shumë, iu bë rrodhe.
- BAJONETË** f. Me forcën e bajonetës keq. me armë, me dhunë. Nën bajonetën e armikut në mes të rrezikut.
- BAJRAK** m. Është me bajrak keq. është me nam të keq, është i njohur prej të gjithëve. Ndërroi bajrak tradhtoi, ndërroi flamur.
- BAKALL** m. vjet. Deftër bakalli keq. regjistër i mbajtur keq, i fëlliqur e gjysmë i grisur. Pusullë (letër) bakalli keq. shkresë a letër, e shkruar në kartë të keqe, jo sipas rregullave dhe e mbajtur fare pa kujdes.
- BAKALLËK** m. kryes. sh. vjet. Bën bakallëk me diçka e trajton diçka si plaçkë tregu, bën pazarllëk me të.
- BAKËR** m. Me bakra e me çakra me të gjitha gjërat, me çdo gjë që ka, me laçkë e me plaçkë.
- BAKLLAVA** f. Nuk bëhet bakllava me miell thekre fj. u. nuk bëhet mirë një punë kur mungojnë mjetet e nevojshme. Ka (kërkon të ketë) njërën dorë në bakllava dhe tjetrën në revani (në mjaltë, në kabuni) përb. shih te DOR/Ë,~A.
- BALANCË** f. libr. Vë në balancë e shqyrtoj mirë diçka për ta vlerësuar ose për ta krahasuar me një tjetër, e peshoj. Është në balancë kërkohet një zgjidhje për diçka, vendoset për diçka.
- BALASH** mb. Njihet si kau (si kali) balash dallohet mirë midis të tjerëve, njihet menjëherë; e tregojnë me gisht.
- BALO** m. Ku lë laroja të hajë baloja keq. shih te LARO,~JA. Kape laro, prite balo! tall. s'e merr vesh i pari të dytin, se secili bën sipas kokës.
- BALONË** f. Balonë prove libr. mjet që përdoret për të hetuar mendimin e të tjerëve për diçka, për të njohur mendimin e përgjithshëm rreth një çështjeje.
- BALOSH** m. Nuk e pyet as për osh as për balosh shih tek OSH,~I.
- BALSAM** m. I vuri (i derdhi) balsam e qetësoi; e ngushëlloi. Lule balsami bot. shih te LUL/E,~JA.
- BALTË** f. Baltë e dobët
- BALLAFAQE** ndajf. Vë (bëj) ballafaqe ballafaqoj.
- BALLË** I m. Ballë për ballë
- BALLGAM** m. E kam ballgam në zemër më rëndon e më shqetëson shumë, e kam gozhdë në zemër.
- BALLKOT** m. bot. I dha barin e ballkotit dikujt i mori mendjen, e trullosi.
- BALLUKE** f. I vë balluke keq. e tradhton, e turpëron, i vë brirë (për bashkëshortët).
- BAM** onomat. Bam e bum jap e marr nga të gjitha anët, bëj ç'është e mundur, përpiqem me të gjitha forcat. Ia bëri bam
- BANAK** m. Nën banak keq. fshehurazi, duke ua shitur mallrat miqve e të njohurve pa i nxjerrë përpara blerësve (në kundërshtim me rregullat e tregtisë socialiste); nën dorë.
- BANESË** f. Banesa e fundit lart. shih te FUNDIT (i, e).
- BANKË** I f. Në bankat e shkollës shih te SHKOLL/Ë,~A. Ulem në bankat e shkollës shih tek ULEM. Në bankën e të pandehurve (e të akuzuarve) në gjyq si i pandehur; në një gjendje të tillë, kur dikujt i kërkohet të japë llogari për fajet që ka bërë ose për përgjegjësinë që ka në një vepër a veprimtari të dëmshme.

BANOJ jokal. Banojmë (jemi, rrimë) nën një kulm shih te KULM, ~I.

BAR I m. Bar helmues shfaqje e mbeturinave ose e ndikimeve të një ideologjie të huaj e reaksionare; mbartësi i një ideologjie të huaj e reaksionare. Bar i keq të meta, vese e koncepte të dëmshme që pengojnë mbarëvajtjen e punës; ai që ka këto të meta, vese e koncepte. Me bar e me gjethe me të gjitha ç'kam; kokë e këmbë. E bëri bar e rrënoi, e shkretoi, e la pa gjë prej gjëje. E hëngri barin (livadhin, çairin) shih te HA. Nuk ha bar (kashtë) shih te HA. E ka mbuluar bari (ia ka mbuluar varrin bari) ka vdekur prej kohësh, prej kohësh nuk është më. I ka dalë (i ka mbirë) bari (në faqe, në sy) ka vdekur prej kohësh; është tepër vonë tashti. I mbiu bari në faqe ka shumë kohë që po pret. Ç'i shtie bar! përb. ç'ia var, mos u merr me të! E bëri të hante bar përb. e vuri poshtë, e mposhti. Fluturon me një fije bar përcm. i rritet mendja shpejt; rrëmbehet lehtë. E ha barin pa shkop keq. shih te SHKOP, ~I. I dha barin e ballkotit diku shih te BALLKOT, ~I. Mbledh me bar blete mbledh në shtëpi një shumicë njerëzish të ndryshëm, duke i joshur me diçka. Kërkon gjilpërën (qimen) në bar (në kashtë, në mullar) shih te GJILPËR/Ë, ~A. E la tokën bar e la tokën djerr, pa punuar. Zë peshk në bar është shumë i shkathët, është shumë i zoti, bën të pamundurën. Më zuri goja bar (erë) jam fare vetëm, s'kam me kë të ndërroj dy fjalë. I vajti bari sa hanxhari shih te HANXHAR, ~I. I zëntë shtëpia (oborri) bar! mallk. i vdekshin njerëzit e shtëpisë, u shoftë me gjithsej, iu shoftë pragu. S'di gomari ç'është bari mospërf. shih te GOMAR, ~I. Prit gomar të mbijë bar! shih te GOMAR, ~I. S'e lë hunda të hajë (të kullotë) bar tall. shih te HUND/Ë, ~A. Zog bari zool. shih te ZOG, ~U.

BAR II m. Bar djathi farë djathi që bëhet nga mullëza e qengjit; farë djathi. Bar dhëmbësh pastë dhëmbësh. Bar kulaçi sodë buke.

BARAS ndajf. I bëri këmbët baras (çift, kizë) mospërf. shih te KËMB/Ë, ~A.

BARAZI f. Shkalla krahasore e barazisë gjuh. një nga shkallët e krahasimit të mbiemrave e të ndajfoljeve, kur sendet a cilësitë që krahasohen janë në një shkallë të barabartë.

BARAZIM m. Në barazim me... në krahasim me...Vë (heq) shenjën (vijën) e barazimit i quaj të barabartë, i barazoj ndërmjet tyre, i paraqit si të njëjtë.

BARDHAK m. Ç'ka barku e nxjerr bardhaku fj. u. atë që e fsheh ose e bluan njeriu në mendje, e nxjerr kur është i pirë.

BARDHË f. Nënshkruan në të bardhë nënshkruan pa shënuar shumën e parave (për çeqet etj.). Zihen (grinden) për të bardhat e laraskës zihen për diçka fare të kotë. Të ha (të qëron) të bardhën e syrit është shumë i zoti, të merr gjak në vetull. E bën (e paraqit) të bardhën të zezë (të zezën të bardhi) keq. e paraqit diçka krejt ndryshe nga ç'është në të vërtetë, e shtrembëron fare të vërtetën. Shikon (gjen) qimen në të bardhën e vezës (në vezë) shih te VEZ/Ë, ~A. E bardha e syrit cipa e bardhë jo e tejdukshme, që mbështjell kokërdhokun e syrit. E bardha e vezës lëndë me përmbajtje të madhe albumine, që rrethon të verdhën e vezës.

BARDHË as. Të bardhët e syrit e bardha e syrit. Të bardhët e vezës e bardha e vezës.

BARDHË mb. Ari i bardhë pambuku. Faqja e bardhë njeriu që të zbardh faqen, ai që të nderon. Juga e bardhë era e pranverës, që fryn kur çelin lulet; erë e dobishme për bimët. Libër i bardhë përmbledhje dokumentesh e shkrimesh zyrtare me të dhëna për një ngjarje ose për një çështje të rëndësishme. Njollë e bardhë

BARDHË ndajf. Bardhë e zi në të bardhë e në të zezë; jo me ngjyra (për filmat, fotografitë etj.).

- BARI** I m. Mbeti si bariu pa bagëti mbeti i shkëputur nga masa që drejtonte. Mbetën si dhentë pa bari mbetën pa udhëheqje, pa drejtues a pa kujdestar. Vuri (bëri) ujkun bari i ngarkoi një detyrë me përgjegjësi një njeriu të pandershëm e të pabesë në një lëmë ku ai patjetër do të dëmtonte. Dhentë pa bari i ha ujku një nga një fj. u. pa një udhëheqje të mirë, bëhesh pre e armikut. Gjej njëherë bari, pastaj shko e bli dhi! fj.u. merr të gjitha masat e nevojshme, para se të nisësh një punë.
- BARK** m. Bark më bark
- BARKË** f. Ka hipur në barkë pa vela ecën me drejtim të pacaktuar, ecën kuturu në jetë.
- BARTEM** vetv. pës. S'bartet çorba me kaçile fj. u. shih te ÇORB/Ë,~A.
- BARUT** m. U bë barut diçka u tha shumë, aq sa mund të thërrmohet. E bëri barut (tym) shih tek TYM,~I. Fishek pa barut shih te FISHEK,~U. Fuçi baruti vend, në të cilin është gati të shpërthejë menjëherë lufta. I dha (i kalli) barut shih te JAP. Iu lag baruti tall. e humbi menjëherë guximin para një kundërshtari a para një eprori. Vend i barutit vend i trimave dhe i luftërave të guximshme, ku mbrohet çdo e drejtë me armë në dorë. Iu bë koka barut i hipi gjaku në kokë, u nxeh. Bie (mban) erë barut ka mundësi të pëlçasë lufta, ndihet era e luftës; është e ndezur lufta, bëhen përlëshje.
- BARRË** f. Barrë e vrarë shih te VRARË (i, e). Qe nën barrë vjet. qe borxhli kundrejt dikujt, qe i detyruar të bënte diçka për të. Nata është me barrë fj. u. shih te NAT/Ë, ~A.
- BARRIKADË** f. Në anën tjetër të barrikadës (matanë barrikadës) në anën e kundërshtarit, në kampin e armikut.
- BASHKË** f. I mori bashkën dikujt e shfrytëzoi deri në palcë, e qethi mirë, i rropi lëkurën.
- BASHKË** ndajf. S'i bën dy bashkë s'është i zoti të kryejë një punë, s'ia del dot në krye. S'le dy gurë bashkë është shumë i prapë, nuk lë gjë pa trazuar (zakonisht për fëmijët). S'lidh (s'bën) dot dy fjalë bashkë nuk di të flasë rrjedhshëm, i shpreh mendimet me vështirësi. Kur të bëhen dy ditë bashkë iron. shih te DIT/Ë,~A. Nuk fle (nuk kullot) delja me ujkun bashkë fj. u. shih te DEL/E,~JA. Kemi ngrënë një barrë kripë (një thes kripë, një furrë bukë, një hambar miell) bashkë shih te FURR/Ë,~A. Më sa bëhen bashkë një grusht pleshta iron. shih te PLESHT,~I.
- BASHKËPUNIM** m. Në bashkëpunim me... libr. së bashku me..., duke bashkëpunuar me...
- BASHKËRENDIM** m. Në bashkërendim me... libr. në pajtim a në përputhje me..., duke u bashkërenduar me...
- BASHKËRISHT** ndajf. Bashkërisht me... libr. së bashku me...
- BASHKËSHOQËRIM** m. bujq. libr. Në bashkëshoqërim me... libr. së bashku me..., duke e shoqëruar me...
- BASHKËVAJTJE** f. gjuh. Në bashkëvajtje me... libr. në lidhje me..., duke u përdorur me...
- BASHKËVEPRIM** m. Në bashkëveprim me... libr. së bashku me..., duke bashkëvepruar me...
- BASHKOHEM** vetv. Qielli me tokën të bashkohen! shih te QIELL,~I. Kur të bashkohet (të takohet, të puqet) qielli e toka iron. shih te QIELL,~I.
- BASHKOJ** kal. Bashkojmë armët shih tek ARM/Ë,~A. Bashkuan besën vjet. lidhën besën, dhanë besën e përbashkët. Bashkoj zërin me dikë shprehem i një mendimi me dikë, përkrah pikëpamjet a kërkesat e tij.
- BASHKU** ndajf. Së bashku me... bashkë me..., tok me...
- BATAK** m. E la në batak (në baltë) dikë shih te BALT/Ë, ~A.

- BATALL** ndajf. bised. Batall (i madh) fort!
iron. punë e madhe!, s'ka gajle!, aq më
bën! E bëri batall diçka e prishi, e bëri
që të mos vlejë më për asgjë.
- BATBAT** ndajf. E çon batbat diçka e shtyn
me sot e me nesër, e zvarrit (një punë
etj.).
- BATHË** f. bot. Bathë e mbirë në udhë njeri
i vetëm, njeri pa prindër dhe pa vëllezër
e motra, njeri pa njeri; jetim. Si batha
shtatëjavëshe mospërf. jo shumë i vjetër;
i papjekur.
- BAZË** f. Në bazë ... (me bazë ...) duke marrë
si njësi në zhvillimin e një veprimtarie, në
shkallë... Në bazë të... (mbi bazën e ...)
duke u mbështetur në..., duke u nisur nga
..., sipas... I ka bazat në (mbi) rërë shih
te RËR/Ë,~A.
- BE** f. Asnjë për be asnjë fare, as edhe një. Bëj
be se... (që)... jam krejt i sigurt, nuk
kam asnjë dyshim. Bëj be për dikë kam
nderim të madh për dikë, e nderoj shumë.
- BEBE** II f. E shikoj (e vështroj) në bebe të
syrit
- BEG** m. Ndal beg se ka hendek thuhet për
dikë që vepron pa pyetur, por që të tjerët
mund ta ndalojnë.
- BEGUN** m. krahin. U bë begun u dobësua
shumë, u lig.
- BEH** m. E bëj beh
- BEHAR** m. U bë behar u çel në fytyrë,
u gëzua. Më bëhet zemra behar gë-
zohem, më kënaqet shpirti. Dimri ha
beharin fj. u. shih te DIM/ËR,~RI.
Iku (shkoi) si vetëtima e beharit shih
te VETËTIM/Ë,~A. Me një lule (me
një dallëndyshe) s'vjen behari (pranvera)
fj. u. shih te LUL/E,~JA. Lule behari
(vere) bot. shih te LUL/E,~JA.
- BEJ** m. Rrinte si beu në kashtë tall. shih te
KASHT/Ë,~A,
- BEKUAR** mb. bised. Gjithë ditën e bekuar
gjithë kohën pa ndërprerje. Ujë i bekuar
shak., thjeshtligj. raki.
- BEL** I m. M'u këput beli shih te KËPUTEM
1. Rri me duar në bel (në ijë, në brez, në
mes) keq. shih tek IJ/Ë,~A.
- BEL** II m. Beli ka (edhe) bisht fj. u. çdo
veprim ka edhe pasojat, dardha e ka
bishtin prapa.
- BELA** f. bised. Për bela
- BELIK** mb. vjet. Mall belik diçka, për të cilën
nuk bëhet merak njeri, mall pa zot.
- BEND** II m. kryes. sh. Është në bend të mirë
është në qejf.
- BENZINË** f. I vuri benzinën e shkatërroi krejt,
e përvëloi. I hodh benzinë (vajguri) zjar-
rit nxit grindjen e dy vetave, acarom
edhe më shumë mosmarrëveshjet, ndez
më shumë luftën. Lag drutë me benzinë
nxit sherrin, i hedh benzinë zjarrit.
- BERBER** m. Bëhet berber në kokën e tjetrit e
mëson diçka në kurriz të tjetrit. Te koka
e qerosit të gjithë bëhen berberë fj. u.
shih te QEROS, ~I. Më rrove, të rrova,
brisku (qe) i berberit dolëm barabar, pa
fituar as njëri as tjetri, as më ke as të
kam.
- BEREQET** m. bised. E kam me bereqet më
ka duk.
- BERIBAT** mb. vjet. E bëri beribat e prishi
fare, e shkatërroi sa s'ka ku të vejë më
keq; e përleu, e ndoti.
- BERIHA** f. thjeshtligj. Pas berihës siç bëjnë
a siç thonë të tjerët, nga t'i thonë, pas
shumicës; kuturu, kot. Për beriha për
bujë, sa për të bërë zhurmë. E bën me
beriha e bën me shumë zhurmë e bujë. I
vuri berihanë e vuri dikë në lojë, e talli
me të thirrura e me britma.
- BERR** m. I bëri berra i bëri copa-copa, i griu,
i dërrmoi. Çdo berr varet nga këmbët e
veta fj.u.
- BESË** f. Me besë që e mban fjalën e dhënë; që
mund t'i besohet pa frikë, besnik. Për
besë!
- BESNIK** mb. Qen besnik i dikujt qen rojë i
dikujt.

BESOJ kal. Nuk u besoj syve (veshëve) habitem shumë nga diçka e papritur që shoh (që dëgjoj). Nuk i beson as këmishës së trupit nuk i beson askujt, nuk ka besim as te njeriu më i afërt.

BETER mb. thjeshtligj. U bë beteri ndodhi një gjëmë e madhe, u bë një kasaphanë e vërtetë, u bë kiameti.

BEZGË f. bot. Vandak me bezga mospërf. njeri i trashë nga mendja.

BËHEM vetv. 1. Ndryshoj përbërjen, përmasat, trajtën etj., kthehem në një gjendje tjetër; filloj të jem...; edhe fig. kthehem, shndërrohem; fitoj cilësi a tipare të tjera, jetoj e veproj si i tillë (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Bëhet i butë (i fortë, i lehtë, i lëmuar). Bëhet i bardhë (i zi, i kuq). Bëhet i ëmbël (i hidhur, i kripur). Bëhet i gjatë (i madh, i hollë, i gjerë). Bëhem i mirë (i urtë, i zellshëm, i shkathët, i bukur). U bë i pasur

U bë abanoz shih tek ABANOZ, ~I. M'u bë akrep shih tek AKREP, ~I. I. Janë bërë ashër shih tek ASH/ËR, ~RA. U bë edhe (një herë) kaq (aq) shih te KAQ. U bë barut shih te BARUT, ~I. I bëhet barrë shih te BARR/Ë, ~A 4. U bë begun shih te BEGUN, ~I. U bë behar shih te BEHAR, ~I. Iu bë (i ra) bela dikujt shih te BELA, ~JA. U bë bërllok shih te BËRLLOK, ~U. U bë bilbil shih te BILBIL, ~I. U bë bishë (ujk) shih te BISH/Ë, ~A. U bë bisht (sëpate) shih te BISHT, ~I. U bë bishtajë shih te BISHTAJ/Ë, ~A. U bë bllacë shih te BLLAC/Ë, ~A. U bë bozë shih te BOZ/Ë, ~A.

BËJ kal. 15. E kthej në një gjendje tjetër, e shndërroj; jap një cilësi, një veti a një pamje të caktuar, i jap cilësitë a tiparet e dikujt a të diçkaje tjetër; e paraqit diçka si dua unë a si mendoj unë, duke e ndryshuar (edhe në një varg njësisish frazeologjike). E bëj të butë (të fortë). E bëj të lehtë e lehtësoj. E bëj të bardhë (të zi, të verdhë). E bëj të gjatë e zgjat. E

bëj të gjerë e zgjeroj. E bëj të shkurtër e shkurtoj. E bëj të madh e zmadhoj.

Aq më bën shih tek AQ. Se s'bën medemos, patjetër, detyrimisht. E bën për asgjë shih tek ASGJË. Bëj si bëj ia dal mbanë në një farë mënyre. Bën ç'bën (dhe...)

BËRË as. Me të parë e me të bërë si ta shohim, shohim e bëjmë, bëjmë si të paraqiten rrethanat. Me të thënë e me të bërë (një të thënë e një të bërë) pa u vonuar, përnjëherë.

BËRLLOK m. E bëri bërllok

BËRTAS jokal. Qet e bërtet shih te QIT. Bërtet (çirret, flet) në të gjitha udhëkryqet libr. shih te UDHËKRYQ, ~I.

BËRRORE f. krahin. Ia ndreqi (ia rregulloj, ia ujdisi) bërroren (samarin, kurrizin, shpinën) shih te NDREQ.

BËRRYL m. Bërryl më bërryl shumë afër, pranë njëri-tjetrit, përbri, krah për krah. U bë bërryl (tapë, thumb, xurxull, fushë, karroqe, livadh) shih te BËHEM. E ka në bërryl dikë nuk e përfill fare. I vuri bërrylin dikujt e mënjanoi nga një fushë veprimtarie me anë të forcës, e largoi me forcë e pa të drejtë. Çau me bërryla zuri një pozitë më të lartë duke mënjeluar e duke dëmtuar të tjerët. Flet me bërryl është dredharak, është i djallëzuar. I tregoi (i ktheu, i drejtoi) bërrylin dikujt shih tek TREGOJ. I ka futur duart deri në bërryl keq. ka ndërhyrë shumë në punët e një tjetri. Shoku njihet në bërryla fj.u. shoku a miku i vërtetë njihet në çaste të vështira, kur dikush ndodhet ngushtë!.

BËZHDILË f. kryes sh. Bëhet bëzhdila thërrmohet, bëhet copa-copa.

BIBË f. I shtypur me këmbë bibash i trashë nga mendja, i shushatur.

BIBLIOTEKË f. Bibliotekë e gjallë libr. shih te GJALLË (i. e).

BIC m. U bë bic u ngop mirë, hëngri sa u fry. Eci bic eci praptazi. Mbeti bic mbeti: pa asgjë, mbeti lakuriq. Më shkon bic nuk

më vete puna mbarë, më ecën ters. E bëri barkun bic u fry së ngrëni.

BICE f. Ia zuri bicen dikujt ia: zuri shtigjet, nuk i la mundësi të bënte diçka.

BIÇAK m. E la biçak e la pa gjë fare, e la lakuriq.

BIÇIM m. thjeshtligj. E solli në biçim dikë a diçka e bëri të jetë siç duhet, e bëri të jetë në rregull.

BIE I jokal. 20. edhe fig. Ndodhem papritur ose padashur në rrethana zakonisht të këqija e të vështira; arrij në një gjendje të caktuar, kaloj në një gjendje shpirtërore; hyj, futem (edhe në një varg njësisht frazeologjike). Ra në grackë (në lak, në kllapë, në kurth, në grep). Ra në greminë. Ra në pritë (në pusi). Ra në rrezik (në fatkeqësi). Ra në hall (në vështirësi, në bela). Ra rob (pre, viktimë). Ra në burg. Ra brenda. thjeshtligj. e futën në burg. Ra në duart (në thonjtë, në kthetrat) e dikujt. Ra nën sundimin (nën ndikimin) e dikujt. Ra ngushtë (keq). Ra në gjak (në armiqësi). Ra në zi. Ra në gabime. Ra borxh. bised. Ra në përleshje (në luftë, në përplëkje). Ra në varfëri (në mjerim, në skamje). Bie në mendime (në mëdyshje). Ra në të thella. Ra në të zeza u zhyt në mendime të këqija. Ra në dëshpërim (në hidhërim). Ra në dashuri. Ra në plogështi. S'bie në vetëkënaqësi (në shkollarizëm, në formalizëm). Ranë në oportunitizëm (në idealizëm, në subjektivizëm). Ranë kllapi. Bie në gjumë (në qetësi, në heshtje). Ra në krizë (në amulli). Ra me barrë. Ra kllaçkë pula. Më ranë veshët rehat. bised. Ra si miu në hauz (në poç). Shpëtoi nga shiu e ra në breshër. fj.u. Shpëtoi nga lumi e ra në det. fj.u.

36. fig. Lodhem shumë, duke bërë të njëjtën gjë vazhdimisht, këputem se beri diçka pa pushim (edhe në disa njësi frazeologjike). Më ranë këmbët (copë) së ecuri (së kërkuari). U ranë krahët (së punuari). I binin thonjtë (së lari rroba, së bëri çorape).

Ra në baltë shih te **BALT/Ë**,~A. Ra në bark shih te **BARK**,~U. S'i bie barku shih te

BIE II kal. E pruri (e solli) në din. dikë shih te **DIN**,~I. E pruri (e vuri) në dyzen shih te **DYZEN**,~I. E bie (e vë) në (për) fije (fill) diçka shih te **FIJ/E**,~A. E pruri kokën përçm. shih te **KOK/Ë**,~A. E pruri (e solli, e qiti) në jetë shih te **JET/Ë**,~A. E bie rrufull shih te **RRUFULL**. E pruri (e nxori, e çoi) rruga (udha) shih te **RRUG/Ë**,~A. Ma pruri (fjalën) në shteg shih te **SHTEG**,~U. Ia bie (ia sjell, ia hedh) fjalën rrotull (larg e larg) shih te **RROTULL**. Ma pruri zemrën në vend shih te **ZEM/ËR**,~RA 3. Ma pruri (ma solli) shpirtin në fyt (ndër dhëmbë) shih te **FYT**,~I.

BIGË f. Ra në bigë nisi të dyshojë; ra në mëdyshje. E vuri (e shtiu, e futi) në bigë dikë e vuri në gjendje shumë të vështirë, e zuri keq.

BIGORR m. U bë bigorr u forcua shumë, u bë i ngurtë, u bë çmërs.

BIJË f. E bija (gruaja) e botës përçm. shih te **BOT/Ë**,~A. Si e ëma dhe e bija mospërf. shih tek **ËM/Ë**,~A.

BILARDO f. Stekë bilardoje shak. shih te **STEK/Ë**~A.

BILBIL m. Bilbil gjyzari figurë e përrallave popullore: bilbil me zë shumë të bukur, që paraqitet sikur bën çudira. U bë bilbil u ndreq, u bë lule (për njerëz që nuk kanë qenë të rregullt). Mbeti bilbil mbeti fare pa gjë ose pa njeri. Ishte si bilbili në kafaz ishte i mirë e i zoti dhe i kishte të gjitha për të jetuar por nuk kishte liri; ishte pa liri e pa shpresë.

BIMË f. Duket bima që kur mbin fj.u. një punë e mbarë duket që në fillim, dita e mirë duket që në mëngjes.

BINA f. bised. I vuri bina dikujt shpifi, trilloi diçka. kundër dikujt. Të shuan binanë (derën, pishën) shih te **SHUAJ**. U shoftë me bina! mallk. u shfarostë me gjithçka, mos i mbettë asnjë gjurmë! S'iu duk (s'iu

gjend) binaja u zhduk fare, humbi pa lënë gjurmë.

BINAR m. Ka dalë nga binarët

BINDEM vetv. U bind dreqi thjeshtligj. ndodhi diçka e jashtëzakonshme, u bë një pështjellim i madh. I bindet shkopit të dirigjentit (të dirigjuesit) libr. shih te **DIRIGJENT**,~I.

BIOGRAFI f. I bëri biografinë keq. tha gjithçka dinte për një njeri, duke e marrë nëpër gojë.

BIR m. I biri (burri) i botës përçm. shih te **BOT/Ë**,~A. I biri i njerks shih te **NJERK/Ë**,~A.

BIRË f. Birë më birë shih **Vrimë më vrimë** te **VRIM/Ë**,~A. I mbeti birë në zemër i erdhi shumë keq që la diçka pa bërë, i mbeti peng.

BIROJ kal. Ia biroj jetën, ia prishi jetën, e shkatërroi. Ia biroj shpirtin (zemrën) i dhimbset shumë, i vjen keq sa s'ka, ia këputi shpirtin.

BISEDË f. Bisedë pas bisede pasi biseduam për një kohë të gjatë për disa çështje, fjalë pas fjalë.

BISEDOJ jokal. Bisedoj (shtrohem, flas) rrafsh me dikë shih te **RRAFSSH**.

BISHË f. U bë bishë (ujk) u egërsua shumë, u tërbua nga zemërimi. Si bisha në kafaz shumë i zemëruar; i tërbuar, i egërsuar.

BISHT m. Me bisht keq. që është me të tepërt, që ka diçka më tepër se çdo të kishte zakonisht. Bisht pas bishti pa iu ndarë. Bishti i fshesës shih te **FSHES/Ë**,~A. Bisht lugati thjeshtligj. shih te **LUGAT**,~I. Për bishtin e laraskës (për ballë të laraskës) për hiçgjë, për një shkak a arsye fare pa rëndësi. As ballë as bisht shih te **BALL/Ë**,~I. Pa bisht, pa krye (pa kok) pa lidhje, pa fillim e mbarim, në mënyrë të ngatërruar e të paqartë. Iku me bisht ndër shalë përçm. iku i mundur e i turpëruar. Bën bisht (i bën bisht) i shmanget takimit me dikë a me diçka, bën mënjanë ose largohet; i

shmanget diçkaje, duke gjetur arsye të kota ose dredhi, dredhon. Ra në bisht u dorëzua, e quajti veten të mundur. E drodh i (e përdrodh) bishtin (këmbën) mospërf. shih te **DREDH**. Në fund e në bisht shih te **FUND**,~I. Është bishti i kavallit (vrime e fundit e kavallit) shih te **KAVALL**,~I. I kreh bishtin diku shih te **KREH**. La bishtin dikush shih te **LË**. Ia lagu bishtin diku shih te **LAG**. E la në bisht dikë i doli përpara, ia kaloi e la prapa. U lidh pas bishtit të diku shih keq. shkon e vepron sipas interesave të diku shih, lidhet ngushtë me dikë e vepron si do ai. Luan (dredh, përdredh, lëviz) bishtin keq.

BISHTAJË f. U bë bishtajë

BISHTALEC m. I kanë dalë mendtë mbi bish-taleca keq. nuk është fare në gjendje të gjykojë e të arsyetojë drejt, s'i ka mendtë në kokë (për vajzat e për gratë).

BISHTPËRPJETË mb. Dhi zgjebosur (e zgjebur) e bishtpërpjetë (bishtin përpjetë) tall. shih te **ZGJEBOSUR** (i, e).

BITËRR f. Mbeti bitërr nuk u zhvillua, mbeti i hollë e i dobët.

BJESHKË f. E bëri bjeshkë diçka e zmadhoi shumë një punë, e bëri qimen tra, e bëri mizën buall. Sheh përtej bjeshkë (prapa malit) sheh larg, është largpamës. Sikur ka bjeshkën në shpinë e ndien veten shumë keq nga ana shëndetësore; është në një gjendje të rëndë, ka shumë halle e kokëçarje.

BJEZGË f. Iku rrozga me bjezga iku shpejt e shpejt e pa rregull.

BLEJ kal. I bleu (i pa) mendjen shih te **SHOH**. Bli ditë e shko e kalon kohën pa bërë gjë, e shkon kohën kot; shtyn ditën, e zgjat kohën me zor. Të shet e të blen shih te **SHES**. Shet e nuk blen shih te **SHES**. E bleu belanë me para shih te **PARA**,~JA. Bleu qen e i doli këlysh shih te **KËLYSH**,~I. Djali pa lerë e djepi (festja) blerë iron. shih **PESHKU** në det e tigani në zjarr te **PESHK** ~U. Gjej

- njëherë bari, pastaj shko e bli dhi! fj.u. shih te BARI,~U.
- BLERTË** mb. Hardhja e blertë zool. zhapiu.
- BLETË** f. Bletë e vulosur shih te VULOSUR (i, e). Si bletë shkëmbi i padobishëm, që nuk jep fryte (për njerëzit). Ia bëri bletë ia mori mendtë, e trullosoi; e ngatërroi keq. Mbledh me bar blete shih te BAR,~I I. Bar blete bot. shih te BAR,~I I. Lule blete bot. shih te LUL/E,~JA. Zog blete zool. shih te ZOG,~U.
- BLINDUAR** mb. usht. Grusht i blinduar grusht i hekurt.
- BLOJË** f. U vu në blojë keq. nisi të flasë pa pushuar, filloi të bluajë si mulli.
- BLU** mb. Kaskat blu shih te KASK/Ë,~A.
- BLUAJ** kal. Bluante (hante) egjër shih tek EGJ/ËR,~RA. Bluan imët shih tek IMËT.
- BLLACË** f. U bë bllacë
- BLLOK** m. Si bllok graniti shih te GRANIT,~I 1. Jemi (qëndrojmë) bllok jemi të bashkuar fort, qëndrojmë të bashkuar njësh dhe pa asnjë të çarë. E ka bllok me dikë është i lidhur ngushtë me dikë, nuk ndahet prej tij.
- BLLOKADË** f. Bëhem bllokadë bëhem pengesë e pakapërcyeshme.
- BOBËL** f. Si boblat (si kërmijtë) pas shiut mospërf. shih te KËRMILL,~I.
- BOÇË** f. E ka syrin boçë s'i trembet syri për shpenzimet që mund të ketë, nuk pyet. Boça e fytit anat. fikthi.
- BOÇKË** f. Trupi boçkë e mendja lomçkë mospërf. i madh nga trupi, po i vogël nga mendja, i papjekur.
- BODEC** m. E shpoj me bodec dikë e nxit, e shtyj dikë, që nuk lëviz vetë për të kryer një punë. S'ha bodec
- BOF** onomat. bised. Ia bëri bof plasi nga inati, nga dëshpërimi ose nga mërzia.
- BOJË** I f. U bë si boja u prish në fytyrë, u zbeh a u pre në fytyrë nga një lajm i papritur, nga zemërimi, nga frika etj. I doli boja keq.
- BOKË** f. E bën bokë dikë nuk e përfill, e trajton sikur nuk ka asnjë vlerë. Nuk është në bokë nuk është në të, nuk është në rregull. I shkoi bokë (puna) i shkoi keq puna, nuk i vajti mbarë. Gjarpri i bokës zool. gjarpër i zi, helmues, që rri në vende të thata.
- BOLLË** f. zool. Si bollë e vrarë shih te VRARË (i, e). U bë (doli) bollë (një punë) u zgjat një punë dhe nuk doli si duhet. E ka bollë dikë nuk e duron dot, nuk e sheh dot me sy. Përzihet si bolla me ngjalën ngatërrohet keq. Nuk i tregon bolla (gjarpri) këmbët fj. u. shih te GJARP/ËR,~RI.
- BOMBË** f. Ra si bombë erdhi papritur, ndodhi befas dhe shkaktoi një goditje të rëndë a një përshtypje të madhe. I plasi bomba në duar i ndodhi papritur një ngjarje e papëlqyer; i doli në shesh diçka e papëlqyer, që përpiqej ta fshihte ose ta bënte pa u ndier. Bombë vullkanike gjeol. copë lave, që del nga krateri i vullkanit menjëherë pas gazeve dhe që merr trajtën e një lëmshi.
- BOREAL** mb. gjeogr. Agimi boreal agimi polar (verior).
- BORË** f. kryes. nj. sh. Bora e pleqërisë poet. flokët e bardhë, thinjat. Si bora në maj që kalon shpejt, që nuk është i qëndrueshëm, që nuk ka jetë të gjatë. Si mali me borë i fortë e i pavdekshëm. Si të marrë bora si të vijnë rrethanat, si të jetë puna, merr për mirë a për keq. I ka rënë bora (në krye) është thinjur. Iu bë zemra borë i ngriu zemra, iu bë zemra akull. Kërkon kallëza në borë shih te KALLËZ,~A. Lule bore bot. shih te LUL/E,~JA.
- BORI** f. Ra boria bëhet thirrja për diçka, jepet kushtimi.

- BORIGË** f. bot. Kërkon dardha nga boriga kërkon diçka të pamundur, kërkon qiçra në hell.
- BORIZAN** m. Pëllumbi borizan zool. lloj pëllumbi, që e ka bishtin të madh.
- BORXH** m. Ka borxh të...
- BORZILOK** m. bot. E bëri borzilok e pastroi mirë, e bëri dritë (dhomën, shtëpinë).
- BORROVIQ** m. zool. Nga këmbët borroviq, nga mendja eksiç i rritur nga shtati, por i papjekur nga mendja.
- BOSTAN** m. Për të vënë në bostan i rreckosur, si dordolec. Mbolli bostan e i dolën kastravecë iron. shih te **MBJELL**. Pikaloshja e bostanit zool. mollëkuqe.
- BOSTANXHI** m. I shet kastravecë bostanxhiut thuhet kur dikush kërkon të mësojë dikë që ato gjëra i di më mirë se ai e para tij, i tregon arat babait.
- BOSH** ndajf. bised. E nxori (e përcolli, e qiti) me duar bosh (me duar thatë, me duar zbrazur) shih te **THATË 3**. E bëri bosh (gruan) vjet. e ndau gruan, e përzuri. E ka kokën bosh
- BOSHT** m. Del si boshti para furkës shpreh mendimin para se t'i vijë radha, kërcen kur nuk i takon për të folur a për të vepruar. Boshti i kurrizit anat. shih shtylla kurrizore te **SHTYLL/Ë, ~A**.
- BOT** ndajf. bised. Bot e bir me përpjekje të mëdha, me të gjitha forcat. Dhashë e bot (dhashë e dhashë, dhashë e mora) shih te **JAP**.
- BOTANIK** mb. Pjekje botanike bot. pjekje natyrore e farërave të bimëve.
- BOTË** I f. I biri (burri) i botës përçm. një burrë a një djalë çfarëdo, një burrë a një djalë i panjohur; tjetri, dikush. E bija (gruaja) e botës përçm. një grua a një vajzë çfarëdo, një grua a një vajzë e panjohur; tjetra, dikush. M'u errësua bota (vendi) shih tek **ERRËSOHEM**. E dërgoi prapa botës (prapa diellit) dikë shih te **DIELL, ~I**. Është jashtë botës keq. s'merr vesh nga bota; sillet ndryshe nga të gjithë e jo ashtu si duhet. Është prapa botës (prapa dynjasë)
- BOTË** II f. Hëngri (kafshoi) botë (dhe) përçm. vdiq.
- BOTËROR** mb. Oqeani botëror (i përbotshëm) gjeogr. shih tek **OQEAN, ~I**.
- BOZË** f. U bë bozë
- BRASHNJË** f. E bëri brashnjë e shau rëndë, e bëri leckë. U bë brashnjë nuk ka më asnjë vlerë, është bërë leckë. Iu bë brashnjë dikujt iu nënshtrua me përlulje, iu bë lepikë.
- BRAZDË** f. Ranë në brazdë u morën vesh për diçka, ranë në ujdi, u pajtuan. Erdhi (ra) në brazdë (në hulli) u vu në rrugë të drejtë; nisi të bindet për diçka. E vuri (e futi) në brazdë (në hulli) e vuri në udhë të drejtë, e solli në rrugë të mbarë.
- BREDH** jokal. Bredh (shkon, shëtit) lule me lule dikush keq. shih te **LUL/E, ~JA**.
- BREDHËRIJ** jokal. I bredhërin gjuha para mendjes shih te **GJUH/Ë, ~A I**.
- BREG** m. Breg më breg i mbushur plot, me majë, buzë për buzë. I bie breg pas bregu nuk i thotë gjërat hapur e drejtpërdrejt, por e sjell fjalën anës e anës, nuk flet troç, por tërthorazi. Qyqe bregu grua e keqe nga goja, që flet shumë dhe ndjell të këqija, grua gjuhëhelm. E kapërceu bregun shih te **KAPËRCEJ**. Dal në breg ia dal mbanë, e kryej një punë të vështirë; shpëtoj nga rreziku, kapërcej një vështirësi. Dolëm në breg arritëm në një përfundim; ramë në marrëveshje, u morëm vesh. As në det as në breg shih te **DET, ~I**. E bëri dheun (sheshin, fushën) breg mospërf. vdiq.
- BREJ** kal. Bren hekur me dikë grindet keq, hahet, bën sherr. Bren (ha) hekurin (çelikun, plumbin, gurin) me dhëmbë shih te **DHËMB, ~I**. E brente (i kishte hyrë, e hante) krimbi shih te **KRIMB, ~I**. Më bren (më ha) zemra shih te **ZEM/ËR, ~RA**. Më bren zemrën shih te **ZEM/ËR, ~RA**.

- BREKË** f. vet. sh. Ishte bythë e brekë me dikë thjeshtligj., keq. shih te BYTH/Ë,~A. Me brekë nëpër këmbë (nëpër shalë, zvarrë) thjeshtligj., tall. i mundur, i turpëruar; me frikë të madhe e plot rrëmujë. S'di të mbathë as brekët thjeshtligj., përb. shih te MBATH.
- BRENDA** Dhëndër brenda ai që ka hyrë dhëndër në shtëpi të vjehrrit, kollovat. Ra brenda (me këmbët e tij)
- BRENDSHËM** mb. Qark i brendshëm fiz. shih te QARK, ~U 3. Rimë e brendshme let. shih te RIM/Ë, ~A. Sekretion i brendshëm fiziologjik. shih te SEKRECION,~I 2. Motor me djegie të brendshme tek. shih te MOTOR,~I 1.
- BRENGË** I f. E kam brengë më mundon vazhdimisht përbrenda, e kam gozhdë në zemër. Më mbeti brengë diçka më mbeti merak; më mbeti peng.
- BRENGË** II f. BRENGË THIU bot. Bimë barishtore me degë të gjata e të shtrira përtokë, me gjethe të imëta e të mprehta, që del e rritet zakonisht nëpër pyje.
- BRESHËR** m. Re me breshër shih te RE,~JA I. Iku si reja me breshër (me furtunë) shih te RE,~JA I. Iku nga shiu e ra në breshër (ra nga shiu në breshër) shih te SHI,~U. S'qëndron breshri mbi breshkë fj.u. në rrethana të tilla s'bëhet punë, nuk ecën puna kështu, është e pamundur të bëhet (një punë). Breshri e rreh e hunda me majë iron. shih te HUND/Ë,~A. Kush mbjell duhi, korr breshër e shi fj.u. shih te DUHI,~A.
- BRESHKË** f. Hirrë breshkë thjeshtligj. shumë i hollë (për lëngun e gjellës, për qumështin etj.). Duket breshka është rrafshuar, është sheshuar krejt; shihet, dallohet çdo gjë shumë qartë, s'ka asnjë pengesë për pamjen. I ka hipur breshkës iron.
- BRETK** I m. zool. Lule bretku bot. zhabinë.
- BRETK** II m. vet. nj. anat. I ra bretku (në punë) u lodh shumë, u këput nga një punë e rëndë dhe e gjatë. I kalli
- bretkun thjeshtligj. e la pas dore, s'çau më kokën për të, e braktisi. Ç'bretkun ke? thjeshtligj. ç'ke?; ç'dreqin ke?
- BRETKOSË** f. zool. Stil Â«bretkosëÂ» sport, mënyrë të notuari si bretkosë, duke lëvizur anash me hapje të gjerë këmbët e duart brenda në ujë.
- BREZ** m. Me alete në brez shih tek ALET,~I. Me kobure në brez shih te KOBUR/E,~JA. Me lugë në brez keq. shih te LUG/Ë,~A. Me shpatë në brez keq. me të keq e me të egër; gati për të goditur. I hodhi një brez (rakisë) shih te HEDH. Erdhi me kulaç pas brezi shih te KULAÇ,~I. Lëshoi brezin (i pari) shih te LËSHOJ. I shkeli brezin diku shih te SHKEL. E ka barkun pa brez ha shumë, s'ka kufi në të ngrënë. Vesh (vë) dy breza bëhem burrë, burrërohem, piqem e hyj në rrethin e burrave. Ka ngjeshur dy breza keq. mendon se është bërë burrë, zot i vetes dhe mund të veprojë pa pyetur njeri, nuk kërkon me këshilla e udhëzime nga askush (thuhet kur një djalë i ri arrin moshën e pjekurisë dhe bëhet mendjemadh e nuk i përfill më prindërit a më të moshuarit). Në brez i ka të shtatat vjet. shih te SHTATAT (të). Ngjitet si pallaska pas brezit shih te PALLASK/Ë, ~A. Rri me duar në brez (në ijë, në bel, në mes) shih tek IJ/Ë,~A. Brezi i qielit ylberi. Brezi i sulmit (brezi i kalitjes) usht. vend i pajisur me gardhe, me gropa, me tarabë, me llogore etj., ku zhvillohet stërvitja ushtarake e nxënësve në shkollë, e ushtarëve në reparte etj.
- BRI** m. Budalla me brirë budalla i madh, që s'e ka shokun. Budallallëk me brirë budallallëk shumë i madh, që duket fare qartë. Dem me brirë njeri kokëfortë. Djall (dreq, shejtan) me brirë thjeshtligj. njeri shumë i keq. Ujk me brirë thjeshtligj.
- BRICË** f. Ia hoqi bricën hoqi shpresat, nuk mban më shpresë te dikush a për diçka.
- BRICJAP** m. zool. Tropiku i Bricjapit gjeogr. Tropiku Jugor.

- BRINJË** f. Brinjë më brinjë tejpertej; gjithë, krejt; shumë, fort. Më ranë (m'u këputën) brinjët u lodha shumë, u këputa. I hallakati brinjët dikujt shih te HALLAKAT. Mori brinjën shih te MARR. E mbështeti brinjën euf. shih te MBËSHTET.
- BRISK** m. Mbeti (ngeli) brisk mbeti pa gjë fare. Ia preu me brisk nuk e la të vijojë a të zgjatet, ia preu shkurt; ia preu me sëpatë. Është buzë brisku është i hollë e i shtrirë mirë; është i palosur, i hekurosur mirë, i ngrirë. E ka gjuhën (gojën) brisk (është brisk nga goja) është i zoti i fjalës, është i gojës, e ka gjuhën shpatë. I pret gjuha (goja) brisk (gozhdë, hekur) shih te PRES I. I ka këmbët brisk është shumë i shpejtë në të ecur, nuk ndihet fare. E ka mendjen (gjykimin) brisk është i zgjuar e i shkathët, është i mprehtë nga mendja. Shkojnë (janë) thikë e brisk (brisk e thua) shih te THIK/Ë,~A. Shkojnë majë e brisk (majë me majë) shih te MAJ/Ë,~A.
- BRISHTË** mb. Vit (mot) i brishtë shih te VIT,~I.
- BRITANIK** mb. Luani britanik edhe iron. simbol për Britaninë e Madhe.
- BROF** jokal. I brofte zemra i hidhej zemra për-pjetë (nga gëzimi etj.).
- BRONZ** m. Koha (periudha, epoka) e bronzit hist. periudha historike midis mijëvjeçarit V e atij II para erës së re, kur u zbulua e u përdor bronzi. Sëmundja e bronzit mjek. sëmundje që u bie fletëve të agrumeve, të cilat marrin një ngjyrë si ajo e bronzit.
- BRUMBULL** m. zool. Kush shkon pas brumbullit, te plehu do ta shpjerë fj. u. kush shkon pas një njeriu të keq, përfundon keq.
- BRUMË** m. Gjalpë brumë gjalpë brumës. Dita (nata) e brumit etnogr. dita e enjte, kur zihej brumi për të gatuar bukët e dasmës. U bë brumë u zbut, u squll. Si buka pa brumë pa shije, pa lezet, pa kripë.
- Sipas brumit tharmin i gjej njeriut a mje-disit atë që i përshtatet. Vuri brumë u pasurua, vuri pasuri. E kalon gjumë e brumë shih te GJUM/Ë,~I. Sikur i ka ngrënë macja brumin shih te HA.
- BRUZ** m. I ra bruzi u prek, u zemërua, i vari buzët.
- BRYMË** f. Si bryma në diell që mbaron e zhduket shpejt, që zhduket menjëherë, si kripa në ujë. Është si bryma para diellit po i vjen fundi, s'e ka të gjatë. Bryma s'është dëborë fj. u. të gjithë ata që i ngajajnë njëri-tjetrit nuk janë njësoj (thuhet zakonisht për të dalluar një njeri më pak të aftë nga një tjetër që është shumë i zoti, kur të dy kanë ndonjë tipar të përbashkët joqenësor). Rroftë sa kungulli në brymë! iron. rroftë shumë pak, vdektë shpejt!
- BU.**
E merr me bo e bën diçka me rrëmbim, nuk e merr shtruar.
- BUALL** m. E bën buall diçka e zmadhon diçka tej mase, e fryn së tepërmi. E bën mizën (pleshtin) buall (ka) e zmadhon tepër diçka, e fryn shumë, i jep një rëndësi më të madhe sesa duhet. As me buaj, as me qe i pavendosur, që nuk di nga t'ia mbajë, me dy mendje; as kështu as ashtu. Hall me buaj, hall me qe keq sido që të bëhet, keq kështu e keq ashtu. U fut (hyri) në bri të buallit (të kaut) shih te BRI,~RI. Ka lëkurë bualli (e ka lëkurën si të buallit) shih te LËKUR/Ë,~A. Nuk sheh buallin para sysh nuk kupton edhe diçka që është fare e qartë. Me sa hyn bualli në veshin (në vrimën) e gjilpërës kurrë, asnjëherë; është e pamundur të bëhet. Të shtie miza e s'të nxjerr bualli shih te MIZ/Ë,~A. Fik bualli bot. shih te FIK,~U 1. Lule bualli bot. shih te LUL/E,~JA.
- BUALLËS** mb. Rrush buallës (kumbullor) bot. shih te RRUSH, ~I.
- BUBË** II f. mit. U bë bubë u bë tmerri i të tjerëve, u bë gogol për dikë. Ia bëri bubë një punë ia bëri të tmerrshme, ia bëri gogol.

- BUBULLIMË** f. Si bubullimë (si rrufe) në qiell të kaltër (të kthjellët) përdoret për diçka të rëndë që vjen fare e papritur.
- BUBURREC** m. U bë buburrec u mblodh nga frika.
- BUCELË** f. Prish bucela e bën kënaçe dëmton diçka të rëndësishme për të rregulluar një vogëlimë, prish shtëpi e bën kasolle.
- BUÇ** I m. krahin. Vë buç nxjerr bark, fryhet më një anë.
- BUÇ** II m. zool. krahin. Bar buçi bot. shih te BAR,~I I.
- BUÇET** jokal. I buçet gjaku shih te GJAK,~U I. Më buçet koka kam shumë kokëçarje e telashe, më zien koka.
- BUÇUK** m. E bëri buçuk e pështjelloi punën, e ngatërroi. I ka (punët) buçuk i ka punët pisk, është ngushtë.
- BUDALLA** m. bised. Shiu i budallait shih te SHI,~U.
- BUF** m. Buf kënete shar. shih te KËNET/Ë,~A. Bufi i ngordhur shih te NGORDHUR (i, e). Me thonjtë e bufit shumë keq, shkel e shko, me këmbët e pulës. E di edhe bufi thjeshtligj. është fare e thjeshtë dhe e kuptueshme, s'ka nevojë të shpjegohet a të tregohet. Leshtë e ujkut, thonjtë e bufit fj.u. shih tek UJK,~U. Bufi mburr zogjtë e tij thuhet për atë që përpiqet të mburrë punën e vet edhe kur nuk vlen, shoshari shoshën e tij lëvdon.
- BUJ** jokal. Ku bun, s'bun nuk qëndron gjatë në një vend, ku gdhiet, s'ngryset.
- BUJË** f. E bëri bujë e zmadhoi a e fryu një gjë, bëri zhurmë rreth diçkaje, e paraqiti diçka si tepër shqetësuese e të ngutshme. Me kujë e me bujë shih te KUJ/Ë,~A. Me pohe e me bujë keq. me zhurmë e me shkëlqim të madh për t'u dukur dhe për të bërë përshtypje te të tjerët.
- BUJQËSOR** mb. Bankë bujqësor e fin. institucion financiar shtetëror në vendin tonë, i cili kryen të gjitha veprimet bankare që kanë të bëjnë me ndërmarrjet e kooperativat bujqësore dhe me SMT-të. Qarkullim bujqësor bujq. shih te QARKULLIM,~I 3.
- BUJTUR** mb. U bë si lakër e bujtur shih te LAK/ËR,~RA.
- BUKË** f. Buka e kripa e diçkaje gjëja më kryesore, gjëja më e domosdoshme. Bukë qeni njeri, me të cilin nuk merresh dot vesh, njeri, me të cilin nuk shkon muhabeti. Buka e një mielli keq. të njëllotë, nga një brumë (për njerëz me mendim e sjellje të njëjta etj.). Buka e vjetër shih te VJETËR(i, e). Buka e verës ylberi. Për një bark bukë për një copë bukë, për pak gjë. Për një copë bukë shumë lirë, për hiç gjë, falas. Si një copë bukë pa ndruajte. Për një kafshatë bukë shih te KAFSHAT/Ë,~A. Çaçë mbi bukë shih te ÇAÇ/Ë,~A. Ia hëngri bukën dikujt shih te HA. Nuk ha bukë shih te HA. S'më hahet buka me dikë shih te HAHEM 6. Ha bukë veç (veçan) shih te VEÇ. Ia ha bukën gomari mospërf. shih te GOMAR,~I. E hante bukën me lot shih te LOT,~I. S'e ha bukën kot edhe poh. e meriton atë që merr: jeton me djersën e vet. Të jep bukë shih te JAP. Kalli pa bukë. keq. njeri i mirë në dukje, po i cekët a i zbrazët. Kthej bukë shih te KTHEJ. Na e la bukën mospërf. vdiq. I është mykur buka dikujt ka bërë faj ose një gabim që dënohet. E ndau bukën me dikë shih te NDAJ. Përzjeu bukën etnogr. shih te PËRZIEJ. Shtëpi buke mikpritës, derëhapur, bukëdhënë. Shkel bukën (me këmbë) shih te SHKEL. Iu bë buka drokth shih te DROKTH,~I.
- BUKËL** I f. zool. U ka hyrë bukla u ka ardhur njeriu që duhej dhe i ka kapur një e nga një në faj, ua ka zbuluar fajet.
- BUKUR** m. I bukuri i unazës (i dorës) bised. gishti i katërt i dorës, gishti i unazës. Është i bukuri (i miri, i zgjuari, trimi) i dheut shih te DHE,~U. I Bukuri i Dheut folk. figurë e përrallave popullore shqiptare, që përfytyrohej si një djalë shumë i bukur, i mirë dhe i dashur.

BUKUR f. E Bukura e Dheut

BUKUR ndajf. Mirë e bukur shih te MIRË.
Bukur për dhëndër! ur. i gëzofsh! të ndenjshin bukur edhe për dhëndëri! (i thuhet një të riu kur vesh rroba a këpucë të reja).

BUKURI f. Për bukuri shumë mirë, fare bukur.

BULEVARD m. Ia bëri bulevard libr. ia paraqiti diçka si shumë të lehtë për t'u kryer, ia bëri shesh me lule.

BULË f. Është bulë e flori është shumë i dobishëm, s'ka të çmuar (për shiun kur bie në kohën e duhur).

BULMET m. Bulmet hudhrash iron. shih te HUDH/ËR,~RA. Ai stan atë bulmet ka mospërf. shih te STAN,~I.

BUM onomat. Bam e bum shih te BAM.

BUNACË f. U bë bunacë

BUNAR m. vjet. Sikur ra në bunar pa lënë asnjë gjurmë, sikur ra në pus (kur dikush zhduket papritur).

BURG m. Iu bë jeta burg iu bë jeta e rëndë dhe e padurueshme, iu nxi jeta. Ia bëri udhën (rrugën) burg

BURGI f. Ia gjeti burgjitë (vidhat, barmat) shih te VIDH/Ë, ~A. Ia liroi burgjitë (vidhat) dikujt shih te LIROJ. I janë liruar (i kanë luajtur) burgjitë (burmat, vidhat) dikujt shih te VEDH/Ë,~A. Ia shtrëngoi burgjitë (vidhat) dikujt shih te SHTRËNGOJ.

BURIM m. Bëhet burim (i pashtershëm) prodhon a jep shumë e vazhdimisht. Është burim i pashtershëm

BURMË I f. I janë liruar (i kanë luajtur) burmat (vidhat, burgjitë) dikujt shih te VIDH/Ë,~A. Ia di (ia njoh) burmat (vidhat) dikujt ia gjej pikën ku mund të kapem, ia gjej vendin dikujt ku duhet të kapem për të zbërthyer diçka etj. Ia gjeti burmat (vidhat, burgjitë) shih te VIDH/Ë,~A.

BURNOT m. E bëj burnot diçka e copëtoj diçka në grimca të vogla, e bëj pluhur; e prish diçka, e shkatërroj fare.

BURRË m. Burri (i biri) i botës përçm. shih te BOT/Ë,~A. Bum i dheut shih te DHE,~U. Burri i nënës keq. shih te NËN/Ë,~A. Më është bërë (si) burri i nënës shih te NËN/Ë,~A. Djalë burri djalë i gjetur, thjeshtë. Në shesh të burrave ballë për ballë, haptas, atje ku tregohet burrëria. A je burrë! krahin. përshëndetje kur takohen dy burra. S'ka burrë (nëne) ... s'ka njeri të lindur (që t'ia dalë në krye një pune). Ta vë babën burrë keq. shih te BAB/Ë,~A. Është një burrë e gjysmë është trim i madh, trim e shkuar trimave. Edhe burrat kanë burra fj.u. ka trima, por ka edhe më trima; trimëria, burrëria e zotësia s'kanë kufi. Burrin e prishin (e çartin) huqet fj.u. veset e këqija prishin edhe atë më trimin e më të zotin. U bë Â«bjeri burri burritÂ» u bë rrëmujë e potere e madhe, s'merrte vesh i pari të dytin, u bë merre ta marrim. Burrë me (një barrë) mustaqe shih te MUSTAQ/E,~JA. S'lind burri me mustaqe fj. u. shih te MUSTAQ/E,~JA.

BURRËRI f. S'e jep burrëria nuk e lejon zakoni i mirë, trimëria dhe fisnikëria e burrit.

BURRNI f. Burrni për burri si burri me burrin, si trimi me trimin, si burrat, si trimat.

BUT I m. Prish bute e bën kënaçe prish një punë të rëndësishme ose një gjë të mirë për të bërë diçka tjetër më të vogël a pa ndonjë vlerë të madhe; prish bucela e bën kënaçe.

BUTË mb. Lahutë (këngë) e butë muz. këngë lirike. Kalbëzim i butë kalbëzim i ngadaltë i pjesëve të bimëve, të cilat marrin një ngjyrë kafe. Me gjak të butë

BUTË ndajf. Bie butë jam mirë, bie në rehati.

BUZË f. Është buzë më buzë është shumë i shoqërueshëm, është i shkuar e i dashur, është shumë i afruar me të tjerët. I vari (i lëshoi, i lëvari) buzët (hundët, turinjtë) një pëllëmbë shih te VAR. Me buzë varur (të varur) shih te VARUR. T'i shposh buzët çfarëdo që t'i bësh, nuk ndërro mendje. Me barkun te baza (te goja) shtatzënë në muajin e fundit të barrës. I bën buzë (hundë) diçkaje nuk e pëlqen, nuk e përfill, i bën naze (zakonisht për të ngrënat). I ra pas buze e pësoi vetë, e gjeti e keqja (thuhet për dikë që ka dashur t'i bëjë keq një tjetri dhe e pëson vetë). Më digjet buza për dikë e dua me shpirt. I dridhet buza (mjekra) është tronditur shumë nga diçka, është prekur thellë në shpirt, është mallëngjyer pa masë; ngashërehet. Fshin buzët shih te FSHIJ. I fshij buzët nga diçka shih te FSHIJ. Hundë e buzë (tërë hundë e buzë, gjithë buzë) shumë i mërzhitur e i pezmatuar, i zemëruar, me qejf të prishur, me buzë të varura. E bëri hundë me buzë e bëri shumë shpejt. Kafshoi (hëngri) buzët me dhëmbë shih te KAFSHOJ. Lëpin (lan) buzët shih te LËPLJ. Luaj buzët shih te LUAJ. I ka lyer buzët është përzier në një faj a në një gabim, ka gisht në një punë jo të mirë, nga e cila ka përfituar diçka. Mbledh (tharton, rrudh, përdredh, shtrembëron) buzët (turinjtë, hundët) shpreh pakënaqësi, mospajtim, mospërfillje a përbuzje ndaj dikujt a diçkaje. Më plasi buza shih te PLAS. Me buzë (me zemër) të plasur shih te PLASUR (i, e). Përveshi buzët shih te PËRVESH. E priti me (tërë) hundë (me hundë e buzë, me turinj) shih te HUND/Ë, ~A. I qepi buzët shih te QEP. S'i qesh baza shih te QESH. I rri me hundë (me turinj, hundë e buzë) dikujt shih te HUND/Ë, ~A. I rri me buzë i rri i zemëruar; i rri me qejf të prishur e me inat. Rrudh buzët (hundët, turinjtë) shih te RRUDH. Iu tha buza (goja, gryka, gurmazi) shih te THAHEM. Iu zbardhën buzët u tremb shumë, e kapi tmerri. E zuri buzën shih te ZË. Bëj (sh-

pie, vë) buzën në gaz shih te GAZ, ~I II 2. M'u bënë buzët (m'u bë goja) shkrumb shih te SHKRUMB, ~I. Ia ka djegur qulli (luga) buzën shih te QULL, ~I. Fshiji buzët (mustaqet) për murrizi (pas murrizit) iron. bëhesh gati kot, se gjë s'ke për të ngrënë a për të marrë. Është buzë brisku shih te BRISK, ~U. Është buzë gjyshi shih te GJYSH, ~I. Është në buzë të greminës (të humnerës) shih te GREMIN/Ë, ~A. Është në buzë (në grykë, në zgrip) të varrit shih te VARR, ~I. I ka buzët me qumësht mospërf. shih te QUMËSHT, ~I. Ke hundë e buzë!? shih te HUND/Ë, ~A. Ia dha me buzë e pa zemër nuk ia dha diçka me gjithë shpirt, ia dha kundër dëshirës së vet. E ka përgjigjen te buza të përgjigjet menjëherë, aty për aty e pa u menduar gjatë, e ka përgjigjen në majë të gjuhës. Iku (erdhi) me buzë të fryra iku (erdhi) shumë i zemëruar e i mërzhitur, tërë inat. I mbeti (i ngeci, i ngriu) fjala në buzë (në gojë, në grykë, në fyt) shih te FJAL/Ë, ~A. Ta pjek peshkun në buzë të mundon shumë, ta nxjerr shpirtin derisa të mbaron një punë. I shkoi (i vajti) buza (goja) prapa (prapa veshit) shih te PRAPA. E shpuri buzën vesh më vesh shih te VESH, ~I. I vajti (i shkoi) buza (goja) te veshi (vesh më vesh) shih te VESH, ~I. I vuri buzës (gojës) lesh shih te LESH, ~I. Ia do buza, por s'e lë hunda shih te LË. Buzë lepuri mjek. e çarë e thellë në buzët e njeriut që ka lindur me këtë cen.

BUZËBARDHË mb. Sa gomarë buzëbardhë ka! iron. s'është po ajo gjë, s'është ai ose s'është e atij që mendon ti, ka edhe të tjerë si ky.

BUZËQESHJE f. Shkëmbyen buzëqeshje keq. shih te SHKËMBEJ 2.

BUZUK m. muz. I bie buzukut tall. flet shumë e në tym dhe s'ia vë veshin askush, i bie legenit.

BYK m. E bëri byk

BYLYK m. Ra në bylyk vjet. e kapërceu

- moshën e miturisë, arriti moshën madhore dhe mund ta përballojë jetën në mënyrë të pavarur, erdhi në moshë, u bë burrë.
- BYREK** m. gjell. Ta pjek byrekun shih te PJEK I. Nuk më ftohet byreku (pilafi) thjeshtligj. shih te PILAF,~I.
- BYTHË** f. bised. Bytha e kuisë! shar. shih te KUSI,~A. Me bythë përpjetë shih te PËRPJETË. Ishte bythë e brekë me dikë thjeshtligj., keq. ishte tepër i afërt me dikë, ishte i lidhur shumë ngushtë me të. S'i zë bytha vend thjeshtligj., keq. shih te VEND,~I.
- CA** I pakuf. bised. Ca e ca njerëz disa njerëz.
- CA** II ndajf. Ca nga ca
- CACËR** m. Cacër pa dhëmbë shar. shih te DHËMB,~I.
- CAK** m. Gjer në cakun e fundit deri në pikën e fundit. E zuri në cak keq. e zuri duke kryer një vepër të keqe, e zuri me preshe në duar.
- CAKË** f. Është gjithë caka vjedh, ka dorë; është brac. Ka pesëqind caka në kokë ka shumë telashe e kokëçarje, e kanë mbuluar hallet.
- CAKËRR** ndajf. bised. E mban bishtin cakërr keq. mbahet me të madh, kapardiset (zakonisht për femrat).
- CAKORRE** f. Ia preu me cakorre dikujt ia tha në mënyrë të prerë, ia tha copë, ia preu me sëpatë.
- CALIK** m. U bë calik (kacek) shih te KACEK,~U.
- CANGË** f. krahin. E ka kokën cangë është kokëfortë, është kokëgdhe.
- CARAN** m. (E la, mbeti) si carani i vatrës (e la, mbeti) fill i vetëm, i shkretë. Është jashtë (brenda) caranit të vatrës është jashtë (brenda) temës. I vete (më vjen) te carani i shkoj (më vjen) në shtëpi, i shkel (më vjen) në vatër; e pushtoj, e përqafoj si mik.
- CAZË** ndajf. bised. Me cazë
- CEFËL** f. Zuri cefël shih te ZË.
- CEKËT** mb. E ka kokën të cekët nuk mendon thellë, është i lehtë nga mendja.
- CEN** m. Merr cen shih te MARR. Rreth i mbyllur (me cen) libr. shih te RRETH,~I.
- CENSURË** f. Pa censurë pa kontroll, lirisht.
- CEP** I m. Cep më cep në çdo anë, në çdo kënd, kudo; nga një anë në tjetrën, nga një skaj në tjetrin. I bën cepa dikujt përpiqet t'ia hedhë tjetrit, i nxjerr bishta, e mashtron.
- CERGË** f. Cergë e re njeri që sapo ka krijuar familje më vete. Zuri cergë (brumë) shih te ZË. Iu bë cergë i zuri derën tjetrit, ndenji për një kohë të gjatë tek tjetri pa dëshirën e tij; iu ngjiti, iu qep. I kanë vënë (i kanë zënë) cergë sytë nuk e sheh qartë gjendjen rreth e rrotull, është verbuar.
- CEZË** f. krahin. Të dhënçin ujë me cezë! mallk. rënç i sëmurë e mos u ngritsh më!
- CICMIC** m. Luaj cicmic e sjell rrotull diçka a dikë pa i dhënë rrugë; bëj një punë sa për të kaluar kohën.
- CIFËL** f. Mere cifël shih te MARR.
- CIFLOSUR** mb. Me buzë të ciflosur buzëplatur, i hidhëruar.
- CIFUND** m. Ia nxjerr cifundin
- CIGARE** f. Tjetrit i digjet mjekra, ai kërkon të ndezë cigaren shih te MJEK/ËR,~RA.
- CIK** m. Cik më (për) cik pikë për pikë, as më shumë dhe as më pak, aq sa është e aq sa duhet; sa njëri dhe tjetri, barabar.
- CIKNË** f. Iu bënë trutë ciknë u budallallos; u matufos.
- CILËSOR** mb. Analizë cilësore kim. studimi i përbërjes së një lënde, duke përcaktuar elementet e saj.
- CIMB** m. Cimb më cimb majë më majë.
- CIMBËL** f. Ia kam cimblën i kam rënë në erë, e kam diktuar, e di. Kam një cimbël me dikë kam mosmarrëveshje ose kam inat me dikë për shkak të një grindjeje.

- CINGALI** f. krahin. Rri në cingali rri gjithnjë gati, rri me gishtin te këmbëza.
- CINGARE** f. Më mbeti cingare diçka më mbeti si barrë, ma varën në qafë.
- CINGARIDHE** f. U bë cingaridhe u dobësua shumë, u tha fare.
- CINGARISEM** vetv. Cingariset (tiganiset, fërgohet, skuqet) me dhjamin e vet shih te DHJAM/Ë,~I.
- CINGËL** m. Luaj cingël me dikë tallem me dikë, duke mos e marrë një punë me gjithë mend; e sjell rrotull, bëj si dua vetë me dikë.
- CINGËLTHI** ndajf. Luaj cingëlthi me dikë luaj cingël.
- CINGËRIS** kal. I cingëris plagën dikujt e prek në diçka që e shqetëson, i ngacmoj plagën.
- CIP** m. Cip më cip
- CIPAL** m. Është si zogu mbi cipal është në gjendje të keqe ekonomike, rron me të keq. I vë cipalin dikujt shih te VË. Nuk të jep as një majë cipali është shumë dorështrënguar.
- CIPË** f. Cipë qepe shih te QEP/Ë,~A. Cipë e kockë shumë i dobët, kockë e lëkurë. Hodhi cipën e zezë shih te ZI (i), ZEZË (e). I ka plasur cipa (peta) e ballit keq. është bërë i pacipë, s'ka turp fare.
- CIRË** f. krahin. Në cirë zhveshur, lakuriq.
- CIRONKË** f. zool. U bë cironkë u dobësua shumë. S'i ha macja cironkat!? Iron shih te MAC/E,~JA.
- CITANIK** m. Është në citanik është gati me të lindur (për gruan shtatzënë).
- CITË** f. Fut (shtie) cita (fite, fitme, fitila, kalla, kunja, spica) shih te FUT.
- CITË** ndajf. Citë mend i zgjuar shumë, me shumë mend, plot mend, gjithë mend.
- CIU** pasth. As ciu, as miu (as vu) as gëk as mëk.
- CIVIL** mb. Luftë civile shih te LUFT/Ë,~A 1. Vdekje civile humbja e të gjitha të drejtave qytetare.
- CJAP** m. zool. Dhjamë cjapi diçka pa fitim, pa leverdi. Shkoi (vajti) si cjapi te kasapi e gjeti të keqen vetë me këmbët e tij; shkoi vetë pa e ditur se ç'rrezik a ç'e keqe e priste. S'është cjap për atë zile shih te ZIL/E,~JA. Cjapi mish e dhia tavë (dhia mish e cjapi tavë) si njëri edhe tjetri; po e njëjta gjë.
- CJEPURR** m. krahin. M'u bë cjepurr nuk më eci mbarë; më vajti ters.
- COHË** f. Coha (tryeza) e gjelbër vjet. shih te GJELBËR (i,e).
- COKËL** f. U bënë cokla u ndanë e u shpërndanë, u përçanë, u shkëputën e u larguan krejt njëri nga tjetri, u bënë kashtë e koqe.
- COPASH** ndajf. Bëhem copash shih te COP/Ë,~A.
- COPË** f. Bëhem copë (copa, copash) COPË-COPË ndajf. E bëri copë-copë e dërrmoi; e dëmtoi rëndë, e shpartalloi.
- COPËTOHEM** vetv. Më copëtohet zemra për dikë a për diçka pikëllohem shumë, ndiej një dhembje të madhe, prekem thellë.
- COPËTOJ** kal. Ia copëtoi zemrën dikujt ia bëri zemrën (shpirtin) copë.
- COPËTUAR** mb. Me zemër të copëtuar (të thyer) shumë i pikëlluar, me dhembje të madhe, i prekur thellë.
- CUCKË** mb. krahin. Derisa të bëhen gorricat cucka sa t'i vijë qejfi, sa t'i pëlqejë.
- CULL** m. krahin. Cull e mull (me cull e me mull) i madh e i vogël, të gjithë.
- CUNG** m. U bë cung ngriu nga të ftohtët, u bë dru. Dal pas cungut mohoj diçka të pranuar më parë, e cila duket qartë. I ka duart cung është dorështrënguar.
- CUNGAL** m. Është në cungal mbahet në fije të perit, është gati duke rënë, duke u prishur etj.

- CURR** m. Curr më curr kot më kot, kodra pas bregut. I bëri veshët curr (bigë, pipëz, gërshërë, çift, katër) shih te PIPËZ,~A. Ngre veshët curr curroj veshët.
- CURROJ** kal. Curroj veshët ngre veshët për të dëgjuar mirë, vë veshin për të dëgjuar me vëmendje të madhe; përgjoj me kujdes.
- CURRUBABË** f. Bëhem currubabë ënjtem, fryhem.
- CYLE** f. I bie cyles flas kot, nuk më dëgjon njeri ç'them.
Ç' përem.
Ç'qe ata? vjet. shih tek ATA II. Ç'qe ata! vjet., iron. shih tek ATA II. Që ç'ke me të shih te KAM. S'kishte ç't'i hante miu pas darke shih te MI,~U.
- ÇABULLE** f. Bëj çabulle bëj rrëmujë të madhe.
- ÇAÇË** f. Çaçë mbi bukë një e mirë mbi diçka tjetër të mirë, thelë mbi bisht.
- ÇAHEM** vetv. U çanë (rrodhen, u shpuan) qiejt shih te QIELL,~I. Çahet nën lëkurë shih te LËKUR/Ë,~A. Iu ça (iu hap) hunda (për duhan) shih te HAPEM. M'u ça koka kam dhembje të madhe koke; kam zjarrmi të madhe. M'u ça zemra u pikëllova shumë, m'u këput shpirti. U ça e u nda u përpoq me ç'mundi, bëri çmos për të arritur diçka. Nuk çahet pisha me gjilpëra shih te GJILPËR/Ë,~A. Kur kërcente (luante, bënte dasmë) fukarai, çahej daullja shih te DAULL/E,~JA.
- ÇAIR** m. E hëngri çairin (livadhin, barin, kulotën) shih te HA.
- ÇAJ** kal. Çaj (thyej) akullin libr. shih tek AKULL,~I. Të çan (të jep) në ballë shih te
- ÇAK** onomat. Pa çak, pa bam (pa bërë as çak, as bam) pa shkrehur asnjë pushkë, pa luftë; pa ndonjë mundim, pa përpjekje. Bëri çak (arma) nuk shkrep, nuk ndezi. Nuk bëri çak nuk e shkrehu asnjëherë, nuk luftoi.
- ÇAKALL** m. Kur s'ke ara në mal, pse bën dava me çakejtë? fj.u. shih tek AR/Ë,~A.
- ÇAKALLE** f. I bie një çakalleje me dikë flet në mënyrë që t'i bëjë qejfin dikujt tjetër ose si t'i vijë mbarë atij, i shkon për fije.
- ÇAKËL** f. S'bën një çakël nuk ka asnjë vlerë, s'vlen një dysh. Mblodhi (mbajti) çaklat u largua nga një vend me të gjitha ç'kishte, mblodhi lecat.
- ÇAKËLL** m. I hedh çakëll shih te HEDH.
- ÇAKËR** f. Me bakra e me çakra shih te BAK/ËR,~RI.
- ÇAKËRDISEM** vetv. bised. Iu çakërdis gjumi nuk e zë gjumi më, i iku gjumi.
- ÇAKTHI** ndajf. Shtie çakthi mbi të tjerët shquhet mbi të tjerët, është me i fortë e me i zoti, i mposht.
- ÇALË** mb. Po të qëndrosh me të çalin, do të mësosh të çalosh fj.u. po të rrih me njerëz të këqij, do të marrësh veset e tyre.
- ÇALLOJ** jokal. Çalon nga të dyja këmbët shih te KËMB/Ë,~A. S'çalon gomari nga veshët fj.u. nuk e pengon punën një e metë e vogël dhe fare pa rëndësi.
- ÇALLËZ** f. Ha çallëza shih te HA.
- ÇALLMË** f. I vuri çallmën dikujt e mashtroi, i vuri brirë. Lule çallmë bot. çallmare.
- ÇANAK** m. Lëpin çanakët (sahanët) e dikujt. keq. shih te LËPIJ. Ra në çanakun e dikujt. keq.
- ÇANDËR** f. I bëhem çandër dikujt i qëndrojmë përballë pa u përkulur, nuk mposhtem.
- ÇAP** I m. Çap pas çapi
- ÇAP** I jokal. bised. Bëj (shkoj, eci) çap e jakë shih te JAKË,~NI.
- ÇAPOK** m. anat. S'ka çapok nuk ka fuqi ose aftësi të mjaftueshme për të bërë diçka, nuk ka këllqe.
- ÇAPRAZ** ndajf. Ia bëj mendjen çapraz ia ngatërroj mendjen, ia prish mendjen.

- ÇARÇAF** m. U bë çarçaf u zbeh fort nga frika ose nga një tronditje. E bëri çarçaf e bëri copë-copë, e shqeu. Ia bëri mendjen çarçaf ia mori mendjen me fjalë, e hutoi, ia trulloi mendjen. E ka mendjen çarçaf nuk e ka mendjen në rregull, nuk është i përqendruar në një punë, është me mendje të prishur.
- ÇARDAK** m. Çardak pa parmak njeri i paturp, që i ka plasur cipa. Ia bëj çardak dikujt ia paraqit çdo gjë të lehtë e pa vështirësi, ia bëj shesh me lule.
- ÇARE** f. bised. S'ka çare (pa çare) medoemos, patjetër.
- ÇARË** mb. Daulle e çarë keq. diçka pa vlerë, diçka që nuk hyn me në punë.
- ÇARK** m. I çarkut i ri fare, që sapo është prodhuar. Çark i ngrehur shih te **NGREHUR** (i,e). Pushkë (dyfek) më çark njeri me botëkuptim të vjetruar, i prapambetur. Ngriu çark u habit shumë, shtangu. Ia di çarkun e njoh shumë mirë, i njoh dhëmbë e dhëmballë.
- ÇART** kal. Ia çarti (ia prishi) qejfin dikujt shih te **PRISH** 17. Ia çarti (ia prishi) zemrën dikujt shih te **PRISH**.
- ÇARTEM** vetv. U çart (u prish), nga mendja (nga mendtë, mendsh, nga fiqiri) shih te **PRISHEM**.
- ÇAST** m. I çastit
- ÇATI** f. Më ra çatia (shtëpia, tavani, qielli) mbi (në) kokë shih te **BIE** I. Themeli çati le të bëhet! shih te **THEMEL**,~I. Në çati ngjiten me shkallë fj.u. shih te **SHKALL**/Ë,~A. Ia kishte marrë era çatinë shih te **ER**/Ë,~A I. I zoti e di ku i pikon çatia (shtëpia) fj.u. shih te **ZOTI** (i).
- ÇAUSH** m. hist. Rrush çausht bot. lloj rrushi kokërrmadhe i bardhë. Zog çausht zool. shih te **ZOG**,~U.
- ÇDO** pakuf. Për çdo rast për të gjitha rrethanat që mund të paraqiten, për të gjitha nevojat që mund të dalin; sidoqoftë. Me çdo çmim shih te **ÇMIM**,~I
4. Me çdo kusht shih te **KUSHT**,~I. Me çdo mënyrë shih te **MËNYR**/Ë,~A.
- ÇEÇE** f. bised. E bëj çeçe e dërrmoj dhe e shtyp fare, e bëj përshesh, e bëj leckë. I hedh çeçen vjet. i bën magji.
- ÇEÇO** m. bised. Si çeçoja patjetër, do apo nuk do, dashur padashur, medoemos. U bë çeço (tapë, thumb, livadh, xurxull, fushë, karroqe, bërryl...) shih te **BËHEM**. E bëri çeço (lule, nuse, usta) shih te **BËJ**.
- ÇEHRE** f. bised. I ra çehrja e vdekjes shih te **VDEKJ**/E,~A.
- ÇEK** kal. E çeku (e çuku) në kalli shih te **KALLI**,~RI.
- ÇEKAN** m. I bie çekanit diku a në diçka ngul këmbë me të madhe për diçka; tërheq vëmendjen për diçka. Të rrahë (të bjerë) çekani diku ose në diçka të vihet theksi kryesor, të ngulet këmbë me shumë në një drejtim. E mori vesh (e kaptoi) ku rrihte çekani e kuptoi cili ishte thelbi i vërtetë i çështjes, e mori vesh synimin ose qëllimin e vërtetë. Ku i bie çekanit? Ku e hedh fjalën, ku e ka qëllimin? Drapër e çekan shih te **DRAP**/ËR,~RI. I rri çekan (çekiç) mbi kokë e mbikëqyr vazhdimisht për të bërë diçka, e nxit vazhdimisht duke e detyruar të bëjë diçka. Më rrahin shumë çekanë (çekiçë) në kokë (mbi krye) kam shumë shqetësime, kam shumë telashe.
- ÇEKI** f. vjet. Çeki nga mendtë (nga koka) i metë nga trutë.
- ÇEKIÇ** m. I rri çekiç (çekan) mbi kokë shih te **ÇEKAN**,~I. Më rrahin shumë çekiçë (çekanë) në kokë (mbi krye) shih te **ÇEKAN**,~I. Njëri (i bie) kudhrës, tjetri çekiçit (çokut) shih te **KUDH**/ËR,~RA.
- ÇEL** kal. Çel (hap) dyert shih te **HAP**. I çeli (i hapi) derën (dyert, portën) shih te **HAP**. Me çeli drita shih te **DRIT**/Ë,~A. Çel (hap) gojën shih te **HAP**. I çel (i hap) gojën dikujt shih te **HAP**. Çel një hendek krijoj një shkëputje të thellë midis dy anëve; shkaktoj mosmarrëveshje të thella. I çeli një jaki (të keqe) dikujt shih te **JAKI**,~A. I çel (i hap) oreksin

- shih te HAP. Çel (hap, bëj) një paran-tezë libr. shih te PARANTEZ/Ë, ~A I. Çel (hap)sytë shih te SY,~RI. I çel (i hap) sytë dikujt shih te HAP. I çel (i hap) zemrën dikujt shih te HAP. Çel (nxjerr) zogj iron. shih te ZOG,~U. Çel (hap) e s'mbyll keq. nuk pushon së foluri, është llafazan i madh. Çele gur gojën! thuhet kur dikush nuk flet fare, s'e hap gojën fare (aq sa flet guri, aq foli dhe ai). Sa çel (hap) e mbyll sytë shih te HAP. Është nga ata (nga ato) që çelin njëqind (dyzet) dyer në ditë keq. rri tërë ditën duke vaj-tur te njëri e tek tjetri.
- ÇELEM** vetv. Iu çel (iu hap) dera dikujt shih te HAPEM. Iu çel (iu hap) goja shih te HAPEM. M'u çel (m'u hap) oreksi shih te HAPEM. I qe çelur qimja shih te QIM/E, ~JA.
- ÇELEMBYLL** ndajf. Flet çelembyll nuk e thotë drejtpërdrejt mendimin, e bie fjalën rrotull, e lë të papërcaktuar fjalën.
- ÇELË** I f. I gjej çelën i gjej rastin e përshtat-shëm, i gjej anën, i gjej fillin. I zë çelën e zë shumë ngushtë, e vë në gjendje të vështirë e pa rrugëdalje.
- ÇELËS** m. Çelës i artë libr. shih tek ARTË (i, e). Çelës kopil shih te KOPIL,~I. Dorë-zoi çelësat
- ÇELËZ** f. Ia bëri me çelëz veproi me dredhi kundrejt dikujt, ia hodhi.
- ÇELIK** m. Shtyllë çeliku i pathyeshëm e i patundur, që u bën ballë rrebesheve. U vesh me (në) çelik (hekur) shih te VISHEM. Ha (bren) çelikun (hekurin, plumbin, gurin) me dhëmbë shih te DHËMB,~I. I ka dhënë ujë çeliku dikujt e ka bërë të ashpër e të rreptë; e ka bërë të vrazhdë e të egër në shpirt. Është zier në lëng çeliku ka vuajtur shumë e është kalitur në jetë, është regjur nga jeta.
- ÇELUR** mb. Me ballë të çelur (të hapur) shih te HAPUR (i,e). Me zemër të çelur (të hapur) shih te HAPUR (i,e).
- ÇELUR** ndajf. Ëndrra me sy çelur (hapur, hapët) shih tek ËND/ËRR,~RRA 3. E ka derën çelur (hapur) shih te HAPUR. E mban derën çelur (hapur) shih te HAPUR.
- ÇEMBER** m. vjet. I ra një çember u zbeh në fytyrë.
- ÇENGEL** m. U bë çengel u dobësua shumë, u tha e u tret. Hodhi çengelin (grepin) shih te HEDH. Ka hedhur çengelat dikush a diçka keq. shih te HEDH. Ia nxjerr me çengel dikujt e bëj të flasë me shumë për-pjekje, mundohem shumë që ta bëj të thotë diçka. Çdo mish (berr) varet nga çengelin e vet (nga këmbët e veta) fj. u. shih te MISH,~I.
- ÇEREK** m. E bej çerekë e bëj copa-copa, e copëtoj.
- ÇEREP** m. E kam çerepin në zjarr shih te ZJARR,~I.
- ÇERVISH** m. vjet. Është bërë si lugë çervishi fut hundët në çdo punë, përzihet kudo.
- ÇESHIT** m. vjet. Çeshit me vete njeri me ti-pare të veçanta, pak të çuditshme.
- ÇETELE** f. vjet. E vë në çetele e mbaj shënim, e shënoj për të mos e harruar a për ta mbajtur parasysh. Janë puthitur çetelja me çetelen keq. janë bashkuar dy njerëz të njëjtë, janë si njëri tjetri, ka gjetur tenxherja kapakun.
- ÇETË** f. E laj çetën marr hakun me të tepërt, e kapërcej masën. I la çetën shih te LË.
- ÇEZMË** f. Të çon (të shpie) në njëqind (në dyzet) çezma (në krua, në shtatë kroje) e s'të jep ujë shih te KRUA, KROI.
- ÇËSHTJE** f. Çështje jetë a vdekjeje shih te JET/Ë,~A I. E bëj çështje e ngre me të madhe diçka; e kërkoj me këmbën-gulje, tërheq vëmendjen e të gjithëve për diçka. E bëj çështje të përbashkët veproj së bashku me një tjetër (zakonisht për një punë të shtrembër). Për se është çështja? për se është fjala, ç'problem ka dalë, si është puna?
- ÇIBAN** m. Si qelbi në çiban shih te QELB,~I. Lëpijnë çibanët (plagët) e njëri-tjetrit keq. shih te LËPIJ.

- ÇIFLIG** m. hist. E ka bërë çiflig vepron me një pasuri të huaj sikur ta ketë të vetën; bën si të dojë në një vend, merr nëpër këmbë interesat e një vendi.
- ÇIFT** mb. Shtiem tek a çift shih tek TEK,~E.
- ÇIFT** ndajf. I bëri veshët çift (bigë, curr, gërshërë, pipëz) shih te PIPËZ,~ A. I bëri këmbët çift (baras, kizë) mospërf. shih te KËMB/Ë,~A.
- ÇIKË** I f. (Burrë, djalë, trim...) me çika trim e i zoti, që shquhet midis të tjerëve. Asnjë çikë aspak; fare. Për një çikë për pak, gati sa, për një fije, pothuaj. Çikën e pikën gjithçka, çdo gjë. Çikë e nga një çikë pak nga pak. Pa çikë e pa nishan pa lënë asnjë gjurmë, pa nam e pa nishan. Jep çikë dikush a diçka nis të dalë, zë e shfaqet. I doli çika diçkaje doli në shesh, u zbulua. E bëri copë e çikë (copë, thërrime, copë e kothere, copë e thërrime, copë e grime) shih te BËJ. I lëshojnë (i bëjnë, i nxjerrin) sytë çika (xixa, shkëndija) shih te SY,~RI.
- ÇIKË** III f. zool. ÇIKË E VOGËL zool. Zog i vogël me kaçule të verdhë në majë të kokës, me pupla ngjyrë ulliri në pjesën e sipërme të trupit dhe me dy rripa të bardhë e të hollë në krahë.
- ÇIKËL** f. kryes. sh. Çikël e pikël në shumë copa të vogla, copë e çikë,
- ÇIKRIK** m. I ka luajtur (i ka ikur) çikriku nuk është në rregull nga mendtë, nuk e ka mendjen në vend.
- ÇILEK** m. bot. Rrush çilek shih te RRUSH,~I.
- ÇIMKË** f. zool. Iu bë çimkë (ferrë, rriqër, këpushë, rrodhe) shih te BËHEM.
- ÇIP** m. Çip më çip
- ÇIP** mb. I ngre veshët çip i ngre veshët për-pjetë për të dëgjuar më mirë, curron veshët.
- ÇIRAK** I m. E bëri (e qiti, e nxori) çirak dikë edhe iron. e ndihmoi shumë dikë, i bëri një shërbim të madh, e nxori në dritë.
- Doli çirak edhe iron. i kaloi vështirësitë që kishte pasur, doli në dritë.
- ÇIRREM** vetv. Çirret (bërtet, flet) në të gjitha udhëkryqet libr. shih tek UDHËKRYQ,~I.
- ÇIVI** f. I shtrëngoi çivitë (vidhat, burgjitë) dikujt shih te SHTRËNGOJ.
- ÇIVIT** m. Bëhet çivit (në fytyrë) mavijoset, kaltërohet.
- ÇIZME** f. kryes. sh. Kusar (hajdut) me çizme, mashtrues i madh, që grabit me shumicë e që di të fshihet mirë. I lëpin (i puth) çizmet (këmbë) dikujt keq. shih te LËPIJ.
- ÇJERR** kal. Çjerr zërin bërtas sa ngjirem, thërras sa më ikën zëri. Ia çjerr cipën dikujt ia nxjerr turpin. Ia çori veshët dikujt e mërziti shumë dikë me fjalë që nuk ia ka ënda, i çau kokën. E çjerr ku s'arohet dëmtoj në një vend që nuk mund të ndreqet më.
- ÇJERRË** mb. Me zemër të çjerrë shumë i pikël-luar, me zemër të copëtuar.
- ÇMBËSHILLEM** vetv. Po i çmbështillet lëmshi dikujt po i afrohet vdekja, po shkon drejt mbarimit të jetës.
- ÇMOS** pakuf. bised. Çmos kurrë si asnjëherë tjetër. Bëj çmos (e çnuk) bëj çdo gjë të mundshme, përpiqem me të gjitha mjetet e mënyrat për të arritur diçka, nuk lë gjë pa bërë.
- ÇMUAR** mb. Gur i çmuar gur ose mineral i rrallë me ngjyra të ndryshme, që përdoret sidomos në punimet e argjendarisë. Metalet e çmuara metalet e rralla si ari, argjendi, platini, që nuk ndryshken.
- ÇNUK** pakuf. bised. Bëj çmos e çnuk shih te ÇMOS.
- ÇOBAN** m. Si dhentë pa çoban pa udhëheqje, pa drejtues a pa kujdestar, si dhentë pa bari.

ÇOHEM vetv. Çohet gavole shih te GAVOL/E,~JA. Çohem në këmbë nis a ndërmar një punë me rëndësi, mbledh të gjitha fuqitë për të bërë një punë të madhe. Më çohet (më ngrihet) mendja shih te NGRIHEM. Çohet (ngrihet) peshë shih te PESHË. Është çuar në pupë shih te PUP/Ë,~A IV. I çohet të rëndët shih te RËND,~T (të). Bjer e çohu (ngrehu e bjer) shih te BIE I. Iu çuan (iu ngritën) flokët (qimet, leshrat e kokës) përpjetë shih te FLOK,~U. Çohen (ngrihen) këmbët i bien kokës shih te KËMB/Ë,~A.

ÇOJ I kal. Çoj më andej (më tej) e shpie më përpara diçka, bëj që të arrijë në një cak më të përsosur. E çon batbat diçka shih te BATBAT. E çuan (e shpunë) dardhë! shih te DARDH/Ë,~A. E çoi (e dërgoi) në djall (në dreq) dikë a diçka thjeshtligj., keq. shih te DJALL,~I. E çoi (e shpuri) fjalën për dikë a për diçka shih te SHPIE. S'e çon (nuk e shpie) më gjatë shih te GJATË. E çoj (e shpie) mendjen diku a te dikush e sjell ndër mend diçka a dikë, nis të mendoj për diçka a për dikë. E çoi poshtë dikë a diçka shih te POSHTË. E çoi (e nxori, e pruri) rruga (udha) shih te RRUG/Ë,~A. E çon trashë dikush shih tek TRASHË. E çoi në varr dikë shih te VARR,~I. E çoj (e shpie) në vend (një fjalë, një urdhër, një porosi etj.) shih te VEND,~I. E çoj (e marr, sjell)për veshi dikë shih te VESH,~I. Të çon (të shpie, të hedh) degë më degë shih te DEG/Ë,~A. E çofshin me katër veta! mallk. vdektë! Mos e çoftë kryet (kokën) shëndoshë! mallk. vdektë! Ku të çon (të shpie) mushka! shih te MUSHK/Ë,~A. Çon (shpie) ujë në mullirin e dikujt shih tek UJ/Ë,~I. Ta çon (ta shkon, ta lëshon, ta fut, ta kalon) ujin nën rrogoz (nën hasër, nën vete) shih te RROGOZ,~I. E çoi në vend të vetën shih te VEND, ~I. Çon një pelë e ha një thellë fj. u. shih te PEL/Ë,~A.

ÇOJ II kal. E çoi (e ngriti, e nxori, e qiti) nga balta dikë shih te BALT/Ë,~A. Çon (ngre) dorë (dorën) kundër dikujt shih te

NGRE. Çoi (ngriti) duart lart (përpjetë) shih te NGRE. Çoj (ngre) gotën (dollinë, kupën, shëndetin) shih te NGRE. Një gur s'çon (s'bën) mur fj.u. shih te GUR,~I. Çon (ngre) hundën (përpjetë) shih te HUND/Ë,~A. Nuk çon (nuk ngre) kandar (peshë) edhe poh. shih te KANDAR,~I. S'e çon (s'e ngre, s'e mban, s'e heq) kandari shih te KANDAR,~I. Çoj (ngre) kokë (krye) shih te NGRE.

ÇOK m. I bie çokut flet kot më kot, rreh ujë në havan. Kam shumë çoqe mbi kokë kam shumë punë a telashe, kam halle të mëdha.

ÇOPARKA f. vet. sh. I ngriti (i mblodhi, i mori) çoparkat iron. e braktisi një vend, u largua menjëherë, ua mbathi këmbëve.

ÇORAP m. kryes. sh. E bëri çorap e bëri rrëmujë, e bëri lesh e li. S'po bëj çorap s'më ecën puna mirë, nuk bëj përpara në diçka. Nuk bën çorap me dikë nuk shkon mirë me dikë, nuk ka marrëdhënie të mira me të. E bën (e hap, e ka) gojën çorap flet shumë, llototit tepër, është llafazan i madh. Ia bëj mendjen çorap ia prish mendjen dikujt, ia bëj mendjen çorbë.

ÇORBË f. Çorbë derri

ÇOTË f. Është çotë nga goja e ka gjuhën të mprehtë, është brisk nga goja.

ÇUAR mb. Si lepur i çuar shumë i shqetësuar, si mbi gjemba.

ÇUÇ m. ÇUÇ GOMARI zool. Lloj zogu me sqep të trashë.

ÇUDI f. (Si) për çudi në mënyrë krejt të pabesueshme e të papritur.

ÇUDITËSE mb. gjuh. Pikë çuditëse pikëçuditje.

ÇUK kal. E çuku (e çeku) në kalli shih te KALLI,~RI.

ÇULL m. U bënë çull u veshën me të zeza në shenjë zie. I vë çullin dikujt i sjell fatkeqësi të madhe dikujt, i sjell vdekjen, i sjell zinë.

ÇURKË f. Derdh djersën çurkë shih te DERDH.

- ÇYREK** m. M'u bë zemra çyrek u gëzova shumë, m'u bë zemra mal. Po i shtie çyrekët të mirë (bukët të mira) shih te SHTIE.
- DAC** m. Është (mbeti) si daci në gaviç është në gjendje të keqe, është zënë ngushtë, nuk di nga t'ia mbajë.
- DAÇ** lidh. bised. Në daç qoftë, daç.
- DADË** f. I rri si dadë dikujt nuk i ndahet, kujdeset në mënyrë të tepruar për dikë, duke mos e lënë t'i bëjë vetë as gjërat më të vogla. S'e ka dadë dikë nuk ia dëgjon këshillat a porosinë dikujt; s'është i vogël që të zbatojë vetëm udhëzimet e më të moshuarve.
- DAFINË** f. Fle (prehet, e ka zënë gjumi) mbi dafina ka rënë në qetësi e është shkujdesur pas arritjes së një suksesi, të një fitoreje etj., është vetëkënaqur, ia ka marrë mendtë lavdia dhe nuk punon e nuk lufton më tej. Dafinë deti bot. landër. E diela e dafinave (e larit, e luleve) fet., vjet. e diela një javë para pashkëve.
- DAJAK** m. I vuri dajakun dikujt shih te VË. Me shajak e me dajak shih te SHAJAK,~U.
- DAJË** m. I thotë (i thërret) derrat dajë thjeshtligj. nga e keqja quan mik edhe atë që s'e do e s'i pëlqen; i bën qejfin një njeriu jo të mirë. S'ka më qofte te daja shih te QOFT/E,~JA.
- DAJRE** f. Bëjnë dajre argëtohen duke i rënë dajres; bëjnë aheng.
- DAL** jokal. Doli nga ama shih tek AM/Ë,~A I. Dal (e nxjerr) në anë shih tek AN/Ë,~A I. Më doli asi shih tek AS,~I I. Doli (u ngrit) nga balta shih te BALT/Ë, ~A. I ka dalë (i ka mbirë) bari (në faqe, në sy) shih te BAR,~I I. Ka dalë nga binarët shih te BINAR,~I. I doli boja keq. shih te BOJ/Ë,~A I. Doli (u bë) bollë një punë shih te BOLL/Ë,~A.
- DALË** f. Dala e gjësë veter. plasja.
- DALË** f. Të hyra e të dala shih te HYR/Ë,~A (e). Të dalat jashtë mbeturinat e padobishme të ushqimit që nxjerr jashtë njeriu a kafsha, të pëgërat.
- DALË** as. Të dalët jashtë veprimi që bën njeriu a kafsha për të nxjerrë jashtë mbeturinat e panevojshme të ushqimit; jashtëqitja.
- DALË** ndajf. Ia ktheu dalë ia ktheu përgjigjen aty për aty, iu përgjigj flakë për flakë. S'ia lë dalë dikujt nuk mbetet prapa dikujt; nuk ia kalon kush, s'ia lë mangut. Më parë e më dalë shih te PARË.
- DALJE** f. Hyrje e dalje shih te HYRJ/E,~A. E bëj dalje diçka fin. bëj veprimet për të nxjerrë një mall nga magazina.
- DALTË** f. Ia la në daltë dikujt u tregua më i zoti e më i shpejtë se dikush tjetër, ia la në dorë.
- DALLËNDYSHE** f. Dallëndyshja e parë shenja e parë e diçkaje që do të vijë me shumicë; ai që çan i pari drejt diçkaje të re e pak të njohur. Qumësht dallëndysheje shih te QUMËSHT,~I. Janë si zogjtë e dallëndyshej janë fare të brishtë e të pafuqishëm dhe kanë nevojë për ndihmë, përkrahje e kujdes të drejt-përdrejtë. Me një dallëndyshe (me një lule) s'vjen pranvera (behari) fj.u. shih te LUL/E,~JA. Bar dallëndysheje bot. shih te BAR,~I I.
- DALLGË** f. Merr dallgë shih te MARR. Është me dallgë dikush është i zymtë e tërë inat, i ka hipur inati. E paskan kapur dallgët dikë qenka zemëruar shumë, qenka tërë inat; po shfryn e turfullon nga inati.
- DALLIM** m. Plotës dallimi gjuh.,vjet. shih te PLOTËS,~I.
- DAMAR** m. I kërcen (i hipi, iu ndez, iu ngrit, e zuri) damari u inatos, u zemërua, mori inat menjëherë. I zbriti (i ra) damari i ra zemërimi, u zbut. I ka plasur damari (delli) i ballit (i marres) keq. nuk ka më turp nga asgjë, është bërë i paturpshëm, i ka plasur cipa. E ka një damar (dell)

marrëzie (marrie) është pak si i marrë, është ca kokëkrisur.

DAMKË f. Është me damkë është i njohur nga të gjithë si i keq, ka fituar nam shumë të keq.

DAMLLA f. bised. Damllaja e qumështit veter. sëmundje e rëndë e bagëtive, që shfaqet me dobësim të përgjithshëm, me fryrje të syve e të barkut dhe me çrregullimin e të ecurit.

DANGALL m. bised. U bë dangall hëngri a piu jashtë mase, u fry së ngrëni a së piri, u bë kacek.

DARDHAR m. E preu me sëpatën e dardharit (me sëpatë të madhe) shih te SËPAT/Ë,~A.

DARDHË f. Ka rënë në dardhë dikush ka rënë ngushtë, është zënë ngushtë, është në hall. I doli dardhë diçka nuk i doli mirë një punë, nuk i doli ashtu siç e parashikonte, i doli më e vështirë nga ç'mendonte; nuk i eci. Do t'i dalin dardhat dikujt do t'i dalin në shesh dallaveret që ka bërë, do t'i dalin të palarat. Do ta haje dardhën dikush shih te HA. Është rrëzuar (një herë) nga dardha dikush e ka pësuar një herë dhe ka vënë mend, është qen i rrahur; ka përvojë nga jeta, është i rrahur me jetën. Dardha në shënëndre gjepura, pallavra, punë boshe. S'bëjnë dardhat në shënëndre është e pamundur të bëhet a të ndodhë diçka, nuk ka mundësi të ngjasë; çdo punë do kohën e vet dhe kushtet e nevojshme. Kërkon dardha (thana, thanëza, rrush) në shënëndre (në dimër) kërkon të pamundurën, kërkon qiçra në hell. E shpunë (e çuan) dardhë u zunë njëri me tjetrin, bënë fjalë, u grindën; i keqësuan, i ashpërsuan marrëdhëniet. Dardha nën dardhë bie një njeri do t'u ngjajë pa tjetër të parëve të tij, vetitë e cilësitë e prindit do të shfaqen edhe te fëmijët. Kërkon dardha nga boriga shih te BORIG/Ë, ~A. Dardha e ka bishtin prapa fj. u. çdo punë, që mund të duket e lehtë e pa telashe, ka edhe pasoja të paparashikuara (zakonisht kur pasojat janë

jo të mira). Është ende në fund të dardhës është ende prapa, është ende në bisht.

DARË f. Ia nxjerr (fjalët) me darë e detyroj të më thotë ato që di, ia nxjerr me zor; përiqem shumë që t'i nxjerr nga goja ato që di, ia nxjerr me grep (fjalët, të vërtetën etj.). Ia shtrënguan darët dikujt shih te SHTRËNGOJ.

DARKË f. Darkë për kokën e darkës darkë e pasur, me të ngrëna e të pira të shumta. S'kishte ç't'i hante miu pas darke shih te MI,~U. S'kishte as një darkë bukë kishte mbetur pothuajse fare pa bukë a pa miell. Ku e zë dreka se zë darka shih te DREKË,~A. Ç'pështyn në mëngjes, e lëpin në darkë shih te LËPIJ.

DASMË f. Dasmë pa aheng shih tek AHENG,~U. Dasma e argjenditë libr. shih tek ARGJENDTË (i, e). I bënë dasmën dikujt iron. e vranë. Vjen (shkon, nisët) si në dasmë vjen (shkon, nisët) në një punë i papërgatitur, i shkujdesur, pa mjetet e pajisjet e nevojshme. S'bëhet dasma me një fyell fj. u. shih te FYELL, ~I. Dasmë pa mish nuk ka (nuk bëhet) fj. u. nuk ka luftë e fitore pa gjak, në çdo luftë ka edhe të vranë. S'ka dasmë çdo ditë (për ditë) fj. u. s'ka përherë të mira e gëzime. S'prishet dasma për një qepë (për një limon)fj. u. nuk duhet prishur a nuk duhet lënë një punë e madhe për diçka të vogël e fare të parëndësishme. Nuk shkohet me tre rupe në dasmë fj. u. shih te RUP,~I. La dasmën e shkoi për shkarpa shih te SHKARP/Ë, ~A. Lë të vdekurin e shkon në dasmë shih te VDEKUR, ~I (i). Gjetkë daullet, gjetkë dasma shih te DAULL/E, ~JA. Po dëgjove daullen, dasmën e ke prapa (te dera) shih te DAULL/E,~JA. Kur bënte dasmë (kërcente, luante) fukarai, çahaj daulla shih te DAULL/E,~JA. Atje ku bëhet dasmë e madhe, merr lugë të vogël! fj. u. shih te LUG/Ë,~A.

DASH m. Dash me flokë shih te FLOK,~U. Dash me këmborë shih te KËMBOR/Ë,~A. Si dashi me këmborë

shih te KËMBOR/Ë,~A. Dashi i kurbanit shih te KURBAN,~I. Shkoi si dash kurbanit shih te KURBAN, ~I. Si dashi me rrurëzën shumë mirë, në pajtim të plotë. Kërkon shtjerrat e deshve kërkon diçka të pamundur. Mori dash delja shih te MARR 33. Vajti si lëkurë dashi shih te LËKUR/Ë,~A. Dash hidraulik tek. mekanizëm që shërben për ngritjen e ujit.

DASHE f. Kërpudhë dashe bot. shih te KËRPUDH/Ë,~A 1.

DASHUROHEM vetv. Është dashuruar me vetveten keq. i pëlqen tepër vetja, është bërë egoist.

DAULLE f. Daulle e shpuar keq. shih te SHPUAR (i, e). Daulle e çarë keq. shih te ÇARË (i, e). E bëri daulle dikë përçm. e la të vdekur në vend. U bë daulle dikush thjeshtligj.

DAVA f. bised. E fitoi davanë doli i fituar, fitoi. E humbi davanë s'fitoi gjë, nuk ia arriti qëllimit, dështoi. Kur s'ke ara në mal, pse bën dava me çakejtë? fj. u. shih tek AR/Ë,~A. Hamë bukën tonë e bëjmë davanë e botës (rrahim thekrën e botës) shih te BUK/Ë,~A.

DE bised. Hajde de thjeshtligj. gjene mirë, s'është keq; ku e gjen të jetë kështu!

DEF m. E bëri def dikë mospërf. e hoqi qafe dikë, e shporri. Bëhu def! shporru!, largohu menjëherë! Nuk i bën koka def dikujt as që pyet fare, s'do t'ia dijë, është kokëfortë; është kokëkrisur. Ia bëfshin lëkurën def! mallk., thjeshtligj. vdektë!

DEFTER m. Defter bakalli keq. shih te BAKALL,~I. Ka dalë nga defteri nuk është më i aftë për punë a për diçka tjetër, nuk është më i zoti; u plak; nuk mund të mbështetemi më tek ai. Hap defterët (e vjetër) edhe keq. ringjall një çështje (zakonisht të pakëndshme), që është mbyllur më parë, rikujton të kaluarën, kujton hesapet a meritë e vjetra që ka me dikë. E hoqi (e shleu, e fshiu, e shoi) nga defteri dikë a diçka nuk mbështetet më tek

ai, nuk ka më shpresë se mund ta ndihmojë, nuk e llogarit më, s'e zë në hesap; nuk e përfill më dikë, nuk kujdeset e nuk bëhet merak më për të. E mbylli defterin (i mbylli defterët) i dha fund një çështjeje, një problemi etj. S'e vë (s'e fut, s'e shtie, s'e ka, s'e shkruan) në defter dikë a diçka edhe poh. s'e përfill dikë a diçka, s'i kushton vëmendje; s'e merr parasysht diçka.

DEGDISEM vetv. bised. Ku nis e ku u degdis! shih te NISEM.

DEGË f. Ka rënë nga dega i ka rënë autoriteti, nuk është më ai i pari, ka rënë nga pozita që kishte; nuk i shkon më fjala. Ka rënë nga shtatë degët ka shumë përvojë nga jeta, është i rrahur me jetën, ka kaluar në prova të vështira. Të hedh (të shpie, të çon) degë më degë e sjell fjalën rrotull e rrotull, sa andej-këtej, pa u përqendruar aty ku duhet e pa e sqaruar deri në fund një çështje; nuk të jep përgjigje të qartë, nuk të jep rrugë. I mbushur degë me degë i mbushur plot e përplot, buzë me buzë, rrafsh. E shqyrtuan (e panë) degë më degë e shqyrtuan me rrënjë, me themel; e zbërthyen hollësisht, fije e për pe. Kapet pas degëve (e jo pas trungut) niset jo nga hallka kryesore, por nga gjërat e dorës së dytë. E kap për degësh e kap diçka jo atje ku duhet e si duhet; merret me gjëra të vogla e anësore, duke lënë mënjanë ato kryesoret e të rëndësishmet; e kap diçka për flokësh. Mbeti lis pa degë (si pika në lis) shih te LIS,~I. Ka mbetur (është bërë) si qyqja në degë shih te QYQ/E,~JA.

DEHEM vetv. Dehet pa pirë iron. e humbet mendjen, turbullohet shpejt, pa ndonjë arsye të rëndësishme, pa shkak; është tepër mendjelehtë e i papërmbajtur. Dehet me një iron. gëzohet e entuziazmohet kot, dehet pa pirë. Tjetri pi, ai dehet shih te PI.

DEHJE f. Dehja e thellësisë mjek. turbullimi e humbja e ndjenjave që vihet re te disa zhytës pasi kalojnë thellësinë pesëdhjetë

metra, kur nuk kanë marrë masa mbrojtëse.

DELE f. U bë dele iu zbardhën fare flokët, u thinj krejt. Si delja në hell në gjendje shumë të vështirë, pa asnjë shpresë shpëtimi. Ndjat delet (dhentë) nga dhitë shih te DHI,~A. Milte dy qyqe dele (dhi) shih te MJEL. Nuk fle (nuk kullot) delja me ujku bashkë fj.u. nuk mund të ketë paqe e bashkëpunim ndërmjet atij që është i ndershëm e punëtor dhe armiqve të egër e të pabesë. Djalli s'ka dele dhe shet lesh shih te DJALL,~I. Kërkon qumësht nga delja shterpë shih te QUMËSHT, ~I. Delen e vetme (që ndahet nga tufa) e ha ujku fj. u. ai që ndahet nga shokët, nga kolektivi e pëson keq. Delja ka kullot, atje lë leshin fj.u. thuhet për një njeri, i cili i shërben atij që i jep të hajë, që e paguan. S'dalin dy lëkurë nga një dele (nga një berr) fj.u. shih te LËKUR/Ë,~A 1. Delja e zezë s'bëhet kurrë e bardhë fj.u. njeriu i lig ose armiku nuk mund të bëhet kurrë i mirë; ujku qimen e ndërton, por lëkurën nuk e ndërton.

DELFIN m. Stil delfin sport. shih te STIL,~I 5.

DELL m. I kërceu (i hipi, iu ngrit) delli i ballit

DEM m. Dem me brirë shih te BRI,~RI. Mori dem lopa shih te MARR 33. E kap (e zë) demin (kaun) për brirësh (nga brirët) shih te BRI,~RI. Demin e shtron zgjedha fj.u. shih te ZGJEDH/Ë,~A.

DEMOKRATIK mb. Centralizëm demokratik shih te CENTRALIZ/ËM,~MI.

DENG m. S'bëhet deng me rrush (s'bëhet rrushi deng) fj. u. shih te RRUSH,~I. I ka lidhur (i ka mbledhur) dengjet i ka rregulluar mirë punët e veta, i ka vënë punët në vijë.

DERDH kal. I derdhi (i vuri) balsam shih te BALSAM,~I. I derdhi barkun (zemrën) dikujt shih I zbraz (i hapi, i zbuloi) barkun dikujt te ZBRAZ. Derdh djersë (derdh djersën çurkë) punoj shumë e pa

u kursyer. Ka derdhur gjakun ka luftuar me armë për një çështje të madhe, ka dhënë jetën. Derdh gjak vras a plagos rëndë dikë. Derdh jargët për diçka thjeshtligj. i lëshon goja lëng dikujt për diçka, e lakmon shumë. Derdh lot qan; vajton; i vjen shumë keq, i dhemb zemra. Derdh mendtë nuk e ka mendjen në një vend, e shpërndan mendjen sa andejkëtej. Derdh trutë lodhet shumë duke menduar a duke u marrë me punë mendore. Ia derdhi trutë dikujt thjeshtligj. e vrau duke e qëlluar në kokë, ia hodhi trutë në erë. Ia derdhi zorrët dikujt thjeshtligj. e vrau, duke e goditur me shpatë etj. në bark. Derdh (nxjerr, lëshon) mjaltë (sheqer) nga goja shih te MJALT/Ë,~I. I derdh (i tret) plumb në gojë (në grykë) e vras pa mëshirë, e asgjësoj (armikun).

DERDHEM vetv. Është derdhur gjak është bërë luftë e madhe e janë vararë njerëz. U derdh kupa kaloi çdo masë e kufi, nuk mund të durohet më. Ia derdh si shirit shih te SHIRIT,~I. Ia derdhën trutë dikujt thjeshtligj. mbeti në vend, vdiq (kur është goditur në kokë). Iu derdhën zorrët thjeshtligj. u vra, ra i vdekur përtokë (kur është goditur në bark). U derdh gjaku pellg shih te PELLG,~U. Gjalpi në lakror derdhet (bie, mbetet) fj. u. shih te BIE I. U derdh vaji, s'mblidhet më fj. u. shih te VAJ,~I I.

DERË f. I fiku derën i bëri dëm shumë të madh, e mori me qafë; e la të shkretë, e la pa njeri. Ia ferrosi derën (shtëpinë) dikujt shih te FERROS. Gëzim për derë iron. diçka që më ndodh mua sot, mund të të ndodhë edhe ty nesër. Hap (çel) dyert shih te HAP. I hapi (i çeli) derën (dyert, portën) shih te HAP. Iu hap (iu çel) dera dikujt shih te HAPEM. T'u haptë dera! shak. shih te HAPEM. Me dyer të hapura shih te HAPUR (i, e). Na e harroi derën (shtëpinë) nuk na vjen më dikush në shtëpi. S'të hiqet nga dera dikush vjen shpesh e të mërzit, s'të ndahet. Në derë të huaj shih te HUAJ (i,e). E humbi derën shih te HUMB. Është (ka

ardhur, e kam) në derë (te dera, prapa derës, në prag të derës) është fare pranë, zëre se ka ardhur. Ia la në derë diku

DERI Deri diku shih te DIKU.

DERIÇKË f. Hyri (doli) nga deriçka hyri (doli) fshehurazi. E nxorën nga dera, hyri nga deriçka (nga dritarja) shih te DER/Ë,~A.

DERMAN m. bised. Pa derman medoemos, patjetër, bën s'bën. Asnjë për derman fare, hiç.

DERT m. bised. Bëj dert shih te BËJ. S'kam dert për dikë nuk dua t'ia di për dikë, s'pyes fare, s'bëhem merak për të.

DERVISH m. Hutë dervishi shih te HUT/Ë,~A II. Zogu dervish zool. shih te ZOG,~U.

DERR m. U bë derr u mërzi shumë, plasi nga mërzia. M'u bë derr dikush a diçka m'u neverit, s'e shoh dot me sy. Iu bë shpirti derr (gomar) u mërzi shumë nga dikush a nga diçka, s'e duron dot më. Çorbë derri shih te ÇORB/Ë,~A. Derr në thes keq. shih te THES,~I. Si derri (si pata) në gjetkëz shih te GJETKËZ,~A. Si derri në thark shumë i mërziur. Jetë derrash jetë e rëndë, jetë e ndyrë. Është kripë derri shih te KRIP/Ë, ~A. Mëlçi (zorrë) derri diçka pa ndonjë vlerë të madhe, gjë që nuk përfilllet. Pëlcet derri është shumë vapë, është vapë e padurueshme. Pëlcet derrin dikush a diçka të fryn e të zemëron pa masë; të mërzi shumë. Punon si derr punon shumë, i qepet e s'i ndahet punës, punon derçe. Një qime derri shih te QIM/E,~JA. Stallë (thark) derrash keq. dhomë, sallë etj. e fëlliqur, e mbajtur shumë keq. Derri do plumb fj. u. armiku duhet asgjësuar me mënyra e me mjete të forta, nuk ka mëshirë për armikun; e keqja duhet zhdukur menjëherë e me rrënjë. Nuk ka pyll pa derra fj. u. bashkë me të mirat do të gjesh edhe ndonjë gjë të keqe; s'janë të gjithë të mirë, midis shumë të mirëve ka edhe ndonjë të keq. Mori derr dosa shih te MARR 33. Shkul një qime

nga një derr (shkul një gur nga një mur) shih te SHKUL. I thotë (i thërret) derri dajë thjeshtligj. shih te DAJ/Ë, ~A. Kur të hipë derri (gomari) në fik (në majë të fikut) thjeshtligj. shih te GOMAR,~I. Hyn derri e dosa keq. hyn e del gjithkush si në një shtëpi pa zot, është han me shtatë porta. Të gjithë derrat një turi kanë fj. u. njerëzit e këqij të gjithë njëloj janë, pavarësisht nga ndonjë dallim i vogël midis tyre. Nuk fshihet derri në thes fj. u. nuk mund të fshihet a të mbulohet e vërteta. Ku di derri këmborë mospërf. thuhet për dikë që nuk merr vesh nga një punë a nuk kupton dot përse bëhet fjalë ose për dikë që nuk di të vlerësojë diçka të mirë; ku di dhia ç'është tagjia. Vath i florinjte në vesh të derri shih te FLORINJTË (i, e). Bar derri bot. shih te BAR,~I 1. Bukë derri bot. shih te BUK/Ë,~A. Kërpudhë derri bot. shih te KËRPUDH/Ë,~A. Lule derri bot. shih te LUL/E,~JA. Shiriti i derri veter., mjek. shih te SHIRIT,~I 3.

DERRKUC m. DERRKUC INDIE zool. Kafshë e vogël brejtëse me lëkurë të lëmuar e me veshë të rrumbullakët, që e ka prejardhjen nga Amerika e Jugut.

DET m. Det mbi det kudo, në çdo vend. U bë det

DEVE f. E bën vezën deve i zmadhon shumë gjërat, e bën mizën buall.

DËBUAR mb. Rri si qen i dëbuar keq. rri mënjane, me frikë e i shtruar, rri me bisht ndër shale, si qen i rrahur.

DËFTEJ kal. I dëfteu (i tregoi) dhëmbët diku shih tek TREGOJ.

DËFTOR mb. gjuh. Mënyra dëftore një nga mënyrat e foljes në gjuhën shqipe, e cila shpreh një veprim ose gjendje që mendohet nga folësi si diçka që ndodh a është, ka ndodhur a ka qenë, do të ndodhë a do të jetë me të vërtetë (p.sh. punoj, ndodhem, punoja, ndodhesha, kam punuar, do të punoj etj.).

- DËGJOHEM** vetv. Dëgjoheh nëpër botë keq. merret nëpër gojë, flasin e përflasin për dikë. I dëgjoheh fjala dikujt ia pranojnë mendimin, porosinë etj., ka ndikim tek të tjerët, i shkon fjala, i zë vend fjala. Nuk dëgjoheh as miza shih te MIZ/Ë,~A. Do t'i dëgjoheh (do t'i ndihet) shurukama shih te SHURUKAM/Ë,~A. Iu dëgjua zëri shih te ZË,~RI. S'i dëgjoheh zëri (fare) dikujt shih te ZË,~RI. Nuk është parë e as dëgjuar diçka shih te SHIHËM. Dëgjoheh vetëm kambana e tij keq. shih te KAMBAN/Ë,~A. Duhet dëgjuar të dyja kambanat shih te KAMBAN/Ë,~A. Më sa dëgjoheh qyqja në dimër shih te QYQ/E,~JA.
- DËGJOJ** kal. Ç'po na dëgjojnë veshët! po ndodhin çudira; ngajjnë gjëra të papritura (kryesisht të papëlqyeshme). S'i kam dëgjuar as emrin dikujt a diçkaje nuk e njoh fare, s'e di kush është a ç'është. Mos e dëgjoftë qyqen! mallk. shih te QYQ/E,~JA. S'ia kam dëgjuar zërin dikujt mospërf. nuk e njoh, s'ia di as emrin. Mos ia dëgjofsha zërin! përçm. mos e pafsha kurrë!, mos u takofsha kurrë me të!, u zhduktë! (për dikë që s'e duam). S'dëgjoj (s'pyes, s'dua t'ia di) nga ajo anë shih tek AN/Ë,~A I. I bie pragut të dëgjojë dera shih te PRAG,~U. I flas derës të dëgjojë qilari shih te FLAS. S'më lënë zilet e mia të dëgjoj këmborët e tua shih te ZIL/E,~JA. Vetë flet, vetë dëgjon shih te FLAS. I bërtet së bijës, të dëgjojë e reja fj. u. shih te BËRTAS 3.
- DËLLINJË** f. bot. (Fle) në majë të dëllinjës fle dosido, pa kërkesa, pa rehati.
- DËM** m. E bëri dëm dikë e vrau.
- DËRGOJ** kal. E dërgoi (e çoi) në djall (në dreq) dikë a diçka thjeshtligj., keq. shih te DJALL,~I.
- DËRHEM** m. Burrë katërqind dërhëmë burrë i zoti dhe me përvojë, që e njeh mirë jetën dhe di të gjykojë me gjakftohtësi; burrë me karakter të fortë e guximtar, që e mban fjalën e dhënë. Kudo oka katërqind dërhëmë është shih tek OK/Ë,~A.
- DËRSTILË** f. Si i shkruar (si i shkelur) në dërstilë shumë i lodhur, i rraskapitur, i dërrmuar.
- DËRRASË** f. Çan dërrasa (kopalla, dokrra) shih te ÇAJ. Çan dërrasa pa pykë shih te ÇAJ. Si gozhda në dërrasë shih te GOZHDA/Ë,~A. I kanë ikur dërrasat ka luajtur mendsh.
- DËRRMAK** m. U bë dërrmak dikush u këput nga lodhja, u dërrmua.
- DËRRMAKE** f. E bëri dërrmakë dikë e shkatërroi krejt, e dërrmoi.
- DËRRMË** f. I dha dërrmën shih te JAP. Morën dërrmën shih te MARR.
- DËRRMOJ** I kal. I dërrmoi (i theu) hundët (brinjët, turinjët, dhëmbët, nofullat) dikujt përçm. shih te THYEJ.
- DËSHIROJ** kal. Dëshiron të të puthë e të ha me dhëmbë shih te PUTH.
- DËSHIROR** mb. gjuh. Mënyra dëshirore një nga mënyrat e foljes në gjuhën shqipe, e cila shpreh një veprim ose gjendje që mendohet nga folësi si diçka që dëshirohet të ndodhë a të jetë (p.sh. rroftë, qoftë, a bëftë, daltë, ardhsha etj.).
- DI** kal. Ia di (për nder, për të mirë) dikujt i jam mirënjohës dikujt. Ku ta dish? ndoshta. S'ia di anën diçkaje shih tek AN/Ë,~A I. Ia di (ia njoh) burmat (vidhat) dikujt shih te BURM/Ë,~A I. Dreqi (djalli) e di (e merr vesh) thjeshtligj. shih te DJALL,~I. Ia di gojën shih te GOJ/Ë,~A 8. Ia di gjuhën dikujt shih te GJUH/Ë,~A II. Sa i di lëkura (koka) dikujt është i zgjuar e i shkatëhët, nuk ia hedh dot; di ta ruajë veten, di t'i shpëtojë një gjendjeje të vështirë ose të sigurojë diçka për vete; është mjaft dinak. Nuk di llafe (fjalë) i bie shkurt e copë. Ia di të mbërthyerat dikujt shih te MBËRTHYERA,~T (të). Nuk ia di optin dikujt shih tek OPT,~I. Di ku shkel dikush shih te SHKEL. ... e ku di unë mospërf. e të tjera të tilla; e plot të tjerë, që s'kanë rëndësi, që s'më interesojnë. Ku di derri këmborë mospërf. shih te DERR,~I.

- DIAGONAL** mb. gjeom. Dok diagonal tekst shih te DOK,~U I.
- DIELL** m. Nën diell mbi tokë, në botë. T'u bëftë diell! ur. shih te BËHEM. Ra (u fal) dielli perëndoi dielli. Si bryma në diell shih te BRYM/Ë,~A. Doli në diell doli nga gjendja e vështirë ku ndodhej, doli në dritë. E dërgoi prapa diellit (prapa botës) dikë e çoi në një vend të largët nga ku të mos kthehet më, e çoi në humbësirë; e hoqi qafe, e treti. Diell me diell
- DIGJEM** vetv. S'i digjet (s'i hapet, s'i pël-cet) barku për dikë përem. shih te BARK,~U. Më digjet buza për dikë shih te BUZ/Ë,~A. I digjet mjekra (koka) shih te MJEK/ËR,~RA. Digjet nur shih te NUR,~I. Digjet ndër vete brehet, vuan përbrenda nga një ëshqetësim. Iu dogj (iu përvëlua, iu zhurit) zemra (shpirti) për dikë a për diçka shih te ZEM/ËR,~RA. Iu dogjën kartat (letrat) ndër (në) duar dikujt iu prishën të gjitha planet, dështoi në planet që kishte bërë, s'mundi të arrinte synimet a qëllimet e veta. U dogj (shkoi) i njomi për të thatin shih te NJOMË (i, e). U dogj (shkoi) edhe i njomi (bashkë) me të thatin shih te NJOMË (i, e). I digjet rrogozi (hasra) nën vete shih te RROGOZ,~I. I digjet (i zien) toka (trualli) nën këmbë gjen kudo qëndresë të fortë, e presin kudo me luftë të ashpër, s'e lënë të qetë. I digjet zemra horë shih te HORË.
- DIHET** vetv. pavet. Ku dihet? mundet, ndoshta, kushedi.
- DIJE** f. Shet dije shet mend, hiqet i ditur.
- DIKTATURË** f. Diktatura e proletariatit pushteti shtetëror i klasës punëtore që vendoset pas fitores së revolucionit socialist nën udhëheqjen e partisë marksiste, që shpreh e mbron interesat e të gjithë punonjësve dhe që është tipi me i lartë i demokracisë.
- DIKTIM** II m. Gjyqi i diktimit drejt., vjet. shih te GJYQ, ~I. Gjykata e diktimit drejt., vjet. shih te GJYKAT/Ë,~A.
- DIKU** ndajf. Deri diku deri në një farë mase a shkalle, deri në një farë pike.
- DIKUSH** pakuf. Dikush qesh, dikush qan një njeri a një palë është në gjendje shumë të mirë, një tjetër a pala tjetër është në gjendje shumë të keqe; dikush fiton, dikush humbet, dikush haj-haj, dikush vaj-vaj.
- DIMËR** m. Dimri ha beharin fj. u. prodhimet e verës harxhohen në dimër; ato që grumbullohen kur puna ecën mirë harxhohen në ditë të vështira. Dimri ha gurë (kashtë, gozhdë) në dimër, meqë nuk ka prodhime të shumta e bën ftohtë, ha-hen edhe ushqimet më të këqija. Me sa dëgjohet qyqja në dimër shih te QYQ/E, ~JA. Kërkon dardha (thana, thanëza, rrush) në dimër (në shënëndre) shih te DARDH/Ë,~A. I lulon bahçja (edhe) në dimër shih te LULOJ. Na rrofsh për dimër, se për verë jemi vetë thjeshtligj., iron. i thuhet dikujt për t'i treguar se ia kemi nevojën në kushte të vështira dhe jo atëherë kur nuk na duhet. Lule dimri bot. shih te LUL/E,~JA. Zog dimri (zog bore) zool. shih te ZOG,~U.
- DIN** m. fet. vjet. S'ka din (e iman) është i pamëshirshëm, është i pashpirt. Me din e me iman
- DINAMIT** m. I vuri dinamitin diçkaje e prishi fare një punë, e shkatërroi që nga themelet.
- DIPLOMACI** f. Diplomacia (politika) e kanonierave shih te KANONIER/Ë,~A.
- DIPLOMË** f. Me diplomë bised. me nam, i njohur prej kohësh e nga të gjithë (zakonisht për sjellje a veprimtari jo të mirë).
- DIRIGJENT** m. I bindet shkopit të dirigjentit (të dirigjuesit) libr. i bindet verbërisht dikujt, bën ashtu si thotë një më i madh a më i fuqishëm, i nënshtrohet diktatit të dikujt
- DIRIGJUES** m. I bindet shkopit të dirigjuesit (të dirigjentit) libr. shih te DIRIGJENT,~I.
- DISK** m. Dal (eci) në disk dal (eci) zbatthur.

DISKUTIM m. S'ka (pa) diskutim patjetër, medoemos. E vë në diskutim diçka nuk e marr diçka si të prerë, si të vendosur a si të zgjidhur, e quaj të diskutueshme.

DITË f. Nga dita në ditë

DITËN ndajf. Ditën për (me) diell shih te **DIELL**,~I. Të vret natën e të qan ditën shih te **VRAS**. Ditën të lëpin këmbët, natën të ngul dhëmbët shih te **LËPIJ**.

DIZGJIN m. kryes. Mban dizgjinët shih te **MBAJ**. Ia shtrëngoi dizgjinët dikujt shih te **SHTRËNGOJ**.

DJALË m. Djalë burri djalë i gjetur, thjeshtër. Djalë mamaje (qumështi) mospërf. shih te **MAMA**,~JA. Djalë (bir) në (për) shpirt shih te **SHPIRT**,~I. Djalë (vajzë) tigani mospërf. shih te **TIGAN**,~I. U bë djali dhëndër shih te **DHËND/ËR**,~RI. E do si djalin e shemrës iron. shih te **SHEM/ËR**,~RA. Vajti djali te dhaskali shih te **DHASKAL**,~I. Babë pas babe e djalë pas djali shih te **BAB/Ë**,~A. Djali pa lerë e djepi (festja) blerë iron. shih **Peshku** në det, tigani në zjarr te **PESHK**,~U. Djemtë (fëmijët) hanë kumbulla (thana), pleqve u mpihen dhëmbët iron. shih te **MPIHEM**.

DJALL m. (Si) për djall... thjeshtligj. përdoret për të shprehur pakënaqësi për dikë a për diçka që vjen në një kohë të papërshtatshme, kundër dëshirës, që sjell ngatërresa etj. U bë për djall (për dreq) u bë keq e më keq, u prish fare, i djallo; u bë për lumë. E dërgoi (e çoi) në djall (në dreq) dikë a diçka thjeshtligj., keq. E dërgoi shumë larg, e dërgoi në një vend ku njeriu vuan e heq, e çoi prapa diellit; e flaku tej diçka. Djalli (dreqi) me të birin thjeshtligj. të gjithë pa dallim, edhe ata që s'duheshin. Djall (dreq, shejtan) me brrirë thjeshtligj. shih te **BRI**,~RI. Djalli (dreqi) e di (e merr vesh) thjeshtligj. se kupton askush, s'merret vesh. Një djall (një dreq) e gjysmë thjeshtligj. shumë; mjaft shtrenjtë. Djall (dreq) o punë! thjeshtligj. përdoret si pasthirmë për të shprehur zemërim, pakënaqësi etj. Në

djall të vejë (të shkojë)! mallk. Prapa diellit vaftë! mos ia pafsha sytë! Dredha e djallit keq. njeri shumë i djallëzuar; djalli vetë.

DJATHË m. E kam (si) bukë e djathë shih te **BUK/Ë**,~A. E hëngri (e mori) sapunin për djathë u gënjye, u mashtrua, e mori një gjë për diçka tjetër. E shet sapunin për djathë gënjen, mashtron të tjerët, u hedh hi syve. Djathë i mirë (gjalpë, dhjamë) në lëkurë të qenit shih te **QEN**,~I. I mori bukën, të harronte djathin thuhet kur dikush nuk i plotëson një tjetri një nevojë kryesore me qëllim që të mos kërkojë gjëra të tjera më pak të rëndësishme a të tepërta. Të jep më shumë djathë (ullinj) se bukë thuhet kur dikush, në vend që ta dëgjojë tjetrin e të përfitojë nga këshillat e tij, ia kthen fjalën e nuk ua vë veshin këshillave, qortimeve e vërejtjeve që i bëhen. Kush ha djathë nga të hoxhës, pëlçet për ujë fj. u. shih te **HOXH/Ë**,~A. Bar djathi bot. shih te **BAR**,~I I. Lule djathi bot. shih te **LUL/E**,~JA.

DJATHTAS ndajf. I priste shpata (palla, kordha, sëpata, jatagani) djathtas e majtas (nga të dyja anët) shih te **PRES I**.

DJATHTAZI ndajf. I vete (ia sjell, i shkon) djathtazi i vete (ia sjell, i shkon) mbarë.

DJATHTË mb. Dora e djathtë e dikujt krahu i djathtë i dikujt. Krahu i djathtë i dikujt ndihmësi kryesor i dikujt, ai që ndihmon më shumë drejtuesin e një pune, ai që mban barrën më të rëndë pas tij.

DJEG kal. Ia dogji lëkurën dikujt shih te **LËKUR/Ë**,~A. I djeg miza trembet se mos e kuptojnë të tjerët që ai e ka fajin (për një njeri që vërtet është fajtor).

DJEGIE f. Motor me djegie të brendshme tek. shih te **MOTOR**,~I 1.

DJEGUR mb. Kartë (letër) e djegur plan, veprim, taktikë etj. ose njeri në shërbim të dikujt, që s'hyn më në punë, që s'mund të përdoret më se është zbuluar, se ka rënë shumë poshtë në sy të të tjerëve etj.

Pleh i djegur pleh i dekompozuar mirë. Vaj i djegur tek. shih te VAJ,~I I, 2. Taktika (politika) e tokës së djegur shih tek TOK/Ë,~A.

DJEP m. Djep pas djepi brez pas brezi. Që në djep që në fillim të jetës së dikujt a të diçkaje, që pa u rritur a pa u zhvilluar mirë. E la në djep e la foshnjë, e la kur ishte ende foshnjë, e la në shpërgënj. S'i ka tundur djepin dikujt shih tek TUND. Djali pa lerë e djepi (festja) blerë iron. shih Peshku në det, tigani në zjarr te PESHK,~U. Më mirë djepin thatë (bosh) se shejtanin brenda fj. u.

DJERSË f. Derdh djersë (derdh djersën çurkë) shih te DERDH. I kulloi djersa u lodh shumë për të bërë një punë, bëri përpjekje të mëdha. E lagu me djersë diçka shih te LAG. E lanë me djersë shih te LAJ 7. I nxori djersë dikujt shih te NXJERR. I ka pirë djersën dikujt shih te PI. I doli djersa në lug shih te LUG,~U. I dolën djersët e mortjes (e vdekjes) shih te MORTJ/E,~A. I shkojnë (i bien, i dalin, e mbulojnë) djersë të ftohta shih te FTOHTË (i, e). I shkuan shtatë palë djersë shih te SHTAT/Ë,~A.

DJERSIT jokal. S'i ka djersitur (s'i ka dalë) ende (mirë) mustaqja është i ri akoma, nuk është rritur akoma mirë, nuk është burrëruar ende (për një djalë të ri); është akoma i papjekur, nuk është rrahur me jetën.

DOBËT mb. Ana e dobët e dikujt a e diçkaje e metë e dikujt a e diçkaje. Pikë e dobët e dikujt anë ose hallkë e karakterit, e biografisë a e veprimtarisë së dikujt që mund të shfrytëzohet nga të tjerët për ta goditur a për t'ia arritur një qëllimi; gjëja në të cilën dikush e ndien veten të pafuqishëm të veprojë a të kundërshtoj. Është pikë e dobët është diçka shumë delikate, që kërkon kujdes të veçantë.

DOBIÇ m. thjeshtligj. E mbuloi dobiçin shih te MBULOJ. Ia la dobiçin (kopilin, doçin) në derë (në prehër) thjeshtligj.

shih te KOPIL,~I. Ta vë (ta hedh) dobiçin (kopilin) në prehër thjeshtligj. shih te KOPIL,~I.

DOBISHËM mb. Koeficienti i punës së dobishme mat. shih te KOEFICIENT,~I.

DOÇ m. sh thjeshtligj. edhe keq. shar. Ia la doçin (kopilin, dobiçin) në derë (në prehër) thjeshtligj. shih te KOPIL,~I

DOÇE I f. E qiti në doçe e nxori pa gjë, e nxori pa pjesë, e la me gisht në gojë. Ka gjetur shkopi doçen keq. shih te SHKOP,~I.

DOGANË f. Flet pa doganë flet pa menduar mirë, i lëshon fjalët si t'i vijnë, flet pa përgjegjësi.

DOK I m. tekst. Dok diagonal dok i thurur me fije që kalojnë në mënyrë të tërthortë.

DOKËRR f. Çan dokrra (dërrasa, kopalla) shih te ÇAJ. Këput dokrra (gjepura) shih te KËPUT 8. E sjell dokërr dikë e sjell rrotull, e sjell vërdallë dikë, e sorollat. I dolën sytë dokërr i kërcyen sytë përjashta, i zgurdulloi sytë (nga zori, nga frika, nga habia). Flet (qit) dokrra në hi flet kot, as vetë nuk e di se ç'thotë, flet gjepura.

DOKUSHDO pakuf. Nuk është dokushdo dalohet nga njerëzit fare të rëndomtë (nga aftësitë, nga detyra që kryen etj.); s'është nga ata që mund të merren nëpër këmbë.

DOLLAP m. Me dollap me dinakëri, me dredhi; me të pabesë, me hile. E futi në dollap e mashtroi; e futi në grackë. I ka sytë dollap i ka sytë fare çelur, nuk po i mbyll fare sytë (thuhet zakonisht për fëmijët kur nuk i zë gjumi). I mban sytë dollap i mban sytë hapur e vëzhgon me kujdes, është syçelë, nuk e zë gjumi, nuk fle (përpara armikut, rrezikut etj.). Hap e mbyll dollapin merret me punë të kota, nuk bën asnjë punë të dobishme, e kalon kohën kot, hap e mbyll derën, luan derën. Pushkë (dyfek) me dollap usht., vjet. shih te PUSHK/Ë,~A.

DOLLI f. Është për t'i pirë dollinë është shumë i mirë, e meriton dashurinë e nderimin e të gjithëve; është shumë i zoti.

DOMATE f. E zunë me domate dikë e dëbuan me të bërtitura e me të shara, e përzunë me përçmim; e bënë me turp botërisht.

DORA-DORËS ndajf.

Dora-dorës që ... sa më shumë (sa më tepër) që.. .

DORASHKË f. Me dorashka (doreza) shih te DOREZ/Ë,~A. Pa dorashka (doreza) shih te

DORDOLEC m. U bë dordolec u lag shumë, u lag gjer në palcë, u bë qull.

DOREZË f. Me doreza (dorashka) fshehurazi, jo hapur, jo drejtpërdrejt; me kujdes, me takt. Pa doreza (dorashka) hapur, pa mbajtur asgjë të fshehur, troç, copë. Hajdut me doreza (me dorashka) hajdut i regjur, hajdut që vepron me shumë kujdes e fshehurazi. I hoqi dorezat dikush filloi të veprojë hapur, doli sheshit.

DORË f. 4. Kjo gjymtyrë si përfaqësuese e njeriut që zotëron diçka, që ka fuqinë a pushtetin mbi dikë ose mbi diçka; njeriu vetë si zotëruar a pronar ose e drejta e tij për të zotëruar, për të urdhëruar, për të vepruar etj. (edhe në disa togje frazeologjike). Dorë e hekurt (e fortë), libr.

5. fig. Ndhimë a përkrahje që i jepet dikujt për të bërë diçka që ai nuk e përballon dot vetë; kujdes a mbrojtje për dikë që është më i vogël, më i dobët etj. (edhe në disa togje frazeologjike). Me dorë të huaj. E ndjeu dorën e shoqërisë (e prindërve). I dhanë dorën e ndihmuan, e përkrahën. I dhanë një dorë dhe e nxorën nga balta. T'i japim të gjithë nga një dorë! I ka hedhur dorën dikujt e ndihmon, kujdeset për dike. I jep dorë (në punë) e ndihmon. E ka lënë dikë a diçka në dorë (në duar) të dikujt ia ka lënë a ia ka besuar për t'u kujdesur për të a për ta mbrojtur. E ka lënë në dorë të fatit dikë a diçka nuk kujdeset a s'pyet fare për të, e ka braktisur fare.

13. fig. Cilësia a vlera e diçkaje; shkalla që zë nga rëndësia, nga vetitë etj. diçka (edhe në disa togje frazeologjike). Miell i dorës së parë miell shumë i mirë, i

një cilësie të lartë. Me rëndësi të dorës së parë me rëndësi të madhe, kryesore. Luan rol të dorës së dytë nuk luan rol kryesor. Është i dorës së dytë nuk është i cilësisë së lartë.

Nën dorë keq. fshehurazi dhe jo sipas rregullave të zakonshme të tregtisë (për shitjen e blerjen e diçkaje). Këso dore

DORËZ f. Ta jep kaun në vorbë dhe shpatën pa dorëz shih te VORB/Ë,~A.

DORËZOJ kal. Dorëzoi (hodhi, la, lëshoi, dha, uli) armët shih tek ARM/Ë,~A. Dorëzoi çelësat shih te ÇELËS,~I. Ia dorëzoi (ia lë) stafetën dikujt ia lë dikujt ta çojë me tej punën e nisur.

DOSË I f. Si tym dose me të shpejtë, s'u duk nga vajti. Hyn derri e dosa keq. shih te DERR,~I.

DRAPËR m. Drapër e çekan simboli i punës, i bashkimit të klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse. Drapri i hënës poet. hëna kur ka nisur të përtërihet ose kur soset dhe ka trajtën e një vetulle. I drejtë si drapri iron.

DREDH kal. Dredh (përdredh, luan, lëviz) bishtin keq. shih te BISHT,~I. E dredh gjuhën

DREDHË f. Dredha e djallit keq. shih te DJALL,~I. I bën dredha (plumbit) ruhet që të mos e zërë plumbi, i shmanget plumbit. I hoqi një dredhë shih te HEQ. Është si dredhë ka trup të hollë e të dobët. I bën dredha fjalës nuk i qëndron fjalës së dhënë, por sillet e flet si t'ia dojë puna; nuk e mban fjalën, e ha fjalën. I bën dredha punës (përgjegjësisë) i shmanget, i bën bisht. I bën dredha pyetjes nuk i përgjigjet pyetjes drejt e në mënyrë të çiltër.

DREGËZ f. Ka zënë (ka vënë) dregëz (kore) plaga shih te KOR/E,~JA I.

DREJT ndajf. Drejt e në thela bised. shih te THEL/Ë,~A. I ra drejt foli hapur e pa shumë fjalë, foli troç, shkurt e pa dredha. I shkon tymi drejt (gjyryk) shih

tek TYM, ~I. Tymi të shkojë drejt, pa le të jetë oxhaku i shtrembër! fj. u. shih tek TYM, ~I. Të rrimë shtrembër e të flasim drejt! fj. u. shih te SH TREMBËR. Barkun petë, por shpatullat drejt! shih te SHPATULL, ~A.

DREJTË mb. I drejtë si drapri iron. shih te DRAP/ËR, ~RI. Në vijë të drejtë me lidhje të pandërmjetme gjaku. Kënd i drejtë gjeom. shih te KËND, ~I. Kundrinë e drejtë gjuh. shih te KUNDRIN/Ë, ~A. Ligjëratë e drejtë gjuh. shih te LIGJËRAT/Ë, ~A I.

DREJTË f. Ç'është e drejta (e vërteta) fj. ndërm. shih te VËRTET/Ë, ~A (e). Të them (të themi) të drejtën (të vërtetën) fj. ndërm. shih te VËRTET/Ë, ~A (e). Fiton (merr) të drejtën e qytetarisë libr. shih te QYTETARI, ~A. I jep të drejtën e qytetarisë libr. shih te QYTETARI, ~A.

DREJTË m. Gjumi i të drejtit gjumë i qetë.

DREJTIM m. Në drejtim (të..) libr. përdoret me një emër a përemër të rasës gjinore për të treguar kahjen a prirjen e një veprimtarie, të një zhvillimi etj.

DREJTOJ kal. I drejtoi (i ktheu, i tregoi) bërrylin dikujt shih tek TREGOJ. Drejto (ndreq, rregullo) gojën! shih te GOJ/Ë, ~A. Drejtoi sytë (vështrimin) nga dikush a nga diçka kishte shpresë të madhe te dikush a te diçka, andej e priste ndihmën, shpëtimin ose një të mirë tjetër. Drejtoi shigjetën kundër diçkaje e përqendroi luftën kundër diçkaje, e mori si shenjë kryesore për ta sulmuar e goditur, e vuri në shënjestër.

DREJTPËRDREJTË mb. Kuptimi i drejtpërdrejte (i fjalës) gjuh. kuptimi që lidhet drejtpërdrejt me sendin a me nocionin që shënon fjala e që nuk është i figurshëm; kuptimi i parë e i mirëfilltë i fjalës pa ngjyrimet shprehëse e emocionale plotësuese (p. sh. shpatë e çeliktë ndryshe nga vullnet i çeliktë fig. ose bushtër Â«femra e qenitÂ» dhe bushtër shar., thjeshtligj.

Â«grua e ligë, e përdalë, bisht tundur, lavireÂ»).

DREJTUES mb. Fjali drejtuese gjuh. shih te FJALI, ~A.

DREKË f. Drekën e mirë! përd. pasth. përdoret si përsëritje kur njerëzit ndahen nga njëri-tjetri pak para drekës. I ngrënça drekën! mallk. shih te HA. Ku e zë dreka, s'e zë darka udhëton a bredh shumë nga një vend në tjetrin, nuk rri në një vend.

DREQ m. U bë për dreq (për djall) shih te DJALL, ~I. U bind dreqi thjeshtligj. shih te BINDEM. E dërgoi (e çoi) në dreq (në djall) dikë a diçka thjeshtligj., keq. shih te DJALL, ~I. Dreqi (djalli) me të birin thjeshtligj. shih te DJALL, ~I. Dreq (djall, shejtan) me birë thjeshtligj. shih te BRI, ~RI. Dreqi (djalli) e di (e merr vesh) thjeshtligj. shih te DJALL, ~I. Një dreq (një djall) e gjysmë thjeshtligj. shih te DJALL, ~I. Dreq (djall) o punë! thjeshtligj. shih te DJALL, ~I. I kalli dreqin (djallin) dikujt a diçkaje thjeshtligj. shih te KALL I. E mori (e hëngri) dreqi (djalli) thjeshtligj. përfundoi keq, e mori lumi. Plasi dreqi shih te PLAS. Më polli dreqi (djalli) shih te PJELL. Punë dreqi! çështje shumë e ngatërruar; telash i madh. Ia bëri pajë dreqit (shejtanit) shih te PAJ/Ë, ~A I. Ka sa të hajë dreqi thjeshtligj. shih te HA. Dreqi (djalli) nuk është aq i zi sa duket shih te DJALL, ~I.

DRIDHEM vetv. I dridhet buza (mjekra) shih te BUZ/Ë, ~A. I dridhet dora shih te DOR/Ë, ~A.

DRIDHUR mb. Me dorë të dridhur

DRITARE f. Është qeli pa dritare (qeli e mbyllur) dikush shih te QELI, ~A. E nxorën nga dera, hyri nga dritarja (nga deriçka) shih te DER/Ë, ~A.

DRITË f. I çeli drita e zuri mëngjesi. Doli në dritë

- DRITHË** m. Lëmë pa drithë (pa bereqet) shih te LËM/Ë,~I. E bën drithë e miell mospërf. i ngatërron të gjitha gjërat, i bën lesh e li. Shiko drithin e jo thesin! fj. u. shiko veprat e jo fjalët, shiko punën e jo gunën.
- DRIZË** f. bot. I vuri drizën (ferrën) diçkaje shih te FERR/Ë, ~A. Ecën mbi driza bën diçka shumë të vështirë e të mundimshme, mban ferra lakuriq.
- DROKTH** m. bot. Iu bë buka drokth i mbeti buka në grykë, nuk i shkon buka, iu bë buka lëmsh (komb) në grykë (nga një lajm i hidhur, nga një hall etj.).
- DRU** m. U bë dru (gur)
- DRU** f. Ha dru mundem keq, humbas keqas (në një lojë, në një ndeshje, në një betejë etj.). I dha (i vuri) drunë dikujt shih te JAP. S'i lagen drutë shih te LAGEM. Mori (hëngri) një dru shih te MARR 24. S'i bën drutë të gjata i bie shkurt, nuk e zgjat shumë (një çështje, një bisedë etj.); nuk ia zgjat shumë dikujt. I do drutë të shkurtra nuk i pëlqejnë fjalët e kota e dredhat, do që t'i bien shkurt e shkoqur. Ashtu (kështu) i do mushka drutë shih te MUSHKË,~A. I gjeti mushka drutë shih te MUSHKË,~A. I hodhi dru zjarrit e ndezi më shumë sherrin, bëri që mosmarrëveshjet e grindjet ndërmjet dy vetave a dy palëve të acarohen më shumë. Lag drutë me benzinë shih te BENZIN/Ë,~A. I preu drutë shkurt me dikë shih te SHKURT. Kur shtie drutë, hap sytë! fj. u. shih te SHTIE. Një dru e shtrembër rrëzon (prish) gjithë stavën fj. u. shih te STAV/Ë,~A. Kalë drush shih te KAL/Ë,~I.
- DRUGË** f. Mban një drugë shih te MBAJ.
- DRY** m. Arkë e dry shih tek ARK/Ë,~A. I vuri drynin (kyçin) gojës shih te KYÇ,~I. I vuri drynin (kyçin, çelësin) shtëpisë shih te KYÇ~I. I vuri drynin (kyçin, çelësin) diçkaje shih te KYÇ,~I.
- DUA** f. Ha bukën e mikut e bën duanë e armikut thuhet kur dikush punon për kundërshtarin ose armikun e atij që e mban, e ushqen a e mbron.
- DUA** kal. Ç'e do s'ka vlerë a dobi, sa para bën. Sa të duash pa masë, boll, shumë. Aq (kaq) dua! shih tek AQ. Këtu të dua! në këtë fjalë qëndro!, mos e ndërro bisedën!; më ke dalë në shteg. Dua s'dua pavarësisht nga vullneti im ose nga dëshirat e mia. Nuk do t'ia dijë shih te DI 7. S'do fjalë (pa fjalë) shih te FJAL/Ë, ~A. I do në gojë keq. shih te GOJ/Ë,~A. Ia do hunda diçka shih te HUND/Ë,~A. Ma do mendja besoj, kujtoj.
- DUHAN** m. Të var në qese të duhanit shih te QES/E,~JA. Nuk ta prish tymin e duhanit shih te PRISH. Duhan i egër bot. madërgonë. Zjarri i duhanit (zjarri i egër) bot. shih te ZJARR,~I.
- DUHEM** vetv. Aq (kaq) sa duhet në masën a në shkallën e duhur, pa teprime e zvogëlime, aq sa është e nevojshme a sa kërkohet. Ashtu si duhet pa të meta e gabime, ashtu si kërkohet, mirë. Ç'i duhet atij? pse përzihet ai në këtë punë?, ç'i hyn në punë atij? S'ka ç'të duhet (kjo punë)! nuk të takon, nuk të përket ty kjo punë, mos u merr me këtë punë!
- DUHI** f. Kush mbjell duhi, korr breshër e shi fj. u. Kush mbjell erën, korr furtunën.
- DUKEM** vetv. Sa për t'u dukur sa për të kaluar radhën, sa për formë; sa për sy e faqe. Siç duken (siç tregojnë) bathët shih te BATH/Ë,~A. S'iu duk (s'iu gjend) binaja shih te BINA,~JA. Duket breshka shih te BRESHK/Ë,~A. Nuk i duket (i humbi, i treti) boja shih te BOJ/Ë,~A. I. Dielli duket (shihet) që në mëngjes (që kur lind) fj. u. shih te DIELL,~I. I duket hunda dyfek keq. shih te DYFEK,~U. I duken malet shesh shih te SHESH,~I. Dita e mirë (moti i mirë) duket që në mëngjes fj. u. shih te MËNGJES, ~I. Djalli (dreqi) nuk është aq i zi sa duket shih te DJALL,~I. Fshati që duket s'do kallauz fj. u. shih te FSHAT,~I. Pula e botës duket më e majme iron. fj. u. shih te PUL/Ë,~A. Qimja e tjetrit të duket

- tra shih te QIM/E,~JA. Gjithkujt mur-
rizi i vet i duket i njomë fj. u. shih te
MURRIZ, ~I.
- DUKË** f. Si e ka dukën? si duket puna, si
janë shenjat, si duken shenjat? Humbi pa
shenjë e pa dukë shih te SHENJ/Ë,~A.
- DUKJE** f. Vë në dukje përmend, zë në gojë,
tregoj; theksoj, nënvizoj.
- DUMAN** m. vjet. U bë duman (tym) shih tek
TYM,~I. I jap një duman shih te JAP.
Me sytë duman me sytë të mjegulluar a
të veshur.
- DURIM** m. Bëj durim duroj. Ka durim prej
guri (prej hekuri) dikush ka shumë durim,
ka durim shumë të madh.
- DUROJ** kal. Duro të durojmë! thuhet
kur duhet të durojmë shumë, të mos
ligështohemi e të mos përkulemi përpara
vështirësive, fatkeqësive, kushteve shumë
të rënda etj. Nuk e duron litarin në
fyt shih te LITAR,~I. S'e duron (s'e
mban) as qielli, as dheu (as toka) shih
te QIELL,~I. Duro zemër e mos plas!
thuhet kur na bie një fatkeqësi shumë e
rëndë dhe s'kemi ç'të bëjmë.
- DUSHK** m. Bëhet dushk thahet; bëhet
shkrumb. Çau dushkun (ferrën) shih te
ÇAJ. Ia fut dushk thjeshtligj. flet pa u
menduar mirë, flet kot, ia fut katundit.
Fushk në dushk shih te FUSHK,~U. I
dha dushkun dikujt e përzuri dikë nga
shtëpia; i dha duart. Mbjell në dushk
nuk punon ashtu si duhet, nuk bën punë
të pastër, punon shkel e shko. Ua hoqën
dushkun fjalëve folën hapur, troç, i thanë
gjërat ashtu siç janë. Shkoi dushk për
gogla shkoi kot, shkoi për dhjamë qeni.
Lule dushku bot. shih te LUL/E,~JA.
- DY** num. them. Me të dy (me të dyja) duart
shih te DOR/Ë,~A. Me dy fytyra (me
dy faqe) shih te FYTYR/Ë,~A. Një me
dy (një e dy) shih te NJË. Pa një, pa
dy shih te NJË. E bëri për dy (për pesë)
para shih te PARA,~JA. Ia bëri tetë me
dy dikujt thjeshtligj. shih tek TETË.
S'e bën dy (dysh) fjalën (e dhënë) shih
te DYSH. S'ia bëri as një, as dy shih
te NJË. Bie (është, ndodhet) në mes dy
zjarresh shih te ZJARR,~I. Çalon nga
të dyja këmbët shih te KËMB/Ë,~A.
Duhet dëgjuar të dyja kambanat shih te
KAMBAN/Ë,~A. Dy pëllëmbë mbi tokë
shih te PËLLËMB/Ë,~A 4. Gjarpër me
dy koka shih te GJARP/ËR,~RI. Ha
(pi) me dy gryka shih te GRYK/Ë,~A.
Jam dy mendjesh shih te MENDJ/E,~A
2. Mbështetet në të dyja këmbët shih
te KËMB/Ë,~A. Mësallë me dy faqe
shih te MËSALL/Ë,~A. E shkeli me
të dy (me të dyja) këmbët shih te
KËMB/Ë,~A. Pa thënë (pa bërë) as një,
as dy shih te NJË. Vezë me dy të verdha
(me dy të kuq) shih te VEZ/Ë,~A. Kur
të bëhen dy ditë bashkë iron. shih te
DIT/Ë,~A. Dy Kamberë në një derë vjet.
shih te DER/Ë,~A. Ia futi (ia vuri, ia
shtiu) te dyja këmbët në një këpucë (në
një opingë) dikujt shih te KËMB/Ë,~A.
Janë dy kufoma e një shpirt shih te
KUFOM/Ë,~A. Është dy (pesë) para
njeri (burrë) shih te PARA,~JA. Është
me dy fije brinjë shih te BRINJ/Ë,~A.
Ishte me dy krënde në vatër shih te
KRËND,~I. Është thikë (presë) me dy
presa shih te THIK/Ë,~A. Nuk ka (as)
dy (pesë) para mend shih te PARA,~JA.
Kërkon të hajë me dy lugë keq. shih
te LUG/Ë,~A. S'le dy gurë bashkë shih
te BASHKË. S'lidh (s'bën) dot dy fjalë
bashkë shih te BASHKË. Milte dy qyqe
dhi (dele) shih te MJEL. Ngjajnë (janë)
si dy pika uji shih tek UJ/Ë,~I. Noton
(lundron) në dy (në një) gisht një shih te
GISHT,~I. Si një e një (që) bëjnë dy shih
te NJË. Me një gur (me një të shtënë)
vret dy zogj shih te GUR,~I. Një rrugë
(udhë) e dy punë shih te RRUG/Ë,~A.
I priste shpata (palla, kordha, jatagani,
sëpata) nga të dyja anët (djathtas e
majtas) shih te PRES I. U zunë (a
grindën) për dy (për pesë) para spec shih
te PARA,~JA. (Një) copë mish me dy
sy përçm. shih te MISH,~I. Dy duar
për një kokë (janë) shih te DOR/Ë,~A.
Është një nga dhia, dy nga vija shih

- te DHI,~JA. Është tri në degë e dy në majë dikush shih te DEG/Ë,~A. Nuk mbahen dy kunguj (dy shalqinj) nën një sqetull (në një dorë) fj. u. shih te KUNGULL,~I.
- DYFEK** m. vjet. Bëri dyfek (pushkë) shih te BËJ. Dyfek (pushkë) me çark shih te ÇARK,~U. Dyfek i palosur mospërf. shih te PALOSUR (i, e). Në flakë të dyfekut (të pushkës) shih te FLAK/Ë,~A. Është i dyfekut (i pushkës) shih te PUSHK/Ë,~A. E ka dyfekun me dikë e ka inatin a zemërimin me dikë. Përgjak dyfekun shih te PËRGJAK. I vuri (i ktheu) dyfekun (pushkën) diku shih te PUSHK/Ë,~A. Është bërë për t'i rënë me dyfek (me pushkë, me kobure) është tharë shumë, është shumë i fortë (për bukën a diçka tjetër që ha-het). I duket hunda dyfek keq. i duket vetja trim; është mendjemadh. Mbeti si dyfeku pa lloz shih te LLOZ,~I. Plasi Muçoja për dyfek tall. thuhet për dikë që ka dëshirë a ambicie të madhe për t'u ngritur në pozitë e për të komanduar etj. Qan dyfeku për zot iron.
- DYFISH** mb. Parti dyfishe fin. shih te PARTI,~A II.
- DYFISHTË** mb. Yll i dyfishtë astr. shih tek YLL,~I 1. Shartim i dyfishtë bujq. shih te SHARTIM,~I. Kryqëzim i dyfishtë bujq. kryqëzim i dytë i një lloji a varietetit që ka dalë nga një kryqëzim i mëparshëm, kryqëzim mbi kryqëzim.
- DYLBË** f. I sheh me dylbi (gjërat) dikush i sheh punët nga larg, nuk i njeh mirë çështjet me të cilat merret a për të cilat flet, nuk është brenda e nuk e njeh thelbin e çështjeve. Ta shikosh me dylbi iron. shih te SHIKOJ.
- DYLLË** m. U bë dyllë (bukë dylli) dikush u zverdh shumë; u zbeh shumë. I vë dyllin diçkaje shih te VË 29. Lule dylli bot. shih te LUL/E,~JA.
- DYMBËDHJETË** num. them. Mbyll dymbëdhjetë dyer me një shul shih te SHUL, ~I.
- I bie ora (sahati) gjithnjë dymbëdhjetë (shtatë) shih tek OR/Ë,~A I.
- DYNJA** f. bised. Hëngri dynjanë shih te HA.
- DYST** ndajf. bised. I shkel këmba dyst (shesh) shih te SHKEL.
- DYSH** m. Është (mbeti) pa një dysh (në xhëp) s'ka asnjë lek, mbeti fare pa para. S'bën (s'vlen) asnjë dysh nuk vlen fare, s'ka asnjë vlerë.
- DYSH** ndajf. Është thyer (është këputur) më dysh
- DYSHEK** m. E bëri për dyshek dikë e rrahu keq sa nuk qëndron dot më këmbë. E la dyshekun (shtratin, krevatin, jatakun) shih te SHTRAT,~I. U ngrit nga dysheku (nga shtrati, nga krevati, nga jataku) shih te SHTRAT,~I. Zuri dyshekun (shtratin, krevatin, jatakun) shih te SHTRAT,~I 1.
- DYTË** mb. Vetë i dytë dy veta së bashku. Nuk e pa i pari të dytin shih te PAR/Ë,~I(i). Nuk e merr vesh (nuk e njeh) i pari të dytin shih te PAR/Ë,~I(i). Barazim i gradës se dytë mat. shih te BARAZIM,~I.
- DYTI** ndajf. Pikë se dyti shih te PIK/Ë,~A.
- DYZEN** m. E vuri (e pruri) në dyzen e akordoi një vegël muzikore me tela.
- DYZET** num. them. Njeri me dyzet (me njëqind) flamurë shih te FLAMUR,~I. I këndojnë dyzet gjela përmbi kokë shih te GJEL,~I. Di të qepë me dyzet gjilpëra shih te GJILPËR/Ë,~A.
- DHALLË** m. Si pleshti në dhallë shih te PLESHT,~I. E bëj dhallë diçka e ngatërroj keq, e bëj lesh e li. M'u bë koka (mendja) dhallë (bozë, çorbë, përsesh, lëmsh, tym...) me janë ngatërruar mendimet e s'di ç'të bëj, s'jam në gjendje të mendoj a të dalloj diçka, jam fare i hutuar, m'u prish mendja. E ngjyente bukën në dhallë ishin shumë të varfër, rronin si mos më keq, mezi mbanin frymën.

- DHASKAL** m. Vajti djali te dhaskali e gjeti njeriun që di ta udhëzojë dhe ta bëjë të sillet e të veprojë si duhet; e gjeti ustanë, ra në usta.
- DHE** m. Nën dhe fshehurazi, tinëz, jo hapur. Burrë i dheut burrë i zoti, me karakter të fortë, burrë mbi burra (përdoret edhe si thirrje, kur i drejtohem dikujt). U bë beja e dheut shih të BE,~JA. I dha dhenë dikujt e detyroi të ikë me të shpejtë, e detyroi t'ua mbathë këmbëve, e vuri përpara; i dha dermën. Me faqe në dhe (përdhe) shih te FAQ/E,~JA. Hëngri (kafshoi) dhe (botë) përçm. vdiq. Hyri në dhe
- DHE** II pj. Dhe ja shih te JA. Si dhe përdoret si lidhës bashkërenditëse këpujore a shtuese, si edhe, dhe. Si ..., (ashtu) dhe përdoret si lidhës bashkërenditëse këpujore a shtuese për të lidhur dy fjalë të një fjalisë a dy fjali të një fare që krahasohen midis tyre; ashtu edhe, gjithashtu.
- DHELPËR** f. Ç'do dhelpër në pazar? e kërkon vetë të keqen, shkon si caji te kasapi. S'ia ha pulat dhelpër dikujt shih te PUL/Ë,~A. E zë dhelpëren (lepurin) me qerre dikush shih te QERR/E,~JA. Kur s'ke pula, pse hahesh me dhelpër? (mos u merr me dhelpër!) shih te PUL/Ë,~A. Moj dhelpër, moj ankojë, shumë armiq zure me gojë! iron, thuhet për një njeri që e ka zakon të ankohet vazhdimisht me qellim që të ketë ndonjë përfitim. Rrush dhelpër shih te RRUSH,~I.
- DHEMB** jokal. I dhembin sytë (kur e sheh) nuk mund ta durojë dikë a diçka, nuk i pëlqen fare.
- DHEN** vet. sh. Ndaj dhentë (delet) nga dhitë shih te DHI,~A. Si dhentë pa çoban shih te ÇOBAN,~I. Si dhentë në shtrungë në rresht njëri pas tjetrit e ngjeshur me njëri-tjetrin. Si dhentë në vathë grumbull, kokë me kokë, ngjeshur me njëri-tjetrin.
- DHESPOT** m. E bën dhespotin (priftin, hoxhën) me barrë tall, shih te BARR/Ë,~A.
- DHËMB** m. I armatosur gjer (deri) në dhëmbë i armatosur shumë mirë, i pajisur me të gjitha armatimet, i armatosur nga koka deri te këmbët. Cacër pa dhembe shar. njeri i matufosur e i rrëgjuar që nuk vlen me për asgjë. S'i kanë dalë (ende, akoma) dhëmbët mospërf. është ende i ri, i ka buzët me qumësht. Diell me dhëmbë dielli i ditëve të ftohta të dimrit, diell që s'të ngroh. Dhëmb për dhëmb në mënyrë të vendosur e të rreptë, me ashpërsi të madhe; për jetë a vdekje; majë me majë. Me erdhi në dhëmbë një fjalë gati sa s'e thashë, e kisha në majë të gjuhës. Flas (them) nëpër dhëmbë flas (them etj.) jo qartë, pa i shqiptuar mirë fjalët e pa i sqaruar gjërat, murmurit. E ha me dhëmbë shih te HA. Hahem me dhëmbë shih te HAH-HEM. I jap një dhëmb dikujt shih te JAP. Ma mbajti dhëmbi gati sa s'e thashë, desh e thashë diçka. Mpreh dhëmbët shih te MPREH. I ndriti dhëmbët (sytë) shih te NDRIT. I ranë dhëmbët (i ranë dhëmbë e dhëmballë)
- DHËMBALLË** f. Me rrënjë e me dhëmballë shih te RRËNJ/Ë,~A. I shkuli (i tundi) dhëmballët (dhëmbët) dikujt shih te SHKUL. I nxori dhëmbë e dhëmballë shih te DHËMB,~I.
- DHËNDËR** m. U bë dhëndër u vesh me rroba të reja, u vesh e u stolis si dhëndër. Bukur për dhëndër! ur. shih te BUKUR. Dhëndër brenda dhëndër që jeton së bashku me prindërit e nuses. U bë djali dhëndër u rrit djali, u bë për t'u martuar. Dhëndri rruhet në fund është ende herët, s'ka ardhur radha, koha etj. për të kërkuar a për të bërë diçka. Kjo është nusja, ky është dhëndri shih te NUSE,~JA.
- DHËNË** as. S'është me të thënë, por me të dhënë s'bëhet gjë, po të presësh që për gjithçka të të mësojnë të tjerët, duhet të të jepet vetë, duhet të jesh vetë i zoti, i aftë etj. për të kryer diçka.
- DHËNË** mb. Fjala e dhënë shih te FJAL/Ë,~A.

- DHI** f. Dhia e shëllirës shih te SHËLLIR/Ë,~A. Si dhia në gjollë shih te GJOLL/Ë,~A.
- DHIMBSEM** vetv. I dhimbset jeta mospërf. ka frikë se mos vdesë, se mos pësojë gjë etj.; e ruan shumë veten. I dhimbset lëkura keq. i dhimbset jeta. I dhimbset qyqes shih te QYQ/E,-JA.
- DHJAMË** m. Dhjamë cjapi shih te CJAP,~I. Vuri dhjamë shih te VË. Si veshka në mes të dhjamt në kushte e rrethana shumë të mira, në mjedis të këndshëm a të rrethshëm, shumë mirë. S'del dhjamë nga pleshti fj.u. përçm.
- DHJES** jokal. Atë që ul qafën, e dhjesin pulat fj. u. thjeshtligj. shih te PUL/Ë, -A.
- DHJETË** num. them. Hyri për dhjet ka filluar vitin e dhjetë të jetës, i mbushi nëntë vjet dhe filloi të dhjetin. Mat dhjetë (tri, shtatë) herë e pre një herë fj.u. shih te MAT. Punon (flet, bën) sa për dhjetë punon, (flet, bën) shumë. Një okë e dhjetë, një okë pa dhjetë (një okë e pesë, një okë pa pesë) shih tek OK/Ë,-A.
- DHOGË** f. Bëhem dhogë (dërrasë) shih te DËRRAS/Ë,-A. Nuk shkel (nuk bie) në dhogë (në dërrasë) të kalbur shih te DËRRAS/Ë,~A.
E V pj. bised.
E po shih te PO.
- ECI** jokal. Ecën mbi driza shih te DRIZ/Ë,~A. I eci fati pati fat gjithnjë, qe me fat. Ecën kundër rrymës shih te RRYM/Ë,~A. Ec drejt hundës! shih te HUND/Ë, ~A. Ecën (shkon) si në vaj shih te VAJ~I I. Është ujë që s'ecën është shumë i ngathët e i plogësht, është ujë amull. Nuk i ecën kali në vijë shih te VIJ/Ë, ~A. I ecën kungulli mbi ujë diku shih tek UJ/Ë,~I. I ecën (i shkon, i vete) puna fjollë shih te FJOLL/Ë,~A. Ecën puna sahat shih te SAHAT,~I.
- EDUKATË** f. Edukatë fizike lëndë mësimore që bëhet në shkollë për t'i formuar nxënësit e studentët nga ana fizike, për t'i bërë të aftë për punë dhe për mbrojtje. Edukatë moralo - politike lëndë mësimore që zhvillohet në shkollën tetëvjeçare për ta formuar nxënësin nga ana morale e politike.
- EDH** m. E mbaj edhin në dërrasë dikë e mbaj dikë me të gjitha të mirat e kujdesem shumë për të, e mbaj në pëllëmbë të dorës.
- EDHE** III pj. Edhe në qofte se... (edhe po qe se... edhe në... edhe sikur...) përdoret kur tregojmë se diçka prapëseprapë do të ndodhë, megjithëse ka rrethana që e pengojnë atë. Edhe pse përdoret për të lidhur një fjali të varur lejore me fjalinë kryesore. Jo vetëm ..., por edhe ... shih te VETËM. Jo vetëm që ..., por edhe ... shih te VETËM. Si... (ashtu) edhe... përdoret për të lidhur dy gjymtyrë fjalie të një fare ose dy fjali që krahasohen ndërmjet tyre.
- EGËR** mb. Dac i egër zool. shih te DAC,~I. Duhan i egër bot. madërgonë. Dushk i egër bot. shih te DUSHK,~U. Dhi e egër zool. shih te DHI,~A. Elb i egër bot. shih tek ELB,~I. Frashër i egër bot. rrunjë. Gështenjë e egër bot. shih te GËSHTENJ/Ë,~A. Gjel i egër zool. shih te GJEL,~I. Kafe e egër bot. bar miu. Kumbull e egër bot. kullumbri. Kungull i egër bot. shih te KUNGULL,~I. Liri i egër bot. shih te LI,~RI. Mace e egër zool. shih te MAC/E,~JA. Mel i egër bot. kostrevë. Pambuk i egër bot. shih te PAMBUK,~U. Qersh i egër bot. thrashegër, rrush mali, qershizë, qershigël.
- EGJËR** f. Bluante (hante) egjër ishte shumë i varfër, mezi mbante frymën me bukë.
- EKONOMI** f. Ekonomi shtëpiake lëndë mësimore në shkollën tetëvjeçare që u mëson nxënësve si të mirëmbajnë shtëpinë, si të gatujnë, si të qepin etj.
- EKSIQ** ndajf. bised. Nga këmbët borroviq, nga mendja eksiq shih te BORROVIQ,~I

- EKUATOR** m. Ekuatori magnetik fiz. vijë jo e rregullt që formohet rreth Tokës nga një varg pikash ku pjerrësia e fushës magnetike është baras me zero. Ekuatori qielor astr. rrethi më i madh i sferës qiellore, që përfytyrohet si një rrafsh pingul me boshtin e rrotullimit të Tokës.
- ELEFANT** m. zool. ELEFANT DETI zool. Lloj foke me feçkë si të elefantit.
- ELEKTRIK** m. Elektrik deti zool. bised. peshk elektrik.
- EMËR** m. Emër për emër duke e përmendur secilin me emër, një për një. Sa për emër
- EMËRUES** m. mat. Gjejmë një emërues të përbashkët libr. i sheshojmë, i rrafshojmë gjërat; biem në një mendim. Sjell (kthej) në një emërues të përbashkët libr. i sheshoj, i rrafshoj gjërat, gjej një bazë të përbashkët, i bëj të ngjashëm nga një pikëpamje.
- ENCIKLOPEDI** f. Enciklopedi e gjallë bised. njeri që ka njohuri të gjëra nga shumë fusha të dijes e të veprimtarisë shoqërore. Enciklopedia e radios (televizive) emission i posaçëm i radios (i televizionit) që jep për masat e gjera njohuri të ndryshme nga fushat e shkencës, të artit, të teknikës, të kulturës etj.
- ENË** f. E ka bërë shtupë enësh shih te SHTUP/Ë,~A. Uthulla e fortë prish enën e vet fj.u. shih tek UTHULL,~A.
- EPOKË** f. Bëri epokë solli kthesë shumë të rëndësishme, shënoi një epokë të re.
- ERË** I f. Erë me erë gjithkund, kudo. Fjalë në erë (në hava) fjalë të thëna pa u menduar, fjalë pa kuptim, fjalë të kota. U bë erë iku shumë shpejt, u zhdruk menjëherë. Flet në erë flet pa u menduar, flet kot. Hedh në erë diçka.
- ERË** II f. Bie (mban, vjen) erë ka gjurmë, shenja ose shfaqje të diçkaje. I bie në erë dikujt a diçkaje i bie në gjurmë, e diktoj, kam gjetur shenja për ta zbuluar.
- ERZ** m. vjet. Ia mori nderin (erzin) dikujt shih te MARR.
- ERR** kal. I erri sytë vdiq.
- ERREM** vetv. M'u errën sytë
- ERRËSOHEM** vetv. M'u errësuan sytë m'u errën sytë. M'u errësua vendi (bota) humba kontrollin e vetëdijen, nuk dija ç'të bëja.
- ERRËT** mb. Në ditë të errët në gjendje të keqe; jo në shkallën e duhur, jo në formë. E shikon me syze të errëta shih te SYZE,~T.
- ESËLL** ndajf. Jam esëll nuk marr vesh nga një punë, nga një zanat etj., nuk e njoh fare diçka, s'marr erë fare nga diçka.
- ESHKË** f. Janë (shkojnë, venë) si eshka me urorin (me masatin) shkojnë shumë keq njëri me tjetrin, zihen a grihen vazhdimisht, shkojnë si macja me miun.
- ETHE** f. kryes. sh. Është ethe e butë shih i BUTE (i,e). Bar ethesh bot. trikë. Lule ethesh bot. trikë.
- ËMBËL** mb. Fjalët të ëmbla, punët të tharta shih te FJAL/Ë, ~A. Kolla e ëmbël (e mirë, e bardhë) mjek., euf. shih te KOLL/Ë,~A. Limon i ëmbël bot. limetë.
- ËMBËLSOJ** kal. E ëmbëlsoi me sheqerka dikë shih te SHEQERK/Ë,~A.
- ËMË** f. Si e ëma dhe e bija mospirf. njësoj, nuk kanë dallim. Flet si e ëma e Zeqos majë thanës thjeshtligj. flet kot, pa u menduar, flet kot së koti. Po nuk qau fëmija, nuk i jep e ëma (nëna) sisë (gji, të pijë) fj. u. shih te QAJ.
- ËNDËRR** f. Përkëdhel një ëndërr shih te PËRKËDHEL.
- FAKT** m. Në fakt libr. në të vërtetë.
- FAL** kal. I fal zemrën dikujt jepem plotësisht pas dikujt e s'kursej asgjë për të. As të fal as të vret të mban me shpresa dhe nuk të kryen punë, të mban me fjalë.
- FALEM** vetv. Të falem nderit pasth. të falënderoj, faleminderit. I falem me shëndet dikujt e përshëndet dikë, i çoj të fala e përshëndetje. I qofsha falur.

- FANT** m. Doli si fanti spathi doli papritur e pa kujtuar. Hyn (futet) si fanti spathi ndërhyt ku nuk duhet, përzihet atje ku nuk i takon.
- FAQE** f. Në faqe të dikujt para dikujt, në prani a në sy të dikujt, faqeza dikujt. Faqe për faqe ballë për ballë, përballë. Faqe me faqe me fytyrë shumë pranë njëri-tjetrit, ngjitur. Faqja e bardhë shih te **BARDHË** (i,e). Faqja e zezë shih te **ZI** (i), **ZEZË** (e). Me faqe të bardhë shih te **BARDHË** (i,e). Me faqe të zezë shih te **ZI** (i), **ZEZË** (e). Për faqe të zezë shih te **ZI** (i). **ZEZË** (e). Doli në faqe
- FARE** ndajf. Për fare përgjithnjë, përgjithmonë. Ishte (bërë) fare thjeshtligj.
- FARË** f. Asnjë për farë as edhe një, as edhe një i vetëm. Ka dale fare është shfarosur, është zhdukur. Farë e fis farefis. Pa farë e pa fis pa asnjë njeri, i vetëm. Farë (lëng) hardalli iron, shih te **HARDALL**, ~I. Farë e kalbur keq. njeri me shumë vese të këqija e i pandreqshëm, njeri i prishur moralisht. Farë e shëndoshë njeri me veti të mira morale. Ia humbi (ia shoi, ia treti) farën dikujt a diçkaje e zhduku me rrënjë, e shfarosi dikë a diçka. I humbi (iu shua, iu tret) fara dikujt a diçkaje s'gjendet asgjë-kundi; u zhduk fare. Kungull (trangull) pa fara mospërf. njeri pa mend në kokë, budalla. E nxori (e qiti) fare e shfarosi, e zhduku. I shkon për farë dikujt kështu e ka pasur zakon fisi a familja e tij, i shkon për fis. Hedh farë në ujë (në lumë, në det, në shkëmb) punon fare kot, pa asnjë dobi. Hidh (qit) farë, nxirr (merr) farë! thuhet kur dikush nuk nxjerr ndonjë fitim nga punimi i tokës a nga ndonjë punë tjetër, sa jep merr. Mbill (qit) farë, korr farë është tokë jopjellore, është tokë ku s'bëhet bereqeti. Shtohet (është) si fara e hitrës (e sinapit, e lirit) shtohet shumë e shpejt.
- FARËZ** f. Farëzat e kokës shak. mendja, mendtë.
- FARFURI** f. E bëj farfuri diçka e pastroj dhe e bëj që të shkëlqejë.
- FARKËTOJ** kal. Farkëton vargonjtë (zinx-hirët) përgatit robërimin; robëron.
- FARMACIST** m. Me peshoren e farmacistit me kujdesin me të madh, duke e matur dhe duke e peshuar mirë gjithçka, me përpikëri të madhe.
- FASULE** f. bot. Humbi si fasulja në vegsh humbi pa gjurmë, s'u pa më. Nuk me ftohen fasulet thjeshtligj. nuk shqetësohem fare për diçka, nuk me prishet puna, nuk me ftohet pilafi.
- FASHË** I f. I hoqi (ca) fasha e mundoi shumë, e sfliti. Ia lidhi gojën me fashë ia mbylli gojën, nuk e la të flasë.
- FAT** m. Për fat për fat të mirë, fatmirësisht. Për fat të keq mjerisht, fatkeqësisht. Për fat te mirë fatmirësisht, lumturisht. Ironi e fatit iron. përdoret kur ndodh diçka që nuk pritej e as mund të mendohej, kur vjen diçka fare e rastit dhe e pagjasë ose diçka e kundërt me atë që duhej të ndodhte. Rrota e fatit vjet., libr. shih te **RROT/Ë**,~A.
- FATMIRËSI** f. Për fatmirësinë time për fat të mirë, fatmirësisht.
- FAZË** f. Doli (iku, kaloi) nga faza thjeshtligj. s'është në rregull nga mendja; u çmend.
- FEMËR** f. Gur femër gur që mund të çahet e të bëhet rrasa. E ka mendjen femër është i zgjuar, i pjell mendja, krijon.
- FEMËROR** mb. Gjinia femërore gjuh. kategori leksiko-gramatikore e emrave dhe e disa përemrave, të cilët shënojnë një frymor femër ose një send që nga ana gramatikore merret si femër; kategori gramatikore e mbiemrave dhe e disa fjalëve të tjera që lidhen me emra a me përemra të tillë dhe që përkojnë me ta.
- FENER** m. E zunë pa fener dikë e kapën duke vjedhur a duke bërë një punë të pander-shme e të pamoralshme, e zunë me pelë për dore.
- FENIKS** m. libr. **PALMA FENIKS** bot. Lloj palme, degët e përkulura të së cilës u ngjajnë pendëve të gjata të një zogu të madh.

- FERMAN** m. Me ferman keq. i njohur nga të gjithë si i keq, me nam. I këndoi fermanin vjet. e dënoi me vdekje dikë, e groposi; i punoi qindin.
- FERRACAK** mb. Kungull ferracak bot. stërkungull.
- FERRË** f. Iu bë ferrë (rriqër, rrodhe. . .) shih te BËHEM. Çau ferrën (dushkun) shih te ÇAJ. I hynë ferrat filloi të shqetësohet, i hyri krimbi. I vuri ferrën (drizën) diçkaje e la, e braktisi. I bëhet ferra Brahim ka frikë për çdo gjë, trembet për çdo gjë, i bëhet gogol. E bën ferrën pëlle shih te PËLLE. Hodhi një gur në ferrë (në lumë, në ujë) shih tek UJ/Ë,~I. Nuk i ka hyrë ferrë (gjemb) në këmbë nuk ka vuajtur fare, nuk ka hequr keq në jetë; nuk ka pësuar asgjë, s'ka pasur asnjë humbje. Jam (rri) si në (mbi) ferra (gjemba, vezë) shih te GJEMB, ~I. E kam ferrë për qafe diçka me shqetëson vazhdimisht, me bezdis shumë. E ka ferrë (gjemb, halë, shushull) në sy shih te HALË,~A. Kërkoi derë e ferrë shih te DER/Ë,~A. E mori ferra fjalën u përhap fjala kudo, e morën vesh të gjithë. E mori ferra uratën mori fund puna, nuk rregullohet me (thuhet kur diçka nuk mund të prapësohet a të ndreqet më). Mban ferra lakuriq shih te LAKURIQ. I mbiftë ferra në derë! mallk. i rëntë një e keqe e madhe e ju shofshin të gjithë, iu softë pragu! Ia mbylli derën me ferra i bëri një të keqe të madhe, i bëri gjëmën, e shoi krejt, e fiku me tërë familjen. I vuri ferrën shtëpisë (derës) nuk la njeri pas, u shua me tërë familjen, u fik, u shkretua. Ferra e nisi, ferra e grisi shih te GRIS. Nuk i ngjitej (nuk e kapte) ferra gjëkund ishte shumë i varfër, s'kishte asgjë, s'kishte ku ta zinte qeni. Hardhia e bën rrushin, ferra e merr uratën fj.u. shih te HARDHI,~A. Zog ferre (miu, shtrige) zool. shih të ZOG,~U. Ferrë e bardhë bot. ferrëbardhë. Ferrë e butë bot. ferrëbutë. Ferrë deti bot. akacie. Ferrë (gjemb) gomari bot. gjembaç, rrëfeshk. Ferrë e keqe bot. drizë. Ferrë e kuqe bot. ferrëkuqe, drizë.
- FERROS** kal. bised. Ia ferrosi shtëpinë (derën) dikujt i bëri një të keqe të madhe, ia mbylli derën me ferra, e shoi krejt.
- FESTE** f. Sipas kokës edhe festen (ajo kokë atë feste do; atë kokë ka, atë feste do) fj. u. shih te KOKË,~A. E ka mizën nën feste (nën kësulë, nën shapkë) shih te MIZ/Ë,~A.
- FETË** f. E bëj fetë (feta)
- FËLLIQ** kal. E fëlliqi (e ndyu, e qelbi, e prishi, e rëndoi) gojën shih te GOJ/Ë,~A. Nuk e fëlliq (nuk e ndyj) dorën me dikë shih te NDYJ. Nuk e fëlliq (nuk e ndyn) pushkën me dikë shih te NDYJ.
- FËLLIQEM** vetv. Nuk fëlliqet (nuk lyhet) dielli me baltë fj.u. shih te DIELL,~I.
- FËMIJË** m. Me fëmijë e me rropulli shih te RROPULL,~TË. Dridhej fëmija (foshnja, barra) në bark të nënës shih te DRIDHEM. Shumë babo e mbytin fëmijën fj. u. shih te BABO,~JA. Fëmijët (djemtë) hanë kumbulla (thana), pleqve u mpihen dhëmbët iron. shih te MPIHEM. Po nuk qau fëmija, nuk i jep nëna (e ëma) sisë (gji, të pijë) fj. u. shih te QAJ. Lodra e fëmijës euf. shih te LODËRZ,~A. Vendi i fëmijës anat. shih te VEND,~I 9.
- FËRGOHEM** vetv. Fërgohet (skuqet, tiganiset cingariset) me dhjamin e vet shih te DHJAM/Ë,~I.
- FËRKEM** m. E shikoj për fill e për fërkem shih te FILL,~I.
- FËRKOJ** kal. Fërkon duart (barkun) keq. kënaqet, i bëhet qejfi kur sheh në gjendje të keqe një njeri që nuk e do, pret t'i shohë të keqen. I fërkon krahët (kurrizin, shpatullat, shpinën, zverkun) dikujt keq. e merr me të mirë e i bën lajka, i bën qejfin, i kreh bishtin.
- FËRTOMË** f. Bie shi me fërtoma bie shumë shi, bie shi me litarë.
- FICE** mb. Gorrice fice fjalë të kota, dokrra, gjepura.
- FIER** m. bot. Lule fieri bot. shih te LUL/E,~JA.

FIGURATIV mb. Artet figurative shih tek ART, ~I 2. Paralelizëm figurativ let. shih te PARALELIZ/ËM, ~MI 4.

FIGURË f. Sa për figurë sa për të thënë, sa për t'u dukur. Bën figurë të mirë (të keqe) libr. shquhet, dallohet, bie në sy për mirë (për keq).

FIJE f. Fije për fije (fije e për pe, fill e për pe) shih te FILL, ~I. I ra në fije (në fill, në të) diçkaje e kuptoi drejt, e mori vesh mirë. E di për fije diçka e di shumë mirë, e di me hollësi. Humbi fijen (fillin) shih te FILL, ~I. Është në fije (në fill) është në rregull, është në vijë, është mirë, i ka punët në vijë. Merr fije diçka merr të krisur, kris. Ka shkuar (është) në fije dikush është dobësuar e tretur shumë, është shumë i sëmurë; është lodhur shumë. I shkon (i vjen) pas fijos (pas fillit) dikujt flet në mënyrë që t'i bëjë qejfin dikujt tjetër, i shkon pas qejfit, nuk ia prish. E vë (e bie) në fije (në fill) diçka e vë në rregull, e rregulloj, e vë në udhë të mbarë, e vë në vijë. Erdhi në fije (në fill) u bë me mirë pas një sëmundjeje a pas një gjendjeje të vështirë, u përmirësua, e mori veten, erdhi në vete; erdhi në vijë. Asnjë fije floku asnjë thërrime, asnjë çikë, aspak. Fluturon me një fije bar përçm. shih te BAR, ~I I. Kapet (mbahet) pas fijos së perit (së flokut, së kashtës) mbështetet në baza jo të shëndosha; mbahet me shpresa të kota. Mbahet pas një fije floku (pas flokëve të vet) iron. shih te FLOK, ~U. Shpëtoi për një fije floku (për një fill, për një qime) që në rrezik të madh, shpëtoi për pak. Varet (qëndron) në fije (në fill) të perit (të flokut) është në rrezik të madh, varet në një qime. Është me dy fije brinjë shih te BRINJ/Ë, ~A. E ka mendjen fije peri është i zgjuar, është mendjehollë; e ka mendjen në rregull, nuk e ka humbur mendjen.

FIJOJ kal. E fijen muhabetin di të bëjë muhabet, e bën muhabetin fjollë.

FIK m. Ra (zbriti, u rrëzua) nga fiku iron. ra nga grada ose nga pozita, e ulën në de-

tyrë; e pësoi. Gjethe (fletë) fiku diçka që përdoret me kot për të fshehur a për të mbuluar një të vërtetë. Mik për fiq mik për interes, mik i rremë. Ulu zbrit nga fiku! iron. mos u mbaj me të madh, ule hundën! I ka rënë pjergulla në fik shih te PJERGULL, ~A. Kur të hip gomari (derri) në fik (majë fikut) thjeshtligj. shih te GOMAR, ~I. Si fiku me arrën (si arra me palën) i përshtaten shumë njëri -tjetrit, shkojnë shumë me njëri-tjetrin. Si pjergulla më fik te bardhë shih të PJERGULL, ~A. Nuk i hipën dot dardhës e i bie fikut fj.u. shih te DARDH/Ë, ~A. Sheh fiku fikun (rrushi rrushin) e piqet fj.u. shih te RRUSH, ~I.

FIKEM vetv. U fikën gazit u shkulën së qeshuri, u gajasën. S'i fiket (s'i trembet) syri shih te TREMBEM.

FILDISHTË mb. Mbyllet në kullën e fildishtë keq. shih te KULL/Ë, ~A.

FILOZOFIK mb. Guri filozofik shih te GUR, ~I.

FILXHAN m. E mat detin me filxhan ka shumë durim për të bërë një punë që kërkon kohë e mundim të madh. Mbytet në një filxhan (në një gotë, në një lugë, në një gisht, në një pikë) ujë mospërf. shih tek UJ/Ë, ~I. Lule filxhani bot. shih te LUL/E, ~JA.

FILL m. Një fill veshje një veshje kombëtare e plotë. Në fill të këmishës pa gjë tjetër në trup, vetëm me këmishë. Fill e nga një fill pak e nga pak. Fill e gjilpërë (në majë të gjilpërës, majë gjilpërë) shih te GJILPËRË, ~A. Fill e për pe (fije për fije, fije e për pe) një për një, hollësisht, me imtësi; deri në fund, pa lënë asgjë. U bë fill dikush u dobësua, u tret shumë; iu bë barku petë nga të pangrënët. I ra në fill (në fije, në të) shih te FIJ/E, ~A. Ia hoqi fillin dikujt a diçkaje nuk i kushtoi me asnjë vëmendje, nuk u kujdes më për të, nuk u bë me merak për të, nuk ia vari; e shpërfilli. E humbi fillin (fijen) e humbi torruan, u hutua. I humbi filli i lëmshit u hutua fare, e humbi fillin e mendimeve.

- Është në fill (në fije) shih te FIJ/E, ~A. Ia ka lëshuar fillin dikujt shih te LËSHOJ. Marr në fill përfill. E mblodhi fillin erdhi në vete; e mori veten.
- FILL** ndajf. Fill për fill
- FILLESTAR** mb. Akumulimi fillestar i kapitalit ek. shih tek AKUMULIM,~I.
- FILLIM** m. Fillim e mbarim
- FILLOJ** kal. Filloi radhë të re shih te RADH/Ë,~A.
- FINJË** f. U bë finjë
- FIQIR** m. bised. Nuk është në fiqir shih Nuk është në vete te VET/E, ~JA. E humbi fiqirin (mendjen) shih te HUMB. E ka lënë fiqiri (mendja) shih te LË. S'ia pret fiqiri (mendja, poçi) shih te PRES 23. Ia prishi fiqirin (mendjen) shih te PRISH.
- FIRIFIU** mb. thjeshtligj. mospërf. Ia bëri mendjen firifu dikujt ia mori mendjen, e bëri për vete; ia ngriti mendjen për diçka. E ka mendjen firifu është mendjelehtë, është si veriu.
- FIRMË** f. E jap me firmë e siguroj dikë për diçka, e them me bindje të plotë, e quaj një gjë shumë të sigurt. E marr me firmë sigurohem, bindem për diçka. Nuk i shkon firma edhe poh. nuk i dëgjohej fjala.
- FIS** m. Farë e fis shih te FAR/Ë,~A. Pa farë e pa fis shih te FAR/Ë,~A. E ka për fis e ka zakon të trashëguar; ajo sjellje i shkon. Do të vejë në fis keq. do ta tregojë veten se ç'është e sa vlen.
- FISNIK** mb. Metale fisnike kim. shih te METAL, ~I.
- FISHEK** m. Fishek pa barut njeri pa vlerë. Fisheku i fundit shih te FUNDIT (i,e). Bëri fishek gjeti një të çarë a një shteg e doli jashtë me vrull (thuhet për flakën e druve që digjen në një kaminë, kur ajo depërton nëpër shtresën e baltës etj. ose kur dikush del me vrull nga një rrethim a nga një gjendje e vështirë). Ishte fishek thjeshtligj.
- FISHKËLLEJ** jokal. I fishkëllen (i fryn, i këndon) në vesh dikujt shih te VESH,~I.
- FITIL** m. Fut (shtie) fitila (fite, fitme) shih te FUT. I ka hyrë fitili thjeshtligj. e ka zënë dashuria, ka rënë në dashuri me dikë. Ka marrë fitilin ka marrë të ftohtë; është i sëmurë nga tuberkulozi; e ka zënë një sëmundje e rëndë. U puqën fitilat janë të një mendjeje, kanë mendime të njëjta; u shkon muhabeti. I vuri fitilin (pishën.) diçkaje shih te PISHË, ~A.
- FITIM** m. Tatim fitimi ek. vjet. shih TATIMFITIM,~I.
- FITTOJ** kal. E fitoi davanë shih te DAVA,~JA. Fiton (merr) të drejtën e qytetarisë libr. shih te QYTETARI,~A. Fitoi flamurin libr. doli i pari, korri një fitore. Fitoi pikë siguroi përfitime për vete; iu ngrit autoriteti e vlera përpara të tjerëve, e përforcoi emrin e vet të mirë. Fiton tokë (truall, vend) zgjerohet veprimtaria e diçkaje; përhapet, shtrihet në hapësirë. I fitoi zemrën dikujt e bëri që ta dojë, e bëri për vete dikë. Fitoi kosh fitoi ai që punoi me kohë e me mend doli i fituar, të tjerët s'patën ndonjë të mirë.
- FITORE** f. Fitore si e Pirros (si fitorja e Pirros) libr. fitore me humbje shumë të mëdha.
- FIZIOLOGJIK** mb. Tretësisë fiziologjike mjek. shih tek TRETËSIR/Ë,~A. Ujë fiziologjik mjek. shih tek UJ/Ë,~I 3.
- FJALË** f. 6. Bisedë që bëhet me një tjetër, diçka që thuhet a që tregohet; muhabet (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Në fjalë e sipër duke folur, gjatë bisedës. Lërimi fjalët! Ngas fjalën nxit bisedën, e zhvilloj me tej një bisedë. E la fjalën përgjysmë. Me që ra (me që erdhi) fjala... duke marrë shkas nga biseda, me këtë rast. E hodhi fjalën për dikë a për diçka. Sa për t'u gjendur në fjalë. E zuri (e kapi) në fjalë. E hodhi fjalën gjetkë. U ngjitet fjala u shkon muhabeti me njëritjetrin. Ma pruri (ma solli, ma nxori)

fjalën në shteg e solli bisedën atje ku desha unë. Ia sjell (ia bie, ia hedh) fjalën rrotull (larg e larg).

Në fjalë për të cilën a për të cilin flitet a bisedohet. Me një fjalë shkurt; në mënyrë të përmbledhur. Pa fjalë (s' do fjalë) pa dyshim, s'ka dyshim. Bëj fjalë për diçka flas për diçka, trajtoj diçka. Bëri (shkëmbeu, këmbëu, ndërroi) fjalë me dikë u grind me dikë, u zu me fjalë. S'bën fjalë nuk ndihet; nuk ankohet e nuk kundërshton, pranon ç't'i japësh etj. S'e bëj për fjalë (për zë) nuk i tregoj askujt diçka që nuk duhet thënë, nuk flas me njeri për diçka që duhet mbajtur e fshehtë. Bie fjala për shembull, fjala vjen. I ra në fjalë dikujt i preu fjalën. E drodhi fjalën shih te DREDH 7. Fjalë ari shih tek AR, ~I. Fjalë në erë (në hava) shih tek ER/Ë, ~A I. Fjalë për fjalë pa ndryshuar asgjë nga ajo që është thënë a është shkruar, një për një. Fjala e fundit

FJETUR mb. E kam mendjen të fjetur jam i qetë ose i sigurt për diçka, e kam hequr merakun, e kam mendjen të mbledhur. Syth i fjetur bot. shih te SYTH, ~I 1.

FJOLLË f. E bën muhabetin fjollë di të bëjë muhabet; është i gojës. I shkon (i vete, i ecën) puna fjollë i shkon puna mbarë, s'i del përpara asnjë pengesë e vështirësi.

FLAKË f. Flakë e flakë gjithandej, krejt, tërësisht. Flakë për (me) flakë aty për aty, në çast, menjëherë. I ka rënë flaka (zjarri, flama) diçkaje shih te BIE I. I doli flaka diçkajey

FLAMË f. I ka rënë flama (flaka, zjarri) diçkaje shih te BIE I. I kalli (i futi) flamën (murtajën) dikujt a diçkaje shih te KALL. Ç'i këllet flamën (plasjen)! shih te KËLLAS. S'ka flamë që s'e zë dikë është njeri që ndikohet lehtë nga ide, pikëpamje a vese te këqija.

FLAMUR m. Fitoi flamurin libr. shih te FITOJ. Humb flamurin libr. shih te HUMB. Mban flamurin shih te MBAJ. Ndërroi flamur tradhtoi, ndërroi bajrak. Ngriti (shpalosi) flamurin shih te

NGRE. Ngriti flamurin e bardhë shih te BARDHË (i,e). Njeri me dyzet (me njëqind) flamurë njeri që nuk i përmbahet një ideje a një ideali, që bëhet herë me njërën e herë me tjetrën palë, që e kthen gunën nga të fryjë era. Tregtar flamurësh libr. njeri i shitur; njeri pakarakter, njeri i paparim. E uli flamurin shih tek UL. I ka ulur flamurët shih tek UL. Doli me flamur të hapur shih te HAPUR (i,e).

FLAS jokal. Flet me bërryl shih të BËRRYL, ~I. I foltë hoxha (prifti) mallk. vjet. shih te HOXH/Ë, ~A. Kur të flasin lopët iron. shih te LOP/Ë, ~A. Flet në mulli tall, shih te MULLI, ~RI. Flet e shflet nuk e bën atë që thotë, nuk e mban fjalën. Ma flet (ma thotë, ma ndien, ma ndjell) zemra shih te ZEM/ËR, ~RA. Fliste nën zë shih te ZË, ~RI. Flasin gjuhë të ndryshme nuk e kuptojnë njëri-tjetrin, nuk merren vesh, secili me të vetën. Flas ndryshe me të ia ndreq unë atij! (me kërcënim). Fol e rruaj vezë shih te RRUAJ. Kujt i flet, murit? është kokëfortë dhe nuk kthen përgjigje fare ose nuk bindet. Fol o gur, fol o mur! shih te GUR, ~I. I flas derës të dëgjojë qilari e them diçka tërthorazi, e hedh fjalën në bisedë me dikë që të dëgjojë një tjetër, i bie pragut të dëgjojë dera. Kija inatin dhe foli hakun (kija matin po hakun mos ia ha) fj.u. shih tek INAT, ~I. Të rrimë shtrembër e të flasin drejt! fj.u. shih te SH TREMBËR. Vetë flet, vetë dëgjon s'e dëgjon asnjëri, nuk ia vë veshin kush; flet kot.

FLE jokal. Fle (prehet, e ka zënë gjumi) mbi dafina shih te DAFIN/Ë, ~A. Fle me gretha shih te GRETH, ~I. Fle në një krahu shih te KRAH, ~U. Fle në këmbë është i ngathët e i plogët nga trupi e nga mendja, është i humbur. E fjeti mendjen ishte i qetë ose i sigurt për diçka; e hoqi merakun, nuk u shqetësua më. Nuk me fle mendja te dikush a te diçka edhe poh. nuk kam besim, nuk besoj. S'më fle mendja (katari) s'më mbushet mendja; jam i pavendosur. Fjettë të mirën! mallk.

- vdektë! Fle (bie) me pulat bie të flejë shumë herët. Fli rehat! mos u shqetëso, mos kij merak për diçka, se ka kush e bën, se ka kush mendon për të. Fjeta rrasët shih te RRASËT. Fle me një sy (hapur) rri në rojë, është syçelët. Fle zbatthur fle pa frikë, fle i qetë. Paska fjetur zbuluar iron. shih te ZBULUAR. I fjeti në zemër diku i pëlqeu shumë, i hyri në shpirt. Në atë krah (anë, brinjë) fli! iron. shih te KRAH,~U. Fle gjumin e vdekjes (fle gjumin e madh, fle të madhin)
- FLETË** I f. Fletë (gjethe) fiku shih te FIK,~U. Fletë delli bot. shih GJETHE DELLI te GJETH/E,~JA.
- FLETË** II f. I vuri fletë gojës e mbylli gojën, nuk foli, e qepi, i vuri kyç gojës. E ktheu (e ndërroi) fletën (pllakën) keq. shih te PLLAK/Ë,~A. Fletë dylli shtypshkr. letër e posaçme që përdoret për të shumëfishuar kopjet në shaptilograf. Fletë tipografike shtypshkr. fashikull me gjashtëmbëdhjetë faqe dhe me dyzet mijë shenja.
- FLETË** III f. U bënë me fletë (me krahë) u gëzuan shumë nga një lajm, nga një fitore etj; dhe morën guxim e forca të reja. I ranë fletët (pendët) shih te PEND/Ë,~A. I dolën fletë (krahë) shih te KRAH,~U, I dha fletë (krahë) shih te KRAH,~U. Mori fletë (krahë) shih te KRAH,~U. Trim me fletë trim i madh; njeri shumë i zoti që çan përpara pa iu trembur vështirësive.
- FLI** f. Bëj fli (theror) flijoj. U bë fli (theror) u flijua.
- FLOK** m. Dash me flokë burrë i shquar, burri me i mirë në një fshat, në një rreth familjar etj. Iu drodhën flokët (qimet e kokës, leshrat e kokës) iu rrëqeth mishi, u tmerua; iu ngritën flokët përpjetë. E mori për flokësh e mori me zor, e mori me forcë. Asnjë fije floku shih te FIJ/E,~A. U bë flokë (lesh) arapi shih te LESH,~I. Ia dha flokët (leshrat, veshët) në dorë shih te JAP. Kapet (mbahet) pas fijos së flokut (së perit, së kashtës) shih te FIJ/E,~A.
- E ka kapur nga majat e flokëve e ka parë përciptas një çështje; nuk e ka përvetësuar thellë diçka, ka përvetësuar gjërat me pak të rëndësishme. Mbahet pas flokëve të vet iron. mbështetet te diçka shumë e dobët dhe e pasigurt. Iu ngritën (iu çuan) flokët (qimet e kokës, leshrat e kokës) përpjetë
- FLOKËKUQ** mb. Grurë flokëkuq bot. shih te GRUR/Ë,
- FLORI** m. Flori në baltë (në pleh) shumë i çmueshëm, shumë i vlefshëm, por në një vend ku nuk e çmojnë ose ku nuk mund të hyjë në punë. Flori në mushama shumë i mirë. Kapak floriri gjëja më e mirë; zgjidhja më e mirë. Ishte i krimbur në flori shih te KRIMBUR (i,e). Të peshonte në flori shih të PESHQJ. Pëllëmbë e flori shih te PËLLËMB/Ë,~A. I bëhet balta flori
- FLORINJTË** mb. Hante me lugë të floringjtë ishte shumë i pasur, rronte në bollëk të madh. Vath i floringjtë në vesh të dërrit gjë e mirë në vend të keq, veti a cilësi e mirë, por që zotërohet nga një njeri që ka disa anë të këqija, gjalpë në lëkurë të qenit.
- FLOTË** f. Flota ajrore tërësia e aeroplanëve të një vendi, aviacioni.
- FLUTUR** f. Pështja e fluturës sport, vjet. kategori e boksierëve, e ngritësve të peshave dhe e mundësve me peshë trupore nga 47-52 kg.
- FLUTURAK** mb. Fjalë fluturake shih te FJAL/Ë,~A. Peshk fluturak (fluturues) zool. shih te PESHK. ~U.
- FLUTURIM** m. Fluturim lirik let. ndërpreja e fillit të tregimit të ngjarjeve në një vepër letrare nga autori për të shprehur me lirizëm ndjenjat e mendimet e veta.
- FLUTUROJ** jokal. Të fluturon koka (të fluturojnë trutë) të pret dënimi me i madh, të ikën koka, vdes. I fluturoi mendja u hutua fare, s'është në vete. Fluturon me një fije bar përçm. shih te BAR,~I I.

- FLUTURUES** mb. Fortesë fluturuese (ajrore) shih te FORTES/Ë, ~A. Peshk fluturues (fluturak) zool. shih te PESHK, ~U.
- FLUSKË** f. U bë fluskë u dobësua shumë, u lig fare. Fluskë sapuni shih te SAPUN, ~I.
- FODULL** mb. bised. Hem qeros, hem fodull (qibar) shih te QEROS, ~I.
- FOLE** f. Fole grerëzash (arëzash) keq. shih te GRERËZ, ~A. Bën (ngre, gjen, zë) fole
- FOLËS** mb. Gazetë folëse shih te GAZET/Ë, ~A.
- FORA** ndajf. bised. Ia bëri fora
- FORCË** f. Me forcë (me tërë forcën) me vendosmëri dhe me këmbëngulje. Me forcat tona (e veta) duke u mbështetur në aftësitë, mundësitë dhe burimet e brendshme a vetjake. Mat forcat me dikë ndeshem me dikë, matem me të. Forcë e mbinatyrshme fuqi e mbinatyrshme. Forcat prodhuese ek. njerëzit me përvojën dhe shprehitë e tyre në punë së bashku me mjetet e prodhimit. Forcat vullnetare të Vetëmbrojtjes Popullore forca të organizuara në formacione luftarake.
- FORMAL** mb. Logjikë formale shih te LOGJIK/Ë, ~A I.
- FORMË** f. I formës së prerë zyrt. i vendosur përfundimisht, që nuk mund të rishqyrtohet e të ndryshohet (për një vendim gjyqi etj.). Format e ndërgjegjes shoqërore filoz. idetë e pikëpamjet politike, juridike, filozofike, morale, fetare, artistike, etj. që pasqyrojnë realitetin shoqëror në këtë ose atë mënyrë.
- FORMUES** mb. Vijë formuese mat. shih te VIJ/Ë, ~A.
- FORT** I ndajf. Aq me fort veçanërisht, sidomos, aq me tepër; aq me shumë. Punë e madhe fort! mospërf. shih te PUN/Ë, ~A.
- FORTESË** If. Fortesë ajrore (fluturuese) aeroplan bombardues i rëndë.
- FORTË** mb. Me të fortë me zor, me pahir. Është kockë e fortë shih te KOCK/Ë, ~A. Ka limë të fortë dikush shih te LIM/Ë, ~A. Ka zdrukth të fortë dikush shih Ka lime të fortë te LIM/Ë, ~A. Shkalla e lartë do (kërkon) këmbë të forta fj.u. shih te SHKALL/Ë, ~A. Uthulla e fortë prish enën e vet fj.u shih tek UTHULL, ~A. Myka e di sa e fortë është gozhda fj. u. shih te MYK/Ë, ~A. Grurë i fortë bot. shih te GRUR/Ë, ~I. Ujë i fortë (i rëndë) kim. shih tek UJ/Ë, ~I.
- FOSHNJË** f. Dridhej foshnja (fëmija, barra) në bark të nënës shih te DRIDHEM. E ka parë ujkun që foshnjë shih tek UJK, ~U I.
- FQINJË** f. Pula e fqinjës të duket patë shih te PAT/Ë, ~A.
- FRAZELOGJIK** mb. 1. gjuh. Që ka të bëjë me frazeologjinë, që i përket frazeologjisë, i frazeologjisë; që është njësi e frazeologjisë, që lidhet me njësitë e frazeologjisë; që përmban njësi të frazeologjisë. Njësi frazeologjike tog i qëndrueshëm fjalësh ose thënie a shprehje e qëndrueshme që ka tiparet dalluese të frazeologjisë. Tipat e njërive frazeologjike. Togfjalësh frazeologjik. Shprehje (përngjitje) frazeologjike. Fjalor frazeologjik.
- FRE** I m. Pa fre pa u përmbajtur; lirisht, pa asnjë kufizim. S'ka fre është i papërmbajtur; s'ka njeri që e mbikëqyr e që kujdeset për të. Ia lëshoi (ia liroi) frerin (kapistallin, kapistrën) dikujt keq. shih te LËSHOJ. Mban frerin shih te MBAJ. E mban në fre dikë e mban nën kontroll të rreptë, nuk e lë të bëjë si të dojë; nuk e lë të shkojë përpara në një fushë të veprimtarisë; e frenon. Ia shtrëngoi (ia mblodhi) frerin (rripat) dikujt shih te MBLEDH. I vë fre dikujt a diçkaje e pengoj, e ndaloj; e freno. Vë (fat) në fre dikë e vë nën kontroll të rreptë; përpiqem ta freno. Ia lëshoi frerin gojës (gjuhës) filloj të flasë pa u përmbajtur, nuk matet mirë kur flet. E mori frerin nëpër këmbë nuk ka

- me frikë nga njeri, nuk pyet me për as njeri, ka marrë vrull e kujton se nuk e pengon dot askush. Ia shtrëngoi frerin gojës (gjuhës) flet më me kujdes, tregohet më i matur në të folur, e mblodhi gojën. I vuri fre gojës (gjuhës) përmbahet në të folur; nuk flet shumë, tregohet më i matur në të folur. I vë fre pleshtit merret me gjëra fare të kota e të parëndësishme; krijon probleme për hiçmosgjë. Gjithkujt i duhet (i hyn në punë) një fre çdo njeri duhet të dijë kur e sa të flasë dhe si të flasë, si të sillet e të veprojë.
- FRESKOJ** kal. I freskoj zemrën dikujt e qetësoj; e kënaq.
- FRËNG** m. bised. E pagoi sa frëngu pulën e bleu shumë shtrenjtë. Fik frëngu (deti) bot. shih te **FIK**, ~U. Rrush frëngu (tokë) botë shih te **RRUSH**, ~I.
- FRIKË** f. I ka hyrë frika në palcë (në bark, në mish) shih te **PALC/Ë**, ~A 6.
- FRON** m. Lëshoi fronin (vendin) shih te **LËSHOJ**.
- FRONT** m. Në front të gjerë në të gjithë vendin, me përmasa të mëdha, në ballë të gjerë.
- FRUGULL** m. E bëj frugull diçka e djeg krejt, e bëj shkumb; e përcëlloj.
- FRUTË** f. Shpuesi i frutave zool. shih te **SHPUES**, ~I.
- FRUTH** m. Fruthi i zi (i keq) mjek. skarlatina.
- FRYHEM** vetv. Iu frynë ijët hëngri shumë. Iu fry koka
- FRYJ** kal. Fryn pendët dikush mbahet më të madh, krekoset. Fryji sytë! s'ke për ta parë më diçka, qaje, laji duart nga diçka. Nuk të fryn në sy shih te **SY**, ~RI. Mos m'i fryj shkotat! mos më mërzit, mos më inatos! I fryn (i këndon, i fishkëllen) në vesh dikush shih te **VESH**, ~I. Ia fryn zemrën dikujt i shkaktoi dhimbje të madhe shpirtërore, e hidhëroi shumë, e dëshpëroi. I fryn zjarrit i nxit më tepër mosmarrëveshjet, grindjet a armiqësitë. I fryn lugës së tij shikon punën e tij e nuk përzihet në çështjet e të tjerëve. I ka fryrë murrani në qese shih te **MURRAN**, ~I. Nga fryn era kthen gunën (gëzofin, shpinën) vepron si t'i bëhet më mirë atij, kthen nga t'i leverdisë. Kthehet (shkon) nga të fryjë era shih tek **ER/Ë**, ~A I. U dogj nga qulli (nga kungulli) e i fryn edhe kosit fj.u. shih te **QULL**, ~I.
- FRYMË** f. Në frymë të dikujt a të diçkaje fare pranë, shumë afër dikujt a diçkaje. Në frymën e... sipas, në bazë të... Me një frymë me ngut, me nxitim, shpejt; menjëherë. Frymë më frymë shumë afër njëri-tjetrit, fare pranë. I ka dalë fryma diçkaje i ka dalë lezetit, është bërë pa shije. I doli fryma (shpirti, xhani) dikujt shih te **SHPIRT**, ~I.
- FSHAT** m. Bën fshat më vete jeton më vete, zhvillon veprimtari më vete; vepron sipas mendjes së vet. Kryeplak në fshat të huaj shih te **KRYEPLAK**, ~U. Fshati që duket s'do kallauz fj.u. diçka që duket a njihet nuk ka nevojë për shpjegime të mëtejshme; është fare e qartë e nuk ka nevojë për ndonjë provë a dëshmi.
- FSHEH** kal. I fsheh brirët keq. shih te **BRI**, ~RI. E fsheh llafin përmbahet, nuk flet menjëherë, nuk ngutet në të folur. I fshehu (i mbuloi, i humbi) gjurmët shih te **GJURMË**, ~A.
- FSHESË** f. Bishti i fshesës njeri që nuk përfillet nga të tjerët (në një familje a në shoqëri). I ra fshesa (kosa, gërsheta) shih te **BIE** I. E bëri fshesë dikë e trajtoi keq dikë, e mori nëpër këmbë. I vuri fshesën dikujt a diçkaje
- FSHIHEM** I vetv. Fshihet pas bregut shih te **BREG**, ~U. Fshihet pas (prapa) gishtit (pas hijes së gishtit) shih te **GISHT**, ~I. Fshihet pas gjuhës së vet shih te **GJUHË**, ~A I. Nuk fshihet derri në thes fj. u. shih te **DERR**, ~I. Nuk fshihet (nuk mbulohet, nuk zihet) dielli me shoshë fj. u. shih te **DIELL**, ~I. Nuk fshihet (nuk hyn, nuk futet) hosteni (minarja) në thes fj. u. shih te **MINAR/E**, ~JA.

- FSHIJ** kal. Fshin buzët bën naze në të ngrënë. I fshiu buzët nga diçka hoqi dorë, nuk ka më shpresë, lau duart nga diçka. E fshiu (e hoqi, e shoi, e shleu) nga defteri dikë a diçka shih te DEFTER, ~I. I fshiu (i lau) duart nga dikush a nga diçka shih te LAJ. I fshiu lotët dikujt i hoqi a i largoi hidhërimin dikujt. Nuk di të fshijë hundët mospërf. nuk është i zoti për asgjë, është fare i humbur. Fshiji mustaqet (buzët) për murrizi (pas murrizit) iron. shih te BUZ/Ë, ~A.
- FSHIKËZ** f. Fshikëza e mirë veter. euf. plasja e bagëtive.
- FSHIKULL** m. U bë fshikull u dobësua shumë, u tret.
- FTOH** kal. I ftohu (i uli, i shoi, i shtroi, i zbuti) gjakrat shih te GJAK, ~U I. I ftoha kryet (kokën) dikujt i zgjidhi një hall të madh; e nxori nga një gjendje e rëndë. As të ngroh, as të ftoh shih te NGROH.
- FTOHEM** I vetv. Nuk më ftohen fasulet thjeshtligj. shih te FASUL/E, ~JA. U ftohën (u ulën, u shuan. u shtruan, u zbutën) gjakrat shih te GJAK, ~U I. Iu ftoh gjaku shih te GJAK, ~U I. Nuk më ftohet pilafi (byreku) thjeshtligj. shih te PILAF, ~I. Iu ftoh zemra shih te
- FTOHTË** mb. Armë e ftohtë (e bardhë) armë që pret ose shpon dhe që përdoret zakonisht në luftimet trup me trup (si shpata, bajoneta, thika. etj.). Hallvë e ftohtë keq. shih te HALLV/Ë, ~A. Luftë e ftohtë shih te LUFT/Ë, ~A 3. Sëmundja e ftohtë euf. tifoja. Me gjak (me gjykim) të ftohtë me gjakftohtësi. E pafsha të ftohtë! mallk. vdektë! Si ujët e ftohtë me dëshirë te madhe; me padurim; si ujët e pakët. E bëri për ujë të ftohtë dikë shih tek UJ/Ë, ~I. I bien (i shkojnë, i dalin, e mbulojnë) djersë të ftohta është në gjendje shumë të vështirë, e ndien veten shumë ngushtë (kur dikë e qortojnë ose e dënojnë për një gabim a faj, kur e vëmë përpara përgjegjësisë etj.). E ka barkun (zemrën) të ftohtë ka shpresa të pakta, nuk beson shumë se do të bëhet diçka. I ka qiçrat të ftohta me dikë ka marrëdhënie të këqija me dikë; nuk shkon mirë me të.
- FTUA** m. U bë ftua u zverdh shumë në fytyrë, u bë limon. Ftua i egër bot. shkurre e vendeve malore, që i ngjan ftoit; me gjethe të vogla e të dendura, që bën kokrra të vogla e të mbuluara me push, të cilat nuk hahen.
- FUÇI** f. Fuçi baruti shih te BARUT, ~I. U bë fuçi hëngri shumë sa iu fry barku, u bë vozë.
- FUG** kal. E fugu (e hodhi, e vuri, e ktheu) kësulën (festen, qeleshën, kapelën, takijen) mbi sy (mënjane) shih te SY, ~RI. Fug peshën e fsheh dorën fj.u. shih Hedh gurin e fsheh dorën te HEDH.
- FUGË** II f. E bëri fugë dikë a diçka e dogji fare, e bëri shkrumb e hi. I vuri fugën diçkaje e rrënoi krejt, e prishi fare.
- FUKARA** m. bised. Kur kërcente (luante, bënte dasmë) fukarai çahaj daullja shih te DAULL/E, ~JA.
- FULQI** m. bised. I kanë dalë fulqinjte është dobësuar shumë. I theu (i dërrmoi) fulqinjte (nofullat, hundët, turinjte, brinjët) dikujt përçm. shih te THYEJ.
- FULTERE** f. Më dha saçin, i jap fulteren të mirën që më bën dikush, ia kthej me të mirë.
- FUND** m. Deri (gjer) në fund krejt, plotësisht. Më në fund
- FUNDIT** mb. Së fundi kohët e fundit. Më së fundi tekembranja, më në fund. Tek e fundit në fund të fundit. Në analizë të fundit libr. shih tek ANALIZ/Ë, ~A. Banesa e fundit euf. varri. I dorës së fundit i një cilësie shumë të dobët. Në dorë të fundit gati në përfundim. Fisheku i fundit i vetmi mjet që i ka mbetur dikujt e që ka në dorë, mundësia e vetme. Fjala e fundit shih te FJAL/Ë, ~A. Deri në frymën e fundit deri në vdekje. Guri (zari) i fundit prova e fundit. Në instancë të fundit libr. në fund të fundit,

- tek e fundit. I orës së fundit shih tek **OR/Ë,~A** I. Në pikë të fundit në fund të fundit, tek e fundit. Udhëtimi i fundit libr. vdekja dhe varrimi. Deri në pikën e fundit të gjakut deri në vdekje. I fundit o qesh, o qan fj. u. shih te **QAJ**. I hoqi gurin e fundit dikujt shih te **HEQ**. I jap dorën e fundit diçkaje e mbaroj, e përfundoj. Dha frymën e fundit vjet. shih te **FRYM/Ë,~A** 8. I dha grushtin e fundit e dëmtoi shumë rëndë ose e shkatërroi plotësisht. I dhanë lamtumirën e fundit lart. shih te **JAP**. Edhe po të jetë në fund të detit.. shih te **DET,~I**. Luaj (hedh, përdor) letrën (kartën, gurin, zarin) e fundit përdor edhe mundësinë e vetme që kam për t'ia arritur diçkaje. Ndau kafshatën e fundit (kafshatën e gojës) me dikë shih te **KAFSHAT/Ë,~A**. Është vrima e fundit e kavallit (bishti i kavallit) shih te **KAVALL,~I**. Ka shkuar (ka vajtur) në pikë të fundit është në një gjendje ekonomike, shëndetësore, morale shumë të rëndë, është si mos më keq.
- FUQI** sh. Fuqi (forcë) madhore shih te **MADHOR,~E**. Fuqi e mbinatyrsme perëndia, zoti (sipas botëkuptimit idealist e fetar). Hipi në fuqi shih te **HIPI**. Zbriti nga fuqia shih te **ZBRES**.
- FURÇË** f. I dha një furçë e lavdëroi për t'i bërë qejfin, i bëri një lëvdatë për ta marrë me të mirë, për t'ia hedhur etj.
- FURDE** f. U bë furde u dobësua shumë, u tret, u bë gisht.
- FUREM** I vetv. Iu fur shpirti u mërzi shumë, i ka ardhur shpirti në maje të hundës.
- FURKË** f. U bë furkë u dobësua shumë, u bë shkop. I ikën furkat luajti mendsh, u prish nga mendtë. E nxori në furkë diçka ua bëri të njohur të gjithëve, nuk e mbajti të fshehur. Del si boshti para furkës shih te **BOSHT,~I**.
- FURTUNË** f. Bëri furtunë (tufan) shkaktoi tronditje të madhe, përmbysi, shembi diçka. U bë furtunë (tufan)
- FURRË** f. U bë furrë dikush u nxeh, u inatos shumë. E bëri furrë diçka e dogji krejt, e bëri shkrumb e hi. Kemi ngrënë një furrë bukë (një thes kripë, një barrë kripë, një hambar miell) bashkë njihemi prej kohësh, punojmë prej kohësh së bashku; jemi shokë a miq të vjetër. I nxjerr si simitet nga furra shih te **SIMITE,~JA**.
- FUSHË** f. Në fushën e mejdanit vjet. shih te **MEJDAN,~I** 2. Fushë me mina shih te **MIN/Ë,~A**. Fusha e nderit lart. shih te **NDER,~I**. Në fushën e nderit shih te **NDER,~I**. Fushë pamjeje (fusha e pamjes) fushëpamje. Fushë (kamp) përqendrimi shih te **PËRQENDRIM,~I**. U bë fushë (tapë, thumb, xurxull...). shih te **BËHEM**.
- FUSHK** m. Fushk në dushk fjalë e kotë që nuk zë vend, gjezur.
- FUSHTAGË** f. I vuri fushtagën dikujt e përzuri dikë, i vuri drunë.
- FUT** kal. E fut (e lë) në arkiv libr. shih tek **ARKIV,~I**. E futi (e vuri, e shtiu) në bigë dikë shih te **BIG/Ë,~A**. E futi (e vuri) në brazdë shih te **BRAZD/Ë,~A**. E futën (e rrasën) brenda thjeshtligj. mo-spërf. shih te **BRENDA**. Fut (shtie) cita (fite, fitila, fitme, kalla, kunjja, spica) e shtyn, e nxit dikë për të bërë një punë të keqe, e shtyn dikë me qëllim të keq kundër një tjetri. S'e fut (s'e vë, s'e shtie, s'e shkruan, s'e ka) në defter dikë a diçka edhe poh. shih te **DEFTER,~I**. E futi në dollap shih te **DOLLAP,~I**. Fut duart diku keq. ndërhy, merr pjesë në një punë, në një çështje etj. që s'i takon. E futi (e shtiu) në dorë dikë a diçka shih te **DOR/Ë,~A** 4. Ia fut dushk thjeshtligj. shih te **DUSHK,~U**. I futi flakën (zjarrin) i futi grindjen, e përçau. I futi (i kalli) flamën (murtajen) dikujt a diçkaje thjeshtligj. shih te **KALL**. Fut (vë) në fre dikë shih te **FRE,~RI** I. I futi (i vuri) gërsërën shih te **GËRSHËR/Ë,~A**. Fut gishtin diku shih te **GISHT,~I**. Ia ka futur në gjak diçka shih te **GJAK,~U** I. Fut gjemba shih te **GJEMB,~I**. I futi gjilpërat dikujt shih te **GJILPËR/Ë,~A**.

Fut hundët (bundën, turinjtë) në diçka keq. ndërhyr në një çështje që s'i takon, përzihet në një punë, në të cilën nuk duhet të përzihet. E futi në kallëpe shih te KALLËP, ~I. I fut (gjërat) në kallëpe shih te KALLËP, ~I. E futi (e vuri) në katror dikë libr. shih te KATROR, ~I. Ia fut katundit thjeshtligj. shih te KATUND, ~I. Fut (vë) këmbët (këmbën) diku shih te KËMB/Ë, ~A. I futi krimbin diku shih te KRIMB, ~I. E futi (e vuri) në lesë dikë shih te LES/Ë, ~A. Ia fut (ia shtie) në (ndër) mend (në mendje) diçka shih te MEND, ~TË. I fuiti (i shtiu) mizat (xixat) diku shih te SHTYU, e nxiti dikë për diçka; i ngjalli një dëshirë të fortë a një shqetësim për diçka. S'e fut (s'e vë, s'e zë, s'e shtie) në numër shih te NUM/ËR, ~RI. E futi (e vuri) në pushkë dikë shih te PUSHK/Ë, ~A. Fut pyka shih te PYK/Ë, ~A 3. Futi qafën diku shih te QAF/Ë, ~A. E futi (e vuri) në sirtar keq. shih te SIRTAR, ~I. E futi nën sqetull dikë shih te SQETULL, ~A 4. E ka futur (e ka vënë) në shënjestër dikë shih E ka vënë në shenjë te SHENJ/Ë, ~A. E futi në shtrungë dikë shih te SHTRUNG/Ë, ~A. E futi në thekër dikë shih te THEKËR, ~RA. E fut në një thes (me një tjetër) shih te THES, ~I. E futi (e shtiu) në thes (në grackë, në kurth, në lak, në kllapë) dikë shih te SHTIE. Nuk futi (nuk shtiu) gjë në thes shih te THES, ~I. I futi (i nguli) thonjtë diku shih te THUA,

FUTEM vetv. I futem (i hyj) brenda diçkaje shih te BRENDA. U fut dhëndër u martua e jeton së bashku me prindërit e nuses. I është futur (i ka hyrë) në gjak diçka shih te

FYÇKË mb. Arrë fyçkë keq. njeri mendjehetë, njeri që e ka kokën bosh.

FYELL m. Fyell pa vrima mospërf. shih te VRIM/Ë, ~A. U bë fyell u zhvesh krejt, ia hoqën të gjitha gjërat që e mbulonin. I bie fyellit (kavallit) shih te KAVALL, ~I. I bie fyellit në një vrimë shih te VRIM/Ë, ~A. I shkon pas fyellit diku

vepron sipas qejfit të dikujt, i shkon pas avazit. Shtati pyll e mendja fyell shih te PYLL, ~I. S'behet dasma me një fyell fj. u. punët e mëdha nuk mund të bëhen vetëm nga një njeri, por kërkojnë bashkimin e forcave.

FYT m. Deri (gjer) në fyt jashtë mase, shumë. Fyt me (për) fyt fytafytas, fytas. Me zemër në fyt me zemërim, me inatin te gryka. E bëri fyt diçka

FYTAS ndajf. Fytas e mbytas me shumë vështirësi, me mundime të mëdha.

FYTYRË f. Me fytyrë fytyrëvrenjtur; i zemëruar, i mërzitur. Me dy fytyra (me dy faqe) hipokrit. Fytyrë për fytyrë me dikë ballë për ballë, sy për sy. Fytyrë e ndyrë (e fëlliqur) shih te NDYRË (i, e). I iku (iu pre) fytyra u zbeh shumë në fytyrë (nga një shqetësim i madh e i papritur). I dha fytyrë diku shih te JAP. I dha fytyrë diçkaje shih te JAP. Ka një fytyrë dikush është njeri i ndershëm e i çiltër, nuk është njeri me dy faqe. Kthej fytyrën nga diçka shih te KTHEJ. Merr fytyrë diçka shih te MARR.

GABIM m. I bën llogaritë gabim vendos a zgjidh një punë pa marrë parasysh të gjitha rrethanat; vepron pa i menduar mirë gjërat. Gabim personal sport. ndërhyrje e parregullt ndaj lojtarit kundërshtar në lojën e basketbollit; dënimi që jepet për këtë ndërhyrje.

GACË f. U bë gacë u skuq në fytyrë, u bë prush në fytyrë. Gacë e mbuluar (thëngjill i mbuluar) keq. shih te MBULUAR (i, e). Ishte gacë në para kishte shumë para (përdorej sidomos për ata që kishin shumë para flori).

GAFORRE f. zool. Tropiku i Gaforres gjeogr. shih tek TROPIK, ~U 1.

GAJLE f. bised. Gajle e madhe! punë e madhe! S'ka gajle nuk prish punë, s'ka gjë. S'e ka për gajle

GAJTAN I m. E sjell gajtan muhabetin e vërtit si të dojë, e dredh sipas qejfit.

- GALINË** f. E ndjek në gur e galinë shih te GUR,~I.
- GAND** ndajf. I shkoi gand i shkoi kot, pa dobi.
- GAPËRR** ndajf. Iu bë gapërr iu ngjiti e s'i ndahet, iu bë ferrë.
- GARDH** m. Prapa gardhit fshehurazi, prapa krahëve. Gardh i gjallë shih te GJALLË (i, e) 3. Gardh i shkukur njeri që e ka humbur vlerën e rëndësinë. Hu gardhi shih te HU,~RI 2. E kërceu (e hodhi, e kapërceu) gardhin e kaloi vështirësinë që kishte, e hodhi hendekun. Mori gardhin diçka u rrit shumë e shpejt, u rrit jashtë mase, i kapërceu kufijtë. Shul gardhi mospërf. shih te SHUL,~I. Gardhi ka sy sado tinëz që të punosh, do të merret vesh; nga sytë e botës nuk fshihesh dot. Rri (mbeti) si hu gardhi shih te HU,~RI. U bë (u rrit) kungulli e mori (e zuri) gardhin shih te KUNGU/LL,~LLI. Mos bëj hop pa e kapërcyer (pa e hedhur) gardhin! fj. u. mos u gëzo përpara kohe! Qe gardh e u bë shteg nuk u prish ndonjë punë, nuk u bë ndonjë gjë e madhe. Fusha ka sy e gardhi (mali, pylli, muri) ka veshë fj. u. shih te FUSH/Ë,~A. Rrush gardhi bot. larushk, rrush i egër.
- GARROQ** m. E kishte barkun garroq kishte uri të madhe, e kishte barkun gropë. Zihen (hahen) si qentë në garroq zihen e grinden pa pushim, hanë kokat njëri me tjetrin.
- GATI** Kujto (zër në gojë) qenin, bëj gati (rrëmbe) shkopin fj. u. shih te QEN,~I.
- GATITU** pasth. Qëndron (rri) gatitu përpara dikujt i bindet menjëherë e pa fjalë dikujt, s'guxon të kundërshtojë.
- GATUAJ** kal. Bluan e s'gatuan e fillon një punë, por nuk e shpie deri në fund, nuk nxjerr gjë në dritë. Ia gatoi kulaçin shih te KULAÇ,~I. Shosh e sit e mos gatuaj shih te SHOSH.
- GAVËR** f. krahin. Lyp gavër shih te LYP.
- GAVIÇ** m. Është (mbeti) si daci në gaviç shih te DAC,~I.
- GAVOLE** f. krahin. Çohet gavole ngrihet për-pjetë, fryhet.
- GAZ** I m. Ia shkeli gazin thjeshtligj. shih te SHKEL.
- GAZEP** m. bised. Bën gazepin dikush qahet e ankohet me të madhe për diçka; e paraqit gjendjen duke i theksuar tepër anët e këqija, e nxin gjendjen a punën jashtë mase. Gjallë e për gazep shih te GJALLË. E ka marrë në (për) gazep dikë a diçka i është neveritur diçka sa s'e sheh dot me sy; i ka dalë nga zemra dikush, e ka marrë shumë inat.
- GAZETË** f. Gazetë folëse program i shkurtër me lajme nga prodhimi dhe nga veprimtaria politike e kulturore e kolektivit, që jepet nëpërmjet qendrës së zërit në një ndërmarrje ose në një aksion. Gazetë muri, botim që nxjerr një kolektiv a një organizatë në një ndërmarrje, në një institucion, në një shkollë etj., që përmban shkrime për çështje të ndryshme të jetës së saj dhe që varet në mur. Gazetë xhepi, organ politik luftarak e letrar, me fletë të vogla, që botojnë një njësi e madhe partizane gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe që lexohej duke kaluar dorë më dorë.
- GDHE** I m. E ka kokën gdhe është shumë kokëfortë, nuk ha fjalë e arsye.
- GDHEND** kal. I gdhend (i tjerr) fjalët shih te FJAL/Ë,~A. Di (është i zoti) të gdhendë fjalë është i zoti të gjejë fjalë të bukura, di t'i parashtrojë gjërat bukur.
- GDHENDEM** vetv. Nuk i gdhendet koka
- GDHIHEM** vetv. U gdhi gërdec shih te GËRDEC,~I. U gdhi kallkan shih te KALLKAN,~I.
- GDHIJ** kal. U err pa gdhirë shih tek ERREM.
- GËLQERE** f. U bë gëlqere (në fytyrë) u zbeh shumë, u zbardh në fytyrë, i iku gjaku (nga sëmundja, nga frika etj.).
- GËLLTIT** kal. I gëlltiti (i përpiu, i hëngri) fjalët i mohoi të gjitha ato që kishte thënë.

- GËNJEJ** kal. E gënjeu gryka shih te GRYK/Ë,~A. Gënjen (rren) shtruar (përtokë) shih te SHTRUAR.
- GËRB** m. zakon. sh. anat., krahin. Iu këputën (i ranë) gërbet u lodh shumë, i ranë këllqet.
- GËRDEC** II m. U gdhi gërdec
- GËRHAS** jakal. I gërhasin (i kërcasin, i këndojnë) zorrët shih te ZORR/Ë,~A.
- GËRMADHË** f. E qau gërmadha e gjeti e keqja, e piu e zeza.
- GËRMICË** II f. krahin. Theu gërmicën mospërf. vdiq.
- GËRSHET** m. E bëj gërshet një punë e ngatërroj, e ndërlikoj, e pleks keq.
- GËRSHËRË** f. I ra gërshëra (fshesa, kosa) shih te BIE I. I prerë me gërshërë shumë i përshtatshëm për të bërë një punë, pikërisht ashtu si duhet. Si të prerë me gërshërë kanë të njëjtin shtat a gjatësi, janë të njëjta mase. I ka prerë një gërshërë (janë prerë me një gërshërë) janë shumë të ngjashëm, pothuajse njësoj. I vuri (i futi) gërshërën
- GËRRYEJ** kal. Të gërryen era fryn erë shumë e fortë, të pret era. E gërreu nga leket ia mori të gjithë lekët, ia harxhoi të gjitha të hollat, e faroi nga paratë. E gërreu barku (e gërryen zorrët) për bukë kishte shumë uri. Gërryente para me lopatë fitonte shumë para pa u munduar shumë.
- GËRRYHET** vetv. I janë gërryer sytë i janë futur sytë thellë në zgavër (nga një sëmundje, nga uria etj.).
- GËSHTENJË** f. Lëng gështenjash kafe shumë e hollë ose gjellë shumë e hollë e pa yndyrë. I nxjerr gështenjat (nga zjarri) me duart e të tjerëve (e botës) e bën një punë duke përdorur si mashë a si vegël të tjerët.
- GËZIM** m. Gëzim për derë iron. shih te DER/Ë,~A.
- GËZOF** m. Ia prenë gëzofin i dhanë atë që meritonte; e dënuan. Ti shkojë peri gëzofit shih te PE,~RI. Janë pe për një gëzof janë pothuajse njëloj, janë shumë të përshtatshëm për njëri-tjetrin. Si të jetë moti, kthen gëzofin shih te KTHEJ. Kthen gëzofin (gunën, shpinën, kurrizin, krahët) nga fryn era shih te KTHEJ.
- GËZHDALLË** f. S'bëhet urë e gëzhdalla fj.u. shih tek UR/Ë,~A I.
- GILIVILI** palak. bised. Bën gilivili tregohet i paqëndrueshëm në bindjet e veta a në sjelljet ndaj dikujt a diçkaje; e dredh, e ha fjalën.
- GISHT** m. U bë gisht u dobësua shumë, u lig (nga ndonjë sëmundje ose nga pleqëria). Ia bëj me gisht dikujt ia bëj me shenjë që të afrohet, që të largohet ose të heshtë. Fshihet pas (prapa) gishtit (pas hijes së gishtit) mundohet më kot të mbulojë një veprim të keq që ka bërë, të metat a diçka tjetër të keqe, mbrohet me mjete a me mënyra të dobëta. Fut gishtin diku futet, përzihet në një punë që s'i takon, fut hundët. Është i gishtit dikush është trim, është i pushkës. Ka gisht në diçka ka marrë pjesë, ka bashkëpunuar ose është përzier në një punë (zakonisht të keqe). I këndon gishti dikujt di të shtjerë mirë me pushkë, shtie mirë me pushkë. Kërcet gishtërinjtë shkon kohën kot, pa bërë asnjë punë, tund zinxhirin. E la gisht dikë e la pa asnjë mjet jetese, e la me gisht në gojë. Lidhe në gisht! mbaje mend mirë!, mos e harro!. Mos e lër në harresë! (i thuhet dikujt, të cilit i japim një porosi). E luan gishtin (e pushkës) shih te LUAJ. E luan gishtin e shëllirës (e lëngut) dikush shih te LUAJ. E ka luajtur gishtin dikush shih te LUAJ. E luan nëpër gishta një lëndë e di shumë mirë; e kupton dhe e zotëron shpejt. Mbeti gisht mbeti vetëm, mbeti pa njeri. E ka ngjyer gishtin diku është përzier në një vjedhje; ka marrë pjesë në një punë jo të mirë dhe ka nxjerrë një përfitim vetjak prej saj. Numëron gishtat i kanë rrjedhur trutë, është matufosur. Numërohen me gisht (me gishtat e dorës) janë shumë pak. Njihet me gisht njihet nga të gjithë si njeri i keq, shquhet midis të tjerëve për

të metat dhe veset që ka. E tregojnë me gisht dikë e tregojnë për njeri të keq, e shquajnë midis të tjerëve për të metat a veset që ka. Vë gishtin mbi dikë a diçka a) caktoj dikë a diçka për një punë, zgjedh dikë a diçka; e shquaj, e dalloj;

GLASË f. I bëri (i la) glasën dikujt thjeshtligj., mospërf. shih te LË. E lëshon si pula glasën thjeshtligj. e thotë a e bën diçka pa pasur parasysh se ku ndodhet e në ç'rrethana është, flet a vepron me vend e pa vend dhe pa përgjegjësi, e lëshon si lopa bajgën.

GLOBAL mb. libr. Metoda globale

GODIT I kal. Goditi (qëlloi) në shenjë shih te SHENJ/Ë,~A.

GOGËL f. Bëhem gogël mblidhem si lëmsh (nga frika, nga të ftohtët etj.). Ia bëj gogël dikujt e shtrëngoj të bëjë atë që dua unë, ia fut të dy këmbët në një këpucë. Është gogël mbi ujë është i lehtë nga mendja, është mendjelehtë. Rronte (jetonte) si gogla në ujë ishte pa ndihmë e pa përkrahje; jetonte në gjendje pasigurie. Shkoi dushk për gogla shih te DUSHK,~U.

GOJË f. Gojë më gojë

GOJËTHATË mb. Mbeti gojëthatë mbeti pa gjë, mbeti me gisht në gojë.

GOLF m. sport. Jakë (grykë) golf jakë e mbyllur dhe e kthyer me dysh, që mbulon pjesën më të madhe të qafës. Pantallona golf pantallona jo të gjata, të cilat poshtë gjurit, deri ku fillon pulpa rrinë ngjitur pas këmbës, ndërsa mbi gju e deri në mes vijnë duke u zgjeruar. Triko golf triko me jakë golf.

GOMAR m. (Punonte) për shpirt të gomarit punonte kot, i shkante munda humbur. Sa gomarë buzëbardhë (ka)! iron, shih te BUZËBARDHË. S'çalon gomari nga veshët fj.u. shih te ÇALLOJ. S'di si (nga) lidhet gomari mospërf. shih te LIDHEM. Ia ha bukën gomari mospërf. është shumë i ngathët dhe i mefshtë. Kur të hipë gomari (derri) në fik (në majë të

fikut) thjeshtligj. kurrë, asnjëherë. I kanë hedhur (i kanë shtënë)trutë e gomarit nuk vepron sipas mendjes së tij, por bën si i thonë të tjerët, ia kanë marrë mendjen të tjerët. I lan kokën (kryet) gomarit shih te LAJ. Nuk i shkoi gomari (kali) në udhë (në urë) edhe poh. shih te UDH/Ë,~A. I shkon (i ka hije) si shala gomarit iron. shih te SHAL/Ë,~A II. vuri lëkurën e gomarit dikujt shih te LËKUR/Ë,~A. S'di gomari ç'është bari mospërf. nuk është i zoti të vlerësojë atë që është me të vërtetë e mirë e me vlerë, nuk di dhia ç'është tagjia. E di gomari ku e vret samari fj.u. secili i di vetë punët e hallet e tij, e di i zoti ku i pikon çatia. S'di t'i japë ujë (as) gomarit dikush mospërf. është i trashë nga mendja ose fare i pazoti. Kali humbi, gomari s'duket fj. u. është rrëmujë e madhe, nuk e merr vesh i pari të dytin. Prit gomar të mbijë bar! mos prit kot; s'dihet kur do të bëhet një punë a kur do të vijë dikush, mund të mos bëhet a të mos vijë kurrë; është fare e pasigurt diçka. Punon kali, ha gomari fj.u. shih te KAL/Ë,~I. Sikur i ka ngrënë gomari bukën (macja brumin) shih te HA. I zoti e nxjerr (e qit) gomarin nga balta fj.u. shih te BALT/Ë,~A. Le gomari që na ngordhi, po s'na lënë rehat as mizat le fatkeqësia, le halli i madh që kemi, por na shqetësojnë e na ngacmojnë edhe për gjëra të vogla. S'ka ç'i bën gomarit, i bie samarit fj.u. ia nxjerr inatin jo atij që duhet, por dikujt tjetër që nuk ka faj, gjetkë e ka inatin e gjetkë e nxjerr. Kali ha tagjinë, gomari mbart bucelat fj.u. shih tek TAGJI,~A. Presin të ngordhë gomari (kali) që t'i marrin patkonjtë përb. presin të përfitojnë ndonjë gjë nga ajo që mbetet, presin të përfitojnë nga diçka pa bërë asgjë vetë. Ti zot, unë zot, po gomarin kush e kullot? Secili duhet të bëjë atë që i takon dhe të mos ia hedhim punën njëri-tjetrit; po të mos bëjë secili punën e vet, nuk i dilet mbanë; po të japin të gjithë urdhra nuk bëhet asnjë punë. Bisht gomari bot. shih te BISHT,~I. Çuç gomari zool. shih te

- ÇUÇ, ~I. Ferrë (gjemb) gomari bot. shih te FERR/Ë, ~A. Lule gomari bot. shih te LUL/E, ~JA. Vesh gomari bot. vesh-gomar.
- GOMË** f. Gomë arabike shih tek ARABIK, ~E. Gomë peshku lëndë sintetike e bardheme, e fortë dhe elastike, që nxirret nga përpunimi i mbeturinave të naftës e që përdoret zakonisht për shoje këpucësh.
- GORRICË** f. U bë gorricë u mblodh si grusht (nga frika, nga një sëmundje etj.). Më doli gorricë diçka s'më vajti mbarë puna. Nuk i ha ato gorrica (vadhëza, kumbulla) shih te HA. Iu bë buka gorricë (gjemb) shih te GJEMB, ~I Derisa të bëhen gorricat cukka shih te CUCK/Ë, ~A.
- GOTË** f. Ngre (çoj) gotë (kupën, dollinë, shëndetin) shih te NGRE. Mbytet në (me) një gotë (pikë, lugë, filxhan, gisht) ujë mospërf. shih tek UJ/Ë, ~I.
- GOTIK** mb. art. Shkrimi (alfabeti) gotik alfabet a lloj shkrimi me shkronja latine të drejta, me kënde e me maja të mprehta, i cili është përdorur nga mesjeta deri në shekullin tonë në Gjermani e në disa vende të tjera.
- GOZHDË** f. Si gozhda në dërrasë i ngulur mirë, që ka zënë vend përfundimisht. Përlaf me gozhdë diçka që nuk mund të pranohet në asnjë mënyrë; diçka që s'hahet, që s'përtypet. Preu gozhdë (thumba) shih te PRES I. Dimri ha gozhdë (gurë, kashtë) shih te DIM/ËR, ~RI. Rri si mbi gozhdë s'rri dot i qetë, i lirshëm e i shkujdesur në një vend, nuk jam i qetë, rri si mbi gjemba. E ka bërë syrin gozhdë nuk preket fare nga vuajtjet e fatkeqësitë e të tjerëve, nuk i vjen aspak keq për të tjerët, është i pamëshirshëm, është shpirtkazmë. I bie po asaj gozhdë (po atij avazi, po atij teli) shih te BIE I. E do (e kërkon) si breshka gozhdën shih te BRESHK/Ë, ~A. U mbeti pushka në gozhdë vjet. nuk lindi ndonjë mashkull në shtëpi që të mbante pushkën, mbeti shtëpia pa burra. I ngeci (i ngeli) sharra në gozhdë shih te SHARR/Ë, ~A.
- GRAH** kal. Ua grahu këmbëve iku me vrap, krisi e iku, ua mbathi këmbëve.
- GRAMAFON** m. Gramafon i prishur përb. shih te PRISHUR (i, e).
- GRATHËL** f. bot., vjet. Iu bë grathël dikush iu ngjit si ferrë dhe nuk i ndahet, iu bë ferrë, iu bë rrodhe (për dikë që të bezdis).
- GRAVITET** m. fiz. Qendra e gravitetit shih te QEND/ËR, ~RA.
- GRAZHD** m. Është për t'u lidhur në grazhd dikush është i trashë nga mendja, është hajvan; duhet trajtuar si kafshë, sepse kështu sillet e vepron.
- GREMINË** f. Ra në greminë pësoi një humbje a fatkeqësi të madhe. E hodhi në greminë dikë i shkatërroi jetën, e çoi në një gjendje shumë të keqe. Është në buzë të greminës (të humnerës) është në prag të shkatërrimit të plotë ose të një humbjeje a fatkeqësie të madhe.
- GREP** m. U bë (si) grep u dobësua shumë, ra shumë nga shëndeti. Ra në grep u mashtrua, u gënjye prej dikujt, ra në kurth. E hodhi gripin diku ia vuri syrin diçkaje dhe përpiqet të nxjerrë përfitime. Ia hodhi gripin dikujt ia vuri syrin dikujt dhe përpiqet ta shtjerë në dorë. Është grep arb. keq. është hamës i madh. Jam (rri) në (ndër) grepa kam një hall të madh që më mundon vazhdimisht e që nuk më lë të rri i qetë; s'rri dot i qetë, rri si mbi gjemba. Nuk i kap gripin është jashtë mundësive a forcave të tij, nuk ka mundësi të bëjë (një punë, një detyrë etj.). Ia nxjerr me grip (me grepa) fjalën (përgjigjen) ia nxjerr dikujt me shumë vështirësi fjalën ose atë që ai di, ngaqë ky nuk dëshiron ta thotë ose ngaqë nuk e di mirë, ia nxjerr me zor, ia nxjerr me darë.
- GRERËZ** f. zool. Fole grerëzash (arëzash) keq. çerdhe njerëzish të ligj që punojnë për t'u sjellë të këqija të tjerëve; çerdhe njerëzish të këqij që zihen e grinden sa t'u hanë kokat njëri-tjetrit.
- GRETH** m. zool. Fle me gretha lëviz shumë kur fle, bën gjumë shumë të shqetësuar.

- GRIBË** f. krahin. Bëhet gribë
- GRIGJË** f. Si vathë pa grigjë shih te VATH/Ë,-A.
- GRIHEM** vetv. Grihet me vete vuan përbrenda, e bren diçka vazhdimisht (një mendim etj.).
- GRIJ** kal. Grin lakër (sallatë) flet shumë dhe kot; llap kot. Më grinë zorrët kam shumë uri. Korr e grin shih te KORR.
- GRILLOJ** kal. U grilloi kokën u mori mendtë duke folur shumë dhe kot, ua lodhi kokën me llafe të kota.
- GRIMË** f. Sa grima
- GRINDEM** vetv. U grindën (u zunë, u shanë) për mustaqet e Çelos shih te MUSTAQ/E,~JA.
- GRIS** kal. Ia grisi (ia çori) maskën shih te ÇJERR 4. I grisi zemrën (shpirtin) e lëndoi shumë, i shkaktoi dhembje, i çori zemrën. Ferra e nisi, ferra e grisi i varfër lindi, i varfër vdiq, me halle filloi, me halle mbaroi. Gris (prish) gjirin, arno pëqirin! fj.u. thuhet kur dikush prish a dëmton një punë të madhe e të rëndësishme për të bërë diçka të vogël; prish bucela e bëj kënaçe.
- GRISEM** vetv. Si u nis, ashtu u gris (u bitis) shih te NISEM.
- GRISKËL** f. Bar griskle bot. shih te BAR,~I I.
- GRISUR** mb. Thes (harar) i grisur (i shpuar) shih te SHPUAR (i, e).
- GRIZHËL** f. zool. Është grizhla është i keqi i vetvetes, ia bën të keqen vetes.
- GROPË** f. E bëri gropë (vendin) ndenji shumë kohë në një vend. Iu bë barku gropë (petë, dërrasë) kishte uri të madhe; kishte shumë kohë pa ngrënë. Iu bë zemra (barku) gropë u hidhërua, u dëshpërua shumë. Gjeti gropën e gurit u mëkëmb shpejt e papritur nga ana ekonomike, ra në kamje të madhe. Kur të shohë gropën e zverkut asnjëherë, kurrë. Gropë ajrore av. zonë, ku ajri ka një temperaturë tjetër në krahasim me atë të mjedisit përreth dhe për këtë shkak aeroplani ulet menjëherë më poshtë se lartësia e kursit.
- GROSH** m. vjet. Më polli (më ndezi) groshi (belaja) me dikë shih te PJELL. Shëndoshë me grosh vjet. thuhej nga ata që mendonin se s'ka ç'të duhet shëndeti, kur e ke xhepin bosh. E bën groshin kacidhe shih te KACIDH/E, ~JA. Dy grosh oka (pesë para oka) mospërf. shih te OK/Ë,~A. I ka fjalët me grosh (ka fjalë e grosh) është shumë i kursyer në fjalë; flet pak, por me vend. Futet pesë para në grosh ndërhyt atje ku nuk i përket, fut hundët kot në punët e të tjerëve.
- GROSHË** f. Lëng groshë mospërf. njeri pa vlerë a pa rëndësi. Është si grosha shtatë javë nuk është në gjendje të arsyetojë a të gjykojë si duhet, është fare i papjekur.
- GRUA** f. Ato të grave euf. shih tek ATO. Gruaja (e bija) e botës shih te BOT/Ë,~A I.
- GRUMBULL** m. Ia dha grumbull dikujt ia tha copë të gjitha, s'i la gjë pa thënë, ia numëroi të tëra.
- GRUMBULLIM** m. Grumbullimi i detyrueshëm mënyra e sigurimit të sendeve ushqimore (bujqësore e blegtorale) në formë detyrimi, që përdori shteti ynë në vitet e para pas Çlirimit për të furnizuar në mënyrë të organizuar punonjësit e qyteteve e të qendrave të prodhimit industrial.
- GRUMBULLOR** mb. Re grumbullore shih te RE,~JA.
- GRUNOR** mb. Bimët grunore bot. Tërësia e bimëve barishtore njëvjeçare me kërcell si cilindër, të zbrazët e me nyja, me lule të grumbulluara në kalli, që bëjnë fryte njëthelbore (si gruri, thekra, elbi etj.).
- GRUP** m. Grup edukativ hist. shih tek EDUKATIV,~E. Martesa me grupe etnogr. shih te MARTES/Ë,~A. Grup gjaku biol. një nga të katër tipat e gjakut te njeriu dhe te kafshët, me cilësi

të veçanta të rruazave të kuqe dhe të serumit. Grup skulpturor art. vepër skulpture që paraqet një grup tërësor njerëzish ose figurash sipas një ideje a teme të caktuar.

GRURË m. bot. E ka grurë (dhjamë, vaj) me dikë ka marrëdhënie shumë të mira me dikë, shkon shumë mirë me dikë, e ka mirë me dikë. I shkon (puna) grurë i vete puna mbarë, i shkon puna shumë mirë. Ra si pula në grurë (në mulli) shih te PUL/Ë,~A. E ha grurin që në arë i shpenzon të ardhurat shpejt e para kohe, nuk di t'i përdorë me ekonomi të ardhurat, nuk di të kursejë. Kakaris si pula pa grurë (në veri) shih te PUL/Ë, ~A. Ndaj bykun nga gruri shih te BYK,~U. Kur s'ke grurë, e mirë është edhe thekra fj. u. shih te THEK/ËR, ~RA. Mbolli thekër e i doli grurë dikujt shih te MB-JELL. Është tre mel dy grurë tall, shih te MEL, ~I. Thekra është e gjatë, po gruri hahet fj. u. shih te THEK/ËR,~RA. Grurë breshke bot. lloj bari që bën kalli si të grurit, grurë i egër, grurth.

GRUSHT m. Grusht i blinduar shih te BLINDUAR (i, e). Grusht për grusht dhëmb për dhëmb, pa u frikësuar. Jepte (mer-te, fitonte, i kishte) me grusht (me grushte) jepte (merrte, fitonte, i kishte) me shumicë, në sasi të madhe (zakonisht për paratë). E ka (e mban) në grusht e ka nën zotërim të plotë, e ka në dorë. Ngre grushtin shpreh kundërshtimin ndaj dikujt a diçkaje, protestoj; jam gati të ndeshem, të luftoj me dikë. Shtrëngon grushtet mblodh forcat e përgatitet për t'u ndeshur me dikë, për një punë që kërkon guxim e përpjekje. I tregoi grushtin dikujt e kërcënoi dikë; i dha të kuptojë se ishte gati të përleshje me dikë, nuk iu nënshtrua. I bie gjoksit me grushte shih te GJOKS,~I. I bie kokës me grushte shih te KOK/Ë,~A. Ia dha nderin në grusht (në dorë) shih te NDER,~I. Ua futi një grusht miza i futi në sherr, e ndezi sherrin. E ha barutin me grushte është trim i madh, është luftëtar i zoti. E ka dorën grusht është

dorështrënguar. E përcolli me një grusht miza (pleshta) shih te MIZ/Ë,~A. Politikë e grushtit të hekurt politikë e forcës dhe e dhunës. I rri me grushte hundëve dikujt keq. shih te HUND/Ë,~A. Erdhi me një grusht miza shih te MIZ/Ë,~A. Ha bukë me grushte barkut ha shpejt e shpejt pothuajse pa e përtypur ushqimin, e rras ushqimin në bark pa e përtypur mirë. Më sa bëhen bashkë (bashkohen) një grusht pleshta iron. shih te PLESHT,~I. Që në gusht nga një grusht fj. u. rezervat sigurohen duke i mbledhur me kohë, pak e nga pak; për të arritur përfundime të mira në një punë duhet filluar me kohë, duke punuar çdo ditë, pak e nga pak. Grusht hidraulik tek. rritje shumë e madhe, më tepër sesa lejohet, e trysnisë nëpër tuba, që shkaktohet nga zvogëlimi i menjëhershëm i shpejtësisë së lëvizjes së lëndës brenda në ta. Grusht shteti ndërrimi i menjëhershëm me dhunë i qeverisë a i formës së qeverisjes, që përgatitet fshehurazi dhe bëhet nga një grup i vogël njerëzish pa u mbështetur te masat e popullit.

GRYKË f. E gënjeu gryka u gënjye nga diçka e jashtme, nuk i doli ashtu siç e priste, u mashtrua. Grykë për (me) grykë fytafyft, fytafyft, grykas. Me grykën e pushkës (nga gryka e pushkës) shih te PUSHK/Ë,~A. Nën grykën e pushkës (e topit) duke e kërcënuar a duke e frikësuar me armë. Iu hodh në grykë (në fyt) dikujt

GUASKË f. U mbështoll (u mblodh) në guaskën e vet u tërhoq dhe u mbyll brenda në vetvete. Është mbyllur në guaskën (në lëvozhgën) e vet shih te LËVOZHG/Ë,~A.

GUDULISEM vetv. Nuk guduliset me pupël zoga shih te PUP/ËL, ~LA.

GUFOJ jokal. I gufon zemra (shpirti) shih te ZEM/ËR,~RA.

GUGA f. vet. sh. Bën guga gugat.

GULÇ m. E ka parë gulç e ka ndier veten shumë ngushtë.

GULÇOJ jokal. I gulçoi zemrën dikujt e shqetësoi fort dikë; e pikëlloi dikë; e nxit dikë me ngulm për të bërë një veprim.

GUMËRATË f. Mbeti gumëratë mbeti ulok.

GUNË f. Nën gunë prapa krahëve, fshehurazi, nën rrogos. I hodhi (i vuri) gunën diçkaje shih te HEDH. Sapun mbi gunë diçka që bëhet sa për sy e faqe, mashtrim. Shtroi gunën shih te SHTROJ. Mos ia hiq gunën! mos e thello me tej, se i dalin të fshehtat e të palarat!; mos ia hiq petën lakrorit! Mban (fsheh) sëpatën nën gunë është i pabesë, të godet pas shpine, fsheh gurin në gji. Kaloi me kallaj mbi gunë shih te KALLAJ,~I. Kthen gunën (gëzofin, kurrizin, krahët) nga fryn era shih te KTHEJ. Për një pe, për një gjilpërë, shkoi kot një gunë e tërë fj. u. shih te PE,~RI.

GUR m. U bë gur (dru) shih te DRU,~RI. U bëftë gur mallk. vdektë! Gur femër shih te FEM/ËR,~RA. Guri (zari) i fundit shih te FUNDIT (i,e). Gur kufiri shih te KUF,~RI. Gur prove libr. shih te PROV/Ë, ~A. Gur në rrokullimë shih te RROKULLIM/Ë,~A. Gur shahu shih te SHAH,~U. Gur themeli shih te THEMEL,~I. Gur themeltar (themelor) gur themeli. Me gurë në kokë me mundime të mëdha, duke kapërcyer vështirësi të mëdha. Si gur (si pllakë) varri shih te VARR,~I. E gjuaj me gurë dikë hedh gurë mbi dikë. Hodhi gurë mbi dikë shih te HEDH. I ka humbur guri dikujt nuk është në vete, e ka humbur fillin, e ka humbur toruan. Nuk është prej guri nuk është njeri fare pa ndjenja, nuk është njeri pa zemër. Ka lindur prej gurit shih te LIND. Luan (lëviz) gurët shih te LUAJ. E nxjerr nga guri diçka është shumë i zoti, bën edhe të pamundurën. Qajnë edhe gurët për dikë ka qenë njeri shumë i mirë, sa që u vjen keq të gjithëve që ka vdekur ose që është larguar përgjithnjë nga një vend. Bën gurin e gjakut dikush shih te

GURMAZ m. Iu shqye (i doli) gurmazi shih te SHQYHEM. Kruaj (pastroj) gurmazin

shih te KRUAJ. Iu tha gurmazi (goja, buza, gryka) për diçka shih te THAHEM.

GURTË mb. E ka zemrën të gurtë nuk i vjen keq për të tjerët, është zemërgur. Thëngjill i gurtë vjet. qymyrguri.

GUSHË f. Gushë për gushë shumë afër njëritjetrit; duke u përqaftuar. Iu lëshua gusha dikujt filloi të flasë pa pushim, e lëshoi gojën. Zë në gushë (marr në gushë) dikë e përqaftoj. E ka shpirtin në gushë i erdhi vdekja, i erdhi fundi, s'ka shpëtim. Gjëndra e gushës mjek. gjëndra tiroide.

GUSHT m. Që në gusht nga një grusht shih te GRUSHT,~I. Shkoi vapa me gushtin fj. u.

GUZHMË f. I vë guzhmën dikujt e shtrëngo, e detyroj dikë.

GJAH m. Bëri gjah u përpoq, u mundua me të gjitha forcat për të kryer diçka. Gjahu në breg e qëllon në kodër vepron pa i peshuar e pa i matur mirë gjërat, vepron kot, kuturu.

GJAK m. Iu avullua gjaku shih tek AVULLOHEM. Bëri gjak theri një kafshë a një shpend. E bëri gjak (mish e gjak) e përvetësoi thellë diçka. U bënë gjak (mish gjak) u bashkuan fort, u shkrinë, u bënë njësh. I buçet gjaku është gati të shpërthejë për të bërë diçka, sa mezi e përmban veten, zien përbrenda. Derdh gjak shih te DERDH. Ka derdhur gjakun shih te DERDH. Është derdhur gjak shih te DERDHEM. I ftohu (i uli, i shoi, i shtroi, i zbuti) gjakrat i qetësoi njerëzit që ishin duke u zënë a duke u grindur ashpër me fjalë, bëri që t'u bjerë zemërimi, qetësoi gjendjen. Iu ftoh gjaku i ra zemërimi, u qetësua. U ftohën (u ulën, u shuan, u shtruan, u zbutën) gjakrat u qetësuan njerëzit që ishin duke u zënë a duke u grindur ashpër me fjalë, u iku zemërimi, u ra inati; u qetësua gjendja. Ia ka futur në gjak diçka

GJALMË m. Bëhet gjalmë dobësohet, hollohet. Iu bë gjalmë dikujt iu qep pas dikujt e nuk iu nda, iu bë rrodhe. E

bëri gjalmë e zgjati shumë diçka, e bëri tërkuzë (bisedën etj.). Gjalma nëpër këmbë pengesa e ngatërresa, kokëçarje, punë të pazgjidhura që të bezdisin. Ia ka mbledhur gjalmat shih te MBLEDH. I mbeti gjalmi nëpër këmbë ka akoma mjaft pengesa e telashe, nuk ka shpëtuar nga hallet e telashtet. Lidh këmbët me gjalmat e mi ngatërrohem vetë në një punë pa qenë e nevojshme, e fut veten në telashe kot; i lidh duart vetes, pengoj vetveten.

GJALPË m. Si (thika) në gjalpë pa asnjë pengesë e vështirësi, me lehtësi, si në vaj. Gjalpi në lakror bie (derdhet, mbetet) fj. u. shih te BIE I. Gjalpë (dhjamë, djathë i mirë) në lëkurë të qenit shih te QEN, ~I. E ka (shkon, është) gjalpë e vaj me dikë ka marrëdhënie shumë të mira me dikë, i ka punët mirë me të, e ka grurë. E ka mjaltë e gjalpë (mjaltë e sheqer, mjaltë e qumësht) me dikë shih te MJALT/Ë, ~I. Kërkon petulla me gjalpë shih te PETULL, ~A. Bar gjalpi shih te BAR, ~I I.

GJALLË as. S'e deshi të gjallët (veten) shih te DUA.

GJALLË mb. S'u bë i gjallë

GJALLË ndajf. Gjallë e për gazep në gjendje shumë të keqe e të vështirë, në pikë të hallit. Gjallë e ngushtë (e keq) në gjendje shumë të vështirë, në varfëri e në vështirësi, keq. Gjallë a vdekur me çdo kusht, patjetër, medoemos. As gjallë as vdekur

GJALLI ndajf. U ndamë për së gjalli kemi një kohë të gjatë pa u takuar njëri me tjetrin. E futi (e vuri, e shtiu) në varr (në dhe) për së gjalli (të gjallë) shih te VARR, ~I.

GJANË f. Mbeti si peshku në gjanë shih te PESH/K, ~KU.

GJARPËR m. Si besa e gjarprit zotim (premtim) i tillë që nuk i duhet besuar kurrë. Gjumë gjarpri gjumë i thellë e i rëndë. Si këmbët e gjarprit thuhet për diçka që nuk duket, që është e fshehtë a e

padukshme. Përpiqet si gjarpër mundohet shumë, jep e merr në të gjitha anët, përpiqet me mënyra të ndryshme. Shkeli mbi gjarpinj i dolën telashe e kokëçarje të mëdha; gjeti belanë. E zuri gjarpri i ra një e keqe e madhe, i ndodhi një fatkeqësi. Gjarpër me dy koka armik shumë i rrezikshëm. Gjarprit shtypi kokën! fj. u. për armikun mos ki mëshirë, armikun shfarose! E hëngri gjarpri me dy koka e gjeti një e keqe e madhe. Hoqi bishtin e gjarprit (u mundua për bisht të gjarprit) shih te BISHT, ~I. Heq (vuan) si gjarpri nën gur (si miu në mur) vuan shumë, është në hall të madh. Mbaj (rrit) gjarprin në gji kujdesem për një njeri, i cili më vonë me pabesi ma shpërblen të mirën me të keqe. Ka pirë lëngun e gjarprit prej dikujt shih te LËN/G, ~GU. Mos e trazo (mos e prek) gjarprin në bisht! ruaju nga armiku edhe atëherë kur të duket se nuk është i rrezikshëm! Nuk i tregon gjarpri (bolla) këmbët fj. u. njeriu i lig a armiku mundohet t'i fshehtë synimet a qëllimet e këqija, është fsheharak. Prej ujkut ra në gjarpër shpëtoi nga një e keqe dhe ra në një tjetër akoma më të madhe, ra nga shiu në breshër. Bar gjarpri bot. shih te BAR, ~I I. Kërpudhë gjarpri bot. shih te KËRPUDH/Ë, ~A. Lule gjarpri bot. shih te LUL/E, ~JA. Presh gjarpri (i egër) bot. shih te PRESH, ~I. Qepë gjarpri bot. xhërrokull. Rrush gjarpri bot. shih te RRUSH, ~I.

GJASHTË num. them. Është me gjashtë gishta është vjedhës. Fiton pesë e ha (prish) gjashtë shpenzon, prish më shumë sesa merr. Pesë dhi gjashtë zile më shumë zhurmë se punë.

GJATË mb. S'e bëri të gjatë

GJATË Gjatë e gjerë (gjerë e gjatë) shih te GJERË. Sa gjatë gjerë (sa gjerë gjatë) në të gjithë gjatësinë e gjerësinë; plotësisht i shtrirë. S'e bën gjatë vepron shpejt, nuk e zgjat, s'e bën të gjatë. Nuk e shpie (s'e çon) më gjatë

GJEJ kal. 8. Zbuloj rrugën, mjetin, mënyrën a anën për të bërë diçka, për të dalë nga një gjendje ose për të siguruar përkrahjen e dikujt (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Gjej rrugën. Gjej mënyrën (mjetin). Ia gjeti veglën. Ia gjeti anën (shtegun, vaun). Ia gjeti vjegën (verigën, rrëfanën). Ia gjetën ilaçin (dermanin). Ia gjeti vidhat (burgjitë, burmat) dikujt.

11. Më ndodh një e keqe, më bie në kokë, pësoj (edhe në një varg njësisish frazeologjike). E gjeti një e keqe (një fatkeqësi). Ç'më gjeti! Mirë na gjeti! E gjeti belaja. Ku të gjeti edhe ty! Ç'të ka gjetur sot kështu? çfarë ke sot kështu? E gjeti si breshka te nallbani. I gjeti mushka drutë. E gjeti kokën e kandilit.

18. I shkoj pas shijes a ëndjes dikujt; pajtohem me dikë në mendime e në shije, merrem vesh me dikë, bie në ujdi (edhe në një varg njësisish frazeologjike). E gjeti fjalën me dikë. Ia gjeti zemrën. I gjeti midenë. Ia gjeti telat dikujt. I kanë gjetur telat bashkë. I kanë gjetur pipëzat. Kanë gjetur një gjuhë të përbashkët. Kanë gjetur shoku-shokun. Gjeti mendja mendjen. Ka gjetur rrasa vegshin (vorbën). keq. Ka gjetur tenxherja kapakun (u rrokullis tenxherja, gjeti kapakun). keq. Ka gjetur shkopi doçen. keq.

Gjeti belanë me dikë a me diçka u ngatërrua keq me dikë a me diçka, i ndezi me të. Ia gjej fillin shih te FILL, ~I 4. Gjen (bën, ngre, zë) fole shih te FOL/E, ~JA.

GJEL m. Si gjeli pa kokë (pa krye) sikur i merren mendtë, si i trullosur, si i hutuar, si i shastisur. Një gjel plaçka shumë pak plaçka. Hidhet (kërcen) si gjel merr zjarr menjëherë, zemërohet e kërcen për gjënë më të vogël. Ngrihet me gjelat ngrihet, zgjohet herët në mëngjes. I rri gjel dikujt qëndron me mendjemadhësi përballë dikujt, krekoset para dikujt, nuk e ul kokën para dikujt, i rri kundër. I bën edhe gjeli vezë i ecën shumë mbarë, i ka punët shumë mirë, i ka të gjitha të mirat. Ra si gjeli (si pula) në thekër shih te THEK/ËR, ~RA. I ka dalë gjel kaproll

një punë i ka dalë përpara një punë, i ka vënë gjoksin, i ka dalë ballë për ballë me guxim.

GJELBËR mb. Ari i gjelbër shih tek AR, ~I. Kafe e gjelbër diçka me pasoja të padëshirueshme, punë a ngatërrësë, në të cilën nuk duhej të përziheshim. Tryeza (coha) e gjelbër vjet. tryeza e bisedimeve diplomatike.

GJELËZ f. zool. Ha këmbë gjelëze jeton me të gjitha të mirat.

GJELLË f. Gjellë pa kripë

GJEMB m. Flet me gjemba thumbon të tjerët kur flet, e hedh fjalën te njëri e tek tjetri për t'i qortuar a goditur, flet me thumba. Fut gjemba fut grindjen, përçarjen, fut spica. I hyri gjembi iu ndez dëshira ose kureshtja për diçka, i hyri krimbi. Jam (rri) si mbi (në) gjemba (ferra, vezë) nuk e ndiej veten të qetë; rri i shqetësuar. Kurorë me gjemba libr. simbol i vuajtjes dhe i mundimit. Qen me gjemba (me kreshta) keq. shih te KRESHT/Ë, ~A. Rri gjemb mbahet i veshur mirë dhe shumë i pastër e i rregullt, rri spicë. I rri gjemb dikujt i rri mbi kokë dikujt e nuk e lë të qetë; i rri çekan mbi kokë. Sikur shkel mbi gjemba (mbi vezë) me shumë kujdes, në majë të gishtave (për mënyrën e të ecurit). I vuri gjembin dikujt e shtrëngoi keqas, ia mblodhi rripat. Iu bë buka gjemb (gorricë) nuk i shkante buka poshtë, i mbeti buka në grykë (nga një lajm i keq etj.). Nuk i ka hyrë gjemb (ferrë) në këmbë shih te FERR/Ë, ~A. E ka gjemb (halë, ferrë, shushull) në sy shih te HAL/Ë, ~A. Kërkon këmbë për gjemb nxjerr ndonjë shkak që të zihet, kërkon njeri që të grindet. Nuk la gjemb këmbë i zhduku, i shfarosi të gjithë, shkatërroi gjithçka. E mban si zogun majë gjembit dikë e mban me të gjitha të mirat, e mban në pëllëmbë të dorës. Flutura e gjembave zool. lloj fluture dëmtuese, vemjet e së cilës janë të përhimëta, me dy vija anësore të verdha dhe me gjemba të verdhë ose kafe. Lule gjembi bot. shih te LUL/E, ~JA.

GJEMI f. Rri sikur i janë mbytur gjemitë rri shumë i brengosur e i zymtë.

GJENDEM vetv. S'i gjendet ana diçkaje shih tek AN/Ë,~A I. S'iu gjend (s'iu duk) binaja shih te BINA,~JA. Sa për t'u gjendur në fjalë (në muhabet) sa për të thënë diçka, duke folur për gjëra të parëndësishme ose që nuk kanë të bëjnë me çështjen. Nuk i gjendet filli është shumë e ngatërruar, është lëmsh. Iu gjend gjak dikujt shih te GJA/K,~KU I. M'u gjend havale shih te HAVALI,~JA. S'i gjendet karari dikujt a diçkaje shih te KARAR,~I. S'u gjendet (u humbi) nishani shih te NISHAN,~I. Sa për t'u gjendur (Kola) në punë sa për t'u dukur që merret me diçka, sa për të thënë se punon. S'i gjendet shoku (shoqja, çifti) për dikë a diçka nuk ka ndonjë tjetër të ngjashëm a të afërt me të për nga vetitë, cilësitë etj., është shumë i mirë, shumë i zoti, shumë trim etj. Nuk i gjendet as nami as nishani është zhdukur krejt, nuk i ka mbetur asnjë gjurmë. U gjend qiri në këmbë shih te QIRI,~U.

GJENDJE f. Jam në gjendje

GJEOLGJIK mb. Prerje gjeologjike gjeol. shih te PRERJE/E,~A.

GJERË mb. Me zemër (me bark) të gjerë i durueshëm, zemërgjerë. E ka gjoksin të gjerë shih te GJOKS,~I.

GJERË ndajf. Gjerë e gjatë (gjatë e gjerë)

GJETKË ndajf. Vret gjetkë ai (fjala e tij) shih te VRAS. Gjetkë daullet, gjetkë dasma shih te DAULL/E,~JA.

GJETKËZ f. Si pata (si derri) në gjetkëz me të gjitha të mirat, si pula në gurë.

GJETH m. I bëri gjeth i griu, i shoi krejt.

GJETHE f. Me bar e me gjethe shih te BAR,~I I. Gjethe (fletë) fiku shih te FI/K,~KU. E ka gjethe dikë e mund a e mposht lehtë dikë, s'e ka për gjë, as që matet dot me të ai. U bë gjethe plepi u dobësua shumë, u tret; u zverdh. Dridhej si gjethe lofate (plepi) kishte shumë

frikë, ishte trembur shumë, i kishin hyrë drithmat nga frika. Është gjethe plepi

GJETHOR mb. bot. Perime gjethore perime, të cilave u përdoren vetëm gjethet si ushqim (spinaqi, sallata etj.).

GJË f. Çdo gjë gjithçka. Në çdo gjë nga të gjitha anët, në çdo drejtim. Pa gjë të keqe shih te KEQ (i), ~E (e). Si pa gjë të keq shih te KEQ (i), ~E (e). Nuk e ka për gjë shih te KAM. Ndonjë gjë diçka. Tjetër gjë diçka e ndryshme, që nuk u ngjan të tjerave a që dallohet nga një tjetër; tjetër punë. E ka për gjë të madhe shih te MADH (i), ~E (e). S'kishte gjë pas shpirtit shih te SHPIRT,~I. Pesë para gjë shih te PES/Ë,~A.

GJË 2. Asgjë, kurrgjë, asgjësend, asnjë send (përdoret në fjalitë mohore; edhe në një varg njësisht frazeologjike). Nuk foli gjë. S'dëgjova (nuk mora vesh) gjë. S'i mbeti gjë. S'ka gjë në dorë (në vijë). S'ka gjë në thes (në torbë, në trastë). Nuk vuri gjë në gojë. Nuk bën dot gjë. Nuk doli pa gjë mori diçka, nuk mbeti me duar bosh; përfitoi diçka. Kjo s'është gjë fare. S'do të thotë gjë. S'la gjë pa bërë (pa thënë) bëri (tha) gjithçka. Ku ka zë, s'është pa gjë. fj. u.

Gjë prej gjëje (prej gjëri) asgjë, asgjëkafshë. Nuk është pa gjë ka edhe ai faj, të meta a gabime; ka edhe ai gisht në diçka. S'është për gjë s'mund të bëjë gjë, nuk është i aftë për asnjë punë, për asgjë. S'ka gjë

GJË m. Gjë prej gjëri (prej gjëje) shih te GJË. Palcë gjëri pjesa më e mirë e diçkaje.

GJËKAFSHË S'ka gjëkafshë asgjë, s'ka përse (si përgjigje për një falënderim).

GJËKUNDI ndajf. S'është gjëkundi nuk është aspak në rregull, nuk e ka fare në vijë punën, s'është asgjëkund. Nuk i ngjitej (nuk e kapte) ferra gjëkundi shih te FERR/Ë,~A.

GJËMË I f. Bën gjëmë vajton me britma, qan me kujë e ulërimë. Të bën gjëmën të sjell a të shkakton një fatkeqësi të madhe, të

bën të keqen, të bën atë që s'ta ka prerë mendja.

GJI m. Në gjirin e ... në përbërjen (e një organizate, e një bashkimi etj.). I hyri në gji (ndër petka) dikujt ia di mirë hallin, ia kuptoi gjendjen. E do si zjarrin në gji shih te ZJARR,~I. E do si prushin në gji (e ka prush në gji) shih te PRUSH,~I. Kërkon kaun në gji kërkon aty ku nuk duhet e ku s'mund të gjejë gjë kurrë. E la me duar në gji e la vetëm e pa njeri, e la qyqe (përdoret kur një gruaje i vdes i shoqi ose kur ky ikën në kurbet për shumë kohë dhe e lë të shoqen me foshnjë gjiri ose me fëmijë të vegjël). Mbaj (rrit) gjarprin në gji shih te GJARP/ËR,~RI. Mbeti me duar në gji mbeti pa njeri, fill i vetëm, pa fëmijë. Rri me duar në gji (në ijë, në mes, në brez, në bel, në xhepa) shih tek IJ/Ë,~A. Gris (prish) gjirin, arno pëqirin fj. u. shih te GRIS. Gjiri i vezëve anat. pjesa e trupit të femrës, ku përftohen vezët.

GJILPËRË f. Fill e gjilpërë (në majë të gjilpërës, majë gjilpëre) hollësisht, fill e për pe. I futi gjilpërat dikujt i kalli spicat. Me pe e me gjilpërë (në pe e në gjilpërë) shih te PE,~RI. Rri si mbi gjilpëra nuk rri aspak i qetë, është shumë i shqetësuar, rri si mbi gjemba. S'bëhet pusi me gjilpëra fj. u. duhen mjetet e nevojshme për diçka, nuk bëhet një punë pa veglat e mjetet e nevojshme. Nuk çahet pisha me gjilpëra nuk mund të bëhet një punë pa veglat e mjetet e nevojshme, duhen mjetet e nevojshme për diçka, s'bëhet pusi me gjilpëra. Del nëpër vrimë të gjilpërës është shumë i zoti, di të dredhojë, është i shkathët. E futi (e kaloi, e shkoj) në vrimë të gjilpërës dikë

GJITHË pakuf. Gjithë si ashtu si; sido që. Me gjithë së bashku me, bashkë me. Gjithë e gjithë

GJITHË pakuf. Mbi të gjitha në radhë të parë, para së gjithash; në mënyrë të veçantë, veçanërisht. Para së gjithash në radhë të parë, para çdo gjëje tjetër.

GJITHSEJ ndajf. Me gjithsej me të gjitha çfarë ka, me të tëra, krejt, tërësisht.

GJIZË f. Kulla me gjizë diçka e pamundur dhe pa asnjë mbështetje, kështjella në ajër.

GJOJA pj. bised. Gjoja se lidh. sikur.

GJOKS m. Me gjoks

GJOL m. bised. Iu bë gjol e përrua i dolën përpara gjithfarë pengesash, nuk i shkuan mirë punët, nuk i shkoi mbarë. Është si gjoli (si deti) me ujë dikush shih tek UJ/Ë,~I.

GJOLLË f. Si dhia në gjollë nuk shkëputet nga diçka që i pëlqen, ngulet diku me kënaqësi e nuk largohet.

GJU m. Në (më) gjunjë i nënshtuar, i gjunjëzuar, i përlurur. Gju më (për) gju

GJUHEM vetv. Gjuhen me fjalë shih te FJAL/Ë,~A.

GJUHË f. 3. fig. Ky organ i vështuar si shprehës e kumtues i mendimeve e i ndjenjave të njeriut, si përfaqësues i aftësisë së tij për të folur dhe vënia në jetë e kësaj aftësie; të folurit, goja; vet. sh. ata që thonë a përhapin diçka (edhe në një varg njësisht frazeologjike). Gjuhët (gojë) e këqija (e liga). keq. Mbaje (mblidhe, rrudhe, bëje zap) gjuhën! përmbahu në të folur!, mos fol mbarë e prapë!, mbaje gojën! E ka gjuhën bilbil është i shkathët dhe i zoti për të folur, flet qartë e bukur. E ka gjuhën brisk shih te BRIS/K,~KU. E ka gjuhën shpatë. E ka gjuhën një pëllëmbë. E ka gjuhën një push. E ka gjuhën lëpjetë. E ka gjuhën të gjatë shih te GJATË (i,e). E ka zgjatur (e ka rritur) gjuhën (e ka bërë gjuhën të gjatë). keq. shih te ZGJAT. E zgjati gjuhën si lëpjetë (si lëpushë). keq. shih te ZGJAT. Mbaje (shtrëngoje) gjuhën pas (prapa) dhëmbëve (ndër dhëmbë, në mes të dhëmbëve)! mos fol më!, kyçe gojën!; fol aq sa duhet!, vëri fre gjuhës! I vë fre gjuhës shih te FRE,~RI. Ia shtrëngoi frerin gjuhës.

Më ra gjuha (goja) u lodha së foluri a së përsërituri diçka. I doli gjuha (një pëlëmbë, një pash)

GJUHË f. Në gjuhën e ... libr. nga pikëpamja e. . ., sipas ..., duke e shprehur sipas mënyrës së... Në (me) gjuhën e Ezopit duke i shprehur mendimet në mënyrë të tërthortë e të figurshme. Ia di gjuhën dikujt e njoh mirë, e di mirë çmendon, ç'qëllime ka etj.

GJUMË m. Si nëpër gjumë në mënyrë të turbullt, jo qartë. Bën gjumë shih te BËJ. Gjumi i të drejtit shih te DREJT/Ë,~I (i). Gjumë gjarpri shih te GJARP/ËR, ~RI. Gjumi i madh (i përjetshëm) euf. vdekja. Gjumi i vdekjes shih te VDEKJ/E,~A. Paska qenë në gjumë! s'paska ditur gjë fare! (thuhet për një njeri që e merr vesh tepër vonë diçka). E ka lënë në gjumë diçka nuk kujdeset për ta bërë a për ta përfunduar sa më shpejt diçka, nuk e shtyn një punë. E vë në gjumë dikë

GJURMË f. Gjurmë për gjurmë pa iu ndarë, këmba-këmbës, hap pas hapi. Bie në gjurmë të dikujt a të diçkaje mësoj se ku ndodhet, e diktoj, i bie në erë. I humbi (i mbuloi, i fshehu) gjurmët i fshehu, i mbuloi të gjitha shenjat, që mund të zbulonin një veprim jo të mirë që ka kryer. Ia humbi gjurmët diçkaje e fshehu a e zhduku diçka që të mos e gjejnë a zbulonjë. Humbas gjurmën nuk jam në gjendje ta ndjek më tej diçka, humbas fillin. I marr gjurmën dikujt a diçkaje mësoj se ku ndodhet, diktoj. E marr në gjurmë dikë e ndjek sipas gjurmëve, e gjurmoj; e ndjek pas. E ndjek (e marr) gjurmën mbrapsht e nis keq një punë a diçka tjetër. U zhduk (humbi) pa lënë gjurmë

GJURMOJ kal. Gjurmmon (kërkon, lyp) qimen në vezë shih te QIM/E,~JA.

GJYKATË f. Gjykata e diktimit drejt., vjet. gjyqi i diktimit; zyra e gjyqit të diktimit.

GJYKIM m. Me gjykim (me gjak) të ftohtë shih te FTOHTË (i,e). E ka gjykimin (mendjen) brisk shih te BRIS/K, ~KU.

GJYM m. Gjym i shpuar shih te SHPUAR (i,e). Shkon (vete) gjym shkon shumë mirë e me gjallëri të madhe (për bisedën, këngën, gostinë etj.). Bie shi me gjyma (me shtamba, me legenë, me kova, me ibrikë) bie shi i madh. Është si gjym i zi shih te ZI (i), ZEZEË (e). Bie shi me grykë gjymi (pusi, shtambe) bie shi me gjyma.

GJYQ m. Bëri gjyq me dikë

GJYRYK m. I shkon tymi gjyryk (drejt) shih tek TYM,~I.

GJYSMË f. Gjysmë për gjysmë

GJYSH m. Gjysh pas gjyshi nga njëri brez në tjetrin, brez pas brezi. Gjysh stërgjyshi (katragjyshi) që prej kohësh të lashta, nga njëri brez në tjetrin, brez pas brezi. Është bërë gjysh në vatër është bërë barrë për dikë. Është bërë buzë gjyshi është shumë i ftohtë.

GJYVEÇ m. Bëj syrin gjyveç tregohem shumë i vëmendshëm, ndjek me shumë kujdes diçka, i hap sytë katër.

GJYZLYKË m. vet. sh. I vë gjyzlykë (syze) dikujt shih te SYZE,~T.

HA kal. 7. jokal. Më kruhet (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Më ha trupi (shtati).

12. fig. Përdoret në togje fjalësh (edhe në disa njësi frazeologjike), zakonisht me lidhëzën sa, me kuptimin: *Â* «sa arrin caku më i lartë a më i largët, sa mban, sa kap, sa përfshin, sa rrok, sa ka mundësi*Â*». I binte sa i hante krahu (shpatulla). Qëllonte sa i hante palla. Ecte sa i hanin këmbët. Thërriste sa i hante zëri. Bërtiste sa i hanin mushkëritë. Ulërinte sa i hante fyti (goja). Fliste sa i hante gjuha. Ishte tepër larg, s'ta hante syri. Ishte aq larg sa ha plumbi (pushka). E ha pushka e arrin plumbi i pushkës, mund ta qëllosh me pushkë.

Më ha ana me dikë prirem, anoj nga dikush. I ha (i marr) arrat dikujt shih tek ARR/Ë,~A. Ka ngrënë baltë është munduar shumë, ka rrojtur me të keq, ka vuajtur. Hëngri baltë përçm. vdiq. E hëngri barin (kullotën, livadhin, çairin)

- HABER** m. bised. S'ka haber për diçka ose nga diçka nuk di gjë fare për diçka, s'di ta bëjë fare një punë, nuk e njeh fare, s'merr erë. S'merr haber nuk kupton; s'merr vesh për çka i thua.
- HABITORE** mb. gjuh. Mënyra habitore një nga mënyrat e foljes në gjuhën shqipe, e cila shpreh një veprim a një gjendje që kryhet ose ngjet papritur dhe ngjall habi te folësi.
- HAHEM** vetv. Nuk hahet as me hudhra shih te HUDH/ËR,~RA. Më hahen mendtë (ndër vete) shih te MEND,~TË. Hahen (zihen) si qentë në garroq shih te GARROQ,~I. S'hahet as me vaj, as me uthull shih te VAJ,~I I. Pema pa u pjekur s'hahet fj. u. shih te PEM/Ë,~A.
- HAIR** m. bised. Manastir pa hair vjet. njeri shumë dorështrënguar, njeri që s'të jep as një pikë ujë; shtëpi jo mikpritëse. I mbiu sherri midis hairit shih te SHERR,~I.
- HAJAT** m. E prishi hajatin me dikë i prishi marrëdhëniet me dikë, u zu, i ndau hesapet. I jep hajat diçkaje përkrah a mbulon një gënjeshtër, i bëhet strehë.
- HAJDE** pasth. bised. Hajde de thjeshtligj. shih te DE. Hajde baba të të tregoj arat (vreshtin)! iron. shih te BABA,~I.
- HAJMEDET** pasth. Bën hajmedet
- HAK** m. bised. E bëri hak e meritoi diçka. I doli hakut (borxhit, nga borxhi) dikujt shih te BORXH,~I. I hyri në hak dikujt i hëngri të drejtën. I vjen hakut (i vjen për hak) dikujt keq. shih te VIJ. Kija inatin dhe foli hakun! (kija inatin, po hakun mos ia ha!) fj.u. shih tek INAT,~I.
- HALË** f. Fjalë e halë thashetheme. Iu bëftë halë në grykë! mallk. i ngeçtë në grykë! E bën halën (qimen) tra shih te QIM/E,~JA. E kishte halën në grykë ishte në gjendje të vështirë, e kishte litarin në grykë. E ka halë (ferrë, gjemb, shushull) në sy e urren shumë, nuk e sheh dot me sy, s'e duron dot. Kërkon halën në përpeq shih te PËRPEQ,~I.
- HALIÇ** m. Humbi si meli në haliç (në rërë) shih te MEL,~I.
- HALL** m. bised. Vaj halli! shih te VAJ,~I II. Është halli që ... (halli është se ...) puna është se ..., duhet të shqetësohemi për ... Ku e ke hallin? ku kërkon të dalësh, ç'synon të arrish? Kam hall sa ... dua sa..., e kam për detyrë sa... (të bëj diçka), e kam keq sa..., e kam vështirë sa... I qaj hallin dikujt shih te QAJ. Mos i qaj hallin atij! shih te QAJ. S'e zë halli (meraku, qederi) shih te ZË. Ishte në ditë (në pikë) të hallit ishte në gjendje shumë të vështirë. Ishte për të qarë hallin ishte shumë keq, ishte në gjendje shumë të vështirë. E bën nga halli e jo nga malli e bën nga e keqja e jo se do vetë.
- HALLAKAT** kal. bised. I hallakati brinjët dikujt e rrahu fort sa i theu brinjët.
- HALLALL** m. bised. Ia bëri hallall
- HALLË** f. Të puth halla në të dy faqet thjeshtligj., iron. u lamë bashkë; s'ke ç'merr, mos prit gjë, mori fund me kaq.
- HALLKË** f. Ia hoqi hallkën dikujt shih te HEQ.
- HALLVË** f. Hallvë e ftohtë keq. diçka që mund të mos bëhet, diçka pa shpresë, punë e ftohtë. Hallvë e pjekur diçka që është bërë, punë e kryer. Të ngrënsha (të ndafsha, të bëfsha) hallvën! thjeshtligj. mallk. vdeksh!
- HAMBAR** m. U bë hambar hëngri shumë, u dend, u bë det. I ushtojnë hambarët (kadet, sheket) shih tek USHTON. E bëri barkun hambar (katua) duroi shumë. Kemi ngrënë një hambar miell (një thes kripë, një barrë kripë, një furrë bukë) bashkë shih te FURRË,~A. E ka zemrën hambar është shumë i durueshëm, e ka zemrën të gjerë.
- HAMULL** m. U bë hamull u ndez, i hipi gjaku në kokë, mori zjarr. Mori hamull u ndez, mori zjarr.
- HAMULLOR** mb. Njësi hamullore bujq. njësi bazë e matjes së punës në punimet e

mekanizuar të tokës, e barabartë me larimin e një hektari tokë në thellësinë 17-20 cm.

HAN m. As në han, as në va pa vend të caktuar; as në qiell, as në dhe.

HANE II pj. Hane ku në një vend të largët, diku larg. Hane kur në një kohë të largët e të papërcaktuar.

HANXHAR m. I ra me hanxhar diçkaje e dëmtoi rëndë, e prishi keq. I nxori hanxharin dikujt e kërcënoi, iu kanos ashpër. Ia preu me hanxhar ia tha hapur e menjëherë, ia tha copë. E kam hanxhar në zemër e kam gozhdë në zemër. I rri me hanxhar në dorë e kërcënon vazhdimisht. I vajti bari sa hanxhari shpenzoi shumë, më shumë humbi se fitoi.

HANXHI m. vjet. I ka bërë hesapet (llogaritë) pa hanxhiun i ka bëri llogaritë pa pyetur atë që do ta bëjë një punë, atë që përgjigjet drejtpërdrejt për një punë a që e di mirë një çështje; ka vepruar pa i menduar e pa i peshuar mirë të gjitha rrethanat e mundësitë.

HAP m. Në çdo hap (çap) kudo. Hap pas hapi

HAP kal. I hapi (i zbraz, i zbuloi) barkun dikujt shih te ZBRAZ. Na hapi barkun

HAPEM vetv. M'u hap (më iku) barku shih te BARK,~U. S'i hapet (s'i pëlqet, s'i digjet) barku për dikë përçm. shih te BARK,~U. T'u haptë dera! shak. qofsh i uruar, paç mbarësi! Iu hap (iu çel) dera dikujt siguroi vijimësinë e familjes me lindjen e një fëmije, zakonisht të një djali (sipas paragjykimeve patriarkale). U hapën detet (u hap deti) shih te DET,~I. Iu hap (iu çel) goja ka filluar të flasë pa druajtje. S'i hapet goja nuk ka fare oreks, nuk ka fare dëshirë për të ngrënë; nuk do të flasë, nuk i pëlqen të shprehet për diçka. Iu hap (iu ç) hunda (për duhan) nuk duron dot më pa pirë duhan. Iu hap (iu çel) oreksi

HAPËS I m. I hodhi hapëset shih te HEDH. S'është në hapës nuk është në rregull nga

mendja. Ka (mban) hapëset (çelësat) e kashtës iron. shih te KASHT/Ë,~A.

HAPËSIRË f. Liria e hapësirës ajrore (liria e ajrit) shih te LIRI,~A.

HAPJE f. Pika e hapjes usht. shih te PIK/Ë,~A.

HAPUR mb. Me ballë të hapur (të çelur) bal-lëhapur. Me dyer të hapura që zhvillohet a bëhet duke pasur të drejtë të marrin pjesë edhe njerëz të tjerë, me hyrje të lirë (për një gjyq, një mbledhje). Me gjoks të hapur pa u frikësuar, trimërisht.

HAPUR ndajf. Me ballë hapur (hapët) bal-lëhapur. Me gojë hapur (hapët)

HARAM m. bised. Ia bën haram diçka ia prishi, ia nxiu, ia bëri që të mos kënaqet me të.

HARAR m. krahin. Harar (thes) i grisur (i shpuar) shih te SHPUAR (i, e).

HARBI f. vjet. U bë harbi u zemërua shumë, u tërbua nga inati. Është harbi nga mendja nuk ia pret fare mendja; është mendjelehtë.

HARC m. E ka kokën harc është kokëfortë, e ka kokën shkëmb.

HARDALL m. Farë (lëng) hardalli iron. njeri që ka lidhje farefisnie shumë të largëta me një tjetër. Doli hardall diçka shkoi kot, nuk fitoi gjë.

HARDHI f. bot. Hardhia e bën rrushin, ferra merr uratën fj. u. thuhet kur punën e bën një njeri, ndërsa frytet i rrëmben një tjetër. Hardhia e mureve shkurre e egër kacavarëse, me gjethe të përbëra me tri ose pesë fletë të vogla, me lule të verdheme e të grumbulluara, që bën si farë ca kokrra të zeza dhe që mbillet si bimë zbukuruese.

HARDHJE f. Flet hardhje e zhapij flet gjepura, thotë marrëzi. Vë hardhjen në bisht përpiqet të bëjë diçka të pamundur. Hardhja e blertë zool. zhapiu.

- HARK** m. Hark elektrik fiz. dy shufra karboni të lidhura me burimin e rrymës elektrike, të cilat, kur afrohen, lëshojnë shkëndija me dritë verbuese.
- HARKOR** mb. Gradë harkore mat. shih te GRAD/Ë,~A.
- HARXHOJ** kal., bised. Harxhoj fjalën kot ndërhyj te dikush për të rregulluar një punë, por nuk ia arrij qëllimit; më shkon mundimi kot. Harxhoj frymën (kot) lodhem së foluri e s'më dëgjon njeri. Harxhoi (pagoi) qimet (leshtë) e kokës shih te QIME,~JA.
- HARRJE** I f. zool. Iu bë harrje dikujt iu qep dikujt dhe e mërzi shumë, e bezdisi tej mase.
- HARROHEM** vetv. Iu harroftë (iu shoftë, i humbtë) emri! mallk. shih tek EM/ËR,~RI.
- HARROJ** kal. Na harroi adresën shak. nuk na ka ardhur prej shumë kohësh në shtëpi, nuk është dukur prej kohësh, na ka harruar shtëpinë. Na e harroi derën (shtëpinë) shih te DER/Ë,~A. Të harrofshin të ligat! ur. shih te LIG/Ë,~A (e). Harro mushkë Valarenë shih te MUSHK/Ë,~A. I mori bukën, të harronte djathin shih te DJATH/Ë,~I.
- HAS** kal. I hasi (i zuri, i ndeshi, i ra) sharra në gozhdë shih te SHARR/Ë,~A.
- HASËR** f. I digjet hasra (rrogozi) nën vete shih te RROGOZ,~I. I hyri uji (ujët) nën hasër (nën rrogoz) shih te RROGOZ,~I. Ta shkon (ta çon, ta lëshon, ta fut, ta kalon) ujët nën hasër (nën rrogoz, nën vete) shih te RROGOZ,~I.
- HASHASH** m. Lule hashashi bot. shih te LUL/E,~JA.
- HATA** f. bised. Me hata me pahir; me të keq. Sa një hata shumë i madh, sa të shtie tmerrin. Bëri hatanë thjeshtligj.
- HATULL** f. Ka një hatull (një dërrasë, ca dërrasa) mangët mospërf. shih te DËRRAS/Ë,~A.
- HAUZ** m. Është si miu në hauz (në poç) rri i veçuar e i mbyllur nga të tjerët, nuk jep e merr me asnjëri, nuk ka marrëdhënie me të tjerët.
- HAVA** f. bised. Fjalë në hava (në erë) shih tek ER/Ë,~A I. Flet në hava flet kot më kot, flet në tym. E hodhi në hava
- HAVADAN** ndajf. bised. Mbeti havadan mbeti në hava. E la havadan e la në hava.
- HVALE** f. bised. Iu bë havale dikujt e mërzi, e bezdisi; i ra më qafë, iu qep e s'i ndahet. Ia gjeti havalenë dikujt a diçkaje ia gjeti anën, ia gjeti pikën më të përshtatshme. M'u gjend havale m'u bë pengesë; më mërzi. Iu bë mendja havale u prish nga mendtë, nuk është në rregull nga mendja; e ha merakun gjithnjë për një gjë, i është ngulur në kokë diçka, i ka hipur në kokë për diçka.
- HAVAN** m. E rrah në havan diçka e shqyrtoj mirë një çështje; e bluaj mirë diçka në mendje.
- HAZINE** f. vjet. Gjeti hazinenë iu krijuan kushte shumë të mira ekonomike, të cilat nuk i priste, ra në bollëk të madh. E ka zembrën hazine është zemërgjerë, e ka zembrën det.
- HEDH** kal. Hodhi (dorëzoi, la, lëshoi, dha, uli) armët shih tek ARM/Ë,~A. I hedh baltë dikujt (hedh baltë mbi dikë) e poshtëron dikë duke shpifur, e përlyen, e njollos; ia nxin emrin. Hedh në baltë shih te BALT/Ë,~A. Hedh bazat (themelet) e diçkaje themeloj. I hodhi një brez (rakisë) hëngri pak meze kur pinte raki. I hedh çakëll ndërhyr me fjalë në një bisedë për të ngatërruar sqarimin e diçkaje. I hedh çeçen vjet. shih te ÇEÇ/E,~JA. Hodhi çengel (gripin) bëri përpjekjen e parë për të arritur diçka.
- HEDHUR** mb. Lëmë i hedhur
- HEJBE** f. vet. sh. I kishte florinj të (paratë) me hejbe (me bisht) shih te BISHT,~I. Nuk ia vari hejbetë (torbën, trastën, kapistrën, këmborën) shih te VAR.

- HEKUR** m. Udhë hekuri (e hekurt) vjet. shih tek UDH/Ë,~A 1. Bren hekur me dikë shih te BREJ. U vesh me (në) hekur (çelik) shih te VISHEM. Ha (bren) hekurin (çelikun, plumbin, gurin) me dhëmbë shih te DHËMB, ~I. Ka durim prej hekuri (prej guri) dikush shih te DURIM,~I. I pret gjuha (goja) hekur (gozhdë, brisk) shih te PRES I. Merr hekurat zvarrë rrëmbehet shumë. Gjuha pret hekurin (çan gurin, çan shkëmbin) fj. u. shih te GJUH/Ë,~A I. Hekuri rrihet sa është i nxehtë fj. u. çdo punë do bërë në kohën e vet, shpejt dhe asnjëherë të mos shtyhet për më vonë.
- HELAQ** ndajf. bised. E bëri helaq dikë thjeshtligj. e shau rëndë, s'i la gjë pa thënë para të tjerëve, e bëri për turp.
- HELM** m. Sheqerkë me helm shih te SHEQERK/Ë,~A. Ishte bërë për të pirë helmin shih te PI. Iu bë zemra (shpirti) helm (vrer) shih te VRER,~I. Më mirë shkelmi se helmi fj. u. shih te SHKELM,~I. Vjell (lëshon, nxjerr) helm e vrer shih te VRER,~I. Dhuratë e armikut o helm o thikë fj. u. e mira që të bën armiku sjell të këqija të mëdha, fsheh tradhti e pabesi, mos prit kurrë të mirë nga armiku.
- HELMUES** mb. Bar helmues shih te BAR,~I I.
- HELL** m. U bë hell
- HENDEK** m. Çel një hendek shih te ÇEL. E hodhi në hendek dikë e braktisi, e hodhi tutje. Ndal beg se ka hendek shih te BEG,~U.
- HEQ** kal. Më heq ana me dikë a me diçka shih tek AN/Ë,~A I. E hoqi (e tërhoqi) në baltë dikë shih te BALT/Ë,~A. Më heq (më shkon, më vete) bark shih te BARK,~U 10. Ia hoqi (ia nxori, ia qiti) bojën keq. shih te BOJ/Ë, ~A. Ia hoqi bricën shih te BRIC/Ë, ~A.
- HEQUR** mb. Ha të hequr shih te HA.
- HERË** f. Në fund të herës herën e fundit. Herë më herë gjithnjë, vazhdimisht; kohë pas kohe. Herë pas here kohë pas kohe. Një herë për një herë tani për tani. përko-hësisht, për një farë kohe. Si një herë, një herë njëlloj në çdo kohë. Si një herë, njëqind herë njëlloj, pa ndryshuar aspak. Një herë në hënë shih te HËN/Ë, ~A.
- HERËT** ndajf. Herët (shpejt) a (ose) vonë pas një farë kohe, në një të ardhme që do të vijë patjetër (për diçka që do të ndodhë medoemos).
- HERO** m. Hero Kombëtar
- HEROIK** mb. Varg heroik let. varg në metrikën e lashtë që ka dhjetë rrokje e pesë theksa dhe që rimon me vargun vijues.
- HEROINË** I f. Nënë Heroinë titull nderi që u jepet në vendin tonë nënave që kanë lindur, kanë rritur dhe kanë edukuar mirë tetë fëmijë e lart.
- HESAP** m. bised. Pa hesap shumë. Një hesap (është) njëlloj është. Për hesapin tim ... sipas mendjes sime..., për mua... Për hesap të tjetrit për interes të tjetrit. Nuk i dilte hesapi shih te DAL. Nuk i jep hesap askujt bën si mendon a si do vetë dhe nuk përgjigjet përpara askujt, vetë shkruan vetë vulos. Tjetër hesap ai është punë (çështje) tjetër ajo. Tjetër hesap (ky)! tjetër avaz ky, na nxjerr të tjera yçkla. Shkurt hesapi fj. ndërm. shih te SHKURT. Sa s'bëhet hesap (sa më s'bëhet) aq shumë sa s'llogaritet dot, pa hesap.
- HESHT** jokal. Historia hesht për diçka shih te HISTORI,~A.
- HESHTJE** f. E lë në heshtje diçka nuk e prek, nuk e zë në gojë a nuk e përmend; nuk merrem me një çështje për ta zgjidhur, e lë mënjanë.
- HË** pasth. bised. Ja që hë thjeshtligj. shih te JA.
- HËNABRENDIA** ndajf. Janë parë hënabrendia shkojnë mirë njëri me tjetrin, e duan njëri-tjetrin.

- HËNAJASHTË** ndajf. Janë parë hënajashtë nuk shkojnë mirë njëri me tjetrin, nuk e duan njëri-tjetrin, nuk duan ta shohin me sy njëri-tjetrin.
- HËNË** f. Ka rënë nga hëna iron. është i rrallë, s'ia gjen shokun në tokë (për të qesëndisur me dikë). Një herë në hënë shumë rrallë, rrallë e për mall. Me hënë (me hënëz) të mirë në gjendje shpirtërore të mirë. Kërkon hënë ka shumë teka, kërkon edhe të pamundurën. Leh në hënë bën zhurmë kot për diçka, sepse askush s'ia vë veshin as s'ia ka frikën. Lehin si qentë në hënë (në hënëz) keq. shih te HËNËZ, ~A. Njeri me hënë (me hënëz) njeri që gjendet shpirtërisht herë mirë e herë keq, pa pasur ndonjë arsye të dukshme; ai që nuk vepron përherë njëloj e drejt, njeri që është me orë, ai që vepron si të ndodhet; njeri me shumë teka. Janë parë me hënë të keqe janë parë hënajashtë. Janë parë me hënë pisk janë parë hënajashtë. E shikon (e vështron) si ujku hënë shih tek UJK, ~U I. E ka bërë lëmë me lëmë e hënë me hënë shih te LËM/Ë, ~I. Puna e hënës euf. sëmundja e tokës, epilepsia. Sëmundja (lëngata) e hënës mjek. sëmundja e tokës, epilepsia.
- HËNËZ** f. Në hënëz thjeshtligj. kot më kot, në tym (për dikë që flet për diçka pa ditur asgjë). Doli në hënëz doli i humbur në diçka; mbeti fare pa gjë, doli në diell. Një herë në hënëz një herë në hënë. Me hënëz (me hënë) të mirë shih te HËN/Ë, ~A. Njeri me hënëz (me hënë) shih te HËN/Ë, ~A. Lehin si qentë në hënëz (në hënë) keq. thërrasin shumë, bërtasin me të madhe.
- HI** m. Me krye në hi në gjendje të pikëlluar e të mjerë. E bëri hi (hi e pluhur, shkrumb e hi) diçka
- HIÇ** m. Hiç me hiç as fitoi as humbi kush gjë. Pesë me hiç thjeshtligj. pa ndonjë përfundim, pa ndonjë rezultat të vlefshëm; asgjë; bosh. Shkëmben hiçin me pluhur shih te PLUHUR, ~I.
- HIÇMOSGJË** pakuf. bised. Për hiçmosgjë
- HIDRAULIK** mb. Dash hidraulik tek. shih te DASH, ~I. Grusht hidraulik tek. shih te GRUSHT, ~I.
- HIDHEM** vetv. Hidhet (futet) në flakë (në zjarr) shih te FLAK/Ë, ~A. Iu hodh në grykë (në fyt) dikujt shih te GRYK/Ë, ~A. Hidhet (kërcen) si gjel shih te GJEL, ~I. U hodh (ra) në krahët e dikujt shih te KRAH, ~U. U hodh (ra) në prehrin e dikujt shih te PREH/ËR, ~RI 6. U hodh (kërceu) përpjetë
- HIDHËRIM** m. E piu gjithë kupën e hidhërimit (e mjerimit) libr. shih te KUP/Ë, ~A.
- HIDHUR** mb. Ka pirë kupën e hidhur libr. ka provuar shumë vuajtje e hidhërime, ka bërë një jetë plot vuajtje e mundime.
- HIJE** f. Bën hije diku (bën hije mbi dhe) keq. është, gjendet, është i gjallë, rron pa kryer ndonjë punë të dobishme, bën hije dikujt
- HIKËRR** I f. bot. Rron me hikra kursen shumë në të ngrënë; është shumë dorështrënguar.
- HIME** f. kryes. sh. Bëhet hime dikush a diçka del jashtë përdorimit, bëhet pa vlerë e i panevojshëm.
- HIP** jokal. I ka hipur breshkës iron. shih te BRESHK/Ë, ~A. I hipi (i kërcu, iu ndez, iu ngrit, e zuri) damari shih te DAMAR, ~I. Hipi në fron u bë mbret. Hipi në fuqi erdhi në pushtet, mori pushtetin. I hipën (i kërcyen) kacabuntjtë e zuri inati, u inatos, u nevikos. I kam hipur atij kali ia kam nisur një pune, për të cilën bëhet fjalë; e di atë punë. Ua hipi këmbëve shak. shkoj më këmbë, nisem për diku më këmbë. I hipi mbi kokë dikujt nuk i ndahet, i rri mbi kokë. I hipi (i kërcu) në kokë (në tru) diçka (për të bërë diçka) iu ngul në tru, i ra në kokë; iu mbush mendja për të bërë diçka dhe nuk heq dorë. I hipën (i erdhën) orët dikujt shih tek OR/Ë, ~A II. I hipi përsipër dikujt a diçkaje
- HIPUR** ndajf. Është hipur mbi kalë shih te KAL/Ë, ~I.

- HIQEM** vetv. S'të hiqet nga dera dikush shih te DER/Ë,~A. M'u hiq qafe (hiqmu qafe)! shih te QAF/Ë, ~A. Hiqmu (sh-porrmu) sysh! shih te SY,~RI. S'më hiqet nga rruga (nga udha) shih te RRUG/Ë, ~A. Hiqet zvarrë (rrëshqanë) shih te ZVARRË. Asnjë ashkël nuk i hiqet shih tek ASHK/ËL,~LA.
- HIR** m. Për hir të... për dikë a për diçka, për të ndihmuar a për të përkrahur dikë a diçka, për hatër të... Me hir e pa hir (hir e pa hir) dashur pa dashur, me dashje ose pa dashje; domosdo.
- HIRRË** f. Hirrë breshke thjeshtligj. shih te BRESHK/Ë,~A. Bar hirre bot. shih te BAR,~I I.
- HIRRËZ** f. veter. Bar hirrëze bot. shih te BAR,~I I.
- HISE** f. bised. I ra për hise (një punë, një detyrë etj.) i takoi atij ta kryente. Vëlla pa hise bised. vëllam.
- HISTORI** f. U bë histori diçka kryes. keq. u zgjat e u bë tërkuzë diçka, duke e marrë nëpër gojë dhe duke e mësuar të gjithë; u përsërit shumë herë. Historia hesht për diçka nuk ka asnjë të dhënë për një ngjarje a figurë historike, nuk dihet fare gjë për të. Hyri në histori edhe shak. u bë i njohur; do të mbetet i paharruar. Nuk e njeh historia as është parë, as është dëgjuar gjë për dikë a për diçka.
- HISTORIK** mb. Materializmi historik shih te MATERIALIZ/ËM,~MI.
- HITHËR** f. Nuk bie reja (rrufeja) në hithra fj. u. mospërf. nuk bie e keqja mbi të keqin, s'vete e keqja tek i keqi. I daltë hithra në vatër! mallk. iu shkretoftë shtëpia!, mos i mbettë asnjëri gjallë!, iu shoftë pragu! Shtohet (është) si fara e hithrës (e sinapit, e lirit) shih te FAR/Ë,~A 4. HITHËR DETI zool. Kandil deti.
- HITHËRISHTË** f. Iu bë shtëpia hithërishtë iu bë shtëpia gërmadhë; iu shkretua shtëpia, s'i mbeti asnjëri gjallë, iu shua pragu.
- HOBE** f. Është si guri në hobe nuk rri në një vend, ku ngryset nuk gdhihet.
- HOLLA** f. vet. sh. I bëri të hollat (paratë) rrush e kumbulla shih te RRUSH,~I.
- HOLLË** mb. Nuk hipën në degë të hollë vepron me shumë kujdes, nuk bën gabime në jetë.
- HOLLOHEM** vetv. Iu hollua gjaku shih te GJAK,~U I. Iu holluan kikëzat dikujt shih te KIKËZ,~A.
- HOLLOJ** kal. I holloi duart (së fërkuari) iron. Është shumë i kënaqur për diçka, fërkon duart nga kënaqësia.
- HON** m. Iu bë zemra hon u pikëllua shumë, iu bë një zbrazëti në zemër; u zemërua fort.
- HOP** m. Hop për hop
- HOP** pasth. Ja hop, ja top (hop, top) të bëhet ç'të bëhet, të dalë ku të dalë; ja fitoj, ja le të humbas. Është hop, top është njeri i lëvizur, nuk rri fare në një vend. Mos bëj hop pa e kapërcyer (pa e hedhur) gardhin! fj. u. shih te GARDH,~I.
- HORË** II f. bised. I digjet zemra horë ka dëshirë të flaktë për diçka. I mori horë (flakë) shpirti shih te SHPIRT,~I. I ndezi zemrat horë ngjalli gëzim të madh, i ngriti zemrat peshë.
- HORIZONT** m. Horizont matematik astr. shih te MATEMATIK, ~E.
- HORR** m. bised. E bëri horr dikë e shau rëndë dikë, e turpëroi dhe e poshtëroi, e bëri rezil.
- HOSTEN** m. Punon me hosten prapa punon me të shtyrë, punon me pahir. E shtyn me hosten dikë e nxit një njeri për të bërë diçka, e shtyn me zor. Nuk hyn (nuk futet, nuk fshihet) hosteni (minarja) në thes fj. u. shih te MINAR/E,~JA. E mban (e vë) në (nën) hije të hostenit dikë shih te HIJ/E,~A.
- HOV** jokal. Hovi përpjetë nga diçka u prek menjëherë, nuk e duroi dot diçka dhe kundërveproi, u hodh përpjetë. I hovi (i hidhet) zemra (gjoksi) përpjetë shih te HIDHEM.

- HOXHË** m. Ali Hoxha, Hoxhë Aliu i njëjti njeri; po ajo gjë, e njëjta gjë. I fol të hoxha (prifti)! mallk., vjet. vdektë! E këndoftë hoxha (prifti)! mallk. vjet. vdektë!
- HU** m. Bredh hu më hu keq.
- HUA** f. Ta paça hua! ur. ta shpërblefsha të mirën me një të mirë! Marrin miell hua
- HUAJ** mb. Në derë të huaj në shtëpinë e tjetrit, jo në familjen e vet a tek të afërmit. Me xhepin e huaj me paratë a me shpenzimet e një tjetri. Hyri në livadh të huaj shih te LIVADH, ~I. Kryeplak në fshat të huaj shih te KRYEPLAK, ~U. Miell nga thesi i huaj (i botës) iron. shih te MIELL, ~I. Kali i huaj (i botës) të lë në mes të udhës fj. u. shih te KAL/Ë, ~I. Mish i huaj
- HUALL** m. E ka gojën huall flet ëmbël, është gojëmjaltë.
- HUDHËR** f. Bulmet hudhrash iron. punë e kotë, punë boshe, diçka pa vlerë. Nuk hahet as me hudhra
- HUMB** kal. I humbi batha shih te BATH/Ë, ~A. E humbi barkun i ra barku, u dobësua.
- HUMBAS** kal. dhe jokal. Humbet nën lëkurë përçm. shih te LËKUR/Ë, ~A. E humbet (e humb) udhën në oborr shih tek OBORR, ~I.
- HUMNERË** f. Është në buzë të humnerës (të greminës) shih te GREMINË, ~A.
- HUNDË** f. I bën hundë (buzë) diçkaje shih te BUZ/Ë, ~A. I ra hunda tall.
- HUQ** m. bised. I doli huq (shterpë) shih te DAL. Ia di huqet dikujt a diçkaje e njoh mirë dhe di si të sillem me të. Mori huq e zuri inati, u inatos, u nxeh. Kali i kuq e ka një huq shih te KAL/Ë, ~I.
- HURDHË** f. Është hurdhë e pagjuajtur (pyll i pagjuajtur) shih te PAGJUAJTUR (i, e).
- HUT** m. U bë hut iku me vrap, iku me të katra (për meshkujt). I ka kënduar huti dikujt i shkojnë punët mirë, i ecën fati.
- HYJ** jokal. I hyj (i futem) brenda diçkaje shih te BRENDA. U ka hyrë bukla shih te BUK/ËL, ~LA. Hyjmë e dalim me dikë kemi marrëdhënie të mira, shkojmë e vijmë. Si hyri doli dikush s'përfitoi asgjë; nuk mësoi asgjë. Hyri (doli) nga deriçka shih te DERIÇK/Ë, ~A. I hyri dorë
- HYRË** f. Të hyra e të dala hyrje e dalje.
- HYRJE** f. Hyrje e dalje vajtje e ardhje të vazhdueshme ndërmjet familjesh, pritje e përcjellje, hyrje-dalje. E bëj hyrje fin. bëj veprimet për të futur një mall në magazinë. Ka hyrje të lirë diku shih te LIRË (i, e).
- HYZMET** m. bised. Ia bën hyzmetin një pune bised. kujdeset që ta kryejë një punë a një detyrë me përpikëri e me të gjitha mundësitë, në mënyrë që të mos e humbasë e të ketë sa më shumë përfitim prej saj.
- I I
Vë pikat mbi i libr. shih te PIK/Ë, ~A.
- IBRIK** m. Bie shi me ibrik (me gjyma, me shtamba, me kova, me legenë) shih te GJYM, ~I.
- IÇ** m. gjell. I doli içi diçkaje e morën vesh të gjithë, u zbulua, s'është më e fshehtë. Ia nxori (ia qiti) için lakrorit ia zbuloi dikujt të metat, gabimet, punët e papëlqyeshme etj. që ai kërkonte t'i mbante të fshehta, ia nxori në shesh të palarat, ia hoqi petën lakrorit.
- IDE** f. Ide absolute filoz. koncept themelor, antishkencor e teologjik i filozofisë idealiste të Hegelit, sipas të cilit para natyrës, para njeriut e pavarësisht prej tyre ka ekzistuar një Â«ide absoluteÂ», e përjetshme, që gjoja krijon gjithçka.
- IDEAL** I mb. psikol., logj., filoz. Trup (gaz, lëng) ideal trup (gaz, lëng) që merret teorikisht për qëllime studimi në një trajtë të caktuar ose me veti abstrakte.

- IDIOMË** f. gjuh. Shprehje me ndërtim të veçantë, tërësisht a pjesërisht të ngurosur, që përdoret në një gjuhë prej kohësh me kuptim të njësishtëm (i cili nuk del drejtpërdrejt nga shuma e kuptimeve të fjalëve përbërëse) dhe që nuk mund të përkthehet fjalë për fjalë në gjuhë të tjera; përngjitje frazeologjike; njësi frazeologjike (p.sh. bëj pallë; i ra bretku; i bie më qafë; vret rëndë; e fjeti mendjen; rri mbi gjemba; mori flakë; daulle e shpuar; dushk për gogla; fill e për pe; sy ndër sy; pikë e gjak; për dhjamë qeni etj.); fjalë e veçantë që përdoret në kuptim të figurshëm vetëm në një gjuhë e që nuk mund të përkthehet drejtpërdrejt në gjuhë të tjera p.sh. pikë në kuptimin \hat{A} «mes \hat{A} »: në pikë të verës (të dimrit, të natës...); buzëdele bot. një bimë barishtore; gojëlidhuri euf. ujku etj.
- II** pj. S'është tamam (nga koka) nuk mendon shumë, është i lehtë, s'është në rregull nga trutë.
- IJË** f. Iu frynë ijët shih te **FRYJ**. Na këputi ijët
- IKI** jokal. Më iku (m'u hap) barku shih te **BARK**, ~U. I ka ikur (i ka luajtur) çikriku shih te **ÇIKRIK**, ~U. I kanë ikur dërrasat shik te **DËRRAS/Ë**, ~A. I iku (i shpëtoi) nga dora (nga duart)
- ILAÇ** m. Ilaç i vjetër në shishe të re keq. përdoret kur diçka paraqitet në një formë, në një pamje a në një mënyrë të re pa ndryshuar përmbajtjen e saj.
- ILIK** m. I kanë ikur iliqet (disa iliqe) dikujt ka filluar të shturet fare, ka filluar të prishet moralisht.
- IMAGJINAR** mb. Numër imagjinar mat. numër që shpreh rrënjën katrore të një madhësie a të një njësie negative (p. sh. $a^2 = -1$ ose $a = \sqrt{-1}$).
- IMAN** m. fet. Me din e me iman shih te **DIN**, ~I. I ndërroi din e iman shih te **DIN**, ~I.
- IMËT** ndajf. Bluan imët mendon e flet me zgjuarsi, thotë gjëra të holla e të mprehta, është i mprehtë nga mendja.
- INAT** m. bised. Për inat (si për inat) fj. ndërm. për fat të keq, për dreq. Për inat të dikujt për të zemëruar a për të inatosur me qëllim dikë. Sa inat! fj. ndërm. sa keq! E bëri me inat me dikë e bëri me bast me dikë, u hëngër me ngulm me dikë për një punë. S'është me inat (s'është punë inati) nuk ia del dot me të keq, nuk mund të arrish gjithnjë me forcë atë çka dëshiron. Ha inat shih te **HA**. Ka lidhur inat shih te **LIDH**. Ia nxori inatin dikujt e trajtoi keq dikë a e ndëshkoi pa të drejtë në inat e sipër; gjetiu e kishte inatin e gjetiu e nxori. Nxjerr inatin (dufin) shih te **NXJERR 28**. S'vihet inat me dikë a me diçka nuk ia del dot me dikë a me diçka, nuk mund të hahesh me të, nuk mund ta mposhtësh. Kija inatin dhe foli hakun! (kija inatin, po hakun mos ia ha!) jepi dikujt atë që i takon, vlerësoje drejt dikë a punën e tij pavarësisht nëse të pëlqen a s'të pëlqen, rri shtrembër e fol drejt.
- IND** I m. Ind e majë
- INDIAN** mb. Në varg indian libr. në radhë një nga një, njëri pas tjetrit (sipas zakonisht të indianëve të Amerikës).
- INERCI** f. Për inerci libr. nga që e kam zakon, nga që më është bërë shprehi.
- INICIATIVË** f. Iniciativë ligj vënëse drejt. nismë ligjvënëse.
- INORGANIK** mb. kim. Kimi inorganike degë e kimisë që studion përbërjen e cilësitë e lëndëve joorganike dhe ndryshimet që ndodhin në to.
- INSTANCË** f. Në instancë të fundit libr. shih te **FUNDIT** (i, e).
- INSTRUMENT** m. libr. Instrument i rati-fikimit dipl. dokument ratifikimi.
- IRIQ** m. Nuk rri iriqi në plis fj. u. shih te **PLIS**, ~I I. Iriq deti zool. kafshë e vogël deti pa bosht kurrizor, me trup të rumbullakët dhe me një guaskë gëlqerore të mbuluar me gjemba që lëvizin.

- IRONI** f. Ironi e fatit libr. përdoret kur ndodh diçka që nuk pritej e as mund të mendohej, kur vjen diçka fare e rastit dhe e pagjasë ose kur diçka gjen një zgjidhje krejt të kundërt nga ajo që pritej a që duhej.
- ISO** f. I mban ison (i bën iso) dikujt keq. e mbështet dhe e përkrah dikë për çdo gjë, ia pranon a ia miraton mendimet, fjalët etj. për t'i bërë qejfin, i shkon pas qejfit, i mban avazin.
- ISH** pasth. Kur s'ke pula, mos bëj ish! fj. u. shih te PUL/Ë,~A.
- JA** I pj. Ja që hë thjeshtligj. s'ke ç'i bën, hë pra.
- JAHNI** f. gjell. Mos e prish jahninë (kazanin) për një qepë! shih te QEP/Ë, ~A.
- JAKË** f. E zuri (e kapi) për jake dikë e kërcënoi dhe e shtrëngoi të bënte diçka.
- JAKË** pasth. bised. Bëj (shkoj, eci) çap e jakë shkoj e vij tutje-tëhu, lëviz në të njëjtin vend lart e poshtë; sillem rrotull sa andej-këtej.
- JAKËZ** f. I ka sytë me jakëz mospërf. është sylesh.
- JAKI** f. I çeli një jaki (të keqe) dikujt e hidhëroi dikë, e shqetësoi shumë, i hapi një plagë.
- JAM** jokal. 3. Kaloj një gjendje, jetoj një gjendje të caktuar; kam një veti, një tipar, një aftësi a diçka tjetër që më vë në një gjendje të caktuar; kam arritur një gjendje të caktuar (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Është i ri (i zoti, trim). Është i gjatë (i madh, i shkurtër). Është e domosdoshme (e kuptueshme, e lehtë, e rëndë). Qofsh i lumtur
Duke qenë (që) për arsye..., meqenëse... Në qoftë se..., në është se..., po qe se..., po të jetë se (që...), me kusht që..., sikur ... Qoftë..., qoftë... edhe... edhe, si... ashtu dhe. Sido që të jetë sidofhtë. Ç'paske qenë! iron., mospërf. s'i gjendet shoku!, i vetmi qenka!, s'e paskam njohur! Të qoftë! merre!, e mbajtsh me shëndet!, e gëzofsh! (edhe iron.).
- Ç'është e vërteta (e drejta) fj. ndërm. shih te VËRTET/Ë,~A (e). Për se është çështja? shih te ÇËSHTJ/E,~A. Është (ndahet) në shenjë shih te SHENJ/Ë,~A. S'është e thënë... (që...) shih tek THËN/Ë,~A (e). Është (më duket) e udhës shih te UDH/Ë,~A. Jemi (qëndrojmë) bllok shih te BLOK, ~U. Janë të një çanaku keq. shih te ÇANAK,~U. S'është për gjë s'di të bëjë asgjë, s'është i aftë as edhe për një gjë. Jemi (rrimë, banojmë) nën një kulm shih te KULM,~I. Janë shenjat që... shih te SHENJ/Ë,~A. Lipsur qoftë! shih te LIPSEM. Sa për të qenë brenda shih te BRENDA. Qoftë edhe një thua shih tek THUA, THOI. Jemi paq me njëri-tjetrin shih te PAQ. Nuk është punë (që bëhet) shih te PUN/Ë,~A. Është (bëhet) bark e shpinë me dikë shih te BARK,~U. Është (e ka, shkon) gjalpë e vaj me dikë shih te GJALP/Ë,~I. Janë gur e uror shih te GUR,~I. Është me këmbë në yzengji dikush shih tek YZENGJI,~A. E kam (jemi) lakra (presh) në kopsht dikë (me dikë) shih te LAK/ËR,~RA. Janë pe për një gëzof shih te GËZOF,~I. Është për të lëpirë gishtat shih te LËPIJ. Ishte me pushkë në faqe shih te PUSHK/Ë,~A. Janë (shkojnë) thikë e brisk (brisk e thua) shih te THIK/Ë, ~A. Janë në thikë e në pikë shih te THIK/Ë,~A. Është thikë me dy presa (tehe) shih te PRES/Ë,~A. Kjo është ç'është kjo është më e mira (më e bukura, më e çuditshmja etj.) nga gjithë sa kemi parë, sa kemi provuar e sa kemi dëgjuar. Them atë që është them të vërtetën, them atë që ka ndodhur në të vërtetë. Udhë e mbarë (i qoftë)! iron. shih tek UDH/Ë,~A. S'është çap për atë zile shih te ZIL/E,~JA. Qe si qe u bë si ka shak. shih te KA,~U. Kudo oka katërqind dërhemë është shih tek OK/Ë,~A. Tymi të shkojë drejt, pa le të jetë oxhaku i shtrembër! fj. u. shih tek TYM,~I.
- JAP** kal. 13. Veprojmë mbi dikë, i bëj diçka, bëj që të ndërrojë gjendjen, të fitojë diçka

etj. (zakonisht në një varg njësisish frazeologjike). I jep gjallëri e gjallëron. I jap ngjyrë (bojë) e ngjyros (e bojatis). I jap ndihmë e ndihmoj. I jap përkrahje e përkrah. I jap arsim (dituri, mësim) e arsimoj. I jap shkollë e shkolloj. I jap dritë e ndriçoj. I dha një të shtyrë (një të rrahur, një të sharë) e shtyu (e rrahu, e shau). I dha një të puthur e puthi. I dha lirinë e çlirroi. I jap forcë e bëj të jetë më i fortë. I dha fuqi e bëri të fuqishëm. I jap bukuri e zbukuroj. I dha sëmundjen (gripin) i ngjiti sëmundjen.

Jap (vë) alarmin shih tek ALARM, ~I. Dha (hodhi, dorëzoi, la, lëshoi, uli) armët shih tek ARM/Ë, ~A. I jap arsye dikujt shih tek ARSYE, ~JA. I jap arratinë shih tek ARRATI, ~A. Dha (bëri) ballë shih te BËJ. Ta jep (ta çon) në ballë shih te

JARGË f. zakon. sh. Derdh jargët për diçka thjeshtlig. shih te DERDH. I shkojnë (i kullojnë) jargët i vete mendja për diçka të shijshme a për diçka që i pëlqen, lakmon diçka; i lëshon goja lëng nga diçka.

JASTËK m. Fjalë me jastëk fjalë me themel, fjalë me peshë, fjalë me vend. I hëngërt (i ngrëntë) në jastëk! mallk. mos i gëzoftë me shëndet (për paratë); rëntë i sëmurë, lëngoftë! Jastëku i fjalës pjesa kryesore në një bisedë, thelbi i një bisede; përfundimi që nxirret nga një bisedë, kapaku i fjalës. E mbaj nën jastëk e kam gjithmonë parasysh, nuk e ndaj asnjëherë. I vuri jastëk fjalës foli me mend, e mbështeti në të dhëna të shëndosha fjalën që tha, foli me baza.

JASHTË Bie jashtë vjet. nuk pajtohet, është në kundërshtim (diçka me diçka tjetër). Dal jashtë euf. bëj nevojën. Të dalët jashtë shih te DALË, ~T (të). Të dalat jashtë shih te DAL/Ë, ~A (e). Jashtë mendjes që s'mund të pranohet; që s'ka të ngjarë, i paqenë. Jashtë tharkut shih te THARK, ~U. I dolën sytë jashtë shih te SY, ~RI. Është jashtë botës keq. shih te BOT/Ë, ~A. S'ka dalë jashtë mureve të shtëpisë (të zyrës) shih te MUR, ~I. Mbeti (rri) me dhëmbë jashtë keq. mbeti

duke qeshur. E nxori hundën jashtë iron. shih te HUND/Ë, ~A. E kanë lënë jashtë valles shih te VALL/E, ~JA. Djepi plot e këmbët jashtë tall. shih te DJEP, ~I. Drapri brenda (në thes) e maja jashtë shih te DRAP/ËR, ~RI.

JATAGAN m. I priste jatagani (kordha, shpata, palla, sëpata) djathtas e majtas (nga të dyja anët) shih te PRES. Një mill s'i nxë dy jataganë fj. u. s'mund të bësh mirë disa punë njëkohësisht; s'mbahen dy kunguj në një sqetull.

JATAK m. E la jatakun (shtratin, krevatin, dyshekun) shih te SHTRAT, ~I. U ngrit nga jataku (nga shtrati, aga krevati, nga dysheku) shih te SHTRAT, ~I. Zuri jastëkun (shtratin, krevatin, dyshekun) shih te SHTRAT, ~I.

JAVË f. Java shtatë, ai tetë shumë dundur, shumë shpesh, orë e çast (për një njeri që shkon dundur në një vend). Java e bardhë fet., vjet. shtatë ditët para kreshmës së madhe, gjatë të cilave njerëzit mund të hanin edhe bulmet e vezë. Java e madhe fet. vjet. shtatë ditët para pashkës së madhe.

JESHIL mb. bised. Myku jeshil (i gjelbër) bot. shih te MYK, ~U.

JETË f. Bëj jetë shih te BËJ. E pruri (e solli, e qiti) në jetë e shpëtoi nga një gjendje e mjeruar, e bëri të jetojë mirë, e qiti në dritë. Ia biroi jetën shih te BIROJ. E bukura e jetës arb. shih te BUKUR, ~A (e). Del në jetë shih te DAL. Gjen jetë shih te GJEJ. Humbi jetën shih te HUMB. Hyj në jetë

JETIM mb. Faji është jetim fj. u. keq. përdoret kur askush nuk e pranon fajin, kur askush nuk i del zot fajit.

JETOJ jokal. Jetojnë në një lëkurë jetojnë njëlloj të gjithë. Jetonte (rronte) si gogla në ujë shih te GOGËL~LA.

JO pj. Si jo më mirë shumë mirë.

JONË pron. E bëmë tonën bëmë gjithçka sa mundëm ne, e bëmë atë që na takonte neve. Në kohën tonë

- JONGAR** m. I bie jongarit kalon kohën kot, s'bën asgjë. Në një tel i bie jongarit shih tek TEL~I.
- JORGAN** m. Iu bë jorgan dikujt e mbrojti, nuk e la të dëmtohej nga diçka. Për një plesht djeg jorganin fj.u. shih te PLESHT,~I. Shtriji (zgjati) këmbët sa ke jorganin (plafin shtratin) fj.u. shpenzo aq sa ke mundësi; vëri vetes detyra që ke aftësi e mundësi t'i kryesh.
- JURIDIK** mb. Person juridik zyrt. ndërmarrje, institucion, shoqëri etj. që i është njohur ligjërish e drejta të përfaqësojë vetveten para shtetit për veprimtarinë që kryen.
- KA** m. Si kau në ugar duke u vërtitur e duke u rrotulluar kot; duke u munduar kot.
- KABA** mb. bised. Më vjen kaba më vjen rëndë.
- KABINET** m. Shkencëtar kabineti libr., keq. shkencëtar që ka shkëputur lidhjet me jetën, shkencëtar që nuk njeh praktikën revolucionare.
- KABUNI** f. Ka (kërkon të ketë) njërën dorë në bakllava dhe tjetrën në kabuni (në mjaltë, në revani) keq. shih te DOR/Ë, ~A.
- KACABU** m. zool. I hipën (i kërcyen) kacabunjtë u inatos, u nevrikos. I zbritën (i ranë) kacabunjtë i iku inati.
- KACEK** m. U bë kacek (calik) hëngri shumë, iu fry barku; u shëndosh shumë. M'u bë barku kacek (daulle, lodër) shih te DAULL/E,~JA.
- KACIDHE** f. S'bën një kacidhe s'vlen fare. E bën groshin kacidhe kursen tepër.
- KAÇAK** m. vjet. U bë kaçak dikush ka munguar për një kohë të gjatë; nuk ka ardhur prej kohësh, humbi.
- KAÇILE** f. Ia di lugët në kaçile dikujt shih te LUG/Ë, ~A. S'bartet çorba me kaçile fj. u. shih te ÇORB/Ë, ~A.
- KAÇKË** f. bised. Kaçka e fytit anat. fikthi i fytit. Kaçka e gjurit anat. kupa e gjurit.
- KAÇUP** I m. U bë kaçup u fry (nga ndonjë sëmundje a nga të ngjallurit); u mbyt në ujë.
- KADE** f. I ushtojnë kadet (sheket, hambarët) shih tek USHTOJ.
- KADI** m. hist. Është vetë vali e vetë kadi (myfti) shih te VALI,~U.
- KADIFE** f. Vë dorashka kadifeje përpiqet të tregohet i butë dhe i mirë për të mashtruar të tjerët. Lule kadifeje shih te LULE,~JA.
- KAF** m. Si bisha në kafaz shih te BISH/Ë, ~A. Ishte si bilbili në kafaz shih te BILBIL,~I.
- KAFE** f. Do dhe Muçoja kafe tall. kërkon diçka që nuk i takon (sepse nuk e meriton ose është ende i vogël).
- KAFKË** f. I doli kafka
- KAFSHATË** f. Për një kafshatë bukë për një shpërblim fare të vogël; sa për të mbajtur frymën, për bukën e gojës. Për kafshatën (për bukën) e gojës shih te GOJ/Ë,~A. I rrëmbeu
- KAFSHOJ** kal. Kafshoi (hëngri) buzët me dhëmbë u pendua për atë që tha ose që bëri. Kafshoi (hëngri) dhe (botë) përçm. shih te HA. Kafshoi (zuri, hëngri) gjuhën shih te GJUH/Ë,~A. Qeni që leh nuk kafshon fj. u. ai që të kërcënon shumë nuk është aq i rrezikshëm sa tregohet.
- KAIKE** f. Ishte bërë kaike mospërf. ishte dehur, kishte pirë shumë dhe lëkundej sa andej e këtej kur ecte.
- KAKARIS** jakal. Kakaris si pula pa grurë (si pula në veri) shih te PUL/Ë,~A.
- KALA** f. Kala (kështjellë) prej karte (prej letre) shih te KËSHTJELL/Ë,~A. Ra kalaja u thye, u mund, u mposht. Iu bë zemra kala dikujt u gëzua shumë, iu bë zemra mal.
- KALB** kal. E kalbi (e ngordhi) në dru shih te DRU,~JA 2. Na kalbi dimri po bën dimër i gjatë edhe me shumë lagështi. Na kalbi shiu po bie shi prej shumë kohësh,

- nuk po pushon shiu. Pema e kalbur kalb (kalbëzon) edhe shoqet fj. u. shih te PEM/Ë,~A.
- KALBEM** vetv. Iu kalbën trutë u bë matuf, nuk është në gjendje të gjykojë më. Mos u kalbtë në dhe! mallk. mos e trettë dheu!
- KALBËZOJ** kal. Pema e kalbur kalbëzon (kalb) edhe shoqet fj. u. shih te PEM/Ë,~A.
- KALBUR** mb. Dru i kalbur njeri që sëmuret shpesh, njeri i dobët; plak. Farë e kalbur keq. shih te FAR/Ë,~A. Nuk shkel (nuk bie) në dërrasë (në dhogë) të kalbur shih te
- KALEM** m. I bie kalemit (lapsit) shih te BIE I. Me kalem (me laps), në dorë shih te LAPS,~I.
- KALË** m. Ra nga kali
- KALIM** m. E trajtoi në kalim (e sipër) diçka e trajtoi a e zuri në gojë kalimthi, pa u ndalur gjatë e pa e zbërthyer, pa u thelluar, shpejt e shpejt dhe shkurt.
- KALOJ** jokal. Kaloi (doli, iku) nga faza thjeshtligj. shih te FAZ/Ë, ~A.
- KALORËS** m. I qan hallin kalorësit se i varen këmbët thuhet kur dikush shqetësohet kot për një njeri, që i ka punët në rregull e që ka mbështetje a përkrahje të fortë.
- KALTËR** mb. Qymyri i kaltër energjia e valëve të detit, gjatë baticës e zbaticës, që shfrytëzohet për centralet elektrike. Si rrufe (si bubullimë) në qiell të kaltër (të kthjellët) libr. shih te BUBULLIM/Ë,~A. Myku i kaltër bot. shih te MYK,~U 1.
- KALL** I kal. I kalli bretkun bised. shih te BRETK,~U. I kalli djallin (dreqin) dikujt a diçkaje thjeshtligj. nuk u interesa, nuk pyeti fare, nuk çau kokën për dikë a për diçka; e braktisi. I kalli (i shtiu) ethet dikujt shih tek ETH/E,~JA 3. I kalli e i futi flamën (murtajen) dikujt a diçkaje thjeshtligj.
- KALL** II kal. krahin. I kalli (i dha) barut shih te JAP.
- KALLABALLËK** m. bised. Mblidhe kallabal-lëkun! shih te MBLEDH.
- KALLAJ** m. Kaloi me kallaj mbi gunë kaloi kot, pa bërë asgjë.
- KALLAJXHI** m. Luante qeni i kallajxhiut
- KALLAM** m. Kallam sheqeri bot. bimë barish-tore shumëvjeçare, me gjethe si të misrit, me kërcell të drejtë e të gjatë, nga e cila nxirret sheqer.
- KALLAMBOQ** m. krahin. Kallamboq i hollë bot. mel.
- KALLAME** f. E bëri kallame e shkatërroi, e prishi krejt, e rrafshoi; e bëri pluhur e hi.
- KALLAUZ** m. vjet. Fshati që duket s'do kallauz fj. u. shih te FSHAT,~I.
- KALLËP** m. I fut (gjërat) në kallëpe u jep gjërave formë të njëjtë, i fut mekanikisht në skema; gjykon në mënyrë burokratike a dogmatike. E futi në kallëpe e quajti pa të drejtë si njeri që ka shkelur vijën, rregullat etj. (kryesisht në plan politik e moral).
- KALLËZ** f sh. Kërkon kallëza në borë kërkon një gjë të pamundur, kërkon qiçra në hell.
- KALLËZUESOR** mb. Fjali kallëzuesore fjalia që përdoret me funksionin e gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror (p.sh. i dukej sikur ishte rinuar). Përcaktor kallëzuesor gjymtyrë e dytë e fjalisë, e shprehur zakonisht me emër ose me mbiemër, që lidhet me kallëzuesin, me kryefjalën ose me kundrinën (p.sh. Në luftën e pabarabartë kundër pushtuesve populli ynë doli fitimtar).
- KALLI** m. Mbeti kalli
- KALLKAN** m. Bëhet kallkan ngurtësohet, forcohet. U gdhi kallkan u gdhi i vdekur.
- KALLO** f. E shkeli (e preku) në kallo (në lyth) dikë e preku atje ku i dhemb më shumë, e preku në plagë; e preku në pikën më të dobët; i preku interesat vetjake. I ka duart me kallo ka punuar shumë; është punëtor i madh; gjithë jetën ka qenë punëtor.

- KALLP** mb. bised. Doli kallp doli jo ashtu si mendohej a si shpresohet.
- KAM** kal. Aty (këtu) ta kam! thjeshtligj. pikërisht për këtë gjë është fjala, pikërisht aty është çështja. Mezi e kam e mbaj a e ruaj me kujdes; e dua shumë, e kam me kimet.
- KAMARE** f. E ka gojën kamare
- KAMBANË** f. Të gjithë i bien një kambane të gjithë të njëjtën gjë thonë. Dëgjohej vetëm kambana e tij keq. të gjithë veprojnë ashtu siç thotë a urdhëron dikush, i cili përpiket të detyrojë të tjerët të pranojnë mendimin e udhëzimet e tij. E humbi rrumbi kambanën shih te RRUMB, ~I. Duhet dëgjuar të dyja kambanat duhen dëgjuar mendimet e të dyja palëve. Lule kambane (këmbore) bot. shih te LUL/E, ~JA.
- KANADEZ** mb. Plep kanadez bot. lloj plepi me trung të trashë e me kurorë të gjerë që bëhet deri 30 metra i lartë dhe jep shumë lëndë druri.
- KANAL** m. Miu i kanaleve (të zeza) zool. shih te MI, ~U2.
- KANAT** m. E hapur me të dyja kanatet e hapur krejt, e hapur tejndanë; e hapur për të gjithë.
- KANDAR** m. Pa kandar pa e llogaritur mirë, pa e menduar a pa e peshuar mirë (për një punë, veprim etj.); kot. I kërceu kandari diku u prek menjëherë e papritur; i hipi inati, u inatos. Nuk ngre (nuk çon) kandar (peshë) edhe poh. nuk është me vlerë, nuk ka rëndësi; nuk duhet marrë parasysh; nuk ndikon në një punë ose tek të tjerët (një fjalë, një mendim etj.). S'e ngre (s'e mban, s'e çon, s'e heq) kandari
- KANDIL** m. I mban kandilin dikujt përkrah e ndihmon dikë në një punë të pander-shme. S'i ka mbajtur kandilin (pishën) thjeshtligj. s'e di ç'ka bërë, nuk e ka ndjekur pas (kryesisht për çështje morale). E gjeti kokën e kandilit thjeshtligj., mospërf. e pësoi ashtu si e meritonte, atë kërkonte atë gjeti.
- KANONIERË** f. usht. Politika (diplomacia) e kanonierave politikë e imperializmit që mbështetet në dhunën e në agresionin.
- KANXHË** f. Hodhi kanxhat shih te HEDH. I hodhi kanxhat dikujt shih te HEDH. I vuri gojës kanxhën nuk foli më, e mbylli gojën, e kyçi gojën.
- KAP** kal. E paskan kapur dallgët dikë shih te DALLG/Ë, ~A. E kap për degësh shih te DEG/Ë, ~A. I kap dora i zë dora. S'e kap (s'e zë) me dorë diçka shih te DOR/Ë, ~A.
- KAPAK** m. Kapak floriri shih te FLORI, ~RI. I vuri kapak një çështjeje a një bisede etj. e mbylli; i dha fund, e përfundoi. I ka sahanët pa kapak flet hapur, pa doreza, copë a pa frikë. Më luajti (më iku) kapaku (tepeleku, tabani) i kokës (kafka, tepja e kokës)
- KAPELË** f. I heq kapelën (shapkën) dikujt shih te HEQ. E hedh (e vë) kapelën (kësulën, festen, qeleshen, takijen) mbi sy (mënjanë) shih te SY, ~RI. Ia la kapelën mbi ujë dikujt tall. shih tek UJ/Ë, ~I.
- KAPEM** vetv. S'di nga kapet diçka nuk di fare si përdoret (një aparat, një armë etj.). Kapet pas shkumave (për shkume) shih te SHKUM/Ë, ~A. Kapet pas degëve (e jo pas trungut) shih te DEG/Ë, ~A. U kap (u zu) për fyti (për gryke) me dikë shih te FYT, ~I. Kapet (mbahet) pas fjes së kashtës (së flokut, së perit) shih te FIJ/E, ~A. S'kapet qielli me dorë fj. u. shih te QIELL, ~I. Nga peri mund të kapet edhe lëmshi fj. u. shih te PE, ~RI.
- KAPËRCEHEM** vetv. Buka pa gëlltitur nuk kapërcehet fj. u. nuk mund të zgjidhen çështjet pa punë e përpjekje; për t'ia arritur një qëllimi duhen bërë përpjekje të njëpasnjëshme.
- KAPËRCEJ** kal. E kapërceu bregun e kapërceu masën e arsyeshme, e kapërceu kufirin. E kapërceu pragun dikush a diçka e kaloi masën a kufirin, shkoi më tej nga ç'duhej. E kapërceu (e kërceu, e hodhi) gardhin shih te GARDH, ~I. E

- kapërceu kufirin (masën) u bë i padurueshëm, nuk durohet dot më, e teproi. I kapërceu (i iku, i luajti) mendja (e kokës) shih te MENDJE, ~A. E kapërceu (e hodhi, e kaloi) lumin pa u lagur (pa lagur këmbët) shih te LAGEM. Flet për uthullën e kapërcen tek qumështi fj. u. shih tek UTHULL, ~A.
- KAPËRCYELL** m. E hodhi kapërcyellin shih te HEDH. Është me këmbë në kapërcyell nuk ka mundur ende ta kapërcejë një gjendje të vështirë ku ndodhet; nuk di nga t'ia mbajë; është duke kërkuar një zgjidhje.
- KAPËZ** f. I mban veshët kapëz rri me veshë ngritur që të mos i shpëtojë asnjë fjalë ose as edhe zhurma më e vogël.
- KAPISTALL** m. E heq (e tërheq) për kapistalli (për kapistre) dikë e detyron dikë të bëjë a të sillet si do ai; e heq për hunde. Ia ka hequr kapistallin (kapistrën) dikujt shih te HEQ.
- KAPISTËR** f. Ia hodhi kapistrën dikujt shih te HEDH. E heq (e tërheq) për kapistre (për kapistalli) dikë shih te KAPISTALL, ~I. Ia ka hequr kapistrën (kapistallin) dikujt shih te HEQ. Ia lëshoi (ia liroi) kapistrën (kapistallin, frerin) dikujt shih te LËSHOJ.
- KAPITAL** m. Kapital i vdekur libr. shih te VDEKUR (i,e). E marr diçka për kapital edhe moh. libr. e quaj si qind për qind të vërtetë atë që thuhet, e quaj si një gjë të rëndësishme; i vë më tepër rëndësi sesa duhet.
- KAPITAL** mb. Investime kapitale ek., zyrt. mjete që përdoren në industri ose në ndërtime për zgjerimin e fondeve themelore të ekonomisë popullore. Ndërtime kapitale ndërtime në industri ose në fusha të tjera të ekonomisë, që bëhen për zgjerimin e fondeve themelore të ekonomisë popullore.
- KAPITALIZËM** m. ek. Kapitalizëm monopolist faza më e lartë dhe e fundit e kapitalizmit, që karakterizohet nga sundimi i monopoleve, imperializmi.
- KAPOSH** m. Një kaposh (një këndes, një kokosh) plaçka shih te KËNDES, ~I. Kapardisej (krekosej) si kaposhi (si gjeli, si këndesi) majë plehut shih te GJEL, ~I. Mbeti (katandisi) kaposhi (kokoshi) një thelë shih te THEL/Ë, ~A. Pendë kaposhi bot. shih te PEND/Ë, ~A.
- KAPROLL** m. zool. I ka dalë gjel kaproll një pune shih te GJEL, ~I.
- KAPSOLLË** f. Sikur i ka ngrënë pula kapsollën shih te PUL/Ë, ~A.
- KAPUÇ** m. I doli kapuç me mëngë i doli ashtu si nuk e priste. Të qiste (të nxirrte) pa kapuç të shfrytëzonte deri në palcë, të rripte lëkurën (për matrapazin, kapitalistin etj.).
- KAQ** Kaq sa... përdoret si lokucion lidhëzor për të lidhur dy fjalë me marrëdhënie shkak-rrjedhim. Jo vetëm kaq fj. ndërm. përdoret për të treguar se, përveç kësaj që po thuhet, ka edhe të tjera, se kësaj që po thuhet i duhet shtuar diçka. Aq e kaq shih tek AQ. Kaq (aq) sa duhet shih te DUHET. Kaq (aq) e pati zakon. iron. shih tek AQ. Kaq (aq) dua! shih tek AQ. Kaq e ka çapin (hapin) shih te ÇAP, ~I 1. U bë edhe (një herë) kaq (aq) u gëzua shumë, iu bë zemra mal. Sikur kaq (sa të kalit) ta bësh dhëmbin! shih te DHËMB, ~I.
- KARABOJË** f. U bë karabojë u vrenjt a u nxi në fytyrë; u zemërua e u inatos.
- KARANTINË** f. I vë karantinë diçkaje (vendos karantinë për diçka) libr. ndaloj, nuk lejoj hyrjen e diçkaje; e kufizoj a e ndaloj përhapjen e diçkaje.
- KARAR** m. bised. S'i fle karari (mendja) s'i mbushet mendja; është i pavendosur. S'i gjendet karari dikujt a diçkaje
- KARAT** m. Burrë (njeri) njëzet e katër karatësh libr. burrë që gjykon me pjekuri dhe nderohet nga të gjithë.
- KARBON** m. Letër karboni letër e lyer me bojë që përdoret zakonisht në daktilograf për të shtypur një shkrim në disa kopje.

- KARKALEC** m. Ngeci karkaleci tall. thuhet kur dikush ngec në një punë ose bie ngushtë dhe nuk di si t'ia bëjë.
- KARMË** f. Ia dha karmën dikujt e përzuri me të shtyra e të shara, e dëboi, i dha dërmën.
- KARTË** f. I hapi (i zbuloi) kartat (letrat) shih te HAP. Kartë (letër) e djegur shih te DJEGUR (i, e). Me karta (me letra) të hapura shih te HAPUR (i, e). Kështjellë (kala) prej karte (prej letre) shih te KËSHTJELL/Ë, ~A. Iu dogjën kartat (letrat) ndër (në) duar dikujt shih te DIGJEM. T'i lexon (t'i këndon) kartat (letrat) në xhep shih te LET/ËR, ~RA. Luaj (hedh, përdor) kartën (letrën, gurin, zarin) e fundit shih te FUNDIT (i, e). Shënim në kartën e regjistrimit një nga masat ndëshkimore me karakter edukimi.
- KARTOLINË** f. Kartolina e zjarrit usht. plani dhe skica e luftimit, që përmban të dhëna për pozicionet e zjarrit, vendosjen e armëve të zjarrit, zonat që mund të mbeten të vdekura nga zjarri etj.
- KARVAN** m. Ylli i Karvanit astr. Afërdita.
- KARRAVESH** m. E mori karravesh (fjalën) e keqkuptoi atë që u tha, e mori tjetër për tjetër, e mori ters.
- KARRIGE** f. Rri (qëndron) mbi dy karrige keq. i bën qejfin edhe njërit edhe tjetrit për të përfituar nga të dy krahët; nuk është parimor dhe i qëndrueshëm në pikëpamjet e tij.
- KARROÇË** f. Kalë karroce shih te KAL/Ë, ~I.
- KARROQE** f. U bë karroqe (tapë, thumb, livadh, xurxull, bërryl, fushë) thjeshtligj. shih te BËHEM.
- KASAP** m. Shkoi (vajti) si cjapi te kasapi shih te CJAP, ~I.
- KASKË** f. Kaskat blu ushtarë që dërgohen në një vend nga Organizata e Kombeve të Bashkuara gjoja për të mbajtur rregullin e qetësinë.
- KASOLLE** f. Prish shtëpi e bën kasolle fj. u. shih te SHTËPI, ~A.
- KASTRAVEC** m. bot. Mos i shit kastravecë bostanxhiut! shih te BOSTANXHI, ~U. Mbolli bostan e i dolën kastravecë iron. shih te MBJELL.
- KASHTË** f. bot. Flakë (zjarr) kashte vrull që nuk mban për një kohë të gjatë, nismë që nuk zgjat shumë. Nuk ha kashtë (bar) shih te HA. U bënë kashtë e koqe u shpërndan ëandej-këtej, u përhapën nga të katër anët; u shpartalluan. I bie kashtës përmbi kallinj është mendjemadh. Dimri ha kashtë (gurë, gozhdë) shih te DIM/ËR, ~RI.
- KAT** m. Hap kat e (më) kat hap të dyja kanatet, hap krejt (një dritare, një derë etj.).
- KATANDIS** kal. Katandisi (mbeti) kaposhi (kokoshi) një thelë shih të THEL/Ë, ~A.
- KATËR** num. them. Nuk bëhem dot katër jam shumë i zënë me punë, kam shumë punë, të cilat nuk mund t'i kryej dot të gjitha njëherësh. I hyn era në të katër anët shih tek ER/Ë, ~A I. E hodhi (e flaku, e nxori, e la) në mes të katër rrugëve (në rrugë, në mes të rrugës, në rrugë të madhe) shih te RRUG/Ë, ~A. Mbeti në mes të katër udhëve (udhëve, në mes të udhës, në udhë të madhe) shih tek UDH/Ë, ~A. Punon sa për katër (veta) punon shumë, është punëtor i madh e i palodhur. Vrapoi (rendi, iku, ia mbathi) me të katra vrapoi duke vënë të gjitha forcat (zakonisht kur e ndjek dikush), vrapoi sa i hanin këmbët. Bën në katër liq dikush shih te LIQ, ~TË. I bëj sytë katër shikoj me kujdes të madh, përpiqem të shoh gjithçka e të mos më shpëtojë asgjë; rri syhapët.
- KATËRQIND** num. them. Burrë katërqind derhemë shih te DËRHEM, ~I. Ka katërqind mendje nuk ka një mendim të përcaktuar qartë; i vijnë mendime të ndryshme; ndryshon shpejt mendim. Kudo oka katërqind derhemë është shih tek OK/Ë, ~A.
- KATËRSH** ndajf. U bë katërsh u përpoq me të gjitha forcat, u lodh shumë me një punë. Është ta çash katërsh shih te ÇAJ.

- E ndan (e çan) qimen me katërsh (me dysh) shih te QIM/E,~JA.
- KATOLIK** mb. Është më katolik se papa tall. mbron me fanatizëm të tepruar një ide, një pikëpamje ose një çështje.
- KATRAGJYSH** m. Gjysh katragjyshi (stërgjyshi) shih te GJYSH,~I.
- KATRAN** m. Katran me bojë shih te BOJ/Ë,~A.
- KATROR** mb. E futi (e vuri) në katror dikë libr. e futi në një gjendje të tillë, zakonisht të keqe, nga e cila nuk shpëton dot; e mbërtheu mirë. Mbjellje me fole katrore bujq. shih te
- KATUA** m. E bëri barkun katua
- KATUND** m. Ia fut katundit thjeshtligj. flet kot, pa gjykuar thellë; bën një veprim të pamatur. Sa poshtë ka rënë katundi mospërf. shih te POSHTË.
- KAUÇUK** m. Fjalim kauçuk fjalim pa një ide qendrore, ku nuk mbahet një qëndrim parimor ndaj problemit që shtrohet dhe që lejon t'i kuptosh gjërat si të duash.
- KAVALL** m. I bie kavallit (fyellit) flet kot, mundohet më kot t'ia mbushë mendjen dikujt. Është vrima e fundit e kavallit (bishti i kavallit) është njeri pa rëndësi, fjala e tij nuk ngre peshë dhe nuk dëgjohet nga të tjerët. Peshk kavall zool. shih te PESHK,~U.
- KAZAN** m. Balli i kazanit shih te BALL/Ë,~I. Fundi i kazanit shih te FUND,~I. Iu shpua kazanit dikujt nuk i doli ashtu siç e mendonte, i doli huq. Zien kazanit flasin njerëzit a bota për diçka; flitet; zhvillohet një veprimtari e ethshme. Zien si kazan t'uhet për dikë që flet me vete a që është shumë i shqetësuar, për shkak se ka diçka që e mundon, por nuk e thotë hapur. Ziejnë në një kazan shih te ZIEJ. Mos e prish kazanin (jahninë) për një qepë shih te QEP/Ë,~A.
- KAZERMË** f. Ushtri e kazermës keq. ushtri që i ka shkëputur lidhjet me masat e gjera të popullit, që zbaton formalisht rregulloret dhe nuk njeh kërkesat e Luftës Popullore.
- KAZMË** f. I vuri kazmën diçkaje e shkatërroi a e prish i nga themelet atë që ishte bërë; e dëmtoi rëndë.
- KEQ** mb. sh. Për fat të keq shih te FAT,~I. Farë e keqe (e ligë) shar. i thuhet dikujt që ka prejardhje të keqe shoqërore ose që është i keq si njeri. Gojët (gjuhët) e këqija (e liga) shih te GOJ/Ë,~A 7. Pa gjë të keqe në mënyrë të çiltër, me çiltëri, pa të keq. Si pa gjë të keqe pa i bërë përshtypje; pa e prishur gjakun fare, sikur të mos ketë ndodhur asgjë, me lehtësinë më të madhe, pa pikë përgjegjësie. Ishte me orë të këqija (të liga) shih tek OR/Ë,~A II. Në vend të keq (të lig) euf. shih te LIG (i), ~Ë (e). E ka llapën (gjuhën, gojën) të keqe thotë fjalë të këqija, është gojështhurur. Ka mendje të keqe (të ligë) mendon për keq; mendon të bëjë ndonjë veprim që mund të sjellë dëm a fatkeqësi. E ka (e sheh, e shikon, e vështron) me sy të keq (të lig, të shtrembër) shih te SY,~RI. E ka thuan të keq shih te THUA, THOI. Janë parë me hënë të keqe shih te HËN/Ë,~A. Bar i keq (i lig) bot. shih te BAR,~I I. Ferrë e keqe bot. shih te FERR/Ë,~A. Shkoza e keqe bot. shkozëzeza.
- KEQ** ndajf. Sa keq! sa gjendje e keqe! Si mos më keq shumë keq. Mirë a keq ashtu si munda ose aq sa munda, ashtu si dita; në një farë mënyre. I doli keq pati pasoja të hidhura. E ka keq me dikë nuk është në marrëdhënie të mira me dikë, nuk i shkon fjala tek ai, nuk merret vesh mirë me të; nuk e do, e ka inat. S'e ka keq nuk është mendim i keq, nuk mendon keq, është diçka e arsyeshme. Mori për keq u keqësua (nga shëndeti etj.). Ka shkelur keq shih te SHKEL. Shkojnë keq grinden, zihen. Shtie keq shtie fitime. Më vjen keq hidhërohem, dëshpërohem a më ther në zemër, më dhimbset.
- KEQE** f. Na mori të keqen (të ligën) mospërf. shih te MARR. Të marrsha të keqen (të ligën)! shih te MARR. Na marrtë të këqijat (pleshtat, pleshtat e tartabiqet) mospërf., thjeshtligj. shih te MARR. Më

- marrsh të keqen (të ligat)! mallk. shih te MARR.
- KËLYSH** m. Këlyshë sokaku shih te SOKAK,~U. Bleu qen dhe i doli këlysh nuk i doli ashtu si e mendonte, i doli më pak a më keq seç e priste.
- KËLLAS** kal. Ç'i këllet brirët (bretkun)! dikujt a diçkaje ç'merresh me të, ç'i vë rëndësi!
- KËLLK** m. Iu drodhën këllqet u frikësua shumë.
- KËMBEJ** kal. Këmbeu (shkëmbeu, ndërroi, bëri) fjalë me dikë shih te FJAL/Ë,~A.
- KËMBË** f. Si me këmbë keq, jo mirë, jo në rregull, pa kujdes. Edhe me një këmbë medoemos, detyrimisht. Bëj këmbë shih te BËJ. Ka bërë këmbë diçka iron. e kanë vjedhur, e kanë marrë; është zhdukur. Më ranë (më dolën) këmbët u lodha duke kërkuar dikë a diçka gjithandej. U ra (ua mbathi, ua dha) këmbëve iku me vrap, iku me të katra (zakonisht nga frika). I ra këmbës
- KËMBËZ** f. E mban (e ka) gishtin në këmbëz (rri me gisht në këmbëz) rri ose është gati për luftë, rri syhapët për t'u mbrojtur në rast se armiku e sulmon. Është këmbëza e urës shih tek UR/Ë,~A.
- KËMBIM** m. Në këmbim (me një emër në r. gjinore) libr. në vend..., për të zëvendësuar diçka. Monedhë këmbimi (shkëmbimi) libr. mjet për të bërë allishverishe, matrapazllëqe a dallavere në kurriz të dikujt. Këmbimi (shkëmbimi) i lëndëve biol. shih te SHKËMBIM,~I.
- KËMBORË** f. Dash me këmborë
- KËMISHË** f. Në këmishë vetëm me ato rroba që ka veshur në trup, i varfër; pa pajë. Në fill të këmishës shih te FILL,~I. Më ra këmisha u habita shumë, mbeta i habitur. Iu drodh këmisha (në trup, në shtat) u tmerrua nga frika, u frikësua shumë. Ka lindur
- KËNAÇE** f. Bie shi me kënaçe bie shumë shi, bie shi me shtamba. Prish bucela e bën kënaçe shih te BUCEL/Ë, ~A.
- KËND** m. Anë e kënd (kënd më kënd)
- KËNDES** m. Një këndes (një kokosh, një kaposh) plaçka shumë pak plaçka. I pjell edhe këndesi (kokoshi) dikujt i vjen e mira nga çdo anë, i vijnë të mirat edhe andej nga nuk i pret, është me fat të madh, i ecën shumë. Kur këndoi këndesi (gjeli) i parë shih te GJEL,~I. Kur këndoi këndesi (gjeli) i tretë shih te GJEL,~I. Kapardisej (krekosej) si këndesi (si gjeli, si kaposhi) majë plehut shih te GJEL,~I. Pesha e këndesit sport. kategori e boksierëve, e ngritësve të peshave dhe e mundësve me peshë nga 50 kilogramë e 800 gramë deri 53 kilogramë e 520 gramë.
- KËNDOJ** I kal. I këndon alilluja dikujt shih tek ALILLUJA. I këndoi fermanin vjet. shih te FERMAN,~I. I këndon gishtit dikujt shih te GISHT,~I. E këndoftë hoxha (prifti)! mallk. vjet. shih te HOXH/Ë,~A. I ka kënduar huti dikujt shih te HUT,~I. I këndoi kollofruthin thjeshtligj. shih te KOLLOFRUTH,~I. I ka kënduar kukuvajka dikujt shih te KUKUVAJK/Ë, ~A. Nuk këndon me perde dikush shih te PERD/E,~JA. Këndon qyqja për dikë shih te QYQ/E,~JA. I ka kënduar qyqja dikujt a diçkaje shih te QYQ/E,~JA. I ka kënduar qyqja në derë shih te QYQ/E,~JA. S'këndon më ajo qyqe shih te QYQ/E,~JA. I këndoi në tru tall. shih tek TRU,~RI. Më këndon veshi
- KËNDOJ** II kal. bised. Ti këndon (t'i lexon) kartat (letrat) në xhep shih te XHEP,~I. Vetë këndon, vetë shkruan (vetë shkruan, vetë vulos) shih te SHKRUAJ.
- KËNETË** f. Buf kënete shar. njeri i shëndoshë e i plogët, përtac e i trashë nga mendja.
- KËNGË** f. Dredh këngën shih te DREDH. Këngë (lahutë) e butë muz. shih te BUTE (i,e). Këngë mbi krah (majë krahut) shih te KRAH,~U. Kënga e mjellmës libr. shih te MJELLM/Ë,~A.

- Kënga e Mukës diçka e vjetër që është thënë e stërthënë, diçka e njohur që është përsëritur vazhdimisht. Disa jashtë valles dinë shumë këngë fj. u. shih te VALL/E,~JA.
- KËPUCË** f. Ia mbathi këpucët dikujt mospërf. shih te MBATH. Nuk e ka vrarë këpuca (samari) shih te VRAS. Doli me këpucë të kuqe dikush iron. shih te KUQ (i), ~E (e). Ia dha këpucët (opingat) në dorë mospërf. e përzuri, e dëboi (një njeri të padëshirueshëm). I hodhi (i futi) një gur në këpucë (në shollë, në opingë) dikujt shih te GUR,~I. I ktheu këpucët (këmbët, potkonjtë, thundrat) nga dielli përb. shih te DIELL,~I. Iu ngjit si bagja (si balta) pas këpucës dikujt shih te BAJG/Ë,~A.
- KËPUSHË** f. Iu bë këpushë (ferrë, rriqër, çimkë, rrodhe) shih te BËHEM.
- KËPUT** kal. Hiq (tërhiq) e mos e këput shih te HEQ. Këput (thyej) arrëzën (qafën)! keq. shih tek ARRËZ~A. Ia këputi frymën dikujt ia këputi shpirtin, e mallëngjeu shumë. Na këputi ijët
- KËPUTEM** vetv. U këput ndër vete euf. u rrënxua. Iu këput rripi i pallës shih te RRIP,~I.
- KËPUTUR** mb. Si yll i këputur shumë i bukur (për fëmijët e për të rinjtë).
- KËRBAÇ** m. Me kulaç e me kërbaç herë me të mirë e me premtime të bukura, herë me kërcënime, me shtrëngim e me dhunë.
- KËRBIŠHT** m. kryes. sh. anat. Më ranë (m'u këputën) kërbishtet u lodha shumë, më ra bretku.
- KËRCAS** jokal. Kërcet (shtrëngon) dhëmbët shih te SHTRËNGOJ. I kërciti (i skërciti) dhëmbët dikujt shih te SKËRCIT. Kërcet gishtërinjtë shih te GISHT,~I.
- KËRCEJ** jokal. I kërcëu (i hipi, iu ndez, iu ngrit, e zuri) damari shih te DAMAR,~I. E kërcëu
- KËRCU** m. U bë kërcu u tha nga të ftohtët, u bë si dru. Kërcu përmbi shkarpa (përmbi samar) diçka e tepërt, mbingarkesë; barrë tepër e rëndë; bela.
- KËRKOJ** kal. Sa të kërkosh sa të duash, me shumicë, shumë. Kërkon fjalë shih te FJAL/Ë,~A. Kërkon hënën shih te HËN/Ë,~A. Kërkon për mokra keq. shih te MOK/ËR,~RA. Kërkon sherr ngacmon dikë, e nxit që të grindet me të. Kërkoftë murin me dorë! mallk. shih te MUR,~I.
- KËRMË** f. Si sorrat pas kërmës keq. shih te SORR/Ë,~A.
- KËRMILL** m. Si kërmijtë (si boblat) pas shiut mospërf. pasi ka shpëtuar nga rreziku.
- KËRNALLE** f. I dha kërnallen i dha dërrmën.
- KËRP** m. bot. KËRP DHEU zool. Urith.
- KËRTHIZË** f. Sikur i ka prerë kërthizën sikur i ka bërë një të mirë me rëndësi jetësore, sikur i ka shpëtuar jetën. M'u shpërdrodh kërthiza shih te SHPËRDRIDHEM.
- KËRRABË** f. U bë kërrabë
- KËRRABËZ** f. I ngeli kërrabëza i doli përpara një pengesë dhe i ngeci puna.
- KËRRUS** kat. Nuk e kërrus (nuk e ul, nuk e përkul) kurrizin (shpinën) edhe poh. nuk i përulëm dikujt, nuk i nënshtrohëm.
- KËSMET** m. bised. Iu bë kësmet (fat, risk) shih te BËHEM. I doli kësmeti sipas paragjykimeve: e gjeti burrin; u fejuua a u martua, i doli fati (për vajzat).
- KËSULË** f. Pa kësulë e pa opinga pa pasur asgjë. E hodhi (e vuri, e ktheu) kësulën (kapelën, festen, qeleshën) mbi sy (mënjatë) shih te SY,~RI. E ka mendjen (në) majë (të) kësulës
- KËSHTJELLË** f. Kështjellë (kala) prej karte (prej letre) keq. pikëmbështetje e dobët. Bën (ndërton, ngre) kështjella në erë (në ajër) keq. bën projekte e plane që nuk mund të vihen në jetë; krijon me mend gjëra që nuk mbështeten në realitetin, sheh ëndrra me sy hapur.

- KËSHTU** ndajf. Kështu që lidh. pra; prandaj; për këtë arsye. Si kështu?! përdoret në fjalitë pyetëse a pasthirmore për të përforcuar pyetjen ose habinë. Kështu e kështu përdoret për të mos përmendur edhe një herë me radhë ato që kemi thënë ose kemi treguar më përpara. Kështu ose ashtu sido që të jetë, medoemos. Ku (për ku) kështu? ku po vete (po vemi) tani? Kështu e tutje këtej e tutje, paskëtaj. E kështu me radhë përdoret në fund të një fjalisë për të përmbledhur një sërë gjërash a veprimesh që gjenden ose bëhen radhazi. Kështu (ashtu) i do mushka drutë shih te MUSHK/Ë, ~A. Kështu e ka zënë mullëzën shih te MULLËZ, ~A.
- KËTEJ** Andej e këtej (sa andej këtej) shih tek ANDEJ. Dhashë andej, dhashë këtej (andej, këtej) shih tek ANDEJ. Këtej i hyri, këtej i doli mospërf. shih te HYJ. Këtej të pi verën, andej të shan derën shih te VER/Ë, ~A II.
- KËTEJMË** mb. Së këtejmi që këtej; që nga kjo anë; prej këtij vendi.
- KËTILLË** dëft. I atillë e i këtillë shih tek ATILLË (i, e). Diçka e këtillë pak a shumë kjo gjë, afërsisht kështu.
- KËTO** dëft. Në këta e sipër ndërkaq, në këtë kohë.
- KËTU** ndajf. Këtu drejt në këtë drejtim. Këtu të dua! shih te DUA. Këtu (aty) të kam! shih te KAM. Këtu ma solli (ma solli këtu) më inatosi shumë, ma solli në majë të hundës. Diç (diçka) luan këtu (në këtë mes)! shih te LUAJ. Bam këtu, bam atje (bam këtej, bam andej) shih te BAM. Kokën këtu, këmbët atje shih te KËMB/Ë, ~A.
- KIAMET** m. bised. Për kiamet
- KIKËZ** f. Iu holluan kikëzat dikujt
- KILE** I f. bised. Ka me kile ka shumë, ka me okë, ka sa të duash. Nuk e ha kilen për okë edhe poh. shih tek OK/Ë, ~A.
- KILOMETËR** m. E bën hapin kilometër ecën me hap të shpejtë, shkon shumë shpejt përpara; përparon me hapa vigane.
- KILLË** f. vjet. Kalli e killë kalli i mbushur mirë, kalli me kokrra të mëdha e të plota; prodhim drithi shumë i mbarë.
- KIMET** m. bised. E kam (e mbaj) me kimet dikë a diçka e mbaj mirë, e ruaj dhe kujdesem shumë për të, e kam të shtrenjtë (sepse e kam të vetëm ose sepse nuk kam shumë të tillë).
- KISHË** f. Gjeti kishë (xhami) ku të falet iron. kërkon mbrojtje atje ku s'duhet, shkoi të zgjidhë një çështje atje ku nuk ia zgjidhin.
- KIZË** f. I bëri këmbët kizë (baras, çift) mospërf. vdiq.
- KJO** dëft. Kjo është ç'është shih te JAM.
- KLLAPË** f. Ia nxorën me kllapë ia nxorën me zor (një fjalë a një mendim), ia nxorën si me grep.
- KLLOÇKË** f. E vuri kllloçkë dikë e shtroi, e bëri të rrijë urtë. Janë si zogjtë e kllloçkës janë të vegjël e të dobët, kanë nevojë për mbrojtje e për kujdes të veçantë. Mbetën si zogjtë pa kllloçkë mbetën pa mbrojtje e pa drejtues, nuk ka kush të kujdeset më për ta (kryesisht për të vegjlit kur mbeten jetimë). Të vjedh vezën nën kllloçkë është vjedhës shumë i shkathët.
- KLLUKË** f. Vezë kllukë njeri shëndetlig e i dobët, që sëmuret shpesh ose preket shpejt nga sëmundjet.
- KOBURE** f. Me dorën në kobure gati të përdorë forcën e armëve; duke u kërcënuar me armë. Me kobure në brez me kërcënim a me dhunë; duke shitur trimëri e mend. Është bërë për t'i rënë me kobure (me dyfek, me pushkë) shih te DYFEK, ~U. E do me kobure (me revole) kokës është kokëfortë, nuk merr vesh me fjalë. E ka mendjen kobure është kokëfortë, nuk merr vesh. Koburja bosh tremb dy veta fj. u. koburja bosh tremb edhe atë që e mban (se e di që është bosh e nuk e vret dot tjetrin) edhe atë tjetrin (që nuk e di se koburja është bosh).
- KOC** m. krahin. E shan me rroc e me koc shih te RROC.

KOCKË f. Deri në kockë shumë thellë, deri në palcë. I ranë kockat u lodh shumë së bëri një punë; u dërrmua. Deri sa të më bien kockat derisa të jem gjallë, derisa të marr frymë. Cipë e kockë shih te CIP/Ë,~A. I kanë dalë kockat është dobësuar shumë. S'ka kockë (për të bërë një punë) nuk ka fuqi, nuk është në gjendje ose nuk është i zoti për të bërë atë punë. Kjo kockë e di unë vetë, që kam hequr, e di si është puna. La kockat (lëkurën, leshtë) keq.

KODËR f. Kodra pas bregut gjepura, dokrra. Flet (hidhet) kodër më kodër flet kuturu, pa lidhje e pa arsyetim. Të hedh kodër më kodër nuk tregon qartë e në mënyrë të përpiktë atë që duhet ose atë që i kërkohet (zakonisht për t'iu larguar çështjes kryesore); kalon nga një çështje në tjetrën pa i sqaruar. Ngre kodra përmbi det iron. përpiqet të bëjë punë që janë të pamundura të bëhen, bën kështjella në erë. Gjahu në breg e qëllon në kodër shih te GJAH,~U.

KOEFICIENT m. mat. Koefficienti i punës së dobishme raporti ndërmjet sasisë së punës së dobishme që bën një makinë a një mekanizëm dhe sasisë së energjisë që harxhon.

KOFIN m. Si kofini (si koshi) pas së vjeli (pas të vjelave) tepër vonë, pasi ka mbaruar puna, kur s'duhet më, kur s'hyn më në punë.

KOHË f. Koha e artë (shekulli i artë) shih tek ARTË (i, e). Kohë (orë) e vdekur shih te VDEKUR (i, e) 6. Që në kohën e qyqes shih te QYQ/E,~JA. Në kohën që (kur)... ndërsa, kur, gjatë. Për sa kohë që... përderisa. Për aq kohë sa... përderisa. Kohë më kohë (kohë pas kohe, nga koha në kohë) herë pas here, në periudha pak a shumë të largëta e jo rregullisht. Në kohën e vet kur ishte në fuqi, kur kishte pushtet në dorë. Orë e kohë shih tek OR/Ë,~A I. Orë e pa kohë shih tek OR/Ë,~A I. Në të njëjtën kohë gjithashtu, krahas kësaj. Njëherë e një kohë (njëherë motit) shih te NJËHERË. Në kohën e baba Qemos shumë kohë më

parë, në një periudhë të largët sa nuk mbahet mend mirë. E ka shkelur koha dikë shih te SHKEL. Vret kohën shih te VRAS. Kroi (pusi) i mirë njihet në kohë të thatë fj. u. shih te KRUA, KROI.

KOJ kal. Me lugë të kon, me bisht të verbon keq. shih te LUG/Ë,~A.

KOKË f. 4. fig. Kjo pjesë e trupit të njeriut si qendra e të menduarit, truri dhe aftësia e tij për të gjykuar e për të arsyetuar; mendja, arsyeja; njeriu si bartës i ideve e i pikëpamjeve të ndryshme, i aftësive të veçanta mendore (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Njeri me kokë njeri me aftësi mendore të madhe. I punon koka.

5. Jeta e njeriut (si gjë shumë e çmuar); vetja (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Mik (shok) me kokë mik (shok) që jep edhe jetën për mikun (për shokun). Lëmë (japim) kokën për atdheun. Humbi kokën. E pagoi (e lau) me kokë.

... për kokën e ... shumë i mirë, shumë i bukur, shumë i zoti etj., aq i mirë, aq i bukur, aq i zoti etj. sa s'bëhet (përdoret me një emër të përsëritur; p.sh. djalë për kokën e djalit, darkë për kokën e darkës etj.). Më avullon koka shih tek AVULLOJ. I është bërë mendja... (koka...) shih te BËHEM. I bie kokës (në kokë) dikuajt a diçkaje

KOKËRDHOK m. Të ha kokërdhokun e syrit

KOKËRR f. Kokërr për kokërr me imtësi, holësisht, një për një. Deri në një kokërr gjithçka, pa lënë asgjë. U bë kokërr (qiqër) shih te QIQ/ËR,~RA 2. Si kokërr molle (thane) shih te MOLL/Ë,~A. Kokrra e motit rrufeja. Pemë pa kokrra njeri që s'të mbaron punë, njeri nga i cili nuk ke dobi; njeri që punon, por nuk ka përfundime të mira në punë; diçka e pafrytshme. I rri (i qëndron) kokërr nuk i trembet fare, i rri ballë për ballë e me guxim. Bathë, bathë, po një kokërr shih te BATH/Ë,~A. U bënë kashtë e kokërr u shpërndanë andej-këtej; u shpartalluan. Bie (fle, rri) në kokërr të shpinës

- bie në kurriz; shtrihem në shpinë. Bluan si mulliri pa kokrra (pa ujë) flet kot më kot, thotë fjalë boshe, grin kot. S'e ha atë kokërr ulliri shih te HA. E ka syrin kokërr (pishë) shih te PISH/Ë,~A. Të merr kokërrën (koqen) e melit para gjelit është shumë i shkathët. Ndaj bykun (kashën) nga kokrrat shih te BYK,~U. Sa thana janë kokrra s'bëjnë fj. u. shih te THAN/Ë,~A. Kokrra e keqe (e zezë) mjek. pika e diellit.
- KOKO** f. fëm. I bëri paratë koko i harxhoi paratë kot, i bëri paratë rrush e kumbulla.
- KOKOSH** m. Një kokosh (një këndes, një kaposh) plaçka shih te KËNDES,~I. I pjell edhe kokoshi (këndesi) dikujt shih te KËNDES,~I. Mbeti (katandisi) kokoshi (kaposhi) një thelë shih te THEL/Ë,~A.
- KOLERË** f. Kolera e shpendëve veter. sëmundje e rrezikshme ngjitëse e shpendëve, që shkakton dobësimin e përgjithshëm dhe ngordhjen e shpejtë të tyre.
- KOLONË** f. Kolona e pestë
- KOLOS** m. Kolos me këmbë argjile mospërf. i madh e i fortë në dukje, por në të vërtetë shumë i dobët.
- KOLLAJ** ndajf. bised. E gjeti për kollaj shih te GJEJ.
- KOLLË** f. Kolla e keqe (e zezë) mjek. tuberkulozi, veremi. Kolla e mirë (e ëmbël, e bardhë) mjek., euf. sëmundje ngjitëse e fëmijëve zakonisht deri shtatë vjeç, që shfaqet me kollë të fortë e të gjatë.
- KOLLOFRUTH** m. I këndoi kollofruthin thjeshtligj. e braktisi dikë a diçka; hoqi dorë prej një pune.
- KOLLOVAR** m. Bëhet kollovar i dikujt mospërf. sillet e vepron ashtu siç i thotë dikush tjetër.
- KOMANDË** f. Politika në komandë! politika mbi të gjitha!, të vëmë në krye politikën!, të udhëhiqemi nga politika! Vë në komandë vë në krye, vë mbi të gjitha të tjerat.
- KOMBËTAR** mb. Hero Kombëtar shih te HERO,~I. Pakicë kombëtare popullsia e huaj që bën pjesë në një shtet, ku shumicën dërrmuese e përbëjnë pjesëtarët e një kombi tjetër.
- KOMISAR** m. Komisar i dritës lart. shih te DRIT/Ë,~A 6.
- KOMUNË** f. Komuna e Parisit hist. shtet revolucionar i masave punonjëse, që u krijua në Paris pas fitores së revolucionit të vitit 1871 dhe që ishte përpjekja e parë në botë për të vendosur diktaturën e proletariatit.
- KOMUNITET** m. Komuniteti primitiv formë organizimi e shoqërisë pa klasa në komunizmin primitiv, që mbështetet në pronën kolektive mbi mjetet e prodhimit, në shpërndarjen e barabartë të tij dhe në vetëqeverisjen e brendshme; bashkësi primitive.
- KOMUNIZËM** m. Komunizmi shoqëror teori shkencore revolucionare e klasës punëtore, që vërteton pashmangshmësinë e zhdukjes së shoqërisë kapitaliste e të fitores së shoqërisë komuniste nëpërmjet revolucionit proletar, jep ligjësonitë e përgjithshme të kalimit nga kapitalizmi në komunizëm dhe të ndërtimit të shoqërisë komuniste nëpërmjet vendosjes së diktaturës së proletariatit. Komunizmi utopik një varg doktrinash paramarksiste, të cilat nuk mbështeteshin në ligjet objektive të zhvillimit të shoqërisë, por niseshin nga dëshirat dhe ëndërrimet për të krijuar një shoqëri pa klasa, me barazi ekonomike e shoqërore pa kryer revolucionin proletar dhe pa vendosur diktaturën e proletariatit. Komunizmi i luftës politike ekonomike e zbatuar nga pushteti sovjetik në kohën e luftës civile e të intervencionit, sipas së cilës fshatarët i dorëzonin shtetit të gjitha tepricat e prodhimeve ushqimore me një çmim të caktuar. Komunizmi primitiv rendi i parë ekonomiko-shoqëror në periudhën e lashtë fisnore kur nuk kishte klasa, i cili mbështetet në pronën e përbashkët mbi

- mjetet e prodhimit e mbi produktet dhe në vetëqeverisjen e brendshme.
- KONAK** m. vjet. Fjalë (vërejtje) me konak fjalë (vërejtje) e thënë me vend, fjalë a mendim i pjekur që zë vend. Bëri konak shkoi mysafir diku; shkoi diku për të kaluar natën. Iu bë konak dikujt e strehoi dikë; e ndihmoi që të fshihet në shtëpinë e tij. Sheh tym e bën konak iron. shih tek TYM,~I.
- KONDAK** m. Luajti nga kondaku luajti mendsh, u çmend.
- KONFERENCË** f. I mban konferencë dikujt iron. shih te MBAJ. Konferencë shtypi shih te
- KONSERVATOR** mb. Parti konservatore parti politike reaksionare e borgjezisë, parti e konservatorëve
- KONTROLL** m. Flet pa kontroll flet gjëra jo të menduara mirë, flet pa përgjegjësi, flet në tym.
- KONTROLLOJ** kal. Nuk e kontrollon (dot) veten nuk është në gjendje të zotërojë veten, nuk di çfarë bën, s'është në vete; nuk përmbahet dot.
- KONVEJER** m. Konvejeri i gjelbër bot. vargu i rezervave ushqimore, që përbëhet prej bimësh të njoma (tërfil, jonxhë, lakër, foragjere etj.).
- KOPALLA** vet. sh. Çan kopalla (dërrasa, dokrra) shih te ÇAJ.
- KOPAN** m. E la (e bëri) kopan dikë e rrahu shumë dikë, e bëri për vdekje; e la të vdekur.
- KOPËR** f. bot. Kopër qeni maraskë, kopër e egër.
- KOPIL** m. Çelës kopil çelës që mund të hapë shumë dyer. Ja la kopilin (doçin, dobiçin) në derë (në prehër) thjeshtligj. ia veshi, ia ngarkoi fajin a gabimin dikujt tjetër, e bëri turpin vetë e ia la një tjetri. Ta vë (ta hedh) kopilin (dobiçin) në prehër thjeshtligj. është i tillë që fajin e vet ia hedh tjetrit.
- KOPSHT** m. Kopsht (bahçe) me lule vend i lulëzuar dhe i begatshëm, ku njerëzit jetojnë të lumtur. Qen kopshti (kopshtari, bahçevani) keq. njeri që as vetë nuk e përdor diçka, as të tjerët nuk i lë ta përdorin, njeri që nuk e gëzon vetë një të mirë dhe nuk i lë as të tjerët ta gëzojnë. E kam (jemi) lakra (presh) në kopsht dikë (me dikë) shih te LAK/ËR,~RA. Nuk e nxjerr dot pulën nga kopshti shih te PUL/Ë,~A.
- KOPSHTAR** m. Qen kopshtari (kopshti, bahçevani) shih te KOPSHT,~I.
- KOQE** f. U bënë kashtë e koqe shih te KASHT/Ë,~A. Bënte koqen e qejfit (e pallës) shih Bënte kokrrën e qejfit te KOK/ËRR,~RRA. Të merr koqen (kokrrën) e melit para gjelit shih te KOK/ËRR,~RRA. Koqja e mirë mjek., euf. lëmsh i vogël në ngjyrë të errët, që formohet zakonisht në mollëzat e gishtërinjve e më rrallë në pjesë të tjera të krahut dhe që të jep dhembje të forta. Koqja e zezë (e ligë) veter., mjek. plasja.
- KORB** m. As rob, as korb shih te ROB,~I. Rrol e korb shih te RROL,~I. Mbetën si zogjtë e korbit mbetën rrugëve, pa ndihmë e përkrahje. U shpërndanë si zogjtë e korbit u shpërndanë nga të katër anët dhe asnjëri nuk di ku gjendet tjetri, u shpërndanë andej këtej në vende të ndryshme (për njerëzit). Kur të zbardhet penda e korbit kurrë, asnjëherë. Sa të zbardhet penda e korbit gjithnjë, pa fund, gjithë jetën.
- KORDON** m. Kordon sanitar
- KORDHË** f. hist. Me kordhë (në dorë) duke përdorur forcën e kërcënimit, me dhunë.
- KORE** I f. Ka zënë (ka vënë) kore (dregëz) plaga është harruar, nuk kujtohet më një ngjarje e hidhur a një plagë e vjetër shpirtërore. Korja e tokës gjeol. shtresa e fortë në pjesën e sipërme të rruzullit tokësor. Korja e trurit anat. cipa e trurit.
- KORE** II f. krahin. Ia la koren (turpin) te dera shih tek TURP,~I.

- KOROMANE** f. I preu koromanen e la pa punë, ia preu kafshatën e gojës.
- KORR** kal. Korr e grin ka pushtet të madh e bën ç'të dojë. Ku mbjell nuk korr dikush shih te MBJELL. Është mbill e mos korr (një punë, një gjendje etj.) shih te MBJELL. Korr përmbi kallinj shih te KALLI,~RI. Korr e nuk (e mos) lidh bën punë gjysmake; nuk e çon deri në fund një punë dhe nuk arrin të marrë frytet e saj.
- KORRET** Pës. Ku mbillet, s'korret dikush shih te MBILLET. S'korret livadhi me gërshërë fj. u. shih te LIVADH,~I.
- KORRIER** m. Korrier diplomatik dipl. punonjës që u shpie shkresa zyrtare të rëndësishme përfaqësive diplomatike jashtë shtetit dhe sjell prej tyre shkresa të tilla për Ministrinë e Punëve të Jashtme.
- KORRIK** m. E shkund arrën në korrik (manin në prill) shih te SHKUND.
- KOS** m. U bë deti kos ka aq shumë sa mund të marrin të gjithë a mund të marrësh sa të duash (zakonisht kur shpërdorohet diçka). Kur të bëhet deti kos iron. kurrë, asnjëherë. Nuk mban më ujë kosi (pilafi, orizi, vera) shih tek UJ/Ë,~I. U dogj nga qulli (nga kungulli) e i fryn edhe kosit fj. u. shih te QULL,~I.
- KOSË** f. I ra kosa (fshesa, gërshëra) shih te BIE I. I vuri kosën e zhduku, e fshiu; e shfarosi.
- KOSIT** kal. Është pre e mos kosit shih te PRES I.
- KOSH** m. Si koshi (si kofini) pas të vjelave (pas së vjeli) shih te KOFIN,~I. Si rrushi e koshi shih te RRUSH,~I. I futi lugët në kosh shih te LUG/Ë,~A. E hodhi në koshin (në shportën) e plehrave
- KOT** ndajf. Merr kot shih te MARR.
- KOTHERE** f. E bëri kothere (copë, thërrime, copë e çikë, copë e kothere, copë e thërrime, copë e grimë) shih te BËJ.
- KOVË** f. Bie shi me kova (me gjyma, me legenë, me ibrikë) shih te GJYM,~I.
- KRAH** m. Krah për krah së bashku, në të njëjtën kohë, me të njëjtin ritëm, në të njëjtën shkallë; krahas. U bënë me krahë (me fletë) shih te FLET/Ë,~A III. I bie krahëve dikujt miratoj një veprim a një mendim të dikujt, i fërkoj krahët. Më bien (më këputen) krahët punoj shumë, punoj gjithë ditën, këputem duke punuar. Ra (u hodh) në krahët e dikujt pajtohet me dikë dhe i besohet atij; bashkohet e bashkëpunon me dikë. I dolën (i lindën) krahë (fletë) iu shtua hovi për të bërë diçka, mori krahë për një punë, u bë me fletë. I dha krahë (fletë) e gëzoi shumë, i dha guxim. I fërkon krahët (kurrizin, shpatullat, shpinën, zverkun) dikujt shih te FËRKOJ. Fle në një krah i ka punët në rregull, e ka mendjen të fjetur; nuk ka halle e shqetësime. Në atë krah (anë, brinjë) fli! iron. mos shko me atë mendje. Sa më ha krahu me të gjithë fuqinë e krahut, me sa forcë që kam, me të gjithë forcën. Hap krahët shih te HAP. Hedh krahë shih te HEDH. I hyri në krah dikush e ndihmoi, iu bë krah. Këngë mbi krah këngë që këndohen ulur, duke mbajtur njërin dorë me pëllëmbë të mbështetur pas veshit, këngë majëkrahut. Me krahë hapur (hapët) shih te HAPUR. Me krahë të lehtë! ur. shih te LEHTË (i, e). I ktheu (i solli) krahët (kurrizin, shpinën, shpatullat) dikujt shih te KTHEJ. Ia ka lidhur krahët (duart) shih te LIDH 17. M'u lehtësuan krahët shih te LEHTË-SOHEM. Iu lidhën krahët (duart) shih te LIDHEM. Mori krahë (fletë) mori guxim. Mbajti (mori) krahun e dikujt mori anën e dikujt, përkrahu dikë. I ngjit krahun (dorën) dikujt shih te NGJIT. Përveshi krahët (mëngët, llërat) shih te PËRVESH. I rreh krahët (shpatullat, supin) dikujt shih te RRAH. Rrudh (mbledh) krahët (supet) shih te RRUDH. I thau (i preu, i shkurttoi) krahët (duart, dorën) shih te DOR/Ë,~A.
- KRAHAROR** m. Rreh kraharonin (gjoksin) shih te RRAH.
- KRAHASIM** m. Në krahasim me... në qoftë se krahasohet me..., duke e krahasuar me...

- KRAKËLLIMË** f. I humbi krakëllima u largua e nuk i dëgjohet më zëri, nuk dihet më se ku është; u zhduk pa lënë gjurmë.
- KREH** kal. I kreh bishtin dikujt i bën lajka dikujt, e lajkaton; e merr me të mirë për të përfituar prej tij.
- KREHËR** m. Lule krehri bot. shih te LUL/E,~JA.
- KREKOS** kal. bised. I krekosi (i ngriti) veshët shih te VESH,~I.
- KREKOSEM** vetv. bised. Krekosej (kapardisej) si gjel (si këndesi, si kaposhi) majë plehut shih te GJEL,~I.
- KRESHTË** f. Qen me kreshta (me gjemba) keq. njeri i rreptë; njeri i ashpër e i vrazhdë; njeri i pashpirt e mizor.
- KRE VAT** m. E la krevatin (shtratin, dyshekun, jatakun) shih te SHTRAT,~I. U ngrit nga krevati (nga shtrati, nga dysheku, nga jataku) shih te SHTRAT,~I.
- KRËND** m. kryes. sh. Ishte me dy krënde në vatër ishte në gjendje të keqe ekonomike; rronte në varfëri, në skamje. Nuk preket (as) me krënde
- KRIMB** m. zool. I futi krimbin dikujt e bëri të shqetësohet për diçka, e bëri që të dyshojë për diçka. E hante (i kishte hyrë, e brente) krimbi e mundonte diçka përbrenda vazhdimisht; e grinte përbrenda pak e nga pak s'e linte të qetë (një mendim, një dyshim etj.). I ka hyrë krimbi dikujt a diçkaje
- KRIMBUR** mb. Ishte i krimbur në flori ishte shumë i pasur.
- KRIP** kal. I kripi kokën dikujt e vrau, e zhduku nga faqja e dheut. Ia kripi lëkurën dikujt e vrau. Ta kripi lëkurën
- KRIPË** f. M'u bë kripi diçka nuk më vajti mbarë më shkoi ters (një punë), sepse më dolën pengesa të papritura. Buka e kripi e diçkaje shih te BUK/Ë,~A. Gjellë pa kripi shih te GJELL/Ë,~A. Me bukë e kripi (e zemër të bardhë) shih te BUK/Ë,~A.
- KRIS** jokal. I krisi koka (mendja, një dërrasë) dikujt u prish nga mendtë, u çmend.
- KRITIK** mb. Realizmi kritik shih te REALIZËM, ~MI 2.
- KROI** m. Kemi pirë ujë në një krua jemi prej një vendi; jemi të afërt; e njohim mirë ënjëri-tjetrin. Ka pirë ujë në shumë kroje (burime) shih tek UJ/Ë, ~I. Të shpie (të çon) në njëqind (në dyzet) çezma (në krua, në shtatë kroje) e s'të jep ujë të premtion, të sjell rrotull dhe nuk të mbaron punë. Kroi (pusi) i mirë njihet në kohë të thatë fj.u. në rrethana të vështira njihet njeriu i mirë e i zoti ose miku i vërtetë.
- KRUA** m. Kemi pirë ujë në një krua jemi prej një vendi; jemi të afërt; e njohim mirë ënjëri-tjetrin. Ka pirë ujë në shumë kroje (burime) shih tek UJ/Ë, ~I. Të shpie (të çon) në njëqind (në dyzet) çezma (në krua, në shtatë kroje) e s'të jep ujë të premtion, të sjell rrotull dhe nuk të mbaron punë. Kroi (pusi) i mirë njihet në kobë të thatë fj.u. në rrethana të vështira njihet njeriu i mirë e i zoti ose miku i vërtetë.
- KRU AJ** kal. Kruan thonjtë tall. rri pa punë; bën diçka të kotë. Kruan veshin dikush shih te VESH,~I. Kruaj (pastroj) zërin (gurmazin) kollem lehtë para se të flas, që të më dalë zëri mirë ose kur s'di çfarë të them. S'më lë të kruaj dhëmbin dikush më rri vazhdimisht pranë, më ngjitet pas e s'më lë të bëj asgjë. Asnjë s'të kruan si dora jote fj.u. asnjë s'ta bën dot shërbimin ashtu siç ia bën njeriu vetes; secili duhet të përpiqet që punës së vet t'i dalë zot vetë.
- KRUHEM** vetv. I kruhen (i hanë) hundët shih te HUNDË, ~A. I kruhet (i ha) shpina (kurrizi) dikujt shih te KURRIZ,~I. Kujt i djeg le të kruhet! thjeshtligj. shih te DJEG. Kujt i ha miza nën kësulë le të kruhet! shih te MIZ/Ë,~A.

- KRUNDE** f. vet. sh. Ishte krunde nuk kishte asnjë lek në xhep, ishte trokë. I merr krundet për miell shih te **MIELL**, ~I. I lirë në miell, i shtrenjtë në krunde shih te **MIELL**, ~I. Mos u përziej me krundet, se do të të hanë pulat (po të përzihesh me krundet, të hanë pulat) fj.u. po u ngatërrove me njerëz të këqij, do të gjesh belanë.
- KRUSHKË** f. Rri si krushkë rri pa punë, rri pa bërë asgjë, rri më duar kryq; mbahet si mike dhe kërkon t'i shërbejnë.
- KRYE** m. Nga fundi në krye (nga kreu në fund) shih te **FUND**, ~I. Ka marrë pisha nga të dy krerët (nga të dy anët) shih te **PISH**/Ë, ~A. Shkoi (humbi, e pësoi) për mendtë e kresë (e kokës) shih te **MEND**, ~TË. Baltë kreu (baltë e bardhë, baltë koke) shih te **BALT**/Ë, ~A.
- KRYE** as. Në krye në udhëheqje, në ballë, në pararojë. Krye më krye (kokë më kokë) shih te **KOK**/Ë, ~A. Pa bisht, pa krye (pa kokë) shih te **BISHT**, ~I. Fund e krye që të gjithë, pa asnjë përjashtim; krejt, fund e majë. Në fund e në krye (në majë) shih te **FUND**, ~I. Na çau kryet (kokën, veshët) shih te **ÇAJ**. Ia dal në krye (një pune, një detyrë) e mbaroj, e kryej, e përfundoj me sukses. I ftohu kryet (kokën) dikujt shih te **FTOH**. Si gjeli pa krye (pa kokë) shih te **GJEL**, ~I. Ia hëngri kryet (kokën) dikujt shih te **HA**. I hyri në krye (në kokë) diçka shih te **HYJ**. S'i hyn në krye (në kokë) shih te **HYJ**. Në krye të detyrës në vendin e punës që i është caktuar; duke kryer detyrën.
- KRYEPLAK** m. vjet. Kryeplak në fshat të huaj kërkon të japë urdhra atje ku s'i takon; fut hundët në punë, për të cilat nuk e ka ngarkuar njeri.
- KRYER** f. gjuh. E kryera e thjeshtë një nga kohët e shkuara të foljes, që tregon një veprim të përfunduar plotësisht para çastit të ligjërit ose një gjendje të kaluar.
- KRYER** mb. Koha e kryer gjuh. një nga kohët e shkuara të foljes, e cila tregon një veprim a gjendje të kaluar në mënyrë të tillë që rezultatet janë të pranishme edhe në çastin e ligjërit. Aspekti i kryer gjuh. kategori gramatikore e foljeve në disa gjuhë, e cila e shpreh veprimin si të përfunduar, jo të zgjatur a të përsëritur ose si veprim që kryhet në një çast të caktuar; kund. aspekti i kryer.
- KRYESOR** mb. Në vija kryesore (të përgjithshme, të trasha) shih te **VIJ**/Ë, ~A.
- KRYQ** m. Puthi kryqin iron. shih te **PUTH**. I puthi kryqin dikujt iron. shih te **PUTH**.
- KRYQE** f. vet. sh. M'u këputën (më ranë) kryqet u lodha shumë, punova tërë ditën e ditës sa u këputa. Ia di kryqet e njoh mirë, ia di dhëmbë e dhëmballë. Ia ndreqi kryqet dikujt e solli në vete a e bindi duke e rrahur me dru; ia tregoi qejfin.
- KRYQËZOJ** kal. Kryqëzon (lidh) duart shih te **LIDH**.
- KTHEHEM** vetv. S'kthehet prapa dikush shih te **PRAPA**. Kthehet (shkon) nga të fryjë era shih tek **ER**/Ë, ~A I. Shkoi (vajti) përlesh e u kthye (doli, erdhi) i qethur fj. u. iron. shih te **LESH**, ~I. Nga lëviz qafa, kthehet koka fj.u. shih te **QAF**/Ë, ~A.
- KTHEJ** kal. I kthej armët (armikut) e kundërshtoj me armë, hidhem kundër tij, e pres me luftë. I ktheu (i vuri) pushkën (dyfekun) dikujt shih te **PUSHK**/Ë, ~A. Ktheu barkun (nga dielli) tall. vdiq. I ktheu (i tregoi, i drejtoi) bërrylin dikujt shih tek **TREGOJ**. Kthej bukë shtroj për të ngrënë. Ia ktheu dalë shih te **DAL**. Ia ktheu dorën
- KTHESË** f. Kthesë (me) plug shih te **PLUG**, ~U.
- KTHETËR** f. Në kthetrat e vdekjes shih te **VDEKJ**/E, ~A.
- KTHJELLËT** mb. Si bubullimë (si rrufe) në qiell të kthjellët (të kaltër) shih te **BUBULLIM**/Ë, ~A.
- KTHJELLOJ** kal. As turbullon, as kthjellon shih tek **TURBULLOJ**.

- KU** Ku ishin e ku s'ishin
- KUBIK** mb. Rrënja kubike mat. numri, i cili, i ngritur në fuqi të tretë, jep numrin e dhënë.
- KUÇ** I bised. kryes. fëm. Erdhën (ikën, shkuan) me kuç e me maç (me qen e me mace) erdhën me gjithçka që kishin; erdhën duke marrë me vete të gjithë e çdo gjë.
- KUDO** ndajf. Kudo qoftë në çdo vend që të jetë. Kudo që... në çdo vend që..., tekdo që.. .
- KUDHËR** f. Njëri (i bie) kudhrës, tjetri çokut (çekiçit) bëjnë një punë jo të bashkërenduar, pa u marrë vesh mirë e duke penguar njëri-tjetrin, njëri i bie gozhdës tjetri potkoit.
- KUFI** m. Gur kufiri
- KUFIZIM** m. Plotës kufizimi gjuh., vjet. plotës që përcakton kuptimin e një foljeje, të një emri ose të një mbiemri duke shënuar se deri ku shtrihet ky kuptim (p.sh. Ai ishte i fortë nga trupi).
- KUFOMË** f. Kufomë e gjallë shih te **GJALLË** (i, e). Janë dy kufoma e një shpirt duhen shumë me njëri-tjetrin.
- KUJDES** m. E kam kujdes, diçka e ndjek si shkon; e mbikëqyr gjersa të përfundojë (një punë, një detyrë); e kam gjithnjë parasysh.
- KUJË** f. Me kujë e me bujë me zhurmë të madhe. Vë kujën nxehem dhe bërtas shumë; bëj shumë zhurmë për diçka.
- KUJTESË** f. Sa për kujtesë sa për ta kujtuar.
- KUJTOJ** kal. Pa prituri e pa kujtua shih te **PRES II**.
- KUKUVAJKË** f. zool. I ka kënduar kukuvojka dikujt i shkojnë shumë keq punët dikujt, i vijnë të këqijat njëra pas tjetrës (sipas besimeve të kota se kukuvojka ndjell zi).
- KULAÇ** m. Ia gatoi kulaçin ia sajoi diçka për keq. Me kulaç e me kërbaç shih te **KËRBAÇ**,~I.
- KULM** m. Jemi (rrimë, banojmë) nën një kulm jemi një familje, banojmë në një shtëpi.
- KULPËR** f. bot. Kulpër e butë bot. sumbullare. Kulpër e egër (e bardhë) bot. shkurre kacavarëse, që rritet deri në gjashtë metra dhe bën lule të bardha, me erë të mirë.
- KULTURË** f. Kultura fizike fizkultura. Monument kulture shih te **MONUMENT**,~I 2.
- KULLË** f. Kulla me gjizë shih te **GJIZ/Ë**,~A. Është mbyllur në kullën e fildishtë keq. jeton e merret me punë krijuese, duke qenë krejt i veçuar e i shkëputur nga jeta e gjallë e popullit (për një shkrimtar, artist a studiues).
- KULLOJ** kal. I kulloi djersa shih te **DJERS/Ë**,~A. I kullojnë (i shkojnë) jargët shih te **JARGË**,~T. As kullon, as turbullon nuk përzihet në asnjë punë, nuk trazon njeri, rri mënjanë; as prish as ndreq. Më kullon (më rrjedh, më pikon) zemra gjak shih te **ZEM/ËR**,~RA. I kullon (i nxjerr, i rrjedh, i buron) goja mjaltë shih te **MJALT/Ë**,~I.
- KULLOT** kal. I kullot mendja (gjetkë) i vete mendja gjetkë ose larg, nuk e ka mendjen këtu, mendon për shumë gjëra të tjera. Ku të kullot mendja?! ku e ke mendjen, ku të fluturon mendja, pse s'e ke mendjen këtu?! Kullot retë shih te **RE**,~JA I.
- KULLOTË** f. E hëngri kullotën (barin, livadhin, çairin) shih te **HA**.
- KULLUAR** mb. Qesh edhe me ujin e kulluar shih te **QESH**.
- KUMBARË** f. etnogr. Kur m'u dogjën mullarët, njoha miqtë e kumbarët fj. u. shih te **MULLAR**,~I.
- KUMBULL** f. I bëri (paratë, të hollat) rrush e kumbulla shih te **RRUSH**,~I. Kur s'ha kumbulla, s'të mpihen (dhëmballët) fj. u. shih te **MPIHEM**. Fëmijët (djemtë) hanë kumbulla (thana), pleqve u mpihen

- dhëmbët iron. shih te MPIHEM. Kum-bull e egër bot. kullumbri.
- KUMTËR** m. etnogr. Kashta e kumtrit astr. shih te KASHT/Ë,~A.
- KUNDËRGRUSHT** m. Kundërgrusht shteti grusht shteti si përgjigje kundër një grushti shteti të bërë më parë.
- KUNDËRSHTIM** m. Bie (është) në kundërshtim me diçka nuk përputhet a nuk pajtohet me diçka, është krejt ndryshe nga diçka tjetër.
- KUNDËRT** f. Në të kundërtën; përkundrazi.
- KUNGULL** m. Kungull (trangull) pa fara mospërf. shih te FAR/Ë,~A. Pinë në një kungull janë njësoj; e njohin mirë njëritjetrit, rrinë gjithnjë bashkë. U bë lule kungulli u trondit shumë e u zverdh krejt në fytyrë nga diçka; u dobësua shumë e u tret. U bë (u rrit) kungulli e mori (e zuri) gardhin
- KUNJ** m. I mbeti kunj i mbeti si një merak i madh, i mbeti gozhdë, i mbeti peng.
- KUPË** f. E derdhi kupën e ka kaluar masën (në sjellje e në veprime të këqija), e ka tepruar, nuk durohet më. E mbushi kupën (gotën) shih te MBUSH. U mbush kupa shih te MBUSHEM. Ngre (çoj) kupën (gotën, dollinë, shëndetin) shih te NGRE. Për ta pirë në kupë shih te PI. Ia thau kupën shih te THAJ. Të than kupën shih te THAJ. Çirret (bërtet, thërrret) në kupë të qiellit shih te QIELL,~I. Ha bukën e përmbys kupën shih te HA. E piu (gjithë) kupën (e hidhërimit, e mjerimit) libr. pësoi një fatkeqësi të madhe, u dëmtua dhe u hidhërua shumë. Ka pirë kupën e hidhur libr. shih te HIDHUR (i, e).
- KUPTIM** m. Kuptimi i drejtpërdrejtë (i fjalës) gjuh. shih te DREJTPËRDREJTË (i, e).
- KUPTIMOR** mb. gjuh. Theksi kuptimor (logjik) gjuh. shih te LOGJIK,~E.
- KUPTOJ** kal. dhe jokal. E kuptoi (e mori vesh) ku i shtinte dyfeku shih te DYFEK,~U.
- KUQ** mb. U bë spec i kuq (në fytyrë) shih te SPEC,~I. Kur të bjerë shi i kuq shih te SHI,~U. Doli me këpucë të kuqe dikush iron. doli me humbje të mëdha, harxhoi më shumë sesa e vlente puna. Kur të këndoje qyqja e kuqe (nga bishti) iron. shih te QYQ/E,
- KUQ** as. Të jep vezë pa të kuq (pa të verdhë) shih te VEZ/Ë,~A. Vezë me dy të kuq (me dy të verdha) shih te VEZ/Ë,~A. Të kuqtë e madh mjek. foka.
- KUQEM** vetv. As kuqet (skuqet), as verdhet (zverdhet) shih te SKUQEM 7.
- KUR** Kur e kur
- KURBAN** m. M'u bëftë kurban mallk. përdoret kur shprehim mospëlqim për atë që bën a që thotë dikush, duke i dëshiruar të pësojë një të keqe; më marrtë të keqen! Dashi i kurbanit ai, të cilit i ngarkohet faji i të tjerëve, ai që vuan a ndëshkohet për fajin e të tjerëve. Shkoi si dash kurban shkoi kot, pa faj, shkoi humbur.
- KURDO** ndajf. Kurdo që... lidh. në çdo kohë që..., sa herë që...
- KURDOHERË** ndajf. Kurdoherë që ... lidh. çdo herë që ..., sa herë që ...; kurdo që...
- KURORË** f. Vuri (hodhi, shtiu) kurorë vjet. u martua (zakonisht me ceremoni fetare).
- KURRË** ndajf. Çmos kurrë shih te ÇMOS. Kurrën e kurrës asnjëherë e në asnjë mënyrë (me kuptim të përforcuar).
- KURRIZ** m. Bark e kurriz shih te BARK,~U. Ra në kurriz qeshi shumë, u shkri së qeshuri, u gajas së qeshuri. I fërkon kurrizin (krahët, shpatullat, shpinën, zverkun) dikujt shih te FËRKOJ. I ha (i kruhet) kurrizi (shpina) dikujt
- KURRIZOR** mb. Shtylla kurrizore anat. shih te SHTYLL/Ë,~A.
- KURRKUND** ndajf. S'është kurrkund
- KUSAR** m. Kusar (hajdut) me çizme shih te ÇIZM/E,~JA.

- KUSI** f. Bytha e kuisë shar. shumë i zi. S'ka gjë në kusi është shumë i varfër. Kusia mbi prush, thëllëza në fushë fj. u. peshku në det, tigani në zjarr. Lepuri në mal e vala (kusia) në zjarr fj. u. shih te LEPUR,~I.
- KUSUR** m. S'la kusur bëri gjithçka mund të bëhej për një punë, i bëri të gjitha përpjekjet e mundshme, s'la gjë pa bërë. Nuk i la kusur dikujt s'i la gjë pa thënë, ia numëroi të gjitha.
- KUSHT** m. Me çdo kusht me çdo mënyrë, pa tjetër, medoemos. Me kusht që... lidh. në qoftë se... po qe se...
- KUSHTOR** mb. gjuh. Mënyra kushtore një nga mënyrat e zgjedhimit të foljeve në gjuhën shqipe, e cila tregon se veprimi kryhet duke qenë i lidhur me një kusht.
- KUT** m. Nuk i doli në kut nuk i doli ashtu siç e kishte parashikuar (një punë, një llogari etj.). Nuk e nxori në kut nuk ia doli mbanë, nuk e përfundoi dot mbarë (një punë). Nuk më hyn në qese (në trastë, në kut) diçka shih te HYJ. E mat me kutin e vet e vlerëson diçka sipas mundësive e aftësive të veta, sipas pikëpamjeve të veta ose ashtu si i vjen mirë a i pëlqen atij.
- KUTI** f. I mbyllur në kuti keq. i veçuar nga të tjerët, i ndarë (për njerëzit që nuk përzihen me të tjerët e shikojnë vetëm punën e tyre). Kutia e shpejtësisë tek mekanizëm i përbërë prej disa rrotash të dhëmbëzuara, që shërben për ndryshimin e shpejtësisë ose të lëvizjes në automobilat, në traktorët etj.
- KUVEND** m. Kuvendi Popullor organi më i lartë i pushtetit shtetëror, mbajtës i sovranitetit të popullit dhe të shtetit dhe i vetmi organ ligjvënës; mbledhja e përfaqësuesve të popullit të zgjedhur në këtë organ; ndërtesa ku mbledhet e zhvillon veprimtarinë e vet ky organ. S'ha kuvend dikush nuk flitet dot me të, nuk i dëgjon fjalët e të tjerëve, nuk merr vesh, nuk bindet. Kuvend lajthish keq. shih te LAJTHI, ~A.
- KUZHINË** f. Kuzhinë ekonomike sobë shtëpie që nuk harxhon shumë lëndë djegëse dhe përdoret për të gatuar e për t'u ngrohur njëkohësisht.
- KYÇ** m. E mbylli me shtatë kyçe (me shtatë palë çelësa) shih te SHTATË. I vë kyçin (çelësin, drynin) diçkaje e mbyll, nuk e lë të punojë, të veprojë etj., e ndërpres.
- KYÇ** kal. Kyçe (mbylle, qepe) gojën! mos fol më!, pusho!
- KYÇUR** mb. E ka gojën të kyçur (të mbërthyer) shih te MBËRTHYER (i, e).
- LABOT** m. bot. U bë labot
- LAFSHË** f. I është rritur lafsha dikujt është bërë mendjemadh, shet mend. E ka lafshën të madhe është mendjemadh, shet mend shumë. E ka ngritur lafshën përpjetë krekoset e mburret shumë, mbahet me të madh. U skuq (u bë) si lafsha e gjelit u inatos shumë.
- LAG** kal. Ia lagu bishtin dikujt e turpëroi, e bëri me njollë. E lagu me djersë diçka punoi shumë, i kanë kulluar djersët për të. Ia lagu (ia njomi) dorën dikujt shih te NJOM. Ia lagu gojën dikujt i dha fare pak, sa për të njomur gojën; i dha një lëmoshë të vogël. E lagën (e lanë) me gjak shih te GJAK,~U 1. S'e lagu këmbën nuk u mundua as për vete as për të tjerët, nuk u përpoq fare. S'i ka lagur këmbët ka shpëtuar mirë, nuk ka pësuar gjë; nuk ka pasur asnjë vështirësi në jetë. I lagu sytë i mbushi sytë me lot, qau. Të rruan pa lagur
- LAGEM** vetv. Iu lag baruti tall. shih te BARUT,~I. S'i lagen drutë nuk i prishet pupa, nuk bëhet merak fare për diçka, aq i bën. Nuk e lëmë barutin të laget jemi gjithnjë gati për t'u mbrojtur nga sulmet e armikut, e mbajmë barutin të thatë. E hodhi (e kapërceu, e kaloi) lumin pa u lagur (pa lagur këmbët) e kaloi një rrezik pa pësuar asgjë.
- LAGËT** mb. Pushkë e lagët mospërf. njeri që nuk vlen fare; njeri që s'ia shkrep, i ngathët, i paaftë.

- LAGUR** mb. Rri si mace e lagur mospërf. rri i turpëruar para të tjerëve për diçka të keqe që ka bërë, rri kokulur e pa bërë zë. Rri si mi i lagur përçm. dridhet nga frika, për një faj që ka kryer. Rri si pulë e lagur përçm. rri me frikë e me druajtje; rri i përlulur e i nënshtruar. Doli pushkë e lagur dikush nuk doli ashtu siç mendohej; ishte njeri i pazoti e i pavlerë. Është fishek i lagur shih te FISHEK, ~U. E ka barutin të lagur nuk ka forca e guxim për të luftuar, nuk është i gatshëm për përlshjen. S'ka ç'i bën shkëndija eshkës së lagur (së njomë) fj.u. shih te SHKËNDIJ/Ë, ~A.
- LAHEM** vetv. U la në lot shih te LOT, ~I
1. Lahet e lyhet të lan e të lyen. Lahet me lëngun e vet shih te LËNG, ~U. Ishte larë e shkuar ishte në çastet e fundit para vdekjes, i kishte çastet të numëruara, kishte marrë fund (për dikë që dihet se do të vdesë patjetër ose që është duke vdekur).
- LAHUTË** f. Lahutë (këngë) e butë muz. shih te BUTË (i, e). E vuri në bisht (në grykë) të lahutës dikë e talli, e vuri në lojë.
- LAJ** kal. Laj ballin para dikujt shlyej një njollë dhe mund të dal ballëhapur përpara të tjerëve. Lau (lëpin) buzët shih te LËPIJ. E laj çetën shih te ÇET/Ë, ~A. I lau (i fshiu) duart nga dikush a nga diçka iku nga dora, nuk e ka më, mbeti pa të, s'ka më shpresë për të. S'e lan dot as dërstila shih te DËRSTIL/Ë, ~A. Laj (pastro) gojën! mospërf. shih veten tënde e ndreq mirë para se të flasësh, s'ke gojë të flasësh për dikë a për diçka. Sa për të larë (për të shpëlarë) gojën iron. shih te GOJ/Ë, ~A.
- LAJMËS** m. vjet. Mish pas lajmësi porosi që shkon dorë më dorë a njeri pas njeriu, porosi që nuk kryhet drejtpërdrejt; punë e pasigurt.
- LAJTHI** f. bot. Kuvend lajthish keq. punë e fshehtë, marrëveshje që bëhet fshehurazi.
- LAK** m. I bën (i jep) lak diçkaje i shmanget a i dredhon një pune, i bën bisht.
- LAKËR** f. E bëri lakër
- LAKOJ** kal. E lakon gjuhën nuk i qëndron fjalës, e ha fjalën, e dredh.
- LAKROR** m. gjell. E bëri lakror dikë e rrahu fort, e bëri fërtele, e bëri pelte. E bëri (e la) lakror (punën) e ngatërroi shumë, e pështjelloi; e la të pasqaruar e të turbullt.
- LAKURIQ** ndajf. Pisk e lakuriq shih te PISK. E la lakuriq dikë i mori gjithçka, s'i la gjë prej gjëje, e la pa asnjë mjet jetese. I ka hipur kalit lakuriq mospërf. ka zënë një vend a ka marrë një detyrë shoqërore pa e merituar; i është rritur mendja shpejt. E mori nusen lakuriq e mori nusen pa pajë, me rrobat e trupit. Mban ferra lakuriq bën diçka shumë të vështirë e të mundimshme, ecën mbi driza.
- LALË** II m. bised. Nusja e lalës zool. nuselalë.
- LAMTUMIRË** f. I dhanë lamtumirën (e fundit) lart. shih te JAP. I la lamtumirën dikujt shih te LË.
- LANET** m. bised. E bëri lanet dikë a diçka e mallkoi dhe e braktisi; e la fare.
- LAPËR** f. U bë lapër u dobësua shumë, u tret.
- LAPS** m. I bie lapsit (kalemit) shih te BIE I. I hyri me laps diçkaje e llogariti mirë një punë. Me laps (me kalem) në dorë në krye të punës, gati. E mprehu (mirë) lapsin (penën) libr. shih te PEN/Ë, ~A. Me një të rënë të lapsit (të penës) shih te RËN/Ë, ~A (e).
- LAR** m. bot. Lari i egër (lari i zi) bot. ashe, beronjë. E diela e larit (e dafinave, e luleve) fet., vjet. shih te DAFIN/Ë, ~A.
- LARA** f. vet. Ia di të larat e të palarat ia di gjërat e mira e të këqija, ia di të gjitha.
- LARASKË** f. zool. Për bishtin e laraskës (për ballë të laraskës) shih te BISHT, ~I. S'ka mbetur laraskë pa bisht fj.u. nuk mbetet njeri pa u rregulluar (i thuhet dikujt që duhet a përgatitet të martohet). Zihen (grinden) për të bardhat e laraskës shih te BARDH/Ë, ~A (e). E ka sjellë laraska iron. nuk dihet se kush e ka sjellë (një send a një lajm).

- LARASH** m. Po i vjen rrotull larashi po i afrohet vdekja.
- LARË** f. S'i nxihet lara nuk pyet fare, nuk do t'ia dijë, s'ka gajle.
- LARË** mb. Me ballë të larë i pafajshëm; sy hapët, krenar, ballëlarë. Doli lugë e larë doli i pafajshëm e i papërlyer, nuk është ngatërruar fare në një çështje. Është lugë e larë s'ka asnjë mjet jetese, s'ka gjë prej gjëje; është shumë i varfër, është i këputur.
- LARG** Larg duart nga ... (një vend)! libr. shih te DOR/Ë,~A. Larg nesh! mos na ndodhtë gjë neve! Larg qoftë (qoftë larg)! përdoret kur nuk duam të ndodhë diçka e keqe. Ka shkuar (ka vajtur) larg i ka kaluar caqet e diçkaje; ka hyrë thellë; ka arritur puna në atë shkallë, sa s'mund të ndalet a të ndreqet më. Është larg mendsh është fare e pabesueshme; nuk ka asnjë dyshim, as që mund të mendohet ndryshe; s'është e drejtë të mendohet që... Sheh (shikon) larg është largpamës. Vret (pret) larg.
- LARGËT** mb. Me qitje të largët libr. që synon larg, që ka qëllime të largëta.
- LARGOJ** kal. E largoi (e hoqi) mendjen nga dikush a nga diçka shih te MENDJ/E,~A 4.
- LARGU** ndajf. Për së largu pa u treguar i afërt me dikë, pa i kushtuar vëmendjen e duhur, nga larg.
- LARO** f. Ku lë laroja të hajë baloja thuhet kur një i fuqishëm rrëmben për vete çdo gjë dhe s'lë asgjë për të tjerët, kur dikush s'të lë as pjesën tënde. Kape laro, prite balo! tall. thuhet kur s'e merr vesh i pari të dytin, kur bëhet rrëmujë e madhe e secili bën sipas kokës.
- LART** Me ballë (me ballin) lart krenar, ballëlarë. Lart e poshtë (poshtë e lart) gjithandej, poshtë e përjetë; tutje-tëhu. Poshtë lart shih te POSHTË. Pështyn lart dikush shih te PËSHTYJ. E shet lart dikush shih te SHES. Vret (rreh) lart (rëndë)
- LARTË** mb. Shtypi i lartë shtypshkr. mënyrë shtypi: shkronjat e radhitura a të derdhura e të faqosura, figurat, skicat etj. dalin mbi rrafshin horizontal. Me zë të lartë me këmbëngulje, me forcë e pa bërë asnjë lëshim. Shkalla e lartë do (kërkon) këmbë të forta fj. u. shih te SHKALL/Ë,~A.
- LARUSHK** m. Kur të bëjë larushku rrush iron. kurrë, asnjëherë. Kur s'ke rrush, ha edhe larushk fj. u. kur s'ke pulën, ha edhe sorrën.
- LASKAR** II m. U bë laskar u dobësua shumë, u tret nga trupi.
- LASHTA** f. vet. sh. Shushunja e të lashtave (e drithërave) zool. shih te SHUSHUNJ/Ë,~A.
- LATË** I f. Si lata, sëpata keq. njësoj janë, si njëri ashtu edhe tjetri. Kur shkoi lata, të shkojë edhe sëpata kur ikën pjesa më me vlerë, s'ke ç'e do tjetrën; ikën sytë, le të ikin edhe vetullat.
- LAVDËROHEM** vetv. S'është as për t'u sharë, as për t'u lavdëruar shih te SHAHEM.
- LAVDISHËM** mb. Shkroi një faqe të lavdishme (të ndritur) shih te SHKRUAJ.
- LAVËR** f. E bëri lavër diçka e prishi diçka, e përmbysi dhe e bëri rrëmujë.
- LAVRAK** mb. Rrush lavrak rrush që e ka veshin të gjatë e me kokrra të rralla.
- LE** pj. Le që ... përdoret kur flasim për diçka që ndodh ose jo pavarësisht nga dëshira e ndokujt. Le që (se)..., por edhe... jo vetëm që..., por edhe ... Le (që)..., por as ...jo vetëm (që)..., por as... Pa le përdoret për të përforcuar një ndjenjë a një dëshirë të folësit, mosbesimin, ironinë, talljen a përcmimin e tij, për të treguar se ajo që thuhet quhet e tepërt, s'mund të vërtetohet ose është e vështirë të ndodhë etj.
- LEBËR** f. mjek. veter. Bar lebre bot. shih te BAR,~I I.

- LECKË** f. E bëri leckë (rreckë, paçavure) e shau rëndë një njeri, s'i la gjë pa thënë, e bëri për pesë para. Me gjithë lecka të tërin, me gjithçka. Me lecka e me pecka me çdo gjë që kishte. Me lecka në zemër në gjendje pasigurie të madhe, me frikë në zemër. Ngriti (mbodhi) leckat (rraqet) mospërf. shih te NGRE. Ia ngriti (ia mblodhi) leckat (rraqet) diku mospërf. shih te NGRE. Ia hodhi leckat në erë diku përçm. e zhduku dikë, e asgjësoi. Është me lecka në krah nuk është ngulur për të banuar në një vend të caktuar ose nuk ka ende një punë të përherëshme, endet sa në një vend në një tjetër; pret nga dita në ditë të niset me gjithë familjen për të banuar a për të punuar në një vend tjetër. Ia dha leckat në dorë diku mospërf. e përzuri në një vend tjetër, e shpërnguli diku me zor. Luan si qeni me leckë me dikë shih te QEN,~I.
- LEDH** I m. S'i hedh dot ledh punës edhe poh. nuk e rregullon dot, nuk gjen dot një zgjidhje të drejtë e të qëndrueshme për një çështje. Zuri lehdin (përruan) keq. shih te ZË.
- LEDH** II m. bised. Zuri ledh dikush vuri pasuri, u bë i pasur, zuri dhjamë. E zuri ledh dikë i ra në dorë papritur një pasuri si trashëgim, u bë papandehur i pasur; i erdhi e mira te dera; i eci mbarë, e ndihmoi fati.
- LEGEN** I m. I bie legenit thjeshtligj.
- LEGJENDË** I f. E bëri legjendë diçka e zgjati shumë tregimin për diçka, duke i shtuar edhe gjëra të paqena e duke e zbukuruar me trillime.
- LEH** jokal. Leh në hënë shih te HËNË,~A. Qeni leh atje ku ha fj. u. keq. shih te QEN,~I.
- LEHTË** mb. Me këmbë të lehta! ur. dalsh mirë e pa u lodhur! (i thuhet dikujt kur niset për udhë). Me krahë të lehtë! ur. dalsh mirë e pa shumë mundime! (i thuhet dikujt kur nis një punë). Me mendje të lehtë me mendjelehtësi. I bëri këmbët të lehta iku me të shpejtë, u mbathi këmbëve me të katra. E ka kokën të lehtë ndihet mirë nga shëndeti, nuk ka ndonjë dhimbje. E ndien zemrën (shpirtin) të lehtë është qetësuar shpirtërisht, nuk është më në ankth. Këmbët e lehta faqja e bardhë! thuhet për dikë, i cili ikën shpejt dhe i shpëton rrezikut. Figurë e lehtë shah. kali dhe oficeri në lojë e shahut. Industria e lehtë industria që prodhon sendet e përdorimit të gjerë.
- LEHTË** ndajf. Lehtë e lehtë
- LEHTËSOHEM** vetv. M'u lehtësuan krahët jam më i lirë a kam kushte më të mira për të bërë diçka.
- LEJ** jokal. Ka lerë (ka lindur) me këmbë (me yll) shih te LIND. Leu (lindi) e mbiu aty shih te LIND. Të len (të lind) e të perëndon shih te LIND. I leu (i lindi) në zemër për diçka i lindi vetiu dëshira për diçka, dëshiron diçka. Ç'len prej macës (ç'pjell macja), gjuan minj fj. u. keq. shih te MAC/Ë,~JA. Djali pa lerë e djepi (festja) blerë iron. shih Peshku në det, tigani në zjarr te PESHK,~U.
- LEK** m. E bëri për një lek e qortoi a e shau rëndë, s'i la gjë pa thënë, ia nxori bojën, e bëri leckë. S'bën asnjë lek nuk vlen fare. Hëngri (i dhanë, mori) gjysmën e lekut përçm. i dhanë plumbin, e pushkatuan. E lidh lekun (paranë) nyjë shih te NYJ/Ë,~A. E lidh lekun me ushkur mospërf. shih tek USHKUR,~I. U bë leku gur mulliri shih te MULLI,~RI.
- LEKTISEM** vetv. Iu lektis zemra për dikë e ka marrë malli shumë për dikë; vuan shumë për dikë.
- LEMERI** f. Vuri lemerinë ulëriu nga tmerr; vuri kujën.
- LEMZË** f. E bëri për lemzë dikë e rrahu shumë, e zhdëpi në dru.
- LEPE** pasth. bised. Ka lepe dikush është i bindur e i dëgjueshëm, i dëgjon të tjerët. Me lepe e me peqe edhe keq. gati për çdo gjë, duke shërbyer pa kundërshtim (thuhet zakonisht për dikë që nuk kundërshton kurrë e u përulet të tjerëve).

LEPITKË f. Iu bë lepitkë dikujt keq.

LEPUR m. U bë si lepur u dobësua a u tret shumë. E bëri lepur dikë e frikësoi shumë, i kalli frikën. Si lepur i çuar shih te ÇUAR (i, e). Si lepur në vresht shumë ngushtë, me frikë të madhe. Për një lëkurë lepur shih te LËKUR/Ë,~A. Zuri lepurin shak. shih te ZË. S'bëhet stan me lepuj fj.u. shih te STAN,~I. Nuk çon (nuk nxjerr, nuk qit) lepur nga strofulli nuk është i zoti për diçka, nuk e nxjerr dot gomarin nga balta i doli (i erdhi) lepur në shteg shih te SHTEG,~U. I ka hyrë lepur në bark (ka lepurin në bark) është trembur shumë, e ka zënë frika, dridhet nga frika.

LERË I f. E bëri barkun lerë piu shumë ujë, piu sa u fry.

LESË I f. U bë lesë u bë tapë. E bëri për lesë dikë e rrahu fort, e shqepi në dru, e bëri për vig. I bëri (i thuri) lesa dikujt i bëri një kurth, i ngriti grackë. E vuri (e futi) në lesë dikë e futi në kurth, e futi në grackë. I vuri lesë dikujt a diçkaje e ndaloi, e pengoi, ia preu hovin, i vuri gardh. I vuri lesën diçkaje e mbylli një çështje, i vuri kapak. Për çdo derë (për çdo shteg) ka një lesë nuk ka të metë a dobësi që nuk mund të ndreqet, çdo të keqeje a plage i gjendet ilaçi.

LESH m. U bë lesh u lodh shumë, u rraskapit. Lau lesh me dikë shih te LAJ. Të leshit e të lirit të mirat e të këqijat, të larat e të palarat. Lesh me qime diçka e kotë, pesë me hiç. U bë lesh (flokë) arapi u ngatërrua shumë diçka, u përzie keq, u bë lesh e li.

LESH as. Leshtë e barkut thjeshtligj. shih te BARK,~U. La leshtë (kockat, lëkurën) keq. shih te KOCK/Ë,~A. Ia ndau leshtë diçkaje e rregulloi mirë një punë, u tregua i zoti për të bërë diçka. I ka rënë leshtë (i kanë rënë qimet) e kokës

LESHTË f. kryes. sh. Të leshtat e të linjtat gjërat e mira e të këqija, të larat e të palarat, të leshit e të lirit.

LETËR f. I fsheh (i mbulon) letrat shih te FSHEH. I hapi (i zbuloi) letrat (kartat) shih te HAP. Kështjellë (kala) prej letre (prej karte) keq. shih te KËSHTJELLË,~A. Letër (pusullë) bakalli keq. shih te BAKALL,~I. Letër (kartë) e djegur shih te DJEGUR

LETRAR mb. Gjuha letrare forma më e përpunuar e gjuhës së një populli, e cila ka norma të caktuara, të ngulitura në të shkruar e në të folur, dhe arrin njësimin më të lartë në kohën e krijimit e të zhvillimit të kombeve e të shteteve kombëtare. Lexim letrar shih te LEXIM,~I.

LEXIM m. Lexim letrar formë e mësimi të letërsisë në shkollën tetëvjeçare, duke i komentuar pjesët letrare e duke dhënë edhe njohuri të tjera nga kjo fushë.

LEXOJ kal. T'i lexon (t'i këndon) letrat (kartat) në xhep shih te XHEP,~I. Lexoj në mes të radhëve (të rreshtave) libr. shih te RADH/Ë,~A.

LË kal. 19. edhe fig. Bëj që të jetë a të bjerë në një gjendje të caktuar (kryesisht të keqe a të vështirë), ia krijoj vetë një gjendje të tillë, i krijoj kushte të rënda a i shkaktoj një të keqe, duke ia marrë, duke ia prishur a duke ia zhdukur diçka; e bëj të përjetojë diçka të rëndë (edhe në një varg njësisish frazeologjike). E la pa gjumë. E la pa bukë (pa ujë, pa rroba, pa shtëpi, pa qerre, pa kalë, pa para). E la pa ngrënë (pa pirë, pa folur). E la pa gjë. S'la gjë. E la lakuriq (zhveshur, zbathur). E la pa njeri (pa vëlla, pa motër, pa baba). E la të vrarë (të vdekur, në vend, lëmsh, top, thes, shakull, dyshek, kopan, pìrg, kulaç). E la vetëm (qyqe mbi dhe). E la gisht (kalli, daulle) ia mori çdo gjë që kishte, e varfëroi. E la vakëf diçka e shkretoi fare. E la pa veshë e shurdhoi fare.

Lë në ahe shih tek AH,~U II. Lë në ahur dikë shih tek AHUR,~I. Lë arallëk shih tek ARALLËK, ~U. E lë (e fut) në arkiv libr. shih tek ARKIV,~I. La (dorëzoi, dha, hodhi, lëshoi, uli) armët shih tek ARM/Ë,~A. E la biçak shih te BIÇAK, ~U.

- LËBYR** kal. Ia lëbyri mendjen ia turbulloi, ia prishi mendjen.
- LËKUND** kal. Ia lëkund zemrën dikujt e prek thellë në zemër, e mallëngjej, e trondit.
- LËKURË** f. 7. bised. keq. Jeta a qenia e dikujt; trupi, vetvetja; jetesa (edhe në disa njësi frazeologjike). Ruan lëkurën e vet. I dhimbset lëkura. Shpëtoi lëkurën. La lëkurën diku mospërf.
- E bëri lëkurë thjeshtligj. e rrahu keq, e zhdëpi mirë, e bëri petë. U bë kockë e lëkurë shih te **KOCK/Ë**, ~A. I ra lëkura, (në punë) u raskapit së punuari; u dërrmua në punë. Çahet për lëkurë nuk i rrihet, s'e mban vendi; pëlçet nga inati, s'duron dot më. Sa i di lëkura (koka) dikujt shih te **DI**. Ia dogji lëkurën dikujt ia punoi keq, ia bëri me të pabesë dhe e dëmtoi rëndë, e mori më qafë. I ha lëkura dikujt shih te **HA**. Humbet nën lëkurë përçm. nuk ndjehet fare, struket diku dhe s'e bën veten të gjallë. Jetojnë në një lëkurë jetojnë njëlloj, në të njëjtat kushte. Ia kripi lëkurën dikujt thjeshtligj. shih te **KRIP**. Për një lëkurë lepur i për diçka të vogël a të parëndësishme, për hiçgjë. Ç'mban lëkura e tij! fsheh shumë gjëra në vetvete, ka qëllime të këqija, por nuk i shfaq. Nuk ia mban lëkura diçka nuk e duron dot.
- LËMË** m. E bëri lëmë diçka e shkatërroi fare diçka, e bëri rrafsh me tokën, e fshiu nga faqja e dheut. E bëri lëmin dikush shih te **BËJ**. Ia bëri lëmë dikujt ia paraqiti të zbukuruar diçka, ia bëri shesh me lule. E ka lëmë ka plot të mira, nuk i mungon asgjë. Lëmë pa drithë (pa bereqet) dikush a diçka që nuk sjell ndonjë dobi, pemë pa kokrra.
- LËMSH** m. U bë lëmsh u mblodh e u bë krus-pull. U bëftë lëmsh! mallk. vdektë!
- LËNDË** f. Shkëmbimi (këmbimi) i lëndëve biol. shih te **SHKËMBIM**, ~ I.
- LËNDINË** I f. E bëri lëndinë diçka e shkatërroi krejt, e bëri rrafsh me tokën, e bëri shesh.
- LËNDOR** mb. Pikë lëndore (materiale) mek. trup me përmasa të papërfillshme, që ka të gjitha veçoritë e materies. Provë lëndore (materiale) drejt. send a diçka tjetër konkrete që merret si dëshmi për të vërtetuar krimin ose për të përcaktuar njeriun që e ka kryer atë.
- LËNDYRË** m. krahin. S'i ka mbetur asnjë pikë lëndyrë dikujt është bërë fare i shpëlarë; ka rënë shumë poshtë përpara të tjerëve, i ka dalë boja.
- LËNG** m. U bë lëng u lag shumë, u bë qull. Lëng ndër lak a gjë fare pa rëndësi, diçka fare pa vlerë. Lëng gështenjash shih te **GËSHTENJË**, ~ A. Lëng groshe mospërf shih te **GROSH/E**, ~A. Lëng (farë) hardalli iron. shih te **HARDALL**, ~ I. Lëng stërlëngu (lëng pas lëngu) mospërf shumë i largët nga lidhjet e gjakut ose nga lidhjet e tjera. Ia ka pirë lëngun dikujt mospërf. shih te **PI**. M'u bë gjaku lëng (ujë) shih tek
- LËNGATË** f. Lëngata (sëmundja) e hënës mjek. sëmundja e tokës, epilepsia. Lëngata e thatë mjek. tuberkulozi. Lëngata e verdhë mjek. verdhëza.
- LËNUR** kal. E lënuri nga mendtë dikë
- LËNUREM** vetv. U lënur nga mendtë
- LËPENDËR** f. Ia la lëpendrat në dorë dikujt iku e shpëtoi nga dikush, i shpëtoi nga duart; ia hodhi.
- LËPIJ** kal. Lëpin (lan) buzët bëhet gati për të ngrënë diçka që i pëlqen; mprihet për të shtënë në dorë diçka që e dëshiron shumë ose për të marrë pjesë në diçka që i sjell kënaqësi a përfitime. E lau dhe e lëpiu dikë shih te **LAJ**. E ka lëpirë lopa
- LËPIRË** mb. Mbeti si gisht i lëpirë mbeti fare pa gjë.
- LËPJETË** f. bot. E ka gjuhën lëpjetë ta kthen fjalën menjëherë, e ka llapën të gjatë; e ka gojën të thartë, është gjuhustër e merret me thashetheme. E zgjati gjuhën si lëpjetë (si lëpushë) keq. foli shumë e

kot, tha gjëra të panevojshme a të pahijshme. Lëpjetë e bukur bot. bimë barishtore dyvjeçare, rreth gjysmë metri e lartë, me gjethe të gjata, me lule të vogla e të pakta, që rritet në vende të ulëta dhe lulëzon në muajt maj-gusht.

LËPUSHË f. E zgjati gjuhën si lëpushë (si lëpjetë) keq. shih te LËPJETË, ~A.

LËROJ kal. Lëron (prashit, mih) në ujë shih tek UJ/Ë, ~I.

LËSHOHEM vetv. Iu lëshua gusha dikujt shih te GUSH/Ë, ~A. Iu lëshua (iu vu) në shpinë dikujt shih te SHPIN/Ë, ~A. U lëshuan si miza në mjaltë shih te MIZ/Ë, ~A.

LËSHOJ kal. Lëshoi (dorëzoi, dha, hodhi, la, uli) armët shih tek ARM/Ë, ~A. S'lëshon askël shih tek ASHK/ËL, ~LA. E lëshon bajgën thjeshtligj. shih te BAJG/Ë, ~A. Lëshon bark diçka nis të përkulet në një anë, shtrembërohet; bëhet gati për t'u shembur (një mur). Lëshoi be për diçka u betua për diçka. I lëshoi (i qiti) be iu lut me të madhe për diçka, iu përgjërua duke e lidhur me be. Lëshoi dorë kundër dikujt e qëlloi, e goditi. E lëshon dorën tregohet dorëlibër, prish me tepri; nuk i peshon mirë qëndrimet a veprimet e veta. E lëshoi dore dikë e braktisi, e ndau, e largoi. E lëshoi në dorë të dikujt shih te DOR/Ë, ~A. S'e lëshon (s'e lë, s'e heq) nga dora diçka shih te DOR/Ë, ~A. Ia ka lëshuar fillin dikujt e ka lënë të lirë të veprojë si të dojë, nuk e mban më nën kujdes e s'e kontrollon më. Ia lëshoi (ia liroi) frerin (kapistallin, kapistrën) dikujt keq. e ka lënë të lirë të veprojë si të dojë, nuk e mban më nën një kontroll të rreptë. E ka lëshuar gojën (gjuhën, llapën) flet shumë, me vend e pa vend; është bërë gojështurur. I lëshoi gojë dikujt e shau dikë. S'e lëshon (s'e heq, s'e lë, s'e ndan) nga goja dikë a diçka shih te GOJ/Ë, ~A. E ka lëshuar kripa dikë bën shaka vend e pa vend, flet mbarë e prapë. I lëshoi litar dikujt i bëri lëshime.

LËSHUAR mb. Me dorë të lëshuar

LËVAR kal. I lëvari (i vari, i lëshoj) vetullat shih te VAR. I lëvari (i lëshoj, i vari) buzët

LËVERE f. U bë lëvere u dobësua shumë, u bë si leckë. Iu bë fytyra lëvere dikujt u zbeh shumë, u bë pëlhurë në fytyrë (nga një lajm i hidhur, nga frika etj.). E bëri lëvere diçka e grisi shumë diçka, e bëri copë-copë.

LËVIZ kal. Lëviz (dredh, përdredh, luan) bishtin keq. shih te BISHT, ~I. Lëviz (luan) gurët shih te LUAJ. Nuk i lëviz (nuk i dridhet, nuk i luan) qerpiku (qepalla, syri, bebja e syrit) shih te SY, ~RI. S'lëviz (s'tundet) nga vendi shih te VEND, ~I. Më lëviz (më luan) zemra ndiej shqetësim të madh për diçka; më hyn shumë frika. S'lë gur pa lëvizur shih te LË. I lëviz (i shket, i rrëshqet, i luan, i dridhet) toka (trualli) nën këmbë shih te DRIDHEM. Nga lëviz qafa, kthehet koka fj.u. shih te QAF/Ë, ~A. Kur rri (kur fle) koka, lëviz gjuha fj.u. shih te KOK/Ë, ~A.

LËVOZHGË f. Është mbyllur në lëvozhgën (në guaskën) e vet sheh vetëm punën e vet, s'jep e merr me të tjerët. S'ka dalë ende nga lëvozhga e vezës (nga veza) mospërf. shih te VEZ/Ë, ~A.

LËVRIJ jokal. I lëvrin (i vlon, i zien) gjaku shih te Lëvrin gjuhën mospërf. flet shumë, llap.

LI m. bot. Të leshit e të lirit shih te LESH, ~I. Të lirit e të mullirit të mira e të këqija, të larat e të palarat, të leshit e të lirit. U bë lesh e li shih te LESH, ~I. Shtohet (është) si fara e lirit (e hitrës, e sinapit) shih te FAR/Ë, ~A. Gur liri (leshi, mëndafshi, pambuku) bised. asbest, amiant. Liri i breshkës bot. Liri i egër. Liri i egër bot. Bimë barishtore e hidhur, me gjethe të holla, të gjata e të dendura, me lule të verdha, që rritet në vende të ulëta dhe nuk e hanë bagëtitë.

LIBËR m. Libër i artë shih tek ARTË (i, e). Libër i bardhë shih te BARDHË (i, e).

LIDH kal. Korr e mos (e nuk) lidh shih te KORR. I ka lidhur (i ka mbledhur) dengjet shih te DENG, ~U. Lidh (kryqëzon) duart s'bën asnjë përpjekje për të ndihmuar dikë që ka nevojë, rri e pret, nuk vepron; rri duarkryq. Lidhe në gisht! shih te GISHT, ~I. Ia lidhi gjuhën dikujt ia mbylli gojën që të mos flasë, e detyroi të mos i thotë mendimet që ka; e detyroi ta mbajë të fshehur diçka. Ka lidhur inat ka vënë inat. Lidh këmbë për diçka ngul këmbë. Ia lidhi (ia zuri, ia ngujoi) këmbët shih te ZË. Ia lidh kryet diçkaje e përfundoj, i jap fund. Ka lidhur mish është shëndoshur, ka vënë mish. Lidh mendjen vendos për të bërë diçka. S'lidh para nuk sjell shumë fitim po të shitet. I lidhën (i vunë) qafolin dikujt shih te QAFOL, ~I. E lidhi qesen i kurseu paratë; u tregua dorështrënguar. I kanë lidhur (i kanë gjetur, i kanë rregulluar) telat bashkë shih tek TEL, ~I. Lidh e zgjidh dikush bën si do vetë, nuk pyet njeri; vendos vetë, ka në dorë edhe gurin edhe arrën; bëhet ashtu siç thotë a siç do ai. S'di të lidhë ushkurin (ushkurët) mospërf. është njeri i humbur, s'di të bëjë asgjë, nuk është i zoti as për veten e tij. Ia lidhi gojën me fashë shih te FASH/Ë, ~A. E lidhi këmbë e duar dikë shih te KËMB/Ë, ~A. Lidh këmbët me gjalmat e mi shih te GJALM/Ë, ~I. Lidh krye me krye shih te KRYE, ~T. E lidh lekun (paranë) një shih te NYJ/Ë, ~A. E lidh lekun me ushkur mospërf. shih tek USHKUR, ~I.

LIDHEM vetv. U lidha pas bishtit të dikujt keq. shih te BISHT, ~I. Iu lidhën duart (krahët) mbeti pa punë pasi e pengonte dikush a diçka; nuk mundi të bëjë dot gjë, nuk ishte i lirë të vepronte. Iu lidh (iu pre) goja (gjuha, fjala) s'tha dot asnjë fjalë, s'mundi të fliste (nga një tronditje e fortë, nga frika etj.). Nuk lidhet në një hu shih te HU, ~RI.

LIDHËS mb. Vizë lidhëse gjuh. vizë e shkurtër që vihet zakonisht ndërmjet dy fjalëve ose ndërmjet dy temave, të

cilat formojnë një njësi (p.sh. ditë-punë, ekonomiko-shoqëror, organizatë-bazë, dora-dorës, Nikaj-Mertur). Zanore lidhëse (bashkuese) gjuh. zanore ndërmjet dy temave të një fjale të përbërë (p.sh. gushtovjeshtë, mesoburrë, ballafaqe, këmbadoras, djegagur).

LIDHJE f. Në lidhje me ... për sa i përket..., lidhur me ...

LIDHOR mb. Mënyra lidhore: një nga mënyrat e zgjedhimit të foljeve në gjuhën shqipe, e cila tregon një veprim a një gjendje që mund, që dëshirohet ose duhet të kryhet a të ndodhë, pasi lidhet me një tjetër.

LIDHUR mb. I lidhur bisht më bisht thjeshtligj. shih te BISHT, ~I. I ka duart të lidhura (të zëna) nuk vepron dot, sepse e pengon dikush a diçka. I ka këmbët të lidhura nuk shkon dot asgjëkund a diku, sepse e pengon dikush a diçka.

LIDHUR ndajf. Lidhur me... në lidhje me... Me duar lidhur pa bërë asgjë, pa vepruar, duarlidhur, duarkryq.

LIG mb. Farë e ligë (e keqe) shar. shih te KEQ (i), ~E (e). Në vend të lig (të keq) euf. në organet seksuale të mashkullit, në vete. Ishte me orë të liga (të këqija) shih tek ORË, ~A II. E mori ora e ligë shih tek ORË, ~A II. E sheh (e ka, e shikon, e vështron) me sy të lig (të keq, të shtrembër) shih te SHTREMBËR (i, e). E ka kokën në vend të lig keq. s'mendon si duhet ose mendon keq, nuk arsyeton si njeri, s'i kupton drejt gjërat. Bar i lig (i keq) bot. shih te BAR, ~I. Barku i lig (i keq) mjek. dizenteria. Gryka e ligë (gryka e keqe, grykët e bardha) mjek. bised. shih te GRYK/Ë, ~A.

LIGEM vetv. Iu lig (iu ligështua) ora dikujt vjet. shih tek OR/Ë, ~A II. Iu lig zemra dikujt u ligështua.

LIGË f. Të harrofshin të ligat! ur. qofsh gjithmonë mirë! Më marrsh të ligat (të keqen)! mallk. shih te MARR. Na mori të ligën (të keqen)! mospërf. shih te MARR.

LIGËSHTOHEM vetv. Iu ligështua (iu lig) ora dikujt vjet. shih tek OR/Ë, ~A II.

LIGSHT ndajf. I erdhi ligsht

LIGJ m. Bën ligjin keq. vendos çdo gjë vetë pa pyetur asnjëri dhe pa përfillur rregullat e caktuara, ç'thotë ai bëhet. E ka ligjin në teh të shpatës shih te SHPAT/Ë, ~A.

LIGJËRATË I f. Ligjëratë e drejtë gjuh. formë e ndërtimit sintaksor të ligjërit, në të cilën ai që flet a shkruan përsërit fjalë për fjalë, pa asnjë ndryshim ato që ka thënë një tjetër ose që ka thënë vetë më parë, duke i veçuar si fjali më vete. Ligjëratë e zhdrejt ë(e tërthortë) gjuh. formë e ndërtimit sintaksor të ligjërit, në të cilën ai që flet a shkruan i riprodhon fjalët e një tjetri ose fjalët që ka thënë vetë më parë pa bërë ndryshime në përmbajtje, por me ndryshime në formë, duke mos i veçuar si fjali më vete. Pjesët e ligjëratës gjuh. kategoritë themelore leksiko-gramatikore, në të cilat grupohen të gjitha fjalët e gjuhës sipas kuptimit leksikor dhe veçorive të tyre gramatikore (p.sh. emri, mbiemri, numërori, përemri, folja, ndajfolja, parafjala etj.).

LIGJËROJ I jokal. I ligjëron zemra është shumë i gëzuar, i këndon zemra.

LIGJOR mb. Mjekësia ligjore degë e mjekësisë që ndihmon organet e hetuesisë e organet gjyqësore për të sqaruar rrethanat e një krimi.

LIK m. Shpëtoi për lik shpëtoi për pak gjë, shpëtoi për një fije, shpëtoi për një qime.

LIKTYRË f. U bë liktyrë u dobësua shumë, u tret.

LIMË f. U bë limë diçka mbeti fare pa njeri a pa orendi, mbeti e zbrazët. E bëri limë diçka e shembi krejt, e bëri rrafsh me tokën; e preu deri në rrëzë diçka. I ra me limë i mendoi mirë fjalët përpara se të fliste, i mati mirë fjalët, nuk foli kot, më kot; foli hollë. I dha limë diçkaje e përpunoi mirë diçka, e bëri të përkryer, e limoi. Ka limë të fortë dikush është i aftë t'i bindë njerëzit, është i zoti t'ua

mbushë mendjen të tjerëve, ka zdrukth të fortë. E ka zëmren prej lime

LIMON m. Limon i shtrydhur shih te SHTRYDHUR (i, e). Nuk hahet as me limon dikush është njeri aq i keq sa nuk durohet dot. S'priset dasma për një limon (për një qepë) fj.u. shih te DASM/Ë, ~A. Limon i ëmbël bot. lloj limoni që bën kokrra vezake pak si të rrumbullakëta e të ëmbla.

LIND jokal. I lindën (i dolën) fletë (krahë) shih te KRAH, ~U Ka lindur prej gurit është shumë i durueshëm, është zemërshkëmb. Ka lindur me këmishë (me yll) është njeri fatlumtur, i shkon mbarë çdo gjë, e gjen e mira vetë. Lindi (leu) e mbiu aty mbeti aty, nuk ikën, nuk shkulet. Si (siç) e ka lindur nëna lakuriq. Kanë lindur për njëri-tjetrin shkojnë e përshatën shumë ndërmjet tyre, sikur janë prerë për njëri-tjetrin. Ka lindur para shejtanit keq. shih te SHEJTAN, ~I. Të lind (të len) e të perëndon në të gjithë vendin, gjithandej; në një hapësirë shumë të madhe.

LINJË I f. Doli linjës u çudit shumë, u habit jashtë mase. I vuri linjën dikujt e vuri nën vete dikë, e vuri poshtë, e mposhti. Rrinte si murgja në linjë shih te MURG/Ë, ~A I.

LINJTA f. vet. sh. Të leshtat e të linjtat shih te LESHT/Ë, ~A (e).

LIPSAN m. vjet. U bë lipsanë

LIPSEM vetv. bised. keq. Lipsur qoftë! në djall të vejël, s'ke ç'e do, s'ia vlen të mundohesh për të.

LIQ m. vet. sh. Bën në katër liq dikush vepron si të dojë; është i zoti e ia del në krye diçkaje.

LIQEN m. U bë liqen u mbush plot me ujë, u bë pellg i madh (kur vërshojnë ujërat, kur derdhet një sasi e madhe e diçkaje të lëngshme etj.).

LIRË mb. Me duar të lira pa pasur pengesë prej ndokujt, lirisht, sipas dëshirës. I ka duart të lira (ka dorë të lirë) mund

të veprojë si të dojë, nuk e pengon asgjë. Jeni i lirë! zyrt. mund të shkoni, mund të largoheni!, s'kemi më punë me ju! Në profesion të lirë që merret vetëm me punë krijuese në fushën e letërsisë e të arteve dhe nuk ka ndonjë detyrë tjetër shtetërore. Gjeti shesh (fushë) të lirë dikush nuk e pengoi askush, pati mundësi të veprojë lirisht e pa vështirësi. E ka dorën të lirë është dorëlëshuar. I la (i dha) dorë të lirë dikujt e lejoi të bënte si të donte, i la liri veprimi, i dha mundësi të veprojë lirisht. Ka hyrje të lirë diku hyn lirisht diku, nuk e pengon njeri të futet, vepron pa pasur ndonjë pengesë. I lë fushë (shesh) të lirë dikujt a diçkaje e lejon dikë që të veprojë lirisht, nuk i nxjerr pengesa; lejon që diçka të zhvillohet lirisht. E la me këmbë të lira dikë e lejoi që të vepronte si të donte pa ndonjë kufizim. I lë rrugë të lirë dikujt a diçkaje e lejon dikë a diçka që të kalojë, nuk e pengon; lejon që të zhvillohet lirisht diçka. I lirë në miell, i shtrenjtë në krunde fj. u. shih te KRUNDE,~T.

LIRI I f. I ka dhënë liri gjuhës keq. flet shumë e pa u menduar mirë, nuk i vë fre gjuhës. Liria poetike let. heqje e shtesa tingujsh ose ndryshime të tjera gjuhësore në vargjet për të ruajtur ritmin, numrin e rrokjeve etj. Liria e detit të hapët e drejta e anijeve të shteteve të ndryshme për të lundruar lirisht në det të hapët. Liria e hapësirës ajrore (liria e ajrit) e drejta e aeroplanëve të shteteve të ndryshme për të fluturuar lirisht në një hapësirë ajrore të caktuar.

LIRIK mb. Fluturim lirik let. shih te FLUTURIM,~I.

LIROHEM vetv. I janë liruar (e kanë lëshuar) rrathët shih te RRETH,~I. I janë liruar (i kanë luajtur) vidhat (burgjitë, burmat) dikujt shih te VIDH/Ë,~A.

LIROJ kal. E liroi dorën

LIS m. Mizë lisi shih te MIZ/Ë,~A 5. Qëndron lis qëndron ballëllart e i patundur, qëndron krenar. Është lis me shumë degë

është njeri i zoti e me shumë shokë e miq; ka përkrahje të madhe. Është lis (pemë) me rremba shih te RREMB,~I. E ka hundën në lis është mendjemadh, mbahet shumë me të madh. Nuk ka hije lisi për dikë shih te HIJ/E, ~A. Mbeti si pika në lis (lis pa degë) mbeti i vetëm, pa njeri tjetër të afërm. Unë për lisa, ti për fshesa nuk kuptohemi fare me njëri-tjetrin, tjetër bëj unë e tjetër ti, s'jemi në një udhë. Rigoni s'bëhet lis fj. u. shih te RIGON,~I. S'pritet lisi (druri) me një sëpatë (me një të rënë të sëpatës) fj. u. shih te SËPAT/Ë,~A.

LISTË f. Në krye të listës në vend të parë, në ballë të diçkaje. Listat e zeza listat që hartohen në mënyrë të fshehtë dhe që përmbajnë emrat e njerëzve të padëshirueshëm për regjimin në fuqi, të cilët në raste të caktuara mund të arrestohen.

LITANI f. fet. Bënin litani vjet. luteshin shumë për diçka.

LITAR m. E bëri litar (tërkuzë, pallamar) shih tek TËRKUZ/Ë,~A. I hurit e i litarit shih te HU,~RI. I lëshoi litar dikujt shih te LËSHOJ. E luajti në litar dikë e talli, e vuri në lojë. Iu mbledh (iu shkurtua) litari (laku) shih te MBLIDHEM. Ia preu litarin dikujt e shpëtoi nga një gjendje shumë e vështirë, ia zgjidhi një hall të madh që kishte. Nuk e duron litarin në fyt nuk i nënshtrohet dikujt; nuk e duron zgjedhën e huaj. I hodhi (i vuri) litarin (lakun) në fyt (në grykë, në qafë) dikujt shih te LAK,~U. Është me litar në grykë dikush shih te GRYK/Ë, ~A. E kishte litarin (lakun, thikën) në fyt (në grykë) shih te LAK,~U. Iu shtrëngua litari për gryke (në fyt) dikujt po i vjen fundi.

LIVADH m. U bë livadh tall. piu shumë, u bë tapë. E bëri livadh diçka e zbukuroi shumë, e bëri fushë me lule. E hëngri livadhin (çairin, barin, kullotën) shih te HA. Ia bëri mendjen livadh dikujt ia prishi mendjen, ia mori mendtë, e hutoi. Hyri në livadh të huaj hyri në një punë që s'i takonte; shkeli të drejtat e një

- tjetri. S'korret livadhi me gërshtë fj. u. s'bëhet një punë pa pasur mjetet e nevojshme. Thur livadhin e lë shtegun hapur shih te THUR.
- LODËR** f. Luan lodrën (lojën) e dikujt shih te LUAJ. Iu bë barku lodër (daulle, kacek) shih te DAULL/E, ~JA. Hedh këmbët (luan këmbët, hedh vallen, kërcen) siç bie lodra (siç bie daullja, sipas daulles) keq. shih te DAULL/E, ~JA. Lodra bie për tjetër valle shih te VALL/E, ~JA.
- LODH** kal. Nuk i lodh këmbët dikush përton të shkojë diku; nuk ka dëshirë të shkojë diku.
- LOFATË** f. bot. Dridhej si gjethe lofate (plepi) shih te GJETHE, ~JA.
- LOG** m. U bë log diçka u zbulua, doli në shesh. E bëri log diçka e ngjeshi mirë, e rراسi dhe e bëri rrafsh e të ngjeshur.
- LOGJIK** mb. Theksi logjik (kuptimor) gjuh. theksimi i një fjale, të cilën duam ta dallojmë në fjali nga kuptimi, për të shprehur pikërisht atë që synojmë gjatë ligjëritimit.
- LOJË** I f. U bë lojë e dikujt e tallin a e qeshin të tjerët, u bë gazi i botës. Bën lojën e dikujt
- LOLO** f. bised. E bëri lolo dikë e talli, e vuri në lojë.
- LOMÇKË** f. krahin. Trupi boçkë e mendja lomçkë mospërf. shih te BOÇK/Ë, ~A.
- LOPATË** f. Merr (fiton) me lopatë e merr diçka në sasi të madhe, fiton shumë. E ka gojën lopatë flet shumë e thotë gjëra të qena e të paqena. Nuk i merr (nuk i ngre, nuk i zë) ujë lopata (shati)
- LOPË** f. U bë lopë u shëndosh shumë nga trupi. Kur të flasin lopët iron. kurrë. E ka lëpirë lopa shih te LËPIJ. Ia ka lëpirë lopa trutë (mendtë) dikujt tall. shih te LËPIJ. I ka pjellë lopa dikujt shih te PJELL. Ka sa të hanë lopët (qentë) thjeshtligj. shih te HA.
- LOT** m. kryes. sh. Derdh lot shih te DERDH. I fshiu lotët dikujt shih te FSHIJ. E lau me (në) lot dikë a diçka shih te LAJ. Lot krokodili shih te KROKODIL, ~I 2. Lot e shpirt krejt, gjallë (për një që ngjan shumë me një tjetër). I mblodhi lotët shih te MBLEDH. E qau me lot diçka
- LOTARI** f. I ra (e zuri) lotaria i ra shorti për të bërë diçka; e caktuan për të kryer një punë, që nuk e kishte marrë askush përsipër. I doli lotaria i dhanë diçka të mirë që nuk e priste, i erdhi e mira te dera. Heq lotarinë shih te HEQ. Vë në lotari diçka provon shortin për diçka, e vë në short.
- LOTUES** mb. Shelg lotues (vajtues) bot. shih te SHELG, ~U.
- LOZE** f. Lëshoi loze shih te LËSHOJ.
- LUAJ** jokal. Luan arushë me dikë keq. shih tek ARUSH/Ë, ~A. Luan (dredh, përdredh, lëviz) bishtin keq. shih te BISHT, ~I. I luan (i tund) bishtin dikujt keq. shih te BISHT, ~I. Luaj buzët flas; flas ngadalë e pa u ndier shumë. Luaj cicmic shih te CICMIC, ~I. Luaj cingël me dikë shih te CING/ËL, ~LI. Luaj cingëlthi me dikë shih te CINGËLTHI. Luan (tund) derën mospërf. shih te DER/Ë, ~A. E luan gishtin (e pushkës)
- LUAN** m. Pjesa e luanit libr. iron. pjesa më e madhe e më e mirë e diçkaje, që e merr më i forti për vete pa përfillur të tjerët
- LUBI** f. E ka lubinë në bark keq. ha shumë, është i pangopshëm.
- LUFTARAK** mb. Fletë luftarake shih te FLETË, ~A 2.
- LUFTË** f. Në vijën e parë të luftës (të zjarrit) shih te VIJ/Ë, ~A.
- LUFTOJ** jokal. I lufton gjaku (zemra) ndizet shumë e merr hov për të bërë diçka, i rreh fort zemra për diçka.
- LUG** m. U bë lug u palos me dysh (nga dhimbjet etj.). I kanë rënë gurë në lug i kanë dalë pengesa a ngatërresa në punë, i janë shtuar vështirësitë. I doli djersa në lug u lodh shumë, u rraskapit.

LUGAT m. Bisht lugati thjeshtligj. ters, keq. Vampiri e njeh lugatin fj. u. shih te VAMPIR,~I.

LUGË f. Një lugë (një majë luge) fare pak, shumë pak. Kam ngrënë me një lugë me dikë e kam pasur shok a mik të ngushtë dikë; e njoh shumë mirë. S'ka lugë për dikë nuk i japin dikujt pjesën që i takon, e lënë pa gjë. Me lugë në brez keq. vetëm për të ngrënë; i gatshëm për të ngrënë kudo e kurdoherë në kurriz të të tjerëve, qelepirxhi. Iu njom luga dikujt u məkëmb pak nga gjendja ekonomike, e mori pak veten. S'më thahet luga shih te THAHËM. Ia than lugën dikujt shih te THAJ. Është bërë si bisht luge është dobësuar shumë, është tretur e tharë nga trupi. Është bërë si lugë çervishi shih te ÇERVISH,~I. I ra luga (sëpata, sqepi, shpata, thika) në mjaltë shih te MJALT/Ë,~I. I ra luga në qumësht dikujt shih te QUMËSHT,~I. I bie maces me lugë mospërf. është në moshë ende të vogël, është foshnjë ose si foshnjë, i papjekur dhe nuk kupton se ç'bëhet; bën veprime prej çilimiu. I ra me lugë të madhe diçkaje e harxhoi pa kursyer fare, i ra pa e mbajtur dorën, u tregua tepër dorëllirë. Doli lugë e larë shih te LARË (i, e). Ia di lugët në kaçile dikujt ia di të gjitha të fshehtat, ia njoh edhe zorrët e barkut. Ia di lugët e pirunët dikujt di gjithçka për dikë, ia njoh mirë edhe gjërat e imëta të shtëpisë; i njoh dhëmbë e dhëmballë. Ia ka djegur luga (qulli) buzën shih te QULL,~I. I fryn lugës së tij shih te FRYJ. I futi lugët në kosh mbeti pa gjë fare, nuk mori asgjë, i lau duart (kur nuk i del ajo që kishte parashikuar më parë). E gjeti lugën në pilaf keq. e gjeti gati çdo gjë, e gjeti shtruar. Ka ngrënë me gjysmë lugë iron. është shumë i dobët nga trupi, është si i ngordhur. Hante me lugë të florinjte ishte në gjendje shumë të mirë, s'i mungonte asgjë, bënte jetë përrallore (për një të pasur). Hyn (futet) si luga në pilaf keq. merr pjesë menjëherë në diçka; ndërhyt menjëherë edhe atje ku nuk i takon, fut hundët. Është lugë e

larë shih te LARË (i, e). Është lugë për vegsh është njeriu më i përshtatshëm për të bërë diçka; është pikërisht ai që duhet. I dhënça ujë me lugë! mallk. u bëftë për vdekje, shkoftë në buzë të varrit! Kërkon të hajë me dy lugë keq. kërkon të përfitojë nga të dy krahët, përpiqet të nxjerrë përfitime për vete duke e pasur mirë me të dy palët. Kërkon të hajë me lugë të madhe keq. kërkon të përfitojë nga diçka më shumë nga sa i takon; është lakmitar. E la (e hodhi) në shportën e lugëve diçka shih te SHPORT/Ë,~A. Nuk thahet (nuk soset) deti me lugë fj. u. shih te DET,~I. I mbeti luga në pilaf iron. u turpërua, mbeti me turp. Mbeti me lugë të zbrazët (bosh) shih te ZBRAZËT (i, e). Ngopet me lugë të zbrazët (bosh) shih te ZBRAZËT (i, e). S'i mori luga gjë tall. s'i eci mbarë puna, nuk i vajti mirë, s'fitoi gjë, s'i mori lopata ujë.

LULE f. U bë lule

LULËKUQE f. U bë lulëkuqe u skuq shumë në fytyrë (nga turpi etj.).

LULOJ jok. I lulon bahçja (edhe) në dimër i vjen e mira edhe kur s'e pret; i shkojnë punët mbarë gjithnjë.

LUMË m. Ai i lumit (i lumit) euf. shejtani, djalli, i paudhi. U bë lumë mospërf. u deh shumë u bë tapë. E hodhi lumin (përruan, vaun, hendekun) shih te HEDH 20. Është për lumë është shumë keq, është në gjendje të vështirë, është në hall të madh. Lumë e det (për lumë e për det)

LUNDËR I f. U bë lundër mospërf. u deh sa mezi qëndron më këmbë, u bë tapë, u bë bërryl.

LUNDËR II f. zool. U bë (si) lundër u ngjalla u majm shumë.

LUNDROJ jok. Lundron (noton) në një (në dy) gisht ujë shih te GISHT,~I.

LUNGË f. Iu bë lungë në zemër u brengos shumë, iu bë plagë në zemër.

LYÇ ndajf. I doli lyç diçka iu ngatërrua, iu bë lëmsh. E nxori (e qiti) lyç diçka e ngatëroi, e bëri lëmsh.

- LYEJ** kal. Të lan e të lyen keq. shih te LAJ. Ia leu dorën (duart) dikuajt keq. i dha diçka që të mos e pengonte në qëllimet e tij, të mos ia zbulonte të këqijat, t'i mbaronte një punë jashtë rregullave etj. I ka lyer duart në diçka ka marrë pjesë në një punë të keqe është përlyer, ka gisht. I ka lyer rrotën dikuajt keq. i ka dhënë mitë që t'i mbarojë një punë, t'i plotëson një kërkesë jashtë rregullave etj. E lyen me sheqer diçka shih te SHEQER, ~I. I ka lyer (i ka bërë) duart me gjak shih te GJAK, ~U I.
- LYHEM** vetv. Lahet e lyhet shih te LAHEM. Nuk lyhet (nuk fëlliqet) dielli me baltë fj. u. shih te DIELL, ~I.
- LYP** kal. I lypi (i kërkoi) dorën vjet. shih te DOR/Ë, ~A 2. Lyp gavër kërkon vend ku të futet a të fshihet, s'gjen vrimë ku të futet. Lyp (kërkon, gjurmon) qimen në vezë shih te QIM/E, ~JA. Lyp për dere e ndan për shpirt shih te DER/Ë, ~A.
- LYPËS** m. Ti lypës e unë përderës njësoj jemi, të dy nuk kemi (për diçka që e kërkojnë te njëri-tjetri dhe as njëri as tjetri s'e ka).
- LYRË** f. Shkoi lyrë leshi dikush a diçka vajti dëm diçka, shkoi kot; u muar me qafë kot dikush.
- LYTH** m. E shkeli në lyth (në kallo) dikë shih te KALLO, ~JA.
- LLAF** m. bised. Çan llaf shih te ÇAJ. E fsheh llafin shih te FSHEH. Pikë llaf! shih te PIK/Ë, ~A.
- LLAPË** f. I doli llapa u lodh shumë nga diçka; vuajti shumë. Ka llapë ka shumë fjalë, flet shumë, ka gojë. E ka llapën (gjuhën) të gjatë (të madhe) shih te GJATË (i, e).
- LLËRË** f. Përveshi llërët (krahët, mëngët) shih te PËRVESH.
- LLOÇ** m. E bëri lloç shih te BËJ.
- LLOGARI** f. Për llogari të dikuajt a të diçkaje në dobi të dikuajt a të diçkaje; për hesap të dikuajt a të diçkaje. I ndau (i qëroi) llogaritë (hesapet, lakrat) me dikë shih te NDAJ. Rregulloi llogarinë (borxhet) me dikë shih te RREGULLOJ. S'e vë në llogari (fare) dikë a diçka nuk e përfill fare, nuk e marr parasys, s'e llogarit; s'e vë në hesap.
- LLOKUM** m. Ia dha llokum në gojë dikuajt ia bëri gati çdo gjë, ia krijoi të gjitha lehtësitë.
- LLOKUME** f. Ia dha llokum në gojë dikuajt ia bëri gati çdo gjë, ia krijoi të gjitha lehtësitë.
- LLOMOTAR** mb. Gjuha gënjeshtare është llo-motare. fj. u. shih te GJUHE, ~A I 1.
- LLOZ** m. Mbeti si dyfeku pa lloz mbeti në një gjendje që s'mund të bënte gjë fare, mbeti pa mjetet e nevojshme. Hyri (shkoi) shul e doli (erdhi) lloz shih te SHUL, ~I.
- LLUCË** f. Mbeti (ngeli, ngeci) në llucë (në baltë) shih te BALT/Ë, ~A.
- LLULLË** f. Pi llullë bëj pallë, bëj qejf.
- LLUM** m. U bë llum u fëlliq shumë. E bëri llum
- MACE** f. Rri si mace e lagur mospërf. shih te LAGUR (i, e). Rri si macja nën sofër rri me frikë të madhe, rri i struktur diku nga frika. Është bërë si lëkurë maceje shih te
- MAÇ** II m. krahin. Erdhën (shkuan, ikën) me kuç e me maç (me qen e me mace) shih te KUÇ, ~I.
- MAÇOK** m. Maçok me brirë
- MADH** mb. Batall i madh (fort) iron. shih te BATALL, ~I. E bëri të madhe diçka bëri shumë zhurmë a bujë rreth diçkaje, e zmadhoi tepër, e paraqiti në mënyrë të fryrë.
- MAGNETIK** mb. Ekuatori magnetik fiz. shih tek EKUATOR, ~I. Momenti magnetik fiz. shih te MOMENT, ~I. Stuhi magnetike fiz. shih te STUHI, ~A.
- MAGJE** f. E ka zënë magjja e kanë mbytur hallet e shtëpisë, ka barrën e shtëpisë mbi vete.
- MAGJIK** mb. Sy magjik radio. shih te SY, ~RI.

- MAJ** I m. Si bora në maj shih te BOR/Ë,~A. Nuk ka kokë dëbora në maj fj. u. nuk qëndron gjatë, shkrin shpejt. Shkëndijat (shkëndijëzat) dalin në maj fj. u. shih te SHKËNDIJ/Ë,~A. Zinin majin vjet., etnogr. ngriheshin herët ditën e një majit dhe dilnin në natyrë për të festuar ardhjen e muajit të luleve (sipas një zakoni të vjetër popullor). Lule maji bot. shih te LUL/E,~JA. Zhuzhaku i majit zool. shih te ZHUZHAK,~U.
- MAJDANOZ** m. bot. Në çdo gjellë majdanoz iron. thuhet kur dikush, me vend e pa vend, merr pjesë në të gjitha punët a çështjet ose kur diçka përdoret për shumë punë edhe kur s'është nevoja.
- MAJË** f. Bën majë shih te BËJ. Bëri majë anija sapo filloi të duket larg në det
- MAJMEM** vetv. S'majmet (s'shëndoshet) kau ditën që do të theret fj. u. shih te KA,~U.
- MAJMË** mb. Flet fjalë të majme flet fjalë të mëdha. Pula e botës duket më e majme fj. u. iron. shih te PUL/Ë,~A. Zorra e majme bised. zorra e trashë.
- MAJTAS** ndajf. I priste shpata (palla, kordha, sëpata, jatagani) djathtas e majtas (nga të dy anët) shih te PRES I.
- MAKNORE** f. zool. Sillet gjithë ditën si maknore sillet si bishti i pelës.
- MAL** m. Prapa malit shumë larg, në një vend të humbur. I dha malin dikujt e detyroi të arratiset, e bëri të marrë malet. Një mal ditë një ditë të gjatë; një pjesë shumë të madhe të ditës. Është sa një mal është shumë i madh, ka përmasa shumë të mëdha (për qenie të gjalla e për sende). Sheh prapa malit (përtej bjeshke) shih te BJESHK/Ë,~A. Si mali me borë shih te BOR/Ë, ~A. Mori malet shih te MARR. Rrëzon (shemb) malet dikush shih te SHEMB. I bën malet fushë dikush është shumë i zoti e këmbëngulës, bën edhe të pamundurën. M'u bë zemra mal u gëzova shumë, u gëzova pa masë. I duken malet shesh shih te SHESH,~I.
- Është si era e malit shih tek ER/Ë,~A I. S'i bihet malit me kokë (me krye) thuhet kur diçka është e pamundur të bëhet, kur ka një pengesë madhore që nuk mund të kapërcehet kurrsesi.
- MALL** I m. Sa për mall sa për qejf, sa për të nxjerrë mallin. Është për mall diçka është shumë e mirë a shumë e bukur, është diçka që ta do zemra gjithnjë. E kishte për mall dikë a diçka e donte shumë, e kishte për zemër. Do t'i kesh mallin dikujt a diçkaje do ta kërkosh e nuk do ta gjesh më (thuhet kur dikush nuk e vlerëson si duhet dikë a diçka kur e ka). Më nxjerr (më heq) mallin e dikujt a të diçkaje shih te NXJERR 28. S'e ha malli për dikë a për diçka iron. nuk shqetësohet fare, as që bëhet merak për dikë a për diçka, aq i bën. Nuk më merr malli për dikë mospërf. nuk dua të di fare për të, nuk dua t'ia shoh fytyrën. E preu malli (barku) për dikë a për diçka iron. shih te PRES I. Rrallë e për mall shih te RRALLË 2. E bën nga halli e jo nga malli shih te HALL, ~I.
- MALL** II m. Mall belik mall pa zot, diçka e lënë pa rojë e pa kujdesie. Mall pa zot diçka, për të cilën s'kujdeset askush, diçka me të cilën gjithkush mund të bëjë ç'të dojë.
- MAN** m. bot. E shkund manin në prill shih te SHKUND. Mana toke bot. luleshtrydhet, dredhëzat.
- MANASTIR** m. Manastir pa hair vjet. shih te HAIR~I.
- MANDALL** m. Derë pa mandall shtëpi a vend tjetër ku mund të hyjë kush të dojë.
- MANDATË** f. bised. I humbtë mandata! mallk. u zhduktë e u harroftë përgjithnjë!, mos qoftë!, mos iu duk të fytyra!
- MANGËT** ndajf. Jam mangët për diçka kam nevojë për diçka; më mungon diçka. Ka një dërrasë (ca dërrasa, një hatull) mangët mospërf. shin te DËRRAS/Ë,~A. Ka një vidhë (burgji) mangët mospërf. shih te VIDH/Ë, ~A.

- S'i lë gjë mangët (metë) dikujt a diçkaje nuk qëndron aspak më poshtë se dikush a diçka tjetër, s'i mungon asgjë në krahasim me të; i ngjan shumë. Nuk ta lë mangët (metë) për nesër shih te LË.
- MANUSHAQE** f. bot. Manushaqe e verdhë bot. badër me lule të verdha, që rritet zakonisht nëpër kënetë.
- MARAQ** m. bot. Maraq i ëmbël bot. Lloj maraqi që mbillet në kopshte dhe që e ka rrëzën e kërcellit të mbështjellë me disa palë petësh të tulta, të cilat hahen si salatë ose gatuhet në mënyra të ndryshme.
- MARENË** f. bot. S'bëhet lundra me dru marene fj. u. s'vlen për një punë të caktuar, s'bëhet bukë me krunde (për një njeri ose për diçka pa vlerë).
- MARR** kal. 24. edhe jokal., edhe fig. bised. Shkoj, lëviz në një drejtim, ia mbaj nga...; ndjek një rrugë; shkoj drejt një gjendjeje (edhe në një varg njësisht frazeologjike). Mori arave (bregut, pyllit, maleve). Mori malet doli në mal. Mori kthesën. Flaka mori qiellin flaka u ngrit deri në qiell. Mori nga e djathta (nga e majta, nga jugu). Mori përperjet ë(lart, poshtë, tatëperjetë, anës). Mori për keq (për mirë). Mori shtrembër (gozhda, vidha). Mori për në fshat (për në qytet, për në veri). Mori anës lumit (anës bregut).
33. Përdoret zakonisht me emra veprimi për të formuar togfjalësha me vlerë foljesh, të cilat lidhen si nga kuptimi ashtu edhe nga ana fjalëformuese me emrat përkatës (edhe në një varg njësisht frazeologjike). Merr ajër ajroset. Mori arratinë u arratis. Merr fotografi fotoqafoj. Merr fund përfundon, mbaron. Merr gjallëri (fuqi, forcë) gjallërohet (fuqizohet, forcohet). Marr guximin guxoj. Marr hak hakmerrem.
- Jap e marr përpiqem të gjej rrugëdalje, bëj çmos për të zgjidhur diçka, për të kryer një punë etj. Japin e marrin
- MARRËDHËNIE** f. Jam në marrëdhënie pune jam në punë, punoj në një ndërmarrje a institucion. Marrëdhëniet në prodhim ek. marrëdhëniet që vendosen ndërmjet njerëzve në procesin e prodhimit, të shpërndarjes e të këmbimit të të mirave materiale dhe që dallohen para së gjithash nga lloji i pronës të mjeteve të prodhimit.
- MARRËZI** f. E ka një damar (një dell) marrëzie (marrie) shih te DAMAR, ~I.
- MARRI** f. E ka një damar (një dell) marrie (marrëzie) shih te DAMAR, ~I.
- MASAT** m. Janë (shkojnë, venë) si eshka me masatin (me urorin) shih tek ESHK/Ë, ~A.
- MASË** I f. Me masë
- MASË** III f. Në masë me shumicë. Bën masë elektr. bën qark të shkurtër e nxjerr shkëndija (kur takohen dy përcjellës të zhveshur të rrymës elektrike).
- MASHALLA** pasth. bised. Për mashalla përdoret zakonisht pas një foljeje për të shprehur një shkallë të lartë cilësie ose veprimi.
- MASHË** f. Mish në mashë shih te MISH, ~I. Duhet kapur me mashë e duhet flakur thuhet për diçka të keqe a të dëmshme, që s'e durojmë dot e që duam ta largojmë sa më parë.
- MASHKULLOR** mb. Vajzë mashkullore krahin. vajzë që është rritur midis shumë vëllezërve dhe që sillet si djalë. Gjinia mashkullore gjuh. kategori leksiko-gramatikore e emrave dhe e disa përemrave, të cilët shënojnë një frymor mashkullor ose një send që nga ana gramatikore merret si mashkull; kategori gramatikore e mbiemrave dhe e disa fjalëve të tjera që lidhen me emra a me përemra të tillë dhe që përkojnë me ta.
- MAT** kal. Mat armët me dikë shih tek ARM/Ë, ~A. I mat çapin dikujt i vete pas, e ndjek.
- MAT** II m. shah. E zuri (e bëri) mat dikë e zuri ngushtë, e bëri që të mos ketë asnjë mundësi shpëtimi, e mbërtheu me shpatulla në mur, e mundi.
- MATEM** vetv. Matu në derë! mospërf. shih te DER/Ë, ~A.

- MATEMATIK** mb. Horizont matematik astr. vija e ndërprerjes së sferës qiellore në rrafshin e horizontit.
- MATERIAL** mb. Kultura materiale tërësia e mjeteve, e orendive dhe e të mirave të tjera të krijuara nga shoqëria në një periudhë historike të caktuar. Pikë materiale (lëndore) mek. shih te LËNDOR, ~E. Provë materiale (lëndore) drejt. shih te LËNDOR, ~E.
- MAVI** mb. bised. Iu bë gjaku mavi u tremb, u frikësua shumë. U bë mavi në fytyrë u nxi nga inati etj.
- MBAHEM** vetv. Nuk i mbahet gjaku shih te GJAK, ~U I. Mbahet gjallë (në këmbë) rron ende, është, jeton. Nuk mbahet mend qysh kur ka kaluar një kohë e gjatë qysh atëherë; nuk dihet se kur ka ndodhur. Mbahet (varet) në një qime shih te QIM/E, ~JA.
- MBAJ** kal. Nuk ia mban thjeshtligj. nuk ka guxim për të bërë diçka a për t'i dalë zot një pune; ka frikë. E mbaj afër dikë shih tek AFËR 6. I mban anën dikujt shih tek AN/Ë, ~A I, 7. Ia mban avaz shih tek AVAZ, ~I. Mban një avaz (i bie një [po atij] avazi) keq. shih tek AVAZ, ~I. I mban avazin (i shkon pas avazit, i vete pas avazit) shih tek AVAZ, ~I. I mban bishtin (i shkon pas bishtit) shih te BISHT, ~I. Mbjalti (mblodhi) çaklat shih te ÇAK/ËL, ~LA. Mban dizgjinët mban drejtimin si duhet, mban frenat në dorë. Mbjal dorën e përdor diçka me kursim, nuk harxhoj shumë. Ia mbaj dorën dikujt kujdesem për të më shumë se për të tjerët. Mban një drugë përsërit gjithmonë të njëjtën gjë, mban të njëjtin avaz. S'më mban dheu shih te DHE, ~U. Ma mbajti dhëmbi shih te DHËMB, ~I. I mbaj erë diçkaje i marr erë, e nuhat. Mban flamurin
- MBANË.**
- Mbanë tjetër fj. ndërm. nga ana tjetër, përveç kësaj. Ia doli mbanë (në krye) shih te DAL 24. E qiti mbanë shih te QIT.
- MBARË** mb. Rruga (udha) e mbarë (të qoftë)! iron. i thuhet dikujt që matet të largohet për t'i treguar se nuk kanë nevojë për të dhe se mund të shkojë nga të dojë. I ka qiqrat të mbara i shkojnë mirë punët, i ka punët në rregull, e ka vënë në vijë. E sjell në rrugë (në udhë) të mbarë
- MBARË** ndajf. Nuk m'u bë mbarë edhe poh. nuk m'u dha rasti i duhur, nuk gjeta dot kohë të lirë ose të përshtatshme për të bërë diçka. I vë mbarë e mbarë i vë me radhë, i vë me rregull. I ra (vendit) mbarë e prapë (mbrapsht) s'la vend pa shkelur, i ra nga të gjitha anët. Folën (biseduan) mbarë e prapë (mbrapsht)
- MBARIM** m. Fillim e mbarim shih te FILLIM, ~I.
- MBAROJ** kal. Mbarova punë me dikë a me diçka ç'kisha për të bërë me të e bëra, s'kam më punë me të. S'të mbaron punë s'të bën gjë, s'ta plotëson një kërkesë, një lutje etj.
- MBARSEM** vetv. Nuk mbarset mushka të pjellë mëz fj. u. shih te MUSHK/Ë, ~A.
- MBART** kal. Mbart (mban) verë e pi ujë shih te VER/Ë, ~A II.
- MBATH** kal. U mbathi (ua dha, u ra) këmbëve shih te KËMB/Ë, ~A. Ia mbathi këpucët dikujt mospërf. ia tregoi qejfin, ia tregoi vendin, ia mblodhi. Ia mbathi potkonjtë dikujt mospërf. shih te POTK/UA, ~OI. Mbathe pleshtat me potkonj shih te PLESHT, ~I. S'di të mbathë as brekët mospërf., thjeshtligj. s'është i zoti a i aftë për asgjë, është fare i humbur.
- MBES** jokal. 4. Bie ose ngelem në një gjendje të caktuar (zakonisht jo të mirë), ngel pa diçka a pa dikë, ngel, mbetem; pësoj diçka (edhe në një varg njësisht frazeologjike); me një trajtë të shkurtër të përemrit vector në r. dhanore më krijohet për një kohë një gjendje e caktuar. Mbeti me barrë (shtatzënë). Mbeti e ve. Mbet jetim. Mbeti i vrar ë(i plagosur, i ngrirë).

Mbeti gjallë. Mbeti i kënaqur (i dëshpëruar). Mbeti i mahnitur (pa gojë, pa mend). Mbeti gojëthatë. Mbeti keq (si peshku pa ujë, si peshku në zall). Mbetsh me shëndet! ur. Mirë mbetsh! ur. Mbeti (është) teneqe (dërrasë, kripë, pip) mbeti pa asgjë, mbeti pa një lek në xhep.

5. Vazhdoj të jem si edhe më parë, ngel ai që kam qenë; vazhdoj të mbaj të njëjtin qëndrim; ruaj po ato veti, tipare, cilësi e pikëpamje që kam pasur, nuk ndryshoj (edhe në një varg njësisish frazeologjike); me një trajtë të shkurtër të përemrit vector në r. dhanore i ngel për një kohë të gjatë në mendje (një shqetësim, një dëshirë e paplotësuar, një fyerje etj.). Mbetën miq (shokë të pandarë). Mbeti i ndershëm tërë jetën. Mbeti sakat (çalaman, qorr, shurdh). Mbeti i pagdhundur (mendjelehtë).

Mbeti (ngeli, ngeci) në baltë shih te BALT/Ë,~A. Mbeti bitërr shih te BIT/ËRR,~RRA. Më mbeti (më ngeli) në derë dikush a diçka shih te DER/Ë,~A. Mbeti në diell shih te DIELL,~I. I mbeti (i ngeli) në dorë

MBETEM vetv. Mbetet (qëndron) në ajër shih tek AJ/ËR, ~RI. Më mbetet cingare diçka shih te CINGAR/E, ~JA. Të mbetet (të ngelet) në dorë (ndër duar) dikush a diçka shih te DOR/Ë,~A. Mbetet plloçë diçka shih te PLLOÇ/Ë,~A. Gjalpi në lakror mbetet (derdhet, bie) fj. u. shih te BIE I.

MBËRTHEHEM vetv. Iu mbërtheje goja (gjuha) nuk mund të fliste; nuk foli fare, s'e çeli gojën.

MBËRTHEJ kal. E mbërtheu (e kapi, e zuri) për fyti (për gryke) shih te FYT,~I. E mbërtheu gojën nuk foli fare, s'e çeli gojën. I mbërtheu sytë mospërf. vdiq. E mbërthej (e mbaj, e gozhdoj) në vend shih te VEND,~I.

MBËRTHYER mb. E ka gojën të mbërthyer (të kyçur) nuk flet dot.

MBËRTHYERA f. vet. sh. anat. Ia di të mbërthyerat

MBËSHTET kal. E mbështeti brinjën mospërf. vdiq.

MBËSHTETEM vetv. Mbështetet me të dyja këmbët shih te KËMB/Ë,~A. Mbështetet (vetëm) me një këmbë shih te KËMB/Ë, ~A.

MBËSHTILLEM vetv. M'u mbështoll (m'u mblodh) diçka në grykë shih te MBLIDHEM 8.

MBËSHTJELL kal. Mbështilli (mblidhi) mendtë (trutë)! shih te MEND,~TË.

MBILLET Ku mbillet s'korret dikush bredh sa nga një vend në një tjetër, ku ngryset nuk gdhiet.

MBIN jokal. I ka mbirë (i ka dalë) bari (në faqe, në sy) shih te BAR,~I 1. Më mbiu në bark m'u mërzi (për një ushqim a gjellë që e hamë shumë shpesh). I mbiu në derë keq. i vete shpesh sa e mërzi, i mbeti në derë. I mbiu në kokë (në mendje) nuk i hiqet nga mendja, aty e ka mendjen. Më mbiu në sy mospërf. shih te SY,~RI. Duket bima që kur mbin fj.u. shih te BIM/Ë,~A. I mbiu bari në faqe shih te BAR,~I I. I mbiftë ferra në derë! mallk. shih te FERR/Ë,~A. I mbiu sherri midis hairit shih te SHERR,~I. Prit gomar të mbijë bar! shih te GOMAR,~I.

MBIRË mb. Bathë e mbirë në udhë shih te BATH/Ë,~A.

MBJELL kal. Mbjell në dushk shih te DUSHK,~U. Mbjell ferra nëpër këmbë bëhet pengesë, fut ngatërresa. Është mbill e mos korr (një punë, një gjendje) është rrëmuje e madhe, është puna lëmsh, s'e merr vesh i pari të dytin. Ku mbjell nuk korr dikush nuk qëndron kurrë në një vend, s'i zënë këmbët dhe bredh pa pushim rrugëve, është rrugaç. Ç'të mbjellësh, do të korrësh fj.u. sipas punës do të kesh edhe shpërblimin; ç'të bësh, do të gjesh. Mbjell misër e korr tallë shih tek TALL/Ë,~A. Mbolli thekër e i doli gruri dikujt i vete mbarë gjithçka, i shkon puna shumë mirë. Mbolli bostan

e i dolën kastravecë iron. ndryshe e mendoj e ndryshe i doli, mendoj për mirë, po i doli keq. Kush mbjell erën, do të korrë furtunën (stuhinë) fj. u. libr. kush bën një të keqe, do ta pësojë nga një e keqe më e madhe.

MBLEDH kal. Mblodhi bishtin përb. u tërhoq, ndenji urtë e s'u ndie më (zakonisht nga frika). Mbledh (tharton, rrudh, përdredh, shtrembëron) buzët (turinj të, hundët) shih te BUZ/Ë,~A. Mblodhi (mbajti) çaklat shih te ÇAK/ËL,~LA. I mblodhi (i ngriti, i mori) çoparkat iron. shih te ÇOPARK/Ë,~A. I ka mbledhur (i ka lidhur) dengjet shih te DENG,~U. E mblodhi (e rrudhi) dorën filloi të shpenzojë më pak a të mos i prishë paratë kot, e shtrëngoi dorën. Mblidhi dhitë! shih te DHI,~A. E mblodhi fillin shih te FILL,~I. Ia ka mbledhur gjalmat e ka detyruar dikë të veprojë siç duhet, ia shtrëngoi rripat. E ka mbledhur gjuhën nuk flet më aq shumë, nuk llap më, i ka vënë fre gjuhës. Mblidhe kallaballëkun! thjeshtligj. mblidhe mendjen, mos u habit, mos fol kot! I mblodhi këmbët i pakësoi kërkesat, u bë më pak kërkues e më i thjeshtë. I mblodhi (i ndeu) këmbët mospërf. shih te NDEJ. Mbledh (shpij) kockat shih te KOCK/Ë,~A. Mbledh (rrudh) krahët (supet) shih te RRUDH. Ia mblodhi ia ngriti, leckat (rraqet) dikuajt mospërf. shih te NGRE. Mblodhi (ngriti) leckat (rraqet) mospërf. shih te NGRE. I mblodhi lotët pushoi së qari. E mblodhi mendjen

MBLEDHUR mb. Me mendje të mbledhur

MBLIDHEM vetv. U mblodh (u mbështoll) në guaskën e vet shih te GUASK/Ë,~A. Iu mblodhën këmbët mospërf. vdiq. Iu mblodh (iu mbështoll) lëmshi dikuajt iu afrua vdekja, i erdhi fundi, është afër mbarimit të jetës, po i mbaron koha. Iu mblodh

MBRAPSHT ndajf. E solli (e ktheu) mbrapsht (shtëpinë) e bëri rrëmujë, e përmbysi. I ka hipur kalit mbrapsht (së prapthi) e

ka nisur keq një punë, nuk e ka nisur për së mbari.

MBREH kal. I mbrehu (i zuri, i ngatërroi) qetë me dikë filloi të grindet a të zihet fytyrë me të, u përlesh, u kacafyt me dikë.

MBRET m. Përralla me mbret mospërf. gjepura, dokrra. I ndërron si mbreti gratë keq., thjeshtligj. i ndërron shpesh gjërat që ka.

MBRETËRI f. Mbretëria e qiellit fet. parajsja.

MBRETËROR mb. Ujë mbretëror shih tek UJ/Ë,~I.

MBRËMJE f. Mbrëmje akademike shih tek AKADEMIK,~E. Matet me hijen (me diellin) e mbrëmjes (e mëngjesit) keq. shih te MËNGJES,~I. Lule mbrëmjeje bot. shih te LUL/E,~JA. Ylli i mbrëmjes astr. shih tek YLL,~I.

MBROJTËS mb. Faqe mbrojtëse shtypshkr. shih te FAQ/E, ~JA. Përparëse mbrojtëse usht. shih te PËRPARËS/E,~JA 2.

MBULOHEM vetv. Nuk mbulohet (nuk zihet) dielli me plisa fj.u. shih te DIELL,~I. Nuk mbulohet (nuk zihet, nuk fshihet) dielli me shoshë fj.u. shih te DIELL,~I.

MBULOJ kal. E ka mbuluar bari (ia ka mbuluar varrin bari) shih te BAR,~I I. E mbuloi dobiçin e mbuloi, e fshehu fajin a gabimin që ka bërë (për të mos u turpëruar në sy të botës etj.). I mbuloi (i humbi, i fshehu) gjurmët shih te GJURM/Ë,~A. E mbuloj në hi

MBULUAR mb. Thëngjill i mbuluar (gacë e mbuluar) keq. njeri i djallëzuar, po që nuk e zbulon veten, njeri që i ka të gjitha nën lëkurë, që vepron nën rrogos; tinëzar, fsheharak.

MBURR kal. Bufi i mburr zogjtë e tij iron. shih te BUF,~I.

MBURREM vetv. Mburret (lëvdohet) në të thatë (për së thati) shih te THATË,~T (të).

- MBUSH** kal. E mbushi barkun (plëndësin) mospërf. u ngop mirë me të ngrënë. E mbushi kokën (i mbushi trutë) i mësoi të gjitha, i futi në kokë (ato që duhen ditur).
- MBUSHEM** vetv. S'i mbushet barku (plëndësi) mospërf. s'ngopet kurrë, nuk ndien të ngopur.
- MBUSHUR** mb. Është pushkë e mbushur (e ngrehur) është i gatshëm për luftë, është i përgatitur për luftë.
- MBYLL** kal. Çel e s'mbyll keq. shih te ÇEL. E mbylli defterin (i mbylli defterët) shih te DEFTER, ~I. E mbylli derën (shtëpinë) vdiq pa lënë njeri pas nga gjaku a nga familja e tij. Ia mbylli derën dikujt ia shoi të gjithë pjesëtarët e familjes, e la pa njeri; e la vetëm e të shkretë, e mjeroi. Ia ka mbyllur derën dikujt nuk e qas në shtëpi të vet. I mbyll derën (dyert, portën, shtegun, rrugën)
- MBYLLASYZASH** ndajf. Luajnë mbyllasyzash
- MBYLLEM** vetv. Iu mbyll dera (shtëpia) vdiq e s'la njeri pas, u shkretua, mbeti fare vetëm.
- MBYLLUR** mb. Me dyer të mbyllura ku nuk mund të marrë pjesë kushdo, ku marrin pjesë vetëm njerëzit që janë drejtpërdrejt të interesuar dhe që janë të autorizuar e të lejuar zyrtarisht, pa njerëz të huaj (për gjyqet, mbledhjet etj.). Plagë e mbyllur dhembje a fatkeqësi që ka kaluar dhe është mbyllur. Rreth i mbyllur (me cen) libr. shih te RRETH, ~I. Është arkë e mbyllur dikush e mban të fshehtë e nuk ua thotë të tjerëve; nuk u hapet të tjerëve; është varr i mbuluar. Është qeli e mbyllur (qeli pa dritare) dikush shih te QELI, ~A. Rimë e mbyllur let. rimë e një strofe katërshe, ku vargu i parë përkon me të katërtin dhe i dyti me të tretin (skema abba). Rrokje e mbyllur gjuh. rrokje që mbaron me një bashkëtingëllore. Zanore e mbyllur gjuh. zanore që përftohet duke e ngritur shpinën e gjuhës drejt qiellzës më shumë se kur shqiptojmë zanoret e hapura.
- MBYLLUR** ndajf. Me sy mbyllur verbazi, verbërisht. Rri me gojë mbyllur nuk flet fare, nuk nxjerr asnjë fjalë nga goja, hesht.
- MBYT** kal. S'e ka mbytur macen iron. nuk e ka treguar forcën që në fillim që t'u shtinte frikën të tjerëve, nuk ia dinë egërsinë që t'i tremben. E mbyt që në vezë diçka e pengon ose e asgjëson diçka që në fillim që sapo shfaqet, nuk e lë të zhvillohet.
- MBYTAS** ndajf. Fytas e mbytas shih te FYTAS.
- MBYTEM** vetv. Ku të mbytem? (s'kam ku të mbytem) s'kam ku të futem, s'di ku të vete që të shpëtoj nga një hall i madh, nga një turp etj. Mbytet në një pikë (lugë, gotë, filxhan, gisht) ujë mospërf. shih tek UJ/Ë, ~I. U mbyt në lumë pa ujë shih te UJ/Ë, ~I.
- MBYTUR** m. Si i mbyturi nëpër shkumë shih te SHKUM/Ë, ~A.
- ME** Me anën e... shih tek AN/Ë, ~A. Me kusht që... shih te KUSHT, ~I. Me përjashtim të... shih te PËRJASHTIM, ~I.
- MEDALJE** f. Ana tjetër e medaljes e kundërta e asaj që duket ose që pranohet si e vërtetë, ana tjetër e çështjes.
- MEDET** pasth. bised. Bën medet vajton. U bë për medet dikush a diçka ka rënë në një gjendje shumë të keqe a të vajtueshme, është bërë për ta vajtuar.
- MEIT** m. bised. U bë meit u zbeh shumë në fytyrë, u zverdh si i vdekuri.
- MEJDAN** m. vjet. Del në mejdan (në shesh) shih te SHESH, ~I. E ndau mejdanin me dikë
- MEKANIK** mb. Materializmi mekanik filoz. shih te MATERIALIZ/ËM, ~MI.
- MEKANIKË** f. Mekanika qiellore astr. degë e astronomisë që studion lëvizjen e trupave qiellorë. Rregulla e artë e mekanikës fj.u. shih tek ARTË (i, e).
- MEKTH** I m. I ra mekthi në punë u lodh e u këput, i ra bretku.
- MEL** m. bot. U bë mel u mblodh, u struk e s'u ndie më (nga frika, nga turpi etj.).

MELODIK mb. muz. Theks melodik gjuh. theks që karakterizohet nga ngritja e ulja e zërit; shkalla e lartësisë së zërit në rrokjen e theksuar.

MEMEC mb. Hartë memece gjeogr. hartë pa emra vendesh, që shërben për të ushtruar nxënësit që t'i gjejnë e t'i shënojnë vetë këta emra.

MEND f. vet. sh. 1. Aftësia e njeriut për të menduar dhe për të njohur botën, zotësia për të hyrë në thelbin e gjërave, për të shpjeguar ligjet e zhvillimit të natyrës e të shoqërisë dhe për të vepruar në përputhje me to; aftësia për të kuptuar e për të gjykuar drejt, arsye; zgjuarsi, mençuri; truri si qendër e veprimtarisë mendore, mendje (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Njeri me mend. Kaq mend ka. Është i trashë (i mpitë) nga mendtë. Punon (sillet, vepron) me mend (në kokë). E kapi me mend. Ia çau mendtë më dysh.

4. Kujtesë (edhe në një varg njësisish frazeologjike). E kam në (ndër) mend e kujtoj, e kam parasysht. E mbaj në (ndër) mend nuk e harroj. E sjell ndër (në) mend e kujtoj. Më shkon ndër mend kujtohem; mendoj. Më vjen (më bie) ndër mend më kujtohet.

Është afër mendsh (afër mendjes) shih tek AFËR. Është larg mendsh shih te LARG. S'do mend me siguri, patjetër; dihet, s'ka nevojë të thuhet, natyrisht.

MENDIM m. E përtyt mendimin shih te PËR-TYP. Vete (shkoj) me mendimin (me mendje) se... shih te MENDJ/E,~A.

MENDJE f. 1. Aftësia e njeriut për të menduar, për të njohur e për të pasqyruar botën, për të arsyetuar e për të gjykuar, që arrihet me anë të veprimtarisë së trurit; arsyeja si veti e njeriut; truri si qendër e veprimtarisë mendore; mend (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Mendje e shëndoshë. Punëtor i mendjes. Aq ia preu mendja.

6. Kujtesë, mend (edhe në një varg njësisish frazeologjike). E kam (e ruaj) në

mendje. Nuk më hiqet (nuk e largoj) nga mendja. E hoqi nga mendja. E fshiu nga mendja nuk e kujton më fare, e harroi krejt. M'u ngul në mendje. Më doli (më iku) nga mendja e harrova fare. Më erdhi (më shkoi, më vajti) në mendje m'u kujtua.

Me akull të mendjes libr. shih tek AKULL,~I. I ra mendjes (prapa) e mblodhi veten, e kuptoi më në fund diçka dhe erdhi në rrugë të mbarë. Bie në mendje (në vete) shih te BIE 1. I ka rënë në mendje për dikë a për diçka nuk i hiqet mendimi për dikë a për diçka, për atë mendon vazhdimisht. Ma do mendja shih te DUA. E fjeti mendjen shih te FLE. S'më fle mendja (karari) shih te FLE. Nuk më fle mendja te dikush a te diçka edhe poh. shih te FLE. I fluturoi mendja

MENDOJ jokal. Mendon zi ndjell diçka të keqe, parashikon diçka të keqe. Pa menduar (gjatë) pa e rrahur punën, shpejt e shpejt e pa lëkundje.

MENEKSHE f. bot. Menekshe gomari bot. bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcej të zgjatur, me gjethe të buta e të mëdha, me lule ngjyrë blu të vetmuara e me bisht më të shkurtër se gjethet.

MENGENE f. E vuri në mengene dikë e shtërëngoi me forcë dhe e detyroi të tregojë, të flasë, të bëjë diçka etj.

MERAK m. bised. E bëri për merak diçka e bëri shumë të bukur, shumë të mirë etj., e bëri që ta kesh lakmi. U bë merak u shqetësua shumë, u merakos.

MERIMANGË f. End si merimanga keq. përpiqet e ngre kurthe për të dëmtuar të tjerët prapa krahëve. Ka lëshuar (ka zënë) merimangë toka ka ardhur toka për t'u mbjellë. Hahen si merimangat në qyp shih te QYP,~I. Është lidhur me pe merimange diçka shih te PE,~RI. I kishte zënë shosha (hambari) merimanga ishte shumë i varfër, s'kishte bukë në sofër.

MERMER m. U bë mermer u nguros, ngriu; vdiq.

- MERREM** vetv. Kur s'ke pula, mos u merr me dhelprat (pse hahesh me dhelprat?) shih te PUL/Ë,~A. Më merret (më zihet) fryma shih te FRYM/Ë,~A 2. I merret (i mbahet) goja shih te GOJ/Ë,~A 7. Më merren mendtë shih te MEND,~TË. Më merren sytë shih te SY,~RI 2. Merrem vesh me dikë shih te VESH,~I. Nuk merret vesh nuk kuptohet.
- MES** m. Në këtë (atë) mes lidhur me këtë, krahas kësaj; ndërkohë, ndërkaq. Mesi i art ë(e mesmja e artë) keq. shih tek ARTË (i,e). Mes për mes tej matanë, duke kaluar nëpërmes, mu në mes. Në mes (në pikë) të ditës shih te DIT/Ë,~A. Në mes të tjerave (të tjerash) ndër të tjera, përveç atyre. I bën mes (punës) i shtrohet punës, punon mirë. Hyri (u fut) në mes ndërhyri për të lidhur a për të pajtuar dy palë ose për të mënjanuar mosmarrëveshjet që kanë. E këputi në mes
- MESDITË** f. Ana e mesditës jugu. Kush ka ditën, të mos presë mesditën fj. u. shih te DIT/Ë,~A.
- MESELE** f. bised. Doli (iku) nga meseleja s'e mbajti fjalën a premtimin, doli nga besa.
- MESËM** mb. E mesmja e artë (mesi i artë) keq. shih tek ARTË (i, e).
- METANI** f. fet. I bën metani dikujt i gjunjëzohet, i nënshtrohet duke iu lutur e duke iu falur.
- METELIK** m. vjet. Ishte pa një metelik (në xhep) ishte shumë i varfër, nuk kishte asgjë; ishte pa një grosh në xhep.
- METË** ndajf. S'i la gjë metë (mangët) dikujt a diçkaje shih te MANGËT. Nuk ta lë metë (mangët) për nesër shih te LË.
- METODË** f. Metoda globale ped., vjet. shih te GLOBAL,~E.
- MEZAT** m. vjet. E nxori në mezat diçka e nxori në shesh, bëri që ta shohin a ta marrin vesh të gjithë.
- MEZI** ndajf. Mezi e kam dikë e dua shumë.
- MË** 5. Përdoret me një emër të përsëritur në rasën kallëzore dhe formon me të togfjalëshja me kuptim ndajfoljor, që shënojnë vendin ku kryhet një veprim, kohën kur bëhet ai, mënyrën si bëhet etj. (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Bredh (vrapon, shkon) rrugë më rrugë (breg më breg, kep më kep, shteg më shteg). E kërkoi fshat më fshat (mal më mal) në çdo fshat (mal). Futej shtëpi më shtëpi futej në çdo shtëpi. Lypte (trokiste) derë më derë. Vjen kohë më kohë vjen kohë pas kohe; vjen në çdo kohë. U panë sy më sy. Qesh vesh me vesh qesh shumë. Mblidhen kokë më kokë mblidhen pranë e pranë. U përhap lajmi gojë më gojë.
6. Përdoret me një emër ose me një përemër në rasën kallëzore në togje të qëndrueshme frazeologjike me kuptime të ndryshme. E mori më qafe. I ra më qafë.
- Më vete shih te VET/E,~JA. Sa s'ka më (sa s'ka ku të vejë më) shih te KAM.
- MËHALLË** f. bised. U bëfsh një mëhallë! ur. shih te BËHEM.
- MËLÇI** f. Mëlçi (zorrë) derri shih te DERR,~I. Na hëngri mëlçinë na lodhi e na mërzi shumë, nuk e durojmë dot më, na breu. Ia vari ujkut mëlçitë në qafë iron. shih te VAR. I ka ardhur mëlçia në grykë nuk e duron dot më; s'mban dot. E ruan si qeni mëlçitë (si qeni mishin) iron. shih te QEN,~I.
- MËLLAGË** f. bot. Lule mëllage bot. shih te LUL/E,~JA. Mëllagë uji bot. takër.
- MËLLENJË** f. Mëllenjë e bardhë zool. mullibardhë.
- MËLLË** m. Më mbeti mëllë më mbeti peng, më mbeti gozhdë (zakonisht kur nuk arrijmë të bëjmë a të mbarojmë një punë).
- MËNDAFSH** m. Gur mëndafshi (liri, leshi, pambuku) bised. shih te LESH,~I.
- MËNGË** f. Mëngë në mes të kurrizit diçka e tepërt dhe e panevojshme, barrë e tepërt; diçka që nuk është në vendin e vet. Të kap për mëngë të zë e të kujton shpesh

për një hua a për diçka tjetër që i ke marrë. Përvesh mëngët (llërat, krahët) shih te PËRVESH.

MËNGJES m. Në një mëngjes të bukur një ditë në mëngjes, dikur papritur e pa kujtuar. Matet me hijen (me diellin) e mëngjesit (e mbrëmjes) keq. e vlerëson veten më shumë se sa është në të vërtetë, është mendjemadh, e mburr veten e nënvlerëson të tjerët. U zhduk (humbi, shkriu) si vesa e mëngjesit (si vesa në diell) shih te VES/Ë,~A. Dielli duket (shihet) që në mëngjes (që kur lind) fj. u. shih te DIELL,~I. Dita e mirë (moti i mirë) duket që në mëngjes fj. u. vlerat, anët e mira të dikujt a të diçkaje duken që në fillim, se si do të jetë dikush a diçka duket që në krye. Ç'pëstyn në mëngjes, e lëpin në darkë shih te LËPIJ. Lule mëngjesi bot. shih te LUL/E,~JA. Ylli i Mëngjesit astr. shih tek YLL,~I 1.

MËNYRË f. Me çdo mënyrë me çdo kusht, me doemos, patjetër. Në asnjë mënyrë kurrsesi.

MËNJanë Heq (vë) mënjane diçka e ndaj dhe e vë diku për ta kursyer, e ruaj veçan, e vloy.

MËRSINË f. bot. Mërsinë mali rrush thëllëze.

MËSALLË f. Mësallë me dy faqe njeri që për të mbrojtur interesat e veta ndërron qëndrim e pikëpamje, njeri që ndryshe flet e ndryshe vepron, njeri me dy fytyra.

MËSHIRË f. E la në mëshirë të fatit dikë a diçka e la jashtë, në rrugë të madhe; e braktisi pa treguar asnjë kujdes për të.

MËSHOJ kal. bised. I mëshoi dorës mbi dikë e goditi dikë fort me dorë a me pëllëmbë, e rrahu.

MËZ m. Del si mëzi para pelës keq. nuk përmbahet; flet pa radhë, para se të flasin të mëdhenjtë. Nuk mbarset mushka të pjellë mëz fj.u. shih te MUSHK/Ë,~A.

MI m. Dasmë minjsh rrëmuje e madhe, zallahi. Është si miu në hauz (në poç) shih te HAUZ,~I. Është (ka rënë) si

miu në miell shih te MIELL,~I. Atij i bren miu pallën thuhet për një njeri që është shumë fatkeq e shumë i pazoti e i humbur. Ka frikë (trembet) edhe nga miu mospërf. është shumë frikacak. E ka lëpirë miu dikë shih te LËPIJ. Heq (vuan) si miu në mur (si gjarpri nën gur) shih te GJARP/ËR,~RI. Hyn (futet) në vrimë të miut shih te VRIM/Ë,~A. Shkojnë (venë) si macja me miun shih te MAC/E,~JA. I vë zile miut trillion gjëra të paqena, shpif e përhap fjalë për gjëra që s'kanë ndodhur kurrë. Bie miu e thyen kokën diku nuk ka asgjë atje, nuk ka gjë prej gjëje; është bosh, s'ka asgjë për të ngrënë. S'kishte ç't'i hante miu pas darke ishte shumë i varfër e i këputur, nuk kishte gjë prej gjëje. Miu ha grepin, macja ha miun gjithkujt mund t'i vijë e keqja nga diçka, nuk ka qenie që të jetë e siguruar nga çdo rrezik. U mbars mali e polli një mi fj. u. shih te MAL,~I. Ç'len prej maces (ç'pjell macja), gjuan minj fj. u. keq. shih te MAC/E,~JA. Vrima e miut - pesëqind grosh thuhet kur njerëzve u kanoset një rrezik i madh dhe s'dinë ku të futen që të shpëtojnë. Bar miu bot. shpargull. Bisht miu bot. shih te BISHTMI,~U. Zog miu (zog ferre, zog shtrige) zool. shih te ZOG,~U.

MIDE f. bised. Nuk e tret mideja diçka është e pabesueshme, nuk besohet, nuk hahet, është gënjeshtër.

MIDIS parafj. Midis të tjerash ndër të tjera, bashkë me të tjerat; përveç kësaj. Bie (është, ndodhet) midis (në mes dy) zjarresh shih te ZJARR,~I. Le të mbesë midis (ndërmjet) nesh! shih te MBES.

MIELL m. Bukë e një mielli keq. shih te BUK/Ë,~A. I ka rënë mielli është thinjur krejt. Bluan miell të hollë thotë gjëra të mençura, pret hollë, është i mprehtë nga mendja. E bën drithë e miell mospërf. shih te DRITH/Ë,~I. Është (ka rënë) si miu në miell është (ka rënë) në mes të gjitha të mirave, është si veshka në mes të dhjavit. Marrin miell hua shih te HUA,~JA. I merr krundet për

- miell mashtrohet lehtë, e merr sapunin për djathë. Nuk është miell i thesit të tij nuk ka dalë nga mendja e tij (për një punë, vepër, mendim etj), po është i tjetër kujt, i botës. Mielli nga thesi i botës (i huaj) iron. është punë a vepër e tjetërkujt, s'është vepër origjinale e dikujt; fjalë, mendim etj., që është marrë nga të tjerët. Kemi ngrënë një hambar miell (një furrë bukë, një thes a një barrë kripë) bashkë shih te **FURR/Ë,~A**. I lirë në miell, i shtrenjtë në krunde fj. u. nuk kursen aty ku duhet. Shto ujë e shto miell mospërf. shih te **SHTOJ**. Guri që punon shtruar bën miell të butë fj. u. shih te **SHTRUAR**.
- MIH** kal. Mih (prashit, lëron) në ujë shih tek **UJ/Ë,~I**. Mih (prashit) para vetes shih te **VET/E,~A**.
- MIJË** f. Me mijë për qind me siguri të plotë; patjetër. Gjysma e mijës (është) pesëqind! mos u mërzit e mos u mendo shumë!, të bëhet si të bëhet!, mos e vra mendjen shumë!; të dalë ku të dalë!
- MIK** m. Mik i paftuar njeri i padëshirueshëm; armik. E lau mikun (vëllanë) etnogr. shih te **LAJ 7**.
- MILINGONË** f. zool. Po shtive milingonën (mizën), të iku hambari fj. u. shih te **SHTIE**.
- MILL** m. Një mill s'i nxë dy jataganë fj. u. shih te **JATAGAN,~I**.
- MINARE** f. Nuk futet (nuk hyn, nuk fshihet) minarja (hosteni) në thes fj. u. nuk mund të fshihet një e vërtetë që duket sheshit.
- MINDER** m. Njeri i minderit keq. njeri që ka qejf të rrijë rehat ose të ketë një detyrë të lartë e të rehatshme; njeri i kolltukut.
- MINË** f. Fushë me mina fushë veprimtarie a detyrë me shumë rreziqe të papritura.
- MINISTËR** m. Ministër fuqplotë dipl. i dërguar i jashtëzakonshëm pranë qeverisë së një vendi tjetër, i një shkalle më të ulët se ambasadori.
- MINUSHË** f. Ia bëri minushë ia mbathi vrapit, iku me të katra.
- MINUTË** f. Në atë (këtë) minutë menjëherë, shpejt; në çast. Orë e minutë shih tek **OR/Ë,~A I**. E presim nga minuta në minutë e presim shpejt, nga çasti në çast. Ç'sjell minuta, s'e sjell ora (s'e sjell moti) fj. u. mund të ndodhë papritur një gjë e rëndësishme në një çast shumë të shkurtër.
- MIRË** f. Ia di për të mirë (për nder) dikujt shih te **DI**. Është me të mirat dikush është me qejf, duron e nuk zemërohet. Fjettë të mirën! mallk. shih te **FLE**. Të marrtë e mira (e mbara)! ur. shih te **MARR**. I bie së mirës (bukës) me shkelma (me këmbë) shih te **SHKELM,~I**. E gjen e mira vetë është njeri fatlumtur, i shkon mbarë çdo gjë. E mira e ka të mirën fj. u. kush bën mirë, gjen mirë. I zuri sytë e mira (buka) shih te **BUK/Ë,~A**.
- MIRË** mb. Për fat të mirë shih te **FAT,~I**. Me hënë (me hënëz) të mirë shih te **HËN/Ë,~A**. Një pjesë e mirë qeniesh a sendesh pothuaj shumica, shumë prej tyre. Bën figurë të mirë (të keqe) libr. shih te **FIGUR/Ë,~A**. I dha një mësim të mirë e qortoi ose e ndëshkoi ashtu si duhet që të zërë mend njëherë e mirë. Mori një mësim të mirë shih te **MËSIM,~I 6**. E ka (e sheh) me sy të mirë dikë shih te **SY,~RI**. E ka thuan të mirë shih te **THUA, THOI**. E përcolli me fjalë të mira e përcolli me premtime, pa i dhënë ndihmë konkrete. Po i shtie çyrekët të mirë (bukët të mira) shih te **SHTIE**. Djathë i mirë (gjalpë, dhjamë) në lëkurë të qenit përçm. shih te **QEN,~I**. Fjalë të mira e gurë në trastë (në torbë, në thes) shih te **GUR,~I**. Kali i mirë njihet nën mutaf fj. u. shih te **MUTAF,~I**. Kroi (pusi) i mirë njihet në kohë të thatë fj. u. shih te **KRUA, KROI**. Kur s'ke grurë, e mirë është edhe thekra fj. u. shih te **THEK/ËR,~RA**. Zonjë e mirë euf. shih te **ZONJ/Ë,~A**.
- MIRË** ndajf. Sa mirë! përdoret kur shprehim kënaqësi ose miratim për dikë a për

diçka që e shohim, e dëgjojmë etj. Si jo më mirë shumë mirë, s'ka si bëhet më mirë. I bëri mirë dikujt diçka i solli dobi (një bar për shëndetin, një vërejtje e qortim për sjelljen, qëndrimin etj.). Doli (u nda) mirë dikush doli me fitim, doli faqebardhë. Mirë e mirë shumë mirë; shumë, fort. Mirë e bukur plotësisht, aq sa duhet; deri në fund, krejtësisht. Mirë a keq ashtu si mund ose aq sa mund, ashtu si di; në një farë mënyre. Një herë e mirë një herë e përgjithmonë, përfundimisht, për përgjithnjë. Mirë ia bëri (mirë ia punoi) veprimi si kishte hak, i dha me të drejtë një mësim. E ka mirë me dikë ka marrëdhënie të mira miqësore e shoqërore me dikë, i shkon fjala tek ai, merret vesh mirë me të. Më vjen mirë gëzohem, më bëhet qejfi. S'e ke as për mirë as për keq dikë s'e ke për asgjë, nuk të ndihmon dot, nuk sjell asnjë dobi. I është futur (i ka hyrë) mirë rolit libr. shih te FUTEM. Laje gojën mirë (me uthull)! iron. shih te LAJ. E mprehu mirë lapsin (penën) libr. shih te PEN/Ë,~A. Pa u tharë mirë boja libr. shih te BOJ/Ë,~A. Më mirë shkelmi se helmi fj. u. shih te SHKELM,~I. Më mirë të të dalë syri sesa nami fj. u. shih te SY,~RI. Më mirë djepin thatë (bosh) se shejtanin brenda fj. u. shih te DJEP,~I. Më mirë të shkojë kryet (koka) se fytyra fj. u. shih te KRYE,~T.

MISËR m. Ia bëri dhëmbët misër dikujt ia bëri dhëmbët copë-copë. ia dërrmoi dhëmbët duke e goditur në fytyrë. Mbjell misër e korr tallë punon e shpreson për shumë, por s'merr gjë. Ai mulli s'e bluan dot atë misër shih te MULLI,~RI. Bloza e misrit shih te BLOZË,~A 3. Fletë misri bot. shih te FLET/Ë,~A I. Krimbi i misrit zool. shih te KRIMB, ~I 2. Morri i misrit zool. shih te MORR,~I 2. Zhuzhaku i misrit zool. shih te ZHUZHAK,~U.

MISTRI f. Është usta pa mistri ka dije, por nuk ka mjete dhe nuk di ta organizojë mirë punën.

MISH m. Ka (shumë) mish është i shëndoshë, po jo i shkathët. Ka vënë mish është shëndoshur shumë, është ngjallur. Ka këputur mish shih te KËPUT. Ka lidhur mish shih te LIDH. Mish i huaj shih te HUAJ (i, e). Me mish e me gjak (me kocka) i gjallë, i tëri, ai vetë (për dikë që ngjan shumë me një tjetër). Me mish e me shpirt me të gjitha forcat e mundësitë; me gjithë zemër, me dëshirë të madhe; fort, shumë. Mish pas lajmësi shih te LAJMËS,~I. Mish në mashë i zhveshur e i zbatshur, lakuriq. Mishi i mishit fëmija i fëmijës tim (si më i dashur e më i ëmbël për mua). As mish as peshk i papërcaktuar mirë, pa tipare të dalluara mirë e pa një vlerë të qartë, as verë as uthull. Mish për top keq. shih tek TOP,~I. Ia nxiu mishrat e rrahu fort, e shembi në dru. Iu bënë duart (këmbët) mish iu gjakosën duart nga puna e rëndë a këmbët nga të ecurit zbatshur, i ranë duart (këmbët) copë. E bëri mish e gjak shih te GJAK,~U I. U bëlesh e mish me dikë shih te LESH,~I. U bë mish për hell shih te HELL,~I. Një copë mish me dy sy mospërf. njeri i trashë që s'kupton kurrëgjë, buf.

MISH as. Iu ngjeth (iu drodh) mishtë

MIZË f. I djeg miza shih te DJEG. Nuk dëgjohet (nuk ndihet) as miza zotëron një heshtje e madhe, është qetësi e plotë, nuk pipëtin asgjë. I futi (i shtiu) mizat: (xixat) dikujt shih te FUT. I hynë mizat

MIZËRON jokal. Më mizëron koka më zien koka (nga punët, nga hallet etj.).

MJAFT Mjaft që... përdoret për të lidhur fjalinë drejtuese me fjalinë e varur kush-tore, e cila shpreh kushtin që është i mjaftueshëm për t'u kryer veprimi. Mjaft më!

MJALTË m. Ka rënë në mjaltë ka rënë në një gjendje shumë të mirë, në një familje a rreth shoqëror shumë të mirë, është si veshka në mos të dhjamit, jeton në mes të gjitha të mirave. Mjaltë e qumësht një lloj melhemi popullor, me të cilin lyhet

- vendi i kafshuar nga nusja e lalës. Muaji i mjaltit shih te MUAJ,~I. Vesa e mjaltit shih te VES/Ë,~A. I ra sëpata (shpata, luga, thika, sqepi) në mjaltë rastisi në rrethana shumë të përshtatshme e pati shumë përfitime; i eci mbarë një punë. Është mjaltë e qumësht është shumë i mirë, shumë i këndshëm. E ka mjaltë e sheqer (mjaltë e qumësht, mjaltë e gjalpë) me dikë shkon shumë mirë me dikë, ka marrëdhënie shumë të mira me të; e duan shumë njëri-tjetrin. I dha një gisht mjaltë dikujt shih te GISHT,~I. Ka ngrënë bukë e mjaltë me dikë ka shkuar shumë mirë me të. Ka ngrënë më shumë mjaltë se bukë
- MJEGULL** f. Si në (nëpër) mjegull (nëpër tym) turbull, jo qartë; si në ëndërr, si nëpër të. Iku (doli) tym e mjegull iku me rrëmbim, doli furishëm. Mbeti si rosa në mjegull shih te ROS/Ë,~A.
- MJEKËR** f. I digjet mjekra (koka) është në gjendje shumë të vështirë, është në hall të madh, po i luan mendja e kokës për diçka e s'di si t'ia bëjë. I dridhet mjekra (buza) shih te BUZË,~A. Lëshofsh mjekër! shih te LËSHOJ. I rroi mjekrën shih te RRUAJ. Më doli mjekra (më dolën thinjat) duke pritur kam një kohë të gjatë që po pres, u mërzi duke pritur. Nën hundën e mjekrën e dikujt shih te HUND/Ë,~A. Nuk ka mjekër për Qabe mospërf nuk është i zoti për një punë, nuk e bën dot atë punë. Hëm të vë plak, hëm të rruan mjekrën edhe të ngarkon një punë a detyrë, edhe nuk të pyet ose nuk të përfill fare. Tjetrit i digjet mjekra, ai kërkon të ndezë cigaren dikush ka halle të mëdha, kurse një tjetër e shqetëson për të mbaruar punën e vet.
- MJEL** kal. Milte dy qyqe dele (dhi) ishte fshatar i varfër, ishte i këputur.
- MJELLMË** f. zool. Kënga e mjellmës libr. vepra e fundit e një shkrimtari, piktori, kompozitori etj., shfaqja e fundit e talentit të një krijuesi (sipas një legjende se gjoja mjellma këndon vetëm një herë, përpara vdekjes).
- MJERIM** m. E piu gjithë kupën e mjerimit (e hidhërimit) libr. shih te KUP/Ë,~A.
- MJET** I m. Mjetet e prodhimit ek. tërësia e veglave dhe e objekteve të punës që përdorin njerëzit në procesin e punës për të përvetësuar lëndët natyrore dhe për të prodhuar të mirat materiale.
- MOH** m. I ra moh (hasha) e mohoi diçka që ka thënë ose që ia ngjitin të tjerët.
- MOKËR** f. Kërkon për mokra keq. flet kot, bluan, grin. I vuri mokrat në këmbë e pengoi, nuk e la të bëjë diçka.
- MOLLË** f. Si kokërr molle (thane) shumë mirë me shëndet. Mollë e ndaluar libr. diçka që nuk lejohet të përdoret a të shfrytëzohet, diçka që nuk lejohet të bëhet. Mollë e pandarë shih te PANDARË (i, e). Mollë sherri shkak grindjeje, sherri a përçarjeje ndërmjet dy njerëzve, dy palëve etj. Vajti te molla e kuqe
- MOLLËZ** I f. Mollëza (molla) e fytit anat. fikthi.
- MOMENT** m. libr. Momenti elektrik fiz. madhësia që del nga prodhimi i ngarkesës elektrike me largësinë e saj nga një pikë e dhënë. Momenti magnetik fiz. madhësia që del nga prodhimi i intensitetit të frymës elektrike me sipërfaqen që rrethohet nga një lak me rrymë. Momenti (rrotullues) i forcës fiz. madhësia që del nga shumëzimi i forcës me krahun e saj.
- MONEDHË** f. Monedhë shkëmbimi (këmbimi) libr. shih te SHKËMBIM,~I. Ç' monedhë është? mospërf. ç'lloj njeriu është, çfarë njeriu është? Iu përgjigj (ia ktheu, ia shpërbleu) me të njëjtën monedhë libr. iu përgjigj a iu soll në të njëjtën mënyrë.
- MONOPOLIST** mb. Kapitalizëm monopolist shih te KAPITALIZ/ËM,~MI.
- MONUMENT** m. I ngritën monument libr. e ngritën shumë lart, i thurën lavde dikujt a diçkaje.

- MORT** m. bised. Ishte (fare) mort ishte shumë i shëmtuar, s' shihej me sy. Goja (fjala) s' bën mort nuk vdes me të vërtetë një njeri ngaqë dikush e zë në gojë vdekjen e tij.
- MORTJE** f. Iu shpif mortja u frikësua shumë, u tmerrua. E shpëlaftë mortja (kolera)! mallk. shih te SHPËLAJ. I dolën djerstet e mortjes (e vdekjes) u lodh shumë, u rraskapit, u lodh për vdekje. E ka mortje (të dytë) dikë a diçka e urren shumë dikë a diçka, s' e sheh dot me sy, e ka vdekje. Është mortja e tij dikush a diçka
- MORR** m. zool. As një morr qorr asgjë, asgjësend, kurrjë. Iu bë morr dikujt thjeshtligj., mospërf. iu ngjit e s'iu nda (për dikë që nuk e duam, që na mërzi etj.). S' e gjeti asnjë morr dëm thjeshtligj. nuk pësoi as dëmin më të vogël, s' humbi asgjë.
- MOS** pj. Si mos përdoret para një emri ose midis trajtave të njëjta të një emri që përsëritet, me kuptimin Â«shumë i mirë, që s' e ka shokunÂ» (p.sh. si mos burrë, vajzë si mos vajzë).
- MOSHË** f. Është (ka hyrë, erdhi) në moshë
- MOT** m. Mot e jetë gjithnjë, gjithmonë. Mot e zaman vjet. vazhdimisht, që prej shumë kohësh, që kur s' mbahet mend. Për jetë e mot gjithnjë, gjithmonë. Kokrra e motit shih te KOK/ËRR, ~RRA. U përzie moti shih te PËRZIEJ. Po rëndon moti shih te RËNDOJ. I shtyrë në mot mjaft i moshuar, i vjetër, plak. Iu bë sahati mot dikujt shih te SAHAT, ~I. Ç' sjell sahati nuk sjell moti fj. u. shih te SAHAT, ~I.
- MOT** ndajf. Sot e mot shih te SOT. Lagu sot e rruhu mot shih te LAGEM.
- MOTËR** f. Janë motër e vëlla
- MPIHEM** vetv. Kur s' ha kumbulla, s' të mpihen dhëmbët (dhëmballët) fj.u. pa bërë gjë s' ke pse të shqetësohesh, s' ke pse të kesh frikë (i thuhet zakonisht dikujt që ka bërë një faj a gabim, por shtiret sikur nuk është fajtor). Djemtë (fëmijët) hanë kumbulla (thana), pleqve u mpihen dhëmbët iron. njëri bën një veprim dhe dikush tjetër shqetësohet pa nevojë për të.
- MPREH** kal. Mpreh armët përgatitet për luftë. Mpreh dhëmbët
- MPREHTË** mb. E mban (e ka) penën të mprehtë shih te PEN/Ë, ~A. E vështroi me sy të mprehtë e vështroi me vëmendje të madhe, e vështroi me mprehtësi.
- MPREHUR** mb. Qëndrojmë me armë të mprehura jemi të gatshëm e të përgatitur për të përballuar çdo sulm, jemi syhapët e të gatshëm kundër çdo armiku. Rrinte (dëgjonte) me veshë të mprehur dëgjonte mirë e me kujdes që të mos i shpëtonte asgjë, rrinte i përqendruar e i vëmendshëm.
- MREKULLI** f. Për mrekulli
- MRET** m. bot. Mret i egër rrushkull, therpelë.
- MRRUDH** kal. E mrrudhi gojën nuk e hapi gojën për të folur, e mblodhi, e mbylli gojën.
- MU** II onomat. Bën mu bised. Është fare e qartë, duket sheshit, bie në sy menjëherë.
- MUAJ** m. Muaji i mjaltit muaji i parë i jetës bashkëshortore. Ato të muajit euf. gjakrat, të larat, zakonet.
- MUÇITEM** vetv. krahin. Iu muçit zemra iu mbush zemra me maraz.
- MUHABET** m. bised. S' më hahet muhabeti me dikë edhe poh. s' më pëlqen shoqëria a miqësia me dikë, nuk ma ka ënda të rri, të flas ose të kem marrëdhënie me të. Kam muhabet me dikë e njoh aq sa mund t' i kërkoj diçka, kam pak miqësi me të. I pushon muhabetit dikush shih te PUSHOJ. E trashi muhabetin shih tek TRASH 7. E zgjat muhabetin me dikë shih te ZGJAT. Sa për t' u gjendur në muhabet (në fjalë) shih te GJENDEM. E bën muhabetin fjollë shih te FJOLLË. E pritën me muhabet deri në gju dikë shih te GJU, ~RI. E sjell gajtan muhabetin shih te GAJTAN, ~I.

- MULLAR** m. E bëjnë ujin mullar nxjerrin kripë, bëjnë togje kripe nga uji i detit. S'bën macja mullar fj.u. mos prit punë a përfundime të mira nga një njeri i pazoti, s'të zgjidh dot gjë një njeri i paaftë. Ia vuri majën mullarit e çoi punën deri në fund, e kreu ashtu si duhet; e zgjidhi diçka drejt. Kërkon gjilpërën (qimen) në mullar (në kashtë, në bar) shih te **GJILPËR/Ë,~A**. Kur m'u dogjën mullarët, njoha miqtë e kumbarët fj.u. miku a shoku i vërtetë njihet kur jemi në gjendje të vështirë, kur na kanoset një rrezik.
- MULLARTHI** ndajf. Erdhi mullarthi me dikë u soll vërdallë pas tij, e mundoi shumë.
- MULLË** f. bised. Zuri mullën hëngri pak sa të thyej urinë. I është bërë mullë në bark i është ngjitur nga pas e s'i ndahet (i është qepur e po e mërzit vazhdimisht). I është qepur mulla për shpine s'ka ngrënë asgjë, e ka barkun fare bosh, i është bërë barku petë.
- MULLËZ** f. Kështu e ka zënë mullëzën kështu ka lindur, kështu është ngjizur; kështu është rritur e kështu vazhdon të jetojë, këtë jetë ka bërë e kështu është mësuar që në fillim.
- MULLI** m. Flet në mulli mospërf. nuk ia dëgjojnë fjalën, këshillën etj.; s'ia vë veshin askush, i shkojnë fjalët kot. Është gur mulliri
- MULLIS** m. Secili të vetën, mullisi të ujit (secili ka hallin e vet, kurse mullisi të ujit) secili ka hallet e shqetësimet e veta; gjithkush sheh hallin e vet.
- MUND** I jokal. Aq munda, aq shkundi shih te **SHKUND**.
- MUNDUAR** mb. I veçuari, i munduari fj.u. kush ndahet nga shokët është i pa-fuqishëm e vuan, bashkimi bën fuqinë.
- MUNGOJ** jokal. I mungon një dërrasë shih te **DËRRAS/Ë,~A**. I mungojnë dhitë shih te **DHI,~A**. Nuk i mungon asnjë qime shih te **QIM/E,~JA**.
- MUNXË** f. bised. I dha munxët e përzuri me mospërfillje a me përbuzje, i dha duart.
- MUR** m. Fol me murin (nuk flitet me murin) thuhet kur kemi të bëjmë me një njeri shumë kokëfortë a shumë mendjemadh që nuk merr vesh a nuk ua vë veshin fare fjalëve të të tjerëve. Nuse për mur (nuse muri) nuse që i rri mikut ose burrit më këmbë dhe që bën çfarë i thotë ai, nuse e qëmoçme. S'ka dalë jashtë mureve të shtëpisë (të zyrës) s'ka dalë në jetë, nuk është futur në jetë, nuk e njeh jetën e gjallë; nuk është i lidhur me njerëzit, nuk interesohet për punë të tjera përveç punëve të veta a të qendrës së tij të punës. Heq (vuan) si miu në mur (si gjarpri nën gur) shih te **GJARP/ËR,~RI**. Është mbyllur brenda (katër) mureve të shtëpisë të (zyrës etj.) rri vazhdimisht brenda, nuk e njeh jetën e gjallë, nuk është i lidhur me njerëzit e me jetën, interesohet vetëm për punën e vet. Kërkoftë murin me dorë! mallk. u verboftë! Është për ta ngjitur pas muri është shumë i dobët nga shëndeti, është bërë kockë e lëkurë. Është për t'u përplasur në mur (pas murit) nuk vlen fare, s'ka asnjë vlerë, është për t'u flakur, është për të rrahur murin me të. Është për të rrahur murin me të mospërf. shih te **RRAH**. I kanë mbetur (vetëm) katër muret ka mbetur shkretë, pa njeri; ka mbetur pa gjë në shtëpi. Kujt i flet murit? shih te **FLAS**. Rri e mban murin rri e pret kot. I shtiu (i vuri) krahët murit (derës) shih te **KRAH,~U 3**. I vuri (e mbërtheu) me shpatulla në mur (pas murit) e mbërtheu keq me fjalë duke i treguar gabimin a fajin që ka bërë; e detyroi të pranojë fajin, gabimin etj., ia mblodhi, ia tregoi vendin. Ajo baltë për atë mur është përçm. shih te **BALT/Ë,~A**. Burri në shkallë, po shkallë në mur fj.u. shih te **SHKALL/Ë,~A**. Fol o mur, fol o gur! shih te **GUR,~I**. Gur gur bëhet mur fj.u. ca e nga ca mbarohet një punë e rëndësishme, pak e nga pak mund të arrish diçka të madhe. Një gur s'bën (s'çon) mur fj.u. shih te **MUR,~I**. Muri luan,

- burri s'luan fj, u. ai që është burrë e mban fjalën. S'i bihet murit me kokë fj.u. s'duhet t'ia hysh një veprimi krejt të paarsyeshëm, është e kotë të nisësh diçka të pamundshme. Shkul një gur nga një mur (shkul një qime nga një derr) shih te SHKUL. Fusha ka sy e muri (pylli, gardhi, mali) ka veshë fj.u. shih te FUSH/Ë,~A. Hardhia e mureve shih te HARDHI,~A.
- MURG** m. Murgu i natës mit. plak shpirtkeq që besohej se jetonte duke bredhur natën për të dënuar njerëzit, për të bërë dëme etj. (sipas besëtytnive).
- MURGESHË** I f. Ka zemër murgeshë ka mëshirë e keqardhje kristiane për këdo pa përjashtim, nuk e ndan të mirin nga i ligu.
- MURGË** I f. Rrinte si murga në linjë rrinte pa folur asnjë fjalë, rrinte e heshtur dhe e shushatur.
- MURTAJË** f. mjek. I kalli (i futi) murtajën (flamën) dikujt a diçkaje thjeshtligj. shih te KALL. Murtaja e bardhë mjek. tu-berkulozi.
- MURRAN** m. I ka fryrë murrani në qese ka mbetur pa asnjë lek në xhep, ka mbetur trokë.
- MURRIZ** m. bot. E bën murrizin hardhi e zbukuron jashtë mase diçka; e paraqet diçka të keqe si të mirë, e bën ferrën pëlle. Më mbeti murriz në zemër më mbeti merak, më mbeti gozhdë në zemër. Fshiji buzët (mustaqet) për murrizi (pas murrizit)! iron. shih te BUZ/Ë,~A. Gjithkujt murrizi i vet i duket i njomë fj.u. iron. thuhet kur dikush lavdëron tepër gjërat e veta, fëmijët e vet a punën e vet, edhe kur nuk e meritojnë.
- MUSTAK** m. Lule mustak shih te LUL/E,~JA.
- MUSTAQE** f. kryes. sh. Burrë me (një barrë) mustaqe
- MUSHAMA** f. Është flori në mushama është shumë i mirë, shumë i pastër e pa asnjë njollë; është njeri me shumë vlerë.
- MUSHKË** f. Kur të pjellë mushka iron. as-njëherë, kurrë. I pjell edhe kau (mushka) dikujt shih te KA,~U. Ku të shpie (të çon) mushka!? ç'bën ashtu, ku vete, s'e sheh sa gabim po vepron, nuk po e kupton se në ç'gjendje të keqe po e çon veten, se si po katandisesh!? Ashtu (kështu) i do mushka drutë keq.
- MUSHKËRI** f. kryes. sh. Bërtiti (thirri, foli, këndoi) me të gjithë (me tërë) mushkëritë bërtiti me zë shumë të lartë, me sa fuqi që kishte. Ia hëngri mushkëritë dikujt e mërziiti dhe e mundoi shumë, e sfliti, ia plasi shpirtin, ia mori shpirtin (thuhet sidomos për mundimet që u shkaktojnë fëmijët prindërve).
- MUSHKËROR** mb. Pema mushkërore anat. shih te PEM/Ë,~A.
- MUSHKONJË** f. zool. S'trembet ujku nga mushkonjat fj.u. shih tek UJK,~U.
- MUSHT** m. Ka marrë musht ka marrë forca, ka marrë fuqi.
- MUTAF** m. Kali i mirë njihet nën mutaf fj.u. njeriu njihet në punë e sipër, njeriu duhet çmuar nga puna që bën.
- MUZIKË** f. Më pas i dëgjohet muzika diçkaje më vonë do të bëjë jehonë, më pas do të merret vesh ç'është, pastaj i del tymi (zakonisht për diçka jo të mirë, që s'kuptohet menjëherë). Çelës muzike muz. shih te ÇELËS,~I 6.
- MYK** m. Bie (mban) erë myk diku ka mendime të prapambetura e të dëmshme; është një gjendje e tillë që tregon se punët kanë mbetur në vend, ka amulli të madhe. Ka zënë myk (ndryshk) diçka shih te ZË.
- MYKEM** vetv. I është mykur buka dikujt shih te BUK/Ë,~A.
- MYKË** f. Plak i mykës (plak në mykë) plak shumë i vjetër, njeri i rënduar nga ple-qëria, me një këmbë në varr. E do me mykë (kokës) është shumë kokëfortë, s'merr vesh me fjalë dhe e kërkon me të egër e me forcë. Ia ktheu nga myka dikujt nuk kujdeset, nuk shqetësohet, nuk pyet më për dikë, s'do t'ia dijë më për të, i

- ktheu krahët. I pret edhe myka i shkon fjala për çdo gjë, nuk ia kthejnë kurrë fjalën, s'ia bëjnë fjalën dysh. I vajti në mykë për diçka iu tek për diçka dhe e do patjetër, s'duron dot pa të, i hipi (kryesisht për ndonjë ushqim, për duhan a për ndonjë dëshirë tjetër). Shkojnë mykë e pykë shkojnë shumë keq njëri me tjetrin, zihen keq e s'i lëshojnë udh ënjëri-tjetrit. Myka e di sa e fortë është gozhda fj. u. ai që e bën punën e di se ç'vështirësi ka ajo.
- MYS** m. Hiqe mys diçka! mos e zgjat më!, mos mendo më për të!, ka marrë fund ajo punë. Ia hoqi mysin asaj pune nuk ka më shpresë të rregullohet ajo punë, hoqi dorë prej saj, ia hoqi fillin.
- NALLBAN** m. E pësoi (e kërkoi, vajti) si breshka te nallbani shih te BRESHK/Ë,~A.
- NAM** m. bised. Me nam (me një folje) shumë mirë, fort bukur. La nam shih te LË. Pa nam e pa nishan (as nam, as nishan) pa lënë asnjë gjurmë; krejt, fare, asgjë. Nuk i gjendet as nami as nishani është zhdukur fare, pa lënë asnjë gjurmë. Më mirë të të dalë syri sesa nami fj. u. shih te SY,~RI.
- NATË** f. Ditë e natë (natë e ditë) shih te DIT/Ë,~A. Murgu i natës mit. shih te MURG,~U. E bëri natën ditë punoi pa ndërprerje, punoi me të gjitha forcat. Nata është me barrë fj. u. nata ka të papritura, nuk dihet se ç'ndodh. Janë (ndryshojnë) si nata me ditën kanë shumë ndryshim njëri nga tjetri; janë e kundërta e njëri-tjetrit. I shkoi (gjithë) nata në gjunjë shih te GJU,~RI. Dita ka sy e nata ka veshë fj. u. shih te VESH,~I.
- NATËN** ndajf. Të vret natën e të qan ditën shih te VRAS. Ditën të lëpin këmbët, natën të ngul dhëmbët shih te LËPIJ.
- NATYRAL** mb. Ekonomi natyrale ekonomi zakonisht fshatare, që prodhon gjithçka për nevojat vetjake dhe jo për tregun.
- NATYRË** f. Në natyrë ek. që paguhet a që merret si mall ose si prodhim në vend të të hollave (për të ardhurat, pagën, shpërblimin, tatimin). I është bërë natyrë e dytë i është rrënjësuar në gjak, i është bërë veti a tipar i ngulitur. Natyrë e qetë art. vizatim ose pikturë që paraqet sende pa jetë ose lule, fruta etj.
- NATYROR** mb. Numrat natyrore mat. numrat e plotë me shenjë pozitive që përbëjnë një varg.
- NDAHEM** vetv. U ça e u nda shih te ÇAHEM. U nda nga jeta (prej nesh, nga gjiri ynë) vdiq. Ndahet (është) në shenjë shih te SHENJ/Ë, ~A. S'u ndahet shpirti shih te SHPIRT,~I. Më ndahet zemra dysh shih te ZEM/ËR, ~RA. S'ndahet mishi prej thoit fj.u shih te MISH,~I.
- NDAJ** kal. Çan e ndan shih te ÇAJ. I ndau bathët e nxori të vërtetën në shesh. E ndau bukën me dikë i preu marrëdhëniet, e prishi miqësinë me dikë, u prish me dikë. Na ndan një det (i tërë) shih te DET,~I. S'e ndan (s'e heq, s'e lë, s'e lëshon) nga goja dikë a diçka shih te GOJ/Ë,~A. Ndjaj gjyqin shih te GJYQ,~I. Të ndafsha (të ngrënsha, të bëfsha) hallvën! thjeshtligj., mallk. shih te HALLV/Ë,~A. Nuk ia ndan hapin dikujt e ndjek kudo, i shkon pas kudo. I ndan një hendek shih te HENDEK,~U 2. I ndau (i qëroi) lakrat (llogaritë, hesapet) me dikë përcaktoi qartë qëndrimin e vet ndaj dikujt; u shkëput përfundimisht nga dikush. Ia ndau leshtë diçkaje shih te LESH,~TË. E ndau mejdanin me dikë shih te MEJDAN,~I. E ndau mendjen vendosi një herë e mirë. Nuk ia ndan (nuk ia heq, nuk ia shqit) sytë shih te SY,~RI. E ndanë (e vendosën, e zgjidhën) me shpatë shih te SHPAT/Ë,~A. E ndaj (e pres) me thikë diçka shih te THIK/Ë,~A. Ndjaj nga vatha shih te VATH/Ë,~A. Topi s'na ndan shih tek TOP,~I. Ndjaj të bardhën nga e zeza shih te BARDH/Ë,~A (e) 9. E ndan bukën në zjarr shih te ZJARR,~I. Ndjaj bykun nga gruri shih te BYK,~U. Ndjaj

- dhentë (delet) nga dhitë shih te DHI, ~A. Ndan kafshatën e gojës (kafshatën e fundit) me dikë shih te KAFSHAT/Ë, ~A. Ndaj bykun (kashtën) nga kokrrat shih te KOK/ËRR, ~RRA. E ndau (e mblodhi) mendjen top shih tek TOP, ~I 7. E ndau punën dysh shih te DYSH. E ndan (e çan) qimen (me) katërsh (dysh) shih te QIM/E, ~JA. Ndaj shapin nga sheqeri shih te SHAP, ~I. Lyp për derë e ndan për shpirt shih te DER/Ë, ~A. Vetëm gjaku i ndan shih te GJAK, ~U 1. Veç shata e lopata do të na ndajë shih te SHAT/Ë, ~A.
- NDAL** kal. I ndal dorën dikujt e pengoj me forcë, nuk e lejoj që të bëjë diçka. E ndali (e la, e mbajti) vrapin diku shih te VRAP, ~I. Ndal diellin me fjalë shih te FJAL/Ë, ~A.
- NDAL** pasth. I them *Â* «ndal*Â*» i pres rrugën, s'e lë të shkojë a të zhvillohet më tej; e kundërshtoj me forcë e me vendosmëri.
- NDALUAR** mb. Mollë e ndaluar shih te MOLL/Ë, ~A.
- NDANË** Tej e ndan shih tek TEJ.
- NDEJ** kal. I ndej dorën i lyp, i kërkoj me të lutur. I ndeu (i mblodhi) këmbët mospërf. vdiq.
- NDER** m. Në fushën e nderit lart. në fushën e betejës. Me nder jush (faqe me nder, me nder me thënë) përdoret përpara se të shqiptojmë një fjalë të pahijshme ose para se të përmendim diçka që e përbuzim. Bëj nder me diçka i dhuroj diçka. Doli me nder gjeti zgjidhje të denjë nga një gjendje e vështirë; përfundoi me sukses një punë të vështirë, doli faqebardhë. Ia di për nder (për të mirë) dikujt shih te DI. I falem nderit përdoret për të shprehur mirënjohje për diçka, faleminderit. Kam nderin të... lart.
- NDERMË** II mb. bised. Gjithë ditën e nderme tërë ditën pa pushim, sa zgjat dita, gjithë ditën e ditës.
- NDERSHËM** mb. I ndershëm gjer në thembër shih te THEMB/ËR, ~RA.
- NDESH** kal. U ndesh arna me thesin shih tek ARN/Ë, ~A. I ndeshi (i hasi, i zuri, i ra) sharra në gozhdë shih te SHARR/Ë, ~A.
- NDESHË** f. krahin. Ndesha e mirë! përshëndetje kur takohen dy veta në rrugë.
- NDEZ** kal. Më ndezi (më polli) belaja (groshi) me dikë shih te PJELL. Nuk i ndezi fisheku shih te FISHEK, ~U. I ndezi (i nxehu) gjakrat shih te GJAK, ~U. Ia ndezi mizat dikujt e inatosi, e bëri të zemërohet. I ndezën qiririn dikujt shih te QIRI, ~U. Ndezi shkëndijën dha shkas i pari, u bë shkaktari i parë për diçka. As ndez, as shuan është njeri i plogët, që nuk merr pjesë gjallërisht në diçka, as ndreq, as prish. I ndezi trutë dikujt e vrau, ia hodhi trutë në erë. Është ndiz e shuaj shih te SHUAJ. I ndez pushka në ujë dikujt shih tek UJ/Ë, ~I. Ia ndezi zemrën flakë (zjarr) i dha hov e dëshirë të madhe për të bërë diçka. I ndezi zemrat horë shih te HOR/Ë, ~A II. E ndez zjarrin në ujë shih tek UJ/Ë, ~I. Tjetrit i digjet mjekra, ai kërkon të ndezë cigaren shih te MJEK/ËR, ~RA.
- NDEZJE** f. Ndezja e zjarrit nuk fillon nga trungu fj. u. shih te TRUNG, ~U.
- NDEZUR** mb. Me gjak të ndezur me inat të madh, gjithë zemërim.
- NDËR** parafj. 4. Vendin në kuptim të figurshëm (edhe në disa njësi frazeologjike). Kam ndër mend. I bie ndër këmbë i lutem shumë. E marr ndër sy. Jam me shpirt ndër dhëmbë jam shumë i sëmure; gjendem në një vështirësi të madhe a përpara një fatkeqësie të madhe.
- NDËRKOMBËTAR** mb. Xhandar ndërkom-bëtar shih te XHANDAR, ~I.
- NDËRMJET** Le të mbesë ndërmjet (midis) nesh shih te MBES. Hyj ndërmjet ndërhyj për të pajtuar dy palë a për të mënjanuar mosmarrëveshjet.
- NDËRTIM** m. Ndërtime kapitale ek. ndërtesat e makineritë në industri ose në një degë të ekonomisë, që shtohen si fonde themelore për zgjerimin e prodhimit.

- NDËRTUAR** mb. I ndërtuar (i ngritur, i mbështetur) mbi rërë shih te RËR/Ë,~A.
- NDËRRIM** m. Ndërrim roje shih te ROJ/Ë,~A.
- NDËRROHEM** vetv. U ndërrua në fytyrë u prish në fytyrë, i iku çehrja, u zbeh.
- NDËRROJ** kal. Ndërroi bajrak (flamur) shih te BAJRAK,~U. Ia ndërroi faqen (fytyrën) e ndryshoi krejt, e shndërroi, i dha pamje krejt të re. Ndërroi (bëri, këmbëu, shkëmbëu) fjalë me dikë shih te FJAL/Ë,~A. E ndërroi (e ktheu) pllakën (fletën) keq. shih te PLLAK/Ë,~A. Ndërroi fytyrë u prish në fytyrë, i iku çehrja, u zbeh. Ndërroi jetë lart., vjet. vdiq. Ndërron lëkurën ndërron pamjen e jashtme. Ia ndërroi (ia ktheu) mendjen dikujt shih te KTHEJ. Ndërron puna është tjetër gjë. I ndërron telat shih tek TEL,~I. I ndërroi din e iman shih tek DIN,~I. Ujku qimen ndërron, por zakonin s'e harron shih tek UJ/K,~KU.
- NDIEJ** kal. E ndjeu (e provoi) mbi supë (mbi shpatulla, mbi kurriz) diçka shih te SUP,~I Ma ndien (ma ndjell, thotë) zemra shih te ZEM/ËR,~RA. Ndiej një limë në zemër shih te LIM/Ë,~A. E ndiente shpinën ngrohtë shih te NGROHTË (i,e). E ndien zemrën (shpirtin) të lehtë shih te LEHTË (i,e).
- NDIHEM** vetv. Nuk u ndie i gjallë
- NDIHMË** f. Me ndihmën e... me anën e, nëpërmjet, me. Në ndihmë të ... për të ndihmuar.
- NDIZEM** vetv. Iu ndez (i hipi, i kërceu, iu ngrit, e zuri) damari shih te DAMAR,~I. Iu ndez (iu nxeh) gjaku shih te GJAKU,~U I. U ndezën (u nxehën) gjakrat shih te GJAKU,~U I. Iu ndezën shkutat shih te SHKOT/Ë,~A.
- NDJEJ** kal. E ndjeu zoti (perëndia) vjet. vdiq.
- NDJEK** kal. Ndjek gjurmët e dikujt veproj njësoj si një tjetër paraardhës, eci në rrugën e tij. Ndjekin pas qerres e dikujt shih te QERR/E,~JA. E ndjek (e marr) gjurmën mbrapsht shih te GJURM/Ë,~A. E ndjek në gur e në galinë shih te GUR,~I. E ndoqi pilë për pilë shih te PIL/Ë,~A I.
- NDJELL** kal. Ma ndjell (ma ndien, ma thotë) zemra shih te ZEM/ËR,~RA.
- NDJENJË** f. Ndjenja e masës libr. shih te MAS/Ë,~A I 4.
- NDODHEM** vetv. U ndodha (më zuri) bosh shih te BOSH.
- NDORE** f. vjet. Nuk bie ndore nuk dorëzohem.
- NDOT** kal. Kush ndot këmbët luan dhëmbët fj. u. kush punon ha.
- NDREQ** kal. Ndrej (drejto, rregullo) gojën! shih te GOJ/Ë, ~A. I ndreqi hesapet me dikë mori hak kundër dikujt, i lau hesapet me dikë. Ia ndreqi kryqet dikujt shih te KRYQE,~T. I ndreqi orët me dikë keq. shih tek OR/Ë,~A I. Ia ndreqi (ia rregulloi, të ujdisi) qejfin (kokën) nuk e la të vepronte sipas trilleve të tij; ia ndreqi samarin. Ia ndreqi (ia rregulloi, ia ujdisi) samarin (bërroren, kurrizin, shpinën) dikujt e rrahu, e ndëshkoi rëndë për një faj ose kur nuk bindej; i dha përgjigjen e merituar, i tregoi vendin dikujt. As prish, as ndreq (punë) shih te PRISH. S'di kujt t'ia prish e kujt t'ia ndreq shih te PRISH 20.
- NDREQEM** vetv. Druri ndreqet sa (kur) është i njomë fj. u. njeriu edukohet më lehtë kur është në moshë të re.
- NDRIT** jokal. I ndriti sytë (dhëmbët) dikujt i foli me të egër; e kërcënoi. I ndritë shpirti! vjet. thuhej për një të vdekur në shenjë nderimi a mirënjohjeje për veprën e tij. S'i ndrit nuri edhe poh. është gjithnjë i vrenjtur, nuk i qesh fytyra.
- NDRITUR** mb. Shkroi një faqe të ndritur shih te SHKRUAJ.
- NDRYDHEM** vetv. M'u ndrydh zemra shih te ZEM/ËR,~RA.

- NDRYSHE** ndajf. Ndryshe nga... me dallim nga një tjetër, në kundërshtim me dikë a me diçka tjetër. Flas ndryshe me të! shih te FLAS.
- NDRYSHËM** mb. Flasin gjuhë të ndryshme shih te FLAS.
- NDRYSHK** m. Ka zënë ndryshk (myk) diçka shih te ZË. I kanë zënë trutë ndryshk (myk) ka mbetur prapa nga jeta, nuk i kupton dukuritë e reja të botës rreth vetes.
- NDRYSHOJ** kal. Ndryshon puna është tjetër gjë; është çështje që duhet parë a trajtuar ndryshe. Nuk ndryshoj (nuk luaj) asnjë presje shih te PRESJ/E, ~A.
- NDUKEM** vetv. Çirret e nduket bërtet e bën zhurmë të madhe që t'u mbushë mendjen të tjerëve ose që të tërheqë vëmendjen.
- NDYJ** kal. Nuk e ndyj (nuk e fëlli) dorën me dikë nuk e rrah dikë që është shumë më i dobët se unë ose që është për t'u përbuzur. E ndyu (e rëndoi, e fëlli, e qelbi) gojën shih te GOJ/Ë, ~A. Nuk e ndyn (nuk e fëlli) pushkën me dikë nuk e vret dikë që është tepër i dobët ose që e përbuz. Shkopin, po e ndyve të tërë, s'ke ku e kap fj. u.
- NDYRË** mb. Fytyrë e ndyrë (e fëlli)qur) njeri i neveritshëm; njeri i poshtër. Vegël e ndotur (e fëlli)qur) njeri që i shërben dikujt për qëllime të ulëta.
- NDYRËSIRË** f. Hedh ndyrësira mbi dikë flet shumë keq për dikë, shpif rëndë kundër dikujt, hedh baltë mbi dikë.
- NEN** II m. krahin. I ra nenit të këmbës e goditi dikë në pikën më të ndjeshme.
- NEPËRKË** f. Nepërkë e shkruar grua shumë e bukur e lozonjare.
- NESËR** ndajf. Nesër, pasnesër, në të ardhmen; kur të vijë koha. Sot për nesër shih te SOT. Me sot me nesër shih te SOT. Në mos sot, nesër së shpejti, pas pak kohësh. Është sot për nesër shih te SOT. Jo sot, por nesër shih te SOT. Nuk ta lë mangët (metë) për nesër shih te LË. Sot i bën hunjtë, nesër i djeg shih te BËJ.
- NËN** parafj. 8. Përdoret me një emër në rasën kallëzore në disa shprehje frazeologjike për të treguar mënyrën si bëhet a kryhet diçka. Punon nën rrogë. Flas nën zë. Qesh nën buzë. Ia dha nën dorë. Vepron nën hundën e dikujt. E thirrën nën armë.
- NËNË** f. S'e bën nëna është shumë i mirë. Ca të nënës (të babait), ca të njerkes (të njerikut) shih te BABA, ~I. Si (siç) e ka lindur nëna shih te LIND. I ka vdekur nëna diçkaje thjeshtligj.
- NËNNNDARJE** f. Nënndarja e parë ek. prodhimi i mjeteve të prodhimit. Nënndarja e dytë. ek. prodhimi i sendeve të konsumit.
- NËNSHKRUAJ** kal. Nënshkruan në të bardhë shih te BARDH/Ë, ~A (e).
- NËPËR** parafj. 5. Përdoret me një emër në rasën kallëzore në disa togfjalësja me vlerë ndajfoljore dhe në disa njësi frazeologjike. Njëpër tym në mënyrë të errët, të paqartë. Njëpër dhëmbë duke pëshpëritur, pa i shqiptuar fjalët mirë dhe qartë. Njëpër ëndërr në ëndërr e sipër. E merr njëpër gojë flet keq për dikë. E merr njëpër këmbë sillet keq me dikë, e poshtëron, e përul.
- I bie njëpër të e kaloj diçka pa e shqyrtuar mirë ose pa e punuar mirë.
- NGACMOJ** kal. Ngacmon (shtyn, trazon) urët shih tek UR/Ë, ~A II.
- NGALËZ** f. bised. Me ngalëz me frikë në gjak; që e ka mizën nën kësulë.
- NGARKOJ** kal. I ngarkoi (i ngriti, i mblodhi) plaçkat edhe iron. shih te PLAÇK/Ë, ~A. Ngarkon vezë në lak shih te LAK, ~U.
- NGAS** I kal. E lau dhe e ngau shih te LAJ. Lëre mos e nga! shih te LË. Ngas fjalën
- NGATËRROHEM** vetv. U ngatërruan fjet (u ngatërrua lëmshi) u ngatërrua një punë, dolën pengesa e ngatërresa në një punë. I ngatërrohet (i dridhet) gjuha shih te DRIDHEM.

- NGATËRROJ** kal. Ia ngatërroi letrat dikujt ia prishi planet, nuk e la t'ia arrinte qëlimit. Ngatërron (përziën) lëmshin (fijet, penjtë) e bën diçka më të ndërlikuar, më të vështirë; krijon një gjendje të vështirë. I ngatërroi (i zuri, i mbrehu) qetë m e dikë shih te MBREJ. Ngatërron (turbullon) ujërat shih tek UJ/Ë,~I.
- NGE** f. S'ia kam ngenë (vaktin) diçkaje edhe poh. nuk kam mundësitë materiale për të bërë diçka, nuk jam në gjendje ekonomike. S'ka nge të marrë frymë shih te FRYM/Ë,~A
- NGEC** jokal. Kërkon të ngeçë me dikë kërkon të zihet me dikë, përpiqet të gjejë shkas për grindje. Ngeci (ngeli, mbeti) në baltë shih te BALT/Ë,~A. Ngeci karkaleci tall. shih te KARKALEC,~I. I ngeci (i mbeti, i ngriu) fjala në buzë (ne gojë, në grykë, në fyt) shih te FJAL/Ë, ~A. I ngeci plori në rrënjë shih te PLOR,~I. I ngeci (i ngeli) sharra në gozhdë shih te SHARR/Ë,~A. I ka ngeçë (i ka ardhur) veza në kryq shih te VEZ/Ë,~A. Thela e madhe të ngeç në fyt fj.u. shih te THEL/Ë,~A.
- NGEL** jokal. Ngeli (ngeci, mbeti) në baltë shih te BALT/Ë,~A. Ngeli (mbeti) brisk shih te BRISK, ~U. Më ngeli (më mbeti) në derë dikush a diçka shih te DER/Ë, ~A. I ngeli (i mbeti) goja shih te GOJ/Ë,~A. I ngeli kërrabëza shih te KËRRABËZ,~A. Më ngeli (më mbeti) në qafë dikush shih te QAF/Ë,~A. I është (i mbeti) qejfi shih te QEJF,~I 5. Ngeli (mbeti) me gisht në gojë shih te GISHT,~I. I ngeli (i ngeci) sharra në gozhdë shih te SHARR/Ë,~A.
- NGELEM** vetv. Të ngelet (të mbetet) në dorë (ndër duar) dikush a diçka shih te DOR/Ë,~A.
- NGOPEM** vetv. U ngopa me bathë shih te BATH/Ë,~A. Ngopet me erë shih tek ER/Ë,~A 1. U ngop deri (gjer) në grykë shih te GRYK/Ë,~A. Ngopet me shkumë shih te SHKUM/Ë,~A. S'ngopet ariu me miza shih tek ARI,~U. Ngopet me lugë bosh (të zbrazët) shih te ZBRAZËT (i,e).
- NGORDH** jokal. E ngordhi (e kalbi) në dru shih te DRU,~JA II. Ka ngordhur ajo pulë që bënte ato vezë shih te PUL/Ë, ~A. Le gomari që na ngordhi, po s'na lënë rehat as mizat shih te GOMAR,~I. Presin të ngordhë gomari (kali) që t'i marrin potkonjtë përb. shih te GOMAR,~I.
- NGORDHJE** f. Është ngordhja me thes në kokë shih te THES,~I.
- NGORDHUR** mb. Bufi i ngordhur lojë fëmijësh gjatë së cilës njëri ulet në tokë, ndërsa të tjerët vënë duart mbi kokën e tij. S'ha pulë të ngordhur nuk është budalla, nuk ia hedh dot.
- NGRE** kal. E ngriti (e nxori, e qiti) nga balta dikë shih BALT/Ë,~A. Ngre ballin (lart) fitoj besim në vete, bëhem i guximshëm; eci ballëhapur. Ngriti bishtin keq.
- NGREH** kal. Ngreh (çoj) veshët shih te VESH,~I Ngreh e shkreh prish vazhdimisht atë që ka ndërtuar; punon pa dobi, ndreq e prish. Ngreh e mos këput
- NGREHUR** mb. Është pushkë e ngrehur (e mbushur) shih te MBUSHUR (i,e).
- NGREHUR** ndajf. Me veshët ngrehur me vëmendje të madhe për të dëgjuar çdo gjë ose për të qenë i gatshëm për çdo të papritur.
- NGRIHEM** I vetv. U ngrit (doli) nga balta shih te BALT/Ë,~A. Ngrehu e bjer (bjer e çohu) shih te BIE I. Iu ngrit (i hipi, i kërceu, e zuri) damari shih te DAMAR,~I. Iu ngrit (i hipi, kërceu) dielli i ballit shih te DELL,~I. Iu ngrit mendja shih te MENDJ/E, ~A, Ngrihet (çohet) peshë shih te PESHË. Ngrihet me vesë (për vesë) shih te VES/Ë,~A. Iu ngritën (iu çuan) flokët (qimet, leshrat e kokës) përpjetë shih te FLOK,~U. I ngrihet (i çohet) pluhuri nga prapa dikujt shih te PLUHUR,~I. Iu ngritën (i erdhën, iu mblodhën) zorrët te goja (në grykë, në fyt) shih te ZORR/Ë,~A. Ngrihu prift të ulet (të rrijë) hoxha! shih te PRIFT,~I I. Ngrihen (çohen) këmbët e bien kokës

shih te KËMB/Ë, ~A. Kush fle me qenin (me qentë) ngrihet me pleshta fj.u. shih te QËN,~I.

NGRIJ jokal. Ngriu çark shih te ÇARK,~U. I ngriu (iu pre, iu tremb) gjaku shih te GJAK,~U I. I ngriu gjakun dikujt e tmerroi a e frikësoi shumë; e tronditi shumë. I ngriu zemra shih te ZEM/ËR,~RA. Jam ngrij shkrij jam shumë i shqetësuar duke pritur diçka të keqe, jam në ankth për diçka. I ngriu (i mbeti, i ngeci) fjala në buzë (në gojë, në grykë, në fyt) shih te FJAL/Ë, ~A.

NGRIRË mb. Me gjak (me zemër) të ngrirë duke pritur me frikë a me shqetësim të thellë diçka të keqe, me frikë a me tmerr në zemër.

NGRITUR mb. Me mendje të ngritur i shqetësuar për diçka, që e ka mendjen te diçka tjetër.

NGRITUR ndajf. I mban veshët ngritur (përpjetë) shih te PËRPJETË.

NGROH kal. As të ngroh, as të ftoh

NGROHEM vetv. Ngrohet në diell (në shullë) rri pa punë, nuk bën asgjë. Jemi ngrohur nën (nga) një diell iron. jemi fare të largët njëri për tjetrin, s'kemi të bëjmë fare njëri me tjetrin; nuk jemi as fis, as soj. Është ngrohur në leshin e vet shih te LESH,~I. Më ngrohet zemra (shpirti) më ngjallet besimi e shpresa, e ndiej veten të çliruar nga shqetësimi, dyshimi a frika.

NGROHTË mb. Qoshe e ngrohtë (vend i ngrohtë) keq. punë e rehatshme, pa telashe e vështirësi dhe me të ardhura të mira. I kishte shpatullat të ngrohta (krahët të ngrohtë)

NGUJOJ kal. Ia ngujoi (ia lidhi, ia zuri) këmbët shih te ZË.

NGUL kal. E nguli bririn përb. vdiq, ngordhi. Ngul kërkoi me të madhe që të më plotësohet një kërkesë a një dëshirë, mbroj me ngulm mendimin tim për diçka, këmbëngul, nuk tërhiqem, ngulmoj. Ngul (hedh, lëshon, zë) rrënjë shih te RRËNJ/Ë,~A

I. Ngul thembrat s'lëviz nga vendi, nuk tundet. I nguli (i futi) thonjtë dikujt shih te THUA, ~THOI 3. Ngul këmbët në akull shih tek AKU/LL,~LLI. I nguli (i futi) thikën prapa kurrizit (pas shpine) shih te KURRIZ, ~I. Ngul hunj e shkull hunj shih te HU,~RI. Ngul qepë e shkull hudhra shih te QEP/Ë,~A.

NGULEM vetv. Iu ngul (i ra, i mbeti) thikë në zemër shih te THIK/Ë,~A.

NGUSHTË mb. Vend i ngushtë libr. degë a fushë në të cilën ka vështirësi për prodhimin ose për një veprimtari tjetër.

NGUSHTOHEM vetv. Më ngushtohet zemra ndiej një dhembje të madhe a një pikëllim të thellë, më dhemb zemra.

NGUTEM vetv. Pa u ngutur me kujdes dhe në mënyrë të matur.

NGJAJ jokal. Bëmë baba (nënë) të të ngjaj thuhet kur fëmija ngjan shumë me prindin edhe në sjellje e në mendime.

NGJAK m. Ia zuri shpirtin ngjak dikujt e mundoi shumë sa ia plasi shpirtin. Iu zu shpirti ngjak vuan shumë, mundohet pa masë, i plasi shpirti.

NGJALË f. Shket (rreshqet) si ngjalë u bën bisht e u shpëton me dredhi gjendjeve të vështira. Përzihet si bolla me ngjalën shih te BOLL/Ë,~A.

NGJALL kal. Ngjall të vdekurin nga varri

NGJESH I kal. Ngjeshin (shtrëngojnë) radhët shih te SHTRËNGOJ. Qesh e ngjesh shih te QESH.

NGJESHUR as. Me të qeshur e me të ngjeshur shih te QESHUR, ~IT (të).

NGJETHEM vetv. Iu ngjeth (iu drodh) mishtë shih te MISH,~TË.

NGJIT I kal. I ngjit dorën (krahun) dikujt ndihmoj dikë që është në vështirësi. I ngjiste (i vinte) brirë (brirët e kaut) dikujt keq. shih te BRI,~RI. I ngjit fjala i shkon fjala, i zë vend ajo që thotë, e dëgjojnë. E ngjiti me barrë e la shtatzënë. Ia ngjiti sytë e shikoi me

- vëmendje të madhe. Më ngjit në zemër dikush shih te ZEM/ËR,~RA. Është për ta ngjitur pas murit shih te MUR,~I.
- NGJIT** II kal. I ngjit shkallët një nga një dikush i merr punët shtruar; është i matur e i kujdesshëm në të folur e në të vepruar; nuk ngutet.
- NGJITEM** I vetv. U ngjit me barrë mbeti shtatzënë. U ngjitet fjala shih te FJAL/Ë,~A 6. Ngjitet edhe pa shkallë dikush shih te SHKALL/Ë,~A. Iu ngjit si ushunjëz dikujt shih tek USHUNJËZ,~A. Iu ngjit si bajga (si balta) pas këpucës thjeshtligj. shih te BAJG/Ë,~A. Në çati ngjiten me shkallë fj.u. shih te SHKALL/Ë,~A. Iu ngjit barku pas shpine (me kurrizin) shih te BARK,~U. Nuk i ngjitej (nuk e kapte) ferra gjëkund shih te FERR/Ë,~A. Iu ngjit gjuha pas qiellze shih te GJUH/Ë, ~A I. Iu ngjit këmisha pas trupit (në trup) shih te KËMISH/Ë,~A. Ngjitet si pallaska pas brezit shih te PALLASK/Ë,~A. S'i ngjitet qimja në trup shih te QIM/E,~JA. U ngjiten shumë për shpinë shih te SHPIN/Ë,~A. Buka që thyhet, s'ngjitet me fj. u. shih te BUK/Ë,~A. Po u thye kulaçi, s'ngjitet më fj.u. shih te KULAÇ,~I.
- NGJITUR** mb. Baltë e ngjitur keq. Njeri i mërzitshëm që të ngjitet nga pas e nuk të shqitet.
- NGJYEJ** kal. E ka ngjyer gishtin diku shih te GISHT,~I. E ngjyenin bukën në dhallë shih te DHALL/Ë,~A. S'e ngjyen (s'e ha) turpin me bukë shih te BUK/Ë,~A.
- NGJYHEM** vetv. Lyhet e ngjyhet shih te LYHEM 1.
- NGJYRË** f. E përshkruan (e paraqit, e pikturon) me ngjyra të zeza shih te ZI (i), ZEZË (e).
- Metalet (metalurgjia) me ngjyra të gjitha metalet (metalurgjia e të gjitha metaleve), me përjashtim të hekurit e të lidhjeve të tij.
- NIS** kal. Si e nisi, e grisi keq. si e filloi keq, ashtu edhe e përfundoi (jetën ose një punë).
- NISEM** vetv. Si u nis, ashtu u bitis (u gris) keq. si filloi keq një punë ashtu edhe përfundoi. Ku u nis e ku u degdis! ndryshe filloi e krejt ndryshe mbaroi, ku filloi e ku mbaroi!
- NISMË** f. Nismë ligjvënese drejt. e drejta për të propozuar a për të paraqitur i pari projektligje në organin ligjvënës.
- NISHAN** m. bised. Me nishan i shquar; i shënuar. (Zhduk, prish, humbas) pa nishan pa lënë asnjë gjurmë, krejt, fare. U humbi (s'u gjendet) nishani nuk ka mbetur asnjë, nuk ka mbetur as edhe një i vetëm. Pa çikë e pa nishan shih te ÇIK/Ë,~A I. Pa nam e pa nishan (as nam, as nishan) shih te NAM,~I. E ka vënë në nishan (në shenjë) dikë shih te SHENJ/Ë,~A. Nuk i gjendet as nami as nishani shih te NAM,~I.
- NOFULL** f. I theu (i dërrmoi) nofullat (hundët, brinjët, turinjët, dhëmbët) dikujt përçm. shih te THYEJ.
- NOT** m. I ra me not diçkaje shak. hëngri ose piu sa mundi, për lau çdo gjë.
- NOTOJ** jokal. Noton në të njëjtat (në po ato) ujëra me dikë keq. shih tek UJ/Ë,~I. Noton (lundron) në një (në dy) gisht ujë shih tek UJ/Ë,~I.
- NUK** pjes. Sa nuk ... gati sa, pothuaj.
- NUMËR** m. Me numër
- NUMËROHEM** vetv. I numërohen brinjët (fijet e brinjëve) shih te BRINJ/Ë,~A. Numërohen me gisht (me gishtat e dorës) shih te GISHT,~I.
- NUMËROJ** kal. Ia numëroi brinjët dikujt e rrahu keqas. Numëroj ditët (orët, muajt...) pres me padurim dikë a diçka. Numëron gishtat shih te GISHT, ~I. I numëronte kafshatat dikujt shih te KAFSHAT/Ë, ~A. Të numëron kafshatat shih te KAFSHAT/Ë, ~A. Numëron (vret, zë) miza (gjithë ditën) mospërf.

shih te MIZ/Ë,~A. Numëron rrënjët bën punë të kotë. Numëron (heq) trespohet shih te HEQ. Numëron (qëndron, mbetet, ngelet, rri) në vend shih te VEND,~I. Numëroj yjet rri pa gjumë, s'më zë gjumi gjithë natën. Në vend-numëro! usht. komandë për të hedhur hapat në vend, pa ecur përpara. Mbeti (bën, rri) në vend-numëro nuk bën asnjë përparim, nuk zhvillohet, ka ngecur. Numëron qimet (fijet) e postiqes shih te POSTIQ/E,~JA. Thanat nuk numërohen fj.u. shih te THAN/Ë,~A.

NUMËRTOJ kal. I ka ditët (orët) të numëruara i mbetet pak kohë për të jetuar; së shpejti i vjen fundi.

NUR m. bised. Digjet nur ndrit, shkëlqen shumë. S'i ndrit nuri edhe poh. shih te NDRIT.

NUSE f. Nuse për mur (nuse muri) shih te MUR,~I. E bëri nuse (lule, usta, çeqo) shih te BËJ. I rri nuse

NXEH kal. I nxehu (i ndezi) gjakrat shih te GJAK,~U I. Mos më nxeh kryet! thjeshtligj. mos më mërzit shumë!

NXEHEM vetv. U nxehën (u ndezën) gjakrat marrin zjarr ndjenjat e pjesëmarrësve në një bisedë, mosmarrëveshje etj. Iu nxeh (iu ndez) gjaku shih te GJAK,~U I.

NXEHTË mb. Me gjak të nxehtë me gjaknxehtësi; në zemërim e sipër. E kishte qesen të nxehtë shih te QES/E,~JA.

NXË I kal. Si ta nxë goja! shih te GOJ/Ë,~A. S'ma nxë mendja (koka) nuk e marr dot me mend, nuk arrij ta kuptoj. S'më nxë vendi shih te VEND,~I. Një mill s'i nxë dy jataganë fj.u. shih te JATAGAN,~I.

NXË II kal. Nxuri (vuri) mend mësoi nga përvoja të mos e përsëritë një punë a një veprim, pësimi iu bë mësim.

NXIHET vetv. Iu nxi balli u turpërua, u bë me turp, iu nxi faqja. U nxi me bojë shih te BOJ/Ë,~A I. Iu nxi dera shih te DER/Ë,~A. S'i nxihet faqja (fytyra) nuk turpërohet për asgjë, është i

pacipë. Iu nxi jeta iu bë jeta e rëndë, e padurueshme, u bë fatkeq; humbi një njeri shumë të afërt e të dashur (zakonisht për gratë). S'i nxihet lara shih te LAR/Ë,~A. M'u nxinë vetullat shih te VETULL,~A.

NXIJ kal. Ia nxiu faqen (fytyrën) e turpëroi, e bëri që të ndihej i turpëruar para të tjerëve. Ia nxiu jetën dikujt ia bëri jetën të padurueshme, i solli shumë të këqija e hidhërimi.

NXIRË mb. I nxiri (i shuari) me bojë shih te BOJ/Ë,~A.

NXIROS kal. Ia nxirosi jetën e mundoi keqas, ia bëri jetën të padurueshme. Ia nxirosi zemrën (shpirtin) i shkaktoi vuajtje, ia bëri jetën të rëndë e pa gëzime.

NXJERR kal. E nxjerr (dal) në anë shih tek AN/Ë,~A I. Nxjerr (vë) në ankand diçka shih tek ANKAND,~I. E nxori (e qiti, e ngriti, e çoi) nga balta dikë shih te BALT/Ë,~A. Ia nxori bishtin një pune e teproi në një punë. Ia nxori (ia hoqi, ia qiti) bojën keq. shih te BOJ/Ë,~A I. E nxori (e qiti) në breg dikë shih te BREG,~U. Nxjerr brirët (brirë) keq. shih te BRI,~RI. Nxjerr për brirësh shih te BRI,~RI. Ia nxjerr cifundin shih te CIFUND,~I. E nxori (e bëri, e qiti) çirak dikë edhe iron. shih te ÇIRAK,~U I. Ia nxjerr (fjalët) me darë shih te DAR/Ë,~A. E nxori në diell dikë shih te DIELL,~I. I nxori djersë dikujt e lodhi shumë, e mundoi jashtë mase, e bëri të djersinte. Nxjerr nga dora (nga duart) shih te DOR/Ë,~A. E nxori (e qiti) në dritë shih te DRIT/Ë,~A. E nxjerr (e qit) nga dheu shih te DHE,~U. E nxori në faqe diçka shih te FAQ/E,~JA. E nxori (e qiti) fare shih te FAR/Ë,~A. I nxori (i gjeti, i qiti) fundin diçkaje shih te FUND,~I. E nxori në furkë diçka shih te FURK/Ë,~A. E nxori (e qiti) për fushe (në fushë) diçka shih te FUSH/Ë,~A.

NYJË f. Nyja e dimrit palca e dimrit, kulmi i dimrit. Nyjë gordiane libr. punë a

- çështje shumë e vështirë për t'u zgjidhur. Iu lidh fjala një (komb) dikujt shih te FJAL/Ë,~A. E lidh lekun (paranë) një e kursen shumë paranë, është shumë dorështrënguar. Iu lidh (iu bë, iu mblodh) një një në grykë (në fyt) iu bë një lëmsh në grykë nga një ndjenjë e fortë, nga ngashërimi, nga hidhërimi etj. Iu lidh një jeta iu bë jeta e rëndë, e padurueshme nga ndonjë fatkeqësi që i ka ngjarë a nga ndonjë vështirësi që nuk e kapërcen dot. Zgjidh (pres) një gor-diane zgjidh një çështje të ngatërruar e të vështirë me një mënyrë të menjëhershme, të vendosur e të guximshme.
- NJERI** m. Njeri i minderit keq. shih te MINDER, ~I. Njeri i rrogosit shih te RROGOZ,~I. Njeri në shenjë shih te SHENJ/Ë,~A. Njeri me taban shih tek TABAN,~I. Njeri pa taban shih tek TABAN~I. Njeri me thopërc shih te THOPËRÇ,~I. Është shpirt njeriu shih te SHPIRT,~I. S'ka njeri të gjallë diku shih te GJALLË (i,e). Nuk mbeti këmbë njeriu shih te KËMB/Ë,~A. Njeri (burrë) njëzet e katër karatësh libr. shih te KARAT, ~I. S'ia ka thënë (s'ia ka treguar) njeriu të gjallë shih te GJALLË (i,e). Është pesë (dy) para njeri (burrë) shih te PARA,~JA.
- NJERI** pakuf. S'ia pret njeri qimen (perin) shih te PRES I. S'e zë (s'e kap) njeri me dorë (për bishti) shih te ZË. Nuk ia ka shkelur njeri hijen prapa shih te SHKEL.
- NJERK** m. M'u bë njerk nuk dua ta shoh me sy, nuk mund ta duroj, ngaqë më bie me qafë e më mërzit tepër, më është bërë si burri i nënës.
- NJERKË** f. I biri i njerkës fëmijë i përkëdhelur e i mbajtur mirë, fëmijë i trajtuar ndryshe nga të tjerët; fëmijë i lastuar. E shikon me syrin e njerkës tregohet i padrejtë kundrejt dikujt a diçkaje, trajton keq, ndryshe nga të tjerët a nga çdo gjë. Ca të nënës (të babait), ca të njerkës (të njerkut) ca trajtohen mirë e ca keq, megjithëse duhen trajtuar njësoj.
- NJË** Deri më një plotësisht, për të gjitha gjërat, deri në fund. Me një fjalë shih te FJAL/Ë,~A. Me një frymë shih te FRYM/Ë,~A. Me një gojë të gjithë njëherësh.
- NJËHERË** Njëherë e një kohë (njëherë motit) dikur, shumë kohë më parë (në të kaluarën). Njëherë si sot në një ditë a në një kohë të ngjashme me të sotmen.
- NJËJTË** mb. Noton në të njëjtat (në po ato) ujëra me dikë keq. shih tek UJ/Ë,~I.
- NJËQIND** num. them. Njeri me njëqind (me dyzet) flamurë shih te FLAMUR, ~I. Si një herë, njëqind herë shih te HER/Ë,~A. Të çon (të shpie) në krua (në shtatë kroje, në njëqind çezma, a në dyzet çezma) e s'të jep ujë shih te KRUA, KROI.
- NJËRI** pakuf. Bëri njëri
- NJËSI** f. 6. gjuh. Element bazë në sistemin e gjuhës ose në nënsistemet e saj. Njësi fonetike (fonologjike, sintaksore, leksikore, frazeologjike).
- NJËSOJ** ndajf. S'janë të gjithë gishtërinjtë njësoj shih te GISHT,~I.
- NJËSH** ndajf. E bëri njësh (një) me tokën shih tek TOK/Ë,~A I. U bë njësh (një) me tokën shih tek TOK/Ë,~A I.
- NJËZAJ** ndajf. (Për) së njëzaj nga e para, nga fillimi; edhe një herë.
- NJËZË** num. përk. bised. Njëzë e njëzë njënjëzë.
- NJIHEM** vetv. Njihet me gisht shih te GISHT,~I.
- NJOH** kal. Nuk e njeh historia shih te HISTORI,~A. Ia njoh kokën dikujt keq. shih te KOK/Ë,~A 4. Ia njoh (ia di) burmat (vidhat) dikujt shih te BURM/Ë, ~A I. Ia njoh beben e syrit dikujt shih te BEB/E, ~JA II. Ia njoh dhëmbë e dhëmballë shih te DHËMB,~I. Ia njoh (ia di) fundin e barkut shih te BARK,~U. Njeh (di) zhurin e detit shih te ZHUR,~I. Vampiri e njeh luginat fj.u. shih te

- VAMPIR,~I. Nuk e njeh (nuk e merr vesh) i pari të dytin shih te PARË (i,e). S'e njeh qeni të zotin shih te QEN,~I.
- NJOLLË** f. Njollë e bardhë shih te BARDHË (i,e). Njolla të zeza shih te ZI (i), ZEZË (e).
- NJOM** kal. E njomi zorrën
- NJOMEM** vetv. Iu njom luga dikujt shih te LUG/Ë,~A. M'u njomën sytë m'u mbushën sytë me lot.
- NJOMË** mb. Druri ndreqet sa (kur) është i njomë fj. u. shih te DRU,~RI. Gjithkujt murrizi i vet i duket i njomë fj.u. shih te MURRIZ,~I. S'ka ç'i bën shkëndija eshkës së njomë (së lagur) fj.u. shih te SHKËNDIJ/Ë,~A. Shkoi (u dogj) edhe i njomi (bashkë) me të thatin thuhet kur bashkë me fajtorin e pëson edhe ai që s'kishte faj, kur prej të keqit e pëson edhe i miri. Shkoi (u dogj) i njomi për të thatin e pësoi ai që s'kishte faj në vend të fajtorit.
- OBJEKTIV** mb. Idealizmi objektiv filoz. shih tek IDEALIZ/ËM,~MI 1.
- OBORR** m. E humb (e humbet) udhën në oborr
- OGUR** m. Nuk ka ogur me dikë nuk shkon mirë, nuk i shkon mbarë me dikë.
- OKË** f. Me okë mospërf. me shumicë, në sasi të madhe, sa të duash; shumë. Pesë para oka (dy grosh oka) mospërf. nuk ka ndonjë vlerë, nuk vlen fare. Nuk është në okë dikush nuk është në gjendje të mirë mendore, i ka humbur gjykimi. E bëri (mendjen) okë për diçka vendosi për diçka, mori vendim të prerë, e bën mendjen top.
- OKSIGJEN** m. kim. I jep oksigjen dikujt libr. keq. e ndihmon a e nxit dikë për të bërë një të keqe, i fryn zjarrit.
- OMBRELLË** f. Nën ombrellën e dikujt nën mbrojtjen e dikujt. Iu bë ombrellë dikujt e mbrojtje, e ruajtje nga goditjet. I vuri ombrellën diçkaje e mbuloi një punë, nuk e nxori në shesh diçka; e pengoi diçka.
- OMEGA** f. palak. libr. Alfa dhe omega shih tek ALFA. Nga alfa tek omega shih tek ALFA.
- OPINGË** f. kryes. sh. Me gjithë opinga të tërin, pa lënë asgjë fare. Pa kësulë e pa opinga pa pasur asgjë. Të më marrësh opingat! thjeshtligj.
- OPOZITË** m. Jam (qëndroj, ndodhem, vihem) ne opozitë me dikë a me diçka libr. nuk jam i një mendjeje me dikë, e kundërshtoj, kam pikëpamje të kundërta me të për një çështje të rëndësishme.
- OPT** m. krahin. I erdhi opti u qetësua, iu çel fytyra. I humbi opti nuk duket më dikush, ka kohë që s'e shohim. Nuk ia di optin dikujt
- OQEAN** m. Një pikë uji në oqean (në det) shih tek UJ/Ë,~I. Oqeani ajror libr. atmosfera.
- ORAR** m. Me orar e pa orar në çdo kohë, në kohën e punës e pas saj, pa vënë re kohën; pa përfillur kohën e caktuar, orë e pa kohë.
- ORBITË** f. Doli në orbitë libr.
- ORË** I f. Sa (te) ora përnjëherësh, në çast, atë çast. Orë e çast vazhdimisht, duke u përsëritur shumë dendur, herë pas here dhe shpesh. Orë e minutë gjithnjë, orë e çast. Orë e kohë gjithnjë, orë e çast. Orë e pa kohë herë pas here; në kohë të papërshtatshme, kohë e pa kohë. I orës së fundit që është dhënë në kohën më të afërt, që sapo është dhënë nga dikush (për një lajm a njoftim). I orës së parë (i orëve të para) i fillimit të diçkaje, që ka marrë pjesë që në fillim në një veprimtari; i flaktë. Ora me dorë (ora me një)
- ORË** II f. Ora e shtëpisë euf. bolla. Ia ha orën dikujt shih te HA. I hipën (i erdhën) orët dikujt u ndërkrue, u bë si i çmendur, i hipën xhindet. Ishte me orë të këqija (të liga) ishte në gjendje të keqe shpirtërore, ishte i zemëruar a i mërzitur. Iu lig (iu ligështua) ora dikujt vjet. I ra hovi i mëparshëm, iu prenë krahët, e lëshoi zemra, u ligështua. I ka vdekur ora dikujt a diçkaje ka marrë fund dikush a diçka.

- ORGANIK** I mb. Kimia organike pjesë e kimisë, që studion bashkimet e karbonit me elemente të tjera si në organizmat e gjallë.
- ORGJI** f. Orgji e përgjakshme (orgji gjaku) libr. kërdi, masakër.
- ORIZ** m. bot. Nuk mban më ujë orizi (pilaf, kosi, vera) shih tek UJ/Ë, ~I. E bëri dy ujë e një oriz shih tek UJ/Ë, ~I. S'ka oriz pa gurë fj. u. shih te GUR, ~I.
- ORTË** f. vjet. S'i gjendet orta dikujt a diçkaje nuk i gjendet shoku dikujt; nuk gjendet diçka tjetër si ajo, s'i gjendet shoku a shoqja.
- OSH** m. bised. S'të bën për osh nuk të përfill. Nuk e pyet as për osh, as për balosh nuk e përfill fare dikë, e bën si të paqenë.
- OXHAK** m. Ia mbylli (ia shoi) oxhakun shih te MBYLL. Oxhak pa tym shtëpi pa njerëz, vatër e shuar. U bë për rreth oxhaku u plak, e zuri pleqëria e rri në qoshe, nuk del dot nga shtëpia. Tymi të shkojë drejt, pa le të jetë oxhaku i shtrembër! fj. u. shih tek TYM, ~I.
- PA** II parafj. Pa dyshim shih te DYSHIM, ~I. Pa fjalë shih te FJAL/Ë, ~A. Pa një pa dy, shih te NJË.
- PA** IV pj. Pa le shih te LE.
- PAANGAZHUAR** mb. libr. Vende (shtete) të paangazhuara vende (shtete) që nuk janë pjesëtare të ndonjë blloku ushtarak a ekonomik të kryesuar nga superfuqitë.
- PAÇAMUR** m. U bënë paçamur u ngatërruan keq, u bënë lëmsh.
- PAÇARIZ** m. bised. E bëri paçariz (punën) e ngatërroi keq punën; e bëri çorbë.
- PAÇAVURE** f. E bëri paçavure (leckë, rreckë) shih te LECK/Ë, ~A. Ia bëri mishin paçavure të zezë e rrahu keq sa ia bëri mishin me njolla të zeza.
- PAEMËR** f. Bari i së paemrës shih te BAR, ~I 1.
- PAFTË** f. Heq paftë tek. holloj më tej një pllakë metali me makinë të posaçme, paftëzoj.
- PAGDHENDUR** mb. Ishte (si) tra i pagdhendur (i palatuar) shih tek TRA, ~RI.
- PAGËZIM** m. Pagëzimi i zjarrit pjesëmarrja për herë të parë në luftë, beteja e parë në të cilën merr pjesë dikush.
- PAGUAJ** kal. Është të paguash e të ikësh është një vend a një mjedis shumë i papëlqyeshëm.
- PAGUAR** as. S'ka të paguar është shumë i vlefshëm, i çmueshëm, i dobishëm a i nevojshëm, s'ka të çmuar.
- PAGJUAJTUR** mb. Është hurdhë e pagjuajtur (pyll i pagjuajtur) dikush është në gjendje të mirë ekonomike; një vend është i begatë a pjellor.
- PAH** II m. Del në pah
- PAHA** f. vjet. Nuk ka paha është shumë i çmueshëm a i vlefshëm s'ka të paguar, s'ka të çmuar.
- PAJË** I f. Bëhu pajë! keq. shporru, qërohu! E mori pajë me vete (iu bë pajë) i mbeti përgjithnjë si njollë, nuk i hiqet më. Ia bëri pajë dreqit (shejtanit) e shporri dikë, e hoqi qafe.
- PAJTIM** I m. Në pajtim me ... libr. në përputhje me... në përshtatje me ...
- PAK** I pakuf. Pak gjë pa... shih te GJË. Mish pak e pupla shumë shih te MISH, ~I. Shumë pula e pak vezë shih te PUL/Ë, ~A.
- PAK** II ndajf. Pak se... jo vetëm që..., nuk mjafton që... Për pak pothuaj, gati sa; për një fije, për një qime. Pak (e) nga pak ca nga ca, dalëngadalë.
- PAKALLUR** mb. I vdekur i pakallur (i pafutur) në dhe shih te VDEKUR (i,e).
- PAKRYER** mb. Koha e pakryer gjuh. një nga kohët e shkuara të foljes, në të cilën folja tregon një veprim a gjendje të zgjatur që është në zhvillim e sipër në një çast të së

- shkuarës. Aspekti i pakryer gjuh. kategori gramatikore e foljeve në disa gjuhë, e cila e shpreh veprimin ose gjendjen të zgjatuar a të përsëritur, pa ndonjë kufizim a pa ndonjë cak kohor; kund. aspekti i kryer.
- PAKTË** mb. Nuk është e paktë diçka është me pasoja të rënda ose është diçka e madhe e me rëndësi, është serioze. Nuk është i paktë dikush është edhe ai ndër ata që dallohen, ka edhe ai aftësi e merita të veçanta ose vlerë a peshë jo të vogël në shoqëri. E mban (e ruan) si ujët e paktë e mban (e ruan) me shumë kujdes, si diçka shumë të vlefshme dhe të çmuar.
- PAKUSHTËZUAR** mb. Refleks i pakushtëzuar (i trashëguar) psikol. shih te REFLEKS,~I 1.
- PALAÇO** m. E bëri palaço dikë e shau rëndë, nuk i la gjë pa i thënë.
- PALARA** f. vet. sh. Ia di të larat e të palarat shih te LARA,~T (të). U nxori të palarat (sheshit) ia nxori gjërat e këqija, ia zbuloi të gjitha.
- PALARË** mb. Si plëndës i palarë mospërf. e llackosur dhe e shëmtuar (zakonisht për një grua që është lyer e stolisur keq).
- PALCË** f. Deri në palcë të qafës në të gjithë trupin, nga koka deri te këmbët; krejt, i tëri.
- PALË** I f. E bëri palë dikë a diçka e shtypi, e bëri petë. E bëri bishtin palë përçm.
- PALË** II f. Me sa palë mend? shih te MEND,~TË. U plak me një palë mend mospërf. shih te MEND,~TË. Për shtatë palë qeje shih te SHTATË. E mbylli me shtatë palë çelësa (me shtatë kyçe) shih te SHTATË. Qante me shtatë palë lot shih te SHTATË.
- PALË** III f. Si arra me palën (si fiku me arrën) shih te FIK,~U.
- PALË-PALË** I ndajf.
Iu bë qafa palë-palë (me pala) shih te QAF/Ë,~A.
- PALOS** kal. Palosi buzët nuk i erdhi mirë, i erdhi thartë, nuk mbeti i kënaqur; u bë gati për të qarë.
- PALOSUR** mb. Dyfek i palosur mospërf. njeri i ligët a me cen në trup, që nuk është i aftë për punë; njeri i metë nga trutë.
- PALLAMAR** m. det. E bëri pallamar (tërkuzë, litar) diçka shih tek TERKUZ/Ë,~A.
- PALLASKË** f. E bëri barkun pallaskë u dend, u fry nga të ngrënë. Ngjitet si pallaska pas brezit të ndjek hap pas hapi e nuk të ndahet, të ngjitet si rrodhe.
- PALLAVRA** f. vet. sh. bised. Shet pallavra (dokrra, dëngla, përralla) shih te SHES 4.
- PALLË** f. Nuk i ha palla nuk çan kokën për asgjë, nuk i bëhet vonë për asgjë, nuk bëhet merak. Sa i ha palla me të gjitha forcat, me sa fuqi që ka. Me pallë (me shpatë) zhveshur shih te ZHVESHUR. E zhveshi pallën shih te ZHVESH. I tund pallën (shpatën) dikujt shih tek TUND. Është bishti i pallës dikush është më i vogël se të tjerët ose është i fundit nga rëndësia a vlera dhe s'e pyet njeri për asgjë, nuk e përfill njeri fjalën e tij, është vrima e fundit e kavallit. Iu këput rripi i pallës shih te RRIP,~I. I priste palla (sh-pata, sëpata) djabatas e majtas (nga të dyja anët) shih te PRES I.
- PALLTO** f. E hoqi nga palltoja dikë e mori me zor dikë, e detyroi të shkojë me të. E kapi (e zuri) për palltoje dikë nuk e la të qetë dikë, deri sa ia plotësoi një punë a një kërkesë; nuk iu nda, iu qep.
- PALLUA** m. zool. Syri i palloit bot. shih te SY,~RI.
- PAMBUK** m. E bëri pambuk dikë e rrahu shumë, e zhdëpi në dru. Shkel në pambuk e ka punën fare të lehtë, jeton në rehati. Të vret me pambuk të bën ta kuptosh gabimin e të pendohesh duke të qortuar lehtë e me të mirë ose duke ta sjellë fjalën larg e larg. Gur pambuku (leshi, liri, mëndafshi) bised. shih te

LESH,~I. Pambuk i egër bot. bimë barishtore, e ngjashme me pambukun, e cila rritet në toka të rënda të mbjella me bimë që prashiten dhe i dëmton këto. Pambuk guri min. asbest. Pambuk xhami (qelqi) tek. lëndë prej fijesh të holla xhami, që përdoren për veçim, lesh xhami.

PAMBUKORE f. Pambukorja e agrumeve bot. sëmundje që u bie zakonisht agrumeve e që shfaqet me disa plagë në lastarë në trajtën e një shkume të bardhë, sidomos pranë sythave dhe nyjave.

PAMBULUAR mb. I vdekur e i pambuluar (i pakallur, i pafutur) në dhe shih te **VDEKUR**,~I (i).

PAMJE f. Fushë pamjeje (fusha e pamjes) shih te **FUSH**/Ë, ~A. Këndi i pamjes (i vështrimit) shih te **KËND**,~I 8. Në pamje të parë sipas përshtypjes që kemi nga ana e jashtme, pa i hyrë në brendësi a në thelb.

PAMOTIVUESHËM mb. 2. gjuh. Që nuk mund t'i përcaktohet prejardhja kuptimore; që nuk i dihet lidhja me kuptimin e parë. Fjalë (njësi frazeologjike) të pamotivueshme. Kuptim i pamotivueshëm.

PANDARË mb. Mollë e pandarë thuhet për njerëz që kanë miqësi të ngushtë e rinë vazhdimisht bashkë. Një dhe i pandarë që nuk pjesëtohet me dikë tjetër, që i përket plotësisht njërit ose që është tërësisht e drejtë e tij.

PAPAGALL m. Çelës papagall tek. shih te **ÇELËS**,~I 2.

PAPË f. fet. Është më katolik se papa tall. shih te **KATOLIK**,~E.

PAQ ndajf. bised. Jemi paq me njëri-tjetrin nuk kemi më llogari për të larë me njëri tjetrin, jemi të larë.

PARA f. Sa para bën nuk vlen, është e kotë. S'lidh para shih te **LIDH**. Tundi paratë shih tek **TUND**. Pesë para gjë shih te **PES**/Ë,~A. U zunë (u grindën) për pesë (për dy) para spec u zunë (u grindën) për diçka fare pa rëndësi, për diçka shumë të

vogël, për hiçmosgjë, kot së koti. Me pesë para në xhep shih te **PES**/Ë,~A. Pesë para oka (dy groshë oka) mospërf. shih tek **OK**/Ë, ~A. Nuk bën pesë para nuk vlen fare, nuk vlen hiçgjë, është diçka fare pa vlerë. E bëri (të bëri lëkurën) për pesë (për dy) para dikujt s'i la gjë pa thënë, ia përplasi të gjitha në fytyrë; e fëlliqi a e turpëroi para të tjerëve. Nuk i bën (nuk i vlen) lëkura një para dikujt nuk vlen fare, nuk është i aftë për asgjë. Futet pesë para në grosh shih te **GROSH**,~I. Nuk ka (as) pesë (as dy) para mend nuk ka mend fare, është i lehtë nga mendja, nuk thellohet fare, i merr gjërat me lehtësi; nuk ia pret mendja. Është pesë (dy) para burrë (njeri) ka trup të vogël e të imët, është shumë i shkurtër dhe i dobët, nuk ta mbush syrin nga pamja; është një njeri pa rëndësi, pa vlerë. E bleu belanë me para e kërkoi vetë një të keqe.

PARA f. E para e punës në radhë të parë, së pari; kryesorja. E priti me të parat dikë e priti keq, e priti me këmbët e para.

PARA Para (përpara) se... lidh. shih te **PËR-PARA**. Para së gjithash shih te **GJITHË** (i,e). Para (përpara) hundës së dikujt shih te **HUND**/Ë,~A. Para (përpara) syve të dikujt shih te **SY**,~RI. Bëj (çaj) para (përpara) shih te **PËRPARA**. Vetë para e vetë pas fillikat i vetëm, pa njeri tjetër. Nuk i dilet para (përpara) shih te **PËRPARA**. E vuri (e mori) para (përpara) dikë shih te **PËRPARA**. E ka vënë punën para (përpara) shih te **PËRPARA**. E ka parë diellin para teje shih te **SHOH**. E kemi të ardhmen para (përpara) shih te **PËRPARA**.

PARAFJALOR mb. gjuh. Rasa parafjalore rasa e gjashtë në gjuhët sllave në të cilën emrat përdoren vetëm me parafjalë dhe i përgjigjen pyetjes Â«për (mbi) kë, për (mbi) seÂ».

PARALEL mb. Lidhje paralele (në seri) elektr. shih te **LIDHJ**/E,~A 12.

PARAPRITËS mb. usht. Pikë parapritëse pikë e përcaktuar me anë të llogaritjeve,

- në të cilën predha mund ta godasë një shenjë që lëviz.
- PARASYSH** ndajf. Nuk e marr parasysh diçka edhe poh.
- PARË** m. Nuk e pa i pari të dytin ikën me vrap në rrëmujë të madhe e në panik. Nuk e merr vesh (nuk e njeh) i pari të dytin është rrëmujë e madhe, s'e njeh qeni të zotin.
- PARË** I as. Me të parë e me të bërë do të veprohet sipas gjendjes që do të krijohet, sipas rrethanave a kushteve konkrete.
- PARË** mb. Me fjalën e parë shih te FJAL/Ë,~A. I orës së parë (i orëve të para) shih tek OR/Ë,~A I. Në radhë të parë para së gjithash, së pari, në vendin kryesor. Në radhët e para (në rreshtat e parë) në ballë, në krye, në vendin më të vështirë të punës a të luftës. Në vijë të parë në punën më të vështirë, në ballë. Hedh (bën) hapin e parë (hapat e parë) shih te HAP,~I 3. E priti me këmbët e para shih te KËMB/Ë,~A. B a r a z i m i gradës së parë mat. shih te BARAZIM,~I 3.
- PARË** ndajf. Më parë e më dalë para së gjithash, pikësëpari. Një orë (çast, saat) e më parë shih tek OR/Ë,~A 1.
- PARI** ndajf. Pikë së pari shih te PIK/Ë,~A.
- PARIM** m. Në parim
- PARMAK** m. Çardak pa parmak shih te ÇARDAK,~U.
- PARMË** f. Parmat e fytit anat. secila nga dy arteriet e mëdha përpara qafës, të cilat çojnë gjakun në kokë.
- PARTALLE** f. kryes. sh. bised. I dha partallet dikujt e përzuri nga një vend, i dha lecat.
- PARTI II** f. Parti dyfishe fin. mënyrë regjistrimi, sipas së cilës çdo shumë që shënohet në dobi të një llogarie ose të disa llogarive, shënohet njëkohësisht edhe në kredi të një llogarie tjetër ose të disa llogarive të tjera.
- PAS** Flet (vepron) pas (prapa) krahëve shih te KRAH, ~U 3. Pas (prapa) perdes libr. shih te PERD/E,~JA 11. Brez pas brezi shih te BREZ,~I 7. Dorë pas dore shih te DOR/Ë, ~A. Hap pas hapi shih te HAP,~I. I bie pas (prapa) dikujt a diçkaje kujdeset për dikë a për diçka vazhdimisht që të vejë në rregull, të përmirësohet, të zgjidhet etj.; interesohet, e ndjek. I rëntë (i ardhhtë) pas veshit (pas qafës). mallk. shih te VESH,~I. I lë pas dore shih te DOR/Ë,~A. Shkojnë pas qerres së dikujt (lidhen pas qerres së dikujt, ndjekin pas qerren e dikujt) shih te QERR/E,~JA. S'kishte gjë pas shpirtit shih te SHPIRT,~I.
- PASMË** mb. E vuri në xhepin e pasmë nuk bëhet merak fare për diçka, as që çan kokën fare për të, e la në harresë, e hodhi pas krahëve.
- PASNESËR** ndajf. Flet për (si) pasnesër flet kot, flet në tym. Nesër, pasnesër dikur në të ardhmen; kur t'i vijë koha.
- PASOJË** f. Si (për) pasojë ... fj. ndërm. rrjedhimisht, prandaj, për rrjedhim.
- PASQYRË** f. E ka zemrën pasqyrë ka shpirt të mirë dhe të pastër, ka zemër të kulluar, është shumë i çiltër. E shoh veten si në pasqyrë shoh qartë të metat dhe gabimet e mia për t'i ndrequr.
- PASTËRMA** f. Është bërë pastërma është tharë e është nxirë në fytyrë; është plakur e dobësuar shumë.
- PASTROJ** kal. Pastro (laj) gojën! mospërf. shih te LAJ. Pastroj (kruaj) zërin (gur-mazin) shih te
- PASTHIRRMOR** mb. gjuh. Që përdoret si pasthirmë; që ka vlerën e një pasthirmë; që ka në përbërjen e vet një pasthirmë. Pjesëz pasthirmore. Ndashfolje pasthirmore. Njësi frazeologjike pasthirmore.
- PASH** m. I ra pash më pash e përshkoi një vend nga njëri skaj në tjetrin a nga kreu deri në fund, i ra në të katër anët. Ecte pash më pash ecte me madhësi, duke

u tundur sa andej e këtej. E ke lejen me pashë (plot pashin) ke lejë të plotë, je i lirë të bësh çfarë të duash a të veprosh si të duash. I doli gjuha (një pash, një pëlëmbë) shih te GJUH/Ë, ~A I. Ma nxori gjuhën (një pash, një pëlëmbë) shih te GJUH/Ë, ~A I. E ka gjuhën një pash flet shumë, nuk pushon së foluri, e ka gjuhën të gjatë. Shtatë pashë nën dhe shih te SHTATË. E pafsha shtatë pashë nën dhe! mallk. shih te SHTATË. Qep një pëlëmbë e shqep një pash shih te QEP.

PASHUAR mb. Është urë e pashuar shih tek UR/Ë, ~A II.

PATË f. zool. Kur të bëhet gjethja sa këmba e patës kur të ngrohet moti mirë, pasi të ketë hyrë pranvera. Pula e fqinjës (e tjetrit) të duket patë fj. u. gjëja e tjetrit të duket më e mirë a më e madhe se jotja, pula e botës të duket më e majme.

PATËSHINË f. krahin. E bëri patëshinë diçka a dikë e dërrmoi duke e shkelur, duke e shtypur; e rrahu, e shembi duke i rënë me diçka etj.

PAVARUR mb. Fjali e pavarur gjuh. fjali që s'varet gramatikisht prej një fjalie tjetër dhe që s'plotësohet nga një fjali tjetër.

PAZAR m. bised. Muhabete (muhabet) pazari diçka për të cilën flitet sot poshtë e përpjetë; thashetheme. S'e ha pazari nuk shkon, s'hahet. Hyri në pazar me dikë keq. shih te HYJ. Ka dalë fjala në pazar e kanë marrë vesh të gjithë, është përhapur fjala kudo, ka marrë dhenë fjala. Është portë pazari është llafazan i madh, merret shumë me thashetheme dhe nuk mban dot asgjë të fshehtë. E nxori në portë të pazarit dikë ia nxori të gjitha të fshehtat, ua tha të gjithëve ç'dinte për të. Ç'do dhelpira në pazar? shih te DHELP/ËR, ~RA. Nuk humbi (s'u shua) pazari për gjilpëra fj. u. shih te HUMB. Hesapi i shtëpisë nuk del në pazar fj.u. shih te HESAP, ~I.

PE m. U bë pe u dobësua shumë, u tret fare. Ia bëri pe dikujt ia mblodhi mirë, ia futi këmbët në një këpucë. Fill e për

pe (fije e për pe, fije për fije) shih te FILL, ~I. Me pe e me gjilpërë (në pe e në gjilpërë) me hollësi të madhe, fill e për pe. Lëshoi pe (vend) shih te LËSHOJ. Ngatërron (përziën) penjtë (fijet, fijet) shih te NGATËRROJ. Pret për ta dikush shih te PRES I. Si rruaza në pe shih te RRUAZ/Ë, ~A. Ia rrudh penjtë dikujt shih te RRUDH. Janë pe për një gëzof shih te GËZOF, ~I. Kapet (mbahet) pas fijos së perit (së flokut, së kashtës) shih te FIJ/E, ~A. Nuk ta kap perin lëmshit nuk ia gjen fillin diçkaje të ngatërruar, nuk di nga t'ia fillojë; s'e zgjidh dot një punë të vështirë, jo të thjeshtë etj. Është lidhur me pe merimange diçka është krejt e pasigurt. Merr pe e gjilpërë s'lë gjë pa marrë, merr çdo gjë. I qepur me pe të bardhë i rregulluar pa kujdes, i ndrequr pa mjeshtëri, që i duken qartë gjurmët e rregullimit; i bërë në mënyrë trashanike. T'i shkojë peri gëzofit t'i përshatatet mirë diçkaje tjetër; të bëhet me kujdes e me lezet, jo në mënyrë të trashë dhe pa mjeshtëri. Shtie (fut) rruaza në pe dikush

PECKË f. zvog. Me lecka e me pecka shih te LECK/Ë, ~A.

PEHRIZ m. bised. Mabaj pehriz në diçka nuk bëj a nuk e përdor diçka. Është me pehriz diçka nuk gjendet lehtë, s'është me bollëk. I vuri pehriz goja nuk flet më mbarë e prapë, i kontrollon mirë fjalët që thotë.

PELENË f. Është në pelena dikush a diçka përçm.

PELË f. Një vrap pele shih te VRAP, ~I. Një thelë sa për një pelë shumë shtrenjtë, sa frëngu pulën. Del si mëzi para pelës keq. shih te MËZ, ~I. E zunë me pelë për dore e zunë duke vjedhur a në faj, e zunë me presh në duar. Çon një pelë e ha një thelë fj. u. harxhon shumë dhe fiton pak; i kushton shumë shtrenjtë diçka. Të jep një thelë e të merr (të rrëmben) një pelë keq. shih te THEL/Ë, ~A.

PELTE f. E bëri pelte dikë e rrahu shumë keq, e zhdëpi në dru, ia zbuti mirë kurrizin; e dërrmoi.

- PELLG** m. U bë pellg në ujë (në djersë) u lag shumë, u bë tërë ujë (tërë djersë), u bë qull. Si mulliri në pellg shih te **MULLI**, ~**RI**. Mbeti si guri në mes të pellgut dikush mbeti pa njeri e të afërm, mbeti fill i vetëm. Shkoi (vajti) si guri në pellg (në ujë, në lumë) shih te **GUR**, ~**I**.
- PEMË** f. Pemë pa kokrra shih te **KOK/ËRR**, ~**RRA**. Është pemë (lis) me rremba shih te **RREMB**, ~**I**. Pema pa u pjekur s'halet fj. u. çdo gjë do kohën e vet, do kushtet e nevojshme që të bëhet a të zhvillohet. Shkund pemët e të tjerëve shih te **SHKUND**.
- PEMËL** f. kryes. sh. Lulet (fletët) i ka të bukura, po t'i shohim pemlat duket i mirë a i mbarë në fillim, po duhet prituri se ç'fryte (rezultate) do të japë, të presim ç'do të na japë në fund, a do të sjellë fryt apo jo.
- PENDAR** m. Pendari i ruan vreshtat fj. u. thuhet për të theksuar se dikush nuk i shkel rregullat jo sepse është i ndërjegjshëm, po sepse ka frikë se mos e shohin a mos e kontrollojnë, frika i ruan vreshtat.
- PENDË** I f. I ranë pendët (puplat, fletët) dikujt mospërf.
- PENEZ** m. E mbante si penez në pëllëmbë të dorës e mbante shumë mirë, me gjithë të mirat; e ruante si gjë të çmuar.
- PENË** f. Me një të rënë të penës (të lapsit) shih te **RËN/Ë**, ~ **A** (e). E mprehu (mirë) penën (lapsin) libr. e thelloi përmbajtjen dhe e përsosi më tej formën, stilin etj. në shkrimet e tij, e mprehu kritikën, luftën etj. kundër dikujt a diçkaje në shkrimet e tij. Rroku penën, iu përvesh një pune të madhe me shkrim për qëllime të caktuara. I shket pena dikujt shih te **SHKAS**. E mban (e ka) penën të mprehtë ruan po atë forcë, po atë thellësi e po atë formë të lartë në shkrimet e tij, shkruan gjithnjë me mprehtësi, nuk e ul forcën në shkrimet e tij.
- PEQE** pj. bised. Me lepe e me peqe edhe keq. shih te **LEPE**.
- PERDAH** m. I dha një perдах bised. e bëri disi një punë, e rregulloi disi, i dha një mistri.
- PERDE** f. Prapa (pas) perdes fshehurazi, tinëzisht. Nuk ka perde dikush nuk ka vesh, për muzikë. Nuk këndon me perde dikush nuk këndon mirë, e shtrembëron melodinë sepse nuk i kap mirë notat. I kanë vënë (i kanë zënë) sytë perde është verbuar e nuk kupton ç'po i bëjnë, nuk e sheh të keqen që i kanoset nga afër. Perde zjarri usht. breshëri predhash që lëshohen në një hapësirë të caktuar kundër objekteve ajrore që fluturojnë ulët a të cilëve u dihet drejtimi i lëvizjes por jo koordinatat e vendndodhjes ose që hidhen për të penguar sulmin e forcave të armikut.
- PERËNDI** f. E kanë (është) perëndi e nderojnë dhe e dëgjojnë dikë si besimtari perëndinë; e mbajnë diçka si të shenjtë, e duan dhe e çmojnë pa masë; e adhurojnë.
- PERËNDOJ** jokal. I perëndoi sytë
- PERËNDUAR** mb. Me sy të perënduar duke perënduar sytë.
- PERIME** f. vet. sh. Perime gjethore shih te **GJETHOR**, ~**E**.
- PERIODIK** mb. Ligji periodik kim. Ligji që shpreh vetitë e elementeve kimike dhe të përbërësve të tyre sipas strukturës së atomeve. Sistemi periodik (i elementeve) kim. Klasifikimi natyror i elementeve që bazohet në ligjin periodik. Thyesë periodike mat. Thyesë dhjetore e pafund, në të cilën një grup i njëjtë shifrash përsëritet pafundësisht.
- PERIUDHË** f. Me periudha në mënyrë jo të vijueshme, me ndërprerje, me disa etapa. Periudhë vegjetative bot. shih te **VEGJETATIV**, ~ **E**.
- PESË** num. them. Pesë me hiç thjeshtligj. shih. te **HIÇ**, ~ **I**. S'ia ka për pesë dikujt nuk pyet për të, s'e ka frikë fare. Nuk e kishte (nuk e bënte) për pesë diçka nuk pyeste, nuk e quante gjë. Pesë para gjë diçka fare e vogël, shumë pak. Nuk

bën pesë para shih te PARA,~JA. Pesë para oka (dy grosh oka) mospërf. shih te OK/Ë,~A. Me pesë para në xhep me shumë pak para; me diçka fare të vogël. Është pesë (dy) para burrë (njeri) shih te PARA,~JA. U bënë pikë e pesë u shpërndanë, s'mbeti asnjë bashkë me një tjetër, ku ra njëri nuk ra tjetri; u bënë kashtë e koqe. E shiti (e bleu) për pesë para e shiti (e bleu) shumë lirë, gati falas. E bëri (ia bëri) lëkurën për pesë (për dy) para diku shih te PARA,~JA. Futet pesë para në guros shih te GROSH,~I. S'ka dele me pesë këmbë thuhet për të theksuar se nuk ka njeri ose send që të jetë fare i përsosur e pa asnjë të metë. U zunë (u grindën) për pesë (për dy) para spec shih te PARA,~JA. Nuk ka as pesë (as dy) lëkura edhe iron. shih te LËKUR/Ë,~A. Fiton pesë e ha (prish) gjashtë shih te GJASHTË. Jo besa-besë e pesa pesë shih te BES/Ë~A. Pesë dhi, gjashtë zile shih te GJASHTË. Pesë më shumë, pesë më pak pesë, një okë pa pesë (një okë e dhjetë, një okë pa dhjetë) shih tek OK/Ë,~A.

PESËQIND num. them. Vrima e miut pesëqind grosh shih te MI,~U.

PESËSH m. vjet. S'vlen asnjë pesësh, s'vlen fare, s'bën asnjë grosh.

PESTIL m. E bëri pestil e rrahu shumë, e zhdëpi me dru.

PESHË f. Peshë e gjallë shih te GJALLË (i,e) 2. Peshë e vdekur shih te VDEKUR (i,e). Është pesha e dheut dikush është njeri me shumë rëndësi a njeriu më i rëndësishëm në një vend. Ka qenë peshë e madhe dikush ka qenë njeri me shumë rëndësi, ka qenë njeri me zë. Nuk ngre (nuk çon) kandar (peshë) edhe poh. shih te KANDAR,~I. Vë në peshë e shoh dhe e shqyrtoj diçka nga të gjitha anët, e vlerësoj duke marrë parasysh edhe të mirat edhe të këqijat, i peshoj të gjitha. Besa e burrit, pesha e gurit fj. u. shih te BES/Ë,~A. Fjala e burrit, pesha e gurit fj. u. burri kur e jep fjalën nuk e luan.

Hedh peshën (gurin) e fsheh dorën shih te HEDH.

PESHË ndajf. Ngre (çoj) peshë dikë e nxit për diçka, i jap zemër dhe e bëj të ngrihet e të veprojë me vrull; e ngre më këmbë. Ngrihet (çohet) peshë ngrihet më këmbë menjëherë me vrull për të bërë diçka; nxitet për veprim. Ngre (çoj) peshë (mendjet, zemrat) nxit që të punojnë a të veprojnë me të gjitha fuqitë që kanë, u jap guxim e veprim për të kryer diçka. I çoi peshë zemrën diku e mallëngjeu, e preku thellë në zemër.

PESHK m. E bëri peshk dikë thjeshtligj. e rrahu shumë, ia bëri kurrizin më të butë se barkun. Gomë peshku shih GOM/Ë,~A. As mish as peshk shih te MISH,~I. Me urdhër të peshkut iron. pa u lodhur për diçka pa bërë vetë asgjë. Mbeti si peshku në gjanë mbeti si peshku në zall. Mbeti si peshku në zall (pa ujë) mbeti pa mjete jetese, është në ngushticë të madhe, mbeti pa gjë fare. Ta pjek peshkun në buzë shih te BUZ/Ë,~A. I ka shkuar mendja për peshk diku i ka shkuar mendja për diçka të mirë a për diçka që gjendet me vështirësi (përdoret zakonisht në vende që janë larg detit, lumnjave a liqeneve). Zë peshk në bar shih te BAR,~I I. Hyri mish e doli peshk mospërf. shih te MISH,~I. Peshku në det e tiganë në zjarr fj. u. iron. thuhet kur një punë ende s'është kryer, kurse dikush kërkon para kohe të gëzojë të mirat që do të vijnë prej saj pasi të përfundojë; është tepër herët për diçka. Peshku i madh e ha të voglin fj. u. ai që është më i fuqishëm e zhdëpi më të voglin ose më të dobëtin, fiton më i forti edhe kur e drejta është në anën e më të dobëtit ose e më të voglit (karakteristikë për shoqërinë me klasa shfrytëzuese dhe për moralin borgjez). Bar peshku bot. shih te BAR,~I I. Lule peshku bot. shih te LUL/E,~JA. Peshk elektrik zool. Peshk deti me trup të rrumbullakët, të sheshtë she me bisht, i pajisur me organe të posaçme që lëshojnë ngarkesa

- elektrike. Peshk fluturak zool. peshk fluturues. Peshk fluturues zool. peshk deti me dy pendët çifte të gjoksit si krahë, me të cilat fluturon ulët mbi sipërfaqen e ujit në një larësi rreth dyqind metrash. Peshk guri zool. peshk i vogël deti, zakonisht me kurriz të murrmë, që jeton në thellësi, zakonisht nën gurë re shkëmbinj e nuk hahet. Peshk pëllumb zool. peshk deti grabitqar, i familjes së peshkaqenëve, pa brinjë kërcore.
- PESHKOJ** kal. Peshkon në ujë të turbullt (në ujëra të turbullta) keq. punon tinëz, vepron në mënyrë jo të ndershme, duke u munduar të përfitojë nga vështirësitë në të cilat gjendet dikush, një vend etj.; e turbullon një gjendje me qëllim që të nxjerrë përfitime.
- PESHOJ** kal. Të peshonte në flori shih te FLORI, ~RI. I peshon arrat pa i shkundur flet pa u menduar; vendos para kohe, është i rrëmbyer.
- PESHORE** f. Me peshoren e farmacistit shih te FARMACIST, ~I.
- PESHQESH** m. Ma la peshqesh në derë shih te DER/Ë, ~A.
- PESHQIR** m. Hyr e dil e tund peshqirin mospërfill. shih te HYJ.
- PETAK** mb. Fjalë petake fjalë që zënë vend.
- PETANIK** m. Si është miku, bëhet petaniku fj. u.
- PETË** f. E bëri petë
PETË-PETË ndajf.
E kishte fytyrën petë-petë e kishte fytyrën tërë rrudha të thella.
- PETK** m. I hyri ndër petka (në gji) diku shih te GJI, ~RI.
- PETULL** f. I bën petullat me ujë (pa vaj) bën plane që nuk mund të vihen në jetë; flet pa u mbështetur mbi baza të shëndosha. Kërkon petulla me gjalpë ka kërkesa të tepërta; kërkon gjëra me shpenzime të mëdha. Përpëlitet (cëritet) si petulla në tigan dikush përvëlohet nga një dëshirë e zjarhtë që nuk mund ta plotësojë, ka një brengë të madhe në zemër, vuan shumë shpirtërisht. Nuk bëhen ato petulla që t'i jep (t'i sjell) shigjetulla fj. u. janë të rrezikshme dhuratat që vijnë nga armiku.
- PEZUL** m. kryes. bised. Mbeti pezul nuk luan nga vendi; rri në një vend (shtrirë ose ulur) e nuk lëviz.
- PEZULL** ndajf. Me frymën (me zemrën) pezull duke qenë shumë i shqetësuar për diçka, në merak të madh për diçka.
- PEZULLIM** m. Pika pezullimi gjuh. shih te PIK/Ë, ~A.
- PËLCAS** jokal. I plasi barku ka ngrënë shumë, u fry së ngrëni. Më plasi barku vuaj kur e shoh, më prek shumë, më hapi barkun. S'i pëlçet (s'i hapet, s'i digjet) barku për dikë përçm. shih te BARK, ~U. Më plasi buza shih te PLAS. Pëlçet derri shih te
- PËLHURË** I f. Pëlhura e Penelopës libr. punë që zgjatet shumë a nuk merr fund kurrë.
- PËLLE** f. E bën ferrën pëlle e zbukuron jashtë mase diçka; e paraqet diçka të keqe si të mirë, e bën murrizin hardhi.
- PËLLËMBË** f. Pëllëmbë e flori tokë shumë pjellore; truall i pasur me minerale të dobishme.
- PËLLUMB** m. zool. Peshk pëllumb zool. shih te PESHK, ~U.
- PËQI** m. I pash pëqirin diku shih edhe moh. tregohet i përulur përpara diku shih, i bën lajka një eprori etj. Prish (gris) gjirin, arno pëqirin fj. u. shih te GRIS.
- PËRBASHKËT** mb. E bëj çështje të përbashkët shih te ÇËSHTJ/E, ~A. Gjejnë gjuhë të përbashkët shih te GJUH/Ë, ~A II. Nuk kam asgjë të përbashkët me dikë kam mendime, pikëpamje, interesa etj. të kundërta me dikë; nuk më lidh asgjë me të. Sjell (kthej) në një emërues të përbashkët libr. shih tek EMËRUES, ~I.
- PËRBËRË** mb. Fjalë e përbërë gjuh. fjalë e formuar nga bashkimi i dy a më shumë temave në një njësi të vetme fonetike,

- leksikore e gramatikore; kompozitë e mirëfillt ë(p.sh. atdhedashuri, besëlidhje, ballëhapët, gojëmjaltë, gurgdhendës, gushëkuq, gushtovjeshtë, tejkaloj etj.).
- PËRBOTSHËM** mb. Oqeani i përbotshëm (botëror) gjeogr. shih te **BOTËROR**,~E.
- PËRÇAP** kal. I përçap (i përtyp) fjalët shih te **PËRTYP**.
- PËRÇART** ndajf. Flet përçart thotë fjalë pa mend e pa arsye, flet në tym, kot.
- PËRDOR** kal. Përdor (luaj, hedh) letrën (kartën, gurin, zarin) e fundit shih te **FUNDIT** (i,e).
- PËRDREDH** kal. E përdrodi (e drodhi) bishtin (këmbën) përçm. shih te **DREDH**. Përdredh (mbledh, rrudh, shtrembëron, tharton) buzët (turinjhtë, hundët) shih te **BUZ/Ë**,~A.
- PËRDHE** ndajf. Me faqe përdhe (në dhe) shih te **FAQ/E**,~JA. Me shpinë përdhe (në tokë) shih te **SHPIN/Ë**,~A. I ka rënë hunda përdhe (në dhe) iron. shih te **HUND/Ë**,~A.
- PËRDHES** mb. Mizë përdhese zool. milingonë, mizë dheu.
- PËRGATITJE** f. Përgatitje artilerie usht. shih te **ARTILERI**,~A 1.
- PËRGJAK** kal. Nuk e ka përgjakur dyfekun
- PËRGJEGJËS** mb. Kënde përgjegjëse mat. shih te **KËND**,~I 1.
- PËRGJIGJE** f. Në përgjigje të... libr. duke iu përgjigjur... E ka përgjigjen në majë të gjuhës përgjigjet shpejt, aty për aty, ta kthen menjëherë.
- PËRGJIGJEM** vetv. I përgjigjet majë për majë shih te **MAJ/Ë**,~A. Iu përgjigj (ia ktheu, ia shpërbleu) me të njëjtën monedhë libr. shih te **MONEDH/Ë**,~A.
- PËRGJITHMONË** ndajf. Një herë e përgjithmonë shih te **HER/Ë**,~A 2. I mbylli sytë përgjithmonë lart. shih te **SY**,~RI.
- PËRGJITHSHËM** mb. Në vija të përgjithshme (kryesore, të trasha) shih te **VIJ/Ë**,~A.
- PËRHERSHËM** mb. Kapital i përherëshëm ek. kapital i pandryshueshëm. Shpendë të përherëshëm zool. shpendë që qëndrojnë në një vend gjatë gjithë vitit; kund. shpendë shtegtarë.
- PËRJASHTIM** m. Me përjashtim të... përveç..., pa përfshirë..., duke përjashtuar... Pa përjashtim që të gjithë, të tërë. Bën përjashtim është rast i rrallë e i vetëm.
- PËRJETËSI** f. Në përjetësi për tërë jetën e jetës, përgjithnjë.
- PËRJETSHËM** mb. Gjumi i përjetshëm (i madh) euf. shih te **GJUM/Ë**, ~I
- PËRKAS** kal. Për sa i përket... libr. në lidhje me.... për ...
- PËRKUL** kal. Nuk e përkul (nuk e kërrus, nuk e ul) kurrizin (shpinën) edhe poh. shih te **KËRRUS**. Përkule (ule) mesin! shih te **MES**,~I.
- PËRMBËSHTJELL** kal. Përmbështjell veten (shpirtin, frymën) i jap guxim e forcë vetes për të përballuar një vështirësi; e marr veten përsëri, e mbledh veten.
- PËRMBYS** kal. Përmbys (pres, shkul) nga rrënjët (me rrënjë) shih te **RRËNJ/Ë**,~A I. Ha bukën e përmbys kupën shih te **HA**.
- PËRMBYS** ndajf. E ktheu përmbys diçka
- PËRMBYSEM** vetv. Sikur qielli të përmbysset (të shembet)! shih te **QIELL**,~I. Edhe sikur bota (dynjaja) të përmbysset! shih te **BOT/Ë**,~A.
- PËRMJERR** jokal. E bëri të përmjerrë (të vjellë) gjak dikë thjeshtligj. ia mori shpirtin, ia nxori shpirtin; mori hak rëndë kundër dikujt (me dhunë).
- PËRPARA** Përpara (para) se... lidh. përdoret në fillim të një fjalisë të varur kohore për të treguar se veprimi i fjalisë kryesore ndodh para veprimit të shprehur nga fjala e varur (p.sh. Hynë në klasë

përpara se të vinte mësuesi.). Përpara (para) hundës së dikujt shih te HUND/Ë, A. Përpara (para) syve të dikujt shih te SY,~RI.

PËRPARMË mb. Nyjë e përparme gjuh. njëjë që vihet përpara një emri për të formuar trajtën e rasës gjinore; nyja që hyn në ndërtimin e një tipi të pasur mbiemrash të shqipes, në ndërtimin e përemrave dëftorë, lidhorë e të pakufishëm, në ndërtimin e numërorëve rreshtorë e të disa emtave femërorë e asnjane. E ardhmja e përparme gjuh. kohë e mënyrës dëftore të foljes, e cila tregon një veprim ose gjendje që pritet të kryhet ose të vijë në të ardhmen para një veprimi ose një gjendjeje tjetër (p.sh. Ai do të jetë kthyer nga puna kur të vini ju). Zanore e përparme gjuh. zanore që njëtohet në pjesën e përparme të gojës.

PËRPEQ m. Kërkon halën (qimen) në përpeq kërkon të gjejë të meta e gabime me çdo kusht, edhe aty ku nuk ka.

PËRPËLITEM vetv. Përpëlitet (cëritet) si petulla në tigan shih te PETULL,~A. Përpëlitet (është) në shtratin e vdekjes shih te VDEKJ/E,~A.

PËRPIJ kal. E përpiu (e thithi, e piu, e rrufti) dhe shih te DHE,~U. I përpiu (i hëngri, i gëlltiti) fjalët shih te GËLLTIT. E përpiu të gjallë e për lau dhe e zhduku. Përpini retë është shumë trim, është i shkathët dhe trim me fletë. E përpiu rrugën e bëri një rrugë me nxitim e me shpejtësi të madhe. E përpiu me sy ia nguli fort vështirimin e s'ia ndante sytë; e shikoi me lakmi e me dëshirë të papërbajtur, e hëngri me sy.

PËRPIKËRI f. Me përpikëri (me siguri) matematike libr. Me siguri të plotë.

PËRPIKTË mb. Shkencat e përpikta matematika dhe shkencat e tjera që mbështeten tek ajo.

PËRPIQEM vetv. Përpiqej (bënte) si zorra (si veza) në prush shih te PRUSH,~I.

PËRPPJEK kal. S'përppjek aty s'arrij dot aty ku dua, s'puth dot. I përpoqi fjalët me dikë bëri fjalë me dikë, u zu, u grind me dikë. Përpoqi pallat (ushtat) me dikë hyri në grindje a në luftë me dikë, u ndesh me dikë. I përppjekin pipat bashkë shih te PIP,~I. S'ka ku të përppjekë (ku të përplasë) kokën shih te KOK/Ë,~A.

PËRPPJETË f. Nuk i hyn asaj së përppjete dikush nuk i futet një pune të vështirë, i mungon vullneti a guximi për të bërë një punë jo të lehtë. Ka të përppjeta, (po) ka edhe të tatëpjeta fj.u. shih tek TATËPJET/Ë,~A(e) 2.

PËRPPJETË Bën (shkon) përppjetë rritet e zhvillohet mirë, merr zhvillim të mbarë, shkon lart. S'bën përppjetë dikush

PËRPLAS kal. Ia përplasi (ia tha) në fytyrë dikujt shin te FYTYR/Ë,~A. Përplasi (përpoqi) këmbët kërkoi diçka me këmbëngulje, e kërkoi patjetër (si fëmija kur kërkon diçka). Ia përplasi derën në fytyrë shih te FYTYR/Ë, ~A. S'ka ku të përplasë (ku të përppjekë) kokën shih te KOK/Ë,~A. Është për t'u përplatur në mur (pas murit) shih te MUR,~I.

PËRPPUSHEM vetv. Përppushet (mbeti) si peshku në zall (pa ujë) shih te PESHK,~U.

PËRQARK Ia sjell mendjen përqark (rrotull, vërdallë) dikujt shih te MENDJ/E,~A.

PËRQENDRIM m. Kamp (fushë) përqendrimi vend i rrethuar dhe i ruajtur nga forcat e policisë a të ushtrisë, ku mbahen të mbyllur revolucionarët e njerëzit me pikëpamje përparimtare në vendet kapitaliste e revizioniste; vend i rrethuar ku mbaheshin të mbyllur revolucionarët dhe robërit e luftës të kapur nga ushtritë nazifashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore.

PËRQENDRUAR mb. Aksion me goditje të përqendruar shih te GODITJ/E,~A I 1.

PËRSE ndajf. S'ka përse përdoret si përgjigje mirësjelljeje kur na falënderon dikush.

PËRSËRIT kal. Përsërit vetveten shih te VETVET/E,~JA.

- PËRSIPËR** I hipi përsipër dikujt a diçkaje shih te HIPI. Marr përsipër (një punë, një detyrë...) ia hyj një pune duke marrë mbi vete përgjegjësinë për ta kryer, i dal zot një pune a një detyrë. I rri përsipër dikujt a diçkaje kujdesem shumë për dikë a për diçka, nuk i ndahem i rri mbi kokë.
- PËRSHESH** m. M'u bë koka (mendja) përsesh (dhallë, bozë, çorbë, lëmsh, tym) shih te DHALL/Ë,~A. Ia bëri turinjtë (hundët, kokën) përsesh dikujt e goditi rëndë dhe e gjakosi në fytyrë, ia theu turinjtë dikujt, e dërrmoi. I ka dalë qumështi mbi përsesh dikujt shih te QUMËSHT,~I. I ha përseshin macja shih te HA. U nda nga lëngu e nga përseshi dikush shih te LËNG,~U. Gjen shesh e bën përsesh shih te SHESH,~I. Di vetëm të hajë (të rrasë) përsesh dikush di vetëm të hajë e të pijë, nuk e ke për punë. U bënë përsesh me përsesh (me njëri-tjetrin) u përlëshën e u rrahën keqas, u vranë e u grinë. Lopa në mal, përseshi në vatër (në xham) fj. u. shih te LOP/Ë,~A.
- PËRSHESH** kal. Ia përseshi turinjtë (hundët) dikujt e goditi rëndë në fytyrë dhe e gjakosi, ia dërrmoi hundët, i theu hundët; i theu turinjtë.
- PËRTEJMË** mb. Botë e përtejme jeta që gjoja ekziston pas vdekjes, bota e përtejvarrit (sipas besëtytnive e paragjyqimeve fetare).
- PËRTOJ** jokal. S'ia përton diçkaje është gati të bëjë diçka, të ndërhyjë diku, të zihet me dikë etj.
- PËRTYP** kal. I përtyp (i përçap) fjalët
- PËRVESH** kal. Përveshi buzët shprehu mospërfillje ose përçmim ndaj dikujt a diçkaje. Përveshi krahët (llërët, mëngët) ia hyri punës me zell e me të gjitha forcat.
- PËRVËLOJ** kal. Iu përvëlua (iu dogj, iu zhu-rit) zemra (shpirti) për dikë a për diçka shih te ZEM/ËR,~RA.
- PËRZË** kal. E përzunë me daulle dikë shih te DAULL/Ë, ~JA.
- PËRZIEJ** kal. Përzjeu bukën etnogr. hyri dhe hëngri për herë të parë te krushku i ri. Përzien (ngatërron) lëmshin (fijet, penjtë) shih te NGATËRROJ.
- PËRZIER** mb. Martesë e përzier shih te MARTES/Ë,~A 1.
- PËRZIERJE** f. Përzierja e bukës etnogr. pritja që i bëhej nuses në shtëpinë e babait një javë pas martesës.
- PËRZIHEM** I vetv. U përzie moti u prish koha. U përzien retë po prishet koha, pritet kohë e keqe. Përzihet si bolla me ngjalën shih te BOLL/Ë,~A. Mos u përziej me krundet, se do të të hanë pulat! (Po të përzihesh me krundet, të hanë pulat.) fj. u. shih te KRUNDE,~T.
- PËRRALLË** f. Përralla me mbret mospërf. shih te MBRET, ~I. U bë përrallë diçka është përsëritur shumë diçka; është folur shumë për diçka që nuk është realizuar. U bë përralla e botës dikush i doli nami i keq për diçka, mbahet nëpër gojë nga të gjithë për një punë jo të mirë. Është përrallë mizash diçka shih te MIZË,~A. Është thes përrallash (fjalësh, llafesh) dikush shih te THES,~I.
- PËRRUA** m. Lumë a përrua shih te LUM/Ë,~I. E hodhi përruan (lumin, vaun, hendekun) shih te HEDH 2. Zuri përruan (ledhin) keq. shih te ZË. Iu bë gjol e përrua shih te GJOL,~I.
- PËSHTYJ** kal. Pështyn lart dikush mbahet me të madh, e mban hundën përpjetë, është mendjemadh. Pështyu në gjellë (në çorbë) e prishi a e ngatërroi një punë me qëllim të keq. Lëpin atë që pështyn (lëpin aty ku pështyn) shih te LËPIJ. Ç'pështyn në mëngjes, e lëpin në darkë shih te LËPIJ.
- PËSHTYMË** f. Iu tha pështyma në grykë (në fyt) nuk mundi të fliste më, iu pre fjala, i mbeti fjala në grykë (nga ndonjë shqetësim a tronditje, nga ndonjë qortim i rëndë, nga të folurit e shumtë

etj.). S' mbushet pusi me pështymë (me gjilpëra) fj. u. thuhet për një punë që nuk ka mundësi të bëhet (në kuptimin Â«duhen mjetet e nevojshme për të bërë diçka të rëndësishme, nuk thahet deti me lugëÂ»).

PI kal. Dehet pa pirë iron. shih te DEHEM. I ka pirë djersën dikujt e ka munduar shumë, ka përvetësuar mundin e punën e tij. E piu (e thithi, e përpiu, e rrufti) dheu dikë shih te DHE, ~U. I piu (i thithi) gjakun dikujt

PIEDESTAL m. Ngre (vë) në pedestal dikë libr. i bëj nderime të mëdha dikujt duke e vlerësuar shumë në sy të të tjerëve; e ngre lart. E rrëzuan (e zbritën) nga piedestali dikë libr. ia hoqën nderimet dikujt, ia ulën vlerësimin e lartë që kishte deri atëherë.

PIKA-PIKA ndajf.

Pika-pika (pikë-pikë) bëhet lumi (zgavrohet guri) fj. u. duke punuar me ngulm e vazhdimisht nga një çikë mund të bëhen punë të mëdha e të rëndësishme; gurë, gurë bëhet kalaja.

PIKË f. Pikë për pikë në përputhje të plotë me diçka, ashtu siç është, pa hequr e pa shtuar gjë, një për një; fjalë për fjalë; hollësisht. Pikë së pari... në radhë të parë..., së pari... Pikë së dyti... në radhë të dytë, së dyti... Pika e parë raki shumë e fortë dhe e mirë që del e para nga kazani, ballë kazani. Pikë e dobët e dikujt shih te DOBËT (i, e). Është pikë e dobët shih te DOBËT (i, e). Pikë e gjak shumë shtrenjtë, me çmim shumë të lartë. Pikë llaf! mos fol më!, mjaft fole!, lëri llafet! Pikë e valë shumë i dëshpëruar, pikë e vrer. Pikë e vdekur gjendje amullie, pa rrugëdalje e pa zhvillim të mëtejshëm. Pikë e vrer (helm e pikë) shumë i dëshpëruar. Pikë e zezë! shih te ZI (i), ZEZË (e). Hoqi pikën e zezë shih te ZI (i), ZEZË (e). Në ditë të pikës në një gjendje jashtëzakonisht të vështirë, në pikë të hallit, në ditë shumë të keqe. Në pikë të fundit shih te FUNDIT (i, e). Më ra pika u preka a u pikëllova shumë (kur pashë a

dëgjova diçka të papritur). I ra pikës tha a bëri pikërisht atë që duhej, qëlloi në shenjë, i ra në të. I humbi pikët para dikujt shih te HUMB. I vë pikë diçkaje libr. i jap fund diçkaje një herë e mirë, e mbyll përfundimisht. U bënë pikë e pesë shih te PESË. Ishte në pikë (në ditë) të hallit shih te HALL, ~I. Është njeri me pikë e ka një njollë, është njeri me damkë, nuk e ka biografinë të pastër. Është pikë në vetull është shumë i mirë a shumë e mirë, është më i miri a më e mira ndër të gjithë. Janë në thikë e në pikë shih te THIK/Ë, ~A. E kam pikë (peng, plagë) në zemër diçka shih te ZEM/ËR, ~RA. E la (e lëshoi) pikë gjallë shih te GJALLË. Ra pikë gjallë shih te GJALLË. Mbeti si pika në pus (pus pa degë) shih te LIS, ~I. Erdhi pikë më pikë erdhi me vrap të madh, erdhi në pikë të vrapit. S'i mbeti pikë gjaku (gjak) në fytyrë shih te GJAK, ~U I. Mbytet në një pikë (lugë, gotë, filxhan, gisht) ujë mospërf. shih tek UJ/Ë, ~I. Një pikë ujë në det (në oqean) shih tek UJ/Ë, ~I. Vë pikat mbi i e sqaroj deri në fund një çështje, përcaktoj mirë e me hollësi çdo gjë; zgjidh përfundimisht diçka të mbetur pezull a që nuk ishte e qartë sa duhej. Deri në pikën e fundit të gjakut shih te FUNDIT (i, e). Ngjajnë (janë) si dy pika uji shih tek UJ/Ë, ~I. Pika (circa) shpon gurin fj. u. duke punuar e duke u përpjekur pandërprerë mund të kapërcehen vështirësi të mëdha e të bëhen punë të rëndësishme. Okën pije, pikën mos e derdh fj. u. shih tek OK/Ë, ~A. Pika (sëmundja) e diellit mjek. sëmundje e shkaktuar nga goditja prej rrezeve të diellit, e cila shfaqet me dhembje koke, marrje mendsh, të vjella, frymëmarrje të vështirë etj. Pika e hapjes usht. qendër ku mbahen armët e pajisjet e tjera të një reparti ushtarak. Pika (gjendja) kritike e lëndës fiz. shih te KRITIK, ~E 3. Pikë lëndore (materiale) mek. shih te LËNDOR, ~E. Pikë parapritëse usht. shih te PARAPRITËS, ~E. Pikë e vdekur fiz.

PIKËL f. Çikël e pikël shih te ÇIK/ËL, ~LA.

Gorrica pikla fjalë të kota, gjepura, pallavra, dokrra.

PIKË-PIKË ndajf.

Pikë-pikë (pika-pika) bëhet lumi (zgavrohet guri) fj. u. shih te PIKA-PIKA.

PIKËPYETJE f. E vë në pikëpyetje diçka (i vë një pikëpyetje diçkaje a dikujt) e bëj të pasigurt zgjidhjen e diçkaje, e vë në dyshim; e quaj të dyshimtë dikë a diçka.

PIKOJ kal. I pikon zemra vrer ka një vuarjtje të madhe; brehet nga dëshpërimi, nga zemërimi etj. I pikoi (i piku) në zemër për dikë a për diçka shih te ZEM/ËR,~RA. I pikon syri gjak shih te SY,~RI. I pikon gjak shpata shih te SHPAT/Ë,~A. Më pikon (më kullon, më rrjedh) zemra gjak shih te ZEMË/R,~RA. Në mos rrjedhtë, pikon sido që të jetë del një përfitim, sado i vogël. Ku ka rrjedhur, do të pikojë shih te RRJEDH. I zoti e di ku i pikon çatia (shtëpia) fj. u. shih te ZOTI (i).

PIKUR mb. I pikur (i pikuar) nga qielli shih te QIELL,~I.

PILAF m. Pas pilafit pasi ka marrë fund një punë; me shumë vonesë, pas së vjelash, kur s'ka më nevojë për të. Pilaf me gozhdë shih te GOZHD/Ë,~A. Nuk më ftohet pilafi (byreku) thjeshtligj. nuk bëhem merak fare për diçka, nuk më bëhet vonë. E gjeti lugën në pilaf keq. shih te LUG/Ë,~A. Nuk mban më ujë pilafi (orizi, kosi, vera) shih tek UJ/Ë,~I. I mbeti luga në pilaf iron. shih te LUG/Ë,~A. Hyn (futet) si luga në pilaf keq., shih te LUG/Ë,~A.

PILË I f. I ka punët pilë dikush nuk ka asgjë të sigurt, e ka gjendjen të paqëndrueshme.

PINGËL f. krahin. I veshur pingël i veshur me rroba të reja.

PIP m. Me veshët pip që dëgjon mirë; që dëgjon me vëmendje të madhe, që të mos i shpëtojë asnjë. I kanë pipat bashkë janë të lidhur ngushtë njëri me tjetrin, kanë plane të përbashkëta (zakonisht jo me ngjyrim miratues). Mbeti pip (teneqe,

dërrasë, kripë) shih te MBES 4. I përpjekin pipat bashkë merren vesh mirë njëri me tjetrin, i rregullojnë punët së bashku (zakonisht jo me ngjyrim miratues).

PIPER m. U bë piper (spec) shih te SPEC~I.

PIPËZ f. I çartën (i prishën) pipëzat i prishën lidhjet e marrëdhëniet e mira që kishin njëri me tjetrin, nuk i kanë më punët mirë ndërmjet tyre, u zunë. I bëri veshët pipëz (bigë, curr, çift, gërshërë, katër) dëgjoi me vëmendje të madhe, u përpoq të mos i shpëtonte asgjë pa dëgjuar. I kanë pipëzat bashkë shih I kanë pipat bashkë te PIP,~I. I ka veshët pipëz dëgjon shumë mirë. I ngre (i mban) veshët pipëz përgjon me vëmendje të madhe, nuk lë gjë t'i shpëtojë pa e dëgjuar. S'u puqen pipëzat shih te PUQEM.

PIQEM I vetv Piqet (digjet) në prush për dikë shih te PRUSH,~I. Nuk piqet buka me shkarpa fj. u. shih te SHKARP/Ë,~A. Sheh rrushi rrushin (fiku fikun) e piqet fj. u. shih te RRUSH,~I. Edhe mishi të piqet, edhe helli të mos digjet fj. u. shih te MISH,~I.

PIQEM II vetv. bised. Më piqet gjaku me dikë shih te GJAK,~U I. U pjek ylli shih tek YLL,~I.

PIR m. krahin. E ka për piri dikush e ka zakon. I shkon për piri dikujt e ka në gjak, kështu vepron gjithnjë e kështu i pëlqen, nuk mund të sillet a të veprojë ndryshe.

PIRG m. E la pirg e vrau, e la thes në tokë.

PIRUN m. Ia di lugët e pirunët dikujt shih te LUG/Ë,~A. Luga mbush barkun, piruni than gurmazin fj. u. shih te LUG/Ë,~A.

PISË f. Ashër e pisë (i zi) shih tek ASH/ËR,~RA I.

PISK m. Për një pisk për pak, për një qime.

PISK ndajf. Pisk e lakuriq i zhveshur fare. Janë parë me hënë pisk shih te HËN/Ë,~A.

PISHË f. Ia bëri pishë dikujt ia kaloi nga zotësia, u tregua më i zoti (zakonisht kur

- dikush bën një punë a zgjidh një detyrë të vështirë, të cilën nuk e ka kryer dot një tjetër).
- PJACË** f. vjet. I ra pjaca mospërf. i ra vlera, s'e kërkon më njeri a s'pyet më njeri për të. S'del në pjacë shak. nuk duket më, rri brenda.
- PJATË** f. E ka në pjatë e ka të sigurt. Lule pjate bot. shih te LUL/E,~JA.
- PJEK** I kal. Djeg e pjek dikush shih te DJEG. Ma poqi buzën më mundoi shumë, ma solli në majë të hundës, ma plasi buzën. Ta pjek byrekun ta bën gropën, të vret, të zhduk. Ta pjek peshkun në buzë shih te BUZ/Ë, ~A. Mos pjektë dy bukë në një hi! mallk. shih te BUK/Ë, ~A.
- PJEK** II kal. bised. Piqe (një herë) këtu! ma jep dorën ta shtrëngo! (i thuhet dikujt që s'e kemi parë ose kur duam ta lavdërojmë për një veprim të guximshëm). I pjekim hutat shih te HUT/Ë,~A II.
- PJEKUR** mb. Hallvë e pjekur shih te HALLV/Ë,~A.
- PJEKURI** f. Pjekuri teknike spec. gjendja më e mirë e bimës a e një pjese të saj për t'u përdorur si lëndë e parë në industri.
- PJELL** kal. dhe jokal. Më polli (më ndezi) belaja (groshi) me dikë ndesh në vështirësi të paparashikuara në marrëdhëniet me dikë, ndodhem ngushtë, më ndez me të. Më polli djalli (dreqi) më dolën telashe e vështirësi të paparashikuara, më dolën ngatërresa të mëdha; më gjeti belaja, më ndezi. I pjell edhe kau (mushka) dikujt shih te KA,~U. I pjell edhe këndesi (kokoshi) dikujt shih te KËNDES,~I. I pjell (edhe) viçi atij shih te VIÇ,~I.
- PJEPËR** m. bot. Pjepër i egër bot. bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell pothuaj të shtrirë në tokë, pa lastarë dhe me gjethe të trasha vezake.
- PJERDH** jokal. S'ka pjerdhur në ujë dikush thjeshtligj., përçm. nuk ka parë rrezik me sy, nuk ka rënë ndonjëherë ngushtë.
- PJERGULL** f. Si pjergulla në fik të bardhë me gjithë të mirat; e mirë në mes të mirash. I ka rënë pjergulla në fik i shkon çdo gjë mbarë, i ka ardhur e mira te dera.
- PJESË** f. Bëj pjesë jam anëtar a pjesëtar i diçkaje; me foljen në vetën III është pjesë përbërëse a njësi e diçkaje. E luan pjesën dikush mospërf. shih te LUAJ. Marr pjesë diku hyj diku, bashkohem me të tjerë në një punë a veprimtari. Më ra në pjesë diçka më erdhi një e keqe pa e pritur, më ra një fatkeqësi. Pjesa e luanit libr. iron. shih te LUAN,~I. Sa për pjesën time... nga ana ime, për sa më takon mua... Pjesët e fjalisë gjuh. gjymtyrët e fjalisë. Pjesët e ligjëratës gjuh. klasat kryesore, në të cilat ndahen fjalët e një gjuhe, sipas kuptimit të përgjithshëm leksikor, veçorive morfologjike e fjalëformuese dhe funksioneve sintaksore (p.sh. emri, mbiemri, përemri, folja, ndajfolja, parafjala etj.).
- PLAÇ** pasth. thjeshtligj. Nuk i tha një herë goja plaç! shih te GOJ/Ë,~A.
- PLAÇKË** f. Një gjel plaçka shih te GJEL,~I. Plaçkë tregu keq. diçka që sipas disave mund të shitet e të blihet në çdo kohë, mund të kalojë nga një dorë tek tjetra pa pyetur të zotin. Me plaçkë e me laçkë me të gjitha ç'ka, me çdo gjë, me tesha e me kotesha.
- PLAF** m. E kishte plafin të madh dikush iron. kishte shumë miq, kishte rreth të gjerë që e ndihmonin dhe e mbronin kur bënte gabime a të këqija. E mbuloi me plaf diçka e fshehu nga të tjerët diçka të keqe; e kaloi pa e parë të tjerët. Rri (punon) si nën plaf rri i fshehur, punon në mënyrë të fshehtë, nën rrogos. Shtriji (zgjati) këmbët sa ke plafin (jorganin, shtratin) fj. u. shih te JORGAN,~I.
- PLAGË** f. Iu bë zemra (shpirti) plagë (copë) shih te COPË, ~A. E kam zemrën plagë kam pësuar një tronditje të thellë shpirtërore nga diçka që më bën të vuaj, jam shumë i brengosur e i pikëlluar. E kam plagë (pikë, peng) në zemër diçka shih te

- PLAK** m. Pleqtë e jetës (plakat e jetës) shih te JET/Ë,~A. Plak i mykës (plak në mykë) shih te MYK/Ë,~A. I shkoi (i vajti) për plak dikujt i shkoi për t'i kërkuar një mendim të pjekur që të zgjidhë mirë e drejt një çështje. Ka plak (zot) ahuri shih tek AHUR,~I. Djemtë (fëmijët) hanë kumbulla (thana), pleqve u mpihen dhëmbët iron. shih te MPIHEM. Plaku i Vitit të Ri qenie përralore, që përfytyrohet si një plak me mjekër të bardhë, i cili u sjell fëmijëve dhurata natën e Vitit të Ri; ai që luan rolin e kësaj qenieje me rastin e festës së Vitit të Ri.
- PLAKË** f. Plakat e jetës (pleqtë e jetës) shih te JET/Ë,~A. Si plaka në mes dy bukësh në gjendje tepër të vështirë, në një gjendje të tillë që s'di nga t'ia mbajë, shumë ngushtë. Bar plakash bot. lulevjeshtë.
- PLAN** I m. Kam në plan mendoj, kam parashikuar. Kam vënë në plan kam ndërmend, mendoj, synoj. I vë në plan libr. i quaj njësoj, i barazoj dy a më shumë njëri, sende etj.
- PLAS** jokal. Më plasi buza u sfilta, u lodha shumë, u mundova shumë; më erdhi në majë të hundës. I plasi në duar (në dorë) diçka shih te DOR/Ë,~A. Plasi dreqi mbaruan më së fundi pengesat, ngatërresat e të këqijat. I plasi në kokë dikujt
- PLASË** f. Është bërë për në plasë të derës është dobësuar shumë nga shëndeti, është tretur fare, është bërë kockë e lëkurë.
- PLASJE** f. Ç'i këllet plasjen (flamën)! shih te KËLLAS. Më vinte plasja më vinte shumë inat, më vinte të pëlças. Bar plasjeje bot. shih te BAR,~I I.
- PLASTIK** mb. Vetia plastike e trurit psikol. Aftësia që ka truri i njeriut të ruajë përshtypjet a gjurmët e veprimit të ngacmuesve të jashtëm.
- PLASUR** mb. Me buzë (me zemër) të plasur shumë i dëshpëruar, i pikëlluar. Është pushkë e plasur (dyfek i plasur)
- PLEH** m. E bëri pleh dikë a diçka e rrahu fort, e dërrmoi; e nxiu duke e rrahur. Flori në pleh (në baltë) shih te FLORI,~RI. Dalin (mbijnë, rriten, shtohen) si kërpudha plehu (si kërpudhat pas shiut) mospërf. shih te KËRPUDH/Ë,~A 1. E hodhi në koshin (në shportën) e plehrave shih te KOSH,~I. E ka zemrën pleh është shumë i dëshpëruar e i vrarë. Është bërë për ta hedhur në pleh nuk vlen më fare. Kapardisej (krekosej) si gjeli (si këndesi, si kaposhi) majë plehut shih te GJEL,~I. Lë dhomën me pleh e fshin oborrin lë një punë kryesore, që duhet bërë më parë dhe bën një tjetër që është më pak e nevojshme. Kush shkon pas brumbullit, te plehu do ta shpjerë fj. u. shih te BRUMBULL,~I.
- PLEP** m. Shkoi (vajti) plep shkoi mirë, vajti shtruar (biseda, muhabeti). Është gjethe plepi shih te GJETH/E,~JA. U bë gjethe plepi shih te GJETH/E,~JA. Dridhej si gjethe plepi (lofate) shih te GJETH/E,~JA. Luan si gjetheja e plepit shih te GJETH/E,~JA. Duhan plepi bot. shih te DUHAN,~I 1. Lule plepi bot. shih te LUL/E,~JA.
- PLEQËRI** f. Bora e pleqërisë poet. flokët e bardha, thinjat. S'mëson kali revan në pleqëri fj. u. shih te REVAN,~I.
- PLESHT** m. Si pleshti në dhallë kuturu, pa mend në kokë, si miza në dhallë. M'u bë plesht (në vesh) m'u ngjit e më mërzi shumë, m'u bë ferrë. I hynë pleshtat (në trup) filloi të shqetësohej e të hante merak, i hynë mizat. Na martë pleshtat (pleshtat e tartabiqet, të këqijat)! thjeshtligj. mospërf. shih te MARR. E shtiu te pleshtat dikë e vuri në një gjendje të vështirë, i nxori telashe. Thes me pleshta shih te THES,~I. Zinte (shtypte) pleshta s'bënte asgjë; merrej me punë të kota, vriste miza. E ka gjumin si të pleshtit ka gjumë shumë të lehtë, ndien menjëherë. E bën pleshtin (mizën) buall (ka) e zmadhon shumë diçka, e fryn tej mase. S'del dhjamë nga pleshti fj. u. përçm. shih te DHJAM/Ë,~I. Ia

- futi (ia shtiu) pleshtat në vesh dikujt e ngacmoi për diçka, e bëri që të shqetësohej, i shtiu mizat. S'futen pleshtat në thes (s'mblidhen pleshtat në grusht) fj. u. është punë që s'bëhet, është e pamundur të bëhet diçka. Kërkon pleshta në kashtë kërkon diçka që nuk gjendet, kërkon gjilpërën në kashtë; rreh ujë në havan. Mbath pleshtat me potkonj përpiqet të bëjë diçka të pamundur e s'bën asgjë, bën një vrimë në ujë. Nxjerr dhjamë nga pleshti shih te **DHJAM/Ë,~I**.
- PLËNDËS** m. Si plëndës i palarë mospërf. shih te **PALARË** (i,e). Punë plëndës lloj qepjeje pala-pala. Ka ngrënë plëndës pule shaka. shih te **PUL/Ë, ~A**. E ka vënë plëndësin në kokë (e ka varur plëndësin në qafë) s'ka më turp për asgjë, është faqenxirë, i ka plasur cipa.
- PLËNG** II m. bised. Më mbeti plëng kam shumë mall e merak për dikë.
- PLIS** I m. Si breshka nëpër plisa shih te **BRESHK/Ë,~A**. Nuk rri iriqi në plis fj. u. njeriu dëshiron të jetë gjithnjë i lirë, nuk i pëlqen zogut kafazi. Nuk zihet (nuk mbulohet) dielli me plisa fj. u. shih te **DIELL,~I**.
- PLOGËT** mb. Gaz i plogët kim. shih te **GAZ,~I 1**.
- PLOR** m. Plori e shelqërori bujqësia e blegto-ria. I ngeci plori në rrënjë nuk ia arriti qëllimit, i ngeci sharra në gozhdë.
- PLOT** ndajf. Me barkun plot i ngrënë, i ngopur. Rrafsh e plot shih te **RRAFSH**. Me zemrën plot me gëzim e me kënaqësi. Flas (them, kërkoj) me plot gojën (plot gojën) shih te **GOJ/Ë,~A**. E ka kokën plot
- PLOTË** mb. Si bletë e plotë me shumicë e me të mira, si bleta. Me zemër të plotë me kënaqësi, me gjithë zemër. Në kuptimin e plotë të fjalës shih te **FJAL/Ë,~A**. I jap fuqi të plotë drejt. e bëj të plotfuqishëm. E kryer e plotë gjuh. shih te **KRYER,~A** (e).
- PLOTËSI** f. libr. Me plotësi zërash njëzëri, në mënyrë të njëzëshme.
- PLOTËSUES** mb. Kënd plotësues gjeom. këndi që së bashku me një tjetër bën një kënd të drejtë.
- PLUHUR** m. E bëri hi (hi e pluhur, shkrumb e hi) diçka shih te **HI,~RI**. U bë pluhur u shkatërrua ekonomikisht, u dogj e u shkatërrua krejt, u bë hi. E hodhi (e rrëzoi) në pluhur dikë a diçka e dërrmoi, e shkatërroi fare; e flaku tutje, e braktisi. E ka zënë pluhuri diçka është har-ruar fare, nuk është kujtuar njeri për të, ka një kohë të gjatë që nuk përdoret. U bë baltë e pluhur dikush u përul para dikujt, u nënshtua, u bë urë e vig. I hodhi pluhur (hi) syve dikujt shih te **HI,~RI**. Nuk i hedh pluhur faqes nuk e bëj veten me turp, nuk turpërohem. Humbi si pluhuri në erë humbi pa lënë gjurmë, humbi pa nam e nishan; shkoi kot. Nuk mban pluhur në vesh preket shumë shpejt; nuk duron fyerje. Nuk mban pluhur mbi vete nuk lejon ta njollosin a ta turpërojnë; nuk duron fyerje. Ngre (çon) pluhur në ilaç dikush merret me një punë të kotë, i futet një pune që s'bëhet. I ngrihet (i çohet) pluhuri (nga) prapa dikujt për të flasin kudo që të vejë (zakonisht kur flasin edhe mirë edhe keq). Mos ngri (mos ço) pluhur! mos fol, mos bëj zhurmë (për një çështje). Shkëmbu- hiçin me pluhur s'fitoi asgjë.
- PLUMB** m. Plumb për plumb një për një; dhëmb për dhëmb (me armikun). Barrë plumbi
- PLUMBÇ** m. E ka syrin plumbç (plumb) shih te **PLUMB,~I**.
- PLLAKË** f. Si pllakë (si gur) varri shih te **VARR,~I**. E ktheu (e ndërroi) pllakën (fletën) keq.
- PLLOÇË** f. krahin. Mbeti plloçë diçka mbeti e palëvizshme, mbeti në vend. Ia bëri tur- injtë plloçë thjeshtligj. e rrahu shumë, ia përshehi hundët. I vuri plloçën (rrasën) diçkaje e mbylli, e quajti të përfunduar

- diçka, nuk e zuri më në gojë, e mbuloi, i vuri kapak.
- PO** I lidh. Po deshe të lutem, në mundsh.
- PO** II pj. E po... përdoret kur duam të kundërshtojmë lehtë e me kujdes, kur duam të përmbyllim një mendim, kur duam të arsyetojmë për diçka ose kur pajtohemi më në fund me diçka. Po e po... (po se po...; po që po...) përdoret kur folësi dëshiron të miratojë a të vërtetojë diçka me forcë.
- POÇ** m. Është si miu në poç (në hauz) shih te HAUZ, ~I. Ra si miu në poç ra në grackë, nuk ka më shpëtim ra si miu në çark. S'ia pret poçi (mendja, fiqiri) edhe poh. shih te PRES I 24. Është poç nga koka (nga mendja) e ka kokën bosh, s'ia pret. Vërtitet rreth poçit sillet gjithnjë rreth një çështjeje pa e zgjidhur atë, nuk del aty ku duhet.
- POÇE** f. E di luga se ç'ka poçja (vegshi, vorba) fj. u. shih te LUG/Ë, ~A.
- POGAÇE** f. Do bukë mbi pogaçe kërkon tepër, do thelë mbi bisht; do diçka që s'bëhet a që s'i takon, kërkon qiçra në hell.
- POGANIK** m. etnogr. Nuk ia kam ngrënë poganikun dikujt nuk e di kur ka lindur, nuk e di sa i madh është; nuk e njoh mirë. Nuk ia ka thyer (nuk ia ka lëshuar) poganikun diçkaje shih te THYEJ.
- POL** I m. Pol gjeografik gjeogr. vendi ku bashkohen meridianët. Pol magnetik pikë afër Polit të Veriut ose të Jugut, drejt së cilës kthehet gjilpëra e busullës.
- POLEM** m. bised. Alemi e polemi shih tek ALEM, ~I.
- POLITIK** mb. Ekonomia politike shih tek EKONOMI, ~A 4.
- PONICË** f. krahin. Ka shkuar (ka vajtur) të bëjë ponica mospërf. ka vdekur, ka shkuar të bëjë vegsha.
- PORDHË** f. Pesë pordhë, dhjetë grosh thjeshtligj. shumë shtrenjtë. Sillet si pordha nëpër brekë thjeshtligj. sillet vërdallë kot, pa bërë asnjë punë. Ia bëri mendjen pordhë dikujt thjeshtligj. e turbulloi, e hutoi fare, ia mori mendjen. E harroi pordha vërën thjeshtligj. i ka ulur veshët, s'mbahet më me të parën, sepse ka ndërruar gjendja.
- POROTË** f. vjet. E bëri porotë e bëri me turp para të tjerëve, e turpëroi, ia mori fytyrën.
- PORSE** lidh. Jo vetëm që... porse përdoret si lidhëz bashkërenditëse e shkallëzimit për të lidhur fjali ose gjymtyrë fjalish, me kuptimin «jo vetëm që... por edhe».
- PORTË** f. Portë më portë në çdo shtëpi; shtëpi më shtëpi, derë më derë. I hapi (i çeli) portën (derën, dyert) shih te HAP. Shikon portën (derën) shih te SHIKOJ. Është portë pazari shih te PAZAR, ~I. E nxori në portë të pazarit dikë shih te PAZAR, ~I. Politikë e portave (e dyerve) te hapura shih te POLITIK/Ë, ~A 1. Shpërtheu një portë (një derë) të hapur shih te HAPUR (i,e). Troket në portë (në derë) të hapur shih te HAPUR (i,e). Troket në portën (në derën) e shurdhit shih te SHURDH, ~I. Porta e Lartë hist. sulltani dhe qeveria si autoriteti më i lartë e përfaqësues i Perandorisë Osmane.
- PORTRET** m. Portret i gjallë shih te GJALLË (i,e) 7.
- POSI** Posi jo përdoret kur folësi dëshiron të miratojë me forcë atë çka është thënë a për të cilën është pyetur ose kur do të theksojë vërtetësinë e diçkaje që dikush e vë në dyshim.
- POSTAT** m. Mos e hap postatin! shih te HAP.
- POSTË** I f. Iu qep (iu ngjit, iu bë) si pullë poste dikujt shih te PULL/Ë, ~A.
- POSTIQE** f. Ia bëri lëkurën postiqe
- POSHTË** Poshtë e lart (lart e poshtë) gjithandej, poshtë e përpjetë; tutje-tëhu. Poshtë e përpjetë gjithandej; tutje-tëhu. Poshtë e më poshtë keq e më keq. Bën (shkon, merr) poshtë merr tatëpjetën,

- bie. E çoi poshtë dikë a diçka e çoi në një gjendje të keqe, e katandisi keq. Ka rënë poshtë dikush a diçka a) nuk vlen më si më parë, ka shkuar tatëpjetë, është bërë më keq a më i keq;
- POTKUA** m. I la potkonjtë përçm. vdiq, mbaroi. Ia mbathi potkonjtë dikujt mospërf. i tregoi vendin, ia tregoi qejfin. Të ter potkonjtë shih tek TER. I ranë potkonjtë kalit
- POTURE** vet. sh. S'di si lidhen poturet mospërf. shih te LIDHEM.
- PRAG** m. E kapërceu pragun dikush a diçka shih te KAPËRCEJ. Puthe pragun (po dole që këtej)! shih te PUTH. Është (ka ardhur, e kam) në prag të derës (në derë, te dera, prapa derës) shih te DER/Ë,~A. I bie pragut të dëgjojë dera nuk e thotë drejtpërdrejt atë që kërkohet, i drejtohet dikujt tjetër që ta kuptojë vetë ai që duhet, flet tërthorazi, i bie dritares të dëgjojë dera. I la një qime ujku te pragu (te dera) dikujt shih tek UJK,~U I.
- PRANVERË** f. Me një lule (me një dalëndyshe) s'vjen pranvera (behari) fj. u. shih te LUL/E~JA. Lule pranvere bot. agulçe.
- PRAPA** Prapa gardhit shih te GARDH~I. Prapa (pas) perdes libr. shih te PERD/E,~JA. Bëri prapa u pendua për diçka, u tërhoq, pranoi gabimin; ndryshoi qëndrimin e tij të mëparshëm. I bie prapa (pas) dikujt a diçkaje shih te PAS. S'kthehet prapa dikush është i vendosur në rrugën e tij. E mori prapa dikë e ndoqi në një punë a në një veprimtari, i shkoi pas. E mori prapa diçka e tërhoqi (një fjalë, një mendim etj.).
- PRAPË** mb. E ka këmbën të prapë sjell fatkeqësi (sipas besëtytnive).
- PRAPË** I ndajf. Bën prapë bën prapësira, bën gjëra që s'lejohen (zakonisht për një fëmijë). E bëri prapë dikë ia ktheu mendjen për diçka, e bëri që ta lërë një punë, e prapësoi. I ra vendit mbarë e prapë (mbrapsht) shih te MBARË. Folën mbart e prapë (mbrapsht) shih te MBARË. E pa mbarë e prapë shih te MBARË. E pyeti mbarë e prapë shih te MBARË. E rrahën (e shoshitën, e gjykuan) mbarë e prapë (mbrapsht) një çështje shih te MBARË.
- PRAPMË** mb. Në çastin e prapmë (e fundit) para se të vdiste, në kohën e vdekjes. Zanore e prapme gjuh. zanore që përftohet në pjesën e pasme të zgavrës së gojës.
- PRAPTHI** ndajf. I ka hipur kalit së prapthi (mbrapsht) shih te MBRAPSHT.
- PRASK** m. krahin. Kali nuk ka prask kali i sheh dhe i kupton orët a zanat (sipas besimeve të kota).
- PRASHIT** kal. Prashit në të thatë shih te THATË,~T (të). Prashit (mih, lëron) në ujë shih tek UJ/Ë,~I. Prashit (mih) para vetes shih te VET/E,~JA.
- PRE** f. E bënë pre (armikun) e shkatërruan krejt, e asgjësuan. Bëri prenë bëri gjëmë të madhe (zakonisht për një vdekje).
- PREHEM** vetv. Prehet (fle, e ka zënë gjumi) mbi dafina shih te DAFIN/Ë,~A.
- PREHËR** m. Ia thau prehrin shih te THAJ. Ia la kopilin (doçin, dobiçin) në prehër (në derë) thjeshtligj. shih te DERË, ~A. Ta vë (ta hedh) kopilin (dobiçin) në prehër thjeshtligj. është i tillë që fajin e vet ia hedh tjetrit. Është rritur në prehër të nënës edhe mospërf. është rritur me shumë kujdes e përkëdheli; është rritur me vezë në tigan.
- PREK** kal. E preku (e shkeli) në kallo (në lyth) dikë shih te KALLO,~JA. E preku në plagë dikë i përmendi diçka të hidhur a diçka që i shkakton dhembje shpirtërore, i ngacmoi plagën. Ia preku (ia gjeti) telat dikujt shih tek TEL,~I. E preku në tela dikë shih tek TEL,~I. S'e prek tokën dikush
- PREKEM** vetv. Nuk preket (as) me krënde shih te KRËND,~I. Nuk preket (as) me pupël (as me pendë) dikush shih te PUP/ËL,~LA.

- PREMTE** f. E premtja e zezë (e madhe) fet. dita kur është varrosur Krishti (sipas legjendës fetare të krishterë).
- PRERË** mb. I ka duart të prera (krahët të prerë) dikush nuk ka fuqi të veprojë, ia kanë ndrydhur a ia kanë pakësuar shumë forcat e mundësitë. I ka thonjtë të prerë dikush shih te THUA, THOI. Është e prerë me thikë diçka është e vendosur njëherë e mirë, s'mund ta ndryshojë askush. Erdhi (shkoi, rri) me kokë të prerë dikush erdhi (shkoi, rri) si i vrarë, shumë i dëshpëruar (nga një e keqe që e ka gjetur a nga një goditje e rëndë që i është dhënë).
- PRERJE** f. Prerja e artë mat., art. shih tek ARTË (i,e).
- PRES** I kal. I preu bishtin dikujt ia hoqi gjërat e tepërta që ka e nuk i meriton. Ia preu me brisk shih te BRIS/K, ~KU. Ia preu me cakorre dikujt shih te CAKORR/E, ~JA.
- PRES** II kal. I pret ditën dikujt e ruan ta zërë ngushtë, i ruan rastin që ta ketë në dorë.
- PRESË** I f. Është (qëndron) në presë (në teh) të briskut (të thikës, të shpatës) shih te TEH,~U. Është thikë (presë) me dy presa shih te THIKË,~A.
- PRESJE** II f. gjuh. Nuk luaj (nuk ndryshoj) asnjë presje nuk bëj asnjë ndryshim në atë që kam shkruar; nuk e ndryshoj fare qëndrimin tim. Nuk ndryshon në asnjë presje nuk ndryshon aspak, është njësoj me dikë a me diçka tjetër.
- PRESH** m. bot. U bë presh u fishk, u tha (një bimë). E ha preshin nga bishti shih te BISHT,~I. E kam presh (lakra) në kopsht dikë shih te LAK/ËR,~RA. E kapën (e zunë, e gjetën) me presh në dorë (me duar në presh) e kapën dikë në çastin kur po vidhte ose po bënte një punë të keqe. Është rritur me bishtra preshi shih te BISHT,~I. Humbi në vaj e fitoi në presh fj. u. shih te VAJ,~I I. Mish me presh e presh me mish mospërf. shih te MISH,~I. Lule preshi bot. shpatëz II 2. Presh i egër (presh gjarpri) bot. bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të shkurtër e me gjethe si të preshit, që rritet zakonisht nëpër lëndina fushore.
- PRESHTË** mb. Kalë të preshtë nuk ka fj. u. një gjë e tillë as që mund të jetë, është diçka e pamundur.
- PRIFT** I m. I foltë prifti (hoxha)! mallk., vjet. shih te HOXH/Ë, ~A. E këndoftë prifti (hoxha)! mallk. shih te HOXH/Ë,~A. Ia thëntë prifti (hoxha) në vesh! mallk. shih te THEM.
- PRILL** m. E shkund manin në prill (arrën në korrik) shih te SHKUND.
- PRISH** kal. I prishi curlet me dikë i prishi marrëdhëniet e mira që kishte pasur me dikë; u zu, u prish me dikë. I prishën (i thyen) fjalët shih te THYEJ. E prishi (e rëndoi, e ndyu, e fëlliqi, e qelbi) gojën shih te GOJ/Ë,~A. Më prishi gjakun dikush më trembi shumë, më frikësoi duke më thënë diçka të keqe, më tronditi shumë; më shqetësoi shumë. Nuk e prish gjakun (terezinë) i merr punët shtruar, nuk shqetësohet, nuk trazohet fare; nuk pyet për të tjerët; nuk trembet, nuk frikësohet. E prishi hajatin me dikë shih te HAJAT,~I. Ia prishi mendjen (fiqirin)
- PRISHEM** vetv. Nuk u prish bota (dynjaja)! mospërf. s'ka ndodhur ndonjë e keqe e madhe!, nuk u bë kiameti! Iu prish çarku shih te ÇARK,~U. Iu prish (iu turbullua) gjaku u tremb, u frikësua shumë; u trondit shumë, u shqetësua shumë. M'u prish gjiza! thjeshtligj., iron. shih te GJIZ/Ë,~A. M'u prish mendja fillova të mendoj ndryshe, m'u kthye mendja; u hutova. U prish (u çart) nga mendtë (nga mendja, mendsh, nga fiqiri) u çmend; u marros. M'u prish puna! mospërf., iron. nuk ka rëndësi për mua!, s'bëhem merak!, s'më bëhet vonë!, aq më bën!, punë e madhe fort! S'priset dasma për një qepë (për një limon) fj. u. shih te DASM/Ë,~A.
- PRISHUR** mb. Gramafon i prishur përb. njeri që flet shumë dhe kot, njeri që s'pushon

- së foluri. Është shoshë e prishur mospërf. është njeri llafazan, është thes i gjerrë. Vezë e prishur njeri pa vlerë e i keq. Me zemër të prishur i zemëruar; i pikëlluar, me zemër të thyer. E ka gojën të prishur (të shthurur, të rëndë) keq. shih te SHTHURUR (i,e). E kam mendjen të prishur më është turbulluar mendja, jam i hutuar, s'e kam mendjen në vend nga një tronditje, nga shqetësimi për dikë a për diçka etj.
- PRITEM** I vetv. Është prerë për dikë a për diçka është pikërisht për atë, shkojnë mirë së bashku, është shumë i përshtatshëm për dikë a për diçka. U pre në fytyrë i ndryshoi fytyra nga një tronditje e fortë. Iu pre (iu lidh) goja (gjuha, fjala) shih te LIDHEM. U pre (i ngriu, iu tremb) gjaku shih te GJAK,~U I. S'pritet lisi (druri) me një shpatë (me një të rënë të sépatës) fj. u. shih te SÉPAT/Ë,~A.
- PROBABILITET** m. Teoria e probabilitetit mat. degë e matematikës, e cila studion ligjësitë e dukurive të rastit, duke u mbështetur në qëndrueshmërinë statistikore të dendurive të shfaqjes së këtyre dukurive, që mund të përsëriten në një numër të pakufizuar herësh.
- PROBLEM** m. U bë problem dikush krijoi shqetësime të mëdha për të tjerët me sjelljet e veprimet e tij sa duhet të merren me të; u përmend për të keq, folën keq për të.
- PROG** m. zakon. sh. I ranë progjet dikujt mospërf. nuk e ka më pushtetin e mëparshëm; nuk e ka më fuqinë e mëparshme, është dobësuar mjaft.
- PRONË** f. Plotësi i pronës gjuh. gjymtyrë e dytë e fjalisë e shprehur me një emër, që tregon pronësi a përkatësi.
- PROVË** f. Gur prove libr. parimi a kriteri themelor që shërben për të provuar qëndrimin ndaj diçkaje.
- PRUSH** m. U bë për prush (për zjarr) diçka u bë për ta djegur, nuk vlen më për asnjë punë. Prush në hi (në tokë, në dhe) fare të vegjël, të parritur e zakonisht pa përkrahje (për fëmijët). Ra në prush ra në një rrezik të madh. Saç pa prush shih te SAÇ,~I. U bë prush në fytyrë
- PSE** ndajf. edhe pse... lidh. përdoret për të lidhur fjali të varura lejore (p.sh. edhe pse e dinte, nuk e tregoi). S'ka pse shih S'ka përse te PËRSE.
- PUBLIK** mb. Shtëpi publike ndërtesë ku mbahen me qëllim shfrytëzimi gra që shesin trupin e nderin e tyre për të siguruar mjetet e jetesës (në vendet borgjeze).
- PUC** mb. I ka bërë puc dikujt e ka vënë krejtësisht nën urdhrat e veta, ia ka mbledhur keq, e ka bërë zap.
- PUÇ** II m. Janë në majë e në puç shih te MAJ/Ë,~A.
- PUÇËRR** f. Puçrra e zezë (e keqe) mjek. veter. plasja.
- PULË** f. Fle me pulat shih te FLE. Si pula pa krye (pa kokë) i shushatur, i hutuar.
- PULLË** f. Iu bë pullë (poste) iu ngjit, iu qep dhe nuk i ndahet, iu bë rrodhe. Iu qep (iu ngjit) si pullë poste dikujt e ndjek pas e nuk i ndahet; iu bë rrodhe. E nguli me pullë (fjalën) foli me vend, tha fjalë të goditura. Mbeti pa para e pa punë dikush shih te PARA,~JA.
- PUNË** f. Bën punë diçka vlen, sjell dobi. Më bëri punë të madhe (më bëri shumë punë) dikush a diçka më ndihmoi shumë, më zgjidhi një hall të madh, më dha dorë, më lehtësoi shumë. Djall (dreq) o punë! thjeshtligj. shih te DJALL,~I. E do puna është e domosdoshme, duhet. Ia do puna i duhet; është i detyruar ose ka interes të veprjë në këtë ose në atë mënyrë, s'ka si të veprjë ndryshe. Hyn në punë diçka vlen, është e dobishme. S'më hyn në punë edhe poh. shih te HYJ. Kryet e punës ai që është kryesori, ai që ka përgjegjësinë më të madhe, drejtuesi, kryetari. Të lan me punë dikush është punëtor i madh, është shumë i zoti për punë, s'e ka shokun për punë. I mbaroj punë dikujt shih te MBAROJ. S'të mbaron punë shih

te **MBAROJ**. Ndryshon puna shih te **NDRYSHOJ**. E para e punës shih te **PARA** (e). Nuk më pret puna (koha) shih te **PRES II**. M'u prish puna! mospërf., iron. shih te **PRISHEM**. S'prish punë shih te **PRISH**. Punë dreqi! shih te **DREQ**,~I. Punë e madhe! mospërf. nuk ka gjë, nuk prish punë. Punë e madhe fort! nuk e çaj kokën fare, nuk më bëhet vonë, nuk merakosem fare. Punë e verdhë shih te **VERDHË** (i,e). Flet puna vetë është e qartë, s'është e nevojshme që të jepen shpjegime a sqarime. Sa për t'u gjendur (Kola) në punë shih te **GJENDEM**. Hyri në punë (në bukë) të qeverisë u bë nëpunës shtetëror. Nuk është punë që bëhet është e pamundur, nuk bëhet. E këput (e ndan, e pret, e qëron) punën dikush i ka gjërat të qarta e të prera, po-në e ka po dhe jo-në jo, nuk i zvarrit gjërat. E ndau punën dysh shih te **DYSH**. I qan puna në dorë dikujt është tepër i ngathët e i plogët, s'është i zoti për punë. Qan puna për të zotin çdo punë kërkon njeriun e përshtatshëm (thuhet sidomos kur dikush është i paaftë e nuk e përballon dot një punë a detyrë). Sheh puna punën shih te **SHOH**.

PUNËTOR mb. Bletë punëtore

PUNOJ jokal. Punon si sahat shih te **SAHAT**,~I. Sa i punoi zëri me gjithë forcën e zërit, aq sa i hante zëri. Nuk ka punuar vera sivjet ka qenë verë me shira ose e ftohtë, nuk ka qenë verë e nxehtë si zakonisht, nuk ka shkuar mirë vera. Punon sot, ha sot shih te **SOT**.

PUPA ndajf. bised. E zuri papa diçka e mohoi, nuk e pranoi diçka. E ka bërë mendjen pupa e ka vendosur për të bërë diçka, e ka mbledhur mendjen top.

PUPË IV f. Është çuar në pupë është bërë mendjemadh, i është rritur mendja.

PUPËL f. I ranë puplat (pendët, fletët) dikujt mospërf. shih te **PEND/Ë**,~A I. Doli puplash dikush u prish nga mendtë. I dolën puplat (pendët) dikujt

PUQ kal. Puqën shpatat

PUQEM vetv. U puqen fitilat shih te **FITIL**,~I. S'u puqen pipëzat nuk merren vesh njëri me tjetrin, nuk shkojnë mirë. Nuk u është puqur lëngu me thelë shih te **LËNG**,~U.

PURTEKË f. Dridhet si purteka në ujë i ka hyrë drithma, ka shumë frikë.

PUS m. E bëri pus diçka

PUSULLË f. Pusullë (letër) bakalli keq. shih te **BAKALL**,~I. E humbi pusullën shih te **HUMB**.

PUSH m. Bar pushi bot. shih te **BAR**,~I I.

PUSHIM m. Shesh pushimi ndërt. shih te **SHESH**,~I 6.

PUSHKË f. Është bërë për pushkë dikush

PUSHOJ jokal. I pushon muhabetit dikush flet ngadalë dhe me mend, i mat fjalët kur flet a bisedon. Nisën vallet kur pushuan daullet shih te **VALL/E**,~JA.

PUTH kal. Të puth dorën! shak. është mirë me shëndet, të bën të fala (kur dikush pyet dikë për një tjetër). I puth (i lëpin) këmbët (çizmet) dikujt keq. shih te **LËPIJ**. Puthi kryqin iron. vdiq. I puthi kryqin dikujt iron. vdiq para një tjetri, shkoi para tij. Puthi pushkën u betua të luftojë deri në fund e të vdesë me armë në dorë. Puth truallin dikush është kërrusur shumë, i ka dalë kurrizi dhe koka i varet deri poshtë në tokë (nga pleqëria etj.). Të puthsha grykën e pushkës! ur. të lumtë! I puth këmbë e dorë (këmbët, pëqirin, dorën, gjunjët) dikujt keq. i përulet shumë dikujt, i shkon pas qejfit a pas avazit, i kreh bishtin, i bën lajka, i bie në këmbë a në gjunjë; i lutet shumë. E puth dhe e vë në ballë diçka e pranoj me gjithë qejf edhe atë, ku ta gjej a ku ta kem edhe atë, jam shumë i kënaqur edhe me atë (kur për disa arsye nuk kam mundësi të kem diçka tjetër më të mirë). Puthe pragun (po dole që këtej)! mos guxo më të shkelësh në këtë shtëpi a në këtë vend!, mos guxo më të vish këtë! Deshi ta kafshonte dhe e puthi dikë deshi t'i bënte keq, por padashur i bëri mirë. Dëshiron të të puthë e të ha

- me dhëmbë do të të ndihmojë dhe të bën dëm, do të të bëjë mirë e padashur të bën keq. Të puth halla në të dy faqet thjeshtligj., iron. shih te HALL/Ë,~A. Për çdo punë puth dorën e tij nuk bën asgjë pa lejen a dijeninë e dikujt, kërkon pëlqimin e tij edhe për punë të vogla e të parëndësishme. Nga një anë të puth, nga tjetra të pret keq. është njeri me dy faqe, që hiqet në sy sikur të do, por nga ana tjetër të bën të keqen.
- PUTHEM** vetv. Puthu me Milon! thjeshtligj., iron. mbaroi, mori fund, s'ke se çfarë të bësh tashti; s'e gjen më tashti atë që e ke humbur.
- PUTHITEM** vetv. Janë puthitur çetelja me çetelen keq. shih te ÇETEL/E,~JA.
- PYES** kal. Lëre (që) mos pyet! shih te LË. Humbi kokën e pyet për flokët fj. u. shih te HUMB. Po s'pate shokun, pyet shkopin! fj. u. është mirë që për çdo gjë të këshillohesh më parë me dikë a të marrësh mendimin e dikujt. Pyet njëqind (shtatë a tetë) vetë, e bëj si di vetë! fj. u. këshillohu me të tjerët, merr mendimin e të tjerëve dhe më në fund vendos vetë për diçka.
- PYETJE** f. Pyetje retorike shih te RETORIK,~E.
- PYKË** f. Ra (mbeti) pykë ra ngushtë, është në një gjendje të vështirë, nga e cila nuk del dot. Futet (hyn) si pykë futet atje ku nuk duhet, fut hundët edhe aty ku nuk i takon. S'ha (s'merr) pykë (të gdhendur) shih te HA. Ishte pykë në diell ishte shumë i varfër, kishte mbetur trokë. E la (e rrëzoi) pykë e la në vend me një të goditur, e la të vdekur në vend. E vuri në pyka dikë e talli, e vuri në lojë. Çan dërrasa pa pykë shih te ÇAJ. Është pykë nga veshët është shurdh, nuk dëgjon fare nga veshët. Pyka shtyhet (nxirret) me pykë [pykën e shtyn (e nxjerr) pyka] fj.u. thuhet kur dikush duhet kundërshtuar, luftuar a zhdukur me të njëjtat mjete që ka përdorur edhe ai vetë. Shkojnë mykë e pykë shih te MYK/Ë,~A.
- PYLL** m. Si në pyll mospërf. si njeri i pagdhendur e i paqytetëruar, sikur është njeri i egër.
- QAFË** f. Pas qafe fare pranë, në rrëzë të veshit. I ra në (më) qafë dikujt
- QAFOL** m. I vunë i lidhën qafolin dikujt i ngarkuan një punë të rëndë, i caktuan një detyrë të vështirë për ta kryer.
- QAJ** jokal. Lan e qan shih te LAJ. E qau gërmadha shih te GËRMADH/Ë,~A. I qaj hallin dikujt
- QAR** m. bised. I ra qarit përfitoi pa u munduar fare diçka që nuk e priste ose që nuk i takonte.
- QARK** bised. Sillet kot rreth e qark (rreth) dardhës dikush shih te DARDH/Ë,~A.
- QARKOR** mb. Letër qarkore shih QARKOR/E,~JA.
- QARR** m. bot. Kur të bëjë qarri arra iron. kurrë, asnjëherë, kur të pjellë këndesi.
- QASE** f. vjet. I shkojnë shtatë (tetë) në qase shih te SHTATË.
- QEDER** m. bised. S'e bën qejfin qeder shih te QEJF,~I.
- QEFIN** m. U bë qefin u zbeh shumë në fytyrë. Me qefin nën sqetulla (në kokë) në rrezik të madh, me kokë në torbë. E mbante qefinin me vete
- QEJF** m. bised. Për qejf për bukuri, shumë mirë. Për qejfin e dikujt për shkak të dikujt. Për t'i bërë qejfin për ta marrë me të mirë, duke lavdëruar e duke ia pranuar menjëherë ato që thotë a që kërkon, megjithëse mund të mos jenë të drejta. Më ka hyrë në qejf dikush a diçka më pëlqen. Ia tregoi (ia rrëfeu) qejfin dikujt e ndëshkoi siç e meritonte; e rrahu (përdoret zakonisht kur dikush ndëshkon dikë që ka bërë faj).
- QELB** m. Si qelbi në çiban i fshehtë, tinëzar. Qelb nën thua diçka e keqe dhe e rrezikshme që nuk duket; njeri i keq e tinëzar. E ka mbledhur si plaga qelbin e ka mbledhur me vështirësi të madhe, me shumë lodhje e mundim.

- QELB** kal. E qelbi fare thjeshtligj. i turpëroi përpara të tjerëve, i fëlliçi, ua nxIU faqen. E qelbi (e prishi, e ndyu, e fëlliçi, e rëndoi) gojën shih te GOJ/Ë,~A.
- QELESHE** f. I vuri qeleshen dikujt e turpëroi, i vuri brirë. E hodhi (e fugu, e vuri, e ktheu) qeleshen (kësulën, festen, kapelën, takijen) mbi sy (mënjatë) shih te SYRI. E ka mendjen në majë të qeleshes (në majë të kësulës) shih te KËSUL/Ë,~A.
- QELI** f. Është qeli e mbyllur (qeli pa dritare) dikush nuk i nxjerr të fshehtat, është varr i mbuluar.
- QEMER** m. Urë pa qemer diçka jo shumë e qëndrueshme, diçka e dobët. Ka dalë (prej) qemerit dikush ka marrë rrugë të keqe, është shturur. E ka qemerin kordhë shih te KORDH/Ë,~A.
- QEN** m. Bukë qeni shih te BUK/Ë,~A. Punon si qen punon jashtë mase e në kushte shumë të vështira. Qen bahçevani (kopshti, kopshtari) shih te KOPSHT,~I. Qen besnik i dikujt shih te BESNIK,~E. Qen me kreshta (me gjemba) keq. shih te KRESHT/Ë,~A. Qen rojë shih te ROJ/Ë,~A. Qen i rrahur shih te RRAHUR (i,e). Qen rrugësh (sokaku, zorrësh, sallhaneje) mospërf. njeri pa vlerë, që endet poshtë e përpjetë pa punë. Stan pa qen shih te STAN,~I. Vdiq si qen vdiq në mes vuajtjesh e mundimesh pa pasur njeri pranë. Erdhën (ikën, shkuan) me qen (me kuç) e me mace (me maç) shih te KUÇ,~I. është për t'ua hedhur qenve shih te HEDH. është qen i punës punon me ngulm, s'i ndahet punës. Dhjamë (gjalpë, djathë i mirë) në lëkurë të qenit gjë e mirë në vend të keq, plaçkë e mirë në duar të këqija. S'ia ha qeni shkopin është shumë i zgjuar e i zoti, nuk ia hedh dot njeri. Ha qen e shpend s'lë gjë pa ngrënë, ha gjithçka, për lan çdo gjë, të than tepsia e sini. Ka sa të hanë qentë (lopët) thjeshtligj. shih te HA. Kapi (zuri) qeni një lepër mospërf., iron. rastisi një herë, një gjë që rastisi një herë, nuk është tregues për diçka të përgjithshme. Kapardiset si qeni në qerre fryhet shumë, mbahet si gjeli majë plehut. S'kishte ku e zinte (e kapte) qeni dikë ishte zhele-zhele, ishte i zhveshur e i zbathur; ishte shumë i varfër e i këputur. Lehin si qentë në hënëz (në hënë) keq. shih te HËNËZ,~A. Luante qeni i kallajxhiut shih te KALLAJXHI,~U. Luan si qeni me leckë me dikë bën si të dojë me dikë, s'e bën për asgjë, s'e vlerëson fare. Ka mbetur si qeni në qerre
- QENDËR** f. Qendra e gravitetit ana më e rëndësishme në një punë a veprimtari, që luan rolin kryesor dhe që kërkon vëmendje të veçantë.
- QENGJ** m. Ujk me lëkurë qengji shih tek UJK,~U I. Ka veshur lëkurën e qengjit shtiret sikur është i butë e i urtë për të fshehur qëllimet e vërteta keqbërëse.
- QEP** kal. I qepi buzët
- QEPALLË** f. kryes. sh. Nuk i dridhet (nuk i luan, nuk i lëviz) qepalla (qerpiku, syri, bebja e syrit) shih te SY,~RI.
- QEPAZE** mb. bised. U bë qepaze u bë me turp, e humbi emrin e mirë, s'i mbeti më nder.
- QEPËM** vetv. Iu qep me bukë në trastë (në torbë) dikujt shih te BUK/Ë,~A. I është qepur mulla për shpine shih te MULL/Ë,~A. Iu qep (iu ngjiti, iu bë) si pullë poste dikujt shih te POST/Ë,~A.
- QEPË** f. bot. Cipë qepe diçka shumë e hollë, pothuajse e tejdukshme. S'prishet dasma për një qepë (për një limon) fj. u. shih te DASM/Ë,~A. Mos e prish jahninë për një qepë mos e prish gjithë punën e bërë për diçka të vogël, mos e prish një punë të rëndësishme për hijgjë. Sikur qeni qepën të hajë! medoemos, me çdo kusht, patjetër, sido që të bëhet. Ngul qepë e shkull hudhra bën një punë të padobishme, krejt të kotë, bën më shumë dëm sesa punë të vlefshme. Sofrën shtroje edhe me bukë e qepë (e kripë) shih te SOF/ËR, ~RA.
- QEPUR** mb. I qepur me pe të bardhë shih te PE,~RI.

- QERE** f. Qerja e këmbëve mjek. sëmundje e lëkurës së këmbëve, që shfaqet me fluska me ujë, sidomos midis gishtërinjve. Qerja e thonjve mjek. sëmundje e thonjve të duarve dhe të këmbëve, nga e cila ata trashen, çngjyrosen dhe thyhen.
- QERËSE** f. Një këmbë në qerëse, një në ugar kërkon të përfitojë nga të dy anët; një dorë në revani, një në bakllava.
- QEROS** m. Te koka e qerosit të gjithë bëhen berberë fj. u. thuhet kur një punë është fare e lehtë e mund ta bëjë kushdo pa asnjë vështirësi.
- QEROS** mb. Hem qeros, hem qibar (fodull) ka kërkesa të mëdha, megjithëse mundësitë e aftësitë i ka të pakta.
- QERPIK** m. kryes. sh. Sa rreh qerpiku shumë shpejt, sa çel e mbyll sytë. Nuk i dridhet (nuk i luan) qerpiku (qepalla, syri, bebja e syrit) shih te SY,~RI. S'ka kohë as të rrahë qerpikët shih te RRAH.
- QERSHI** f. bot. Fshesa e qershisë bujq. shih te FSHES/Ë,~A.
- QERRE** f. E ka qerre me të shkon shumë mirë me dikë, e ka shumë mirë me të, e ka grurë me të. Shkojnë pas qerres së dikujt (lidhen pas qerres së dikujt, ndjekin pas qerren e dikujt) veprojnë sipas dëshirave a porosive të dikujt; lidhen pas interesave të rrethit a të grupit të dikujt. Kapardiset si qeni në qerre shih te QEN,~I. Ka mbetur si qeni në qerre shih te QEN,~I. Iu thye qerrja në derë (te dera) fitoi diçka papritur, përfitoi rastësisht, pa punë e pa mundim; i vajti e mira në derë. I erdhi lepuri në qerre dikujt shih te LEPUR,~I. E zë (e kap) lepurin (dhelprën) me qerre dikush vepron pa u ngutur për të kryer një punë të vështirë, po është i sigurt se ia del mbanë. I zuri qerrja (rrota, rrasa) bishtin shih te BISHT,~I. Sa të qajnë qetë, qan qerrja shih te KA,~U. Qerre dore vjet. karrocë dore. Qerrja e madhe astr. Arusha e Madhe. Qerrja e Vogël astr. Arusha e Vogël.
- QESE** f. E lidhi qesen shih te LIDH. E shkundi qesen shih te SHKUND. E zgjidhi (e hapi) qesen (kuletën, trastën) shih te ZGJIDH. Nuk më hyn në qese (në trastë, në kut) diçka shih te HYJ. I ka fryrë murrani në qese shih te MURRAN,~I. E kishte qesen të nxehtë (të ngrohtë) kishte mjaft para, e kishte xhepin plot. Të var në qese të duhanit ka aftësi të veçantë për t'i vënë të tjerët në lojë, të tall në mënyrë të hollë.
- QESH** jokal. As qan, as qesh shih te QAJ. S'i qesh buza (fytyra) është i ngrysur, i zymtë, nursëz. Qesh nën hundë (nën mustaqe) shih te HUND/Ë,~A. Qesh e ngjesh e qorton, e shan dikë ose i bën diçka të keqe tjetrit duke e paraqitur si me shaka. Qesh, se s'qan dot shih te QAJ. I qesh zemra është i gëzuar. Për të qeshur e për të qarë diçka që është njëkohësisht edhe e rëndë, edhe komike. I fundit o qesh o qan fj.u. shih te QAJ. I qeshi shtegu i ballit shih te SHTEG,~U. Qesh edhe me ujin e kulluar nuk pëlqen asgjë, po vetëm kritikon, nuk i duket e mirë asgjë, s'kënaqet kurrë. Qesh me zemër e jo me buzë nuk qesh sa për sy e faqe, por qesh me gjithë zemër, gëzohet me të vërtetë. Qesh me sy e qan me zemër shih te QAJ. Në atë shtëpi qeshin edhe trarët është familje e gëzuar, e lumtur dhe shumë mikpritëse. Në atë shtëpi nuk qesh as vera është familje e rëndë e jo mikpritëse.
- QESHUR** as. Me të qeshur e me të ngjeshur duke e paraqitur diçka si me shaka, por në të vërtetë duke e qortuar e sharë dikë ose duke i bërë një të keqe.
- QETË** mb. Natyrë e qetë art. shih te NATYR/Ë,~A.
- QETH** kal. I do qethur mishin me gërshtëri duhet zhdukur, duhet bërë copa-copa.
- QETHEM** vetv. Doli si rruar, qethur shih te RRUHEM. Kur të qethen dhentë e kuqe shih te DHEN,~Të. Kur të qethen viçat iron. shih te VIÇ,~I.

- QETHUR** mb. Shkoi (vajti) për lesh e doli (u kthye, erdhi) i qethur fj. u. iron. shih te LESH,~I.
- QËLLIM** II m. Me qëllim që... për të ..., që ...
- QËLLOJ** kal. Qëllon (shtie) në hi shih te HI,~RI. Qëlloi (goditi) në shenjë shih te SHENJ/Ë,~A. Qëllon në xixëllonjë shin te XIXËLLONJ/Ë,~A. Gjahu në breg e qëllon në kodër shih te GJAH,~U.
- QËMTOJ** kal. Po e qëmton gjumi po i vjen për gjumë, po e zë gjumi dalëngadalë, po i mbyllet sytë nga gjumi.
- QËNDIS** kal. Ia qëndisi në lule të ballit shih te LUL/E,~JA.
- QËNDROJ** jokal. I qëndron (i rri) afër dikujt shih tek AFËR 6. Qëndron (mbetet) në ajër shih tek AJ/ËR,~RI. Qëndroi (mbeti) në bisht shih te BISHT,~I. Qëndrojmë (jemi) bllok shih të BLOK,~U. I qëndron (i rri) me fyt dikujt shih te FYT,~I. Qëndron (rri) gatitu përpara dikujt shih te GATITU. Qëndron (është, mbeti) në hava shih te HAVA,~JA. Qëndron me (në) këmbë diçka shih te KËMB/Ë,~A. I qëndroj (i rri) mbi (në) kokë (krye) dikujt a diçkaje shih te KOK/Ë,~A. I qëndron (i rri) kokërr shih te KOK/ËRR,~RRA. Qëndrojnë larg shih te LARG 4. Qëndron më lart shih te
- QËROJ** kal. E qëroi si hudoër dikë shih te HUDH/ËR, ~RA. I qëroi hesapet me dikë i lau llogaritë me dikë. I qëroi (i ndau) lakrat (llogaritë, hesapet) me dikë shih te NDAJ.
- QËRUAR** mb. Vezë e qëruar diçka krejt e përgatitur, e bërë gati si llokum, përshesh në pjatë.
- QIBAR** mb. bised. Hem qeros, hem qibar (fodull) shih te QEROS,~E.
- QIELL** m. Ra nga qielli u bë ose erdhi vetvetiu a papritur. M'u hapën (m'u çelën) qiejt u gëzova shumë. Hidhu në qiell (hidhu për-pjetë)! shih te HIDHEM. Me krye (me kokë) në qiell
- QIELLOR** mb. Mekanika qiellore astr. shih te MEKANIK/Ë,~A.
- QIELLZË** f. Iu ngjit gjuha pas qiellze shih te GJUH/Ë,~A.
- QIFT** m. zool. Si qifti pulën me shpejtësi të madhe, rrëmbimthi. I vjen qift i vjen rreth e rrotull diçkaje, duke dashur ta marrë.
- QILAR** m. Është më afër dera se qilari fj. u. shih te DER/Ë, ~A. I flas derës të dëgjojë qilari shih te FLAS.
- QILIM** m. Qilimi i gjelbër libr. fusha e futbollit.
- QIME** f. Asnjë qime (fije floku) asnjë fije, asnjë grimë aspak. Pas qimes për një grimë, për diçka të vogël. Deri në një qime deri në hollësitë më të vogla, pa lënë mangët as gjënë më të vogël, plotësisht. Iu drodhën qimet e kokës (flokët, leshrat e kokës) shih te FLOK, ~U. Nuk të fal (as) qimen është shumë kërkues, nuk bën as lëshimin më të vogël. Flet me qime flet në mënyrë shumë të përpiktë. Ia kallu qimen thjeshtligj. e la diçka pas dore, s'ia vari dikujt a diçkaje. Këput edhe qimen shih te KËPUT. Lesh me qime shih te LESH, ~I. Një qime derri është pak, një fije. Sa qimet e kokës shumë shtrenjtë. Si qimja në qere shumë i rrallë; shumë rrallë. I rri në qime dikujt tregohet i kujdesshëm ndaj dikujt në të folur e në veprime. Shpëtoi për një qime (për një fije floku, për një fill) shih te FIJ/E, ~A. S'e trembi (fare) qimen nuk u frikësua, nuk iu tremb syri. Varet (mbahet) te një qime është gati duke u prishur a duke vdekur, pak gjë e ndan nga prishja a nga vdekja. E bën qimen (halën, perin) tra i zmadhon shumë gjërat, i paraqit gjërat shumë më të mëdha sesa janë. Më dolën qime të bardha shih te BARDHË (i,e). Ia ha syri në qime dikë shih te SY,~RI. Futet si qimja në qull hyn aty ku s'duhet, futet (ndërhyn) në një punë pa qenë fare e nevojshme dhe e prish punën. I qe çelur qimja ishte i gëzuar. Është qime e gjallë
- QIND** m. Qind për qind

- QIPULL** m. mit. I hipën (i kërcyen, e zunë, e kapën) qipujt (xhindet) shih te XHIND,~I. I zbritën (i ranë) qipujt (xhindet) shih te XHDND,~I.
- QIQËR** f. Kërkon qiqra në hell shih te HELL,~I. I ka qiqrat të ftohta me dikë shih te FTOHTË (i,e). I ka qiqrat të mbara i shkojnë mirë punët, i ka punët në rregull, e ka vënë në vijë.
- QIRA** f. Shtëpi pa qira thjeshtligj. burgu. S'e vlen barra qiranë edhe poh. shih te BARR/Ë,~A. S'e ka marrë shpirtin me qira thuhet kur dikush përpiket të mos i pranojë detyrat a punët e rënda e të shumta, të cilat nuk i përballon dot ose i shkatërrojnë shëndetin.
- QIRI** m. Është bërë qiri është tretur, është dobësuar shumë. E kërkoi me qiri e kërkoi në çdo anë, s'la vend pa e kërkuar. Kishte mbetur qiri ishte ngushtë, ishte në gjendje të vështirë, e kishte punën pisk. I ndezën qiririn presin që të vdesë dikush nga çasti në çast. I rri qiri (më këmbë) dikujt i rri gati dikujt për t'i plotësuar çdo kërkesë, i rri më këmbë; kujdeset shumë për dikë. U gjend qiri në këmbë u ngrit menjëherë në këmbë. E kërkon sherrin me qiri kërkon me çdo mënyrë shkak për t'u grindur, është i gatshëm për të bërë sherr. Mbeti qiri në këmbë
- QIT** kal. E qiti (e nxori, e ngriti, e çoi) nga balta dikë shih te BALT/Ë,~A. I qiti (i lëshoi) be shih te LËSHOJ. Qet e bërtet rropatet me çdo mjet të vërtetojë ose të kundërshtojë diçka. Ia qiti (ia hoqi, ia nxori) bojën keq. shih te BOJË,~A I. E qiti bosh (fjalën) shih te BOSH. E qiti borxh shih te BORXH,~I. E qiti (e nxori) në breg dikë shih te BREG,~U. Qit cekën shih te CEK/Ë,~A. E qiti (e bëri, e nxori) çirak dikë edhe iron. shih te ÇIRAK,~U I. E qiti nga defteri e fshiu nga defteri. E qiti në doçe shih te DOÇ/E,~JA I. I qiti në dorë diçka shih te DOR/Ë,~A. E qiti (e nxori) në dritë shih te DRIT/Ë,~A. E qit (e nxjerr) nga dheu shih te DHE,~U. E qiti (e nxori) fare shih te FAR/Ë,~A. Ia qiti fishekët një pune shih te FISHEK,~U. I qiti (i nxori, i gjeti) fundin diçkaje shih te FUND,~I. E qiti (e nxori) për fushë (në fushë) diçka shih te FUSH/Ë,~A. E qiti në harresë e harroi. Ia qiti (ia nxori) nga hundët (nga hunda, për hundësh) diçka keq. shih te HUND/Ë,~A. Sikur e ka nxjerrë (e ka qitur) nga hunda (për hundësh) shih te HUND/Ë,~A. E qiti (e solli, e pruri) në jetë shih te JET/Ë,~A. Të qiste (të nxirrte) pa kapuç shih te KAPUÇ,~I. E qiti kokën e tregoi se kush është; filloi a rifilloi të veprojë. Qit (nxjerr) krye (kokë) shih te NXJERR. Qit (nxjerr) më (në) krye diçka shih te KRYE,~T. U qiti (ia nxori) në lëndinë diçka shih te LENDIN/Ë,~A I. E qiti (e nxori) lyç diçka shih te LYÇ. E qiti mbanë e përfundoi me sukses një punë, ia doli në krye. E qiti mendsh e luajtji mendsh. Ia qiti (ia nxori) mendtë (trutë) dikujt shih te MEND,~TË. I qiti puplat u rrit, filloi ta ndiejë veten gjallë e të lëvizë. I qiti (i bëri) rrethin shih te RRETH,~I. I qiti stërdhëmbët shih te STËRDHËMB,~I. I qiti (i nxori) sytë dikujt shih te NXJERR. Qet (hedh, shtie) shkelma shih te SHKELM,~I. E qiti pas shpine shih te SHPIN/Ë,~A. I qiti (i nxori, i mori) shpirtin dikujt shih te SHPIRT,~I. E qiti (e nxori) në shteg shih te
- QITJE** f. Me qitje të largët libr. shih te LARGËT (i,e). E bëri tabelë qitjeje dikë libr. i drejtoi të gjitha goditjet a kritikatat kundër dikujt. Shesh qitjeje usht. hapësira që duhet të ketë përpara pozicioni i zjarrit, në të cilën mund të bëhet qitje pa pengesë dhe në një kënd sa më të gjerë majtas e djathtas.
- QOFKË** f. zool. Shikon (vështron) nga qofkat shikon andej-këtej, nuk e përqendron vështrimin në një vend; nuk është i vëmendshëm (përdoret sidomos për fëmijët).
- QOFTE** f. gjell. E do qofte e do gati diçka, kërkon t'ia bëjnë të tjerët diçka, pa u lodhur vetë.

QOFTË.

Në qoftë se ...

QOKË f. I ra në qokë i ra në të një pune, një çështjeje, e gjeti tamam, i ra pikës.

QORR m. bised. E ruan si qorri syrin e vetëm kujdeset shumë për dikë a për diçka, e ruan si sytë e ballit.

QORR mb. bised. Rrugë (udhë) qorre (e verbër) shih te VERBËR (i,e). E bëri qorr dikë keq. u përpoq t'ia hedhë dikujt. Bën një sy qorr (të verbër) shih te VERBËR (i,e). I ka hipur kalit qorr ka nisur një punë që nuk do të ketë përfundime të mira, ndjek një rrugë që s'dihet se ku do ta çojë. Fasule (groshë) qorre fasule kokërrvogël me një pikë të zezë. Zorrë qorre (e verbër) anat. shih te ZORR/Ë,~A 1.

QORROJ kal. bised. Qorroj njërin sy bëj sikur nuk e shoh diçka, hiqem sikur nuk e kam vënë re, bëj një sy të verbër.

QOSE m. U zunë për mjekrën e qoses u zunë për diçka të paqenë, u zunë fare kot.

QOSHE f. bised. Qoshe më qoshe cep më cep, në çdo anë. U bë për qoshe u plak, nuk është më i aftë për punë e për të lëvizur. S'ka qoshe diçka është tepër vonë, nuk ndreqet dot më. Nuk ia merr qoshen shih te MARR. Të qan (të than) qoshen shih te QAJ. Qoshe e ngrohtë (vend i ngrohtë) keq. shih te NGROHTË (i,e). Qoshe e rehatshme keq. shih te REHATSH/ËM (i), ~ME (e). Në qoshe (në krye) të vatrës shih te VAT/ËR,~RA. Rri si me qoshe rri si i zemëruar a fort i mërzitur. Ka zënë qoshen

QUAJ kal. E quaj (e shoh, e gjej) të udhës shih tek UDH/Ë,~A. I quaj gjërat me emrin e vet libr. shih tek EM/ER,~RI.

QULL m. E la qull diçka e la pas dore, nuk kujdeset për një punë a për një çështje, e la pa e kryer, pa e sqaruar deri në fund a pa e zgjidhur. E la në qull dikë e braktisi dikë kur ishte në gjendje të vështirë, e la në baltë. Të vraftë qulli! tall. shih

te VRAS. Ia bëri kurrizin qull dikujt e rrahu shumë, ia bëri kurrizin më të butë se barkun. Ia ka djegë qulli (luga) buzën e ka pësuar një herë, e ka provuar njëherë diçka të keqe. Mos u fut (mos hyr) në atë qull! mos u përziej në një punë me ngatërresa e jo shumë të pastër!, mos u fut në atë baltë! Futet si qimja në qull shih te QIM/E, ~JA. I mbeti luga në qull iron. shih te LUG/Ë,~A. S'e nxjerr (dot) qimen aga qulli shih te QIM/E, ~JA. U dogj nga qulli (nga kungulli), e i fryn edhe kosit fj. u. e ka pësuar keq nga diçka e mëparshme dhe tregon kujdes të tepruar edhe kur nuk është e nevojshme.

QUMËSHT m. Është bërë qumësht dikush është zbutur, i ka zbritur inati; është urtësuar. Djalë qumështi (mama)je mospërf. shih te MAMA,~JA. U fry si qumësht u zemërua shumë, u inatos keq. Qumësht dallëndysheje

QUMËSHTOR mb. Lule qumështore bot. shih te LUL/E, ~JA.

QURRA f. vet. sh. I ha pula qurrat mospërf. shih te PUL/Ë,~A.

QYMYR m. E ka zënë qymyri shak. ka rënë në dashuri. Qymyri i bardhë uji si forcë lëvizëse për të dhënë energji. Qymyri i kaltër era si forcë lëvizëse për të dhënë energji.

QYP m. E di qyp e di shumë mirë! I hipi qypit u zemërua shumë. Rri si qyp rri në një vend, pa lëvizur e pa thënë gjë, rri si shul. Flet si miza në qyp (si në qyp) flet me zë të ulët e mbyturazi, nuk merret vesh fare se ç'thotë. Hahen si merimangat në qyp grinden keqas e vazhdimisht njëri me tjetrin. Iu mbush mendja qyp shih te MENDJ/E,~A.

QYQ m. Është qyq në degë është shumë i zoti.

QYQE f. U bë qyqe piu e u deh keq, u bë tapë. Është bërë si qyqe është; dobësuar shumë, është tretur. E bëri (fare) qyqe e qortoi rëndë e s'i la gjë pa thënë, e bëri leckë. Mos e dëgjoftë qyqen! mallk. vdektë pa ardhur pranvera! I dhimbset (edhe)

- qyqes është fare i mjerë: është në gjendje të vajtueshme. Të këndoftë qyqja! mallk. vdeksh.
- QYSH** Qysh kur (se) që kur, që kurse.
- QYTETAR** mb. Luftë qytetare luftë civile.
- QYTETARI** f. I jep të drejtën e qytetarisë libr. e pranon që të jetë si diçka me të drejta të plota në përdorim ose në jetë. Fiton (merr) të drejtën e qytetarisë libr. pranohet haptazi e vihet në jetë nga të gjithë a nga shumica.
- RABUSH** m. S'e fut në rabush nuk e llogarit; nuk e përfill. E vë në rabush e marr shënim, e mbaj parasysh. Ka hyrë në një rabush me dikë keq. është futur në një radhë a në një grup me dikë, ka filluar të bashkëpunojë me dikë. I merr fjalët e i vë në rabush nuk ua vë veshin fjalëve, porosive e këshillave të dikujt, nuk u jep rëndësi, i lë në harresë.
- RADIO** f. Enciklopedia e radios shih tek ENCIKLOPEDI, ~A.
- RADHË** f. Në radhë të parë shih te PARË (i,e). Në radhët e para (në rreshtat e parë) shih te PARË (i,e). Radhë e pa radhë pa një rregull të caktuar, si t'i teket a t'i vijë mbarë.
- RAKI** f. Flet rakia përdoret kur një i dehur flet fjalë të mëdha ose fjalë që nuk do t'i thoshte po të ishte esëll. I hodhi një brez rakisë shih te HEDH. Pagan ujin për raki shih te PAGUAJ. E pi rakinë me opingë shih tek OPINGË, ~A.
- RAPORT** II m. Në raport me... në krahasim me.
- RAST** m. Në rast se... në qoftë se. Për çdo rast sido që të ndodhë, sido që të vijë puna.
- RE** I f. Gjer në re (te retë) shumë lart. Re e gjallë shih te GJALLË (i,e). Re me breshër
- RE** I f. I bërtet së bijës ta dëgjojë e reja fj. u. e hedh fjalën për ta dëgjuar dikush tjetër, e thotë tërthorazi diçka, i bie pragut të dëgjojë dera.
- REAKSION** I m. Reaksion bërthamor fiz. zbërthimi i bërthamave të atomeve të një elementi, si pasojë e të cilit ai shndërrohet në një element tjetër, duke lëshuar energji të madhe. Reaksion zinxhir
- REAL** mb. Numrat realë mat. numrat e zakonshëm të dalluar nga numrat imagjinarë. Shkencat reale vjet. shkencat natyrore, të dalluara nga shkencat shoqërore.
- REALITET** m. Në realitet në të vërtetë.
- REFENE** f. Nuk e vë në refene nuk e përfill, nuk e vë në hesap.
- REGJEM** vetv. Iu regj lëkura është mësuar tashmë me një punë; nuk i bën me përshtypje diçka.
- REGJIM** m. Regjimi i kursimit ek. metodë e drejtimit të ekonomisë socialiste, që ka për qëllim të shtohet prodhimi dhe të kryhet çdo punë me shpenzime sa më të pakta e duke shfrytëzuar rezervat e brendshme.
- REGJISTRIM** m. Shënim në kartën e regjistrimit shih te SHËNIM, ~I. Karta e regjistrimit shih te KART/Ë, ~A.
- REGJUR** mb. I regjur (i rrahur) me vaj e me uthull shih te VAJ, ~I I.
- REHAT** m. bised. Më bën shpirti (syri) rehat gjej kënaqësi të madhe, kënaqem shumë.
- REHAT** ndajf. bised. Fli rehat! shih te FLE. Më vjen rehat ndiej kënaqësi, më vjen mirë. Më ranë veshët rehat shih te VESH, ~I. Më zunë kockat rehat gjeta më në fund prehje a qetësi. Le gomari që na ngordhi, po s'na lënë rehat as mizat thjeshtligj. shih te GOMAR, ~I.
- REHATSHËM** mb. bised. Qoshe e rehatshme keq. vend pune ku ka pak për të bërë, punë e lehtë pa kokëçarje e pa shqetësime.
- RELIEV** m. Del në reliev libr. bëhet më i dukshëm, spikat; bie në sy. Nxjerr (vë) në reliev libr. bëj që të spikatë, bëj që të bjerë menjëherë në sy, nxjerr në pah, vë në dukje.

- REND** I m. Rendi i ditës tërësia e çështjeve që shqyrtohen e që rrihen në një mbledhje a në një konferencë sipas një radhe të caktuar. Është (vë, mbetet) në rendin e ditës është (mbetet) në qendër të vëmendjes, qëndron në radhë të parë si diçka që duhet shqyrtuar e zgjidhur, është çështje e ditës. Nuk i del rend dikujt nuk i del koha, nuk ka kohë për të bërë diçka, ka shumë punë, është shumë i zënë me punë.
- RENDOR** mb. Numëror rendor gjuh., vjet. numëror rreshtor.
- REPART** m. Shpirti i repartit keq. prirja e dikujt për t'u kujdesur e për t'u përpjekur vetëm për interesat e një grupi të ngushtë, ku bën pjesë ai vetë.
- RETËR** f. E bëri retra (fërtele, lakër) shih te BËJ 15. U bënë retra (kryes. për këpucët, rrobat) u bënë copë-copë, u grisën. M'u bë retër m'u ngjit nga pas e nuk m'u nda pa ia plotësuar një kërkesë a një dëshirë, m'u bë rrodhe. Shtrëngo (mbledh) retrat detyrohem të veprojmë në një mënyrë të caktuar nga nevoja a nga ndonjë shtrëngesë tjetër, mbledh rripat.
- RETORIK** mb. libr. Pyetje retorike pyetje që bëhet për t'i tërhequr vëmendjen lexuesit ose dëgjuesit, duke pohuar diçka në trajtën e një pyetjeje, që e ka vetë përgjigjen brenda.
- REVAN** m. Ka marrë revan ka hyrë në një rrugë jo të mirë dhe ecën i papërmbajtur. S'mëson kali revan në pleqëri fj. u. thuhet për diçka që i ka kaluar koha dhe nuk mund të bëhet më.
- REVANI** f. gjell. Ka (kërkon të ketë) një rëndë dorë në bakllava dhe tjetrën në revani përb. shih te DOR/Ë,~A.
- REVOLE** f. bised. E do me revole (me kobure) kokës shih te KOBUR/E,~JA.
- REZE** f. I vuri (i hodhi) rezen shtëpisë (derës) vdiq pa lënë njeri pas, e mbylli derën.
- REZERVË** f. Pa rezerva me të gjitha forcat, me gjithë shpirt, pa kursim.
- REZIL** m. bised. shar. E bëri rezil e shau rëndë para të tjerëve për diçka të keqe që kishte bërë, i mori fytyrën, e poshtëroi, e turpëroi para të tjerëve.
- REZULTAT** m. Si rezultat libr. si rrjedhim, si pasojë; si përfundim.
- REZHDË** f. Lule rezhde bot. shih te LUL/E,~JA.
- RËNDEM** vetv. I rëndet (i rëndon) dheut shih te RËNDOJ.
- RËNDË** as. Të rëndët e dheut euf. ankthi. I çohet të rëndët i vjen për të vjellë.
- RËNDË** mb. Është i rëndë nga veshët nuk dëgjon mirë. Ka dorë (e ka dorën) të rëndë
- RËNDË** ndajf. I ra rëndë diçka e lëndoi, e preku thellë në sedër. E kam rëndë dikë a diçka
- RËNDOJ** kal. Aq i rëndojnë aq ia pret, aq mend ka. E rëndoi dorën mbi dikë e rrahu rëndë (zakonisht pa të drejtë a pa qenë nevoja). I rëndon (i rëndet) dheut mospërf. është e kotë që jeton, më mirë të mos ishte gjallë (për një njeri të keq ose që është dembel e nuk bën asgjë). E rëndoi (e prishi, e ndyu, e fëlliçi, e qelbi) gojën shih te GOJ/Ë,~A. Po rëndon moti po keqësohet gjendja, po acarohen punët.
- RËNË** f. Me një të rënë të penës (të lapsit) shumë lehtë. Me një të rënë të shkopit shih te SHKOP,~I. E zhdukuri me një të rënë (me një vijë) pene diçka libr. shih te VIJ/Ë,~A.
- RËNË** mb. (Si) i rënë nga qielli shih te QIELL,~I.
- RËRË** f. Kështjellë në rërë diçka e paqëndrueshme, pa themele të shëndosha. I ndërtuar
- RI** mb. Në një dritë të re libr. nga një anë tjetër, e ndryshme dhe më e plotë, i ndriçuar më mirë; nga një pikëpamje tjetër e ndryshme. Faqe e re shih te FAQ/E, ~JA 10. Gjak i ri grup njerëzish

- që pranohen në një organizatë për ta forcuar e gjallëruar atë. Plaku i Vitit të Ri shih te **PLAK**,~U. Filloj radhë të re shih te **RADH/Ë**,~A. Ilaç i vjetër në shishe të re keq. shih tek **ILAÇ**~I.
- RIGON** m. bot. E vë në hije të rigonit dikë shih te **HIJ/E**,~A. Rigoni s'bëhet lis fj. u. thuhej nga klasat shfrytëzuese për të mohuar aftësitë dhe mundësitë e zhvillimit e të përparimit të njerëzve të thjeshtë. Hipi miza në rigon shih te **MIZ/Ë**,~A.
- ROB** m. Me rob e robi shih te **ROBI**,~A. As rob, as korb asnjëri, askush.
- ROBI** f. përmb. krahin. Me rob e robi me të madh e me të vogël, me gjithë njerëzit e shtëpisë, krejt.
- ROGË** f. Në rogë të ballit në mes të ballit, në lule të ballit.
- ROJË** f. Në rojë të... në mbrojtje të... Rojë nderi
- ROL** m. Luan rolin e dikujt shih te **LUAJ**. I është futur (i ka hyrë) mirë rolit libr. shih te **FUTEM**.
- ROMAK** mb. hist. Shifrat romake shenjzat e numrave (I, II, III, IV, X, C etj.), që janë të ndryshme nga shifrat arabe dhe që përdoren zakonisht në vend të numërorëve rreshtorë.
- ROSË** f. zool. Mbeti si rosa në mjegull nuk di nga të shkojë.
- RUAJ** kal. Ruan erërat është njeri me dy faqe, kthen nga të fryjë era. E ruan faqen ruhet para të tjerëve të mos i dalë boja, ruan nderin para botës. Ruan lëkurën i largohet rrezikut; shikon vetëm veten e vet, nuk çan kokën për të tjerët. E ruaj (e vë, e fut) në xhep shih te **XHEP**,~I. E ruan (e mban) si breshka dheun shih te **DHE**,~U. E ruaj (e dua) si sytë e ballit (si dritën e syve) shih te **SY**,~RI. E ruan si syrin e vetëm shih te **SY**,~RI. E ruan si qeni mishin (si qeni mëlçitë) iron. shih te **QEN**,~I. E ruan si i varfri kaun shih te **KA**,~U. Ruaje (mbaje) zogun sa e ke në dorë! fj. u. shih te
- RUBË** f. krahin. Iu vu ruba (një shtëpie) u shua nga vdekjet, iu vu ferra, iu vu futa. U bë për të vënë rubën e zezë shih te **ZI** (i), **ZEZË** (e).
- RUDË** mb. Sa më thellë, më ruda iron. thuhet për një punë, që sa më tej i shkohet, aq më e ndërlikuar del.
- RUHEM** vetv. I ruhet si vdekjes shih te **VDEKJ/E**,~A. Ruhet (ikën, largohet) si shejtani (si djalli) nga temjani shih tek **TEMJAN**,~I.
- RUP** m. vjet. Nuk shkohet me tre rupe në dasmë fj. u. duhet të jesh i përgatitur mirë kur ndërmerri diçka të madhe.
- RYSHFET** m. E shkelën me ryshfete (me para) shih te **SHKEL**.
- RRAFSH** ndajf. Rrafsh e plot me shumë gjëra, me shumë të mira; me të gjitha të mirat. U shtrua (foli, bisedoi) rrafsh me dikë u ul këmbëkryq me dikë dhe foli shtruar për të gjitha çështjet. E bëri rrafsh me tokën e prishi që nga themelet, e rrafshoi, e shkatërroi pa i lënë gjë më këmbë.
- RRAH** kal. 15. jokal. fig. E kam syrin te diçka ose diku, synoj, kam qëllim, më punon mendja diku (edhe në një varg togjesh frazeologjike); bëj me ngulm diçka. E di ku rreh ai e di ku synon, e di ku kërkon të dalë. Aty rreh të dalë. Të gjithë në një vend rrahin.
- Rrahu benë vjet. bëri be, u betua. Të rrahë (të bjerë) çekani diku ose në diçka shih te **ÇEKAN**,~I. Rreh gjoksin (kraharonin)
- RRAHUR** mb. Qen i rrahur njeri që e ka pësuar një herë keq në jetë dhe që nuk ka më guxim e nuk vetëvepron, ngaqë ruhet se mos e pësojë përsëri.
- RRALLË** mb. Më të rrallë nganjëherë, rrallë. I ka shokët të rrallë shquhet, dallohet shumë ndër të tjerët, zor t'ia gjesh shokun.
- RRANGALLË** f. I bie rrangallës flet kot.
- RRAP** m. bot. U bë rrap e rrënjë ka jetuar shumë; ka parë e ka dëgjuar shumë.

- RRAQE** f. vet. sh. Ngriti (mblodhi) rraquet (rreckat, leckat) mospërf. shih te NGRE. Ia ngriti (ia mblodhi) rraquet (leckat) dikuajt mospërf. shih te NGRE.
- RRAS** kal. Di vetëm të rrasë (të hajë) përsesh dikush shih te PËRSHESH,~I.
- RRASË** f. I vuri rrasën (plloçën) diçkaje shih te PLOÇ/Ë,~A. Iu bë shtëpia rrasë (e gjallë) s'i mbeti gjë prej gjëje në shtëpi, iu bë shtëpia trokë. Ka gjetur rrasa vegshin (vorbën) keq. janë njësoj njëri me tjetrin, ka gjetur tenxherja kapakun. Ka mbetur rrasë në diell ka mbetur pa asgjë, pa asnjë dysh. E nxjerr në rrasë të gjallë është shumë i zoti, nxjerr vaj nga guri. Rron (edhe) në rrasë të gjallë është njeri shumë i kalitur e i aftë, është trim e i paepur, çan përpara në jetë. I zuri rrasa (rrota, qerrja) bishtin shih te BISHT,~I.
- RRASËT** mb. Ethe të rrasëta ethe të forta, që të dërrmojnë tërë trupin.
- RRASËT** ndajf. Fjeta rrasët fjeta shumë mirë, pa u zgjuar fare. Punojnë rrasët punojnë me ngulm, me kujdes e pa ndërprerje, punojnë shumë mirë, s'e ngrenë kokën nga puna.
- RRASHTË** f. E la rrashtën diku shih te LË. Është bërë me rrashta zogjsh shih te ZOG,~U.
- RRAXHË** I f. Janë një rraxhë janë të një mase, sa njëri tjetri, të prerë me një gërshërë. I vë rraxhën e bëj rrafsh, e rrafshoj.
- RRECKË** f. E bëri rreckë (leckë, paçavure) dikë shih te LECKË,~A. Mblodhi (ngriti) rreckat (leckat, rraquet) mospërf. shih te NGRE.
- RREGËZINË** f. E bëri rregëzinë e qortoi shumë rëndë, s'i la gjë pa thënë, e bëri leckë.
- RREGULL** m. S'është në rregull flet ose vepron në mënyrë jonormale.
- RREGULL** f. Rregulla e trashit mat. shih tek TRESH,~I. Rregulla e artë e mekanikës fiz. shih tek ARTË (i,e).
- RREGULLOJ** kal. Rregullo (ndreq, drejto) gojën! shih te GOJ/Ë,~A. Rregulloi llogarinë (borxhet) me dikë lau hesapet me dikë. I rregulloi pllakën shih te PLLAK/Ë,~A. Ia rregulloi (ia ndreqi, ia ujdisi) qejfin (kokën) shih te NDREQ. Ia rregulloi (ia ndreqi, ia ujdisi) samarin (bërroren, kurrizin, shpinën) shih te NDREQ. I kanë rregulluar (i kanë gjetur, i kanë lidhur) telat bashkë shih tek TEL,~I.
- RREJ** kal. bised. Më rren mendja se... më thotë mendja se..., më duket se...
- RREMB** m. Është lis (pemë) me rremba është njeri me vlerë e me shumë të mira, është pemë me kokrra.
- RREPTËSI** f. Zona e rreptësisë sport. pjesë katërkëndëshe e vijëzuar, që ndodhet 16 metra përpara portës në fushën e futbollit.
- RRESHT** m. Në rreshtat e parë shih te PARË (i,e). Lexoj në mes të rreshtave (radhëve) libr. shih te RADH/Ë,~A.
- RRESHTOJ** kal. S'di t'i rreshtojë fjalët edhe poh. nuk di të flasë bukur, nuk i lidh rrjedhshëm fjalët.
- RRETH** m. Rreth i hekurt rrethim i plotë, pa asnjë të çarë; darë. Rreth i mbyllur (me cen) libr.
- RRETH** Rreth e rreth jo drejtpërdrejt, anës e anës, larg e larg. Vjen rreth (rrotull) dikush shih te RROTULL. Vinin rreth rronin disi, jetonin me ato që kishin. Vjen rreth (rrotull, anës) për shi (për dëborë) shih te RROTULL. I vjen (i sillet) rreth (rrotull, vërdallë) dikuajt shih te RROTULL. Më vjen (më sillet) rreth (rrotull) diçka shih te RROTULL. S'kam ku të vij rreth (rrotull) shih te RROTULL. Vërtitet rreth poçit shih te POÇ,~I. Sillet kot rreth (rreth e qark) dardhës dikush shih te DARDH/Ë,~A.
- RRETHANË** f. Plotës i rrethanës gjuh. shih RRETHANOR,~I.

- RREZE** f. Ka rreze (është me rreze) është shumë i bukur, ka pamje shumë të hijshme; shkëlqen. Si rrezja e diellit shumë i shndritshëm, i shkëlqyer; shumë i bukur.
- RREZIK** m. I bie kambanës së rrezikut libr. jap kushtrimin; tërheq vëmendjen e të tjerëve për një të keqe të madhe që na kanoset.
- RREZM** m. Doli rrezmit (toka) nuk është më pjellore si përpara, nuk prodhon më.
- RRËFANË** f. Ia gjej rrëfanën diçkaje e gjej mjetin a mënyrën për të zgjidhur diçka; ia gjej anën.
- RRËFEHEM** vetv. S'rrëfëhet me gojë është diçka e habitshme, e jashtëzakonshme. Më ka zënë (atje) ku s'rrëfëhet
- RRËFEJ** kal. Ia rrëfeu (ia tregoi) qejfin dikujt shih te QEJF, ~I. I rrëfeu (i tregoi) rrugën (udhën) dikujt mospërf. shih tek UDH/Ë, ~A. I rrëfeu (i tregoi) shkopin dikujt shih tek TREGOJ. I rrëfen (i tregon) babait arat iron. shih te BABA, ~I.
- RRËKE** f. E ka marrë rrëkeja
- RRËMBEJ** kal. Rrëmbej (rrok) armët (pushkët) ngrihem në luftë, ia filloj luftës; ngjesh armët.
- RRËMOJ** kal. I rrëmoi barkun e preku në plagët e fshehta, i zbuloi ç'kishte në zemër.
- RRËNJË** I f. Me rrënjë në mënyrë të thellë, shumë mirë e me hollësi. (E pyes) rrënjë më rrënjë (e pyes) me hollësi, imtësisht. Ia heq (ia tërheq) rrënja për diçka ka qejf për diçka, ia do qejfi. Lëshon (zë, ngul, hedh, shtie) rrënjë
- RRËQEBULL** m. zool. Iu bë rrëqebull iu ngjit pas dikujt, nuk i ndahet, iu qep pas.
- RRËSHQANË** ndajf. Hiqet rrëshqanë (zvarrë) shih te ZVARRË. E tërhoqi (e hoqi) këmbën rrëshqanë (zvarrë) shih te ZVARRË.
- RRËSHQAS** jokal. Më rrëshqiti (më shkau) gjuha (goja) shih te GJUH/Ë, ~A I. I rrëshqitën (i shkanë) këmbët dikujt shih te SHKAS. Ka rrëshqitur (ka lajthitur) nga mendja ka luajtur mendsh. I rrëshqiti (i shkau) shëndeti dikujt shih te SHËNDET, ~I I. I rrëshqet (i shket, i dridhet, i luan, i lëviz) toka (trualli) nën këmbë shih te DRIDHEM.
- RRËZË** I f. Është nga rrëza vjet. është nga lagjet e skajshme të qytetit, është nga lagjet e të varfërve, është i varfër (thuhej në të kaluarën me mospërfillje nga shtresat shfrytëzuese për të shfrytëzuarit). Në rrëzë të veshit shih te VESH, ~I. Ai është në rrëzë të dardhës shih te DARDH/Ë, ~A. Nuk ka majë pa rrëzë fj. u. askush a asgjë nuk mund të ecë përpara pa pasur një themel të shëndoshë; nuk ka zhvillim pa një mbështetje të shëndoshë.
- RRËZOHEM** vetv. Është rrëzuar (një herë) nga dardha dikush shih te DARDH/Ë, ~A. U rrëzua (ra, zbriti) nga fiku iron. shih te FIK, ~U. Iu rrëzua (i ranë) pendët (puplat) shih te PEND/Ë, ~A I. U rrëzua kali, t'i presim këmbët! iron. shih te KAL/Ë, ~I.
- RRËZOJ** kal. E rrëzoi (e hodhi) me një gisht shih te GISHT, ~I. I rrëzoi këmbët dikujt e lodhi shumë, e bëri të ecte poshtë e përpjetë sa u këput. Rrëzon (shemb) malet dikush shih te SHEMB. E rrëzuan (e zbritën) nga piedestali dikë libr. shih te PIEDESTAL, ~I. E rrëzoi (e hodhi) në pluhur dikë a diçka shih te PLUHUR, ~I. E rrëzoi (e la) pykë shih te PYK/Ë, ~A. Një dru e shtrembër rrëzon (prish) gjithë stavën fj. u. shih te STAV/Ë, ~A.
- RRI** jokal. 6. Jam në një gjendje të caktuar; qëndroj (edhe në një varg njësisht frazeologjike). Rri gati. Rri zgjuar. Rri urtë. Rri pa gjumë. Rri shkujdesur. Rri fshehur. Rri hapur është hapur. Rri varur. Rri në pusi (në pritë). Rri në pritje pres. Rri në errësi (në diell). Rri i mërzitur (i zemëruar). Rri me frikë (me gjak të ngrirë). Rri me gojë hapur. Rri si gyp. Rri si mbi gozhdë. shih te GOZHD/Ë, ~A. Rrinë (ndër) grepa. shih te GREP, ~I. Rri mbi thëngjij. shih te

THËNGJI/LL,~LLI. Rri si i ngrirë (si hu, si pulë e lagur). Rri si mbi gjemba.

7. Qëndroj pa bërë diçka, nuk lëviz; nuk punoj, pushoj; nuk veproj (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Rri kot. Rri duarkryq (duarlidhur, me duar në ijë, me duar në gji) rri pa punë, nuk punoj; nuk veproj. Rri pa punë (pa folur, pa ngrënë, pa pirë). Ha, pi e rri. Nuk rri në një vend lëviz vazhdimisht. Rri, mos fol! Rri të rrimë. Rri me duar në xhepa. Rri e mban murin. Ujë të rri, qelbet. fj. u.

8. fig. Mbjaj një qëndrim të caktuar kundrejt dikujt a diçkaje; sillem në një mënyrë (edhe në një varg njësisish frazeologjike). I rri rëndë. I rri kundër e kundërshtoj. I rri me hundë (me turinj, me inat). I rri (tërë) hundë e buzë. Rri mënjane nuk marr pjesë, nuk përzihem në diçka. Rri me buzë. shih te BUZ/Ë,~A. I rri si dadë dikujt shih te DAD/Ë,~A. I rri me fyt dikujt shih te FYT,~I. I rri kallkan dikujt shih te KALLKAN,~I. I rri nuse. shih te NUS/E,~JA. I rrinte qiri (me këmbë) dikujt shih te QIRI,~U. I rri sus. shih te SUS.

Aty më rri! thjeshtligj. shih tek ATY. I rri (i qëndroj) afër (pranë) dikujt shih tek AFËR 6. Rri në cingali shih te CINGALI,~A. S'i rrinë duart (rehat) shih te DOR/Ë,~A. Rri (qëndron) gatitu përpara dikujt shih te GATITU. I rri gjel dikujt shih te GJEL,~I. Rri gjemb shih te GJEMB,~I. I rri gjemb dikujt shih te GJEMB,~I. Rri në hije shih te HIJ/E,~A. I rri me këmbë dikujt shih te KËMB/Ë,~A. I rri (i qëndroj) mbi (në) kokë (krye) dikujt a diçkaje shih te KOK/Ë,~A. I rri (i qëndron) kokërr shih te KOK/ËRR,~RRA. S' rri në kuvend dikush shih te KUVEND,~I. I rri (i qëndron) larg shih te LARG 5. Më rri mendja diku ose te dikush a te diçka e kam vazhdimisht mendjen diku ose te dikush a te diçka; nuk më hiqet nga mendja. Rri mriiz shih te MRIZ,~I. I rri përsipër dikujt a diçkaje shih te PËRSIPËR. I rri poshtë

dikujt shih te POSHTË. I rri në qime dikujt shih te QIM/E,~JA. Rri në tokë! iron. shih te TOK/Ë,~A. Rri (qëndron, mbeti, ngeci, ngeli, numëron, bën hapa) në vend shih te VEND,~I. E drejta rri si vaji mbi ujë fj. u. shih te DREJT/Ë,~A (e) 5. Rrinte si beu në kashtë tall. shih te KASHT/Ë,~A. I rri çekan (çekiç) mbi kokë shih te ÇEKAN,~I. Rri (qëndron) mbi dy karige keq. shih te KARRIG/E,~IA. Rri (rron, jeton, është) në hijen e dikujt keq. shih te HIJ/E,~A. Rri me gisht në këmbëz (e mban, e ka gishtin në këmbëz) shih te KËMBËZ,~A. Rri me gojë mbyllur shih te MBYLLUR. I rri me grushte hundëve dikujt keq. shih te HUND/Ë,~A. S' rri gjeli mbi vezë shih te GJEL,~I. I rri me hanxhar në dorë shih te HANXHAR,~I. Nuk rri iriqi në plis fj.u. shih te PLIS,~I I. Rri (është) jashtë valles shih te VALL/E, ~JA. (Më) rri si murga në linjë shih te MURG/Ë,~A. I rri punës përsipër si vaji mbi uthull shih tek UTHULL, ~A. I rri sofa gjithnjë shtruar dikujt shih te SOF/ËR,~RA. Me sa rri sorra me dy hunj shih te SORR/Ë,~A. I rri shpatë mbi kokë dikujt shih te SHPAT/Ë,~A. Rri si shushunja në hi shih te SHUSHUNJ/Ë,~A. Rri (mbeti, bën) në vend numëro shih te NUMËROJ. Nuk e di se ku rri me shtëpi shih te SHTËPI,~A. Si rri gjuha prapa dhëmbëve (s'i zë gjuha vend ndër dhëmbë) shih te GJUH/Ë,~A 1. Rri (qëndron) këmbë mbi (përmbi) këmbë shih te KËMB/Ë,~A. Kur rri (kur fle) koka, lëviz gjuha fj. u. shih te KOK/Ë, ~A. Ngrihu prift të rrijë (të ulet) hoxha! shih te PRIFT, ~I I. Të rrimë shtrembër e të flasim drejt! fj.u. shih te SHTREM-BËR. Thesi bosh (i zbrazur, pa gjë) s' rri (s'qëndron) më këmbë fj.u. shih te THES,~I.

RRICË f. Rricë më rricë buzë më buzë, plot e përplot. U bë rricë e pa veten shumë ngushtë, u mblodh e u bë lëmsh nga frika.

RRIKË I f. bot. I lë rrikën dikujt ia ngarkoi fajin a gabimin dikujt tjetër, ia hedh fajin

- tjetrit.
- RRIP** m. Rrip daulleje shih te DAULL/E,~JA. Rrip transmisioni libr. mjet që shërben për të përçuar vijën politike në masat e gjera dhe për t'u lidhur ngushtë me to (për organizatat e masave kundrejt partisë). I lëshoj rripin dikujt shih te LËSHOJ. Ia liroj rripin dikujt shih te LIROJ. Ia mblodhi (ia shtrëngoi) rripat (frerin) dikujt shih te MBLEDH. Shtrëngoi (mblodhi) rripin (rripat) shih te MBLEDH. Shtrëngo rripat! shih te SHTRËNGOJ. E bëri rrip daulleje dikë a diçka shih te DAULL/E,~JA. U bë rrip daulleje u deh keq, u bë tapë. Mbeti rrip daulleje mbeti pa gjë fare, i humbi të gjitha, u varfërua krejt. Ka humbur rripin e këmborës shih te HUMB. Iu këput rripin i pallës i ra krenaria dhe mburja e tepruar, i ra hunda.
- RRIPË** f. Ai i rripave euf. djalli, shejtani, ai i përroit. Përpara rripë e prapa thikë keq nga të dyja anët, vështirë andej e vështirë këtej. Mori rripën mori tatëpjetën. Mori rripat (skërkat) iku, u arratis, mori malet.
- RRIQËR** f. zool. Iu bë rriqër (rrodhe) shih te RRODH/E,~JA. Është rriqër të qepet e të thith gjakun pa u ndier.
- RRISKË** f. Punonte për riskën e fëmijëve punonte për bukën e fëmijëve, për bukën e gojës, për një copë bukë.
- RRIT** kal. Ia rrit fjalën dikujt keq. ia miraton e ia përkrah ato që thotë pavarësisht nëse e ka mirë ose jo, ia ushqen fjalën. Ia rrit mendjen (ia rrit veshët) dikujt i bën lëvdata të tepruara, e bën të mburret e t'i pëlqejë vetja. Rrit (mbaj) gjarprin në gji shih te GJARP/ËR,~RI. Rrit sorrën të të nxjerrë sytë shih te SORR/Ë,~A.
- RRITEM** vetv. I është rritur lafsha dikujt shih te LAFSH/Ë, ~A. I është rritur mendja (hunda) dikujt është bërë mendjemadh. Është rritur me thërrime shih te THËRRIM/E,~JA.
- RRITJE** f. Sëmundje e rritjes shih te SËMUNDJ/E,~A.
- RRITUR** mb. I rritur me ajkë qumështi shih tek AJK/Ë,~A. I rritur (i ushqyer) me thelpinj arre shih te THELB,~I.
- RRJEDH** jokal. Rrodhën (u shpuan) qiejt shih te QIE/LL,~LLI. I rrodhën sytë shih te SY,~RI. Në mos rrjedhtë, pikon shih te PIKON. Ku ka rrjedhur, do të pikojë thuhet për dikë që ka qenë i pasur dhe ka rënë ekonomikisht etj., por vazhdon të gjejë ende disa mjete e mënyra për të pasur disa të ardhura, qoftë edhe të pakta. Më rrjedh (më lëshon, më shkon) goja lëng shih te LËN/G,~GU. Rrodhi (shkoi) gjaku rrëke (lumë) shih te RRËKE,~JA. I rrjedh goja mjaltë shih te MJALT/Ë,~I. Ka rrjedhur (ka kaluar) shumë ujë shih tek UJ/Ë,~I. Më rrjedh (më kullon, më pikon) zemra gjak shih te ZEM/ËR,~RA.
- RRJEDHË** f. E ka marrë rrjedha dikë a diçka po shkon gjithnjë keq e më keq, e ka marrë rryma, ka marrë të tatëpjetën.
- RRJEDHËS** mb. Llogari rrjedhëse fin. llogari e hapur që ka një ndërmarrje a një institucion në bankë, ku derdh e tërheq të hollat herë pas here.
- RRJEDHIM** m. Si (për) rrjedhim fj. ndërm. domethënë, në këtë mënyrë, rrjedhimisht, prandaj, pra. Si rrjedhim i ... nga, për shkak se, si pasojë e ...
- RRJEP** kal. Të rrjep të gjallë (të rrjep e të merr lëkurën) të shfrytëzon pa mëshirë; është krejt i pamëshirshëm e mizor; të merr shpirtin. E rropi të gjallë e rrahu keqas, i mori shpirtin. Është ther e mos rrip shih te THER. E rrjep morrin nga bishti është shumë dorështrënguar, kursen sa më s'bëhet.
- RROBË** f. I kam rrobat (e kam këmishën) në finjë shih te FINJ/Ë,~A. Ka veshur rrobat e zisë shih te ZI,~A 1. Shiti rrobat dhe lëkurën shih te SHES.
- RROC** palak. Me rroc e me koc me të gjithë njerëzit e vet, me farë e me fis; me të gjitha, me gjithçka ka. E shau me rroc e me koc e shau shumë rëndë, s'i la gjë pa thënë.

- RRODHE** f. bot. Iu bë rrodhe (rriqër) iu ngjit nga pas sa e mërziti, iu qep e nuk iu nda.
- RROGOZ** m. Punon (vepron) nën rrogoz vepron fshehurazi, pa u kuptuar e me dredhi, vepron prapa krahëve. Njeri i rrogozit njeri i thjeshtë, i shtresës së varfër të popullit; njeri që shtrohet gju me gju me popullin. U bë rrogoz
- RROJ** jokal. Rroftë sebepi iron. përdoret kur dikush shfrytëzon një shkak, një rast a një rrethanë çfarëdo për të bërë diçka ose për të nxjerrë ndonjë përfitim. Rroftë sa kungulli në brymë! iron. shih te BRYM/Ë,~A. Rron me hikrra shih te HIK/ËRR,~RRA I. Rron (edhe) në rrasë të gjallë shih te RRAS/Ë,~A. Na rrofsh për dimër, se për verë jemi vetë thjeshtligj. iron. shih te DIM/ËR,~RI. Rronte (jetonte) si gogla në ujë shih te GOG/ËL,~LA. Rronte me një shoshë lakra shih te LAKËR,~RA. Rron (jeton, rri, është) në hijen e dikujt keq. shih te HIJ/E,~A. Rronte në kurriz (në shpinë) të dikujt shih te KURRIZ,~I.
- RROK** kal. Rrok (rrëmbej) armët (pushkët) shih te RRËMBEJ. Sikur ka rrokur (ka rënë, ka kapur) qiellin me dorë shih te QIE/LL,~LLI.
- RROKULLIMË** f. Gur në rrokullimë në gjendje të vështirë, kur nga çasti në çast mund të ndodhë një e keqe, në buzë të greminës.
- RROKULLISEM** vetv. U rrokullis tenxherja e gjeti kapakun shih te TENXHER/E,~JA.
- RROL** m. Rrol e korb shumë i zi.
- RROPULLI** f. vet. sh. Me fëmijë e me rropulli me të gjithë e me të gjitha ç'ka në shtëpi, me njerëz, me laçka e me plaçka.
- RROTË** f. Rrota e fatit vjet. libr. ngjarjet e rastit e të paparashikuara në jetën e njeriut. Rrota e historisë libr. zhvillimi objektiv i ngjarjeve historike që ecin gjithnjë përpara. I ka lyer rrotën dikujt keq. shih te LYEJ. Hedh (vë) gurë në rrota shih te GUR,~I. I vë (i fut) shkopinj në rrota shih te SHKOP,~I. I zuri rrota (qerrja) bishtin shih te BISHT,~I. I venë punët në katër rrota i ka punët shumë mirë, i shkon mbarë çdo gjë.
- RROTULL** Vjen rrotull (rreth) dikush lëviz kot, sillet pa bërë asnjë punë. Vjen rrotull (rreth, anës) për shi (për dëborë) është gati të fillojë shiu (dëbora). E sjell rrotull (vërdallë) dikë e mbaj me fjalë dikë dhe nuk ia plotësoj një nevojë a një kërkesë që ka; e heq për hunde. Ia sjell (ia bie, ia hedh) fjalën rrotull (larg e larg) nuk ia them drejtpërdrejt, nuk i flas hapur. I vjen (i sillet) rrotull (rreth, vërdallë) dikujt
- RROTULLOJ** kal. Rrotulloj në mend e mbaj në mendje gjatë diçka, duke e parë nga anë të ndryshme, e rrah gjatë me mend.
- RROTULLUES** mb. tek. Shat rrotullues shih te SHAT,~I.
- RROZGË** f. Iku rrozga me bjezga shih te BJEZG/Ë,~A.
- RRUAJ** kal. I rruan bishtin dikujt thjeshtligj. shih te BISHT,~I. Të rruan pa lagur
- RRUAZË** f. La rruazën diku shih te LË. Si rruaza në pe stisur bukur, lidhur e radhitur bukur. Shtie (fut) rruaza në pe dikush shih te PE,~RI. Zuri rruazën (qafën, zverkun) keq. shih te ZË. Lule rruaze bot. shih te LUL/E,~JA.
- RRUDH** kal. Rrudh buzët (hundët, turinjtë) lëviz buzët (shtrembëroj fytyrën) për të shprehur pakënaqësi, mospërfillje a përbuzje për diçka. E rrudhi (e shtrëngoi) dorën shih te SHTRËNGOJ. E rrudhi gojën e mbajti veten që të mos thotë fjalë të rënda a të pahijshme, matet mirë kur flet, e mbajti gojën. Rrudhi (mblodhi) krahët (supet) mblodhi krahët për të treguar se nuk e di a nuk e kupton diçka. Rrudhi (ngrysi, mblodhi) vetullat (ballin) u vrenjt në fytyrë, u ngrys. Ia rrudhi penjtë dikujt nuk e la të vepronte si të donte, ia mblodhi rripat. Ia rrudhi zemrën dikujt e bëri të humbiste shpresat; e pezmatoi.

- RRUDHEM** vetv. I janë rrudhur trutë ka rrjedhur nga trutë, është matufosur.
- RRUFE** f. Si rrufe (si bubullimë) libr. shih te BUBULLIM/Ë, ~A. Bën be e rrufe shih te BE, ~JA. Nuk bie rrufeja (reja) në hithra fj. u. mospërf. shih te HITH/ËR, ~RA.
- RRUFULL** f. E bie rrufull dikë
- RRUGË** f. Rrugë (udhë) pa krye shih te KRYE, ~T. Rruga (udha) e mesme zgjidhje që përpiket të jetë në mes të dy anëve të kundërta pa anuar as nga njëra as nga tjetra; mënyrë veprimi që synon të shmangët nga të kundërtat ose t'i pajtojë ato. Rrugë (udhë) e verbër (qorre) shih te VERBËR (i,e). I bëj (i lëshoj, i hap) rrugë (udhë) dikujt tërhiqem përpara dikujt a diçkaje, mënjanohem, e lë të lirë të veprojë si të dojë. E bën rrugë (udhë) diçka përhapet më tej; gjen përkrahje, gjen mbështetje.
- RRUHEM** vetv. Doli si rruar, qethur mbeti pa asgjë; doli nga një punë pa fituar asgjë. Dhëndri rruhet në fund shih te DHËND/ËR, ~RI.
- RRUMB** m. I ka humbur rrumbi dikujt shih te HUMB. E ka humbur rrumbin e këmborës shih te HUMB. E humbi rrumbi kabanën është bërë rrëmujë e madhe, nuk e merr vesh i pari të dytin.
- RRUMBULL** m. U bë rrumbull u deh keq, piu sa u bë tapë, u rrumbullo. Ia tha rrumbull i tha hapur në sy atë që mendon, ia tha troç.
- RRUMBULLAK** mb. Fjalë rrumbullake fjalë që nuk zënë vend.
- RRUMBULLAKËT** mb. Bota është e rrumbullakët fj. u. i thuhet dikujt për t'i treguar se përsëri mund të takohemi me të për një çështje ose se gjendja mund të kthehet në të kundërtën. Tryezë e rrumbullakët shih te TRYEZ/Ë, ~A.
- RRURËZ** f. Si dashi me rrurëzën shih te DASH, ~I.
- RRUSH** m. Si rrushi e koshi janë njësoj, si njëri edhe tjetri. I bëri (paratë, të hollat) rrush e kumbulla i prishi të gjitha, i shpenzoi kot e me dorë të lëshuar. Kur të bëjë larushku rrush iron. shih te LARUSHK, ~U. E bëri rrush e prush e bëri me nxitim e jo mirë, e bëri shkel e shko. S'bëhet rrushi deng (s'bëhet deng me rrush) fj.u. është gjë që s'bëhet, është e pamundur. Kërkon rrush (dardha, thana, thanëza) në dimër (në shënëndre) shih te DARDH/Ë, ~A. Kur s'ke rrush, ha edhe larushk fj.u. shih te LARUSHK, ~U. Shkoi (u vra) si qeni në rrush (në vresht) shih te QEN, ~I. Sheh rrushi rrushin (fiku fikun) e piqet fj.u. Marrin shembull njëri nga tjetri, vepronë siç bëjnë të tjerët.
- RRUSHKULL** m. bot. U bë rrushkull u varfërua shumë.
- RRYMË** f. Ecën kundër rrymës vepron në mënyrë të pavarur, në drejtim të kundërt me shumicën, u kundërvihet mendimeve e veprimeve të të tjerëve, që mbizotërojnë në një kohë. E mori rryma shkoi padashur me të tjerët, iu nënshtrua pa kundërshtuar mendimeve e veprimeve të të tjerëve, e mori vala. Shkon pas rrymës bën si bëjnë edhe të tjerët, nuk vepron në mënyrë të pavarur, u përshtatet mendimeve dhe veprimeve të të tjerëve, që mbizotërojnë në një kohë.
- S
- Sa s'... gati sa, pothuaj, desh, mend.
- SA** Aq sa shih tek AQ. ...e sa diçka më tepër, edhe pak mbi atë sasi (pas një numërori: Njëzet e sa ditë). Për sa ... lidhur me atë që... Sa e sa... shumë, një numër të madh e të përsëritur shumë herë.
- SABAH** m. vjet. Lule sabahu bot. Lule mëngjesi.
- SAC** m. I vuri saçin dikujt e vuri në një gjendje shumë të vështirë, e ngushtoi. Ia hoqi saçin dikujt e shpëtoi nga një shqetësim i madh, e çliroi nga një hall i madh, bëri që ta ndiejë veten të qetë. Është saç pa prush nuk ka vlerë të plotë, sepse

- i mungon diçka e domosdoshme; nuk të mbaron punë, megjithëse ka mundësi; është pemë pa kokrra.
- SAHAN** m. Lëpin sahanët (çanakët) e dikujt keq. shih te LËPIJ. I ka sahanët pa kapak shih te KAPAK,~U.
- SAHAT** m. bised. Një sahat (orë, çast) e më parë shih tek OR/Ë,~A I. Punon si sahat punon shumë mirë, në mënyrë të përpiktë. Vete (ecën, shkon) puna sahat shkon puna shumë mirë, çdo gjë bëhet në kohën e duhur. Iu bë sahati mot dikujt iu duk sikur nuk po shkonte koha, mezi pritë, u lodh a u mërzit duke pritur. E pa sa ishte sahati iron. e mori vesh, e kuptoi si qëndronte puna. Ç'sjell sahati nuk sjell moti fj. u. në një çast mund të ndodhë diçka shumë e rëndë; e keqja mund të bëhet në çast. I bie ora (sahati) gjithnjë dymbëdhjetë (shtatë, tetë) shih tek OR/Ë,~A I. Lule sahati bot. shih te LUL/E,~JA.
- SAKAT** mb. bised. Sakat nga mendja (nga trutë) i metë nga mendja, me të meta mendore.
- SALLATË** f. Grin sallatë (lakër) flet kot, flet në erë. Ia bëri mendjen (trutë, kokën) sallatë e trullosi, e bëri që të mos marrë vesh çfarë thuhet a çfarë ndodh, ia prishi mendjen. Ia bëri trupin sallatë dikujt mospërf. e copëtoi, e griu me thikë a me hanxhar, e bëri copë-copë.
- SALLHANE** f. vjet. Qen sallhaneje (rrugësh, sokaku, zorrësh) shih te QEN,~I.
- SAMAR** m. Kërcu përmbi samar shih te KËRCU,~RI. Shalë mbi samar shih te SHAL/Ë, ~A. Ia ndreqi (ia rregulloi, ia ujdisi) samarin (bërroren, kurrizin, shpinën) dikujt shih te NDREQ. Po e vret samari dikë iron. po e shqetëson diçka që i kanë thënë, po e djeg fjala që ka dëgjuar. S'e ka vrarë samari (këpuca) shih te VRAS. I erdhi fundi me samar e përfundoi jetën keq, me vuajtje e mundime. Ia bëri samarin copë
- SANITAR** mb. Kordon sanitar shih te KORDON,~I.
- SAPUN** m. Flluskë sapuni diçka pa vlerë ose pa baza, që zhduket shpejt e pa lënë gjurmë. Sapun mbi gunë shih te GUN/Ë,~A. Sapun pa shkumë shih te SHKUM/Ë, ~A. Janë si sapuni me shparcën shih te SHPARC/Ë, ~A. E hëngri (e mori) sapunin për djathë shih te DJATH/Ë,~I. E shet sapunin për djathë shih te DJATH/Ë, ~I. Lule sapuni bot. shih te LUL/E,~JA.
- SARDELE** f. zool. U bënë sardele janë ngjeshur shumë, shtrënguar në pak vend.
- SASIOR** mb. Analizë sasiore kim. studim i përbërjes së një lënde, duke përcaktuar sasinë e elementeve që përbëjnë.
- SATËR** mb. E vuri kokën në satër për dikë a për diçka u betua me kokë për dikë a për diçka.
- SE** Më se... në shkallën më të tejme të asaj që është, plotësisht, krejt, shumë (p.sh. Është më se e vërtetë (e drejtë). Ishte më se i bindur.). Se mos... përdoret për t'i dhënë shprehjes një ngjyrim dyshimi, mospranimi ose përbuzjeje, ironie.
- SEBEP** m. bised. vjet. Rroftë sebeci! iron. shih te RROJ.
- SEDËR** f. Vuri sedër vuri të gjitha forcat për të bërë diçka sa më mirë a për të mos u turpëruar. Ha (vë) sedër me dikë shih te HA.
- SEDIJE** f. E bën në sedije dikë a diçka nuk e përfill fare.
- SEFTE** f. bised. Bëri sefte diçka
- SEHIR** m. bised. Për sehir sa për të kaluar kohën, pa bërë asnjë punë. Bën (mban) sehir keq. nuk merr pjesë, nuk ndihmon për një punë a për një fatkeqësi, rri duarlidhur kur duhet bërë diçka.
- SEND** m. E kanë lënë (e kanë lëshuar) sendet dikë ka mbetur pa gjë në shtëpi, s'ka gjë prej gjëje, s'ka me se të rrojë.

- SEPSE** Edhe sepse përdoret në krye të një fjalisë të varur lejore, që tregon se, pavarësisht nga rrethanat e ndryshme, nuk mund të ndalohet kryerja e veprimit të shprehur në fjalinë kryesore (p.sh. Edhe sepse kishte shumë punë, u tregua i gatshëm t'i ndihmonte).
- SERI** f. Lidhje në seri elektr. vendosja e rezistencave dhe e pajisjeve që punojnë me rrymë elektrike në mënyrë që rryma të kalojë medoemos varg nga njëra tek tjetra.
- SEVDA** f. bised. Ia ka sevdanë dikujt a diçkaje edhe moh. e shikoi me zili.
- SËMUNDJE** f. Sëmundje e rritjes dobësi ose e metë kalimtare në fillim të zhvillimit të dikujt a të diçkaje. Sëmundja e ligë epilepsia. Sëmundja e sheqerit mjek. shih te SHEQER, ~I.
- SËPATË** f. I ra (ia preu) me sëpatë i ra shkurt e në mënyrë të prerë, nuk la vend për diskutime e kundërshtime. Si lata, sëpata keq. shih te LAT/Ë, ~A I. Sëpatë pa bisht shih te BISHT, ~I. Ia shkrepë me sëpatë shih te SHKREP. U bë bisht sëpate shih te BISHT, ~I. Ra si sëpata pa bisht dikush ra si i vdekur përdhe. Bien sëpatat në një vend pajtohen mendimet e qëllimet. I ra sëpata në gur shih te GUR, ~I. I ra sëpata (luga, thika, sqepi, shpata) në mjaltë shih te MJALT/Ë, ~I. Mban (fsheh) sëpatën nën gunë shih te GUN/Ë, ~A. I priste fjalët me sëpatë fliste në mënyrë të prerë, nuk pranonte asnjë kundërshtim. E preu me sëpatë të madhe (me sëpatën e dardharit) ia preu shkurt e pa mëdyshje; nuk i bëri asnjë lëshim; nuk i dha mundësi të kundërshtonte ose të parashtronte arsyet e veta për diçka. Nuk i pret sëpata në një vend nuk thotë të njëjtën gjë, e ndryshon mendimin shpesh; flet kot e pa lidhje logjike, vend e pa vend. I mbeti lëkura në bisht të sëpatës dikujt nuk iu nda sëpata nga duart, mbeti gjithnjë duke prerë dru, mbeti tërë jetën druvar. I priste sëpata (palla, shpata, kordha) djathtas e majtas (nga të dyja anët) shih te PRES I.
- Shkoi (humbi) si sëpata pa bisht shih te BISHT, ~I. Është më i rëndë bishti se sëpata (sqepari) shih te BISHT, ~I. Është sëpatë me dy presa (me dy tehe) dikush është shumë i zoti e i shkathët. Kur shkoi lata, të shkojë edhe sëpata shih te LAT/Ë, ~A I. S'pritet lisi (druri) me një sëpatë (me një të rënë të sëpatës) fj.u. punët e vështira kërkojnë përpjekje e durim.
- SI** 2. Përdoret në njësitë frazeologjike që ndërtohen me anë të krahasimit. Si pulë e lagur. Si në shtëpi të vet. Si në (mbi) gjemba. Si në pëllëmbë të dorës. Së miu në qark. Si sorkadhe. Si nuse me tela. Si bilbil. Si peshku pa ujë. Si kofini pas të vjeli. I shpejtë si rrufeja (si vetëtima). Si urdhëro usht. shih tek URDHËROJ 5. Si e si me çdo mënyrë, me çdo kusht.
- SIDO** ndajf. Sido që përdoret për të lidhur një fjali lejore me fjalinë kryesore p.sh.: Sido që ishte shumë i zënë, e pranoi edhe punën tjetër. Sido që armiku ishte më i armatosur, partizanët e shpartalluan.
- SIKUR** Edhe sikur përdoret për të lidhur një fjali të varur lejore me fjalinë kryesore në kuptimin «edhe po të ...», edhe në qoftë se ... À» (p.sh. Edhe sikur të vonohet, do ta presim. Edhe sikur të bjerë shi, do të dalim të punojmë).
- SILLEM** vetv. U soll e u mbështoll dikush shih te MBËSHTILLEM. Më sillet (më vjen) rrotull (rreth) diçka shih te RROTULL. I sillet (i vjen) rrotull (rreth, vërdallë) dikujt shih te RROTULL. I sillet (i vjen) festja (takija) rrotull (vërdallë) shih te VËRDALLË. Sillet si kali në lëmë mospërf. shih te KAL/Ë, ~I. Sillet si lëmshi në shoshë shih te LËMSH, ~I. Sillet kot rreth (rreth e qark) dardhës dikush shih te DARDH/Ë, ~A. Sillet nga sillet, bie në kunj e lidhet shih te KUNJ, ~I.
- SIMITE** f. I nxjerr si simitet nga furra e prodhon a e përgatit diçka shpejt e shpejt, pa i kushtuar kujdes cilësisë. E humbi si Xhaferi simiten shih te HUMB.

- SIMPATIK** mb. Bojë simpatike lëng pa ngjyrë, që bëhet i dukshëm vetëm pasi të ngrohët dhe që përdoret për të shkruar diçka të fshehtë.
- SINAP** m. bot. Shtohet (është) si fara e sinapit (e hithrës, e lirit) shih te FAR/Ë,~A.
- SINI** f. E kishte sininë gjithnjë plot e kishte gjithnjë sofrën shtruar për njerëzit e shtëpisë e për mysafirë, e kishte sofrën plot. T'u gëzoftë sinia! ur. e paç gjithnjë sofrën plot e me të gjitha të mirat.
- SIPËR** Sipër e sipër në mënyrë të përciptë, përciptas; sa për të kaluar radhën. I rri sipër tregon kujdes të madh për dikë a diçka; i rri mbi krye. E trajtoi në kalim (e sipër) diçka shih te KALIM,~I.
- SIPËRFAQE** f. Del në sipërfaqe bëhet e dukshme, del në shesh.
- SIRTAR** m. E futi (e vuri) në sirtar diçka keq. e la pa zgjidhur një punë a një çështje që ia kishte paraqitur dikush me shkrim.
- SISË** f. Po nuk qau fëmija, nuk i jep nëna (e ëma) sisë (gji, të pijë) fj. u. shih te QAJ.
- SIT** kal. Shosh e sit e mos gatuaj shih te SHOSH.
- SITË** f. E kaloi në sitë diçka e shqyrtoi diçka me imtësi ose pa lënë të kalojnë gjëra të dëmshme a të rrezikshme. Shosha shosh, sita sit fj. u. shih te SHOSH/Ë,~A. E vunë në sitë e në shoshë dikë e vunë në lojë, e tallën, e përqeshën.
- SJELL** I kal. Këtu ma solli (ma solli këtu) shih te KËTU. E solli në biçim dikë a diçka shih te BIÇIM,~I. E solli me bisht dikë shih te BISHT,~I. E solli çarku shih te ÇARK,~U.
- SKAJ** m. Skaj më skaj në çdo anë, në çdo cep, kudo; cep më cep. I doli në skaj punës ariti ta kryejë mirë një punë, i doli në krye. Nuk ia dinte skajin mallit (pasurisë) ishte shumë i pasur.
- SKELET** m. Skeleti i tokës bujq. pjesa e tokës që përbëhet nga gurët, zalli dhe rëra e trashë.
- SKELETOR** mb. anat. Tokë skeletore bujq. tokë me taban të cekët e me përqindje të lartë gurësh e zalli, tokë zallishte.
- SKENË** f. Prapa skenës keq. fshehurazi nga sytë e botës, pa e marrë vesh të tjerët.
- SKËRKË** f. Mori skërkat (rripat) shih te RRIP/Ë,~A.
- SKËRMIT** kal. I skërmiti (i kërciti) dhëmbët dikujt iu kërcënua ashpër, i foli me kërcënim.
- SKËTERRË** f. I zi skëtterrë shumë i zi, i zi sterrë.
- SKLLOP** II m. E bëri skllop diçka e zbuti shumë duke e rrahur me diçka a duke e zier, e squlli.
- SKORT** m. zool. Hedh skortin të zërë troftën kërkon të fitojë diçka të madhe duke dhënë si shpërblim diçka me vlerë fare të vogël a krejt pa vlerë.
- SKRA** f. Është bërë skra është dobësuar shumë, është tretur e tharë.
- SKULPTUROR** mb. Grup skulpturor art. shih te GRUP,~I.
- SKUQ** kal. Ia skuqi veshët dikujt
- SKUQEM** vetv. Si skuqet faqja (fytyra) edhe poh. nuk e zë turpi, nuk ka turp, është i pacipë. Skuqet (fërgohet, tiganiset, cingariset) me dhjamin e vet shih te DHJAM/Ë,~I.
- SKUTINË** f. kryes. sh. Që në skutina që në foshnjëri, që në shpërgënj, që në djep.
- SMALT** m. Bojë smalti bojë vaji me shkëlqim të posaçëm, që formon një cipë të fortë e që thahet shpejt.
- SOCIAL** mb. Asistenca sociale hist. organizëm i ngritur në vitet fill pas Çlirimit për të ndihmuar të dëmtuarit nga lufta dhe shtresat e varfra. Ushqimi social shih tek USHQIM,~I.

- SOFËR** f. E gjeti sofrën shtruar e gjeti çdo gjë të gatshme, nuk u mundua vetë për asgjë. S'kishte gjë në sofër ishte shumë i varfër, ishte fare i këputur. Nuk lë gjë në sofër s'lë gjë pa ngrënë, përulan çdo gjë, është llupës i madh. Nuk lë gjë për sofër është shumë i shkathët për punë, bën çdo gjë, nuk ua përton punëve të shtëpisë. Rri si macja nën sofër shih te MAC/E,~JA. I rri sofra gjithnjë shtruar dikujt pret e përcjell miq vazhdimisht, është shumë mikpritës. Sofrën shtroje edhe me bukë e kripë (e qepë)! fj. u. mikun prite me atë që të kesh!
- SOKAK** m. bised. Fjalë sokaku (rrugësh) fjalë që thuhet poshtë e përpjetë, thashetheme. Këlyshë sokaku mospërf. fëmijë me edukatë të keqe që bredhin rrugëve, fëmijë rrugësh, rrugaçë. Qen sokaku (rrugësh, zorrësh, sallhaneje) mospërf. shih te QEN,~I. Mori sokakët filloi të bredhë andej e këtej pasi është larguar nga shtëpia a nga një vend; mori udhët. E hodhi në sokak e flaku në rrugë; e hodhi në mes të katër rrugëve. Mori sokakun përpjetë u ngjit lart, u rrit shumë pa pasur ndonjë pengesë. E dinë (e morën vesh) edhe gurët e sokakëve (e rrugës) shih te GUR,~I.
- SORRË** f. zool. Si sorrat pas kërmës keq. me lakmi a me dëshirë të madhe. Me sa rri sorra në dy hunj (si sorra në dy hunj) asnjëherë, kurrë, kurrën e kurrës. E pagoi si prifti sorrën pagoi shumë shtrenjtë, e pagoi si frëngu pulën. Kur s'ke pulën, ha (edhe) sorrën shih te PUL/Ë, ~A. S'na i ka çukitur (s'na i ka ngrënë, s'na i ka pirë) sorra (pula) mendtë nuk e kemi humbur mendjen, nuk jemi aq të marrë a aq budallenj që të mos e marrim vesh, të mos e kuptojmë diçka. Rrit sorrën të të nxjerrë sytë i bën mirë një mosmirënjohësi. Sorra sorrës (korbi korbit) s'ia nxjerr sytë të këqijtë ose njerëzit e një grupi a të një tafari e mbrojnë njëri-tjetrin.
- SOSEM** vetv. bised. Iu sos jeta (fryma) shih te JET/Ë,~A. Nuk soset (nuk thahet) deti me lugë fj. u. shih te DET,~I.
- SOT** ndajf. Ndonjëherë si sot shih te NJËHERË. Sot për sot për sa i takon kohës së tanishme; në rrethanat e tanishme, tani për tani;
- SPANGO** f. I lëshoi spangon diçkaje shih te LËSHOJ.
- SPATHI** mb. Doli si fanti spathi shih te FANT,~I.
- SPEC** m. U bë spec (piper) u zemërua shumë e menjëherë, i hipi inati menjëherë. U bë spec (u kuq) në fytyrë u skuq fort (nga zemërimi, inati etj.). Punë me spec punë e lidhur me vështirësi dhe me kokëçarje e të papritura; diçka me pasoja të rrezikshme. Shaka me spec shaka që mund të ketë pasoja të rënda, shaka me zarar. U zunë (u grindën) për pesë para spec shih te PARA,~JA.
- SPECIFIK** mb. Pesha specifike përpjesëtimi i diçkaje në një tërësi; roli ose vendi që zë diçka në një tërësi.
- SPICË** f. I kalli spicat dikujt shih te KALL I.
- SPIK** m. I hoqi spik jetës bënte jetë shumë të mirë.
- SPILC** m. Është ndër (në) spilca
- SPIRANCË** f. det. Ngriti spirancën (çengelat) u nis, u largua.
- SPOL** m. Kishte me spol kishte me shumicë, me grushte (për paratë). U bë spol u deh keq, u bë tapë.
- SPORT** m. (Sa) për sport për të kaluar kohën, pa ndonjë arsye të rëndësishme a pa nevojë, kot.
- SPRIJË** f. Ka sprijën (shiritin, tenjën) në bark dikush shih te SHPIRT, ~I.
- SQEP** m. Nuk i ra në sqep edhe poh.
- SQEPAR** m. Është më i rëndë bishti se sqepari (sépata) shih te BISHT,~I.
- SQEPKUQ** mb. Korb sqepkuq zool. shih te KORB,~I.
- SQETULL** f. Me qefin nën sqetull (ne kokë) shih te QEFIN,~I. Nuk mbahen dy kunguj (dy shalqinj) nën një sqetull (në një dorë) shih te KUNGULL,~I.

- STAFETË** f. Ia dorëzoj (ia lë) stafetën dikujt shih te DORËZOJ.
- STALLË** f. Stallë (thark) derrash keq. shih te DERR,~I.
- STAN** m. Stan pa qen vend ku hyhet e dilet pa rregull, han. Stan vorbash mospërf. shih te
- STATUJË** f. Rri (qëndron) si statujë rri (qëndron) i ngrirë në vend, pa lëvizur, si i shtangur.
- STATUT** m. Statuti themeltar kushtetuta.
- STAVË** f. Një dru e shtrembër rrëzon (prish) gjithë stavën fj. u. një njeri me sjellje të keqe dëmton një kolektiv të tërë.
- STEKË** f. Stekë bilardoje shak. njeri shumë i gjatë e i hollë.
- STËRDHËMB** m. I qiti stërdhëmbët e kërcënoi, i tregoi dhëmbët.
- STËRGJYSH** m. Gjysh stërgjyshi (katragjyshi) shih te GJYSH,~I.
- STËRLËNG** m. tall. Lëng stërlëngu (lëng pas lëngu) mospërf. shih te LËNG,~U.
- STIL** m. Në stil të gjerë në përpjesëtime të mëdha; në sasi të madhe; gjerësisht.
- STOP** pasth. bised. Bëri stop në vend e ndaloi plotësisht e menjëherë lëvizjen, nuk bëri më asnjë hap përpara.
- STRAJCË** f. Me kokë (me krye) në strajcë (në torbë, në trastë, në thes) shih tek TORB/Ë,~A.
- STRALL** m. Ku ha pula strall (gurë) shih te GUR,~I.
- STREHIM** m. Strehim politik e drejta e banimit dhe mbrojtja që i jepet një të huaji, i cili është larguar nga atdheu për të shpëtuar nga ndjekjet për shkak të bindjeve ose të veprimtarisë së tij politike.
- STROFULL** m. Nuk çon (nuk nxjerr, nuk qit) lepur nga strofulli shih te LEPUR,~I.
- STRUC** m. zool. Bën lojën e strucit libr. përpiqet të fshihet e të shpëtojë nga një rrezik në mënyrë krejt të papërshtatshme; mundohet t'i shmanget së vërtetës pa dobi. Diplomaci e strucit përpjekje për të mbyllur sytë para një çështjeje shqetësuese a të rëndë që e dinë të gjithë ose për të mos mbajtur qëndrim të prerë e të hapur.
- STUHI** f. Kush mbjell erën do të korrë stuhinë (furtunën) fj. u. libr. shih te MBJELL. Stuhi magnetike fiz. trazim i papritur i fushës magnetike të Tokës që shkakton lëvizje të parregullta të gjilpërës magnetike dhe çrregullime në radiondërlidhje.
- SUBJEKTIV** mb. Idealizmi subjektiv filoz. shih tek IDEALIZ/ËM,~MI 1.
- SUKULL** m. E ka bërë sukull e ka nënshtuar plotësisht dikë dhe e përdor si do vetë; e ka bërë leckë.
- SUP** m. I bie supeve (i rreh supet) dikujt shpreh miratimin për diçka, e merr me të mirë a i jep zemër dikujt, duke i rënë lehtë prapa krahëve; miraton e përkrah veprimet e dikujt. Marr mbi supe (mbi shpatulla, mbi vete) diçka shih te SHPATULL,~A. Ngre (çoj, mbledh, rruhd) supet shih te NGRE. E provoi mbi supe (mbi shpatulla, mbi kurriz) diçka e mësoi diçka drejtpërdrejt nga përvoja e vet, e përjetoi vetë. Sup me sup shumë afër njëri me tjetrin, të bashkuar për ta mbajtur e përkrahur njëri-tjetrin, krah për krah. I mori këmbët mbi supe (në krahë) shih te MARR.
- SURBULL** mb. Është bërë si veza (veja) surbull dikush është bërë i flashkët, i qullët e i mefshtë, është sqaqur.
- SUS** E bën sus e detyron të rrijë urtë e pa zë ose të sillet mirë. I rri sus dikujt i bindet plotësisht, pa asnjë kundërshtim, i rri qiri më këmbë.
- SUSTË** f. Me sustë vetvetiu, pa bërë asnjë punë a pa mundim fare.

- SY** m. (Mat, çmoj, përcaktoj) me sy (mat, çmoj, përcaktoj...) me hamendje, përafërsisht, jo me një masë të caktuar e në mënyrë të përpiktë. Në sytë e dikujt
- SYZE** f. vet. sh. I vë syze (gjyzykë) dikujt përpiket ta mashtrojë dikë, kërkon t'ia paraqitë diçka ndryshe nga ç'është në të vërtetë. E shikon (e sheh) me syze të errëta e sheh ose e paraqit gjendjen a një punë më të keqe se sa është në të vërtetë, e nxin punën. Gjarpër me syze (me gjyzykë) shih te GJARP/ËR, ~RI.
- SHAH** I m. Gur shahu dikush që vepron sipas dëshirave të një tjetri.
- SHAHEM** vetv. S'është për t'u sharë vlen edhe kështu siç është, nuk është i keq, është mjaft i mirë, nuk është për t'u hedhur poshtë. S'është as për t'u sharë, as për t'u lavdëruar nuk ka ndonjë vlerë të veçantë, por as ndonjë të metë të dukshme, nuk është as i mirë, as i keq.
- SHAJ** kal. Shan shtamba të zotin iron. shih te SHTAMB/Ë, ~A. Këtej të pi verën, andej të shan derën shih te PI.
- SHAJAK** m. E ka lënë shajak punën e ka lënë punën në një gjendje jo të mirë, e ka lënë keq. Me shajak e me dajak herë me të mirë e herë me të keq; edhe me kulaç, edhe me kërbac.
- SHAJTOJ** kal. Shajtoi nga mendtë u prish nga mendtë.
- SHAKA** f. Bëj shaka me diçka e marr me të qeshur; tallem kot e me dëm. Shaka me thepa shih te THEP, ~I.
- SHALË** I f. Iku me bisht ndër shalë përçm. shih te BISHT, ~I. Mori bishtin ndër shalë përçm. shih te BISHT, ~I. I shtie prush në shalë dikujt shih te PRUSH, ~I.
- SHALË** II f. Shalë mbi samar barrë a detyrë e re, e një shkallë më të lartë, të cilën ia ngarkojmë dikujt që është i zënë me shumë punë të tjera dhe nuk e përballon dot.
- SHALQI** m. bot. Nuk mbahen dy shalqinj (dy kunguj) nën një sqetull (në një dorë) fj. u. shih te KUNGULL, ~I. Të ha shalqirin e të rreh me lëkura është mosmirënjohës, ha bukën dhe përmbys kupën.
- SHAMATË** f. Bëri shamatë për diçka kundërshtoi me të madhe, duke bërë shumë zhurmë. Nuk i bëj shamatë dikujt nuk e trazoj, nuk i flas, e lë në punën e tij, nuk ndihem.
- SHAMI** f. Dogji shaminë shih te DJEG.
- SHAP** I m. kim. E ha (e merr) shapin për sheqer e kujton si të mirë diçka që nuk është aspak e tillë, e merr sapunin për djathë. Ndjaj shapin nga sheqeri dalloj të padobishmen nga e dobishmja; dalloj të keqen nga e mira a të drejtën nga e padrejta; sqaroj një çështje që s'është e kthjellët, duke dalluar atë që është e vërtetë nga ajo që s'është e vërtetë.
- SHAPKË** I f. I heq shapkën (kapelën) dikujt shih te HEQ. Ka mizën nën shapkë (nën kësulë, nën feste) shih te MIZ/Ë, ~A.
- SHARË** as. S'ka të sharë dikush a diçka është shumë i mirë sa s'ke ç'i thua, s'ka asnjë cen a të metë.
- SHARTUAR** mb. I shartuar në degë i vrazhdë e i pasjellshëm; jo i arsyeshëm i krisur nga mendja, kokëkrisur. I shartuar në trung (në trup) i edukuar mirë, i sjellshëm, i urtë e i kuptueshëm.
- SHARRË** f. I ha sharra shih te HA. I ka prerë një sharrë janë të tërë njësoj. E sharroftë sharra! mallk. vdektë!, u shkretoftë! I vuri sharrën diçkaje e prishi diçka krejt, e shkatërroi. Është bërë për ta çarë me sharrë shak. është shëndoshur shumë. S'e kapte as sharra, as lima ishte shumë i varfër, ishte krejt i këputur. I zuri (i ndeshi, i hasi, i ra) sharra në gozhdë i doli përpara një vështirësi e pakapërcyeshme dhe e paparashikuar. I ngeci (i ngeli) sharra në gozhdë ngeci në vend nga një pengesë e pakapërcyeshme, nuk shkon dot më tej. Sharra që pret, shkëlqen edhe vetë fj.u. ai që mëson e ndihmon të tjerët,

- mëson e përfiton edhe vetë prej tyre. Lule sharrë bot. shih te LUL/E,~JA.
- SHARROJ** I kal. E sharroftë sharra! mallk. shih te SHARR/Ë,~A.
- SHAT** m. Merr shatë (toka) shih te MARR. Shat rrotullues disqe të dhëmbëzuara, të bashkuara në një bosht e të përkulura të gjitha nga njëra anë, që përdoren për të thyer koren e tokës. Një shat ujë sasi uji për ujitje aq sa kalon në një vijë. E mban shatin në ujë dikush shih tek UJ/Ë,~I. Veç shata e lopata do të na ndajë duhemi aq shumë, sa vetëm vdekja do të ndajë. Nuk i merr (nuk i ngre, nuk i pi, nuk i zë) shata (lopata) një shih te LOPAT/Ë,~A. Shati tërheq nga vetja fj. u. keq. thuhet për një njeri që mendon më parë a më shumë për të mirën e vet, për nevojat e veta.
- SHEJTAN** m. Është bërë si shejtani keq. është fëlliqur shumë, është ndotur i tëri. Ka lindur përpara shejtanit keq. ia kalon edhe shejtanit në djallëzi, është dinak i madh dhe shumë i prapë. Është i shejtanit e i mejdanit është i zoti të bëjë edhe keq, edhe mirë, është i zoti për të gjitha punët. Shejtani (djalli, dreq) me brirë thjeshtligj. shih te BRI,~RI. Ia bëri pajë shejtanit (dreqit) shih te PAJ/Ë,~A I. Ka bërë shkollën e shejtanit keq. ka mësuar të gjitha djallëzitë e ligësitë. E shtie (e fut) shejtanin (djallin) në shishe shaka. shih te SHISH/E, ~JA. I ka hyrë shejtani (djalli, dreqi, macja, maçoku) në bark shih te BARK,~U. E ka shejtanin (djallin, dreqin, macen, maçokun) në bark shih te BARK,~U. Ikën (largohet, ruhet) si shejtani (si djalli) nga temjani shih tek TEMJAN,~I. Ia ka shitur shpirtin shejtanit keq.
- SHEKE** f. I ushtojnë sheket (kadet, hambarët) shih tek USHTON.
- SHEKULL** m. Shekulli i artë (koha e artë) shih tek ARTË (i,e).
- SHELQËROR** m. Plori e shelqërori shih te PLOR,~I.
- SHEMB** kal. Shemb (rrëzon) malet dikush është shumë i fuqishëm, bën punë të mëdha, nuk ka pengesë që ta ndalojë.
- SHEMBEM** vetv. Nuk u shemb dynjaja! mo-spërf. nuk u prish bota!, nuk u bë kiameti!, punë e madhe! U shemb qielli shih te QIELL,~I. Sikur qielli të shembet (të përmbysset) shih te QIELL,~I.
- SHEMËR** f. E do si djalin e shemrës iron. nuk e do fare, s'e sheh dot me sy, e urren.
- SHENJË** f. Sipas shenjave... me sa duket..., sipas gjithë gjasave... I bie në shenjë (i bie shenjës) gjej pikërisht atë që kërkohet, prek thelbin e çështjes. Qëlloi (goditi) në shenjë zbuloi dhe kritikoi pikërisht burimin e një të mete, të një gjendjeje të pakënaqshme etj. Qëlloj aty ku duhej, vuri gishtin në plagë. Humbi pa shenjë (e pa dukë) humbi, u zhduk pa lënë asnjë gjurmë. Janë shenjat që ka shumë mundësi që jep shenjë (shenja) tregon një farë gjallërie, bën një farë lëvizjeje. Jep shenja për tregon se është i aftë për një punë a për një veprimtari, tregon se do të bëjë diçka. Ka shenja që... ka shumë mundësi që... E ka marrë (në) shenjë dikë diçka i ka drejtuar goditje kundër dikujt a diçkaje, e sulmon vazhdimisht. E mban në shenjë dikë tregohet syhapur ndaj dikujt, prej të cilit mund t'i vijë ndonjë rrezik. Është (ndahet) në shenjë dallohet, shquhet ndër të tjerët nga një veti, nga aftësitë etj. Njeri në shenjë njeri i shquar, njeri që dallohet nga të tjerët për merita, për aftësi, për zotësi etj. I vë shenjën dikujt e dalloj dikë nga të tjerët për ti besuar një detyrë që kërkon aftësi e zotësi të veçantë ose për ta trajtuar ndryshe. E ka vënë (e ka) në shenjë dikë e vëzhgon, e ruan dhe e ndjek dikë si e si t'i gjejë rastin për ta kritikuar e për t'i bërë keq; e sulmon dikë vazhdimisht, e godet sa herë që ai gjen rastin. Nuk jep shenjë jete duket si i vdekur. Një shenjë (një nishan) pushke (dyfeku) larg shih te PUSHKË~A. Vë (heq) shenjën (vijën) e barazimit shih te BARAZIM,~I. U vë shenjë fjalëve të dikujt u vë mendjen

fjalëve të tij, i kam parasysht gjithmonë; i marr me gjithë mend.

SHENJTË mb. Me frymën e shenjtë iron. si me magji, si me anë të një fuqie të mbinatyrshme. Lidhje e shenjtë libr., keq. lidhje e qeverive a e forcave reaksionare e kundërrevolucionare të disa vendeve, që ka për qëllim të shtypë luftën çlirimtare e lëvizjet revolucionare të masave popullore dhe të klasës punëtore (ashtu siç vepron Lidhja e Shenjtë e monarkëve të Rusisë, të Austrisë e të Prusisë për të shtypur lëvizjet revolucionare e çlirimtare në Evropë në fillim të shek. XIX).

SHEQER m. E lyen me sheqer diçka përpiket ta fshehtë thelbin e keq të diçkaje, duke përdorur fjalë të ëmbla e mënyra joshëse. Plumb me sheqer iron. helm i sheqerosur, thikë pas shpine. Nuk ra sheqeri në ujë! iron. nuk ndodhi ndonjë e keqe e pandreqshme, nuk u bë hataja, nuk u prish bota! Është sheqer i gjallë dikush është shumë i dashur e fjalëmirë me të tjerët, është shumë gojëmbël. Është top sheqeri është e shëndetshme, e bardhë dhe e bukur (për vajzat). E ha (e merr) shapin për sheqer shih te SHAP, ~I. E ka gojën sheqer është gojëmbël. E ka mjaltë e sheqer (mjaltë e qumësht, mjaltë e gjalpë) me dikë shih te MJALT/Ë, ~I. Ndaj shapin nga sheqeri shih te SHAP, ~I. Nxjerr (lëshon, derdh) mjaltë (sheqer) nga goja shih te MJALT/Ë, ~I. Kallam sheqeri bot. shih te KALLAM, ~I. Sëmundja e sheqerit mjek. sëmundje e shkaktuar nga tepria e glukozës në gjak; diabet.

SHEQERKË f. E ëmbëlsoi me sheqerka dikë e mori me të mirë dikë, me qëllim që ta gënjente, që të nxirrte përfitime prej tij. I dha një sheqerkë keq. i dha një bakshish a një dhuratë të vogël për ta marrë me të mirë, për ta bërë për vete. Sheqerkë me helm diçka që duket e mirë e joshëse nga jashtë, por që fsheh një rrezik të madh.

SHERBET m. E piu sherbetin mospërf. vdiq.

SHERR m. Për sherr për dreq. Për sherrin e dikujt a të diçkaje për shkakun e dikujt

a të diçkaje. Mollë sherrit libr. shih te MOLL/Ë, ~A. Më polli sherrit me dikë më gjeti belaja me dikë. Shikon për sherr kërkon të zihet me dikë. I bie sherrit prapa shih te PRAPA. E kërkon sherrin me qiri shih te QIRI, ~U. I mbiu sherrit midis hairit i ndodhi një e keqe e papritur.

SHES kal. Të shet e të blen është shumë i zgjuar, është shumë i shkathët e dinak. Shet e nuk blen flet vetë për t'u mbushur mendjen të tjerëve dhe nuk dëgjon fare se ç'thonë ata. Shet dije shet mend, hiqet si i ditur. E shet lart dikush mbahehet me të madh, është mendjemadh, e mban hundën përpjetë. Shet mend përpiket të tregohet më i ditur a më i zoti sesa është, mburret përpara të tjerëve. I shet kastravecë bostanxhiut shih te BOSTANXHI, ~U. E shiti lëkurën shtrenjtë u vra pasi e dëmtoi rëndë kundërshhtarin, ia pagoi shtrenjtë armiku. Shiti rrobat dhe lëkurën u vu kokë e këmbë në shërbim të dikujt për para a për përfitime të tjera vetjake. E shet sapunin për djathë shih te DJATH/Ë, ~I. E shet shkumën për ajkë shih te SHKUM/Ë, ~A. Ia ka shitur shpirtin shejtanit keq. shih te SHEJTAN, ~I. Ta shet ujin e pusit për verë shih te VER/Ë, ~A II. Djalli s'ka dele dhe shet lesh shih te DJALL, ~I. Shtëpinë shite, shokun mbaje! fj. u. për shokun e vërtetë mos kurse asgjë, miqësia e vërtetë s'ka të paguar. I zoti e shet, tellalli s'e jep fj. u. shih te ZOTI (i).

SHESH m. Shesh për shesh haptas, si burrat, sheshit. Del në shesh (në mejdan) bëhet e njohur, bëhet e qartë. Mori sheshin shih te MARR. Nxjerr në shesh zbuloj një gjë që mbahej e fshehtë a nuk dihej, bëj të njohur, shpall. Shesh armësh shih tek ARM/Ë, ~A. Në shesh të burrave shih te BURR/Ë, ~I. E bëri sheshin (dheun, fushën) breg mospërf. shih te BREG, ~U. Ia bëri shesh (fushë) me lule diçka shih te FUSH/Ë, ~A. Ra e drejta në shesh u bë drejtësi për të gjithë, u trajtuan të gjithë barabar, nuk u mbajt asnjë me hatër. Nuk i bie hunda në shesh

- dikujt shih te HUND/Ë,~A. I duken malet shesh i sheh punët me një sy tepër optimist, sepse nuk i njeh vështirësitë e pengesat dhe nuk e kupton gjendjen e vërtetë. S'është në shesh, po në thes shih te THES,~I. Ia nxori (ia qiti) lakrat në shesh shih te LAK/ËR,~RA. Nuk nxjerr (nuk qit) gjë në shesh (në treg) nuk arin të përfundojë diçka, s'nxjerr gjë në krye. I shkel këmba shesh (dyst) shih te SHKEL. Gjen shesh e bën përsesh bën si do vetë, sepse nuk e pengon njeri, përfiton nga rasti a nga rrethanat dhe silltet e vepron si i do qejfi.
- SHESHOJ** kal. I sheshoi udhën dikujt i hoqi pengesat, ia bëri më të lehtë që të arrijë një synim.
- SHESHTË** mb. Shtyp i sheshtë shtypshkr. mënyrë shtypi: shkronjat e radhitura a të derdhura e të faqosura, figurat, skicat etj. vendosen në një rrafsh horizontal.
- SHËLLIRË** f. Dhia e shëllirës dhia e vetme e të varfrit, nga e cila merrte pak qumësht. E luan gishtin e shëllirës (e lëngut) dikush shih te LUAJ.
- SHËNDET** m. Bëra me shëndet diçka hëngra për herë të parë në atë vit një pemë a një ushqim tjetër të stinës. I falem me shëndet shih te FALEM. Na la shëndetin (pendët) dikush mospërf. shih te LË. I lë shëndetin dikujt shih te LË. Mbaje me shëndet! iron. e deshe, vetë e ke fajin, prandaj rri urtë!, të qoftë! (për dikë që ka pësuar diçka jo të mirë nga pakujdesia ose për ndonjë arsye tjetër).
- SHËNDOSH** kal. I shëndosh kryet dikujt i shkoj dikujt për ngushëllim, i vete për kryeshëndoshë.
- SHËNDOSHËM** vetv. S'shëndoshet (s'majmet) kau ditën që do të theret fj. u. shih te KA,~U.
- SHËNDOSHË** mb. Farë e shëndoshë shih te FAR/Ë,~A.
- SHËNDOSHË** ndajf. Shëndoshë me grosh vjet. shih te GROSH,~I. Vafsh shëndoshë ti! shih te VETE. Mos e çoftë kryet (kokën) shëndoshë! mallk. shih te ÇOJ
- SHËNËNDRE** m. vjet. Dardha në shënëndre shih te DARDH/Ë,~A. S'bëjnë dardhat në shënëndre shih te DARDH/Ë,~A. Kërkon dardha (rrush, thana, thanëza) në shënëndre (në dimër) shih te DARDH/Ë,~A.
- SHËNJESTËR** f. usht. E ka vënë (e ka futur) në shënjestër dikë shih E ka vënë (e ka) të shenjë te SHENJ/Ë,~A.
- SHËTIT** jokal. E shëtit (e mat) me pëllëmbë shih te PËLLËMB/Ë, ~A. Shëtit sytë (vështrimin) hedh vështrimin andej-këtej, kullot sytë. Shëtit (bredh, shkon) lule më lule dikush keq. shih te LUL/E,~JA.
- SHFAROSJE** f. Kamp shfarosjeje kamp përqendrimi i ngritur nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore për asgjësimin e komunistëve, të kundërshtarëve të tyre politikë dhe të grupeve etnike.
- SHI** m. Si kërmijtë (si boblat) pas shiut mospërf. shih te KËRMILL,~I. Na kalbi shiu shih te KALB. Shiu i budallait shi i imët e i ngadalshëm që të bën qull pa e kuptuar. Shi e diell lagaterë. Bën shiun e diellin bën ç't'i dojë qejfi, i ka vetë në dorë të gjitha punët, vendos vetë për gjithçka pa pyetur njeri. Kur të bjerë shi i kuq kurrë, asnjëherë. I ka rënë shiu në lakra shih te LAK/ËR,~RA. Mbijnë (dalin) si kërpudhat pas shiut shih te KËRPUDH/Ë,~A 1. Iku nga shiu e ra në breshër (ra nga shiu në breshër) shpëtoi nga një e keqe, por e gjeti një e keqe tjetër më e madhe. Krimb shiu shih GLIST/ËR,~RA 1. Shi yjor astr. rënie me shumicë e meteorëve.
- SHIGJETË** f. E ka syrin shigjetë (pushkë) dikush shih te PUSHK/Ë,~A.
- SHIGJETULL** f. zool. Nuk hahen ato petulla që t'i jep (t'i sjell) shigjetulla fj. u. shih te PETULL,~A.
- SHIHEM** vetv. Siç shihet ndërm. përdoret për t'ia hequr karakterin kategorik një pohimi, duke e paraqitur atë jo si diçka që e themi ne, por si diçka që duket e kuptohet vetvetiu, ose për të përmbyltur një mendim a shtjellim idesh. U

pa shënim që vihet zakonisht në një shkresë, në një detyrë mësimore etj. nga dikush për të treguar se e ka shqyrtuar atë dhe ka bërë veprimet e nevojshme. Nuk është parë e as dëgjuar diçka nuk ka ndodhur ndonjëherë diçka e tillë. Janë parë hënabrenda shih te HËNABRENDA. Janë parë hënajashtë shih te HËNAJASHTË. Janë parë me hënë të keqe shih te HËN/Ë,~A. Janë parë me hënë pisk shih te HËN/Ë,~A.

SHIKIM m. Në shikimin e parë shih te PARË (i,e). Përfshij me një shikim (me sy, me një vështrim) shih te PËRFSHIJ 7. Treti shikimin (vështrimin) larg shih tek TRET.

SHIKOJ kal. Shikon (vështron) nën ballë shih te BALL/Ë,~I. Shikon derën (portën) pret me padurim të vijë dikush. Ta shikosh me dylbi! iron. s'ke për t'ia arritur që ta kesh a ta gëzosh, s'ke për ta parë kurrë. Shikon (sheh) larg shih te LARG. Shiko dhe prapa shih te PRAPA. Shikon (vështron) nga qofkat shih te QOFK/Ë,~A. E shikoj në sy (diçka) shih te SY,~RI. E shikonte me (nën) vetulla shih te VETULL,~A. E shikoj (e vështroj) në bebe të syrit shih te BEB/E,~JA II. E shikoj për fill e për fërkem shih te FILL,~I. Shikon (gjen) qimen në vezë (në të bardhën e vezës) shih te VEZ/Ë,~A. E shikon me syrin e njerks shih te NJERK/Ë, ~A. E shikoj me syrin plot dikë a diçka shih te PLOT. E shikon (e sheh) me syze të errëta shih te SYZE,~T. E shikon të vërtetën në sy shih te VËRTET/Ë,~A (e). Hap gojën e shikon qiellin shih te HAP. Shikon (sheh) qimen në syrin e tjetrit e nuk shikon (nuk sheh) trarin në syrin e vet shih te QIM/E, ~JA. Mos shiko (mos vështro) gjithnjë përpjetë, po shiko (vështro) dhe tatëpjetë! fj. u. shih tek TATËPJETË. Mos i shiko shkallët, por shikoj oborrin! (dikujt) fj. u. shih te SHKALL/Ë,~A. Mos i shiko shpatullat, por shikoj zemrën! fj. u. shih te SHPATULL,~A.

SHIRË mb. E gjeti lëmë të shirë e gjeti gati

diçka, nuk u mundua fare.

SHIRIT m. U bë (fare) shirit dikush u dobësua shumë, u tret, u bë kockë e lëkurë. Iu derdh si shirit iu turr me vrull e me shkathtësi, iu derdh si gjarpër (për ta goditur, për ta qortuar, për ta sharë). Iu bë buka shirit dikujt

SHIRK m. U bë shirk u fry së ngrëni; u bë kacek. E la shirk e vrau, e la të vdekur, e la shakull në vend. Si shirku (si kofini, si koshi) pas të vjelash (pas të vjeli) shih te KOFIN,~I.

SHISHE f. E shtie (e fut) shejtanin (dreqin, djallin) në shishe shak. është shumë i zoti, i shkathët e dinak, bën edhe atë që duket e pamundur. Ilaç i vjetër në shishe të re keq. shih tek ILAÇ,~I.

SHKAK m. Nga shkaku ... (me një emër ose me një përemër pronor a dëftor në r. gjinore) për arsye ..., si pasojë..., për faj... Për shkak... (me një emër ose me një përemër pronor të vetës së tretë në r. gjinore) nga. . . , për arsye..., si pasojë ..., për faj... Nga shkaku që... (se ...) ngaqë, sepse, duke qenë se. Për shkak se... sepse, ngaqë, duke qenë se ...

SHKALC m. krahin. E bënë për shkalc dikë e rrahën aq fort, sa nuk mund të qëndronte dot më këmbë a të ecte vetë. U bë për shkalc u lodh aq shumë, sa nuk qëndron dot më këmbë, u rraskapit.

SHKALLË f. Shkallë e thyer mospërf. shih te THYER (i,e). Aq i arrijnë shkallët dikujt aq i ka mundësitë ose aftësitë, nuk bën dot më shumë se aq, s'është i zoti për më tepër. Ra nga shkallët dikush

SHKAPET kal. Shkapet mendtë jap e marr me veten, vras mendjen.

SHKARPË I f. kryes. sh. U bë shkarpë

SHKAS jokal. I shkanë burgjitë (vidhat) dikujt ka luajtur nga mendtë, s'është më në vete, s'është më në terezi, lajthiti. I shkau nga duart (nga dora) dikush a diçka e humbi kontrollin mbi të, s'e zotëron dot më, nuk e ka më në dorë. Më

shkau (me rrëshqiti) gjuha (goja) shih te GJUH/Ë,~A 1. I shkanë (i rrëshqitën) këmbët (i shkau këmba) dikujt ka bërë një gabim dhe si pasojë humbi pozitën që kishte, ra. I shket pena dikujt është i zoti t'i hedhë në letër me lehtësi mendimet e veta; është i aftë për të shkruar artikuj a vepra të tjera. I ka shkarë syri dikujt e ka parë dhe e ka pëlqyer dikë, i është mbushur mendja për të. I shkau (i rrëshqiti) shëndeti dikujt shih te SHËNDET,~I 1. I shkanë (i kanë shkarë) trutë dikujt s'është më i aftë të arsyetojë e të gjykojë drejt e në mënyrë të shëndoshë, ka humbur qartësinë mendore, s'është në vete. I shkanë themelet dikujt a diçkaje nuk ka më një mbështetje të sigurt, ndodhet përpara shembjes, rënies, shkatërrimit a humbjes; nuk e ka jetën të gjatë. I shket

SHKEL kal. Di ku shkel dikush është i matur, është i kujdesshëm. I shkeli bishtin dikujt

SHKELM m. Hedh (qet, shtie) shkelma kundërshton me kokëfortësi e pa ndonjë arsye të shëndoshë për një punë a detyrë që i ngarkohet, nuk rri urtë, nuk bindet, hedh vicka. I dha shkelmin dikujt e dëboi dikë, e përzuri me zemërim e në mënyrë të vendosur. Punë me shkelma punë me pahir. Punon me shkelma punon vetëm po ta detyrosh me pahir a ta kërcënosh. I vuri shkelmin diçkaje e hodhi poshtë diçka, e prishi, e shkatërroi, e përmbysi. I bie së mirës (bukës) me shkelm (me këmbë) nuk e vlerëson a nuk e kupton si duhet gjendjen e mirë që ka ose një të mirë që i bëhet dhe heq dorë prej saj, duke dëmtuar veten. I ka vënë shkelmim (gjunjë) në bark dikujt e shtyp dhe e mundon pa mëshirë, e ka vënë nën zgjedhë të rëndë. I ka vënë shkelmin (këmbën, duart) në fyt (në grykë, në gjoks) dikujt e ka shtrënguar keq, e ka vënë në gjendje shumë të vështirë, po i merr shpirtin, i ka vënë litarin në grykë. Më mirë shkelmi se helmi fj. u. më mirë të ta thonë a të ta bëjnë të keqen hapur, sesa të të godasin tinëz e me të pabesë.

SHKELUR mb. Si i shkelur (si i shkuar) në dërstilë shih te DËRSTIL/Ë,~A.

SHKENCËTAR m. Shkencëtar kabineti keq. shih te KABINET,~I.

SHKËMB m. Si bletë shkëmbi shih te BLET/Ë,~A. Hedh farë në shkëmb (në ujë, në lumë, në det) shih te FAR/Ë,~A. Gjuha çan shkëmbin (gurin) fj. u. shih te GJUH/Ë,~A I. Qëndron si shkëmb graniti është i pathyeshëm e i papërkullur, qëndron i paepur.

SHKËMBEJ kal. Shkëmbeu (këmbeu, ndërroi, bëri) fjalë me dikë shih te FJAL/Ë,~A. Shkëmbeu hiçin me pluhur shih te PLUHUR,~I.

SHKËMBIM m. Në shkëmbim (me një emër në r. gjinore) në vend..., për të zëvendësuar diçka. Monedhë shkëmbimi (këmbimi) libr. mjet për të bërë allishverishe, matrapazllëqe a dallavere. Shkëmbimi (këmbimi) i lëndëve biol. tërësia e shndërrimeve kimike e biologjike që ndodhin në organizmat e gjallë gjatë përvetimit e shpërvetimit të lëndëve.

SHKËNDIJË f. Ndez shkëndijën shih te NDEZ. I lëshojnë (i bëjnë, i nxjerrin) sytë shkëndija (çika, xixa) shih te SY,~RI. Shkëndijat (shkëndijëzat) dalin në maj fj. u. çdo punë ka kohën e vet. S'ka ç'i bën shkëndija eshkës së njomë (së lagur) fj. u. për t'ia dalë në krye një pune nuk mjafton vetëm dëshira e mirë, por duhen plotësuar me kohë kushtet e nevojshme.

SHKËNDIJËZ f. Shkëndijëzat (shkëndijat) dalin në maj fj.u. shih te SHKËNDIJ/Ë,~A.

SHKOHET ishte larë e shkuar shih te LAHEM.

SHKOJ jokal. Sa s'ka ku të shkojë (ku të vejë) më (sa s'ka më) shih te KAM. Ishte larë e shkuar shih te LAHEM. Shkel e shko shih te SHKEL. Më shkon bic shih te BIC,~I. I shkon pas bishtit (i mban bishtin) shih te BISHT,~I. I shkoi bokë (puna) shih te BOK/Ë,~A. Shkoi (vajti) prapa diellit shih te DIELL,~I. Shkoi

(vajti) në djall shih te DJALL,~I. Në djall të shkojë (të vejë)! mallk. shih te DJALL,~I. I shkon (i vete, ia sjell) djath-tazi shih te DJATHTAZI. I shkon (i vjen) për dore (ndoresh) shih te DOR/Ë,~A. Si do t'i shkojë (si do t'i vejë, si do t'i dalë) filli dikujt a diçkaje shih te FILL,~I. Ka shkuar (është) në fije dikush shih te FIJ/E,~A. I shkon (i vjen) pas fjes (pas fillit) dikujt shih te FIJ/E,~A. Shkon (vete) firë shih te FIR/Ë,~A. I shkoi gand shih te GAND,~I. Shkon (vete) gjym shih te GJYM,~I. E shkoi në hell dikë shih te HELL,~I. Shkoi pa hoxhë dikush a diçka iron., vjet. shih te HOXH/Ë,~A. Shkoi huq shih te HUQ. I shkoi (i kaloi) koha dikujt a diçkaje është vjetruar, nuk është më i përshtatshëm, nuk përdoret më. I shkoi (i iku) koka shih te KOKË,~A. Më shkon lak shih te LAK,~U. Ka shkuar (ka vajtur) larg shih te LARG. I shkoi (i ra) lodra euf. shih te LOD/ËR,~RA. Më shkon (më vete) mendja për diçka shih te MENDJ/E,~A. Shkoj në mendje (ndër mend) diçka shih te MENDJ/E,~A. Më shkon ndër mend (në mendje) shih te MEND,~TË. Shkoj (vete) me mendje (me mendimin) se... shih te MENDJ/E,~A. Shkon (bën) përpjetë shih te PËRPJETË. I shkon për piri (e ka për piri) shih te PIR,~I. Shkoi (vajti) plep shih te PLEP,~I. Shkon (bën, merr) poshtë shih te POSHTË. Sa për të shkuar (për të kaluar) radhën shih te RADH/Ë,~A. Më shkon (më vete) syri te dikush a te diçka shih te SY,~RI. S'pa (udhën) nga shkoi (nga vajti) shih te SHOH. I shkon (i vete) për shtat dikujt shih te SHTAT,~I. I vjen për shtat dikujt shih te SHTAT,~I. I shkojnë (i venë) shtatë thjeshtligj. shih te SHTATË. Shkoi (iku) me të shumtët mospërf. shih te SHUMT/Ë,~I (i). Shkon tatëpjetë shih tek TATËPJETË. E shkoj tatëpjetë diçka shih te TATËPJETË. Shkoi te teshat shih tek TESH/Ë,~A. I shkojnë urov prej dikujt shih tek UROV,~I. Shkoi (doli) va pa va shih te VA,~U. Shkon (ecën) si në vaj shih te VAJ,~I.

Shkon në vend (fjala) shih te VEND,~I. Shkoi e vajti diçka

SHKOLLË f. Në bankat e shkollës në kohën kur dikush vijon mësimet në shkollë. Ka bërë shkollën e shejtanit keq. shih te SHEJTAN,~I. U ulën në bankat e shkollës shih tek ULEM. Shkollë e lirë ushtarake usht. shih te LIRË (i,e).

SHKOP m. U bë për shkop u plak sa nuk mund të ecë dot pa u mbështetur në shkop. Me një të rënë të shkopit si me magji, menjëherë e me lehtësi, pa u munduar e pa u përpjekur. Me shkopin magjik menjëherë e pa mundim, me një të thënë; si çudibërës. I bindet shkopit të dirigjentit (të dirigjuesit) libr. shih te DIRIGJENT,~I. Ka gjetur shkopin doçen keq. ka gjetur tenxherja kapakun. E ha barin pa shkop keq. vepron lirisht, nuk e pengon asgjë, livadhish. S'ia ha qeni shkopin shih te QEN,~I. E heq shkopin zvarrë është njeri i urtë, nuk trazon njeri, s'i bie njeriu në qafë. Ishte me plaçka në shkop shih te PLAÇK/Ë,~A. Vetë zot, vetë shkop shih te ZOT,~I II. I vë (i fut) shkopinj në rrota i nxjerr pengesa e ngatërresa, e pengoj në punën e tij, i nxjerr telashe. Kujto (zër në gojë) qenin, rrëmbe (bëj gati) shkopin fj.u. shih te QEN,~I. Shkopin, po e ndyve të tërë, s'ke ku e kap fj. u. shih te NDYJ.

SHKOTA f. vet. sh. krahin. Iu ndezën shkostat u inatos, u nxeh shumë. Mos m'i fryj shkostat! mos më mërzit, mos më inatos!

SHKRAP onomat. Nuk ia bën shkrap s'është i zoti për asgjë, nuk di asgjë, nuk ia shkrep fare.

SHKREH kal. Ngreh e shkreh shih te NGREH. S'e ka shkrehur ndonjëherë (pushkën) nuk ka rënë asnjëherë në përpjekje, nuk e njuh luftën, s'e ka zbratur ndonjëherë.

SHKREP kal. Ia shkrepin në fytyrë (në hundë, në tori) dikujt shih te FYTYR/Ë,~A. Pa e shkrepur një herë pa gjetur asnjë vështirësi; pa bërë as çak, as bam. Ia shkrepin me sëpatë ia tha sheshit, ia përplasi në fytyrë. Shkrep syrin shkel syrin.

I shkrepri një xixë i erdhi një mendim i ri në kokë. Është fishek që s'shkrep shih te FISHEK, ~U.

SHKRETËTIRË f. Zë në shkretëtirë libr. fjalë a mendim që nuk e dëgjon askush.

SHKRËNDUR mb. I shkrëndur nga trutë fare pa mend në kokë, budalla.

SHKRIF kal. Më shkrii zemrën më lehtësoi, më hoqi një brengë a një frikë.

SHKRIHEM I vetv. U shkri (u tret) si kripa në ujë shih te KRIP/Ë, ~A

SHKRIJ kal. Shkriu akulli shih tek AKULL, ~I. Shkriu (humbi, u zhduk) si vesa e mëngjesit (si vesa në diell) shih te VES/Ë, ~A.

SHKRIM m. Shkrimi i shenjtë fet. Â«Dhiata e reÂ» dhe Â«Dhiata e vjetërÂ», bibla.

SHKRONJË f. Shkruaj me shkronja të arta shih tek ARTË (i,e).

SHKRUAJ kal. Shih e shkruaj! punët duken qartë, s'ka nevojë për shpjegime, është siç e sheh. Ku ta shkruajmë këtë? iron. thuhet kur dikush, që njihet si i paaftë, si përtac etj., në një rast të rrallë e kryen mirë një punë dhe i habit të tjerët. E shkruaj në akull shih tek AKULL, ~I. Shkruaj me shkronja të arta shih tek ARTË (i,e). Shkroi një faqe të lavdishme (të ndritur) bëri një heroizëm, që do të mbetet i paharruar në histori. S'e shkruan (s'e vë, s'e fut, s'e shtie, s'e ka) në defter dikë a diçka edhe poh. shih te DEFTER, ~I. Vetë shkruan, vetë vulos bën si do vetë, nuk pyet për njeri.

SHKRUAR mb. E ka të shkruar në ballë shih te BALL/Ë, ~I.

SHKRUMB m. E bëri shkrumb e hi (hi, hi e pluhur) dikë a diçka shih te HI, ~RI. Iu bë goja (iu bënë buzët) shkrumb iu tha goja nga të nxehtët a nga ethet, iu zhurit goja, iu rreshkën buzët, u dogj për një pikë ujë.

SHKUAR mb. Si i shkuar (si i shkelur) në dërstilë shih te DËRSTIL/Ë, ~A. Koha e

shkuar gjuh. kohë në të cilën folja tregon se veprimi ose gjendja e shprehur prej saj është kryer para çastit të ligjërimit ose para një çasti të caktuar të së shkuarës.

SHKUL kal. E shkulëm barkun folëm e bërtitëm, po nuk na dëgjoji kush. I shkuli (i tundi) dhëmballët (dhëmbët) dikujt e detyroi dikë të përgjigjej gjer në një për një veprim a për një sjellje të padrejtë, e ndëshkoi rreptë. Shkul (përm-bys, pres) nga rrënjët (me rrënjë) shih te RRËNJ/Ë, ~A I. I shkuli (i hoqi, i tërhoqi, i zgjati) veshin (veshët) dikujt shih te VESH, ~I. Më shkuli zorrët nuk e duroj dot, më nxori zorrët, më vjen për të vjellë prej tij. Shkul një gur nga një mur (shkul një qime nga një derr) është shumë dorështrënguar, mezi e nxjerr lekun nga xhepi. E shkulën (e ngritën) me rrënjë e me degë shih te RRËNJ/Ë, ~A I. Ngul hunj e shkul hunj shih te HU, ~RI. Ngul qepë e shkul hudhra shih te QEP/Ë, ~A.

SHKULUR mb. Gardh i shkukur shih te GARDH, ~I.

SHKUMË f. Kapet pas shkumave (për shkumë) përpiqet kot. E ngau shkuma u tremb shumë, i ngriu gjaku. Ngopet me shkumë gënjehet kollaj, ngopet me lugë të zbrazët. Sapun pa shkumë diçka e padobishme, muhabet pa bulmet. Me shkumë në gojë me zemërim të madh, si i tërbuar. I doli shkumë nga goja

SHKUND kal. Aq munda, aq shkundi bëri atë që mund të bënte, aq e kishte fuqinë a aftësinë. Shkund pemët e të tjerëve rron duke zhvatur nga njëri e nga tjetri, rron në kurriz të të tjerëve. E shkundi qesen

SHKUNDEM vetv. M'u shkundën zorrët më griu uria, e kam barkun bosh. Tundet e shkundet mbahet me të madh, kapardiset.

SHKURT ndajf. I ra shkurt (një punë) e përfundoi shpejt një punë a një çështje, pa u thelluar dhe pa hyrë në hollësira. Gjykon (mendon) shkurt nuk gjykon thellë, nuk thellohet, nuk sheh larg. Shkurt hesapi... fj. ndërm.

SHKURTËR mb. I do drutë të shkurtra shih te DRU,~JA. I ka ditët të shkurtra nuk do të zgjatë shumë, nuk do ta çojë gjatë. I ka duart të shkurtra nuk ka shumë fuqi, pushtet a mundësi për të kryer një punë (zakonisht jo të mirë); nuk ka fuqi a mundësi për të shtënë në dorë diçka. I ka fjalët të shkurtra nuk e zgjat shumë, ta thotë prerë e shkurt. E ka qafën të shkurtër shih te QAF/Ë,~A. Gënjeshtria i ka këmbët të shkurtra fj. u. gënjeshtria zbulohet shpejt, del në shesh menjëherë.

SHKURTOHEM vetv. M'ë shkurtuan këmbët s'më mbajnë këmbët, më priten këmbët e nuk eci dot (nga pleqëria, nga sëmundja, nga frika etj.). Iu shkurtua (iu mblodh) litari (laku) shih te MBLIDHEM. Iu shkurtua drita e syve nuk sheh dot larg, iu dobësuan sytë (nga pleqëria).

SHKURTOJ kal. Ia shkurttoi (ia preu) dorën (duart) dikujt shih te DOR/Ë,~A. I shkurttoi (i preu, i thau) duart (dorën, krahun) shih te DOR/Ë,~A. Shkurtoje (preje) gjuhën! mjaft fole!, mos u bëj llafazan! Ia shkurttoi këmbët dikujt e ndëshkoi rreptë dhe nuk e lejon të shkelë më diku, që të mos bëjë dëme e të këqija. Shkurti shkurtton urët fj.u. në shkurt bën ftohtë dhe harxhohen shumë dru për zjarr.

SHLYEJ kal. E shleu (e fshiu, e shoi, e hoqi,) nga defteri dikë a diçka shih te DEFTER,~I.

SHLLIGË f. Shlligë (nepërkë) shullëri shih te SHULLË,~RI.

SHNDËRRIM m. Shndërrim algjebrik mat. veprimi me anën e të cilit një shprehjeje algjebrike ose një ekuacioni i jepet një formë tjetër. Shndërrim gjeometrik gjeom. veprimi me anën e të cilit një figurë gjeometrike kthehet në një figurë tjetër.

SHOH kal. Ke parë ti... fj. ndërm. përdoret kur shprehim habi për diçka që nuk e pritnim të ndodhte a që s'e kemi menduar. Pa ç'pa ... u shtrëngua të bëjë diçka kundër dëshirës së tij, s'kishte si

t'ia bënte ndryshe, s'e zgjati më. Shohim e bëjmë (duke parë e duke bërë) të presim një herë si do të vejë puna, të mos e vendosim që tashti, të veprojmë si të na mësojë puna vetë. Sheh përtej bjeshke (prapa malit) shih te BJESHK/Ë, ~A. Sa për Â«shihni botëÂ» sa për t'u dukur, sa për sytë e botës. Nuk ia ka parë derën dikujt nuk i ka shkëlur në shtëpi, nuk i ka vajtur kurrë. Pa dritën libr. u shtyp, u botua (për një vepër). I sheh me dylbi (gjërat) dikush shih te DYLBI,~A. E pafsha të ftohtë! mallk. shih te FTOHTË (i,e). E ka parë gulç shih te GULÇ,~I. I pa hairin dikujt a diçkaje shih te HAIR,~I. E sheh nën hundë dikë shih te HUND/Ë, ~A. Ka parë jetë ka jetuar mirë, nuk i ka munguar asgjë në jetë. Sheh (shikon) larg shih te LARG. I pa (i bleu) mendjen deshi të kuptonte se ç'mendonte për një çështje të caktuar, deshi të merrte vesh se ç'kishte ndër mend të bënte. Nuk e shoh dot me sy (s'dua t'ia shoh sytë) shih te SY,~RI. Ia pa sherrin dikujt a diçkaje shih te SHERR,~I 2. S'pa (udhën) nga shkoi (nga vajti) iku menjëherë e me nxitim, iku nga sytë këmbët, ia mbathi udhë pa udhë (nga frika etj.). Shih e shkruaj! shih te SHKRUAJ. I sheh edhe shpina shih te SHPIN/Ë,~A. Kur të shohë shpatullat (kurrizin, veshët, zverkun, qafën)! kurrë, asnjëherë, kurrën e kurrës. Sheh zi sheh vetëm anën e keqe të diçkaje, mendon vetëm për të këqijat që mund të vijnë nga diçka. I sheh (gjërat) bardhë e zi shih te BARDHË. Ulu (poshtë) se të panë! iron. shih tek ULEM. Ka parë botë (dynja) me sy ka shëtitur në shumë vende. Nuk sheh buallin para sysh shih te BUALL,~I. E ka parë diellin para teje ka lindur më parë se ti, di dhe ka më shumë përvojë në jetë se ti, sepse është më i madh. E pa sa ishte sahati shih te SAHAT,~I. Nuk sheh më larg (më tutje) se hunda e vet (përtej hundës së vet) shih te HUND/Ë,~A. Nuk pa i pari të dytin shih te PARË (i,e). Sheh puna punën shohim e bëjmë. E

pafsha në rrugë të madhe! mallk. shih te RRUG/Ë~A. E pashë me sytë e ballit (me këta sy) shih te SY,~RI. Mos i paktë syri keq! ur. qoftë gjithnjë i lumtur! Nuk i shohin sytë këtej nuk ia mban të vijë këtej, s'guxon të vijë. E sheh (e shikon) me syze të errëta shih te SYZE,~T. Pa vdekjen me sy gati vdiq, sa s'vdiq, rrezikoi jetën; vuajti shumë, u sfliti. Shih me sy e plas me zemër (shih me sy e s'është për ty) shih te SY,~RI. S'sheh syri, sheh mendja shih te SY, ~RI. Sheh tym e bën konak iron. shih tek TYM,~I. Sheh yllin e merr pyllin shih tek YLL,~I. Sheh (shikon) qimen në syrin e tjetrit e nuk sheh (nuk shikon) trarin në syrin e vet shih te QIM/E,~JA. E pafsha në (nëpër) dyert e botës (dyerve të botës)! mallk. shih te DER/Ë,~A. Dielli shihet (duket) që në mëngjes (që kur lind) fj. u. shih te DIELL,~I. Mos mburr degët pa parë rrënjët fj. u. shih te RRËNJ/Ë,~A. Sheh rrushi rrushin (fiku fikun) e piqet fj. u. shih te RRUSH,~I. Kur t'i hipësh kalit, shihi potkonjtë fj. u. shih te POTK/UA,~OI.

SHOK m. Është shok me para shih te PARA,~JA. Vëllezër jemi, shokë s'jemi mund të jemi vëllezër a të kemi lidhje gjaku të afërta, por mund të kemi ti-pare, veti, interesa, pikëpamje e synime të ndryshme dhe të mos shkojmë mirë njëri me tjetrin. Shtëpinë shite, shokun mbaje! fj. u. për shokun e vërtetë mos kurse asgjë, miqësia e vërtetë s'ka të paguar. Kush i bën varrin shokut, bie vetë brenda fj. u. shih te VARR,~I.

SHOKË f. Shoka e kumbarës krahin. ylberi.

SHOLLË f. I është bërë faqja shollë nuk ka më turp e sedër, nuk i bëjnë më përshlypje kritikata e qortimet, është i pacipë. I është bërë lëkura (e ka lëkurën) shollë është regjur e s'do t'ia dijë më për diçka, s'ndien më, s'pyet për fjalët, sharjet etj. I futi (i hodhi) një gur në shollë (në opingë, në këpucë) dikujt shih te GUR,~I.

SHOLLONDUR m. krahin. U bë shollondur u vra keq në shumë vende, u bë copë (kur

bie).

SHOSH kal. Shosh e sit e mos gatuj punon, por nuk nxjerr gjë në dritë. Shosha shosh, sita sit fj. u. shih te SHOSH/Ë,~A.

SHOSHË I f. Bën vrima në shoshë bën një punë pa vlerë, bën një vrimë në ujë. Është shoshë pa rreth ka një farë aftësie a vlere, por i mungon diçka, që e bën të padobishëm. Është shoshë e prishur shih te PRISHUR (i,e). Është shoshë e shpuar mospërf. shih te SHPUAR (i,e). Të jep ujë me shoshë

SHOSHIT kal. Mos e fut në hambar pa e shoshitur fj. u. mos e bëj mik dikë pa e njohur mirë!

SHPALOS kal. Shpalosi (ngriti) flamurin shih te NGRE.

SHPARCË f. Janë si sapuni me shparcën rinë gjithnjë bashkë, nuk ndahen kurrë. I shpëton shparca nga duart është shumë i dobët e i pafuqishëm; është plak i rrëgjuar që s'i punon dora e këmba.

SHPARGËR m. Sapo ka dalë nga shpërgënjtë mospërf. është ende i papjekur. Është ende në shpërgënj

SHPATË f. Mprehu shpatën shih te MPREH. E ndanë (e vendosen, e zgjidhën) me shpatë e zgjidhën diçka me anë të forcës e në mënyrë të prerë. Me shpatë në brez keq. shih te BREZ,~I. Me shpatë (me pallë, me thikë) zhveshur shih te ZHVESHUR. Shpata e Damokleut libr. rrezik i madh që i ri dikujt vazhdimisht mbi kokë. I tund shpatën (pallën) dikujt shih tek TUND. I ra shpata (sëpata, luga, thika, sqepi) në mjaltë shih te MJALT/Ë,~I. Është shpatë nga goja është i zoti në të folur, e ka gjuhën brisk. Është shpatë e gjallë është trim i madh e luftarak. Është shpatë e thyer shih te THYER (i,e). Është (qëndron) në teh (në presë) të shpatës (të briskut, të thikës) shih te TEH,~U. E ka gjuhën shpatë flet me zjarr për të mbrojtur një çështje; flet prerë e me të madhe. Ka mbaruar me liq e me shpatë shih te

LIQ,~TË. I pikon gjak shpata thuhet për dikë që ka vvarë njerëz të pafajshëm. I rri shpatë mbi kokë dikujt i rri gati dhe nuk e lë të bëjë ndryshe nga ç'dua unë, i bie kokës. E ka arsyen në majë të shpatës nuk ka të drejtë, po i zgjidh çështjet si do vetë, sepse është më i fortë se të tjerët. E ka ligjin në teh të shpatës vepron me anë të forcës, bën si do vetë. I priste shpata (palla, kordha, sëpata) djathtas e majtas (nga të dyja anët) shih te **PRES I**. Të jep kaun në vorbë dhe shpatën pa dorëz shih te **VORB/Ë,~A**. Lule shpatë bot. luleshpatë, shpatore.

SHPATULL f. I fërkon shpatullat (krahët, kurizin, shpinën, zverkun) dikujt keq. shih te **FËRKOJ**. I rreh shpatullat (krahët, supet) dikujt shih te **RRAH**. S'ka shpatulla për një punë nuk është i zoti për ta bërë një punë nuk e përballon dot. I mbajnë shpatullat mund ta përballojë një punë a një detyrë, ka aftësi për të bërë punë edhe më të mëdha e më të vështira. I ktheu (i solli) shpatullat (krahët, kurizin, shpinën) dikujt shih te **KTHEJ**. Të lan në shpatull

SHPEJT ndajf. Shpejt e shpejt

SHPEJTË mb. Me të shpejtë me nxitim; me vrap. I ka të shpejta nuk do ta shpjerë gjatë, do të marrë fund brenda një kohe të shkurtër; do të vdesë pas pak kohe. Ndihmë e shpejtë shih te **NDIHM/Ë,~A** 3.

SHPELLË f. Është shpellë e madhe është ngatërrestar i madh. Iu bë zemra shpellë u hidhërua shumë, u pikëllua nga një fatkeqësi shumë e madhe.

SHPEND m. zool. Ha qen e shpend shih te **QEN,~I**. Kolera e shpendëve veter. shih te **KOLER/Ë,~A**.

SHPENGUAR mb. I ka këmbët (duart) të shpenguara nuk e pengon njeri të bëjë diçka, është i lirë të veprojë, i ka duart të lira.

SHPËLAJ kal. Sa për të shpëlarë (për të larë) gojën iron. shih te **GOJ/Ë,~A**.

Ia shpëlanë kokën ia hoqën nga koka disa mendime a pikëpamje të gabuara që kishte. I shpëlau (i lau) duart nga i biri i iku i biri nga shtëpia e nuk kujdeset më për të (thuhet për prindërit). I shpëlau duart nga kazma (nga lopata, nga çekani, nga bishti i lopatës) iron. nuk punon më me kazmë (me lopatë, me çekan), ka hequr dorë nga puna e krahut. E shpëlaftë mortja (kolera)! mallk. e marrtë mortja, vdektë!

SHPËRDRIDHEM vetv. M'u shpërdrodh kërhiza më erdhi shumë ndot, më iku barku.

SHPËRTHEJ kal. Shpërthyen retë ranë shira të mëdha, u përmbysën retë, u zbraz qielli. Shpërtheu një derë (një portë) të hapur shih te **HAPUR** (i,e). I shpërtheu (i plasi) mina ndër duar shih te **MIN/Ë,~A**.

SHPËTOJ kal. I shpëtoi (i iku) nga dora (nga duart) shih tek **IKI**. Shpëtoj gjendjen gjej një rrugëdalje në një gjendje të vështirë, përballoj një gjendje të vështirë. Shpëtoi lëkurën e vet shih te **LËKUR/Ë,~A** 8. Shpëtoi për lik shih te **LIK,~U**. I shpëton shparca nga duart shih te **SHPARC/Ë,~A**. I shpëtoi (i iku) zogu nga dora shih te **ZO/G,~GU**.

SHPIE kal. E shpunë (e çuan) dardhë shih te **DARDH/Ë,~A**. Hedh (shpie) dëm diçka shih te **HEDH**. E shpuri (e çoi) fjalën për dikë a për diçka e zuri në gojë dikë a diçka, foli, e hodhi fjalën për dikë a për diçka. Nuk e shpie (s'e çon) më gjatë shih te **GJATË**. Ku të shpie (të çon) mushka! shih te **MUSHK/Ë,~A**. E shpie (e çoj) në vend (një fjalë, një urdhër, një porosi etj.) shih te **VEND,~I**. Shkonte nga (ku) e shpinin këmbët shih te **KËMB/Ë,~A**. Ia shpuri gojën te veshi shih te **GOJ/Ë,~A**. Shpie (bëj, vë) buzën në gaz qesh pak, buzëqesh. Shpie (çon) ujë në mullirin e dikujt shih tek **UJ/Ë,~I**. Shpie buzën vesh më vesh shih te **VESH,~I**. Të shpie (të hedh, të çon) degë më degë shih te **DEG/Ë,~A**. Të shpie (të çon) në njëqind (në dyzet) çezma (në krua, në

- shtatë kroje) e s'të jep ujë shih te **KRUA**, **KROI**.
- SHPIJ** kal. Shpij (mbledh) kockat shih te **KOCK/Ë,~A**.
- SHPINË** f. I fërkon shpinën (krahët, kurrizin, shpatullat, zverkun) dikujt keq. shih te **FËRKOJ**. I ha (i kruhet) shpina (kurrizi) dikujt shih te **KURRIZ**, ~I. E hedh pas (prapa) shpinës (krahëve, kurrizit) diçka shih te **KRAH,~U**. I hipi në shpinë (në kurriz) dikujt
- SHPIRT** m. Bir (djalë) për (në) shpirt bir (djalë) i adoptuar. Bijë (vajzë) për (në) shpirt bijë (vajzë) e adoptuar. Ia biroi shpirtin (zembrën) shih te **BIROJ**. Më doli shpirti u lodha e u këputa, u rraskapita; vuajta shumë, hoqa të zitë e ullirit. I doli shpirti (xhani, fryma) dikujt
- SHPIRTËROR** mb. At shpirtëror fet. prift që ndjek nga afër dhe drejton jetën shpirtërore e fetare të dikujt; prift, tek i cili rrëfehen rregullisht besimtarët (në vendet ku vepron feja e krishterë).
- SHPOHEM** vetv. Iu shpua kazani dikujt shih te **KAZAN,~I**. I është shpuar xhepi (kuleta) iron. i janë mbaruar paratë, s'i ka mbetur asnjë lek.
- SHPOJ** kal. E shpoj me bodec dikë shih te **BODEC,~I**. T'i shposh buzët shih te **BUZ/Ë,~A**. Më shpon (më vret) veshin (veshët) shih te **VESH,~I**. Më shpoi zemrën më preku thellë. Pika (cirka) shpon gurin fj. u. shih te **PIK/Ë,~A**.
- SHPORTË** f. U bë shportë u shpua, u bë vrima-vrima (për enët etj.). Shportë pa fund njeri që s'di të mbajë një të fshehtë e i shpërrallon fjalët andej-këtej. Shportë karavidhesh keq. shih te **KARAVIDH/E,~JA 2**. E hodhi në shportën (në koshin) e plehrave shih te **KOSH,~I**. E hodhi (e la) në shportën e lugëve diçka e mbajti të fshehtë diçka, nuk ia tregoi njeriu. Mbush (mban, merr) ujë me shportë (me shoshë) shih te **SHOSH/Ë,~A**. Vezët në shportë e shportën në dorë! fj. u. çdo gjë që ka rrezik të dëmtohet, duhet mbrojtur e siguruar në mënyrë të plotë, masat që merren për diçka, nuk duhet të jenë gjysmake. Kur dëgjon se ka shumë pemë, merr shportën e vogël fj. u. shih te **PEM/Ë,~A**.
- SHPREHJE** f. Ka shprehje libr. i shpreh qartë, bukur e në mënyrë tërheqëse mendimet e veta, flet bukur. I mungon shprehia libr. nuk di a nuk mundet t'i shprehë qartë e bukur mendimet e veta, flet në mënyrë të thatë e jotërheqëse.
- SHPRESË** f. Jep shpresë premtan se do të ecë përpara, se do të bëhet një njeri me vlerë në këtë ose në atë fushë. E gënjen shpresa shpreson më kot se...
- SHPUAR** mb. Daulle e shpuar keq. njeri llafazan e i padurueshëm, që flet shumë e s'bën asgjë. Gjym i shpuar diçka e pavlefshme, e dalë jashtë përdorimit. Legen i shpuar mospërf. llafazan i madh; ai që s'mban dot asnjë të fshehtë. Teneqe e shpuar mospërf.
- SHPUES** m. Shpuesi i frutave zool. insekt i vogël, me trup në ngjyrë qielli të errët, të mbuluar me qime të shkurtra e të rralla, i cili dëmton mollët, dardhët, kajsitë, pjeshkat, kumbullat etj.
- SHQEME** f. bot. Ç'i bën dhia shqemes, shqemja ia bën lëkurës fj. u. kush bën keq, gjen keq; ç'të bësh, atë do të të bëjnë.
- SHQEP** kal. Qep e shqep shih te **QEP**. Qep një pëllëmbë e shqep një pash shih te **QEP**.
- SHQERRË** f. Lule shqerre bot. luledele.
- SHQIM** kal. Ia shqimi derën ia fiku derën, ia shoi pragun.
- SHQIMEM** vetv. Iu shqim hisja nuk i mbeti asnjë mashkull në derë, iu shua dera.
- SHQIP** ndajf. Nuk ha shqip nuk merr vesh, nuk gjykon në mënyrë të shëndoshë e nuk bindet, s'ha kuvend.
- SHQIPONJË** f. Shqiponja dykrenore vizatim i një shqiponje me dy krerë në stemën dhe në flamurin e Republikës Popullore

- Socialiste të Shqipërisë. Shqiponja nuk ha miza fj. u. njerëzit e shquar nuk merren me çikërrima e me gjëra të ulëta.
- SHQIT** kal. Shqiti (hapi, shqeu) sytë shih te SHQYEJ. Nuk ia shqit (nuk ia ndan, nuk ia heq) sytë shih te SY,~RI.
- SHQYEJ** kal. Shqeu gurmazin u çor e u ngjir duke thirrur. Shqeu (hapi) sytë u habit së tepërmi, nuk u besonte syve për atë që shikonte.
- SHQYHEM** vetv. U shqye daullja
- SHTAGË** f. Shtagë arrash njeri i gjatë e shumë i dobët.
- SHTAMBË** f. I thyen shtambat u zunë e nuk flasin më njëra me tjetrën, e prishën miqësinë, nuk janë më shoqe (për vajzat e gratë). Bie shi me shtamba (me gjyma, me legenë, me ibrikë) shih te GJYM,~I. Bie shi me grykë shtambë (pusi, gjymi) shih te
- SHTAT** m. I bie për shtat dikujt
- SHTATANIK** mb. Shtatanik në bark shih te BARK,~U.
- SHTATAT** f. vet. sh. fet. vjet. Në brez i ka të shtatat vjet. i erdhi vdekja, s'i ka të gjata.
- SHTATË** num. them. Ia numëroi të shtata
- SHTATË** num. rresht. E mbushi (e kaloi) të shtatën e kaloi rrezikun, shpëtoi.
- SHTEG** m. Shteg më shteg rrugë e pa rrugë. I bëri shteg dikujt i hapi rrugën a portën dikujt, nuk e pengoi. Ma pruri (fjalën) në shteg më dha rast vetë që t'ia them. Ia di (mirë) shtegun (shtigjet) ia di anën, e di si ka nisur, si është zhvilluar e si mund të bëhet a të zgjidhet (për një punë a një çështje). Çaj shtigjet (rrugën, udhën) shih te ÇAJ. Hap shteg (shtegun) për diçka shih te HAP. I hap shtegun dikujt shih te HAP. Lë shteg për diçka (i lë shteg diçkaje) shih te LË. I mbyll shtegun (derën, portën, rrugën) dikujt a diçkaje shih te MBYLL. I pres shtegun (rrugën, udhën) diçkaje shih te PRES I.
- I doli (i erdhi) lepuri në shteg i shkoi mirë puna, i eci mbarë diçka, i erdhi fati përpara.
- SHTEGTOJ** jokal. I shtegton mendja dikujt i shkon mendja, i bredh mendja.
- SHTER** jokal. I ka shterur mendja përb. i kanë rrjedhur trutë. I kanë shterur (i kanë rrjedhur) trutë përb. shih te RRJEDH.
- SHTERP** mb. I doli shterpë (huq) shih te DAL. Kërkon qumësht nga delja shterpë (nga cjapi) shih te QUMËSHT, ~I.
- SHTET** m. Grusht shteti shih te GRUSHT,~I. Kundërgrusht shteti shih te KUNDËRGRUSHT,~I. Provimet e shtetit provimet përfundimtare që jepen në mbarim të një shkolle të lartë për të marrë diplomën përkatëse.
- SHTETËROR** mb. Kapitalizëm shtetëror shih te KAPITALIZ/ËM,~MI.
- SHTËNË** f. Me një të shtënë (me një gur) vret dy zogj shih të GUR,~I.
- SHTËPI** f. Ia ferrosi shtëpinë (derën) dikujt shih te FERROS. Na e harroj shtëpinë (derën) shih te DER/Ë,~A. E mbylli shtëpinë derën shih te MBYLL. Iu mbyll shtëpia (dera) shih te MBYLLEM. Ora e shtëpisë euf. shih te OR/Ë,~A II. Pa plëng e pa shtëpi shih te PLËNG,~U 1. Me shtëpi e bagëti me te gjitha, me laçkë e me plaçkë. Shtëpi publike shih te PUBLIK,~E 1. Shtëpi pa qira thjeshtligj. shih te QIRA,~JA. E zuri shtëpia (tavani) shih te ZË. I bëj rrëke shtëpisë sime shih te RRËKE,~JA. Iu bë shtëpia hithërishtë shih te HITHËRISHT/Ë,~A. U bë ishte shtëpi me themel shih te THEMEL,~I. I vuri kyçin (drynin, çelësin) shtëpisë shih te KYÇ,~I. I vuri (i hodhi) rezën shtëpisë (derës) shih te REZ/E,~JA. Iu vu ruba një (shtëpie) shih te RUB/Ë,~A. I zëntë shtëpia (oborri) bar! mallk. shih te BAR,~I I. Bën shtëpi në mes të udhës shih te UDH/Ë,~A. Po i hape derën, të rrëmben shtëpinë shih te DER/Ë,~A. Hyn e del si në shtëpinë e vet hyn e

del a vepron lirisht, s'pyet asnjëri. Prish shtëpinë e bën kasolle, prishë diçka shumë të vlefshme për të bërë diçka të parëndësishme, prish bucela e bën kënaçe. Hesapi i shtëpisë nuk del në pazar fj. u. shih te HESAP, ~I. I zoti e din ku i pikon shtëpia (çatia) fj. u. shih te ZOTI (i). Në shtëpinë e të varurit nuk e zënë në gojë litarin fj. u. shih te VARUR (i,e).

SHTIE kal. 11. edhe fig. E bëj dikë që të ndiejë diçka, i fut diçka në shpirt, e shpie në një gjendje shpirtërore të caktuar (zakonisht jo të mirë); fut, kall (edhe në një varg njësisish frazeologjike). I shtiu frikën (tmerrin, lemerinë, datën). Më shtiu krupën (të keqtë).

24. Përdoret së bashku me emra, zakonisht prejfoljorë e të paraprirë nga një parafjalë, dhe formon me ta togfjalësha me kuptimin e foljeve që kanë lidhje fjalëformuese me këta emra (edhe në një varg njësisish frazeologjike). E shtiu nën kontroll e kontrollon, e zotëron. E shtie në be e vë të betohet, e detyroj të bëjë be, e përbej.

Aq ia shtie (ai) aq është në gjendje të mendojë e të kuptojë, s'kupton më tepër, aq ia pret (mendja). Si ia shtie unë sipas mendimit tim, ashtu si ma pret mendja mua. I shtiu (i kalli) ethet dikujt shih tek ETH/E, ~JA 3. E shtie në amë shih tek AM/Ë, ~A 1. Ç'i shtie bar! përb. shih te BAR, ~I. Shtie me bathë tall. shih te BATH/Ë, ~A. E shtiu (e vuri, e futi) në bigë dikë shih te BIG/Ë, ~A. Shtien brinjët punojnë e lodhen pa masë, u këputen brinjët, u bien kockat. Shtie (fut) cita (fite, fitme, fitila, kalla, kunjja, spica) shih te FUT. Shtie çakthi mbi të tjerët shih te ÇAKTHI. Ka shtë në (ka hedhur) dashuri shih te HEDH. S'e shtie (s'e vë, s'e fut, s'e shkruan, s'e ka) në defter dikë a diçka edhe poh. shih te DEFTER, ~I. E shtiu (e futi) në dorë dikë a diçka shih te DOR/Ë, ~A 4. Shtie (qëllon) në hi shih te HI, ~RI. I shtiu këmbët e lodhi e e mundoi shumë, e këputi nga këmbët, i ranë këmbët. Shtie keq dikush fut fite. Shtiu (vuri, hodhi) kurorë vjet. shih te

KUROR/Ë, ~A. E shtie në mendje (në kokë) e ngulit mirë në mendje, e ngul në kokë. Ia shtie (ia fut) në (ndër) mend (në mendje) shih te MEND, ~TË. S'e shtie (s'e vë, s'e zë, s'e fut) në numër shih te NUM/ËR, ~RI. I shtiu pishat d i k u j t shih te PISH/Ë, ~A. E shtiu te plesh-tat dikë shih te PLESHT, ~I. I shtiu (i hodhi) prangat shih te HEDH. Mos e shtjer në pus! shih te PUS, ~I. E shtiu në rreth dikë shih te RRETH, ~I. Shtie (hedh, lëshon, zë, ngul) rrënjë shih te RRËNJ/Ë, ~A. Ia shtiu (ia vuri) syrin dikujt a diçkaje shih te SY, ~RI. Nuk ia shtie sytë nuk e përfill, nuk e be-genis. Shtie (hedh, qet) shkelma shih te SHKELM, ~I. Shtie shurdhat e bën veshin të shurdhër. Shtie tehri shih tek TEHRI, ~A. E shtiu (e futi) në thes (në grackë, në kurth, në tek, në kllapë) dikë

SHTIR kal. E shtiri lumin e hodhi lumin.

SHTJEKËZ f. Mbjaj syrin në shtjekëz jam vigjilent, qëndroj syçelë.

SHTJERRË f. zakon. sh. Kërkon shtjerrat e deshve shih te DASH, ~I.

SHTOG m. bot. Shtog i egër bot. shih SHTOG/ËR, ~RA 1.

SHTOGTË mb. Dyfek i shtogtë përçm. njeri që nuk është i zoti të mbarojë një punë, të zgjidhë një çështje etj.

SHTOHEM vetv. Sthohet (është) si fara e hithrës (e sinapit, e lirit) shih te FAR/Ë, ~A.

SHTOJ kal. Shton nga xhepi dikush shih te XHEP, ~I. Shto ujë e shto miell mospërf. e zgjat a e zvarrit një punë pa fund, duke e zmadhuar pa nevojë vëllimin e saj. Kali i mirë e shton (vetë) tagjinë fj. u. shih tek TAGJI, ~A.

SHTRAT m. I është bërë shtrat dikujt a diçkaje keq. i është bërë mbështetje, e përkrah dhe e mbron; i ka krijuar kushte të përshtatshme për të vepruar a për t'u zhvilluar. E la shtratin (krevatin, dyshekun, jatakun) u shërua. Është mbërthyer në shtrat shih te MBËRTHHEM. U ngrit nga shtrati (nga krevati,

nga dysheku, nga jataku) u shërua. I vuri krahet shtratit shih te **KRAH**,~U
3. Është (përpëlitet) në shtratin e vdekjes shih te **VDEKJ/E**,~A. Shtriji (zgjati) këmbët sa ke shtratin (jorganin, plafin) fj. u. shih te **JORGAN**,~I.

SHTREMBËR f. Ia ka me të shtrembër dikujt ia ka me hile, përpiket t'ia hedhë.

SHTREMBËR mb. Ka hyrë në rrugë të shtrembër ka marrë rrugë të keqe; ka hyrë në rrugë të gabuar. E ka (e sheh, e shikon, e vështron) me sy të shtrembër (të keq, të lig) nuk e vlerëson drejt, nuk e pëlqen; përpiket ta pengojë; nuk i do të mirën. Një dru e shtrembër rrëzon (prish) gjithë stavën fj.u. shih te **STAV/Ë**,~A. Tymi të shkojë drejt, pa le të jetë oxhaku i shtrembër fj. u. shih tek **TYM**,~I.

SHTREMBËR ndajf. E shikon (e sheh) shtrembër (vëngër) mban qëndrim jomiqësor ndaj dikujt a diçkaje, nuk i dëshiron të mirën, nuk e pëlqen. Të rrimë shtrembër e të flasim drejt! fj. u. sido që të jetë, duhet të themi të vërtetën, të themi atë që është, edhe pse s'na pëlqen.

SHTREMBËROJ kal. Shtrembëron (mbledh, tharton, rrudh, përdredh) buzët (turinjtë, hundët) shih te **BUZ/Ë**,~A.

SHTRENJTË mb. I lirë në miell, i shtrenjtë në krunde shih te **KRUNDE**,~T.

SHTRENJTË ndajf. E shiti lëkurën shtrenjtë shih te **SHES**.

SHTRESËZIM m. Shtresëzimi shoqëror teori sociologjike borgjeze, që i ndan njerëzit në shtresa shoqërore sipas moshës, seksit, racës, besimit fetar, nivelit arsimor, vendbanimit etj. dhe që ka për qëllim të hedhë poshtë parimet marksiste-leniniste të ndarjes së shoqërisë në klasa, të mohojë ligjin e luftës së klasave dhe të përjetësojë pabarazinë shoqërore.

SHTRËNGIM m. I jep shtërëngim vetes përpiket, mundohet shumë për të bërë diçka.

SHTRËNGOHEM vetv. U shtërëngua puna nuk mund të kalohet si përpara, nuk është më aq lehtë, është bërë e vështirë që të arrish a të bësh diçka. Më shtërëngohet zemra (shpirti, kraharori) kam një shqetësim të madh, ndiej diçka të rëndë në shpirt; më vjen shumë keq për dikë a për diçka, më dhemb zemra. Iu shtërëngua litari për gryke (në fyt) dikujt shih te **LITAR**,~I.

SHTRËNGOJ kal. I shtërëngoi burgjitë (vidhat, çivitë) dikujt e detyroi të sillet a të veprojë në një mënyrë të caktuar, ia mblodhi mirë. Ia shtërënguan darët dikujt e detyruan me forcë; ia mblodhën rripat. Ia shtërëngoi dizgjinët dikujt ia mblodhi, nuk e la të bënte sipas qejfit, ia mblodhi frerin. E shtërëngoi (e rrudhi) dorën nisi të kursejë më shumë, e përdor diçka më me kursim, u bë më i kursyer. I shtërëngoj dorën dikujt e uroj dhe e përgëzoj dikë për një punë të mirë që ka bërë; e përshëndet dhe e lavdëroj. Shtërëngon (kërcet) dhëmbët mbledh të gjitha fuqitë për të kryer një punë të rëndë a për të përballuar një gjendje të vështirë. Shtërëngon grushtet shih te **GRUSHT**,~I. Shtërëngoj këmbët shpejtoj, nxituj. Nuk e ka shtërënguar këpuca (ndonjëherë) nuk e ka ndier veten ngushtë ndonjëherë: s'ka qenë nevojtar, s'di ç'është skamja. Nuk ia vret (nuk ia shtërëngon) këpuca këmbën shih te **VRAS**. Ia shtërëngoi lakun dikujt shih te **LAK**,~U. Shtërëngoi puna duhet përfunduar a duhet zgjidhur sa më parë një punë, nuk pret më, nuk duron më. Shtërëngojmë (ngjeshim) radhët bashkohemi edhe më fort për të përballuar diçka. Shtërëngoi rripin u detyrua të jetoj me më pak mjete e më keq, në kushte më të vështira. Shtërëngoj rripat! bëhu gati!, qëndro!, trimërohu! Ia shtërëngoi (ia mblodhi) rripat (frerin) dikujt shih te **MBLEDH**. Ia ka shtërënguar vegjës (avlëmendit) i është futur punës si duhet, po punon me të gjitha forcat. E shtërëngoi veza shih te **VEZË**,~A. Ia shtërëngon dhëmbët nganjëherë e qorton rëndë a e rreh nganjëherë; ia mbledh

mirë, ia tregon qejfin. Ia shtrëngoi frerin gojës (gjuhës) shih te FRE,~RI. Shtrëngoje (mbaje) gjuhën pas (prapa) dhëmbëve (ndër dhëmbë, në mes të dhëmbëve) shih te GJUHË,~A 1,3.

SHTRIGË f. Kalë shtrigash (shtrige) zool. shih te KAL/Ë,~I. Zog shtrige (zog ferre, zog miu) zool. shih te ZOG,~U.

SHTRIJ kal. Shtriu dorën (duart) mbi (në) diçka u përpoq ta vinte në dorë, ta kishte për vete; u përzie në një punë që nuk i takonte, futi hundët. I shtriu (i zgjati) dorën dikujt

SHTROHEM vetv. U shtruan (u ftohën, u ulën, u shuan, u zbutën) gjakrat shih te GJAK,~U. Shtrohem (ulem) këmbëkryq me dikë e bisedoj një punë gjatë e gjerë dhe shtruar me dikë. Shtrohet këmbëkryq diku

SHTROJ kal. E shtroi në dru (në dajak) dikë e rrahu shumë, e shqepi së rrahuri, e shqepi në dru. Shtroi çipat me dikë zhduk mosmarrëveshjet, rrafshoj pikat e kundërta me dikë për t'u pajtuar me të. Shtroi gunën u sheshua diku për të ndenjtur gjatë e pa u bërë merak për asgjë; vajti në shtëpi të dikujt dhe ndenji një kohë të gjatë pa qenë i dëshiruar, i zuri derën dikujt. I shtroi (i ftohu, i uli, i shoi, i zbuti) gjakrat shih te GJAK,~U. Ia shtroi (e bëri dasmën) deri në gju shih te GJU,~RI. E shtroi nën havan dikë shih te HAVAN, ~I. Shtroj kuvend me dikë nis një bisedë të gjatë me dikë. Ia shtroi me lule shih te LUL/E, ~JA. E shtroi mendjen arriti në një përfundim të caktuar dhe mori një vendim për një çështje, e mblodhi mendjen dhe gjykon me gjakftohtësi. E shtroi (e uli) qafën (kurrizin) përb. shih te QAF/Ë,~A. Shtroj syrin marr shenjë. Edhe sikur të ma shtrojnë me flori shih te FLORI,~RI. Demin e shtron zgjedha fj. u. shih te ZGJEDH/Ë,~A. Si të shtrosh, ashtu të mbulojnë fj. u. si të sillesh me të tjerët, ashtu do të sillen edhe të tjerët me ty. Sofrën shtroje edhe me bukë e kripë (e qepë) fj. u. shih te SOF/ËR,~RA.

SHTRUAR mb. Me mendje të shtruar duke e parë punën me gjakftohtësi; i qetë, me mendje të mbledhur.

SHTRUAR ndajf. Gënjen (rren) shtruar (përtokë) gënjen në mënyrë aq të hollë e me gjakftohtësi të madhe, saqë të tjerët e besojnë. E gjeti lëmin shtruar shih të LËM/Ë,~I. E gjeti sofrën shtruar shih te SOF/ËR,~RA. I rri sofa gjithnjë shtruar dikujt shih te SOF/ËR,~RA. Guri që punon shtruar, bën miell të butë fj. u. njeriu këmbëngulës dhe fjalëpakë bën punë të mirë.

SHTRUNGË f. Si dhentë në shtrungë ngucur, rrasur, ngushtë; mbledhur bashkë shtrënguar e në mënyrë të çregullt. E futi në shtrungë dikë e shpuri dikë në një gjendje që s'ka nga t'ia mbajë, e detyroi të bëjë ashtu siç i thotë ai, e vuri nën urdhrat e veta. I erdhi në shtrungë i erdhi në shteg, i erdhi në dorë, e ka në dorë.

SHTRYDH kal. Shtrydh trutë (mendjen) mendohej fort për diçka, vras mendjen. Shtrydh sytë qaj me zor, me pahir. Më shtrydhi zemrën më preku thellë në zemër.

SHTRYDHUR mb. Limon i shtrydhur njeri që është shfrytëzuar nga të tjerët për interesin e tyre dhe pastaj është braktisur si diçka që nuk hyn më në punë.

SHTUPË f. Ia la shtupë dikujt ia la dikujt një punë në gjendje të atillë, që të mos dijë se nga t'ia mbajë, ia la punët shuk. E ka bërë shtupë enësh dikë e ka bërë leckë fare dikë, e ka marrë nëpër këmbë. I ishte bërë zemra shtupë e ka humbur fare guximin, i është ligështuar zemra, i është bërë zemra leckë. I doli puna shtupë i doli puna bosh, s'pati asnjë dobi, s'nxori gjë në dritë. Ia kanë mbyllur (ia kanë zënë, ia kanë vulosur) gojën me shtupë nuk e lënë të flasë, e kanë detyruar të heshtë. I vuri shtupën (tapës) gojës e mbylli gojën, nuk flet fare, e kyçi gojën.

SHTYJ kal. E shtyn me gjoks një punë shih te GJOKS, ~I. E shtyn me hosten dikë

shih te HOSTEN,~I. Shtyn (ngacmon, trazon) urët shih tek UR/Ë,~A II.

SHTYLLË f. Shtyllë çeliku i pathyeshëm e i patundur, që u bën ballë rrebesheve. E mbërthyen (e gozhduan, e vunë) dikë në shtyllën e turpit libr. e damkosën me turp. Shtylla kurrizore

SHTYP kal. E shtypin ethet ndien pak si ethe, e kanë zënë pak ethet. Ia shtypi (ia theu, ia këputi) kokën e shkatërroi krejt, e asgjësoi, e zhdukuri, e vrau. Shtypte (zinte) pleshta shih te PLESHT,~I. Ma shtypi zemrën më preku thellë, ma ndrydhi zemrën. I shtypi kripë mbi kokë dikujt i shkaktoi vuajtje e kokëçarje të shumta. Shtyp (rreh) ujë në havan shih te RRAH. Shkund me duar e shtyp me këmbë shih te DOR/Ë,~A. Gjarprit shtypi kokën! fj. u. shih te GJARP/ËR,~RI.

SHTYPEM vetv. Më shtypet zemra bie në një gjendje të rëndë shpirtërore, brengosem, më ndrydhet zemra.

SHTYPUR mb. I shtypur me këmbë bibash shih te BIB/Ë,~A.

SHTHEM kal. Thotë e shthotë thotë diçka dhe e mohon prapë, nuk i mbahet asaj që thotë.

SHTHUR kal. E ka shthurur gojën keq. flet ç't'i vijë, s'i vë fre gojës; përdor gjithfarë fjalësh të ndyra, flet larë e pa larë, është gojëndyrë. Thur e shtur shih te THUR.

SHTHURUR mb. E ka gojën të shturur (të prishur, të rëndë) keq. është gojështurur, është gojëndyrë.

SHUAJ kal. As ndez, as shuan shih te NDEZ. E shoi (e fshiu, e shleu, e hoqi) nga defteri dikë a diçka shih te DEFTER,~I. Të shuan derën (binanë, pishën) të bën dëm të madh, të shkatërroi a të rrënon krejt, të fik, të merr në qafë; të zhduk fare, të vret. Ia shoi (ia humbi, ia treti) farën dikujt a diçkaje shih te FAR/Ë,~A. Shuaj (ftoh, ul, shtroj, zbut) gjakrat shih te GJAK,~U. Ia shoi (ia mbylli) oxhakun shih te MBYLL. E shoi zjarrin e mbylli me qëllim një çështje të acaruar, e qetësoi

qëllimisht gjendjen. Është ndiz e shuaj merret me punë të kota, s'e ke për gjë. E shoi (e zhdukuri, e fshiu) nga faqja e dheut shih te FAQ/E,~JA.

SHUALL m. Bëhet (bie) shuall mbulohet krejt me diçka (kryesisht me pemë që bien në tokë), bëhet rrogoz.

SHUAR mb. I shuari (i nxiri) me bojë shih te BOJ/Ë,~A.

SHUHEM vetv. Iu shoftë (iu harroftë, i humbtë) emri shih tek EM/ËR,~RI. U shuan (u ftohën, u ulën, u shtruan, u zbutën) gjakrat shih te GJAK,~U. Iu shoftë pisha! mallk. vdektë, u zhduktë. Iu shuan sytë vdiq. Iu shua ylli diçkaje u sos fare, mbaroi krejt, s'ka më asnjë pikë. Iu shoftë hija e diellit! mallk.

SHUK m. Shuk e puk kruspull, gërmuq. Iu mblodh zemra shuk (lëmsh) shih te LËMSH,~I.

SHUL m. Shul gardhi mospërf. budalla, i trashë nga mendja, hu gardhi. Hyri (shkoi) shul e doli (erdhi) lloz nuk mësoi asgjë, s'përfitoi fare nga një mësim, nga një përvojë etj., si hyri doli; si vajti erdhi. Mbyll dymbëdhjetë dyer me një shul është shumë i zoti, shumë i shkathët.

SHUL ndajf. Shul e tërthor kryq e tërthor. Mbeti shul mbeti pa gjë, mbeti në diell. Ma zuri shul diçka ma përfoli e ma nxori nga hundët. Ia zuri shul dikujt keq.

SHULLË m. Nepërkë (shlligë) shullëri

SHUMË I pakuf. Është lis me shumë degë shih te LIS,~I. I lëshon shumë ujë mullirit tall. shih te LËSHOJ. Mish pak e pupla shumë shih te MISH,~I. Njeri me dyzet (me njëqind) flamurë shih te FLAMUR,~I. Ka pirë ujë në shumë burime (kroje) shih tek UJ/Ë,~I. Ka rrjedhur shumë ujë shih tek UJ/Ë,~I. Shumë pula e pak vezë shih te PUL/Ë,~A.

SHUMË II ndajf. Aq më shumë veçanërisht, sidomos, aq më tepër; madje. E hapi shumë gojën shih te GOJ/Ë,~A.

- SHUMTË** mb. Shkoi (iku) me të shumtët mospërf. vdiq.
- SHUPLAKË** f. I dha shuplakën vjet. e mori më sysh (kur kujtohej, sipas besëtytnive, se një fëmijë ishte sëmurrur ngaqë e kishin goditur hijet a syri i keq). Mori shuplakën vjet. u shitua, u shkal (sipas besëtytnive). E mban në shuplakë (në pëllëmbë) të dorës dikë shih te PËLLËMB/Ë,~A.
- SHURDH** m. Troket në derën (në portën) e shurdhit i drejtohet dikujt që nuk ua vë veshin fare fjalëve të tij. Bie daullja në vesh të shurdhit është e kotë t'i flasësh një njeriu që nuk do ose nuk është në gjendje të kuptojë atë që i thonë, venë dëm fjalët për një njeri që s'do të dëgjojë.
- SHURDH** mb. Na la (mbetëm) shurdh (të shurdhër) shih te SHURDHËR (i,e). Bën një vesh shurdh (të shurdhër) shih te SHURDHËR (i,e). Bën veshin shurdh (të shurdhër) shih te SHURDHËR (i,e).
- SHURDHËR** mb. Na la (mbetëm) të shurdhër (shurdh) na la vetëm pa gaz e hare, na shkretoi. Bie (shkon) në vesh të shurdhër i bëhet një kërkesë, një propozim atij që s'do të dëgjojë, që nuk i kushton vëmendje zërit të tjetrit. Bën një vesh të shurdhër (shurdh) bën sikur nuk dëgjon a sikur nuk para merr vesh mirë, nuk shqetësohet shumë, bën lëshime. Bën veshin të shurdhër (shkordh) bën sikur nuk e dëgjon fare tjetrin, nuk ua vë veshin fare kërkesave të tij, i ka shtënë veshët në lesh. Bën një vesh të shurdhër e një sy qorr shih te SY,~RI.
- SHURDHOJ** kal. I shurdhoi (i nxori, i qiti) veshët e mërziti me biseda të gjata e për të njëjtën gjë, e lodhi e e mërziti duke përsëritur a duke kërkuar të njëjtën gjë. Një sy verboje, një vesh shurdhoje shih te SY,~RI.
- SHURUKAMË** f. krahin. Do t'i dëgjohej (do t'i ndihet) shurukama do t'i dëgjohej zëri, do të bëhet zhurmë (për një punë etj.).
- SHURRË** f. I shpëtoi shurra thjeshtligj., përcm. u tremb shumë. Humbi si shurra e pulës thjeshtligj. u zhduk pa lënë gjurmë.
- SHUSHULL** f. kryes. sh. E ka shushull (halë, ferrë, gjemb) në sy shih te HAL/Ë,~A.
- SHUSHUNJË** f. Rri si shushunja në hi rri si i vdekur, nuk lëviz e nuk ndihet fare. Shushunja e dardhës zool. kandërr me ngjyrë të zezë të ndritshme e me flatra të tejdukshme, që dëmton dardhën, vishnjën, qershinë e pemë të tjera. Shushunja e të lashtave (e drithërave) zool. lloj buburreci me ngjyrë blu në të gjelbër e me shkëlqim metalik, që dëmton të lashtat.
- SHYQYR** pasth. bised. Bëj shyqyr gëzohem, kënaqem me diçka, shpreh gëzimin për diçka. Ia di shyqyrin ia di të mirën, ia njoh vlerën.
- SHYT** mb. I ha shyta e i nxjerr me brirë beson lehtë gënjeshttrat dhe ua thotë edhe të tjerëve të shtuara e të zbukuruara. Shkoi shyta të kërkojë brirët, la edhe veshët fj. u. iron. shkoi për të fituar diçka, po humbi edhe atë që kishte pasur; vajti për t'i kërkuar llogari dikujt, po i kërkuar llogari atij vetë dhe e vunë përpara.
- SHYT** ndajf. Ja shyt, ja fyt të dalë ku të dalë, të bëhet si të bëhet. Doli shyt s'fitoi gjë.
- TABAKA** f. Është e zonja (e fortë) për tabaka (për një grua) është e zonja për t'u shërbyer miqve a të ftuarve në dasma ose në gosti të mëdha.
- TABAKO** f. E kam tabako mospërf. është diçka që e bëj fare lehtë, as e llogarit, as e vë në kandar, e kam bukë e djathë. Njeri me taban njeri i palëkundur, njeri i qëndrueshëm e me karakter të fortë. Njeri pa taban njeri i lëkundur, njeri i paqëndrueshëm e me karakter të dobët.
- TABELË** f. E bëri tabelë qitjeje dikë libr. shih te QITJ/E, ~A.
- TAFT** m. bised. Tafti-bafti! le të dalë ku të dalë, le të bëhet si të dojë; ta provoj një herë me shpresë se do të dalë mirë.

- TAGJI** f. E hëngri tagjinë tall.
- TAKË** f. Ia la takë bëri që dikujt t'i vinte shumë keq për diçka, ia la gozhdë. I mbeti take i erdhi shumë keq për diçka, i mbeti gozhdë.
- TAKIJE** f. Më vjen (më sillet) takija (festa) vërdallë (rrotull) shih te VËRDALLË.
- TAKOHEM** vetv. Më takohen sytë me dikë shkëmbej vështrimin me një tjetër, shihem sy ndër sy me dikë. Kur të takohet (të bashkohet, të puqet) qielli e toka (qielli me tokën) iron. shih te QIELL,~I.
- TAKTIKË** f. Taktika (politika) e tokës së djegur shih tek TOK/Ë, ~A.
- TALË** f. bised. Gjeti talën gjeti zgjidhje, mori rrugë (për një punë, për një çështje etj.).
- TALLAGAN** m. Ia la në tallagan e mashtroi, ia hodhi.
- TALLAZOHET** vetv. Iu tallazua zemra u trondit, u shqetësua shumë.
- TALLË** f. Mbjell misër e korr tallë shih te MIS/ËR,~RI.
- TAMBËL** m. krahin. Bar tambli bot. qumështore. Lule tambli bot. qumështore, bar tambli.
- TANI** ndajf. Tani për tani përkohësisht, hë për hë, dora-dorës.
- TANISHËM** mb. Koha e tanishme gjuh. koha e tashme.
- TAPË** f. Është tapë (tapë topi) thjeshtligj., tall, i trashë nga mendja, që nuk kupton asgjë, që nuk merr vesh fare; që nuk ka fare njohuri për një fushë a për një çështje të caktuar. I vuri tapën (shtupën) gojës shih te SHTUP/Ë,~A. Është si tapa në shpinë të detit keq. s'është i zoti të zërë një vend e të qëndrojë, s'qëndron dot në një vend.
- TAPI** f. Nuk e ka marrë (s'e ka) me tapi nuk e ka marrë diçka që ta mbajë përgjithmonë.
- TARBË** mb. bised. E bëri tarbë dikë e mblodhi dikë, e bëri zap, e shtroi; e zbuti, e shtroi (një kafshë).
- TARTABIQE** f. zool. Na marrtë pleshtat e tartabiqet (pleshtat, të këqijat)! mospërf. thjeshtligj. shih te MARR.
- TARTAR** m. Tartari e merr vesh (se ç'bëhet) është rrëmujë e madhe, s'e merr vesh njeri, djalli e merr vesh se ç'bëhet.
- TASHËM** mb. Koha e tashme gjuh. kohë, në të cilën folja tregon se veprimi a gjendja e shprehur prej saj ndodh ose vihet re në çastin që flasim a shkruajmë.
- TATËPJETË** f. Mori tatëpjetën (teposhtën, tingtingën) shkoi gjithnjë e më poshtë, u bë gjithnjë e më keq, shkoi tatëpjetë.
- TATËPJETË** f. Mori të tatëpjetën mori tatëpjetën.
- TATËPJETË** Shkoi tatëpjetë shkoi gjithnjë e më poshtë, shkoi drejt një gjendjeje gjithnjë e më të keqe, u bë më keq, shkoi poshtë. E shkoi tatëpjetë diçka e gëlltiti, e kapërceu poshtë. Dikush (njëri) përpjetë e dikush (tjetri) tatëpjetë shih te PËRPJETË.
- TAVAN** m. S'ka tavan diçka s'ka cak a kufi, është e papërcaktuar, nuk dihet sa zgjat (p.sh. A«Jeta s'ka tavanA») Më ra tavan (çatia, shtëpia, qielli) mbi (në) kokë shih te BIE.
- TAVË** f. E ka në tavë e ka në dorë e të sigurt. Cjapi mish e dhia tavë (dhia mish e cjapi tavë) shih te CJAP,~I.
- TE** Tek e fundit shih te FUNDIT (i,e).
- TEATËR** m. Luan teatër me dikë shih te LUAJ.
- TEH** m. I pret me dy tehe dikujt i shkon fjala, ka shumë fuqi, i pret shpata nga të dy anët. Është sëpatë me dy tehe (me dy presa) dikush shih te SËPAT/Ë, ~A. Është thikë (presë) me dy presa (tehe) shih te THIK/Ë, ~A. Është (qëndron) në teh (në presë) të thikës (të briskut, të shpatës) është në një gjendje kur vendoset përfundimisht fati i dikujt a i diçkaje; vetëm qimja e ndan.

- TEHRI** f. Asnjë tehri (me tepër) as edhe një fije, asnjë çikë më tepër. Shtie tehri fut ngatërresa, ngatërëron; fut spica.
- TEJ** E hodhi (e flaku) tej (tutje) diçka nuk e pranoi në asnjë mënyrë, e hodhi poshtë. Çoj tej (më andej) shih te ÇOJ I.
- TEJSHKUAR** mb. libr. E kryer e tejshkuar gjuh. shih te KRYER, ~A (e).
- TEK** mb. Shtiem tek a çift hedhim short njëri me tjetrin, duke nxjerrë secili në të njëjtën kohë aq gishta sa dëshiron, për të parë se ç'numër formohet tek a çift nga të gjithë gishtat së bashku (fiton ai, të cilit i del numri i zgjedhur).
- TEK** ndajf. Kur e tek shih te KUR. Rrallë e tek shumë rrallë.
- TEK** Tek e fundit shih te FUNDIT (i,e).
- TEKDO** Tekdo që... kudo që ...
- TEKNIK** mb. Pjekuri teknike spec. shih te PJEKURI, ~A. Sistemi teknik spec. shih te
- TEL** m. Ia gjeti (ia preku) telat dikujt u soll me dikë ashtu si e donte ai, ia bëri diçka si i pëlqente, ia gjeti zemrën. I kanë gjetur (i kanë lidhur, i kanë rregulluar) telat bashkë kuptohen a merren vesh mirë me njëri-tjetrin, kanë rënë në marrëveshje, janë lidhur shumë ngushtë njëri me tjetrin. I luan telat di si t'ia dalë një pune, di të veprojë. E luan në tel dikë e sjell vërdallë dikë, bën si të dojë me të. I ndërton telat nuk e mban fjalën, nuk është i qëndrueshëm; është me shumë fytyra. E preku në tela dikë e preku atje ku duhet, ia gjeti ku i dhemb a ku i pëlqen më shumë, e preku në pikën e dobët të tij. Rrahu telin (telat) vjet. shih te RRAH. Sikur vuri telat u vonua shumë. Ë bëri nuse me tel dikë mospërf. e detyroi të sillet urtë e butë, ia mblodhi, e bëri zap. I bie po atij teli (po atij avazi, po asaj gozhde) shih te BIE I. Është për t'i hedhur telat është shumë e bukur, është si nuse e re. Iu drodhën telat e zemrës edhe iron., u prek shumë, u mallëngjye. Në një tel i bie jongarit thotë të njëjtën gjë, vijon po atë avaz, në një vrimë i bie fyellit.
- TELEGRAFIK** mb. Agjenci telegrafike shih tek AGJENCI, ~A 2.
- TELLALL** m. Vuri tellallin e bëri diçka me zhurmë e me të thirrura sa e mori vesh gjithë bota; s'e mbajti të fshehur diçka, e përhap një lajm në të katër anët. I zoti e shet, tellalli s'e jep fj. u. shih te ZOTI (i).
- TEMJAN** m. Ikën (largohet, ruhet) si dielli (si shejtani) aga temjani i shmanget me çdo kusht dikujt a diçkaje, ia ka shumë frikën; ikën menjëherë, shpejt e shpejt e i trembur.
- TEMPERATURË** f. Temperatura absolute fiz. shkallë nxehtësie, që merr si fillim a si zero temperaturën $-273^{\circ}C$. Temperaturë kritike shih te KRITIK, ~E.
- TENEQE** f. Teneqe e shpuar shar. shih te SHPUAR (i,e). I bie teneqesë mospërf. flet kot më kot, hap, bën zhurmë kot, i bie legenit. Mbeti (është) teneqe (dërrasë, kripë, pip) shih te MBES 4. E morën me teneqe i varën teneqenë. I varën (i vunë) teneqenë (legenin) dikujt mospërf.
- TENXHERE** f. Ka gjetur tenxherja kapakun (u rrokullis tenxherja e gjeti kapakun) keq. kanë gjetur njëri-tjetrin (dy njerëz që janë njëloj nga karakteri, nga zakonet etj.).
- TENJË** f. zool. I ka hyrë tenja po e bren sëmundja nga brenda, i ka hyrë sëmundja. Ka tenjën (shiritin, sprinjën) në bark dikush iron. ha e nuk ngopet; nuk shëndoshet fare, megjithëse ha shumë. Tenja e gjësë së gjallë kërrnjotë.
- TEPE** f. bised. Më iku (më luajti) tepja (kafka) e kokës (kapaku, tepeleku, tabani) i kokës shih te KAPAK, ~U.
- TEPELEK** m. bised. Më iku (më luajti) tepeleku (kapaku, tabani) i kokës (kafka, tepja e kokës) shih te KAPAK, ~U.

- TEPËR** Aq më tepër veçanërisht, sidomos, aq më shumë; madje. Aq më tepër që ... (se ...) sidomos ngaqë..., veçanërisht sepse... Për më tepër mbi të gjitha, veç të tjerash; madje. Ka një fjalë më tepër ka të drejtë të thotë a të flasë diçka më shumë se një tjetër. Ka një mendje më tepër mendon më shumë se një tjetër, me të cilin krahasohet.
- TEPOSHTË** f. Mori teposhtën (tatëpjetën, tingtingën) shih tek TATËPJET/Ë,~A.
- TEPROJ** kal. Po s'doli, do të teprojë shaka, të rregullohem me atë që kemi, të mos kërkojmë tjetër gjë kur s'ka.
- TEPSI** f. E bëri tepsi diçka e bëri shesh, e sheshoi (rrugën etj.). E bëri të kërcejë (të luajë, të hedhë) valle në tepsi dikë e detyroi të bëjë diçka edhe kundër dëshirës së tij, bëri si deshi me të.
- TER** kal. Ia teri këmbët (opingat) dikujt mospërf. e vrau. Të ter potkonjtë është shumë i shkathët, të heq këpucët nga këmba.
- TEREZI** f. bised. Me terezi
- TERS** mb. bised. Ters i Pojanit thjeshtligj. njeri që gjithnjë e për çdo gjë shfaq mospërf. njeri që gjithnjë ndjell keq.
- TERRITORIAL** mb. Ujërat territoriale brez ujërash të detit a të liqenit gjatë brigjeve të një shteti, që përfshihet brenda kufijve të tij.
- TESPIHE** f. vet. sh. Dredh (tund) tespihet (zinxhirin) shih te DREDH. Heq (numëron) tespihet shih te HEQ.
- TESQERE** f. vjet. Mori tesqerenë mospërf. vdiq.
- TESTE** II f. I ra në teste e kuptoi ku ishte qëllimi, e kapi menjëherë, i ra në të, i ra në shenjë.
- TESH** m. mjek. Bar teshi shih te BAR,~I I.
- TESHË** f. Shkoi tek teshat shkoi në varr, vdiq. Me tesha e kotesha shih te KOTESHA,~T.
- TETË** num. them. Ia bëri tetë me dy dikujt thjeshtligj. ia mblodhi, e bëri zap. I shkollonë tetë (shtatë) në qase shih te SHTATË. Java shtatë, ai tetë shih te JAV/Ë,~A.
- TË** II përem. I ra në të (në fije, në fill) shih te FIJ/E, ~A. Nuk është në të nuk është në vete, nuk është në rregull. S'ka gjë në të nuk i ka punët në vijë; e ka gabim.
- TËMBËL** m. Më plasi tëmbilin dikush a diçka shih te PLAS.
- TËMTH** m. kryes. sh. anat. I janë fryrë tëmthat shih te FRYHEM. Ia nxori (ia qiti) tëmthat dikujt bën shumë zhurmë, bërtet a thërret me të madhe sa e mërzit shumë dikë. Më plasën tëmthat shih te PLAS. E vura gishtin në tëmth u mendova mirë, i vura gishtin kokës.
- TËRBUAR** mb. Ujë i tërbuar shak. raki.
- TËRË** pakuf. Me tërë forcën (me forcë) shih te FORC/Ë,~A. Me tërë (me plot) kuptimin e fjalës shih te FJAL/Ë,~A. E ka me tërë (me gjithë) mend shih te MEND,~TË. Tërë (gjithë) sy e veshë shih te SY,~RI.
- TËRË** mb. Mbaroi me të tëra humbi gjithçka, nuk i mbeti asgjë, mori fund.
- TËRËSI** f. Në tërësi në përgjithësi, në vija të trasha.
- TËRHEQ** kal. E tërhoqi (e hoqi) në baltë dikë shih te BALT/Ë, ~A. Mos e tërhoq prej gjuhe! shih te GJUHE/Ë,~A I. E tërhoq (e heq) për hunde (për hundësh) dikë e mashtron, e sjell vërdallë, e bën të sillet si do ai. E tërhoq (e heq) për kapistalli (për kapistre) dikë shih te KAPISTALL,~I. Tërhiq (hiq) e mos e këput shih te HEQ. I tërhoqi (i hoqi, i zgjati, i shkuli) veshin (veshët) shih te VESH,~I. E tërhoq (e heq) për veshi shih te VESH,~I. Më tërhoq vëmendjen (vërejtjen) diçka a dikush më bie në sy diçka a dikush, më bën ta shikoj a ta vërej me kujdes. I tërhoq vërejtjen (vëmendjen) dikujt e qortoj, e kritikoj. E tërhoq (e heq) zvarrë një punë e zvarrit diçka, e vonoj një punë. E tërhoq (e merr)

- zvarrë diçka shih te ZVARRË. I tërheq fjalët zvarrë shih te ZVARRË. E tërhoqi (e hoqi) këmbën zvarrë (rrëshqanë) shih te ZVARRË. I tërheq (i heq) kërraba nga vetja keq. shih te KËRRAB/Ë, ~A. Shati tërheq nga vetja fj. u., keq. shih te SHAT, ~I.
- TËRKUZË** f. E bëri tërkuzë (litar, pallamar) diçka e zgjati tepër e pa nevojë një punë, një bisedë etj.
- TËRSHËRË** f. bot. S' di sa (ku) shkon tërshëra është rrëmuje e madhe, nuk e merr vesh i pari të dytin, s' e merr vesh qeni të zotin. Tërshërë e egër bot. bar i keq njëvjeçar i ngjashëm me tërshërën, që dëmton rëndë të lashtat. Tërshërë e zbehtë bot. bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të hollë deri një metër të lartë, me zhardhok të shkurtër, me gjethe të gjera e me lule të mbledhura si fshesë, që bën disa kallinj të vegjël.
- TËRTHOR** ndajf. Shul e tërthor shih te SHUL. I ra kryq e tërthor (një vendi) shih te KRYQ.
- TËRTHORTË** mb. Me rrugë të tërthortë me mënyra jo të rregullta a jo të drejta, jo si duhet e si bëjnë gjithë të tjerët. Ligjëratë e tërthortë (e zhdrejtë) shih te LIGJËRAT/Ë, ~A.
- TIGAN** m. Djalë (vajzë) tigan mospërf. djalë i përkëdhelur dhe i rritur me të gjitha të mirat. Fundi i tiganit (i kuisisë) tall. shumë i zi (për një njeri). Përpëlitet (cëritet) si petulla në tigan shih te PETULL, ~A. Është mësuar me vezë në tigan është rritur me të gjitha të mirat, ka bërë jetë të rehatshme e pa vështirësi, nuk është i kalitur në jetë. Peshku në det tigan në zjarr fj. u., iron. shih te PESHK, ~U.
- TIGANISEM** Pës. Tiganiset (fërgohet, skuqet, cingariset) me dhjamin e vet shih te DHJAM/Ë, ~I.
- TIJ** pron. sh. Erdhi dita e tij shih te DIT/Ë, ~A. Bufi mburr zogjtë e tij iron. shih te BUF, ~I.
- TIM** Bëj timen shih te BËJ.
- TINGTINGË** f. bised. Mori tingtinga (tatëpjetën, teposhtën) shih te TATËPJET/Ë, ~A.
- TIPOGRAFIK** mb. shtypshkr. Fletë tipografike shih te FLET/Ë, ~A II.
- TIS** I m. I kanë vënë sytë tis nuk i kupton gjërat, i janë verbuar sytë.
- TJEGULL** f. E bëj tjegull diçka e thaj shumë diçka, e thaj krejt; e pjek më shumë se sa duhet (për duhanin, për bukën etj.). S' ka tjegull mbi kokë (mbi krye) dikush, s' ka shtëpi, ku të banojë, s' ka çati mbi kokë. I vjen tjegulla përqark (vërdallë) dikujt nuk di nga t'ia mbajë, i vjen mendja vërdallë.
- TJERR** kal. Tjerr (pret) hollë shih te HOLLË 8. Tjerr lëmshe kundër dikujt shpif shumë kundër dikujt, thur intriga të mëdha. Ia tjerrin thekun bisedës shih te THEK, ~U I.
- TJETËR** pakuf. Mbanë tjetër ndërm. shih te MBANË. Ndërmjet (midis) të tjerave... (ndër të tjera. ...) së bashku me ato që janë përmendur a që dihen, ndërmjet gjërave të po atij lloji. Përveç të tjerave.. . veç gjërave që dihen, veç disa gjërash, arsyesh etj. që s' ka nevojë t' i përmendim. Veç të tjerave shih te VEÇ. Del mbi të tjerët shih te DAL. Me fjalë të tjera.. shih te FJAL/Ë, ~A. Tjetër gjë shih te GJË, ~JA. Tjetër hesap (ai) shih te HESAP, ~I. Tjetër për tjetër krejt ndryshe. Ha bukë veç të tjerëve shih te VEÇ. Është në terezi tjetër shih te TEREZI, ~A. Mend për tjetër herë shih te MEND, ~ TË. E shoh me një sy tjetër e gjykoj ndryshe nga sa e gjykoja më parë, e vlerësoj ndryshe. Lodra bie për tjetër valle.
- TOK** ndajf. Së toku së bashku, bashkërisht.
- TOKË** I f. vet. nj. Ra në tokë lindi (për fëmijët). Ra për tokë ra shumë poshtë (për gjendjen shpirtërore etj.). Fiton tokë (truall, vend) shih te FITOJ. Humb tokë libr. shih te HUMB. Është për tokë është në gjendje shumë të keqe (për

- prodhimin, disiplinën etj.); nuk vlen fare, është shumë keq (për një njëri me përgatitje të dobët, e sjellje të keqe etj.). S'e ka toka! është shumë i mirë a i bukur, s'e ka shokun a shoqen, s'ka të tillë në botë. Nuk e mban toka diçka shih te MBAJ. Nuk e mban toka (vendi) dikë shih te MBAJ. Dy pëllëmbë mbi tokë shih te PËLLËMB/Ë, ~A 4. S'e prek tokën dikush shih te PREK. Prush në tokë (në hi) shih te PRUSH, ~I. Puthi tokën (truallin) dikush u përul me nderim përpara dikujt; ra në gjunjë përpara dikujt a diçkaje. Si qielli me tokën shih te QIELL, ~I. Rren për tokë (shtruar) shih te RREJ. Rri në tokë! iron. jo more! (kur dikush thotë diçka shumë të çuditshme e të pabesueshme). Me shpinë në tokë (përdhe, përfundi) shih te SHPIN/Ë, ~ A. E zbriti në tokë dikë e ka bërë të njohë e të kuptojë jetën e vërtetë që e rrethon, kushtet e vërteta, në të cilat punon e vepron. Zë tokë shih te ZË. Kur të bashkohet (të takohet, të puqet) qielli e toka (qielli me tokën) iron. shih te QIELL, ~I. U bë një (njësh) me tokën vdiq. E bëri një (njësh) me tokën e shkatërroi krejt, e rrafshoi (një qytet, një fshat, një shtëpi etj.). E bëri tokë e tavani shtëpinë etj. e bëri rrëmujë, e bëri lesh e li, e bëri lësh. E bëri rrafsh me tokën shih te RRAFSH. S'i bie fjala në (për) tokë nuk thotë asnjë fjalë pa vend, e di se ç'flet, nuk flet kot; është i pjekur, i matur; është i zgjuar. I ranë duart në tokë dikujt
- TON** III m. I jep tonin (jetës, mbledhjes, etj.) libr. e përcakton, e bën të marrë një drejtim a një rrugë të caktuar (një mbledhje, një punë etj.); bën diçka që shërben si shembull për të tjerët bëhet shembull për diçka.
- TOP** m. U bë top (toka etj.) ngriu nga të ftohtët, u bë akull. I ra me top
- TOPANXHË** f. vjet. S'bëhet dora topanxhë fj. u.
- TOPIL** m. bised. U bë topil u lig shumë; u bë qull.
- TORBË** I f. E futi në torbë e bëri për vete plotësisht duke ia hedhur, e shtiu në grackë. Me kokë (me krye) në torbë (në trastë, në thes) me rrezik të madh për jetën, duke rrezikuar jetën. Si torba (si trasta) në degë shih te DEGË, ~A. Me torbë me trastë shih tek TRASTË, ~A. Nuk ia var torbën (trastën, kapistrën, kapistallin, këmborën, hejbetë) shih te VAR. S'ka gjë në torbë (në trastë) nuk ka siguruar gjë, nuk ka gjë në dorë nuk i ka punët mirë, nuk ka gjë në vijë (për një punë, një çështje). Iu qep me bukë në torbë (në trastë) dikujt shih te BUK/Ë, ~A. E vuri kokën (kryet) në torbë (në trastë) rrezikoi kokën, ndërmoi një veprim duke rrezikuar jetën. Fjalë të mira e gurë në torbë (në trastë) shih te GUR, ~I. As në thes, as në torbë shih te THES, ~I. E mban në torbë bukën e barutit është gati për gjithçka, me bukë e me armë, është gati për të përballuar çdo rrezik.
- TORISHTË** f. I kanë hyrë në torishtë (punët) i ka në rregull punët; i ka ndrequr punët, i ka vënë në vijë.
- TORPILË** f. usht. I vuri torpilën diçkaje e shkatërroi krejt diçka, i vuri minat, i vuri kazmën.
- TORTË** I f. E zgjat (e tjerr) tortë diçka e zgjat shumë dhe pa nevojë një punë, një bisedë etj., e bën tërkuzë.
- TORUA** m. E humbi toruan u hutua fare, u shastis, e humbi pusullën. Ia prishi toruan ia prishi mendjen, ia ndërroi mendimin.
- TRA** m. E bën qimen (halën) tra shih te QIM/E, ~ JA. Ia di trari e carami i di vetë hallet e tij, e di vetë ku i pikon çatia. Ishte (si) tra i pagdhendur (i palatuar)
- TRAGË** f. Nuk ka tragë të... nuk ka ndër mend... (të bëjë një punë, të niset etj.).
- TRAHAN** m. Rri duke tharë trahan dikush merret me punë pa rëndësi e kalon kohën pothuajse fare pa punë a me punë fare të lehta.

- TRANGULL** m. Trangull (kungull) pa fara mospërf. shih te FARË, ~A.
- TRANSMISION** m. tek. Rip transmissiioni libr. shih te RRIP, ~I.
- TRANZITOR** mb. libr. Flamur tranzitor flamur i kuq, zakonisht i qëndisur e me diçka të shkruar në të, që u jepet organizatave shoqërore e ndërmarrjeve të përparuara, punonjëseve të dalluar, fituesve të një gare etj.
- TRAP** I m. Bie në trap (në kurth) shih te KURTH, ~I. Ku ta nxjerrë trapi të bëhet si të bëhet; të dalë ku të dalë (për një punë, për një çështje etj.).
- TRASTË** f. Nuk më hyn në trastë (në qese, në kut) diçka shih te HYJ. Me kokë (me krye) në trastë (në torbë, në thes) shih te TORB/Ë, ~A. Ia lë në trastë dikujt shih te LË. Mori trastën (torbën) doli për të lypur, shkoi nëpër dyert e botës për të kërkuar; u bë lypës. Si trasta (si torba) në degë shih te DEG/Ë, ~A. Me trastë e me torbë me bollëk, sa të duash, pa asnjë kufizim; me të dy duart. Nuk ia vari trastën (torbën, kapistrën, kapistallin, këmborën, hejbetë) shih te VAR. E zgjidhi (e hapi) trastën (qesen, kuletën) shih te ZGJIDH. S'ka gjë në trastë (në torbë) shih tek TORB/Ë, ~A. Nuk e ka trastën në kurriz shih te KURRIZ, ~I. S'kishte ku i varej trasta shih te VAREM. Ia la në trastë dikujt shih te LË. Iu qep me bukë në trastë (në torbë) dikujt shih te BUK/Ë, ~A. E vuri kokën (kryet) në trastë (në torbë) shih tek TORB/Ë, ~A. E di Gjoni çfarë ka në trastë (në thes) fj.u. i di secili hallet e veta, e di i zoti ku i pikon çatia. Fjalë të mira e gurë në trastë (në torbë, në thes) shih te GUR, ~I. Ruan me trastë e prish me thasë fj.u. kursen aty ku nuk duhet, nuk di ku të kursejë, është i shtrenjtë në krunde e i lirë në miell; harxhon më shumë se sa kursen.
- TRASH** kal. I trashën fjalët filluan të zihen, u acaruan. Të trash mendjen të mbush kokën me lloj-lloj gënjeshttrash, të çorodit.
- TRASHEM** vetv. Pa u trashur filli shih te FILL, ~I. I është trashur gjuha mospërf. ka pirë shumë janë trashur gjunjët është lodhur shumë. I është trashur koka (truri, mendja) mospërf. nuk i hyn gjë në kokë, nuk mëson dot më; është bërë matuf. I është trashur lëkura
- TRASHË** mb. Në vija të trasha (të përgjithshme, kryesore) shih te VIJ/Ë, ~A. Vret (shet) të trasha (të rënda) shih te VRAS. E ka lëkurën të trashë dikush duron shumë, nuk do t'ia dijë nga asgjë; nuk i bën përshtypje. Ujët e trashë (e madh) euf. jashtëqitja e njeriut, nevoja e madhe. Zorra e trashë anat. shih te ZORR/Ë, ~A 1.
- TRASHË** ndajf. Trashë e gjerë gjerë e gjatë. Ra trashë me dikë ra ngushtë me dikë, nuk dinte si të sillet me të, nuk dinte si t'ia dilte mbanë. Bluan (pret) trashë dikush flet pa u menduar, flet pa i kontrolluar fjalët, thotë budallallëqe, bluan të trasha. E çonte trashë dikush ishte në gjendje të mirë ekonomike. E la trashë diçka e la pa prerë, nuk e ndau në pjesë a në copa të vogla. E kaluan trashë diku e kaluan mirë diku (në ndonjë gosti etj.), patën me bollëk për të ngrënë e për të pirë.
- TRASHËGUAR** mb. Refleks i trashëguar (i pakushtëzuar) psikol. shih te REFLEKS, ~I.
- TRASHJE** f. Kërpudhë trashje bot. lloj kërpudhe në ngjyrë të bardhë, me shumë mish, që hahet.
- TRAZOJ** kal. Trazoi fjalë me dikë u zunë, u grindën. I trazoi gjakun e shqetësoi, i prishi gjakun. Trazon (shtyn, ngacmon) urët shih tek UR/Ë, ~A II. S'lë gur pa trazuar (pa luajtur, pa kthyer) shih te LË.
- TRE** m. num. them. Shpatullat s'bëhen tri fj. u. shih te SHPATULL, ~A. Tre hunj e një thupër keq. shih te HU, ~RI. Është tri në degë e dy në majë dikush shih te DEG/Ë, ~A. Është tre mel e dy grurë mospërf. shih te MEL, ~I. Mat tri (shtatë,

- dhjetë) herë e pre një herë shih te MAT. I bëjnë sytë tre e tre dikujt i bëhen ca si miza përpara syve, nuk i dallon gjërat qartë, nuk sheh mirë.
- TREG** m. Plaçkë tregu keq. shih te PLAÇK/Ë, ~A. Nuk nxjerr (nuk qit) gjë në treg (në shesh) shih te SHESH, ~I.
- TREGOHEM** vetv. Nuk tregohet me gojë është diçka që të mahnit, është e jashtëzakonshme.
- TREGOJ** kal. Siç tregojnë (siç duken) bathët shih te BATH/Ë, ~A. I tregoi (i ktheu, i drejtoi) bërrylin dikujt e kundërshtoi dikë, nuk pranoi atë që i tha a që i kërkoi dikush; nuk i dha asgjë. I tregoi cepin dikujt shih te CEP, ~I I. I tregoi derën dikujt shih te DER/Ë, ~A. I tregoi (i dëf-teu) dhëmbët dikujt
- TREGTAR** m. Tregtar flamurësh shih te FLAMUR, ~I.
- TREMBEM** vetv. Iu tremb (i ngriu, iu pre) gjaku shih te GJAK, ~U I. S'i trembet (s'i fiket) syri nuk ka frikë fare, nuk do t'ia dijë prej askujt, është trim i madh. Nuk trembet ariu (arusha) me shoshë fj. u. shih te SHOSH/Ë, ~A. S'trembet ujku nga mushkonjat fj. u. shih tek UJK, ~U I.
- TRESH** m. Rregulla e treshit mat. Rregull për llogaritjen e një madhësie të panjohur, duke nisur nga tri ose pesë a më shumë madhësi të tjera të njohura, që kanë ndërmjet tyre përpjesëtim të drejtë a të zhdrejtë.
- TRET** kal. I treti (i humbi, nuk i duket) boja shih te BOJ/Ë, ~A. S'e tret dheu (besën, amanetin) nuk humb kurrë, nuk harrohet kurrë. Goja tret edhe malet fj. u. shih te MAL, ~I. Treti (hodhi) shikimin (vështrimin) larg vështroi larg, hodhi vështrimin tutje si i harruar. Ia treti (ia humbi, ia shoi) farën dikujt a diçka je shih te FAR/Ë, ~A. Treti (humbi) mendja e kokës shih te HUMB. I tret (i derdh) plumbin në gojë dikujt përd. shih te DERDH 4.
- TRETEM** vetv. U tret në mendime humbi në mendime. U tret (u shkri) si kripa në ujë shih te KRIP/Ë, ~A.
- TRETË** num. rresht. Kur këndoi gjeli (këndesi) i tretë shih te GJEL, ~I.
- TRETËSIRË** f. Tretësirë fiziologjike mjek. Tretësirë kripërash, e përgatitur në mënyrë artificiale, që ka veti të ngjashme me ato të plazmës së gjakut.
- TRETJE** f. Aparat i tretjes anat. shih tek APARAT, ~I.
- TREVË** f. S'kishte vend e trevë prej tij nuk e linte aspak të qetë, nuk i ndahej për asnjë çast. Mos gjetsh vend e treva! mallk. mos gjetsh qetësi, mos paç gëzim!
- TRËNDAFIL** m. Trëndafil breshke bot. balkrocë. Trëndafil deti zool. shih FIL-LIKAT/E, ~JA. Trëndafil i egër bot. shkurre e egër deri në tre metra e degëzuar dhe me gjemba të fortë, me lule në ngjyrë të bardhë me pesë petla e me erë të mirë, që bën kokrra të kuqe me shumë fara brenda; kaçë.
- TRËNDAFILTË** mb. Me ngjyra të trëndafilita libr. i zbukuruar shumë, pa dhënë anët e këqija e të pakëndshme, si fushë me lule.
- TRËNDELINË** f. Është bërë trëndelinë është dobësuar shumë, mezi mbahet në këmbë. Është trëndelinë (nga mendja) mospërf. është fare i lehtë nga mendja; e ka kokën bosh. Kishte mbetur trëndelinë kishte mbetur pa asnjë lek në xhep; s'kishte asgjë në shtëpi, ishte shkundur fare.
- TRI** f. num. them. Shpatullat s'bëhen tri fj. u. shih te SHPATULL, ~A. Tre hunj e një thupër keq. shih te HU, ~RI. Është tri në degë e dy në majë dikush shih te DEG/Ë, ~A. Është tre mel e dy grurë mospërf. shih te MEL, ~I. Mat tri (shtatë, dhjetë) herë e pre një herë shih te MAT. I bëjnë sytë tre e tre dikujt i bëhen ca si miza përpara syve, nuk i dallon gjërat qartë, nuk sheh mirë.
- TRIDHJETË** num. them. U shit për tridhjetë aspra shih tek ASP/ËR, ~RA.

- TRILL** m. I kërceu trilli dikujt i hipi inati, i kërceu damari, i hipën të vetat.
- TRINË** f. U bë trinë keq. u deh keq, u bë tapë.
- TRIVË** f. I ka humbur triva diçkaje nuk i gjendet as nami as nishani, ka humbur fare. S'është në trivë dikush s'është në të, s'është në rregull.
- TROFTË** f. zool. Hedh skortin të zërë troftën shih te SKORT, ~ I. Trofta e qenit fulterëz.
- TROKAS** jokal. I trokas në derë dikujt shih te DERË, ~ A. Troket në derë diçka është fare afër, thuajse ka ardhur. Troket në derë (në portë) të hapur shih te HAPUR (i,e). Troket në derë (në portën) e shurdhit shih te SHURDH, ~I. Po troket në derën tënde iron. shih te DER/Ë, ~A.
- TROKE** f. Është bërë për troke dikush mospërf. është bërë si kafshë, është bërë për t'i varur një këmborë. Njëri i bie trokes, tjetri i bie këmborës nuk shkojnë mirë njëri me tjetrin; nuk kanë një mendje, tjetër thotë njëri e ndryshe flet tjetri.
- TROKË** f. Ishte (bërë) trokë
- TRU** m. anat. 2. fig. Pjesa kryesore e sistemit nervor të njeriut si qendër e të menduarit; aftësia mendore për të gjykuar, për të arsyetuar a për të kuptuar realitetin që na rrethon; gjendja mendore e njeriut; mendja (edhe në një varg njësisht frazeologjike). Njeri me tru me aftësi mendore të mëdha. Me tru e me zemër me mendje e me zemër; punon truri. Më shastisi (më çau, më plasi, më thartoi) trutë më mërziqi aq shumë sa nuk e duroj dot më. I mbiu (i ra) në tru iu ngul në mendje. I shkrep (i erdhi) në tru një mendim. Çlodh trutë çlodhem pas një lodhjeje mendore, pushoj mendërisht. Iu ngulit në tru. Ia futi në tru. Po vriste trutë. Çalon nga trutë. E kanë lënë trutë. S'i pret truri. I pjell truri. Më iku nga trutë. I lëshon truri harron shumë. Shtrydh trutë shtrydh mendjen. Mbledh trutë mbledh mendjen, vij në vete. Të than trurin të mpin mendimin. Më ziejnë (më vlojnë) trutë më zien mendja. I kanë zënë trutë ndryshk s'mban dot mend; s'i hyn në kokë. I janë bërë trutë çorbë i është bërë mendja çorbë i ka trutë në fund të këmbëve është budalla, është pa tru; është shumë mendjelehtë.
- U bë tru diçka zjeu shumë, u bë si pelte. I ra në tru
- TRUALL** m. Fiton truall (tokë, vend) shih te FITOJ. Puth truallin dikush shih te PUTH. I ra mishit për truall shih te MISH, ~I. I digjet (i zien) trualli (toka) nën këmbë shih te DIGJEM. I rrëshqet (i shket, i luan, i lëviz, i dridhet) trualli (toka) nën këmbë shih te DRIDHEM. Puna e truallit euf. shih te PUN/Ë, ~A.
- TRUNG** m. U bë trung
- TRUP** m. Ka trup është e trashë dhe e mirë, ka një përqindje të lartë alkooli (për verën). Mbjaj mbi trup më bie përsipër një barrë e rëndë, rëndon mbi mua; e kam ngarkesë të tepërt që më sjellë vështirësi a pengesa. Mori trup dikush u rrit, u zgjat mjaft, hodhi shtat. I shartuar në trup (në trung) shih te SHARTUAR (i, e). Me trup e me zemër i tëri, plotësisht. Si një trup i vetëm të gjithë tok, së bashku, si një tërë; të lidhur njëri me tjetrin e të pandarë, të bashkuar fort për një qëllim të lartë. Nuk i beson as këmishës së trupit shih te BESOJ. S'mban gjë në trup është i hapur, nuk di të mbaj gjë fshehur. S'i ngjitet qimja në trup shih te QIM/E, ~JA. Trupi boçkë e mendja lomçkë mospërf. shih te BOÇK/Ë, ~A. Trup i përbërë kim. Trup i formuar nga disa elemente më të thjeshta. Trup i thjeshtë kim. element i kimik i thjeshtë.
- TRYEZË** f. Tryeza (coha) e gjelbër vjet. shih te GJELBËR (i,e). Tryeza e rrumbullakët
- TUFAN** m. Bëri tufan (furtunë) shih te FURTUN/Ë, ~ A. Ishte tufan ishte pa gjë fare, s'kishte asgjë.
- TUFË** f. E ka mendjen në tufë të festes është shumë mendjelehtë, e ka mendjen në majë të kokës.

- TUL** m. E bëri tul dikë e rrahu shumë, ia zbuti kurrizin. Gjuha është prej tuli fj. u. shih te GJUH/Ë, ~A I. I futi (i shtiu) veshët në tul bëri sikur nuk e dëgjoi dikë; e bëri veshin të shurdhër.
- TUND** kal. I tund (i luan) bishtin dikujt keq. shih te BISHT, ~I. Tund (luan) derën mospërf. rri kot; merret me punë pa vlerë, sa për të kaluar kohën. S'i ka tundur djepin dikujt nuk ia di moshën, s'ka nga t'ia dijë se ç'moshë ka. I tundi (i shkuli) dhëmballët (dhëmbët) dikujt shih te SHKUL. Tundi këmbën mospërf. vdiq. Tundi këmbët
- TUNDEM** vetv. U tund vendi
- TUNDËS** m. Mban vezë në tundës shih te VEZ/Ë, ~A.
- TUPAN** m. vjet. Iu bë barku tupan mospërf. U fry së ngrëni, iu bë barku daulle, iu bë barku kacek. E vunë në tupan
- TURBULLOHEM** vetv. Iu turbullua (iu prish) gjaku shih te PRISHEM.
- TURBULLOJ** kal. Turbullon (ngatërron) ujërat (ujit) shih tek UJIT, ~I. Nuk turbullon ujë nuk ngatërron njeri, nuk prish punë. As turbullon, as kthjellon
- TURBULLT** mb. Peshkon në ujë të turbullt (në ujëra të turbullta) keq. shih te PESHKOJ.
- TURI** m. Fut turinjtë (hundët) në diçka keq. shih te FUT. Ka turinj (hundë) shih te HUND/Ë, ~A. Nuk ka turinj (hundë) për dikë a për diçka mospërf. shih te HUND/Ë, ~A. Mbledh (tharton, rrudh, përdredh, shtrembëron) turinjtë (buzët, hundët) shih BUZ/Ë, ~A. Ia bëri turinjtë (buzët) përsesh dikujt shih te PËRSHESH, ~I. E priti me turi (tërë hundë, me bandë e buzë) shih te HUND/Ë, ~A. Me turinj (me buzë, me hundë) varur shih te VARUR. Theu turinjtë shih tek THYEJ. I theu (i dërrmoi) turinjtë (hundët, brinjët, dhëmbët, nofullat) dikujt përçm. shih tek THYEJ.
- TURK** m. Koka e turkut dashi i kurbanit.
- TURP** m. E mbuloi me turp dikë e turpëroi. Buka s'ka turp (marre) kur të ka marrë uria ha sa të ngopesh, mos u druaj nga të tjerët. Puna s'ka turp. fj. u. nuk është turp të punosh, puna është nder. E ka ngrënë turpin me bukë shih te HA. S'e ha (s'e ngjyen) turpin me bukë shih te BUKË, ~A. Ia la turpin (koren) te dera e turpëroi, e fëlliqi dhe iku. E mbërthyen (e gozhduan, e vunë) dikë në shtyllën e turpit libr. shih te SHTYLL/Ë, ~A.
- TURRË** I f. Është bërë turrë
- TUTJE** E hodhi tutje diçka nuk e pranoi në asnjë mënyrë, e hodhi poshtë. Ik, or, tutje! TY.
- Kjo është për ty! për këtë vepro si ta presë mendja e si të duash!, kjo varet prej teje. kjo është puna jote!
- TYM** m. Si në (nëpër) tym jo qartë, nëpër të, si në ëndërr. U bë tym (duman)
- TYRBE** f. Është bërë tyrbe pas dikujt nuk i ndahet dikujt, shkon gjithnjë pas tij, pasi e do shumë.
- TYRE** pron. Do të bëjnë të tyren do të bëjnë gjithçka që kanë mundësi të bëjnë, do të bëjnë atë që u takon atyre ose atë që duan ata.
- THAHEM** vetv. Iu tha barku
- THAJ** kal. Thau barkun (gojën) ndenji pa ngrënë, e la barkun bosh; kurseu shumë në të ngrënë. Ia thau barkun (gojën) s'i dha gjë të hante, e la pa ngrënë. I thau derën ia zhduku të gjithë njerëzit e familjes a fëmijët, e la pa njeri, e la shkretë, ia mbylli derën, ia shoi pragun. I thau (i preu, i shkurtoi) duart (dorën, krahët) shih te DORË, ~A. I thau kupën e la në varfëri, e varfëroi, ia la shtëpinë trokë. Të than kupën është shumë i shkathët, ta rrëmben kafshatën nga goja. Ia thau lugën dikujt ia hoqi bukën e gojës; e la pa gjë fare. Ia thau prehrin i vdiq, i iku përgjithnjë, e la të shkretë. Të than (të qan) qoshen shih te QAJ. Na thave sytë na ka marrë shumë malli për ty, se ka kohë që s'të kemi parë. Ia thau trutë dikujt ia lodhi aq shumë mendjen një

punë sa s'është më në gjendje të merret me një veprimtari krijuese a të kuptojë mirë diçka, sa s'i hyn më gjë në kokë. I thau vatrën nuk i bëri fëmijë, i la shtëpinë mbyllur (për gruan). Ia thau zembrën dikujt

THANË f. Si kokërr thane (molle) shih te MOLL/Ë, ~A. Thanat nuk numërohen fj. u. gjërat pa vlerë nuk numërohen; gjërat e vogla e pa rëndësi nuk duhen vënë re megjithëse mund të mos na pëlqejnë. Ka ngrënë lule thane

THARË mb. (në disa njësi frazeologjike). I ka duart të thara. përb.

THARK m. Jashtë tharkut jashtë familjes, jashtë vatrës. Si derr në thark shih te DERR, ~I.

THARM m. Sipas brumit tharmin shih te BRUM/Ë, ~I.

THARTË mb. Fjalët të ëmbla, punët të tharta shih te FJAL/Ë, ~A.

THARTOJ kal. M'i thartoi trutë më trullosi; m'i lodhi aq shumë trutë, sa s'më punon mendja.

THATË mb. E ka dorën të thatë nuk i ka duk gjë, i harxhon shpejt gjërat, s'i mbetet gjë në dorë. E ka kripën të thatë e ka çdo gjë në rregull, i shikon mirë çdo gjë.

THATË ndajf. 4. Pa ndonjë gjë tjetër pa e shoqëruar me diçka tjetër, vetëm atë (edhe në një varg njësisht frazeologjike). Hanin bukë thatë. E hëngri gjellën thatë. E hëngri djathin thatë. E piu qumështin thatë.

S'e ha (s'e lë) thatë s'mbetet pas nga të tjerët, është trim edhe ai; është trim edhe ai; është i zoti e s'ia hedh dot, nuk gënjejhet a nuk gabohet lehtë. E mbajmë barutin thatë jemi kurdoherë të gatshëm për të luftuar, nuk i lëmë armët të na ndryshken.

THATË as. Në (më) të thatë pa shkak, pa arsye. Bluan në të thatë flet kot, lllomotit, thotë gjëra pa vlerë e s'e dëgjon njeri. Lëvdohet (mburret) në të thatë (për së

thati) lëvdohet kot, fare pa të drejtë, pa pasur asnjë meritë. Prashit në të thatë

THEK I m. kryes. sh. Thekë e degë shumë i grisur, copë-copë. Në thekun e zembrës në thelbin e zembrës.

THEK I kal. Të thek ai është shumë i zoti, është shumë i fortë.

THEKËR f. bot. E futi në thekër dikë e futi në ngatërresa, e futi në të thella, e ngatërroi. Ra në thekër e humbi toruan, u shushat. Ra si pula (si gjeli) në thekër ra në bollëk ushqimesh, ra në të ngrëna të bollshme. Kapardiset (krekoset) si maçoku në thekër shih te MAÇOK, ~U. Mbeti (ra) si ujku (si zagari) në thekër shih tek UJK, ~U I. Mbolli thekër e i doli grurë dikujt shih te MBJELL. Kur s'ke grurë, e mirë është edhe thekra fj. u. njeriu bën si të ketë, kënaqet me atë që ka; kur s'ke pulën, ha edhe sorrën. Thekra është e gjatë, po gruri ahahet fj. u. vlen puna, jo pamja, mos i shih gunën, po punën. Hamë bukën tonë e rrahim thekrën (bëjmë davanë e botës) shih te BUK/Ë, ~A. Bri thekre bot. shih te BRI, ~RI.

THELB m. Arra pa thelb fjalë a punë boshe, pa vlerë. Ka thelb buka fj. u. buka që të japin vlen shumë, nuk bën të hash bukën e të përmbysësh kupë. I ushqyer (i rritur) me thelpinj arre i ushqyer shumë mirë, i rritur me të gjitha të mirat, i rritur me shumë kujdes.

THELLË f. Drejt e në thela bised.

THELLË mb. E ka shpirtin të thellë nuk vdes a nuk ngordh lehtë e shpejt. Shtyp e thellë shtypshkr. mënyrë shtypi në të cilën shkronjat, figurat, skicat etj. gdhenden në një fletë të hollë dhe dalin në letër e shtypur të dalluara për shkak të trashësisë së ndryshme të shtresës së bojës.

THELLË ndajf. U fut thellë e kaloi kufirin e caktuar, e kaloi masën e diçkaje. Sa më thellë aq më të ruda iron. shih te RUDE, ~A.

- THELLËSI** f. Në thellësi të shpirtit në botën e brendshme të njeriut, në botën e ndjenjave të tij, thellë në shpirt; fshehur, në vetvete. Që nga thellësia e zemrës (e shpirtit) me ndjenjat më të ngrohta; me dashuri të madhe, nga thelbi i zemrës.
- THEM** kal. S'ke ç'i thua është shumë i mirë, është i përsosur, s'ka të sharë. Ma thotë mendja, se., mendoj se. . . kujtoj se. . . I them Â«ndal!Â» shih te NDAL. Ta thotë në sy është i hapur, flet të vërtetën, s'flet prapa krahëve, ta thotë troç. Thotë e shthotë shih te SHTHEM. I tha (i foli) në vesh diçka shih te VESH,~I. Ma thotë (ma ndien, ma ndjell) zemra shih te ZEM/ËR,~RA. S'i la gjë pa thënë shih te LË. S'thotë gjë ai nuk kundërshton, nuk pengon; nuk të qorton. Pa thënë (pa bërë) asnjë, as dy shih te NJË. Ia thëntë prifti (hoxha) në vesh! mallk., vjet. vdektë! Njëri ia thotë e tjetri ia pret ç'thotë njëri, thotë edhe tjetri; sa thotë njëri një gjë, tjetri e përkrah. Nuk i tha një herë goja Â«plaç!Â» shih te GOJ/Ë,~A. Unë them Â«ja ujk!Â», ti kërkon gjurmët (kur ke ujkun, mos i kërkë gjurmët!) fj.u. shih tek UJK,~U I.
- THEMBËR** f. Nën thembrën e dikujt i shtypur nga dikush, nën sundimin e tij. I dha një thembër i dha fare pak, i dha diçka fare të vogël sa për të kaluar radhën. Nga koka deri te thembrat i gjithi, kokë e këmbë. I ndershëm gjer në thembër shumë i ndershëm. Ngul thembrat shih te NGUL. E ka në thembër (e ka ngjitur për thembre) e ka shumë afër, i gjendet pranë. Thembra e Akilit libr. pika më e dobët e dikujt, ana në të cilën dikush e ndien veten të pasigurt e të pambrojtur; diçka që kërkon kujdes të veçantë e që është mjaft e vështirë. As në thembër s'ia arrin s'i afrohet fare, as që mund të krahasohet a të matet me të. Ka jetuar me thembrat e botës ka jetuar, në varfëri të madhe, ka bërë një jetë të mjerë. I shkoi (i ra) zemra te thembra
- THEMEL** m. Deri në themel krejtësisht; me rrënjë; që nga themeli. Që nga themeli
- THEMELOR** mb. Numëror themelor gjuh. shih te NUMËRORI,~I 1.
- THEMELTAR** mb. Guri themeltar gur themeli.
- THEP** m. Shaka me thepa shaka që dëmton, shaka me thumba. Ia tha me thepa ia tha me qëllim të keq, për ta ngacmuar a për ta goditur.
- THER** kal. E theri në grykë i bëri dëm të madh, e mori më qafë. Të ther (të vret) e s'të paguan është njeri i pamëshirshëm, që bën shumë të këqija e s'jep llogari përpara askujt. Më therin sytë se shoh dot me sy dikë a diçka, nuk mund ta duroj. Më therë veshi (më therin veshët) kur e dëgjoj shih te VESH,~I. Është ther e mos e rrip bën punë gjysmake, e lë punën në mes të rrugës, nuk e çon deri në fund një gjë. S'shëndoshet (s'majmet) kau ditën që do të theret fj. u. shih te KA,~U.
- THES** m. Derr në thes keq. pa ditur gjë, pa e parë ose pa e njohur fare dikë a diçka.
- THËLLËZË** f. zool. Gjeti vezët e thëllëzës
- THËLLON** jokal. Më thëllon në zemër më dhemb zemra, më ther zemra.
- THËNË** f. S'është e thënë...(që...)
- THËNË** as. Me të thënë e me të bërë (një të thënë e një të bërë) shih te BËRË,~T(të).
- THËNGJILL** m. Thëngjill i mbuluar (gacë e mbyllur) keq. shih te MBULUAR (i,e). U bë thëngjill u dogj krejt, u bë shkumb. Rri mbi thëngjij jam në një gjendje të keqe, rri mbi prush. Ma bëri zemrën thëngjill ma nxiu zemrën, më hidhëroi shumë. Thëngjill i gurtë (thëngjill gur) vjet. Qymyrguri.
- THËRRES** kal. Thirri mendjes! mendohu mirë!, mblidhe mendjen!, eja në vete! I thërret (i thotë) derrat dajë thjeshtligj. shih te DAJ/Ë,~A. Sa të thërresin qetë, thërret qerrja shih te KA,~U.

THËRRIME f. E bëri thërrime (copë, copë e cikë, copë e kothere copë e thërrime) shih te BËJ.

THËRRMOJ kal. Ia thërrmoi zemrën e pikëlloi shumë, ia copëtoi zemrën, ia bëri zemrën copë.

THI m. Brengë thiu bot. shih te BRENG/Ë,~A II.

THIKË m. U bë për thikë u bë për të therur, do therur (për kafshët). U bënë për thikë u zunë keq, arritëm deri atje sa mund të thereshin me njëri-tjetrin, sa mund të vritnin njëri-tjetrin. Hyri në thikë bised. shih te HYJ. Janë në thikë janë zënë e janë grindur keq, janë armiq të papajtueshëm. E ndau (e preu) me thikë diçka e ndau shumë qartë, e veçoi mirë, e dalloi në mënyrë të prerë një gjë nga gjërat e tjera. Është e prerë me thikë diçka shih te PRERË (i, e). I shkoi në thikë i theri të gjithë. Me thikë ndër dhëmbë keq shih te DHËMB,~I. Si thika në gjalpë shih te GJALP/Ë,~I. Thikë pas shpine keq shih te SHPIN/Ë,~A. Thikë në zemër goditje shumë e rëndë shpirtërore. I ra (iu ngul, i mbeti) thikë në zemër i erdhi shumë keq për diçka, i shkaktoi dhembje të madhe; e dëshpëroi pa masë, e vrau rëndë shpirtërisht. E ka thikë në zemër i ka ardhur shumë keq për diçka dhe s'e harron dot, ndien dhembje të madhe kur e kujton dikë a diçka. I vuri në thikë i bëri të zihen keq; i bëri të theren e të vriten njëri me tjetrin. I ra thika (sëpata, luga, sqepi, shpata) në mjaltë shih te MJALT/Ë,~I. Është (qëndron) në teh (në presë) të thikës (të briskut të shpatës) shih tek. TEH,~U. Është thikë (presë) me dy presa (tehe) ka sa të mira aq edhe të këqija, sa mund të të ndihmojnë aq edhe të dëmtojnë; kërkon kujdes të madh. Janë thikë më thikë i kanë acaruar keq marrëdhëniet, janë armiq të papajtueshëm, janë dhëmb për dhëmb. Janë në thikë e në pikë i kanë acaruar marrëdhëniet sa më s'bëhet, janë bërë armiq të papajtueshëm. E kishte thikën (lakun, litarin) në grykë (në fyt) shih te

LAK,~U. I nguli (i futi) thikën prapa kurrizit (pas shpine) shih te KURRIZ,~I. E pret si dhia thikën shih te DHI,~A. Me thikë (me shpatë, me pallë) zhveshur shih te ZHVESHUR. Shkojnë (janë) thikë e brisk (brisk e thua) shkojnë shumë keq njëri me tjetrin; i kanë acaruar, shumë marrëdhëniet. I vajti thika në heqës shih te HEQËS,~I II. I ka shkuar, (i ka vajtur) thika, në kockë (në asht, në palcë) është në gjendje shumë të rëndë e në hall të madh, ka arritur në një gjendje që s'mund ta durojë më. I vuri thikën (thonjtë) në grykë (në fyt) dikujt shih te GRYK/Ë,~A. Dhurata e armikut o helm o thikë fj.u. shih te HELM,~I I. Përpara rripë e prapa thikë shih te RRIP/Ë,~A. Pret thika në mish të botës thuhet kur dhembja e tjetrit, gjendja e tij e vështirë etj. s'i bëjnë përshtypje dikujt. Të mos na presë thika vetëm në njërën anë të mos shohim vetëm gabimet, mungesat e të metat e tjetrit, por edhe tonat, të mos jemi të njëanshëm.

THINJË f. kryes. sh. Më dolën thinjat (më doli mjekra) duke pritur shih te MJEK/ËR,~RA.

THITH kal. I thithi (i piu) gjakun shih te PI. E thithi (e piu e përpiu, e rrufti) dheu dikë shih te DHE,~U. Ia thithi vlagën dikujt shih te VLAG/Ë,~A. E ka thithur bashkë me qumështin e nënës shih te QUMËSHT,~I.

THJESHTË mb. E kryera e thjeshtë gjuh. shih te KRYER,~A (e). Ligjërimi i thjeshtë gjuh. thjeshtligjërimi. Shumica e thjeshtë më shumë se gjysma (për votuesit, përfaqësuesit etj.).

THNEGËL f. zool. Çekiç thneglash zool. shih te ÇEKIÇ,~I.

THOI m. Deri në thonj shumë, në shkallën më të lartë. Nën thua fshehurazi, në mënyrë të fshehtë, tinëzisht. I ranë thonjtë dikujt

THONJËZA f. vet. sh. gjuh. Në thonjëza siç mendon; siç thotë dikush tjetër për të cilin po flitet; gjoja; ashtuquajtur.

- THOPËRÇ** m. kryes. sh. mit. Njeri me thopërç njeri me nerva, njeri me xhinde. I kanë rënë thopërçit është nevrikosur shumë, i kanë hipur xhindet.
- THUHET** Pës. Sa s'tuhet sa s'tregohet dot, sa s'ka ku të vejë, në një shkallë shumë të lartë, pa masë. Ashtu qe thënë vjet. ashtu qe e thënë.
- THUMB** m. U bë thumb (tapë, livadh, xurxull, fushë, karroqe, bërryl) shih te BËHEM. E do me thumb do shpuar a duhet nxitur që të bëjë diçka, e do me të shtyrë. Preu thumba
- THUNDËR** f. Ra në thundër u pengua e gati sa s'ra, u pengua keq (për, kalin etj.). I ktheu thundrat (potkonjtë, këpucët, këmbët) nga dielli për b. shih te DIELL, ~I. I vajti thundra në qafë shih te QAF/Ë, ~A. Thundër mushke bot. thundërmushkë.
- THUPËR** f. Ose hu ose thupër fj.u. shih te HU, ~RI. Tre hunj e një thupër keq. shih te HU, ~RI.
- THUR** kal. Thur e shtur bën e prish, nuk e rregullon, s'e ndreq (për një punë që s'mbaron).
- THYEJ** kal. Thyej (çaj) akullin libr. filloj i pari diçka të re, kapërcej i pari pengesat që dalin etj. Na theve brinjët!
- THYER** mb. Me zemër të thyer
- THYHEM** vetv. Të thyhet në dorë shih te DOR/Ë, ~A. Është thyer (është këputur) më dysh shih te DYSH. Më thyhen gjunjët s'kam fuqi të qëndroj më këmbë, më priten këmbët; jam shumë i lodhur. Iu thye qerrja në derë (te dera) shih te QERR/Ë, ~JA. Buka q ëthyhet, s'ngjitet më fj. u. shih te BUK/Ë, ~A. Po u thye kulaçi, s'ngjitet më fj. u. shih te KULAÇ, ~I. Më mirë të pritët koka (kryet), se të thyhen gjunjët fj.u. shih te GJU, ~RI.
- UDHË** f. Bën udhë (rrugë) diçka shih te RRUG/Ë, ~A. E bëri udhë (rrugë) shih te RRUG/Ë, ~A. Bën (flet, punon) me udhë (me rrugë) bën diçka ashtu siç duhet, siç është e rregullt, siç e kërkon e drejta; bën diçka me mend, me arsye. Bën (flet, punon) pa udhë (pa rrugë) vepron jo siç duhet, jo siç është e rregullt, siç e kërkon e drejta; bën diçka pa mend, pa arsye. E pruri (e nxori, e çoi) udha (rruga) shih te RRUG/Ë, ~A.
- UDHËKRYQ** m. Çirret (bërtet, flet) në të gjitha udhëkryqet libr. Flet për diçka gjithandej që ta marrin vesh të gjithë, vë tellallin.
- UDHËTIM** m. Udhëtimi i fundit libr. vdekja dhe varrimi. Viti në udhëtim libr. viti në vazhdim, viti në të cilinën jetojmë.
- UGAR** m. E bëri ugar një punë e rregulloi një punë, bisedoi dhe u mor vesh që më parë për një punë, e vuri në vijë diçka. Si kau në ugar shih te KA, ~U. Një këmbë në qerëse, një në ugar shih te QERËS/E, ~JA.
- UJDI** f. bised. E vuri në ujdi diçka e rregulloi, e vuri për fije.
- UJDIS** kal. bised. U ka ujdur gjaku shih te GJAK, ~U I. Ia ujdisi (ia ndreqi, ia rregulloi) qejfin (kokën) shih te NDREQ. Ia ujdisi (ia ndreqi, ia rregulloi) samarin (bërroren, kurrizin, shpinën) dikujt shih te NDREQ.
- UJEM** m. E bëri ujem (ia bëri mendjen ujem) e turbulloi, ia mori mendjen, ia prishi mendjen.
- UJERK** m. M'u bë ujerk m'u neverit, s'e shoh dot me sy.
- UJË** m. Doli mbi ujë
- UJË** as. I nxori ujët dikujt e shtrydhi mirë dikë; e shfrytëzoi deri në pikën e fundit. Si ujët e ftohtë shih te FTOHTË (i,e). E mban (e ruan) si ujët e paktë shih te PAKTË (i, e).
- UJËS** mb. Kungull ujës bot. kungullujës.
- UJK** I m. Iu bë ujk diçka iu mërzi shumë diçka, i doli fare nga zemra, s'e duron dot, s'e sheh dot me sy. U bë ujk (bishë) shih te BISHË, ~A. Në gojë të ujkut rrethuar

nga armiq të egër, fare pranë një rreziku të mundshëm. I kalli ujkun thjeshtligj. shih te KALL. Ujk me brirë thjeshtligj. shih te BRI,~RI. Ujk deti njeri i regjur me vështirësitë e detit, detar i vjetër e me përvojë. Ujk i vjetër (plak) njeri i rrahur me jetën; ai që e njeh mirë një punë. Fut ujkun në vathë shih te VATHË. Ka lëkurën (qimen) e ujkut e ndjekin gjithmonë të këqijat, nuk i ndahen të zezat; i vërsulen të gjithë edhe pa të drejtë. I la një qime ujku te dera (te pragu) dikujt i la një ngatërresë, i la një çështje të ngatërruar për ta zgjidhur, një grindje etj. Mori udhën e ujqve mori një rrugë të shtrembër, hyri në një udhë të keqe. Mbeti (ra) si ujku (si zagari) në thekër mbeti në gjendje të vështirë, shumë ngushtë, sa s'ka ku të vejë më keq, pa përkrahje, pa rrugëdalje, pa shpresë. E pagoi si ujku me lëkurë mori dënimin e merituar, e pagoi shtrenjtë, me kokë një veprim të keq. E shikon (e vështron) si ujku hënën e shikon me inat. E ka parë ujkun që i vogël (që në vogëli, që foshnjë) është njeri i rrahur me jetën, ka parë e ka kaluar shumë të këqija e rreziqe, nuk trembet nga rreziqet e nga kërcënimet. I tregon lëkurën e ujkut dikujt e frikëson, e tremb dikë duke iu kanosur me diçka. S'trembet ujku nga mushkonjat fj. u. thuhet për dikë që nuk do t'ia dijë fare kur e kërcënon një kundërshtar i pafuqishëm. Ujk me lëkurë qengji njeri i pabesë, që i mbulon qëllimet e veta grabitqare duke u shtirë sikur është i mirë. Prej ujkut ra në gjarpër shih te GJARPËR,~RI. Vuri (bëri) ujkun bari shih te BARI,~U I. Ka lëkurën e ujkut në kurriz (në shpinë) është me turp mbi shpinë; ka shumë faj. Leshtë e ujkut, thonjtë e bufit fj. u. kundër të keqit e të egrit duhet përdorur forca. I vari ujkut mëlçitë në qafë iron. shih te VAR. Ujku qimen ndërron, por zakonin s'e harron thuhet për dikë që hiqet sikur ka ndryshuar qëllimet dhe natyrën e tij, por që në të vërtetë është po ai i pari. Unë them Â«ja ujku!Â», ti kërkon gjurmët (kur ke ujkun, mos i

kërko gjurmët!) fj. u. thuhet për dikë që kërkon të fshehtë diçka që duket fare qartë ose që e kërkon të vërtetën jo aty ku ajo duket qartë, por aty ku ajo mbulohet e errësohet. Çakalli bëri kërdinë, ujkut i doli nami fj. u. thuhet për dikë që ka bërë shumë të këqija, por është fshehur pas dikujt tjetër që njihej nga të gjithë si keqbërës. Dhentë pa bari i ha ujku një nga një fj. u. shih te BARI,~U I. Gojë ujku bot. gojujk. Gjemb ujku bot. ashe. Thanë ujku bot. shih te THAN/Ë,~A.

UL kal. Uli (dorëzoi, dha, hodhi, la, lëshoi) armët shih tek ARMË,~A. E uli bishtin thjeshtligj. hoqi dorë me turp nga kërkesat e tepruara, u tërhoq me turp; e uli hundën. Ul e ço (ngre) thotë vazhdimisht të njëjtën gjë. E uli flamurin hoqi dorë nga qëndresa, u dorëzua. I ka ulur flamurët libr. ka hequr dorë nga mendjemadhësia e nga krenaria e kotë, nuk mbahet më me të madh, i kanë rënë pendët. I uli (i ftohu, i shoi, i shtroi, i zbuti) gjakrat shih te GJAK,~U. E uli (e vuri) në gjunjë dikë shih te GJU,~RI. E uli hundën iron. shih te HUND/Ë,~A. S'e ul hundën keq. shih te HUND/Ë,~A. Uli kokën (kryet)

ULEM vetv. Ulu ca!

ULUR ndajf. Me kokë ulur kokulur. Me shpinë (me kurriz) ulur i nënshtuar, i përlur.

ULLI m. bot. Dega e ullirit libr. simboli i paqes. Hiqnin (vuanin) të zitë (lëngun) e ullirit hiqnin gjithë të këqijat, vuanin e mundoheshin pa masë. Tund degën e ullirit iron. përpiqet t'u tregojë të tjerëve se është gjoja mbrojtës i flaktë i paqes për të fshehur synimet luftënxitëse. S'e ha atë kokërr ulliri shih te HA. Të jep më shumë ullinj (djathë) se bukë shih te DJATH/Ë, ~I.

ULLUK m. Bel ulluk shih te BEL,~I II. Zdrukth ulluk shih te ZDRUKTH,~I.

UNAZË f. I bukuri i unazës (i dorës) bised. shih te BUKUR, ~I (i). Ishte në unazë ishte i fejuar. E ka unazë në gisht e ka

- gjithnjë parasysh, nuk e harron, e ka vath në vesh. Unaza vjetore rrathë në trungun e një druri të prerë për së gjeri, që tregojnë moshën e tij.
- UNIK** mb. Orar unik orar pune pa ndërprerje në mes, pa pushimin e drekës. Shkollë unike. vjet. shkollë shtatëvjeçare e arsimit të detyrueshëm.
- UNIVERSAL** mb. Magazinë universale shih te **MAGAZIN/Ë,~A** 2.
- URATË** f. Na la uratën
- URDHËR** I m. Me urdhër të peshkut iron. shih te **PESHK,~U**.
- URDHËROR** mb. Mënyra urdhërore gjuh. mënyra e foljeve që shpreh një urdhër, një kërkesë ose një lutje.
- URDHJE** f. mjek. Bar urdhjeje bot. rrushqyqe.
- URË** I f. Me urë e pa urë me të gjitha mënyrat e mjetet me çdo kusht. I bëhet urë (urë e vig) dikujt përulet, nënshtrohet përpara dikujt dhe e lejon të bëjë ç'të dojë. Urë pa qemer shih te **QEMER,~I**. S'bëhet urë me gëzhdalla fj. u. çdo gjë ka nevojë për mjetin ose për mënyrën e vet që të bëhet. U bë urë e gurë u robtua në punë u përpoq me të gjitha fuqitë për të përballuar vështirësitë e jetës e për të fituar diçka. Është ende (akoma, hala) tek ura iron. i thuhet dikujt që nuk ka ndryshuar fare që ka ngelur me të vjetrën a ka ngelur prapa nga të tjerët ose dikujt që nuk ka marrë vesh se ç'bëhet përreth, që është në bisht të situatës. Është këmbëza e urës është njeri shumë i prapë njeri që llap gjithmonë telashe. Mbeti në bisht të urës (të bishti i urës) nuk eci me hapin e kohës, mbeti prapa. Nuk i shkoi kali (gomari) në urë (në udhë) edhe poh. shih tek **UDH/Ë,~A**. Një herë shkoi lepuri mbi urë edhe iron. thuhet për një veprim që ndodh rrallë ose që nuk përsëritet më. Urë ajrore vijë nëpër të cilën kalojnë për një kohë pa ndërprerje aeroplanë nga një pikë në tjetrën për qëllime të veçanta.
- URË** II f. Luan urët shih te **LUAJ**. Shkund urët shih te **SHKUND**. Shtyn (trazon, ngacmon) urët bëhet shkak që të acarohet më tej një grindje një mosmar-rëveshje, i nxit nga prapa krahëve të tjerët që të grinden, fut spicat. U bë urë e zezë
- URI** f. Gropa e urisë anat. shih. te **GROP/Ë,~A** 4.
- URITH** m. zool. Plug urith shih te **PLUG,~U** 1.
- UROR** m. Janë (shkojnë, venë) si eshka me urocin (me masatin) shih tek **ESHK/Ë,~A**. Janë gurë e uror shih te **GUR,~I**.
- UROV** m. bot. Ha urov vuan, heq keq. I shkojnë urov prej dikujt ia ka frikën dikujt, i shkojnë shtatë.
- URTË** mb. Me të urtë në mënyrë të qet të butë e të shtruar; me forcën e fjalës e të bindjes, pa zemërim e pa britma, me mirëkuptim. Fjalë e urtë folk. shih te **FJAL/Ë,~A**.
- URTË** ndajf. Urtë e butë
- USTA** m. E bëri usta (nuse, lule, çecho) shih te **BËJ**. Ra në usta (gjeti ustanë) ndeshi me një njeri që ka dorë të fortë, dhe që i shtrëngon rripat; ra me një njeri të regjur, të cilit nuk ia hedh dot. Është usta pa mistri shih te **MISTRI,~A**.
- USHKUR** m. S'di të lidhë ushkurin (ushkurët) mospërf. shih te **LIDH**. E lidh lekun me ushkur mospërf. është shumë dorështërnguar.
- USHQIM** m. Ushqimi social tërësia e gjellëtoreve, e restoranteve, e kafeve etj. që shërbejnë për popullsinë sendet ushqimore që tregtohen në këto njësi.
- USHQYER** mb. I ushqyer (i rritur) me thelpinj arre shih te **THELB,~I**.
- USHTARAK** mb. Shkollë e lirë ushtarake usht. shih te **LIRË** (i,e) 7.
- USHTË** f. Përpoqi ushtat (ballët) me dikë shih te **PËRPJEK**.

USHTON jokal. I ushtojnë sheket (kadet, hambarët) s'ka asgjë në shtëpi, s'i ka mbetur asgjë në shtëpi; është shumë i varfër.

USHUNJËZ f. zool. Iu ngjit si ushunjëz dikujt keq. iu qep e nuk i ndahet, iu ngjit si rrodhe.

UTHULL f. U bë uthull u nxeh, u inatos shumë. Pi uthull! tall. i thuhet me shpoti dikujt që nxehet menjëherë. E bëri për vaj e për uthull dikë shih te VAJ, ~I I. U derdh vaji në uthull (u derdh vaji e ra në uthull) nuk u bë ndonjë dëm, ra vaji në lakra, gjalpi po në lakrorë mbeti. S'hahet as me vaj, as me uthull shih te VAJ, ~I I. Pi macja uthull iron. i thuhet zakonisht një të vogli kur e shohim që pi duhan, raki a diçka që është për të rriturit. Nuk pi macja uthull iron. është diçka e pa mundur, është gjë që s'bëhet. I rrahur (i regjur) me vaj e me uthull shih te VAJ, ~I I. Ia veshi këmishën me uthull dikujt e rrahu keqas, ia bëri kurrizin copë. Laje gojën mirë me uthull! iron. shih te LAJ. Flet për uthullën e kapërcen të qumështi nuk i shtron sipas radhës gjërat në një bisedë, kalon pa prituri nga një çështje të një tjetër që nuk lidhet drejtpërdrejt me të. I rri punës përsipër si vaji mbi uthull nuk i ndahet punës, kujdeset natë e ditë për një punë a detyrë që ia kanë ngarkuar. Uthulla e fortë prish enën e vet fj. u. thuhet për dikë që nxehet shpesh, pa shkak dhe që kështu dëmton veten. Vaj e verë e uthull bised. ylberi.

UTHULLOHET vetv. Iu uthulluan trutë humbi aftësinë për të arsyetuar qartë, iu turbullua mendja; u matufos.

VA m. Nuk ranë në va edhe poh. nuk u kuptuan, nuk u morën vesh; nuk ranë në ujd; nuk shkuan mirë. Ia gjeti vaun dikujt ia gjeti rastin a shtegun dikujt për t'i marrë hakun e për ta dëmtuar. As në han as në va shih te HAN, ~ I. E hodhi vaun (lumin) shih te HEDH 20. E nxori në va dikë e mori dikë nga gjendja e vështirë, e nxori nga halli; e nxori në

rrugë. Edhe vau të mbyt fj. u. edhe rreziqet a të këqijat që duken të vogla mund të të sjellin një dëm të madh, prandaj nuk duhen nënvlerësuar. E zuri vaun i kapërceu vështirësitë, i kaloi hallet. Flet va e pa va flet mbarë e prapë, me vend e pa vend, ku duhet ku s'duhet; flet kot, flet më tym. E kaloi lumin va ndoqi rrugën më të lehtë e më të mirë për të zgjidhur diçka. U nis (ia mbajti) va pa va u nis pa ditur se ku do të dilte, ia mbajti më tym. Shkoi (doli) va pa va shkoi (doli) rrugë pa rrugë; i doli në krye me përpjekje me mundime të mëdha, me shumë vështirësi.

VADHËZ f. Nuk i ha ato vadhëza (gorrica, kumbulla) shih te HA.

VAJ I m. E ka vaj (grurë, dhjamë) me dikë shih te GRURI/Ë, ~I. I nxori vaj dikujt e lodhi shumë, e stërmundoi. Shkon (ecën) si në vaj shkon mirë, pa asnjë vështirësi e pengesë. E vuri në vaj

VAJ II m. Bëj vaj ankohe, qahem për diçka. E ka vajin në buzë dikush ankohe vazhdimisht, gjithnjë qahet. Mbeti me vaj në buzë dikush.

VAJGUR m. I hedh vajguri (benzinë) zjarrit shih te BENZIN/Ë, ~A. Rrush vajguri (me erë) lloj rrushi i zi që piqet vonë dhe ka një erë si të vajgurit.

VAKËT mb. E mban me ujë të vakët (të ngrohtë) shih tek UJ/Ë, ~I.

VALË f. Pikë e valë shih te PIK/Ë, ~A. Në valë të gjakut shih te GJAK, ~U I. Vala e shpirtit grahma e vdekjes. I ka rënë një valë mbi kokë (mbi krye) dikujt

VALË mb. I ra uji i valë u tremb, u shqetësua shumë nga diçka që i erdhi papritur.

VALI m. hist. Është vetë vali e vetë kadi (myfti) është i plotfuqishëm, bën siç i teket, bën si do vetë, vendos dhe urdhëron vetë; nuk pyet për të tjerët.

VALLE f. Mos e hap vallen shumë! mos e kalo masën e shpenzimeve, mos e tepro! E kanë lënë jashtë valles nuk e kanë ftuar

- të marrë pjesë në një punë, në një festë, në një trashëgim etj.; e kanë përjashtuar nga rrethi. Rri (është) jashtë valles nuk merr pjesë në një punë e nuk përgjigjet për të. Shkon pas valles së dikujt keq. Bën siç thotë dikush tjetër, i plotëson dëshirat e kërkesat, i shkon sipas avazit. E bëri të hedh ë(të luajë) valle në tepsi shih tek TEPSI, ~A. Hedh këmbën sipas valles vepron sipas kushteve dhe mjedisit ku është, i hedh këmbët sipas avazit. Hedh vallen siç bie daullja (sipas daulles, siç bie lodra) keq. shih te DAULL/E, ~JA. Po hyre në valle, duhet të kërcesh fj. u. kur e fillon një punë, duhet ta shpiesh deri në fund. Lodra bie për tjetër valle është fjala për diçka tjetër; kanë ndryshuar punët. Nisën vallet kur pushuan daullet u krye me vonesë diçka, nuk u bë në kohën e duhur, erdhi si kofini pas të vjelave. Ku i bie daulles unë e ku e hedh vallen ti shih te DAULL/E, ~JA. Disa jashtë valles dinë shumë këngë fj.u. kur nuk punon vetë e s'ke ndonjë barrë a përgjegjësi mbi supe, është lehtë t'u japësh mend të tjerëve.
- VAMPIR** m. Vampiri e njuh lugatin fj.u. njeriu i keq e njuh shokun e tij, i ligu shkon me të ligun.
- VANDAK** m. Vandak me bezga mospërf. shih te BEZG/Ë, ~A.
- VAPË** f. Mos na bëj vapë! thjeshtligj. mos më mërzit, mos më bezdis! (përdoret kur dikush na shqetëson).
- VAR** kal. I vari një fjalë dikujt i shpuri një lajm; i tha diçka. I varën këmborën (prapa, në qafë) dikujt shih te KËMBOR/E, ~A. Vari kokën (kryet)
- VARE** I f. E ka kokën vare është shumë kokëfortë.
- VAREM** vetv. pës. Po i varet koka dikujt po dremit, po kotet, po e zë gjumi. I janë varur mustaqet iron. shih te MUSTAQE, ~T. I varet në qafë dikujt shih te QAF/Ë, ~A. Varet (mbahet) në një qime shih te QIM/E, ~JA. M'u var zëri e humba zërin; u ngjira. S'kishte ku i varej trasta ishte shumë i varfër, ishte i mjerë. Varet (qëndron) në fije (në fill) të perit (të flokut) shih te FIJ/E, ~A. Iu var (i mbeti) samari nën bark dikujt shih te SAMAR, ~I.
- VARËSI** f. Në varësi nga ... libr. në lidhje me..., në përshtatje me..., si rrjedhim i...
- VARFËR** m. E ruan si i varfri kaun shih te KA, ~U.
- VARFËRIM** m. Varfërimi absolut i proletariatit (i punonjësve) ek. ulja e përgjithshme e nivelit të jetesës së punëtorëve, keqësim i përgjithshëm i gjendjes ekonomike dhe i të gjitha kushteve të punës e të jetesës së punëtorëve në vendet kapitaliste. Varfërimi relativ i proletariatit (i punonjësve) ek. pakësim i vazhdueshëm i të ardhurave që marrin punëtorët në vendet kapitaliste në krahasim me kohën e mëparshme dhe me klasat e tjera të shoqërisë.
- VARG** m. Varg e varg një pas një, njëri pas tjetrit, me radhë, zinxhir. Varg pas vargu një pas një, njëri pas tjetrit. Varg e vijë një pas një, njëri pas tjetrit, varg e vistër. Varg e vistër një pas një, njëri pas tjetrit, me radhë e pandërprere.
- VARGUA** m. Ishte trashur vargonjsh keq. shih tek TRASHEM.
- VARUR** mb. Me buzë (me hundë) të varura i vrenjtur, i ngrysur, i zemëruar; i pakënaqur e i mërzitur. Me turinj të varur me buzë të varura. Në shtëpinë e të varurit nuk e zënë në gojë litarin fj.u. thuhet për të paralajmëruar që të mos flitet për një çështje, nga e cila mund të lëshohet shumë dikush që është i pranishëm (ngaqë ai ka një gjymti a të metë të tillë, ka vuajtur shumë a e ka pësuar nga diçka, ka kryer një faj të tillë etj.).
- VARUR** ndajf. Me buzë (me turinj, me hundë) varur i vrenjtur, i zemëruar; i pakënaqur e i mërzitur.
- VARR** m. I hapi varrin (gropën) dikujt
- VASHË** f. poet. I biri i vashës trim i madh, trim mbi trima.

- VATËR** f. Në krye (në qoshe) të vatrës në vendin më të nderuar, në krye të vendit. I thau vatrën shih te THAJ. Është bërë gjysh në vatër shih te GJYSH,~I. I daltë hithra në vatër! mallk. shih te HIDH/ËR,~RA. Ishte me dy krënde në vatër shih te KRËND,~I. Jam një zjarr e një vatër me dikë shih te ZJARR,~I 2. Nxjerr ujë në vatër dikush
- VATH** m. Iu bë vath në vesh dikujt shih te VESH,~I. E vari (e vuri, e mban, e ka) vath në vesh diçka shih te VESH,~I. Vath i florinjte në vesh të derrit shih te FLORINJTË (i,e). Lule vathi bot. shih te LUL/E,~JA.
- VATHË** f. Si dhentë në vathë shih te DHEN,~TË. E futi (e vuri) në vathë dikë e bëri zap, e vuri nën kontroll; e futi në kurth a në grackë. Hyri në vathë u bashkua me gjithë të tjerët dhe iu bind urdhrave të dikujt. U nda nga vatha u veçua nga të tjerët. Si vathë pa grigjë shkretë, pa njeri. Fut ujkun në vathë fut armikun në shtëpi.
- VAZHDË** f. E ka bërë vazhdë (vijë) diçka shih te VIJ/Ë,~A. E vuri në vazhdë dikë e bindi dikë, e vuri në rrugë të drejtë, e vuri në vijë.
- VAZHDIMËSI** f. Në (me) vazhdimësi libr. vazhdimisht, në mënyrë të vazhdueshme.
- VDEKJE** f. Deri në vdekje deri në fund të jetës; përgjithnjë. Për vdekje
- VDEKUR** m. Ngjall të vdekurin nga varri shih te NGJALL. Ai nxjerr të vdekurin nga varri shih te NXJERR. Lë të vdekurin e shkon në dasmë keq. lë një punë të rëndësishme a të ngutshme për t'u marrë me diçka jo të domosdoshme, nuk i vlerëson drejt punët.
- VDEKUR** mb. Kapital i vdekur lib. ide a mendime që nuk mbështeten në praktikë a në jetën e gjallë dhe nuk zbatohen a nuk janë të zbatueshme. Letër e vdekur libr. Diçka së cilës nuk i kushton vëmendje askush, diçka për të cilën nuk interesohet askush. Peshë e vdekur diçka pa vlerë, diçka që s'hyn në punë; gjë pa jetë. Pikë e vdekur shih te PIK/Ë,~A. I vdekur e i pafutur (i pakallur) në dhe që është në buzë të varrit, i vdekur e i pambuluar. I vdekur e i pambuluar
- VDEKUR** ndaj. Gjallë a vdekur shih te GJALLË. As gjallë as vdekur shih te GJALLË.
- VDES** jokal. O rashë o vdiqa shih te BIE I. I ka vdekur mendja mospër. s'është në rregull nga mendtë, mendon e flet gjëra të kota a pa vlerë, ka rrjedhur fare. I ka vdekur nëna diçkaje thjeshtligj. shih te NËN/Ë,~A. I ka vdekur ora dikujt a diçkaje shih tek OR/Ë,~A II.
- VE** f. Lule veje (veze) bot. shih te LUL/E,~JA.
- VEÇ** Veç të tjerave ndër të tjera, midis së tjerash. Jo veç, po ...jo vetëm kaq, por ... Ha bukë veç (veçan) të tjerëve është më i mirë se të tjerët, dallon nga të tjerët.
- VEÇAN** ndajf. Ha bukë veçan (veç) të tjerëve shih te VEÇ.
- VEÇANTI** f. Në veçanti në mënyrë të veçantë, veçanërisht; sidomos.
- VEÇUAR** mb. I veçuari, i munduari fj.u. kush ndahet nga shokët, është i pafuqishëm e vuan.
- VEDËR** f. Bie shi me vedra bie shi i madh, bie shi me gjyma. Lule vedre bot. shih te LUL/E,~JA.
- VEGËL** f. Ia gjeti veglën diçkaje ia gjeti anën, ia gjeti mjetin. I vuri vegël diçkaje i shtoi diçka që nuk e ka, i vuri a i ngjiti një bisht.
- VEGSH** m. Humbi si fasulja në vegsh shih te FASUL/E,~JA. Është lugë për vegsh shih te LUG/Ë,~A. Shkoi për (për të bërë) vegsha (vorba) iron. shih te VORB/Ë,~A. Ka gjetur rrasa vegshin (vorbën) keq. shih te RRAS/Ë,~A. Bën vegshin e s'i vë vjegën (vegjën) e lë punën pa mbaruar për një gjë të vogël. E di luga se ç'ka vegshi (vorba, poçja) fj.u. shih te LUG/Ë,~A. Gënjeshtra e bën vegshin,

por nuk ia vë kapakun fj.u. puna e keqe a veprimi i keq merret vesh, gënjeshtër nuk fshihet dot.

VEGJETATIV mb. biol. Sistemi nervor vegjetativ fiziol. pjesë e sistemit nervor, që drejton veprimtarinë e organeve të brendshme dhe rregullon shkëmbimin e lëndëve në organizëm.

VEGJË f. Bën vegshin e s'i vë vegjën (vjegën) shih te VEGSH, ~I. Ia ka shtrënguar vegjës (avləmendit) shih te SHTRËNGOJ.

VEL m. Ka hipur në barkë pa vela shih te BARK/Ë, ~A.

VELENXË f. Ju bë velenxë dikujt ia mbuloi dikujt të metat e gabimet, ia fshehu të palarat për ta mbrojtur. I hoqi velenxën dikujt

VELLO f. etnogr. Ia hoqi vellon nuses e zbuloi dikë a diçka, e bëri të duket ashtu siç ishte në të vërtetë, ia hoqi petën lakrorit.

VEMJE f. zool. I ka hyri vemja është i sëmurë, i ka hyrë sëmundja, i ka hyrë krimbi (sidomos për ata që sëmuren nga tuberkulozi).

VEND m. Në vend menjëherë, aty për aty; aty ku ishte. Në vend të dikujt a të diçkaje në këmbë të dikujt a për diçka. Në vend që... përdoret për të shprehur një zgjidhje tjetër ose për të kundërvënë dy veprime a gjendje të ndryshme. Në vend (i ati, e ëma) shumë i ngjashëm në pamje me të atin (me të ëmën), gjallë i ati (e ëma). Vend e pa vend edhe aty ku nuk duhet; pa arsye; kot. Bëri vend diçka u bë zakon, u rrënjos, nuk hiqet dot. E çoj (e shpie) në vend (një fjalë, një urdhër, një porosi etj.) e zbatoj, e përmbush a e plotësoj deri në fund. M'u errësua vendi (bota) shih tek ERRËSOHEM. Gjej vend gjej rast a mundësi, gjej shteg. Gjen vend diçka shprehet a pasqyrohet; del. Gjeti vendin mospërf. mori atë (zakonisht dënimin) që meritonte. Më ha vendi s'ri dot në një vend, nuk më mban vendi; rri si mbi gjemba. U hodh nga vendi u zemërua menjëherë, kërceu përprjetë. Ka vend

është e mundshme, ka mundësi, mund; duhet, është e nevojshme. S'ka vend këtu dikush a diçka nuk lejohet, nuk duhet lejuar; nuk pranohet. Kryet e vendit shih te KRYE, ~T 7. E la në vend dikë e vrau me një të goditur. Lëshoi vend (pe) shih te LËSHOJ. I lëshoj vendin dikujt e nderoj, e vlerësoj, i heq kapelën për meritat që ka. Luaj vendit! përdoret për të shprehur një habi të madhe për ato që na tregojnë ose na thotë dikush ose në rastet kur një njeri ka paragjykimin se ajo që thotë dikush mund të sjellë ndonjë të keqe. Mbjaj vendin! keq. shih te MBAJ. E mbaj (e mbërthej, e gozdoj) në vend bëj që dikush të mos përparojë në punë a në jetë; nuk e lë të lëvizë a të përparojë. Nuk e mban vendi (toka) dikë shih te MBAJ. Mbeti në vend vdiq menjëherë. Mëshoji vendit! keq. shih te MËSHOJ. Më ngre vendi jam shumë i shqetësuar e nuk mund të rri dot, kam kokëçarje e shqetësime të mëdha. S'më nxë vendi jam shumë i shqetësuar, nuk më pritet, nuk kam durim; lëviz sa andej këtej, nuk rri dot në një vend nga shqetësimi a padurimi. Qëndron (mbeti, ngeci, ngeli, numëron, bën hapa) në vend nuk përparon më tej, mbetet në të njëjtën gjendje; mbetet prapa, nuk ecën me kohën, mbetet aty ku ishte; nuk ndryshon. Rrahu (çau, kërkoi) vendin (dheun, dynjanë) shih te RRAH. S'më rrihet në (një) vend jam shumë i shqetësuar, kam një hall a brengë të madhe; s'duroj dot dhe lëviz andej-këtej. Shkon në vend (fjala) zbatohet, vihet në jetë. I tregoi vendin dikujt e ndëshkoi dikë siç e meritonte, i tregoi se sa vlente e si duhej të sillej. S'tundet (s'lëviz) nga vendi nuk shqetësohet për asgjë, nuk e ha merakun. Në vend numëro! usht. shih te NUMËROJ. E vuri në vend dikë e vuri përpara përgjegjësisë, ia mblodhi. E vuri në vend diçka

VENDOS kal. Vendos karantinë për diçka (i vë karantinë diçkaje) libr. shih te KARANTIN/Ë, ~A.

VEPËR f. Vepër arti ndërt. shih tek ART, ~I.

- VEPRUES** m. Plotësi i vepruesit gjuh. rrethanor, i cili tregon një njeri, një kafshë a një send që kryen veprimin e shprehur nga folja në diatezën pësore.
- VERBËR** mb. Rrugë (udhë) e verbër (qorre)
- VERBËRI** f. Verbëria e pulave veter. sëmundje që u bie pulave dhe i verbon nga sytë.
- VERBOJ** kal. Me lugë të kon, me bisht të verbon keq. shih te LUG/Ë,~A. Një sy verboje, një vesh shurdhoje! shih te SY,~RI.
- VERDH** kal. Ia verdhi këmbët mospërf. e vrau.
- VERDHEM** vetv. As skuqet (kuqet) as verdhet (zverdhet) shih te SKUQEM 7.
- VERDHË** f. Vezë me dy të verdha (me dy të kuq) shih te VEZ/Ë,~A. Të jep vezë pa të verdhë (pa të kuq) shih te VEZ/Ë,~A.
- VERDHË** mb. Punë e verdhë punë e keqe; punë e ndyrë. Ethet e verdha mjek. shih tek ETH/E,~JA 1. Lëngata e verdhë mjek. shih te LËNGAT/Ë,~A. Ndryshku i verdhë bujq. shih te NDRYSHK,~U 3. Njollë e verdhë anat. shih te NJOLL/Ë,~A 1. Ujërat e verdha shih tek UJ/Ë,~I. Vija e verdhë ndër. shih te VIJ/Ë,~A.
- VEREM** m. mjek. U bë verem
- VERË** I f. Buka e verës shih te BUK/Ë,~A. Dimër e verë shih te DIM/ËR,~RI 2. Si gjethja në verë shumë, me shumicë; shumë i përhapur, i dendur a i zhvilluar. Si qyqja verën shih te QYQ/E,~JA. Ta bën verë (me gojë) të premtton shumë, ta bën shesh me lule. Ardhtë si vera! ur. ardhtë me shumë të mira! Është shend e verë shih te SHEND,~I. I erdhi vera te dera i erdhi e mira pranë. Në atë shtëpi nuk qesh as vera shih te QESH. Na rrofsh për dimër, se për verë jemi vetë! thjeshtligj., iron. shih te DIM/ËR,~RI. Korani i verë zool. shih te KORAN,~I. Lule vere bot. shih te LUL/E,~JA. Qe-fulli i verës zool. shih te QEFULL,~I.
- VERË** II f. I hedh ujë verës shih tek UJ/Ë,~I. Nuk mban më ujë vera (orizi, pilafi, kosi) shih tek UJ/Ë,~I. Mbart (mban) verë e pi uji është dorështrënguar, është kopracc. Ta shet ujin e pusit për verë ta hedh, të mashtron, nuk mund t'i zihet besë. Këtej të pi verën, andej të shan derën shih te PI. Vaj e verë e uthull bised. ylberi.
- VERI** I m. U bë veri iku shumë shpejt, u zhduk papritur, u bë erë. I është bërë mendja veri është trullësuar fare, s'është në vete; i është ngritur mendja. E ka mendjen si veriu është mendjelehtë, s'mbahet me asgjë. Kakaris si pula në veri (si pula pa grurë) shih te PUL/Ë,~A.
- VERIGË** f. Gjen verigë për diçka gjen një shkak për t'u kapur në një çështje ose për të dredhuar në një punë, gjen një vjegë. Ia gjeti verigën diçkaje
- VERZOMË** f. E bëri verzomë diçka e ngatërroi tepër.
- VESË** f. Ngrihem me vesë ngrihem herët, ngrihem pa zbardhur dita. U zhduk (humbi, shkriu) si vesa e mëngjesit (si vesa në diell) u zhduk shpejt, humbi menjëherë e pa lënë gjurmë. Vesa e mjaltit shih te MJALT/Ë,~I 2.
- VESH** m. Gjithë (tërë) sy e veshë shih te SY,~RI. Gomar me veshë. thjeshtligj., keq. njeri shumë i trashë nga mendja; budalla me brirë. Më bëjnë (më gënjejnë) veshët më duket sikur dëgjoj diçka. I ra veshit u mendua mirë, i vuri gishtin kokës. I ra (i hyri, i shkoi, i erdhi) në vesh diçka e dëgjoi diçka rastësisht; e mori vesh diçka. I ranë veshët nuk mbahet më të madh, e uli hundën, i ranë pendët. I rëntë (i ardhtë) pas veshit (pas qafës)! mallk. vdektë; i rëntë papandehur një fatkeqësi!, e pëssoftë nga nuk e pret! (i thuhet dikujt që i ka shkakuar një tjetri një të keqe ose që gëzohet për fatkeqësinë e tjetrit). Curroj vesh shih te CURROJ. Na çau veshët (kokën, kryet) shih te ÇAJ. Ia çori veshët dikujt shih te ÇJERR. Ç'po na dëgjojnë veshët! shih te DËGJOJ. I digjnin

veshët, u turpërua shumë. I fryn (i këndon, i fishkëllen) në vesh dikujt e nxit dikë kundër një tjetri, duke i pëshpëritur fjalë e thashetheme; e kurdis kundër një tjetri. Ia futi (ia shtiu) në vesh diçka dikujt i tha a e njoftoi diçka, i bëri të njohur diçka; i pëshpëriti diçka. I hëngri veshët shih te HA 11. Hap veshët shih te HAP. I hoqi (i tërhoqi, i shkuli, i zgjati) veshin (veshët) dikujt e qortoi dikë për një gabim, për një veprimi a për një punë jo të mirë. S'i hyn në vesh (fjala) nuk do ta dëgjojë; nuk kupton. M'u kënaq veshi u kënaqa duke dëgjuar, më pëlqente ta dëgjoja. Më këndon veshi (i djathtë), ndiej se do të pësoj një fatkeqësi a do të dëgjoj një lajm jo të mirë (sipas paragjykimeve). Kruan veshin dikush thuhet kur dikush nuk është në gjendje të përgjigjet për një pyetje që i bëhet (zakonisht për nxënësit kur i pyesin mësuesit). Më la pa veshë më shurdhoi veshët. Marr vesh shih te MARR. S'merr vesh dikush shih te MARR. Merrem vesh me dikë kuptohem mirë me dikë; bie në ujdi me të. E marr (e sjell, e çoj) për veshi dikë e marr me zor, e marr me detyrim. Mbjaj vesh përpiqem të dëgjoj; pres për të dëgjuar diçka, përgjoj; dëgjoj. I mbaj vesh

VESH kal. I ka veshur sytë diçka e ka bërë që të mos shohë më tej, e ka verbuar, e ka bërë që të mos e shohë të keqen, i ka zënë sytë, i ka marrë mendtë. Ia veshi këmishën me uthull dikujt shih tek UTHULL, ~A. Ka veshur rrobat e zisë shih te ZI, ~A 1. Preje për vete e vishma mua! shih te PRES I.

VESHKË f. Si veshka në mes të dhjavit shih te DHJAM/Ë, ~I. Veshkë artificiale mjek. aparat i ndërlikuar, që bën punën e veshkës kur këtë e operojnë ose kur është e sëmurë.

VET pron. vetv. sh. Me forcat e veta (tona) shih te FORC/Ë, ~A. Ecën me këmbët e veta shih te KËMB/Ë, ~A. Fërgohet (skuqet, tiganiset, cingariset) me dhjamin e vet shih te DHJAM/Ë, ~I.

Frikësohet (ka frikë, tutet) nga hija e vet shih te HIJ/E, ~A. Fshihet pas gjuhës së vet shih te GJUH/Ë, ~A I. Ha këmbët e veta shih te HA. Është në ditët e veta shih te DIT/Ë, ~A. Lahet me lëngun vet shih te LËNG, ~U. E mat me kutin e vet shih te KUT, ~I. Mbahet pas flokëve të vet iron. shih te FLOK, ~U. Është mbyllur në lëvozhgën (në guaskën) e vet shih te LËVOZHG/Ë, ~A. Shkon në bukë të vet shih te BUK/Ë, ~A. Vepron me (më) kokën e vet bën ashtu siç mendon vetë, nuk i pyet të tjerët. I quaj gjërat me emrin e vet libr. shih tek EM/ËR, ~RI. Nuk sheh më larg (më tutje) se hunda e vet (përtej hundës së vet) shih te HUND/Ë, ~A.

VETE përem. vetv. Më vete

VETE jokal. Në djall të vejë (të shkojë)! mallk. thjeshtligj. shih te DJALL, ~I. Vajti (shkoi) në djall shih te DJALL, ~I. Mirë vafsh (vafsh shëndoshë)! ur. udha e mbarë! Shkoi e vajti diçka shih te SHKOJ. S'pa (udhën) nga vajti (nga shkoi) shih te SHOH. I vete pas avazit shih tek AVAZ, ~I. Si do t'i vejë (si do t'i dalë) filli dikujt a diçkaje shih te FILL, ~I. Do t'i vejë ai fis keq. shih te FIS, ~I. S'më vete goja s'më pëlqen të them diçka. Sa s'ka ku të vejë (të shkojë) më (sa s'ka më) shih te KAM. I vajti koka u vra; vdiq, iku, mbaroi. Ka vajtur (ka shkuar) larg shih te LARG. Më vete (më shkon) mendja për diçka shih te MENDJ/E, ~A. Vete (shkoj) me mendje (me mendimin) se...shih te MENDJ/E, ~A. I vajti në mykë për diçka shih te MYK/Ë, ~A. Më vete (më shkon) syri te dikush a te diçka shih te SY, ~RI. I vete (i shkon) për shtat dikujt shih te SHTAT, ~I. I venë (i shkojnë) shtatë thjeshtligj. shih te SHTATË. Vajta në talë shih tek TAL/Ë, ~A. I vete (i shkon) pas ujërave shih tek UJ/Ë, ~I. I vajti në vesh dikujt shih te VESH, ~I. Më vete (më shkon) në zemër diçka shih te ZEM/ËR, ~RA 3. Më vete sipas zemrës shih te ZEMËR, ~RA 3. Prapa diellit të vejë! mallk. shih te DIELL, ~I. Më

- vajti buka pas kurrizit shih te BUK/Ë, ~A. Vajti te molla e kuqe shih te MOLL/Ë,~A. Vafsh shëndoshë ti! ti je në rregull, i ke mirë punët, je mirë, të lumtë ty!
- VETË** përem. vetv. Vetë i dyti.. . së bashku me një tjetër, dy veta. Vetë me vete shih te VET/Ë,~JA.
- VETËM** mb. Është i vetmi, për (në) ... shquhet, s'ka shok, dallohet mbi të gjithë.
- VETËM** Vetëm se... veçse, por. Jo vetëm (që)...por edhe.. . përdoret për të lidhur dy fjali a dy gjymtyrë të njëjta të fjalisë, prej të cilave e dyta theksohet më shumë se e para ose shpreh kundërshtim ndaj asaj që përmbahet në të parën. Jo vetëm që...,porse... jo vetëm..., por edhe...Vetëm e vetëm përdoret për të përforcuar shprehjen e një kufizimi.
- VETËTIMË** f. Ia bëri sytë vetëtimë dikujt i ra fort në fytyrë me pëllëmbë, ia ngjeshi syve. Iku (shkoi) si vetëtima e beharit iku shumë shpejt. Si vetëtimë (si bubullimë) në qiell të kthjellët (të kaltër) libr. shih te BUBULLIM/Ë, ~A.
- VETËTIN** jokal. Nuk i vetëtin syri shih te SY,~RI.
- VETIU** ndajl. Del (vjen, kuptohet) vetiu (vetvetiu) shih te VETVETIU. E ka prej vetiu e ka nga natyra e tij.
- VETO** f. libr. Vë veton në diçka shprehet në mënyrë të prerë kundër diçkaje dhe përdor të drejtën për ta kundërshtuar e për ta ndaluar.
- VETON** jokal. krahin. Nuk i veton (as që i veton) ashka e syrit dikujt shih tek ASHKË,~A.
- VETULL** f. I ranë vetullat u zemërua, u ngrys; i vari buzët. M'u nxinë vetullat u bëra me turp, u turpërova shumë. Rrudhi (ngrysi, mblodhi) vetullat (ballin) shih te RRUDH.
- VETVETE** përem. vetv. Në vetvete në thelb, nga ana e tij. Qëllim në vetvete qëllim i marrë veçmas e pa asnjë lidhje me të tjerët, qëllim i shkëputur nga një synim më i madh.
- VETVETIU** ndajf. Del (vjen, kuptohet) vetvetiu (vetiu) kuptohet pa ndonjë vështirësi, vetëkuptohet.
- VEZË** f. Që në vezë që në fillim, që në çastin kur sapo ka nisur të rritet e të zhvillohet. Ecën si mbi vezë ecën ngadalë e me shumë kujdes, ecën me ngathtësi të madhe. Jam (rri) si mbi (në) vezë (gjemba, ferra) shih te GJEMB,~I Ngroh vezët shih te NGROH. Sikur shkel mbi vezë (mbi gjemba) shih te GJEMB,~I. E shtrëngoi veza ka nevojë të ngutshme, ka hall që s'pret, është shumë ngushtë. Si veza në kulaç i rrethuar me të gjitha të mirat, si veshka në mes të dhjavit. Vezë kllukë shih te KLLUK/Ë,~A. Vezë e prishur shih te PRISHUR (i, e). Vezë e qëruar shih te QËRUAR (i, e). Si vezët (si zogjtë) e qyqes shih te QYQ/E,~JA. Vezë me dy të verdha (me dy të kuq) diçka që ndodh rrallë, gjë e rrallë. I bën (edhe) gjeli vezë shih te GJEL,~I. E bën vezën deve shih te DEVE,~JA. S'ka dalë ende nga veza (nga lëvozhga e vezës) mospërf. është i ri ende, s'di nga jeta, është i papërvogjë. Fol e ruaj vezë shih te RRUAJ. Gjeti vezët e thëllëzës shih te THËLLËZ/Ë,~A. Të jep vezë pa të verdhë (pa të kuq) është shumë i shkathët, është shumë dinak e i djallëzuar dhe ta hedh kur të duash. Kërkon (gjurmon, lyp) qimen në vezë shih te QIM/E,~JA. Mban vezë në tundës ruan çdo gjë; është kursimtar dhe shumë i kujdesshëm. Është mësuar me vezë në tigan shih tek TIGAN,~I. Ngarkon vezë në lak shih te LAK,~U. I ka ngecur veza kryq ka një hall të madh që s'po e zgjidh dot, i ka ngecur sharra në gozhdë. Përpiquej (bënte) si veza (si zorra) në prush shih te PRUSH,~I. S'rri gjeli mbi vezë shih te GJEL,~I. Shikon (gjen) qimen në vezë (në të bardhën e vezës) përpiquej t'i gjejë dikujt me çdo kusht një të metë

sado të vogël. I erdhi veza për të pjellë thjeshtligj.

VË kal. 29. Përdoret së bashku me disa emra pa parafjalë dhe formon me ta togfjalësha me kuptimin e foljeve, që kanë lidhje fjalëformuese me këta emra (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Vë bast. I vë besë i besoj. Vuri dashuri ra në dashuri, shtiu dashuri. I vuri dyllin diçkaje e dyllosi. S'i vë faj nuk e quaj fajtor, nuk e ngarkoj me faj. I vuri fre e frenoi, e përmbajti. Vë inat inatoset. I vuri kufi (cak) e kufizoi. Vë kujdes kujdesohem. I vuri kusht e kushtëzoi, e bëri me kusht. Vuri ulërimën (lemerinë, kujën). Vë merak merakoset. I vuri minat diçkaje. I vuri njollë (damkë) dikujt e njollosi, e damkosi, e bëri me turp, e poshtëroi para të tjerëve. Vë shpresat te dikush a te diçka shpresoj. I vë theksin e theksoj.

30. Përdoret së bashku me emra, zakonisht prejfoljorë e të paraprirë nga një parafjalë, dhe formon me ta togfjalësha me kuptimin e foljeve, që kanë lidhje fjalëformuese me këta emra (edhe në një varg njësisish frazeologjike). E vuri në be e lidhi me be, e detyroi të bëjë be. E vuri në djëni dikë ia bëri të ditur diçka, e njoftoi për diçka. E vë në diskutim diçka e diskutoj, e quaj të diskutueshme. Vuri në dukje se... theksoi se..., përmendi, tregoi se... Nuk e vë në dyshim nuk dyshoj për atë. E vuri në funksionim diçka e bëri të funksionojë. E vuri në gjuhë dikë e gjuhëzoi, e nënshtroi. E vuri nën kontroll nisi ta ketë nën kontroll. E vuri në lëvizje e bëri që të lëvizë, e gjallëroi. Vë në lidhje lidh. E vunë në litar e varën. S'e vë në llogari (në hesap) dikë a diçka s'e llogarit. E vuri në mendime e bëri që të mendohet. E vuri në mundime dikë e futi në mundime, e mundoi. E vuri para përgjegjësisë dikë e bëri të përgjegjjet për atë që ka bërë ose të kuptojë përgjegjësinë që ka, i kërkoi llogari.

Vë (nxjerr) në ankand diçka shih tek ANKAND,~I. I vuri (i derdhi) balsam shih te BALSAM,~I. Vë (bëj) ballafaqe

shih te BALLAFAQE. I vë balluke keq. shih. te BALLUK/E,~JA. I vuri berihanë shih te BERIHA,~JA. I vuri bërrylin dikujt shih te BËRRYL,~I. E vuri (e shtiu, e futi) në bigë dikë shih te BIG/Ë,~A. I vuri bina dikujt shih te BINA,~JA. E vë në bisht diçka shih te BISHT,~I. Për të vënë në bostan shih te BOSTAN,~I. E vuri (e futi) në brazdë (në hulli) shih te BRAZD/Ë,~A. S'e vë në brinjë mospërf. shih te BRINJ/Ë,~A. Vë buç shih te BUÇ,~I. I vë cipalin dikujt e dëbon, e përzë, e ndjek nga një vend. I vuri çallmën dikujt shih te ÇALLM/Ë,~A.

VËLLA m. Vëlla pa hile krahin. vëllam. Sikur edhe vëllai të më lindë çfarëdo që të ndodhë, edhe sikur të më vijë diçka shumë e mirë (për një punë që s'dua ta bëj). Gjumi është vëllai i vdekjes. fj.u. shih te GJUM/Ë,~I. Vëllezër jemi, shokë s'jemi shih te SHOK,~U.

VËMENDJE f. I tërheq vëmendjen dikujt shih te TËRHEQ.

VËNG m. E bëri vëng dikë e shtrëngoi mirë, s'e la të luante, i mblodhi rripat.

VËRDALLË ndajf. E sjell vërdallë (rrotull) dikë shih te RROTULL. I vjen (i sillet) vërdallë (rrotull, rreth) dikujt shih te RROTULL. I vjen (i sillet) festja, (takija) vërdallë (rrotull) ka shumë kokëçarje dhe nuk di si t'ia bëjë, është në një gjendje shumë të vështirë ose është shumë i ngarkuar me punë dhe s'di ç'të bëjë më parë. I vjen (i sillet) mendja (koka) vërdallë (rrotull) ka shumë kokëçarje dhe nuk di si t'ia bëjë, i vjen festja vërdallë. I vjen tjeçulla vërdallë (përqark) dikujt shih te TJEGULL,~A.

VËREJTJE f. Nën vërejtje përkohësisht në gjendje arresti, nën vëzhgim të veçantë.

VËRTET Vërtet që ... megjithëse.

VËRTETË f. Me të vërtetë vërtet. Q'është e vërteta (e drejta...) fj. ndërm. përdoret

- për të theksuar atë që thuhet, me kuptimin *Â* «në të vërtetë, pa dyshim; sigurisht *Â*». Të them (të themi) të vërtetën fj. ndërm. përdoret për të theksuar më shumë vërtetësinë e asaj që thuhet, me kuptimin *Â* «sigurisht, vërtet *Â*». E shikon të vërtetën në sy i vlerëson gjërat ashtu siç janë, i sheh gjërat drejt. Ia tha të katër të vërtetat në sy ia tha gjërat hapur, nuk i fshehu asgjë, ia tha copë të gjitha.
- VËRTETË** mb. Në kuptimin e vërtetë të fjalës shih te *FJAL/Ë, ~A*.
- VËRTIT** kal. E vërtit nëpër mendje diçka mendoj shumë për diçka, vras mendjen.
- VËRTITEM** vetv. Vërtitet rreth poçit shih te *POÇ, ~I*.
- VËRRI** f. Dhia në malësi, delja në vërrin fj.u. shih te *DHI, ~A*.
- VËSHTRIM** m. Me (në) vështrimin e parë
- VËSHTROJ** kal. Vështron (shikon) nën ballë shih te *BALL/Ë, ~I*. E vështroj (e shikoj) në bebe të syrit shih te *BEB/E, ~JA II*. Mos vështro (mos shiko) gjithnjë përpjetë, por vështro (shiko) dhe tatëpjetë fj.u. shih tek *TATËPJETË*.
- VIÇ** m. E bëjnë kaun me viç sajojnë gjëra të paqena, merren me thashetheme dhe shpifin. Kur të qethen viçat iron. kurrë, asnjëherë. I ikën lopa me gjithë viç i shpëtojnë gabime shumë të mëdha, i kalojnë edhe gabime të trasha. Të merr lopën me gjithë viç të merr gjithçka, të lë pa gjë; të grabit pa mëshirë. I pjell (edhe) viçi atij i vijnë të mirat andej nga nuk i pret, i pjell edhe këndesi. I rri si lopës pa viç dikujt shih te *LOP/Ë, ~A*.
- VIDHË** f. Ia gjeti vidhat (burmat, burgjitë) dikujt ia gjeti pikën ku mund të kapet; ia gjeti anën dikujt për ta bindur për diçka, për ta bërë për vete etj. Ia di (ia njoh) vidhat (burmat) dikujt shih te *BURM/Ë, ~A I*. Ia liroi vidhat (burgjitë) dikujt shih te *LIROJ*. I janë liruar (i kanë luajtur) vidhat (burmat, burgjitë) dikujt nuk është në rregull nga mendja;
- ka shkalluar. Ka luajtur nga vidhat (nga burgjitë) nuk është në rregull nga mendja; ka shkalluar. I shkanë vidhat (burgjitë) dikujt shih te *SHKAS*.
- VIG** m. U bë për vig është ligur e dobësuar shumë nga sëmundja sa s'ecën dot me këmbët e veta; është i sëmurë rëndë, është në prag të vdekjes, është me një këmbë në varr.
- VIHEM** vetv. U vu në blojë keq. shih te *BLOJ/Ë, ~A*. S'vihet inat me dikë a me diçka shih tek *INAT, ~I*. Pa u vënë re shih te *RE*. Nuk vihet në xhep dikush shih te *XHEP, ~I*. Iu vu (i mbeti) njolla me bojë shih te *NJOLL/Ë, ~A*. Iu vu ruba (një shtëpie) shih te *RUB/Ë, ~A*. S'vihet dy gjilpëra majë më majë fj.u. shih te *GJILPËR/Ë, ~A*.
- VIJ** jokal. Fjala vjen për shembull, ta zëmë, bie fjala. I vjen anës
- VIJË** f. Varg e vijë shih te *VARG, ~U*. E ka bërë vijë (vazhdë) diçka po e përsërit gjithnjë, e ka bërë gjë të zakonshme. I hoqi (i vuri, i futi) vijë (vizë) dikujt a diçkaje shih te *VIZ/Ë, ~A*. Është në vijë
- VIOLINË** f. Violina e parë
- VISTËR** f. Varg e vistër një pas një, njëri pas tjetrit. Me radhë, pa ndërprerje.
- VISHEM** vetv. U vesh me (në) të zeza (me rroba të zeza, me rrobën e zezë) filloi të mbajë zi, ra në zi. U vesh me (në) hekur (çelik) u armatos gjer në dhëmbë. M'u veshën sytë
- VISHNJË** f. *VISHNJË E EGËR* bot. Shkurre a dru i ulët me gjethe të rrumbullakëta, me lule të imëta, të bardha e me erë të këndshme, që bën kokrra sa një qershi e vogël, në ngjyrë të zezë, pa lëng e të hidhura; qershi e egër.
- VIT** m. Viti vitit nuk i ngjet një kohë nuk i ngjet një kohë tjetër; është vështirë të parashikosh se ç'mund të ndodhë në të ardhmen; Pema e Vitit të Ri shih te *PEM/Ë, ~A*. Plaku i Vitit të Ri shih te *PLAK, ~U*. Vit akademik periudha, gjatë

- se cilës zhvillohen mësimet në shkollat e larta. Vit dritë astr. vit-dritë. Viti i Ri dita e parë e muajit janar, dita e parë e çdo viti. Vit shkollor (mësimor) periudha, gjatë së cilës zhvillohen mësimet në shkollat tetëvjeçare e të mesme. Vit tropik vit i barabartë me 365 ditë, 5 orë, 49 minuta e 46 sekonda.
- VIU** onomat. As ciu, as viu (as miu) shih te CIU.
- VIZË** I f. I hoqi (i vuri, i futi) vizë (vijë) dikujt a diçkaje nuk e përfill më; hoqi dorë nga dikush a nga diçka, e fshiu nga defteri.
- VIZHË** f. Lule vizhe bot. lulevizhë;
- VJEDH** kal. E vodhi (e rrëmbeu) me sy shih te SY,~RI. E vodhi me bisht të syrit shih te SY,~RI. Ta vjedh hundën midis syve (në mes të syve) është vjedhës i regjur, e qëron të bardhën e syrit. Të vjedh vezën nën kloçkë shih te KLLOÇKË,~A.
- VJEGË** f. Bën vegshin e si vë vjegën (vegjën) shih te VEGSH,~I.
- VJELA** f. vet. sh. Si kofini (si koshi) pas të vjelave (pas të vjeli) shih te KOFIN,~I.
- VJELË** as. Si kofini (si koshi) pas të vjeli (pas të vjelave) shih te KOFIN,~I.
- VJELL** kal. E bëri të vjell (të përmjerrë) gjak dikë thjeshtligj. shih te PËRMJERR.
- VJELLË** as. Më vjen të vjellë nga dikush a nga diçka më vjen ndot; më mërzhitet shumë kur e shoh ose kur e dëgjoj.
- VJESHTE** f. Lule vjeshte bot. shih te LULE,~JA.
- VJETËR** mb. Bukë e vjetër mik i vjetër, shok i njohur prej kohësh. Dru i vjetër njeri i fortë e i paepur, kockë e fortë; racë e fortë. Ujk i vjetër (plak) shih tek UJK,~U. Hap defterët e vjetër edhe keq. shih te DEFTER,~I. Ilaç i vjetër në shishe të re keq. shih tek ILAÇ,~I. Bashkëpunëtor shkencor i vjetër titull shkencor, që u jepet studiuesve me përvojë dhe që është një shkallë më e ulët se titulli «profesor».
- VJETOR** mb. Unaza vjetore shih tek UNAZ/Ë,~A.
- VLAGË** f. Ka vlagë mban ende, mund të mbahet me ato që ka. Ia thithi vlagën dikujt e njohu mirë dikë, ia piu lëngun.
- VLEJ** jokal. S'e vlen barra qiranë edhe poh. shih te BARRË,~A 2. Nuk i vlen (nuk i bën) lëkura një para dikujt shih te PARA,~JA.
- VLERË** f. Vlera materiale ek. gjithë mjetet e prodhimit e të jetesës, që kanë një çmim të caktuar. Letra me vlerë fin. shih te LET/ËR,~RA.
- VLOJ** I jokal. I vlon (i zien, lëvrin) gjaku shih te GJAK,~U I.
- VLLAJË** f. Doli prej vllajës e ra në prush ra në një gjendje më të vështirë, ra më keq, iku nga shiu e ra në breshër.
- VOGËL** mb. Lekë (para) të vogla lekë, monedha a kartëmonedha me vlerë të vogël, lekë të shkoqur. I madh e i vogël shih te MADH (i), ~E (e). I vogël për prehër, i madh për zemër fj.u. shih te PREH/ËR,~RI. Atje ku bëhet dasmë e madhe, merr lugë të vogël! fj.u. shih te LUG/Ë,~A. Ku të tregojnë copën e madhe, merr lugën e vogël! fj.u. shih te LUG/Ë,~A. Arusha e Vogël astr. shih tek ARUSH/Ë,~A. Çika e vogël zool. shih te ÇIK/Ë,~A. Dera e vogël euf. shih te DER/Ë,~A. Qerrja e Vogël astr. Arusha e Vogël. Ujët e vogël (e hollë) euf. shih tek UJ/Ë,~T 2.
- VOLI** f. Për voli të diçkaje që të jetë a që të bëhet më lehtë diçka.
- VONË** ndajf. Herët (shpejt) a (ose) vonë shih te HERËT. S'i bëhet vonë
- VORBË** f. Stan vorbash mosërf. stan i keq, stan pa bulmet. Ka gjetur rrasa vorbën (vegshin) keq. shih te RRAS/Ë, ~A. Shkoi për (për të bërë) vorba (vegsha) iron. mbaroi, vdiq.
- VORFËNOR** mb. vjet. Strehë vorfënore shih te STREH/Ë,~A.

VRAP m. Një vrap pele afër, jo larg; jo shumë larg. Në pikë të vrapit shumë shpejt, me të katra. E ndali (e la, e mbajti) vrapin diku ndaloi, qëndroi (pas një ecjeje të gjatë e të shpejtë ose pas përpjekjesh të ngutshme a të vrullshme).

VRARË mb. Barrë e vrarë (në bark të nënës) njeri që mezi mbahet, që tërhiqet zvarrë e s'është i zoti për asgjë, njeri i lënë a i humbur, fatkeq. Si bollë e vrarë fare i lodhur e i këputur, që s'ka fuqi fare e s'lëviz dot.

VRAS kal. As të fal as të vret shih te FAL. Të vret barkun iron. të pëlqen shumë diçka, ke qejf ta hash. Vret degë më degë shih te DEG/Ë, ~A. Vret kohën rri pa punë, harxhon kohën kot. Vret (pret) larg shih te LARG. Vret (rreh) lart (rëndë) shih te LART. Nuk e vret mendjen (kokën) për diçka edhe poh. nuk mendohet shumë për diçka, nuk përpriqet shumë për ta zgjidhur diçka, nuk e lodh mendjen. Vret (numëron, zë) miza (gjithë ditën) mospërf. shih te MIZ/Ë, ~A. Të vret (të ther) e s'të paguan shih te THER. Të vret me pambuk shih. te PAMBUK, ~U. Vriste e priste

VRER m. Na mbushi vrer na hidhëroi shumë; na mërziti pa masë. Vjell (lëshon, nxjerr)vrer (helm e vrer) flete shumë keq për dikë a për di diçka, duke nxjerrë gjithë urrejtjen ka për të, s'lë gjë të keqe pa thënë për të. Iu bë zemra (shpirti) vrer (helm) u hidhërua shumë, u pikëllua. I pikon zemra vrer shih te PIKOJ.

VRESHT m. Si lepur në vresht shih te LEPUR, ~I. Flet në arë e në vresht shih tek AR/Ë, ~A. Shkoi (u vra) si qenë në vresht (në rrush) shih te QEN, ~I. Hajde baba të të tregoj vreshtin (arat)! iron. shih BABA, ~I. Lule vreshti bot. dorë-zonjë, lulevreshtë.

VRIMË f. Fyell pa vrima mospërf. njeri që s'vlen për asgjë; njeri fare budalla. Bëri një vrimë në qiell shih te QIELL, ~I. Bën vrima në shoshë shih te SHOSH/Ë, ~A. Bëri një vrimë në ujë shih tek UJ/Ë, ~I.

I bie fyellit në një vrimë, thotë a përsërit të njëjtën gjë vazhdimisht, i bie të njëjtit avaz. Del nëpër vrimë të gjilpërës shih te GJILPËR/Ë, ~A. E futi (e kaloi, e shkoi) në vrimë të gjilpërës dikë shih te GJILPËR/Ë, ~A. Të fut (të kalon, të shkon) në vrimë të gjilpërës shih te GJILPËRË, ~A. Hyn (futet) në vrimë të miut ka shumë frikë dhe fshihet, nuk di ku të futet nga frika. La leshin në vrimë doli me humbje të madhe në një punë, e pësoi keq. Nuk lë vrimë pa u futur shih te LË. Më sa hyn buall në vrimën (në veshin) e gjilpërës shih te BUALL, ~I. Është vrima (bira) e fundit e kavallit (bishti i kavallit) shih te KAVALL, ~I.

VRITEM vetv. Ku rafsha mos u vrafsha shih te BIE I. U vranë në gisht shih te GISHT, ~I.

VULË f. Është (njeri) me vulë njihet mirë nga të gjithë për diçka zakonisht jo të mirë, është me damkë. I ra vula dikujt e humbi emrin e mirë a vendin drejtues. E humbi vulën u hutua, e humbi toruan. I humbi vula dikujt u zhduk pa lënë gjurmë, u shua, u fik, s'i gjendet as nami as nishani. I humbet vula (nami, nishani)! mallk. vdektë e mos u përmend të më! Nuk i shkon vula edhe poh. nuk i shkon fjala, nuk e dëgjojnë të tjerët. I vuri vulën diçkaje e plotësoi me diçka të fundit që i mungonte, i vuri kapakun; e përfundoi diçka, i dha fund; e miratoi përfundimisht.

VULOS kal. E vulosi (e qepi) gojën shih te QEP. Ia kanë vulosur (ia kanë mbyllur, ia kanë zënë) gojën me shtupë shih te SHTUP/Ë, ~A. Vetë shkruan, vetë vulos shih te SHKRUAJ.

VULOSUR mb. Bletë e vulosur njeri në gjendje shumë të mirë ekonomike, me shumë kamje, kamës.

VULLKANIK mb. Xham vullkanik min. shih te XHAM, ~I.

XIBËRRISHTË f. E futi nëpër xibërrishta dikë e mendoj dikë kot, e bëri t'i shkojë mundimi kot.

- XIXË** f. Bën xixë shih te BËJ. I futi (i shtiu) xixat (mizat) dikujt shih te FUT.
- XIXËLLONJË** f. Qëllon në xixëllonjë dikush qëllon shumë mirë, ka shumë nishan.
- XHAM** m. Është prej xhami është shumë i dobët, i brishtë. Lesh xhami (qelqi) shih te LESH~I 4. Pambuk xhami (qelqi) tek. shih te PAMBUK,~U. Ujë (lëng) xhami shih tek UJ/Ë,~I. Xham vullkanik min. shkëmb mineral me ngjyrë të zezë në kafe ose i kuqërremtë në të murrme, që përdoret në prodhimin e çimentos për të rritur cilësinë e saj.
- XHAMI** f. Gjeti xhami (kishë) ku të falet iron. shih te KISH/Ë, ~A.
- XHAN** m. bised. E bëj xhan fëm. E përkëdhel, e puth dhe e përqafoj. E kam xhan fëm. e dua shumë, e kam shpirt.
- XHANDAR** m. Xhandar ndërkombëtar shtet i fuqishëm reaksionar. Që ndërhyt me dhunë për t'u diktuar vullnetin e vet shteteve të tjera më të vogla.
- XHEP** m. E futi në xhep dikë e shtiu në dorë dikë, e bëri për vete. Të fut ndër xhepa është i vetmi për të mashtruar. E ka në xhep diçka e ka në dorë diçka, nuk i mungon, e nxjerr kur të dojë; e ka të sigurt një gjë. E ka në xhep dikë e ka futur në dorë dikë, nuk ka nga luan. Kruaj xhepat shih te KRUAJ 3. I mbushi xhepat shih te MBUSH. Ia ngrohu xhepin dikujt shih te NGROH. I preku xhepin dikujt e mori vesh sa të holla ka, e pa a e kuptoi sa para ka. I është shpuar xhepi (kuleta) iron. shih te SHPOHEM. I shton nga xhepi dikush shton nga vetja fjalë, që nuk i ka thënë dikush. E vë (e fut, e ruaj) në xhep a) e marr diçka që më thotë një tjetër, e ruaj dhe nuk e harroj;
- XHIGER** m. I nxori xhigerin i çau barkun me thikë a me bajonetë, e theri, e vrau mi-zorisht.
- XHIND** m. U bë xhind u zemërua keq, u tërbua nga inati. I hipën (i kërcyen, e zunë, e kapën) xhindet (qipujt) u zemërua keq, u ndërkrye. Është me xhinde është zemëruar keq, është gjithë inat; është njeri që zemërohet shpejt. I zbritën (i ranë) xhindet (qipujt) i iku zemërimi, u qetësua.
- XHOKË** f. Ta pret xhokën dikush shih te PRES I.
- XHOL** II m. Hyn (futet) si xhol fut hundët në çdo punë, përzihet edhe aty ku nuk i takon.
- XHUFKË** f. Zero me xhufkë (me bisht) keq. shih te BISHT,~I
- XHUMBË** f. M'u bë xhumbë në grykë (në bark) m'u bë lëmsh në grykë.
- YHA** pasth. thjeshtligj. E zunë me yha dikë e vunë përpara dikë duke e tallur; e ndërprejnë ose e dëbuan me të bërtitura mospëlqimi.
- YJOR** mb. Shi yjor astr. shih te SHI,~U.
- YLL** m. Dhjetë me yll thuhet për notën më të lartë në shkollë, kur nxënësi a studenti është përgjigjur në mënyrë të shkëlqyer. Ngrihet (niset) me yje ngrihet shumë herët në mëngjes, ngrihet pa gdhirë mirë. Numëroj yjet shih te NUMËROJ. I perëndoi ylli dikujt a diçkaje
- YMËR** m. bised. I mori ymrin dikujt e mendoj shumë dikë, i nxu jetën, i mori shpirtin.
- YNDYRË** f. S'del yndyrë nga dikush nuk sjell asnjë lloj përfitimi a dobie dikush.
- YRNEK** m. bised. Një yrnek janë mospërf. keq. janë njësoj, nuk kanë ndryshim njëri nga tjetri.
- YST** m. vjet. Doli yst doli mbi të tjerët, doli i pari.
- YZENGJI** f. E ka humbur fare yzengjinë dikush nuk përmbahet, nuk pyet njeri, është shturur fare. Është me këmbë në yzengji dikush
- ZAGAR** m. Mbeti (ra) si zagari (si ujku) në thekër shih tek UJK,~U I.
- ZAKON** m. Ujku qimen ndërrohet, por zakonin s'e harron shih tek UJK,~U 1.

- ZALL** m. Zall me zall kudo, në të gjitha anët; lart e poshtë. Gjallë e në zall shih te GJALLË. E la në zall e la pa ndihmë, pa përkrahje e pa kujdesje, e la ngushtë, e la në të keq. Mbeti në zall mbeti pa ndihmë e pa përkrahje, mbeti ngushtë, mbeti në të keq. Mbeti si guri në zall (në ujë, në lumë) shih te GUR,~I. Mbeti si peshku në zall (pa ujë) shih te PESHK,~U.
- ZAMAN** m. vjet. Mot e zaman shih te MOT,~I.
- ZANAT** m. La zanatin e zuri zurnanë përdoret kur dikush lë një punë të rëndësishme e më të mirë dhe zë një punë pa rëndësi e pa shumë dobi. Sa ka zanati! edhe iron. ka punë e gjëra që i njeh mirë vetëm ai që merret me to dhe që s'mund t'i dinë të gjithë, duhet ta njohësh mirë një punë që ta bësh si duhet.
- ZAR** m. Zaret u hodhën u bë hapi vendimtar dhe pritet përfundimi, u bë një hap i tillë që nuk lejon më të kthehesh prapa, u hodh guri. Luaj (hedh, përdor) zarin (letrën, kartën, gurin) e fundit shih te FUNDIT (i, e).
- ZAVËZ** f. Ia bëri zavë ia mblodhi rripat. Nuk ia mban zava shih te MBAJ.
- ZBARDH** kal. Zbardh (hap, zbulon) dhëmbët keq. zgërdhiet; qesh me të tallur. Zbardhi sytë mospërf. vdiq.
- ZBARDHEM** vetv. Iu zbardhën buzët shih te BUZ/Ë,~A. Kur të zbardhet penda e korbit shih te KORB,~I. Sa të zbardhet penda e korbit shih te KORB,~I.
- ZBATHUR** ndajf. Fle zbathur shih te FLE.
- ZBEHTË** mb. Tërshërë e zbehtë bot. shih tek TËRSHËR/Ë,~A.
- ZBËRTHEJ** kal. I zbërthen brinjët keq.
- ZBRAZ** kal. I zbrazi (hapi, i zbuloi) barkun dikujt
- ZBRAZËT** mb. Me bark të zbrazët i uritur, i pangrënë, me barkun bosh. Me xhep të zbrazët pa para; i varfër. Mbeti me lugë të zbrazët (bosh) mbeti fare pa gjë;
- s'ka ç'të hajë. Ngopet me lugë të zbrazët (bosh) kënaqet pa gjë, gënjehet shpejt, mashtrohet lehtë; gënjen veten, u beson lehtë fjalëve a premtimeve.
- ZBRAZUR** ndajf. E nxori (e përcolli, e qiti) me duar zbrazur (me duar thatë, me duar bosh) shih te THATË 3.
- ZBRES** jokal. I zbriti (i ra) damari shih te DAMAR,~I. Zbriti (ra, u rrëzua) nga fiku iron. shih te FIK,~U. Zbriti (ra) nga froni shih te FRON,~I 3. Zbriti nga fuqia ra nga pushteti, nuk ka më pushtet. I zbritën (i ranë) kacabunjtë shih te KACABU,~NI. I zbritën
- ZBULOHEM** vetv. Iu zbuluan (i dolën) lakrat lakrorit shih te LAK/ËR,~RA.
- ZBULOJ** kal. I zbuloi (i zbrazi, i hapi) barkun dikujt shih te ZBRAZ. Zbulon (zbardh, hap) dhëmbët keq. shih te ZBARDH. I zbuloi (i hapi) kartat (letrat) shih te HAP. I zbutoj rrënjët dikujt a diçkaje s'lë gjë pa mësuar për të, ia gjej të gjitha. E zbuloi veten e tregoi veten se ç'është, nuk fshihet më; demaskoi vetveten.
- ZBULUAR** ndajf. Me bark zbuluar pa fshehur gjë, hapur. Paske fjetur zbuluar iron. nuk qenke në qejf, nuk qenke mirë.
- ZBUT** kal. I zbuti (i shoi, i ftohu, i uli, i shtroi) gjakrat shih te GJAK,~U I. Ia zbuti kurizinin (shpinën, brinjët) keq. e rrahu fort, e rrahu keq, e rrahu mirë e mirë. Ia zbuti (ia uli) zërin shih tek UL.
- ZBUTEM** vetv. Iu zbut gjaku dikujt shih te GJAK,~U I. U zbutën (u ftohën, u ulën, u shuan, u shtruan) gjakrat shih te GJAK,~U I. Iu zbut zemra dikujt shih te ZEM/ËR,~RA.
- ZDRUKTH** m. E futi në zdrukth dikë ia rregulloi mirë dikujt, e gdhendi. Ka zdrukth të fortë dikush. shih Ka limë të fortë dikush te LIM/Ë,~A.
- ZEJE** f. Ia mori zejen diçkaje e mësoi diçka, e përvetësoi mirë; ia mori dorën një pune.
- ZEKTH** m. I ka hyrë (i ka hipur, i ka kërcyer) zekthi (miza)

- ZEMËR** f. Ia biroj zemrën (shpirtin) shih te BIROJ. Më bren (më ha) zemra dyshoj për dikë a për diçka, më ha dyshimi. Më bren zemrën më shqetëson vazhdimisht, nuk më lë të qetë një dyshim a një çështje që kërkon zgjidhje. I broftë zemra shih te BROF.
- ZERO** f. Zero me bisht (me xhufkë) keq. shih te BISHT, ~I. Zero absolute fiz. temperatura $-273, 16^{\circ}C$, në të cilën vëllimi i një gazi do të ishte i barabartë me zero.
- ZEZË** f. Në të zezë aty ku duhet, mu në qendër, në pikën kryesore. Mori të zezën shih te MARR. E piu e zeza shih te PI. I punoi të zezën shih te PUNOJ 20. Për të zezë të thoit shih te THUA, THOI. Sa e zeza e thoit shih te THUA, THOI. E bën (e paraqit) të bardhën të zezë (të zezën të bardhë) keq. shih te BARDH/Ë, ~A (e). Ndaj të bardhën nga e zeza shih te BARDH/Ë, ~A (e)9. E zeza e syrit (të zitë e syrit) pjesa e rrumbullakët me ngjyrë të zezë, kafe etj., që rrethon beben e syrit, irida.
- ZË** m. S'bëj zë
- ZË** kal. Zë (bëj) be betohem. I zë besë i besoj. Ia zuri bicen dikujt shih te BIC/E, ~JA.
- ZËNË** mb. I ka duart të zëna (të lidhura) shih te LIDHUR (i,e).
- ZGRIP** m. Është me (në) zgrip
- ZGJAT** kal. I zgjati (i shtriu) dorën dikujt shih te SHTRIJ. E ka zgjatur gjuhën (gojën) keq. është bërë llafazan, merr nëpër gojë dikë a diçka, flet shumë kundër dikujt a diçkaje, e shan dikë; merret me thashetheme. Zgjati hundët keq. u përzie në punët e dikujt tjetër, fut hundët në çështje që nuk i përkasin. Zgjat krahët (duart, gishtërinjtë) keq. shtrin e përhap ndikimin e vet. E zgjat muhabetin me dikë bëhet i afërt me dikë, afrohet shumë me të. I zgjat (i shtrin) qafën dikujt shih te QAF/Ë, ~A. I zgjati veshët u mundua të dëgjojë një zë të largët a të dobët, vuri veshin me kujdes për të dëgjuar diçka; përgjoi. I zgjati (i hoqi, i tërhoqi, i shkuli) veshin (veshët) dikujt shih te VESH, ~I. Ia zgjati veshët dikujt ia rriti mendjen me lëvdata, e lëvdoi më shumë nga sa e meriton. Më zgjate veshët shih te VESH, ~I. E zgjati gjuhën si lëpjetë (si lëpushkë) keq. foli jashtë mase, foli gjëra të panevojshme ose të papëlqyera e të pahijshme. Zgjati (shtriji) këmbët sa ke jorganin (plafin, shtratin) fj.u. shih te JORGAN, ~I.
- ZGJATEM** vetv. I janë zgjatur (i janë rritur) thonjtë keq. shih te THUA, THOI.
- ZGJEBE** f. mjek. veter. Bari i zgjebes bot. shih te BAR, ~I I.
- ZGJEBOSUR** mb. Dhi e zgjebosur (e zgjebur) e bishtin përpjetë (bishtpërpjetë) tall. njeri i pavlerë, por mendjemadh; hem qeros, hem qibar.
- ZGJEBUR** mb. Gur i zgjebur bigorr.
- ZGJEDH** kal. Ia zgjodhi mendjen ia bleu mendjen.
- ZGJEDHË** f. Hyri në zgjedhë u nënshtua. S'i ka rënë zgjedha në vesh nuk ka hequr shumë, nuk ka vuajtur e s'e njuh jetën, s'e ka vrarë puna. Vuri (futi) qafën në zgjedhë ia hyri vetë një pune të rëndë e të vështirë. Demin e shtron zgjedha fj.u. njeriun e sertë e shtron puna.
- ZGJIDH** kal. Lidh e zgjidh dikush shih te LIDH. I zgjidh duart dikujt i jep mundësi të veprojë e të bëjë ç'të dojë, i lë dorë të lirë. Ia zgjidh gjuhën (gojën) dikujt e bën a e nxit që të flasë; e detyron t'ia thotë hapur të gjitha sa ka. E zgjidhi gjuhën (gojën) filloi të flasë e të tregojë për diçka që e mbante të fshehtë. E zgjidhi (e hapi) qesen (kuletën, trastën) nuk i kurseu paratë; ndryshe nga zakonisht, u tregua dorëhapët, u bë dorëlëshuar. E zgjidhi thesin
- ZGJIDHEM** II vetv. As lidhet, as zgjidhet shih te LIDHEM. Iu zgjidh (iu çel) gryka thesit shih te GRYK/Ë, ~A. Iu zgjidh gjuha (goja) dikujt filloi të flasë lirisht, filloi ta thotë hapur mendimin e tij; e theu heshtjen.

- ZI** as. Me të zi me vështirësi, me zor, mezi. Hiqnin (vuanin) të zitë (lëngun) e ullirit shih tek ULLI,~RI. Të zitë e syrit (e zeza e syrit) shih te ZEZ/Ë,~A (e).
- ZI** ndajf. Bardhë e zi shih te BARDHË. Sheh zi shih te SHOH. I sheh (gjërat) bardhë e zi shih te BARDHË.
- ZI** mb. Ari i zi shih tek AR,~I I. Faqja e zezë turp i madh; çnderim që i bëhet dikujt dhe që i lë njollë për tërë jetën. Me faqe të zezë me turp. Për faqe të zezë për turp.
- ZIEJ** kal. I zien (i vlon, i lëvrin) gjaku shih te GJAK,~U I. Zien kazani shih te KAZAN,~I. Zien si kazan shih te KAZAN,~I. Ziejnë në një kazan janë të gjithë njëlloj.
- ZIGJ** m. Vjen në zigj dikush përmirësohet, ndreqet, piqet.
- ZIHEM** vetv. U zu (u kap) për fyti (për gryke) me dikë shih te FYT,~I. Iu zu (iu tha) gjuha nuk flet dot asnjë fjalë (nga një shqetësim a tronditje, nga turpi etj.), iu kyç goja. Nuk zihet në hesap shih te HESAP,~I. Sikur është zënë në mulli tall. shih te MULLI,~RI. Nuk zihet (nuk mbulohet) dielli me plisa fj.u. shih te DIELL,~I. Nuk zihet (nuk mbulohet, nuk fshihet) dielli me shoshë fj.u. shih te DIELL,~I. Iu zu shpirti ngjak shih te NGJAK,~U.
- ZIHET** vetv. Zihet në lëng të vet shih te LËNG,~U.
- ZILE** f. Derr me zile shar. fare i pagdhendur, shumë i trashë nga mendja; i pabindur.
- ZINXHIR** m. Dredh (tund) zinxhirin (tespihet) rri kot, e kalon kohën kot, vret miza. Si qeni i lëshuar nga zinxhiri që nuk përmbahet dot, që vepron pa fre.
- ZJARR** m. U bë zjarr u inatos a u nxeh shumë, sa s'e përmban dot veten. U bë për zjarr (për prush) diçka shih te PRUSH,~I. I ka rënë zjarri (flaka, flama) shih te BIE I. Djeg me (në) zjarr përvëlton, asgjëson. I fryn zjarrit shih te FRYJ. I futi zjarrin (flakën) shih te FUT. Hidhet (futet) në zjarr (në flakë) shih te FLAK/Ë,~A. I hyri zjarri (në shtëpi) i hyri grindja e përçarja në shtëpi. I dha zjarr (flakë) diçkaje shih te JAP. Luan me zjarrin përzihet në diçka të rrezikshme që mund të dëmtojë rëndë atë vetë, rrezikon shumë duke bërë diçka. Mori zjarr (hëna, horizonti) shih te MARR. Merr zjarr (flakë) diçka shih te FLAK/Ë, ~A. Mori zjarr puna etj. shih te MARR. Prova e zjarrit një detyrë e vështirë, me kryerjen e së cilës dikush provon se është i aftë a i përshtatshëm për punë, për t'i besuar diçka. Solli (futi) zjarrin (në shtëpi) solli grindjen e përçarjen në shtëpi. E shoi zjarrin shih te SHUAJ. Si uji me zjarrin që nuk i bashkon asgjë, që janë kundër njëri-tjetrit. Vatër zjarri vend që mund të shërbejë si pikënisje për të ndezur luftën. I vuri zjarrin (flakën, fitilin, pishën) shih te PISH/Ë,~A. Zjarr (flakë) kashte shih te KASHT/Ë,~A. Zjarr për zjarr pa e zgjatur fare, menjëherë, aty për aty, flakë për flakë. Iu bë vendi zjarr nuk i rrihej më në atë vend, rrinte si mbi prush. I del zjarr (tym, flakë) nga koka shih tek TYM,~I. E do si zjarrin në gji nuk e do fare, nuk mund ta durojë dot; e urren.
- ZOG** m. Nxjerr (çel) zogj iron.
- ZONJË** f. Zonjë e bukur bot. helmarinë. Zonjë e mirë euf. sëmundja e lisë. Lule zonje bot. shih te LUL/E,~JA.
- ZORRË** f. kryes. sh. I dolën zorrët (përjashta) vulli shumë; i erdhi shumë ndot. Ia derdhi zorrët dikujt thjeshtligj. shih te DERDH. Më gërvishti zorrët shih te GËRVISHT 2. E gërryen zorrët (e gërreu barku) për bukë shih te GËRRYEJ. Më grinë zorrët shih te GRIJ.
- ZOT** II m. I dal (për) zot
- ZOTI** m. vet. tr. e shquar. S'e njuh qeni të zotin shih te QEN,~I. Shan shtamba të zotin iron. shih te
- ZURNA** f. muz. La zanatin e zuri zurnanë shih te ZANAT,~I.

- ZVARRANIK** mb. Krehër zvarranik lloj krehri që përdoret për të krehur e për ta bërë me push shajakun.
- ZVARRË** ndajf. Me brekë zvarrë (nëpër këmbë, nëpër shalë) thjeshtligj. tall. shih te BREKË, ~T. Hiqet zvarrë (rrëshqanë)
- ZVERDHEM** vetv. Iu zverdh hunda dikujt shih te HUND/Ë, ~A. As skuqet (kuqet) as zverdhet (verdhet) shih te SKUQEM 7.
- ZVERK** m. I fërkoj zverkun (krahët, kurizin, shpatullat, shpinën) dikujt shih te FËRKOJ.
- ZVOGËLOHEM** vetv. Iu zvogëluan sytë i erdhi gjumi, s'duron dot më pa gjumë.
- ZH** Nga a-ja deri te zh shih tek A I.
- ZHABË** f. zool. S'këndon zhaba në të thatë fj. u.
- ZHAPI** m. zool. Flet hardhje e zhapij shih te HARDHJ/E, ~A.
- ZHDREJTË** mb. Kundrinë e zhdrejtë gjuh. shih te KUNDRIN/Ë, ~A. Ligjëratë e zhdrejtë gjuh. shih te LIGJËRAT/Ë, ~A I. Rasë e zhdrejtë gjuh. shih te RAS/Ë, ~A.
- ZHDUK** kal. Zhduk me një vijë (pene) diçka libr. shih te VIJ/Ë, ~A.
- ZHIBËL** f. S'ia heq zhiblën nga syri dikujt nuk i jep as ndihmën më të vogël, kur ka nevojë.
- ZHIVË** f. Zhivë e bardhë kim. kripë shumë e helmët e zhivës, që përdoret si lëndë dezinfektuese dhe në kozmetikë.
- ZHUBËL** f. E bëri zhubël dikë e shau keq dikë, e bën leckë; e mundi keq, e dërrmoi, e shpartalloi (në një lojë).
- ZHUR** m. Di (njeh) zhurin e detit di shumë gjëra, s'ka gjë që s'di. Ka zhurin e detit ka me shumicë.
- ZHVESH** kal. E zhveshi pallën filloi të qortojë, të godasë a të kërcënojë hapët të tjerët; filloi të bëjë shumë krime e të këqija.
- ZHVESHUR** mb. Me sy të zhveshur shih Me sy të lirë te LIRË (i, e) 6.
- ZHVESHUR** ndajf. Me pallë (me shpatë, me thikë) zhveshur me të egër, me kërcënim e me të keq; duke përdorur forcën.
- ZHYEJ** kal. Ia zheu faqen dikujt e turpëroi, e fëlliqi.
- ZHYHEM** vetv. Iu zhye faqja u turpërua, u fëlliq.
- ZHYT** m. Zhyt e mbyt me të keq, me shumë mundime, me shumë telashe e halle mbi kokë, keq e keq.